



# TRIODI KATANIKTIK

**Përzgjedhje**

**Botim i Manuskripit të Bishkëpsisë të Paraklitit  
(Ngoshtëllimtarit)  
Gropos-Atikë, Greqi, 2019**



# TRIODI KATAKTIK

**Përzgjedhje**

*Përktheu  
Atë Justin Anthimiadhi*

**Botim i Manastirit të Hirshëm të Paraklitit  
(Ngushëllimtarit)  
Oropos-Atikë, Greqi, 2019**



Titulli i origjinalit: Τριώδιον Κατανυκτικόν

**Triodi, një nga thesaret e çmuara të Kishës,**  
jepet dhuratë për vëllezërit tanë të dashur klerikë dhe psaltë  
të Shqipërisë

© Manastiri i Hirshëm i Paraklitit, Oropos-Atikë, Greqi

*Duhet të kihen gjithmonë parasysh Udhëzimet në fillimin e volumit të parë të Mujorëve, si p.sh. se “Në Leximet biblike të Dhiatës së Vjetër mbajmë qëllimisht, me vetëdije gabimet letrare që ajo ka”.  
Germat e pjerrëta të këndimet biblike i kemi shtuar që të na ndihmojnë për t’i kuptuar më mirë.*

O Perëndi, mëshiroji dhe shpëtoji ata që bashkëpunuan me shpirt dhe u lodhën për himnin Tënd. Amin.

Lejohet kopjimi i citimeve biblike, por të referohet burimi.

Επιτρέπεται ή άντιγραφή τών βιβλικών παραπομπών μέ μόνη τήν άναφορά τής πηγής.

Copyrighting of biblical quotes are permitted; it is necessary only to reference the source.

Разрешается выписка библейских цитирований; необходимо сделать ссылку на источник.



## *Krishti me kurorë gjembash*

*Skicuar me dorën e të ndjerit Ilia Xhokaxhi, në periudhën e persekutimeve.*

*Piktori ia dhuroi përkthyesit.*





E DIELA  
E DOGANIERIT DHE E FARISEUT  
NË MBRËMËSORE

*Thirrto: 7 ngjallësore dhe 3 Idhiomele të Triodit:  
Ting. I*

Le të mos falemi farisianisht, o vëllezër; se ai që lartëson veten e tij do të përunjët;<sup>1</sup> le të përulemi si Publikani përpara Perëndisë me agjërim, duke thirrur: Ki mëshirë për ne mëkatarët, o Perëndi.\*

(2x)

Fariseu, i mundur nga lavdidashja e rreme, dhe Publikani, i epur nga pendimi, të erdhën ty, Zotit të vetëm;<sup>2</sup> por njëri, duke u mburrur, u privua nga të mirat, ndërsa tjetri, duke mos folur, u denjësu për dhurata; me këto psherëtimat përforcomë, o Krisht Perëndi, si njeridashës.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

O Zot i tërëpushtetshëm,<sup>3</sup> e di sa forcë kanë lotët, sepse Ezekian e ngritën nga dyert e vdekjes,<sup>4</sup> Mëkatarin e çliruan nga fajet kronike,<sup>5</sup> ndërsa Doganierin e drejtësuan mbi Fariseun; të lutem pra, si të më

numërosh tok me ta, mëshiomë.

Tani *Hyjlandësore*  
*Dogmatike e Tingullit të javës*

*Pasvargje ngjallësore*  
Lavdi *Ting. Tërth. I*

Duke qenë sytë e mi të rënduar prej paligjësave të mia, nuk mund t'i ngre e të shoh eterin; po pritmë të penduar si Publikanin, o Shpëtimtar, dhe mëshiomë.

Tani *Hyjlandësore*

Tempull dhe derë<sup>6</sup> je, pallat dhe fron<sup>7</sup> i mbretit, o Virgjëresh' e gjithënderuar; me anën e së cilës shpërblyesi ynë Zoti Krisht ndriti mbi ata që flinin n'errësirë duke qenë Diell drejtësie<sup>8</sup> dhe duke dashur të ndriçojë ata që gatoi me dorën e vet<sup>9</sup> pas korës së tij.<sup>10</sup> Prandaj, o e gjithëhimnuar, duke pasur përpara tij guxim nënor, ndërmjeto papushuar, që të shpëtohen shpirtat tanë.\*

*Përlëshore ngjallësore*



## NË MËNGJESORE

*Shërbesa e zakonshme. Kanunet: Ngjallësori në 4, Kryqngjallësori në 2, i Hyjlindësës në 2 dhe i Triodit në 6 (Poezi e Gjergjit):*

*Ting. Tërth. II*

*Ode I*

*Os en ipiro pezefsas*

Me parabol' na drejton Krishti gjithë ne,\* që ta ndreqim jetën ton',\* Doganierin lart e ngre\* nga përlulesia pra,\* e shfaq krenaria Fariseun qart' të ulët keq.

Meqë sheh rënie të tmerrshme prej krenaris'\* dhe çmim prej përlulesis'\* që çon lart, urrejtje ki\* për mëkatin farisian\* edhe ki zili të mirat që kish Tagrambledhësi.

Të mirat mbarë i zbraz marrëzia krejt,\* ndërsa me përlulesi\* çdo e keqe bie posht',\* ndaj ta duam qartësisht,\* besnikë, ta neveritim sjelljen lavdidashëse.

Mbreti i çdo gjëje donte që Nxënësit\* të mos kishin mburrje hiç,\* i mësonte pra ata\* dhe i nxiste të kishin\* përlulje dhe psherëtimë mu si Tagrambledhësi.

Me psherëtimë dhe vuajtje pa pushim\* pors i Publikani, Zot,\* përdëllimit tënd i vij\* pra tani; më dhembshuro\* dhe mua që tashmë po jetoj përlulesisht dhe thjesht.

*Hyjlindësor*

O Zonjë, ty të besoj mendje, frymë, trup,\* pritje, shpirt, vullnet, kështu\* më çliro dhe më shpëto\* nga çdo ngasje, çdo armik\* i tmerrshëm, çdo kërcënim i ardhshëm dhe nga çdo dënim.

*(Zbritësoret e Ipapandisë, nëse nuk është mbyllur akoma e kremtja; ndryshe:)*

*Zbritësore: Os en ipiro pezefsas*

»Si në sterë Izraeli kaloi leht'\* dhe në këmbë, duke par'\* Faraonin, ndje-

»kësin,\* mbrapa gjurmëve të tij,\* të »zhytej; thërriste: Zotit t'i këndojm' këng' »mundëse.<sup>11</sup>

*Ode III*

*Uk estin ajtos os si*

Nga plehra kafshësh dhe çdo ves\* ngrihet çdo i përlulur;\*<sup>12</sup> ndërsa bie prej lartësisë tmerr çdo kryelart',\* pra prej virtetit, ndaj ne\* le ta shmangim sjelljen e tij plot vese.

E remja lavdidashje zbraz\* çdo drejtësi të pasur,\* por përlulja shpërbën shumicën e pasioneve.\* O Shpëtimtar, imitojm'\* Doganierin, shfaqna dhe ne tok me të.

Si Tagrambledhësi, dhe ne,\* duke goditur gjoksën,\* "Perëndi edhe Zot", me kataniks thërrasim pra,\* "të vijë keq, falna ne\* mëkatarët", që si ky të ndjehemi.

Besnikë, të fitojmë zell,\* arritje butësie,\* të jetojmë përlulesisht me qarje, psherëtim' \* prej zemre, lutje; kështu\* do të marrim ndjes' prej Perëndisë Zot.

Të flakim çdo vëllim të madh\* pra që ka fodullëku,\* dhe marrosje të frikshme, madhësi me neveri,\* dhe arrogancën plot tmerr\* dhe pa vend të Fariseut ndaj Zotit.

*Hyjlindësor*

Përikja jon' e vetme je,\* o e Dëllirë, ndaj kam\* un' besim te ti, të mos bie nga e mira shpres',\* përkrahjen tënde ta gjej,\* të shpëtoj nga çdo dëm i së keqes pra.

*Zbritësore: Uq estin ajtos os si*

»Nuk ka të shenjtë pra si ti,\* o Perëndia »im, Zot,\* që e ngrite lart bririn e besnikëve »të tu\* dhe na forcove<sup>13</sup> të gjith',\* o i mir', »mbi gurin e pohimit<sup>14</sup> tënd.

*Ndenjëso*

*Ting. IV Tahi prokatâlave*



Përluja e ngriti të ngrysurin fort Publikan,\* që ish plot turp, dhe Krijuesit i thirri: "Për mua qyqin të vijë keq";\* por Fariseun, folës\* me të madhe, e hodhi\* mburrja nga drejtësia; për të mirat të kemi\* pra zell dhe nga të këqijat ne të largohemi.

Lavdi

Përluja dikur e ngriti Tagrambledhësin lart,\* se thirri me qarje "të të vijë keq", dhe e drejtësoi; ta imitojm'\* gjithë ne pra që ramë\* thellësisht në të keqe;\*<sup>15</sup> prej thellësis' së zemrës,<sup>16</sup> Shpëtimtarit t'i themi\* me zë: Bëmë faj, na fal, i vetmi njeri-dashës.

Tani *Hyjindësore*

O Zonjë, pranoji shpejt lutjet që ty të ofrojm',\* blatoji këto te Biri yt edhe Perëndia, o e panjollshmja Zonj';\* nga çdo rrezik, nevojë\* sa te ti rendin, ngriji;\* kurthet dhe arrogancat e armiëve të pafe,\* që kundër nesh armatosen, mposhti, e pastër krejt.

Ode IV

*Hristós mu dhinamis*

Fjala, pasi u përlu deri në formë shërbëtori,<sup>17</sup> e tregoi përlulësinë si udhë të shkëlqyer ngritjeje. Çdokush që e imiton atë, lartësohet duke u përlulur.

Fariseu i drejtë u lartësua, ndaj ra poshtë; ndërsa Doganieri, i mbushur me mori të këqijash, u përlu, ndaj u lartësua, duke u drejtësuar papritur.

Budallallëku u shfaq shkak varfërie nga pasuria e virtyeteve, ndërsa nga ana tjetër përlulësia shkak për fitim drejtësie nga mospasja e skajshme; atë ta zotërojmë.

O Zot, parathe se patjetër u kundërvihesh kryelartëve dhe u jep të përlulurve hirin tënd;<sup>18</sup> tani që u përlulëm, na dërgo hirin

tënd, o Shpëtimtar.

Zoti Shpëtimtar, duke na ngjitur përgjithmonë drejt lartësimi të hyjshëm, tregoi përlulësinë që shkakton lartësim, se i lau mirë me vetë duart e tij këmbët e Nxënëseve.<sup>19</sup>

*Hyjindësor*

Përderisa, o Virgjëreshë, linde dritën e pafuëshme,<sup>20</sup> shpërbëje errësirën e shpirtit tim me lavd ndriçues dhe drejtoje jetën time në udhë shpëtimi.

*Zbritësore: Hristós mu dhinamis*

» "Fuqia ime Krishti, Perëndia, është",\*<sup>21</sup>  
» psal me mendje të pastër edhe thërrret,\*  
» siç e meriton pra Zoti, Kisha jon' e vyer  
» fort\* dhe feston në Krishtin me hare.

Ode V

*To thio feji su agathé*

Le të nxitojmë të imitojmë virtytet e Fariseut dhe të kemi zili përlulësinë e Doganierit, duke urryer absurditetin që kishte secili nga ata, pra marrëzinë dhe prishjen për shkak të shkëlqeve.

Udhë e drejtësisë<sup>22</sup> u zbulua si boshe kur Fariseu e bashkoi me egoizmin; ndërsa Publikani, pasi e fitoi si shoqëruese përlulësinë, e shfaqti virtyt lartësues.

Fariseu mendonte sikur vraponte në virtyte si karrocier, por Tagrambledhësi, pasi e lidhi keqardhjen me përlulësinë, edhe pse këmbësor, parakaloi karrocën që lëkundej, dhe arriti mirë para saj.

Pasi ta zhvillojmë të gjithë në mendje paravolinë e Doganierit, e jani ta kemi zili me lot atë, duke i sjellë Perëndisë shpirt të dërrmuar<sup>23</sup> dhe duke kërkuar ndjesën e mëkateve.

O të mençur, le ta zmbarsim mënyrën e Fariseut, e cila ishte kryelartë, dashakeqe,

egoiste, arrogante, e tmerrshme dhe fudulle, që të mos zhvishemi nga Hiri hyjnor.

### *Hyjlindësor*

**O** e Mirë, na dërgo shkop fuqie gjithë neve që përkim te ti, na bëj të mbizotërojmë në mes të tërë armiqve<sup>24</sup> dhe na ruaj nga çdo dëm.

### *Zbritësore: To thio fegji su agathé*

»Me drit' hyjnore, i miri ti,\* shpirtrat »e atyre që po mëngojnë<sup>25</sup> me mall për »ty, shndriti - lyp - \* të të njohin, Fjalë e »Perëndis', Zot<sup>26</sup> vërtet,\* që rithërret nga »mjegulla e mëkateve.

### *Ode VI*

#### *Tu viu tin thálasan*

Vrapuan së bashku dy\* si në stadium në jet':\* një Farise, një Doganier,\* por u zhyt njëri plot turp, dhe u hodh posht'\* nga idiotësia tmerr,\* dhe shpëtoi pra tjetri me përlulesi.

**N**e, duke arritur mir'\* përfundim në drejtësi\* në jetë, le ta imitojm',\* pra ta kemi zili shpirtin doganor,\* të kemi jet' fare larg\* nga çdo fryrje plot neveri farisiane.

**T**a kemi zili sjelljen\* e Jisuit Shpëtimtar,\* përlulesin' e tij, krejt ne\* që fort duam të gjejmë suksesshëm lart\* fushim pa fund plot me gaz,\* kur të rrimë në vendin e të gjallëve.<sup>27</sup>

**E** shfaqe te Nxënësit\* që e kishe, o Krisht Zot,\* përlulesin' që lart na çon,\* kur e ngjeshe përparësen në mes dhe\* u lave krejt këmbët pra\* dhe i bëre ta imitonin sjelljen drejt.<sup>19</sup>

**J**etesën e kishin veç:\* Fariseu me virtyt\* dhe Publikani plot mëkat,\* por nga fryrja e çmendur pësoi keq,\* ra njëri, dhe lart u ngjit\* tjetri kur i përlulur në mendim u shfaq.

### *Hyjlindësor*

**N**ë jetë pa djallëzi,\* lakuriq në thjeshtësi\* isha gatuar, por me rrob'\* faji, me trashësi mishi, Vajzë, pra,\* më veshi armiku im;\*<sup>28</sup> por shpëtohem tani me ndërmjetimin tënd.

### *Zbritësore: Tu viu tin thálasan*

»Ja detin e jetës tash\* e shikoj të ngrihet »prej\* furtune ngasjesh ashpërsisht,\* »te limani yt shumë i qetë rend\* edhe »të thërras: Ma ngri\* shpirtin tim, o »mëshirëplot', nga prishja pra.<sup>29</sup>

### *Kontaqi*

#### *Ting. IV Epefanis simeron*

**F**ariseu fliste lart\* kot, ndaj t'i ikim,\* dhe përluljen me rënkim\* që Tagrambledhësi pra kish,\* le ta mësojm'; Shpëtimtarit Zot\* le t'i thërrasim: I vetmi i mir', na fal.

### *Tjetër*

#### *Ting. III I Parthenos simeron*

**L**e t'i sjellim Perëndis'\* pra psherëtim' Publikani,\* le t'i bëjmë metani\* ne mëkatarët pors i Zot,\* se ky do\* që tërë njerëzit të shpëtojnë,\*<sup>30</sup> ndjesë jep\* dhe sa pendohen, i fal të gjithë,\* se për ne u mishërua,\* sado me Atin është' Perëndi pa fillim.

### *Shtëpia*

**O** vëllezër, le ta ulim të gjithë veten tonë, me psherëtim dhe vajtime le ta vrasim ndërgjegjen,<sup>31</sup> që atëherë, atje në gjykimin e amshuar,<sup>32</sup> të shfaqemi besimtarë të pafajshëm, pasi të kemi marrë faljen; sepse atje është me të vërtetë prehja, për të cilën tani le të përgjërohemi ta kemi; andej, prej Edenit të mrekullueshëm,<sup>33</sup> u arratisën dhimbja, trishtimi dhe psherëtimat<sup>34</sup> e thella; atë, Edenin, e bëri Krishti, që me Atin është' Perëndi pa fillim.



*Sinakari i Mujorit dhe i sotëm:*

Në të njëjtën ditë, kujtojmë paravolinë e Doganierit dhe të Fariseut nga Ungjilli i hyjshëm i Llukait.

*Vargje:* Nëse sillesh si Fariseu, qëndro larg kishës,/ sepse brenda saj është Krishti, i cili pret të përlulurit.

*Vargje për Triodin:* O Krijues i të lartave dhe i të poshtmeve, pranoje/ nga engjëjt himnin trishenjtor<sup>35</sup> dhe nga njerëzit Triodin.

Me ndërmjetimet e gjithë shenjtoreve që bënë vepra të mëdha, o Krisht, Perëndia ynë, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

*Ode VII**Dhrosovolon men tin káminon*

Fariseu, duke u mburrur për veprat e drejtësisë, u zu mjerisht në lak lavdie bo-she, ngaqë u krenua pa masë; ndërsa Doganieri, duke u ngritur në krahun e lehtë të përlulësisë, u afrua te Perëndia.

Doganieri, meqenëse e përdori mënyrën e përluljes si shkallë, u ngjiti drejt lartësisë së qiejve; ndërsa Fariseu mjeran, kur u lartësua me anë të mendjelehtësisë së rreme të egoizmit, përfundoi në bodrumin e Hadhit.<sup>36</sup>

Djallëzori përpiqet t'i vjedhë të drejtët duke ngritur kurthe me mënyra të rreme lavdëdashjeje, ndërsa i lidh mëkatarët me leqe dëshpërimi; por ne që e kemi zili Doganierin, le të nxitojmë pra të çlirohemi nga të dyja të këqijat.

Le të biem në gjuhë para Perëndisë me lutje, lot dhe psherëtima të nxehta, duke imituar përluljen lartësuese të Publikanit, o besnikë, dhe duke kënduar: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.<sup>37</sup>

Duke i këshilluar me mësimdhënie Nxë-

nësit, o Zot Shpëtimtar, u parathoshe të mos mendonin lart, por të bashkoheshin me të përlulurit;<sup>38</sup> prandaj të thërrasim ne besnikët: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.<sup>37</sup>

*Hyjindësor*

Të njohim, o e Thjeshtë, si bukurinë e Jakovit<sup>39</sup> dhe shkallën e hyjnueshme të tendosur nga poshtë drejt lartësisë, të cilën e pa më parë ai<sup>40</sup> dhe e cila zbrit nga sipër Perëndi të mishëruar dhe njëkohësisht ngre lart vdekatarë.

*Zbrjtësore: Dhrosovolon men tin káminon*  
»Nj' engjëll furrën vesëprurëse e bëri për »Djemt' oshënarë, ndërsa kaldenjt',\* me »një urdhër që\* Perëndia dha, u dogjën »krejt.\*<sup>41</sup> Tiranu i bind, prandaj thërret:\* »Je i bekuar ti, o Perëndi!<sup>42</sup> i etërve tan'.

*Ode VIII**Ek flogós tis ostis*

Nëpërmjet mendimit të përlulur, Doganieri, kur psherëtiu, e zbuti Zotin dhe shpëtoi; ndërsa, nëpërmjet mënyrës së keqe të gjuhës që fliste me fodullëk, Fariseu ra nga drejtësia.

O shpresëplotë, le të largohemi nga fryrja e vullnetit dhe nga epiteli i pastërtisë së Fariseut, duke pasur zili mirë mendimin dhe përluljen e Doganierit, e cila u mëshirua.

O shpresëplotë, le të themi në kishën e shenjtë fjalët e Doganierit: "O Perëndi, le të vijë keq", që tok me atë të marrim falje, pasi të çlirohemi nga sëmundja e mburrjes së Fariseut.

Le ta kemi zili të gjithë psherëtimën e Doganierit dhe, duke folur me Perëndinë me lot të nxehtë, le t'i thërrasim: O Njerëdashës, mëkatuam; o i dhembshur, i mi-

rë, le të të vijë keq dhe na shpëto.

Perëndia e aprovoi psherëtimën e Doganierit dhe, pasi e drejtësoi, u tregoi të gjithëve të përkulën përherë, duke kërkuar faljen e paudhësive nëpërmjet psherëtimave dhe lotëve.

### *Hyllindësor*

Nuk di përkrahje tjetër, përveç teje; ty të vë përpara si ndërmjetuese pranë atij që lindi prej teje, o e Dëllirë, e tërëpaqortueshme; çliromë nga të gjitha ato që më trishtojnë.

### *Zbritësore: Ek flogós tis osiis*

»Vesë nxore prej flakës tek oshënarët «ti,<sup>41</sup> dhe me ujë e dogje flin' e të drejtit «shenjti<sup>43</sup> vetëm me vullnetin tënd, o «Krisht, bën çdo gjë<sup>44</sup> ti; \* ne në gjithë «jetët të përmbillartësojmë.

### *Ode IX*

#### *Theón anthrópis idhín*

Përuļjen morëm si udh' për lartësim\* nga Krishti, ndaj zili ta kemi sjelljen dhe shembullin,\* tipin shpëtimtar të Tagrambledhësit pra,\* larg le ta hedhim mburrjen, fryrjen, dhe me mendim\* të përlur Zotin Perëndi ta zbutim gjithë ne.

TA zmbarsim budallallëkun shpirtëror\* dhe të fitojmë mendje krejt të drejtë përulesisht,\* ta urrejmë fryrjen e lavdisë së kot'\* dhe të përpiqemi të mos drejtësojm' veten,<sup>45</sup> por me Publikanin le ta zbutim Perëndinë Zot.

Krijuesit le t'i sjellim me trishtim\* lutje si Doganieri; por uratat me krenari\* fari-siane, mosmir'njohjen, zërin e lart'\* pra që të afërmin dënon, le t'i evitojm',\* që të përfitojmë dritë dhe të zbutim Perëndinë'.

Rëndohem unë nga një mori fajesh\* të shumta, tejkalova Doganierin në ligësi\*

me bollëk, përvetësoj dhe fryrjen në fjal'\* që Fariseu kish, nga çdo an' i shkretë jam,\* pa të mira, të të vijë keq për mua, Zoti im.<sup>46</sup>

Për lumturin' tënde denjësona pra\* ne që për ty në shpirt u varfëruam,<sup>47</sup> se sjellim drejt\* frymë të dërrmuar,<sup>28</sup> sipas nxitjes që jep\* urdhri yt; dhe, si ta pranosh, Shpëtimtari yn'\* Zot, shpëtona ne që po të adhurojmë besërisht.

Dikur në Tempull u ngjit një Doganier,\* me plot besim u lut te Perëndia, u bë i drejt',\* se, meqë me lot kish shkuar, me psherëtim'\* dhe me dërrmim në zemër,<sup>23</sup> poshtë e hodhi ky\* tërë barrën e mëkatit, se e zbuti Zotin krejt.

### *Hyllindësor*

Na bëj të të lumërojmë me himnin,\* me lavdërime ne pra që të nderim ty denjësisht,\* madhërojmë Birin tënd, e Tërë-dëllir,\* mburra e të krishterit dhe ndërmjetuesja,\* o e vetmja e bekuar, që të pret mir' Zoti Krisht.

### *Pas Zbritësoreve, i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor dhe Idhiomelet:*

#### *Lavdi Ting. Tërth. IV*

Hapmi dyert e pendimit, o Jetëdhënës, se shpirti im vjen qëmenatë<sup>25</sup> te tempulli yt i shenjtë,<sup>48</sup> duke sjellë tempullin e trupit,<sup>49</sup> krejt të përlur. Po ti si i dhembshur pastroje me përdëllimin tënd të mëshirshëm.\*

#### *Tani Hyllindësore I njëjti*

Drejtomë në rrugët e shpëtimtari, o Hyllindëse, sepse e ndota shpirtin me mëkate të turpshme, duke shkuar tërë jetën time me ngathtësi; me ndërmjetimet e tua pastromë prej çdo ndyrësie.\*

#### *Ting. Tërth. II*



*Varg:* Përdëllmë, o Perëndi, sipas përdëllimit tënd të madh dhe sipas dhembshurive të tua të shumta shuaje paudhësinë time.

Unë i mjeri, duke kujtuar mëkatet e shumta dhe të tmerrshme që kam bërë, dridhem nga dita e frikshme e gjyqit,<sup>50</sup> por, duke marrë guxim nga mëshira e dhembshurisë sate, si Davidi po të thërrres: Përdëllmë, o Perëndi, pas përdëllimit tënd të madh.<sup>51\*</sup>

Më të nderuarën. *Dhe Zbritësorja:*

*Theón anthrópis idhín*

» Nuk munden Zotin ta shohin njerëzit,<sup>52</sup> \* se rreshta engjëjsh s'kan' guxim ta shohin,<sup>53</sup> veçse nga ti, \* e Dëllirë, njerëzve » iu duk si njeri, \* Fjala e mishëruar,<sup>54</sup> e » madhështojmë ne, \* dhe të lumërojmë » me ushtritë engjëjlore tok.

*Dërgimësore ngjallësore dhe të Triodit:*

*Tis mathitēs sinéltōmen*

Të shmangim fjalë kryelart', \* të keqen farisiane, \* dhe të mësojm' përlësi\* të ndritur Doganieri, \* të ngrihem i duke thirrur\* drejt Zotit tok me të pra: \* Për ne shërbyesit e tu\* të të vijë keq, Krisht, që vullnetarisht\* linde nga e Virgjra dhe Kryq durove; \*<sup>55</sup> me veten botën ngrite ti, \*<sup>56</sup> Zot, me fuqi hyjnore.

*Hyjllindësore*

Perëndillindëse, nga ti\* Krijuesi i sferës\*<sup>57</sup> dhe Zoti i të gjithave, \* mori mish njerëzor pra, \* nga barku yt i pacenshëm, \* e tërëpërhimnuar; \* natyrën time mbarë ky\* e rinovoi se ishte prishur keq, \* më pas të la siç ishte para lindjes; \* të gjith' të mburrim me besim: \* Ki gaz, lavdi e botës.

*Lavdërime (me Vargjet e së dielës):*

*4 ngjallësore dhe 4 të Triodit:*

*Ting. I*

Le të mos falemi farisianisht, o vëllezër;

se ai që lartëson veten e tij, do të përunjet; le të përulemi si Publikani përpara Perëndisë me agjërim, duke thirrur: Ki mëshirë për ne mëkatarët, o Perëndi.\*

Fariseu, i mundur nga lavidashja e rreme, dhe Publikani, i epur nga pendimi, të erdhën ty, Zotit të vetëm;<sup>2</sup> por njëri duke u mburrur, u privua nga të mirat, ndërsa tjetri, duke mos folur, u ndjësua për dhuratat; me këto psherëtima mbështetmë, o Krisht Perëndi, si njeridashës.

*Ting. III*

Duke njohur ndryshimin midis Publikanit dhe Fariseut, o shpirti im, urreje zërin kryelartë të njërit, por ki zili lutjen me kataniks të tjetrit, dhe thirr: O Perëndi, le të të vijë keq për mua mëkatarin dhe përdëllmë.

Duke urreyer zërin mburacak të Fariseut, o besnikë, dhe duke pasur zill lutjen me kataniks të Publikanit, le të mos krenohemi;<sup>42</sup> por, duke përlurur veten, le të thërresim me kataniks: O Perëndi, na i fal mëkatet tona.

*Lavdi Ting. Tërth. IV*

O Zot, e dënove Fariseun që e drejtësonte veten<sup>49</sup> duke u mburrur për veprat, dhe e drejtësove Doganierin që u përlur dhe kërkonte mëshirë me psherëtimë; se ti nuk i pranon mendimet krenare dhe nuk i poshtëron zemrat e dërrmuara;<sup>28</sup> prandaj dhe ne po të biem ndër këmbë me përlësi ty që pësove për ne;<sup>58</sup> jepna ndjesën dhe përdëllimin e madh.<sup>59</sup>

Tani

E përmbibekuar

*Dhoksologjia e Madhe.*

*Duhet të dihet se nga kjo e diel deri në të Dielën e të Gjithë Shenjtorëve, Eothimonet psalen në Lititë e mëngjesit në Lavdi dhe*

**Tani; dhe se nga kjo e diel fillojmë të lexojmë në narteks, pas Përlëshimit të Litisë, Katekizmat e shën Theodor Studitit, që thuhën nga Igumeni ose, nëse nuk është, nga Tipikari, ndërsa vëllezërit rrinë dhe dëgjojnë. Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Triodit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore dhe e kishës. Kontaqi i sotëm Le t'i sjellim Perëndisë'.**

## CITIME

1. Matth. 23.12; Lluk. 14.11; 18.14
2. Jud. 4
3. II Kor. 6.18; Apok. 1.8; 4.8; 11.17; 15.3; 16.7; 19.6
4. IV [II] Mbret. 20.2-5
5. Lluk. 7.37-50
6. Jez. 44.1-4
7. II Kron. 18.18; Is. 6.1; Ez. 1.26; 10.1; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 32
8. Mal. 4.2 (3.20)
9. Gjen. 2.7-8,15; II Makk. 7.23; Ps. 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9
10. Gjen. 1.26; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
11. Eks. 14.21-15.1
12. Ps. 112(113).7
13. I Mbret [Sam.] 2.1-2
14. Matth. 16.16-18
15. Fja. Urt. 18.3
16. Ju. 8.14
17. Fil. 2.6-7
18. Fja. Urt. 3.34; Jak. 4.6; I Petr. 5.5
19. Joan 13.4-5,14-15
20. I Tim. 6.16
21. Abak. 3.19; Joan 20.28
22. Ps. 22(23).3 etj.
23. Ps. 50(51).19
24. Ps. 109(110).2
25. Is. 26.9
26. Joan 1.1
27. Ps. 114(115).9
28. Gjen. 3.4-7
29. Jona 2.7
30. I Tim. 2.4
31. I Kor. 8.12
32. Mark 3.29
33. Gjen. 2.8
34. Is. 35.10
35. Is. 6.3; Apok. 4.8
36. Fja. Urt. 9.18
37. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
38. Rom. 12.16
39. Ps. 46(47).5
40. Gjen. 28.12-17
41. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 24-26
42. Dan. 3.28
43. III [I] Mbret. 18.38
44. Ju. 9.5-6; Ps. 134(135).6; Urt. Sol. 12.18; Mark. 1.40; Hebr. 1.3
45. Lluk. 10.29

46. Neh. 13.22
47. Matth. 5.3
48. Ps. 5.8 etj.
49. I Kor. 3.16-17; 6.19; II Kor. 6.16
50. Is. 34.8; Matth. 10.15; 11.22,24; 12.36; II Petr. 2.9; 3.7; I Joan 4.17
51. Ps. 50(51).3
52. Eks. 33.20; Joan 1.18
53. Is. 6.2
54. Joan 1.14
55. Joan 10.17-18
56. Ef. 2.6; Kol. 3.1
57. Joan 1.2
58. I Petr. 2.21
59. Num. 14.19 etj.



## E DIELA E DJALIT PLANGPRISHËS NË MBRËMËSORE

### Thirrto

*7 ngjallësore dhe 3 Idhimele të Triodit:*

### Ting. I

Në një vend të pamëkatshëm dhe të gjallë u besova<sup>1</sup> dhe mbolla mëkatin; me drapër korra kallinjtë e moskujdesjes dhe stivosa me duaj qepitë e veprave të mia, të cilat nuk i shtrova në lëmin e pendimit; pra të lyp ty Perëndisë, bujkut<sup>2</sup> tonë të parajetshëm: Me erën e zemërdhembshurisë sate shpërndaje kashtën e veprave të mia dhe jepi shpirtit tim grurin e ndjesës duke më mbyllur në grunarin tënd<sup>3</sup> qiellor, dhe shpëtomë.\*

Le të njohim, o vëllezër, fuqinë e misterit; se ati i tërëmirë i del përpara dhe e puth Birin Plangprishës që u kthye nga mëkati te vatra atërore, dhe i fal papë shenjat e lavdisë së tij, dhe bën një ngazëllim mistik me të sipërmit,<sup>4</sup> duke therur vëçin e ushqyer, që në të sillmi siç ka hije për atin njerëdashës që bëri therore, dhe për flinë e lavdëruar, Shpëtimtarin e shpitrave tanë.\*

Lavdi Ting. II



Oh, nga sa të mira e privova veten time unë mjerani! Oh, nga çfarë mbretërie<sup>5</sup> rashë unë i ziu! Pasurinë që mora, e konsumova; porosinë e shkela. Ah, o shpirt i mjerë! Në zjarrin e amshuar pra dënohesh;<sup>6</sup> prandaj, përpara fundit, thirrri Krishtit, Perëndisë: Si Birin e Sthturur prit-më, o Perëndi, dhe mëshromë.

Tani *Hyjlindësore*  
*Dogmatike e Tingullit të javës*

*Pasvargje ngjallësore*  
Lavdi *Ting. Tërth. II*

Si shpërndava pasurinë e dhuratës atërore, me shtazët e paarsyeshme kullotja unë i mjeri, dhe vuaja nga uria, ngaqë nuk ngopesha me ushqimin e tyre, të cilin e dëshiroja; por, pasi u ktheva tek ati i dhembshur, thërras me lot: Pritmë si ro-gëtar mua që i përgunjem njeridashjes sate dhe shpëtomë.

Tani *Hyjlindësore*

Zoti Krisht, bërësi dhe shpërblyesi im, o e gjithëpastër, si lindi prej teje i veshur si un', çlroi Adamin prej mallkimit të parë.<sup>7</sup> Prandaj, o e gjithëpastër, të thërresim pa pushuar si nënë Perëndie dhe virgjëreshë me të vërtetë, përshëndetjen e engjëllit:<sup>8</sup> Gëzohu, o Zonjë, mbrojtje dhe hije, dhe shpëtim i shpirtave tanë. \*

*Përlëshore ngjallësore*



NË MËNGJESORE

*Shërbesa e zakonshme. Kanunet: Ngjallësi në 4, Kryqngjallësi në 2, i Hyjlindës në 2 dhe i Triodit në 6 (Poezi e zotit Josif):*

*Ting. II*

*Ode I*

*Tin Moseos odhin*

O Jisu Perëndi,\* tani më prit dhe mua me pendim\* si Plangprishësin Bir pra;\* jetova gjith' jetën me shkujdesje\* dhe të inatosa<sup>9</sup> ty shumë, o Zot.

E shpërndava pra keq\* të hyjshmen pasuri që ti ma dhe\* më përpara, ika larg\* nga ti, jetova brenda mëkatit,\* kthehem, pritmë mua, i dhembshuri at'.

Krahët pra atëror\* tani, i tërëdhembshur, hapí krejt,\* pritmë edhe mua ti\* porsí Prodikun Bir, që me plot gaz\* ty të lavdëroj, Zoti im, me himnim.

*Hyjlindësor*

Zot, ndaj meje trego\* çdo mirësi, si mirëbërës ti,\* dhe morin' e krimeve\* të mia shuaje pra me lutjet\* që hyjnisht i bën në-na jote, o Krisht.

*Zbritësore: Tin Moseos odhin*

»Merre oden, o shpirt,\* që Moisiu shenjt »tha dhe thirr ti:\* Për shpëtimin tim u bë\* »përkrahës, mbrojtës, ky është Zoti,\* Pe- »rëndia im, dhe do ta lavdëroj.<sup>10</sup>

*Ode III*

*Stirothenta mu ton nun*

Dola jasht' logjikës krejt\* marrëzisht, pas shpikësve të vesit unë\* jam i ngjitur, o Krisht,\* por pranomë si Plangprishësin Bir dhembshurisht.

Zërin e Prodikut un'\* imitoj edhe thërras: Kam mëkatuar,\* si atë pra tani\* për-qafomë edhe mos më zbraps, o ati im.

Hapi krahët ti, o Krisht,\* dhembshurisht dhe pritmë mua që po kthehem\* nga i largëti vend,\* nga mëkati, nga pasionet i fëlliqur krejt.

*Hyjlindësor*



O e bukura ndër gra,\*<sup>11</sup> pasurom' dhe mua me ide të mira,\* se nga faje pa mas'\* jam i varfër, e Dëlrë, që të të lëvdoj.

*Zbritësore: Stirothenta mu ton nun*

»Perëndia im, jam shterp'\*<sup>12</sup> un' në »mendje, ndaj frytdhënës më trego ti,\* »o bujk<sup>2</sup>, mbjellësi pra\* i të mirave, me »dhembshurinë tënde, Zot.

*Ndenjëso*

*Ting. I Ton tafon su Sotir*

Nxito t'më hapësh ti\* krahë ati; shpenzova\* në shturje jetën time, por shoh pasurinë,\* bollëkun e mëshirës sate të pashtershme; mos e lër\* zemrën që tani\* e varfër është, se, o Zot,\* po thërras te ti\* me kataniks: Mëkatova,\* shpëtomë, i mirë krejt.

Lavdi *E njëjtë*

Tani *Hyjlindësore*

E virgjra Vajzë, je\* krejt e panusëruar,\* Hyjlindëse nën', mbrojtja dhe streha e vetme\* e çdo besniku, e dëlrë; nga peripetitë tmerr,\* nga trishtimet tok\* dhe nga rreziqet çlirona\* ne të gjithë që\* në ty shpresojm', për ne lutu,\* shpëtoji pra shpirtrat tan'.

*Ode IV*

*Tin ek Parthenu su jënisin*

O Atë përmbiqiellor, e shpërndava keq pasurinë e të mirave që më dhe, edhe u skllavërova te qytetarë të huaj, ndaj të thërras: Mëkatova para teje, pranomë si qëmoti plangprishësin, pasi të m'i hapësh krahët e tu.

U robërova në çdo ligësi pasi u nënshtrova<sup>13</sup> mjerisht te krijuesit e pasioneve, dhe u çmenda nga pakujdesia; dhembshuromë, o Shpëtimtar, Atë përmbiqiellor,<sup>14</sup> mua që përika në përdëllimet e tua të shumta.

U mbusha tërë turp dhe nuk kam guxim të vështroj në lartësinë e qiellit<sup>15</sup>, sepse pa mendiu përkula mëkatit, por tani, duke u kthyer, thërras me kataniks: Mëkatova para teje, më prano, o Tërëmbret.

*Hyjlindësor*

Ndihma e njerëzve, shpresa e sigurt e të gjithë të krishterëve, strehimi i të shpëtuarve, shpëtomë, o Virgjërëshë e pacen, me ndërmjetimet e tua nënore dhe denjësomë për jetën e ardhshme.

*Zbritësore: Tin ek Parthenu su jënisin*

»Pra lindjen tënde prej Vajze krejt\* e »papa profeti\* dhe e shpalli fort me zë:\* »Un' kam dëgjuar për famën tënde dhe »jam trembur,\* se nga Themani ti\* dhe »nga mali i shenjtë hijeplotë\* ke arritur,<sup>16</sup> »o Krisht Zot.

*Ode V*

*Tis niktos dhiethusis*

U robërova te qytetarë të huaj, u shpërngula në vend shkatërrues dhe u mbusha me turp; por tani, duke u kthyer, të thërras ty, o Zemërdhembshur: Mëkatova.

Hape zemrën tënde atërore tani që po kthehem nga të këqijat, o Atë përmbiqiellor,<sup>14</sup> dhe mos më dëbo, meqë ke mëshirë tepër të madhe.<sup>17</sup>

Nuk guxoj të vështroj sipër në lartësi,<sup>15</sup> sepse të kam inatosur<sup>9</sup> pa masë, o Krisht; mirëpo, duke njohur dhembshurinë tënde, o i mirë, thërras: Mëkatova, të të vijë keq, shpëtomë.

*Hyjlindësor*

O Virgjërëshë e tërëshenjtë hirplote, që linde falësinë e të gjithëve, me anën e përgjërimeve të tua lehtësoje barrën e rëndë të mëkateve të mia të tmerrshme.

*Zbritësore: Tis niktòs dhieithusis*

»Pasi nata kaloi,\* dita pra është afër\*<sup>18</sup>  
 »dhe shkëlqeu drita në botë<sup>19</sup> nur;\* dhe  
 »prandaj të himnojnë\* dhe të lavdërojnë\*  
 »rreshta engjëllorë, o Krisht Perëndi.

*Ode VI**Vithò amartimaton*

Nga fundi i mëkatit shtrëngohem përgjithnjë,\* më zhyt tallazi<sup>20</sup> i fajeve, Zoti im;\* drejt portit të jetës pra drejtomë ti,\* shpëtomë, o Perëndi, mbreti i lavdisë, o Krisht.

Endava pasurin' atërore frikshëm un',\* u varfërova dhe jam mbushur plot me turp;\* jam skillav të mendime pa fryt shpirtëror,\* ndaj ty të thërras: Shpëtomë, i dhembshur, njeridashës.

Uri kam për të mirat e ndryshme, prishem keq,\* për ty u bëra i huaj, Krisht; por tani\* që kthehem, më dhembshuro, i përmbimir,\* pra mua që ta himnoj njeridashjen, më shpëto, Zot.

*Hyjlindësor*

Në bark e kishe Krishtin Zot Shpëtimtar, o Vajz',\* ndaj për shpëtim denjësomë; i varfër jam\* nga lloj-lloj të mirash, o e Virgjër krejt,\* që, o e dëlirë fort, madhështit' e tua t'i psal.

*Zbritësore: Vithò amartimaton*

»Nga fundi i mëkatit shtrëngohem, Shpëtimtar,\* dhe dimëroj brenda detit<sup>20</sup> të jetës keq,\* por ti, si Jonan' prej bishës, nxirrme<sup>21</sup> »lart\* dhe mua nga veset, Zot, pra çliromë »dhe shpëtomë.

*Kontaçi**Ting. III I Parthenos simeron*

Është më nxitim, pa mend\* larg lavdit tënd atëror pra,\* pasurinë që më dhe,\* në të këqijat e humba;\* fort me zë\* porsì Prodiu po të thërras ty:\* Jam fajtor\* për-

para teje, Atë i dhembshur,\* pritmë të penduar, bëmë\* dhe mua si një nga rrogëtarët e tu.

*Shtëpia*

Përderisa Shpëtimtari ynë përditë na mëson me zërin e vet, me Shkrimet, le të dëgjojmë për të pashpëtueshmin, i cili u bë i mençur, dhe le ta imitojmë besërisht pendimin e tij të mirë; le t'i thërrasim me zemër të përlulur atij që i pa qartësisht të gjitha të fshehtat.<sup>22</sup> Mëkatuam përpara teje, o Atë i dhembshur, dhe nuk jemi të denjë kurrë të quhemi bij si më parë; mirëpo, meqenëse je njeridashës nga natyra, pranomë dhe bëmë si një nga rrogëtarët e tu.

*Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:*

Në të njëjtën ditë, kujtojmë nga Ungjilli i Shenjtë parabolën e Djalit Plangprishës, të cilën Etërit tepër të shenjtë e rreshtuan të dytën në Trid.

*Vargje:* Nëse dikush është plangprishës si unë, le të vijë me guxim,/ sepse u hap për të gjithë dera e keqardhjes hyjnore.

Me njeridashjen tënde të parrëfyshme, o Krisht, Perëndia ynë, mëshirona. Amin.

*Ode VII**Ta Heruvim mimimèni*

Unënshtrova jashtë mase mjerisht në kënaqësitë e trupit, u skillavërova absolutisht të shpikësit e pasioneve dhe u bëra i huaj për ty, o Njeridashës; por tani thërras me zërin e Prodiut: Mëkatova, o Krisht, mos më shpërfill, si i vetmi përdëllyes.

Thërras fort "Mëkatova", dhe nuk guxoj fare të vështroj në lartësinë e qiellit,<sup>15</sup> o Tërëmbret, sepse më marrëzi vetëm unë të inatos<sup>9</sup> duke shkelur urdhërimet e tua; por ti, si i vetmi i mirë, mos më hidh larg fytyrës sate.<sup>23</sup>



O Zot, me lutjet e apostujve, të profetëve, të oshënarëve, të martirëve të respektuar dhe të të drejtëve, m'i fal të gjitha mëkatet, se e inatos<sup>9</sup> mirësinë tënde, o Krisht, që të të himnoj në gjithë jetët.

#### *Hyjlindësor*

Përderisa u shfaqë më e shkëlqyer se Keruvimet, Serafimet dhe se çdo ushtri qiellore,<sup>24</sup> o Perëndilindëse e tërëpaqortueshme, bashkë me to përgjëroju atij që trupëzove, Perëndisë Fjalë të Atit pa fillim, që të denjësohem i të gjithë për të mirat e amshuara.

#### *Zbritësores: Ta Heruvim mimumeni*

»Në furrë imitonin Djemt',\* bënin si »Keruvimet:\* Kërcenin dhe thërrisnin:\* »Je i bekuar, Perëndi,\*<sup>25</sup> se me gjykim vërtet ti i hodhe të tëra këto mbi ne për mëkatet tona,<sup>26</sup> ti pra që je\* i lavdëruar dhe »i përmbihimnuar përher' në gjithë jetët.<sup>25</sup>

#### *Ode VIII*

##### *Ton en ti vato Mosi*

Ti që me varfëri vullnetare<sup>27</sup> nga mëshira e shumtë<sup>27a</sup> zbritë mbi dhë<sup>28</sup> që ta shpëtosh botën, si përdëllyes shpëtomë mua që u varfërova tani nga çdo punë e mirë.

Kur u largova nga porositë e tua, u skllavërova tejet mjerisht te mashtruesi; mirëpo tani që po kthehem, pranomë mua që bie në gjuhë si qëmoti Plangprishësin, o Atë përmbiqiellor.

Kur iu nënshtrova mendimeve prishëse, u nxiva dhe u largova prej teje, sepse u çmenda tërësisht, o i Dhembshur, ndaj shpëtomë mua që po bie në gjuhë para teje me pendim.

#### *Hyjlindësor*

O Hyjlindëse e kulluar, ringritja e vetme e të rënëve, ringrimë edhe mua që jam i

tëri i dërrmuar dhe i poshtëruar për shkak të mëkateve të shumëllojshme.

#### *Zbritësores: Ton en ti vato Mosi*

»Te Moisiu, në mal,\* në Sina, parashafti\* »mrekullin' e së Virgjërës në një ferrë<sup>29</sup> »Zoti Krisht;\* himnojeni, bekonit,\* përmbi- »lartësoni atë në gjithë jetët.<sup>25</sup>

#### *Ode IX që ka Akrostihidhë: "Josif"*

##### *Ton jijenon tis ikuse*

Shih kthimin tim, shih lotët, shih shtrëngimin e zemrës sime, Shpëtimtar,\* Krisht Zot, dhe mos më shpëfill, por përqafo më sërish\* nga dhembshuria dhe më numëro me luzmën\* e njerëzve që kanë\* shpëtuar, që me gaz mëshirat e tua pra t'i përhimnoj.

Thërras porsì Kusari un' »Kujtomë»,<sup>30</sup> si Doganieri zymtësisht\* tash e godas gjoksin, them fort: »Të të vijë keq' pra,\*<sup>5</sup> i Tërdhembshur, çliromë nga çdo e keqe\* si Birin mjaft të Shturur,\* o Tërëmbret, që ta himnoj bashkëzbritjen posht' të skajshme krejt.

O shpirti im mjeran fort, thirri Krishtit me psherëtima tash: O Zot,\* i varfëruar për mua krejt me dashje,<sup>27</sup> un' jam\* i varfëruar nga çdo punë e mirë, më jep,\* si shumëpërdëllyes,\* i mir' i vetëm, pasuromë me çdo të mirë si thesar.

Dëfrimin e dikurshëm që ti bëre kur erdhi prap' Plangprishësi\* vullnetarisht, o i Mirë, bëje edhe tani\* për mua që jam mjeran, krahët pra të shenjtë,\* të respektuar hapi\* që un' të skajshmen bashkëzbritje ta përhimnoj që të shpëtoj.

#### *Hyjlindësor*

Me ndërmjetimin tënd ndriçues shndrit, Virgjëreshë, syt' e mi mendor',\* se nga e keqja mjaft janë errësuar; më fut\* në udhë dhe më dërgo drejt pendimit, që

un',\* ty që e trupëzove\* përmbi çdo fjalë  
Fjalën Zot, të të përhimnoj detyrimisht.

*Pas Zbritësoreve, i gjithë rendi i Ungjillit  
Mëngjesor dhe Idhiomelet: Hapmi dyert;  
Drejtomë në rrugët; Unë i mjeri (Jq. 10).  
Më të nderuarën. Dhe Zbritësorja:*

*Ton jijenôn tis ikuse*

»Kush midis të dhelindurve pa ose  
»dëgjoji gjë të till' dikur\* se një e virgjër  
»shtatzën' u shfaq<sup>31</sup> dhe lindi pa ankth,\*  
»pa dhimbje foshnjë;<sup>31a</sup> e tillë të ish çu-  
»dia,\* ndaj ty të madhështojmë,\* Mari  
»Hyllindëse pa cen, e dëlirë pa qortim  
»aspak.

*Dërgimësore ngjallësore dhe të Triodit:*

*Jineqes akutisthite*

**E** prisha keq mjerani un'\* thesarini, pa-  
sjen që më dhe,\* hirin pra,<sup>32</sup> kur u shpër-  
ngula\* i poshtëruari; kisha\* jetën të ligë,  
Shpëtimtar,\* te demonët e prisha kot\* se  
më mashtruan; më shpëto,\* dhe si Plang-  
prishësin pritmë,\* po kthehem, Atë i  
mirë.

*Tjetër*

**E** prisha, e shpërndava keq,\* kot pasu-  
rinë tënde, Zot,\* mua të mjerin më  
mposhtën\* demonët fare të ligj pra,\*  
o Shpëtimtar me mjaft mëshir',\* për  
plangprishësin ji i but',\* jam i njollosur,  
më pastro,\* ma jep stollinë e parë\* të  
mbretëris' sate, o Krisht.

*Hyllindësore*

**E** shenjta Virgjëreshë nën',\* jehonë ishe,  
zë i fort',\* për oshënarët, profetët,\* apo-  
stujt bashkë, martirët,\* zbutë për ne tët  
Bir dhe Zot,\* shërbëtorët e tu jemi,\* kur  
do të ulet për gjykim,\*<sup>33</sup> Hyllindëse, të ve-  
ndosë\* siç i përket pra secilit.

*Lavdërime (me Vargjet e së dielës):*

*5 ngjallësore dhe 3 të Triodit:*

*Ting. II*

**Z**ërin e Plangprishësit të ofroj, o Zot; më-  
katova para syve të tu, o i Mirë, e shpër-  
ndava pasurinë e karizmave të tua, por  
pritmë të penduar, o Shpëtimtar, dhe  
shpëtomë.

*Ting. IV*

**O** i dhembshur, si Biri i Sthturur erdha  
dhe unë që shpenzova gjithë pasjen time  
në mërgim; e shpërndava pasurinë që më  
dhe, o Atë; pritmë të penduar, o Perëndi,  
dhe mëshiomë.

*Ting. Tërth. IV*

**K**ur e shpenzova dhe e konsumova në  
shturje pasurinë atërore, u bëra i shkretë  
si banova në vendin e qytetarëve dinakë;  
dhe duke mos duruar bashkëjetesën e  
ta, pasi u ktheva, të thërres ty, Atit zemër-  
dhembshur: Mëkatova ndaj qiellit dhe  
para teje, dhe s'jam i denjë të quhem biri  
yt; bëmë si një nga rogëtarët e tu, o Pe-  
rëndi, dhe mëshiomë.

*Lavdi Ting. Tërth. II*

**Atë** i mirë, u largova prej teje, mos më  
braktis, as mos më trego të pavlershëm  
për mbretërinë tënde; armiku fort i lig më  
zhveshi<sup>34</sup> dhe ma hoqi pasurinë; dhuratat  
e shpirtit i shpërndava në shturje; ndaj,  
pasi u ngrita, u ktheva, dhe po të thërres:  
Bëmë si një nga rogëtarët e tu ti që i  
ndeve në Kryq duart e tua të pacenuara  
për mua, që të më rrëmbesh nga bisha e  
tmerrshme dhe të më veshësh me stollinë  
e parë, si i vetmi i shumë mëshirshëm.

Tani

E përmbibekuar

*Dhoksologjia e Madhe*

*Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit  
dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Triodit. Pas  
Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore dhe e ki-*



shës. *Kontaqi i sotëm* Ika me nxitim.

### CITIME

1. Gjen. 2.8
2. Joan 15.1
3. Matth. 3.12; Lluk. 3.17
4. Lluk. 7.10
5. Apok. 1.6; 5.10
6. Matth. 18.8; 25.41; Juda 7
7. Gjen. 3.17-19
8. Lluk. 1.28
9. Ligji i Dytë 4.25 etj.
10. Eks. 15.1-2
11. Kënga 1.8; 5.9; 6.1
12. I Mbret. [Sam.] 1.5
13. II Petr. 2.19
14. Matth. 6.14,32; 15.13; 18.35
15. Lluk. 18.13
16. Abak. 3.1-3
17. I Petr. 1.3
18. Rom. 13.12
19. Joan 1.9
20. Jona 1.11,15; 2.4,6
21. Jona 2.11
22. Ps. 43(44).22
23. Ps. 50(51).13
24. III [I] Mbret. 22.19; Neh. 9.6; Osa 13.4
25. Dan. kap. 3. Lutja e Azarias 1,27-28
26. Dan. kap. 3. Lutja e Azarias 4
27. II Kor. 8.9
- 27a. Tov. 8.16 etj.
28. Joan 3.13; 6.38,42
29. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
30. Lluk. 23.42
31. Is. 7.14
- 31a. Is. 66.7
32. Ef. 1.7; 2.7
33. Matth. 19.28; 25.31-32
34. Gjen. 3.7-11



### E SHTUNA PARA TË LIDHURIT TË MISHIT

Kujtimi i gjithë të Fjeturve që nga jeta, etërve dhe vëllezërve tanë të krishterë orthodoksë.

#### TË PREMTEN NË MBRËMËSORE

*Thirrto*

*3 Martirike të Tingullit të javës*

*dhe të 3 të Triodit:*

*Ting. Tërth. IV O en Edhëm Parádhiso*

**Duke kujtuar, o besnikë, sot të gjithë të**

vdekurit\* sipas emrit, që jetuan me kushtim,\* bes\* që nga jeta, ta himnojmi\* Shpëtimtarin Zot pa pushim,\* t'i kërkojmë që në orën e gjyqit\* të kenë mbrojtje të mirë mjaft\* përpara Perëndisë ton\* që tërë dheun e gjykon,\* vendin e djathtë<sup>1</sup> me gëzim,\* pjesë të drejtësh lart\* të arrijnë, në ndriçim dhe trashëgim\* që shenjtoret krenjt kanë,\*<sup>2</sup> të bëhen dhe të vyer denjësisht\* pra në mbretërin' e tij mbiqellore me dëfrim dhe lavd.

**T**i që me vetë gjakun tënd shpërbleve njerëzit, Shpëtimtar,\* dhe me vdekjen tënde vrave vdekjen ton\* të hidhur, na çlirove krejt,\* në amshim jetën na e dhe\*<sup>3</sup> përmes ngjalljes sate; prehi gjithë, Zot,\* ata që fjetën me plot besim\* qoftë në det ose në dhé,\* në shkretëtirë, në qytet\* ose në çdo vend, priftërinj,\* mbretër, asketë tok\* murgj dhe kryepriftërinj pra, në çdo mosh\* dhe në çdo gjeneratë;\* këta të vyer bëji denjësisht\* lart për mbretërinë tënde qiellore me dëfrim dhe lavd.

**U**ngjalle nga të vdekurit, Krisht, dhe vdekja nuk është më\* sundimtare mbi sa fjetën me besim;\* ndaj, Zot, kërkojmë vazhdimisht:\* Prehi shërbyesit e tu\* në avlit' e tua<sup>4</sup> në përjetësi\* edhe në gjirin abramian\*<sup>5</sup> sa nga Adami deri sot\* të adhuruan pastër ty,\* etërit, fisin tonë krejt,\* miqtë, vëllezërit\* si dhe çdo njeri që është sjellë mir',\* perëndishëm në jetë\* dhe u shpërngul te ti me çdo mënyr'\* denjësoji pra për mbretërinë tënde qiellore lart.

Lavdi *Nekrosim*

*Ting. Tërth. IV I Joan Damaskinoit*

**Q**aj e vajtoj kur shkoj ndër mend vdekjen, dhe shoh bukurinë tonë të formuar sipas ikonës së Perëndisë,<sup>6</sup> të shtrirë në varr, të shëmtuar, pa rëndësi, pa formë. O çudi!

Ç'është ky mister që ndodh me ne? Si iu dorëzua prishjes dhe si u bashkuam me vdekjen? Me të vërtetë, siç është shkruar, sipas urdhrit të Perëndisë,<sup>6a</sup> i cili u fal prejhen atyre që u ndanë prej nesh.\*

Tani *Hyjllindësor*

*Dogmatike e Tingullit të javës (që po kalon)*

O dritë gazmore dhe, në vend të Proqimitit, psalim në Ting. Tërth. II.

Allilua (3x)

*Të dytën me Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

Allilua (3x)

*Të tretën me Varg:* Dhe kujtimi i tyre në jetë të jetëve.

Allilua (3x)

Bëna të denjë, o Zot, etj.

*Pasvargje:*

*4 Martirike të Tingullit të javës*

Lavdi *Nekrosim*

*Ting. Tërth. II I Joan Damaskinoit*

Urdhri yt krijues ka qenë fillimi im dhe qenia ime; dhe duke dashur të më bësh krijesë të gjallë prej natyre të dukur dhe të padukur, ma formove trupin prej dheut dhe më dhe shpirt me fryrjen tënde të perëndishme dhe jetëbërëse.<sup>7</sup> Prandaj, o Krisht, vendosi shërbëtorët e tu në vendin e të gjallëve<sup>8</sup> e në tendat e të drejtëve.<sup>9\*</sup>

Tani *Hyjllindësor*

*Triimeros anestis Hristë*

Krisht, prehi shërbëtorët e tu\* që fjetën, ndërmjeten te ti\* nëna jote,\* oshënarët, çdo shenjtor,\* profetët me apostujt, martirët, hierarkët\* edhe të drejtët; tok të luten ty.

*Menjëherë pas* Tani përlëshoje shërbëtorin tënd, psalet *Kanuni Nekrosim i Tingullit të javës (nga Oktaihu) me Vargje: në Troparin*

*e parë:* Me ndërmjetimet e martirëve të tu, prehi, o Krisht, shpirtat e shërbëtorëve të tu; *në të dytin:* Shpirtat e tyre do të rrinë në të mira; *në të tretin:* Lavdi; *në të katërtin:* Tani. *Pas Odes III, Ndenjësores Nekrosime (kërkoje në Oktaih, të shtunën Ting. Tërth. II, pas Stihologjisë së parë).* Lavdi dhe Tani (*Ting. i njëjtë*): O Hyjllindëse Virgjëreshë, mos më braktis në kohën e jetës sime, o mbrojtja njerëzore, mos më kërkoi ndonjë garanci, por ti vetë më përkrah dhe më mëshiro. *Pas Odes VI, Kontaqi:* Bashkë me shenjtorët prehi. *Pas mbarimit të Kanunit Nekrosim, Trishenjtë dhe:*

*Përlëshore Ting. Tërth. IV*

O i vetmi Krijues, që i rregullon të gjitha me thellësi urtësie<sup>10</sup> dhe njerdashje, dhe ua shpërndan të gjithëve atë që është në dobi të tyre, prehi, o Zot, shpirtat e shërbëtorëve të tu, sepse shpresën e besuan te ti, Bërësi, Gatuesi dhe Perëndia ynë.<sup>11</sup>

Lavdi

Sepse shpresën e besuan te ti, Bërësi, Gatuesi dhe Perëndia ynë.<sup>11</sup>

Tani *Hyjllindësore*

Ty të kemi dhe mur, dhe liman, dhe ndërmjetuese që të pret mirë Perëndia që linde, o Hyjllindëse e panusëruar, shpëtimi i besimtarëve.

Mëshirona, o Perëndi etj. Se ti je Perëndi mëshirues. *Dhe menjëherë Troparet* Bashkë me shpirtat e të drejtëve që kanë mbaruar etj. *të gjitha të Trisajisë, duke shtuar dhe atë të sotmim (fq. 297 Uratore e Vogël), pa Përlëshimin e Trisajisë. Pra, pas Uratës O Perëndi i shpirtave dhe i çdo trupi... Urtësi. Beko, o atë etj. Përlëshimi (i Mbrëmësorës).*





## TË SHTUNËN NË MËNGJESORE

*Pas Gjashitë Psalmeve dhe Paqësoreve,  
psalim në Ting. Tërth. IV*

Aliluia (3x)

*Të dytën me Varg:* Të lumtur ata që i zgjo-  
dhe dhe i more, o Zot.

Aliluia (3x)

*Të tretën me Varg:* Dhe kujtimi i tyre në  
jetë të jetëve.

Aliluia (3x)

*Përlëshore Ting. Tërth. IV*

**O** i vetmi Krijues, që i rregullon të gjitha  
me thellësi urtësie<sup>10</sup> dhe njeridashje, dhe  
ua shpërndan të gjithëve atë që është në  
dobi të tyre, prehi, o Zot, shpirtrat e shë-  
rbëtorëve të tu, sepse shpresën e besuan  
te ti, Bërësi, Gatuesi dhe Perëndia ynë.<sup>11</sup>

Lavdi

Sepse shpresën e besuan te ti, Bërësi,  
Gatuesi dhe Perëndia ynë.<sup>11</sup>

Tani *Hyllindësore*

**T**y të kemi dhe mur, dhe liman, dhe ndë-  
rmjetuese që të pret mirë Perëndia që li-  
nde, o Hyllindëse e panusëruar, shpëtimi  
i besimtarëve.

*Sihologjia e zakonshme. Në të gjitha "Përsëri  
dhe përsëri" të Sihologjive dhe të Kanunit,  
kujtohen vëllezërit tanë që u larguan më përpara.*

*Në Sihologjinë e parë themi Ndenjësoret Ne-  
krosime dhe Martirike të Tingullit të javës (që  
po kalon); pastaj të Paqortueshmin (Ps. 118) në  
dy Stanca (Qëndrime); dhe pas Stancës së parë  
prifti kujton ("Përsëri dhe përsëri" etj.), ndërsa  
në plotësimin e së dytës, Bekimtores Nekrosime  
(fq. 245 Uratore e Vogël). Pas "Përsëri dhe  
përsëri" prifti kujton prapë. Pastaj psalti:*

*Ndenjësore Ting. Tërth. I*

Prehi, o Shpëtimtari ynë, bashkë me të

drejtët shërbëtorët e tu dhe fushoji në  
avllitë e tua siç është shkruar,<sup>12</sup> duke  
mos i vënë re, si i mirë, paudhësitë e ty-  
re të bëra me dashje dhe pa dashje dhe  
të gjitha ato me dije dhe pa dije, o nje-  
ridashës.

Lavdi

**D**he të gjitha ato me dije dhe pa dije, o  
njeridashës.

Tani *Hyllindësore*

**O** Krisht Perëndi, që nga një Virgjëreshë  
linde si diell për botën, pasi të na shfaqësh  
me anën e saj bij drite,<sup>13</sup> mëshirona.

*Psalmi 50 dhe Kanuni që ka Akrostihidhë  
në Troparet Triadike dhe Hyllindësoret: "I  
Theodorit të padenjë":*

*Ting. Tërth. IV*

*Ode I*

*Irmosi: Asma anapëmpomen lai*

»**P**opuj, Perëndisë ton' mahnitës<sup>14</sup> t'i  
»drejtojmë melodi,\* prej skllavëris' çliroi  
»Izraelin;<sup>15</sup> krejt ne\* një këngë triumfi pra\*  
»psalim; le t'i thërrasim:\* Do këndojmë  
»për ty,<sup>16</sup> Zot i vetëm.<sup>17</sup>

**L**e t'i përgjërohemi të gjithë Krishtit sot  
që kryejmë\* kujtimin e të vdekurve prej  
kohësh, që ky,\* nga zjarri që s'shuhet  
kurr',\*<sup>18</sup> sa plot me besë fjetën,\* t'i çli-  
rojë, se kishin shpres' jete.<sup>19</sup>

**K**risht, në thellësinë e gjykimeve të tua  
urtësisht\*<sup>10</sup> paracakton, i dhembshur  
fort, mënyrën, kohën\* dhe fundin e jetës  
son';\* ndaj sa mbuloi varri\* në çdo vend,  
ti shpëtoji në gjykim.

**Z**ot, që vë kufi te jeta jonë, orthodhoksët,  
mbretërit\* dhe priftërinjtë, popullin tënd  
mbarë, pra, që\* nga nata e jetës son'\*  
jan' zgjuar, ti tregoji\* bij të ditës<sup>20</sup> që s'ka  
perëndim hiç.

Sa besnikë ujë i mbuloi, luftë i kositi pra,\* tërmet i zuri, vrasës keq i vranë, sa zjarr\* i dogji, rreshtoi krejt,\* o përdëllyes Krisht ti,\* me të drejtët, në anën e tyre.

Duke mos i vënë re çdo borxhi, faj mishor të njerëzve,\* në çdo gjini të tyre edhe në çdo moshë,\* o Bërës, vendosi ti\* para katedrës sate\* pa faj, kur do të mbrohen në gjykim.

### Triadik

Tre Persona që veç ekzistojnë, krejt në një natyrë pra,\* himnoji un': Atë të palindur, Bir që lindi\* dhe Shpirtin e Shenjtë tok\* një mbretëri pa nisje,\* një pushtet, një hyjni, një lavd, një drit'.

### Hyjindësor

Ti vërtet mbi dhë u duke qiell më i madh se qielli\* lart fare në eter, o e panusëruar,\* e virgjër, se linde ti\* pra diell drejtësie\*<sup>21</sup> që sundon përmbi kozmosin mbarë.

Zbritësore: *Asma anapëpsomen lai*  
Popuj, Perëndisë

### Ode II

Irmosi: *Ëdhetë, idhete oti ego imi*

»Shihni, shihni, se unë jam Perëndia<sup>22</sup>  
»juaj, që linda para jetëve nga Ati, dhe tani  
»në fund isha në barkun e Virgjëreshës  
»pa burrë; dhe e ndjeva mëkatën e para-  
»tit Adam,<sup>23</sup> si njerdashës. (2x)

Shihni, shihni, se unë jam Perëndia<sup>22</sup>  
juaj, që, me gjykim të drejtë,<sup>24</sup> i fiksova  
kushtet e jetës, që nga prishja i mora  
për paprishje<sup>25</sup> të gjithë ata që fjetën me  
shpresë për ngjalljen e amshuar.

O Zot, që i more nga katër skajet ata që  
vdiqën besërisht në det a në tokë, a në  
lumenj, burime, liqene, puse ose u bë-  
në gjah egërsirash, shpendësh dhe zva-  
rnikësh, prehë të gjithë.

O Zot, në pëllëmbën tënde i ke vendosur  
të gjitha që më parë; ata që u shpërbënë  
në katër elemente, në ardhjen tënde, ko-  
mbinoji dhe ngjalli, dhe fali fajet e tyre të  
bëra me dije dhe pa dije.

O Zot! Oh, sa e frikshme do të jetë ardhja  
jote e dytë! Sepse, kur të vish mbi dhë si  
në formë rrufeje,<sup>26</sup> do të ngresh çdo kri-  
jesë tënden, që të gjykohe; atëherë de-  
njësoji të jenë bashkë me ty ata që do të të  
mirëpresin,<sup>27</sup> të cilët jetuan besërisht.

### Triadik

O Njësi e përmbitërëpërsosur, e përmbi-  
perëndishme, trihipostate, Atë i palindur,  
Bir i vetëmlindur dhe Shpirt që dole prej  
Atit ndërsa u shfaqe përmes Birit, një  
esencë, natyrë, zotëri dhe mbretëri, shpë-  
tona të gjithë ne.

### Hyjindësor

O nënë e Virgjër, çudia e shtatzënisë sate  
është e parrëfyeshme, sepse si lind dhe  
njëkohësisht je e dëlirë? Si bëhesh me fë-  
mijë dhe nuk ke fare përvojë burri? U bë  
siç di Fjala e Perëndisë që lindi prej teje  
përmbinatyrshëm, në mënyrë të re.

Zbritësore: *Ëdhetë, idhete oti ego imi*  
Shihni, shihni, se unë jam

### Ode III

Irmosi: *O stereosas en ti hiri su*

»Ti që fiksove me dorën tënde qiejt, o  
»Fjalë Perëndi,\*<sup>28</sup> siguroji zemrat tona,<sup>29</sup>  
»se kemi besim te ti, në dritën e njohjes  
»krejt\* të së vërtetës,<sup>30</sup> o Shpëtimtar i bo-  
»tës. (2x)

Sa me lavdi dhe me besë udhën, jetën,  
e përfunduan drejt,\* denjësoji që të kenë  
kurorën e drejtësisë.<sup>31</sup> O Zot dhe Perëndi,\*  
dhe në amshim të shijojnë pra të mirat.



**O** Perëndi, kur do t'i provosh të gjithë në zjarr tmerr,<sup>32</sup> prehi ti\* sa papritur u rrëmbyen, u dogjën nga vetëtima, dhan' shpirt prej ftohtësis',\* prej lloj-lloj plagësh, fatkeqësisë të ndryshme.

**T**ë drejtësuarit me Orthodhoksinë në jetë, o Krisht Zot,\* pra në jetën që është' det i trazuar gjithnjë, lundruan drejt, denjësoji ti\* në portin, jetën që s'prishet, të arrijnë.

**S**a si ushqim i ka marr' çdo lloj natyre e peshqve, o Zot, Krisht,\* edhe shpendët që nga qielli, siç e gjykove, Perëndi, ngjalli me ndriçim,\* me lavd në ditën e fundme<sup>33</sup> dhe të frikshme.

#### *Triadik*

**N**jësin' hyjnore e ndaj un' në Persona, në treshe mendërisht;\* thjeshtësisht, njëkohësisht i bashkoj tre Personat, sepse shfaqen me një shkëlqim\* krejt të trefishtë me shpejtësi rrufeje.

#### *Hyjlindësor*

**Ç**udia jote s'kuptohet dot, se pa burrë je shtatzënë ti\* edhe virgjërinë tënde e ruan kur lind, o e Dëlirë; ndaj të himnon\* në jet' gjinia e njerëzve, krejt engjëjt.

*Zbritësore: O stereosas en ti hiri su*

**T**i që fiksove me dorën

#### *Ndenjësore*

*Ting. Tërth. I Ton sinânarhon Logon*

**T**i që Kryq edhe vdekje durove, Krisht, për ne,\* si Jetëdhënës dhe Hadhin e vrave, ngjalle kështu,\*<sup>34</sup> Shpëtimtar, të vdekurit; sa ikën larg nga ne,\* prehi si njeri-dashës, Zot,\* dhe, meqë ti ke mëshirë shumë,<sup>35</sup> Krisht, denjësoji\* kur të vish prap' në ardhjen tënde të frikshme tmerr, për mbretërin' tënde lart.

Lavdi

*E njëjtë*

#### *Tani Hyjlindësore*

**S**trehën tënde të shpejt', ndihmën, përdëllimin tënd\* tek unë pra shërbëtori yt t'i tregosh, Zonjë ti,\* zbuti edhe dallgët e mendimeve që kam,\* se jan' të kota, ngrije lart\* shpirtin tim që ra, Mari Hyjlindëse Virgjëreshë,\* se e di unë, di që mundesh t'i bësh të gjitha, e dëlirë, sa do.<sup>36</sup>

#### *Ode IV*

*Irmosi: Eks orus kataskiu Loge*

»Nga mali hijeplot',<sup>37</sup> Hyjlindësja e »vetme, o Fjalë, kur ti kishe\* për t'u »mishëruar,\* me hyshikim shën profeti »drejt e kuptoi,\* me tmerr lëndonte forcën »tënde pra.<sup>38</sup> (2x)

**K**ujto, o Shpëtimtari ynë, të gjithë etërit, paraetërit, gjyshërit dhe stërgjyshërit, që vdiqën që nga fillimi dhe deri tani në fund, sipas ligjit dhe me besim të drejtë.

**F**ushoju tok me shenjtoret, o Krisht, eremitët, murgjit e manastireve, të rinjtë, të moshuarit, që arritën ta mbaronin jetën me besë në mal, në udhë, në varre dhe në shkreti.

**P**rehi, o Shpëtimtari ynë, të gjithë ata që menjëherë ndërruan jetë besërisht, nga trishtimi a hareja që erdhi papritur dhe përjetuan mirëqenie ose mizori.

**O** Krisht, Shpëtimtari ynë, prehi ata që i zhduku të ftohtët, i rrëmbeu kalit, breshëri, dëbora dhe shiu i madh, dhe ata që u vranë me qeramidhe ose i zuri dheu poshtë.

#### *Triadik*

**Ë**shtë gjë e huaj kjo që Hyjnia është një dhe tre, e gjitha në çdo Person pa ndarë, sepse Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë janë ata të cilëve u falemi si një Hyjnie.

*Hyjlindësor*

**O** Zotlindëse, ne që lëkundemi nga shtrëngata e mëkatit, duke na drejtuar me lutjet e tua, çona në limane shpëtimtare, që të çlirohemi nga dertet e shumëllojshme.

*Zbritësore: Eks orus kataskiu Loge*  
Nga mali hijeplot'

#### Ode V

*Irmosi: Orthrizi to pnevma mu*

»Mëngon shpirti im përpara teje, o Zot,\* »se dritë jan'\* urdhërimet<sup>39</sup> e pranisë sate pra;\* me këto, Krisht, shkëlqejë mendjen tonë dhe na drejto\* nëpër udhë jete plot lavd dhe nder.

Duke bërë sot kujtimin e çdokujt që vdiq besërisht që nga jeta, o Zot, të thërrasim vazhdimisht: Prehi të gjithë bashkë me shenjtorët e tu.

**O** i Dhembshur, çliroji nga Ferri i përjetshëm<sup>40</sup> ata që i more brez pas brezi nga mbretërit, arkondët ose nga murgjit orthodhoksë.

Çliroji nga çdo dëshkim, o Zot, Perëndia ynë, ata që lejove të vdesin befasisht nga peripeci të shumta, duke ditur interesat e gjithë atyre që gatove.

**O** Shpëtimtari ynë, të tërë ata që vdiqën besërisht, çliroji nga çdo ndëshkim, nga zjarri që flakëron përherë, nga errësira pa dritë, nga kërcëllimi i dhembëve dhe krimbi<sup>41</sup> që torturon pa fund.

#### Triadik

Bashkona në një<sup>42</sup> vullnet të porosive të tua, o Njësi trihipostate, e bashkëfronshme, pa fillim, ti që në ndarje e ke bashkimin, dhe përsëri anasjelltas te Personat natyrën.

#### Hyjlindësor

**U** shfaqe, o e Dëllirë, më e çmuar se Sera-

fimet me pamje zjarri, kur kishe në bark Jisuin Shpëtimtar të paafroshëm për ta, i cili përmes mishërimit e hyjnizoi brumin e të dhelindurve.

*Zbritësore: Orthrizi to pnevma mu*  
Mëngon shpirti im

#### Ode VI

*Irmosi: Sinehómenon dhekse me*

»Njeridashës Zot, më prano mua që »kam\* dhe shtrëngohem pra mjaft\* nga »fajet; edhe si profetin<sup>43</sup> shpëtom', se »bie para dhembshurisë sate.

**K**ryetari i jetës,<sup>44</sup> Perëndia yn',\* me pësimin tënd ti\* e zgjidhe dhimbjen, vdekjen,<sup>45</sup> prehi\* shërbyesit e tu që fjetën prej jete.

**P**rehi, Zot, me shenjtorët sa, me një gjykim\* pa shpjegim, vdiqën keq\* nga pifjet, helmi vdekjeprurës\* si dhe për shkak të ngecjes prej ndonjë hale.

**Z**ot i dhembshur, kur do të rrinë lakuriq,\* pa mbulesë të gjith'\* në gjyq përpara faqes sate,<sup>46</sup> ti fali sa të adhuruan besërisht.

**K**ryeengjëlli yt do oshëtijë fort\* me të fundmen bori\* për ngjallje<sup>47</sup> jete<sup>48</sup> për të gjithë;\* Krisht, prehi atëher' shërbyesit e tu.

**P**erëndi, besimtarët që ke marrë ti\* që nga jeta, gjinin'\* krejt njerëzore denjësoje\* që të të mburrë me shërbyesit e tu.

#### Triadik

**E** trishenja hyjkryesi në një fron tok,\* Atë, Bir dhe Shën Shpirt,\* ti Perëndia im je dhe mban\* krejt Gjithësinë me tërëpushtetin tënd.

#### Hyjlindësor

**L**ule jete prej rrënjës sate mbiu nur,\* o stëratë Jese,<sup>49</sup> pra Vajza e kulluar; Kri-



shtin\* si Zot e lindi shpëtimtar bot'ror,<sup>50</sup>  
kërce.

*Zbritësore: Sinehómenon dhekse me  
Njeridashës Zot, më prano*

*Kontaqi Ting. Tërth. IV*

**B**ashkë me shenjtoretë prehi, o Krisht,  
shpirtrat e shërbëtorëve të tu, atje ku nuk  
ka dhembje, as helme, as psherëtimë,<sup>51</sup>  
por jetë të pambaruar.\*

*Shtëpia*

**V**etëm ti je i pavdekshëm,<sup>52</sup> ti që bërë  
dhe gatove njeriun; ndaj ne vdekatarët  
nga dheu u formuam<sup>7</sup> dhe në të njëjtin  
dhë do të shkojmë, siç urdhërova ti që më  
gatove dhe më the: "Përderisa je dhë, do  
të ikësh në dhë".<sup>6a</sup> Atje do të shkojmë të  
gjithë ne të vdekshmit duke bërë si vaj  
mortor oden "alilluia".

*Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:*

Në të njëjtën ditë, Etërit tepër të hyjshëm  
caktuan t'i kujtojmë të gjithë ata që fjetën  
që nga jeta me besë dhe me shpresë për  
ngjalljen e jetës së amshuar.

*Vargje:* O Fjalë, harroji shkeljet e të vde-  
kurve,/ duke mos e shfaqur si të vdekur  
dhembshurinë tënde të mirë.

Rreshtoji, o Zoti Krisht, në tentat e të dre-  
jtëve të tu shpirtrat e atyre që u prehën  
më parë, dhe mëshirona si i vetmi i pa-  
vdekshëm. Amin.

*Ode VII*

*Irmosi: O en arhi tin jin*

»Ti në fillim e themelove dheun\*<sup>53</sup> dhe i  
»forcove qiejt përmes fjalës;\*<sup>28</sup> je i bekuar  
»në jetë përgjithmonë pra,\* o Zot, Perëndi  
»i etërve tan'.<sup>54</sup>

**D**uke kujtuar ata që vdiqën besërisht që  
nga jeta, thërrasim: Je i bekuar në jetë, o  
Zot, Perëndi i etërve tanë.<sup>54</sup>

**O** Perëndi, prehi shpresëplotët që fjetën  
besërisht, që vdiqën befasisht me çdo lloj  
hedhjeje, hekuri, druri, guri të çdollojshëm.

**O** i dhembshur, në ardhjen tënde të fri-  
kshme vendosi në të djathtën e deleve të  
tua<sup>4</sup> ata që të shërbyen orthodhoksisht në  
jetë, o Krisht, dhe u shpërngulën drejt teje.

**R**reshtoji në korin e të zgjedhurve të tu, o  
Krisht, shërbëtorët e tu që të të thërrasin:  
Je i bekuar në jetë, o Zot, Perëndi i etërve  
tanë.<sup>54</sup>

**O** Shpëtimtar i dhembshur, që e krijove  
nga toka baltën e mishit dhe i dhe jetë  
me anë të Shpirtit,<sup>7</sup> ata që more, prehi  
në jetën e përjetshme, o Perëndi.

*Triadik*

**H**ynjia le të përhimnohet si një përzjerje  
drite trediellore, Atë, Bir dhe Shpirt Hyjnor,  
një në natyrë, por tri në hipostaza.

*Hyjlindësor*

**T**ë këndojmë, o Virgjëreshë, një melodi  
davidiane, duke të quajtur mal Perëndie,  
në të cilin, kur bano!<sup>55</sup> mishërisht Fjala,  
na hyjnizoi shpirtërisht në të.

*Zbritësore: O en arhi tin jin*

**T**i në fillim e themelove

*Ode VIII*

*Irmosi: Ton en ori ajo dhoksasthenta*

»**K**të që mbi mal të shenjtë u lëvdua,\*<sup>56</sup>  
»që në ferrën me zjarr<sup>57</sup> i shfaqti Moisiut\*  
»misterin e gjithmonëvirgjëreshës, lëvdo-  
»jeni pra Zotin,\* edhe lartësojeni ju në  
»gjithë jetët.<sup>58</sup> (2x)

**T**i që e fshive dikur hijen e vdekjes,<sup>59</sup> sapo  
linde si diell nga varri, o Zot i lavdisë,<sup>60</sup>  
bëji përjetë bij të ngjalljes<sup>61</sup> sate të gjithë  
ata që vdiqën me besim.

Ti, njohësi i të fshehurave<sup>62</sup> dhe i të pazbuluarave, kur do të zbulosh veprat e errësirës dhe mendimet e zemrave tona, atëherë mos u kërkoi llogari<sup>63</sup> të gjithë atyre që fjetën besërisht.

Kur të ulesh mbi fron dhe të urdhërosh të qëndrojnë për gjyq<sup>64</sup> ata që do të mbli-dhen nga skajet e dheut nëpërmjet trumbetës,<sup>47</sup> atëherë le të të vijë keq për të gjithë, o Krisht, si përdëllyes.

O Zot i lavdisë,<sup>60</sup> ata që vdiqën befasisht nga aksidentet, nga zhurma tepër e madhe, nga vrapimi në udhë, shuplaka, grushte dhe shkelma dhe fjetën besërisht, falë përjetë.

#### *Triadik*

Të himnoj si Njësi në esencë, të adhuroj si Trini në Persona, o Atë, Bir dhe Shpirt i Tërëshnjtë; e lavdëroj në jetë pushtetin e pafillim të mbretërisë sate.

#### *Hyjlindësor*

U tregove, o Perëndilindëse e virgjër, si burim i vulosur<sup>65</sup> rrëkeje të gjallë, sepse, meqë e linde pa burrë Zotin, i vadit përjetë besnikët me rrjedhjen e pavdekësisë.

*Zbritësore: Ton en ori ajio dhoksasthenta*

**K**të që mbi mal të shenjtë

#### *Ode IX*

*Irmosi: Ton prodhilothenta en ori*

»Bir in e Gjithnjëvirgjërshës, të deklaruar\* që më parë përmes ferrës me zjarr «te një ligjëvënës\* mbi një mal<sup>67</sup> për shpëtim besëmirësh,\* Krishtin,\* pa pushim e «madhështojm' me himn.

Denjësoje ti për gëzim në banesën sipër\* të atyre që dëfrejn<sup>66</sup> të shenjtorëve të tu, Zot,\* çdo njeri që nga jeta me besë\* fjeti\* dhe me shpresën e Parajsës pra.

Prej fatqeqësish vdekjeprurëse sa u zhdukën,\* prej rrufesh të ndryshme pra që nga qielli lart ranë\* dhe prej toke të çarë, prej zhytjesh\* deti,\* prehi gjithë besimtarët, Zot.

Pleq, të rinj, fëmijë dhe foshnja të vogla fare\* dhe adoleshentë, çdo mosh', natyrë femërore,\* mashkullore tok, prehi besnikët,\* o Zot\* Perëndi, që i ke marrë lart.

Prehi sa me besë të kan' adhuroar edhe\* fjetën nga pickim helmues dhe nga gëlltitje gjarpri\* a nga kuaj, nga shkelje pra, zhytje,\* leqe\* nga i afërmi, nga njerëzit.

Në praninë tënde, atëherë denjësoji\* të qëndrojnë para teje pa hiç dënim të gjithë\* sipas emrit, që fjetën nga jeta,\* krejt pra\* brez pas brezi me besim te ti.

#### *Triadik*

Pa pushim lavdi ty, Hyjni Trinisore, një Zot.\* Kushdo ndaras Perëndi është, por një në natyrë.\* Ati, Biri dhe Shpirti, se kanë\* dritën\* e trefishtë krejt në veçori.

#### *Hyjlindësor*

Lindja jote është mbi mendje: Të paraqenin\* që mban çdo gjë, si pashprehshëm e lind, e shtrin, e mënd ti,\* pra të vetmin, çliruesin ton' Krisht?\* Botën\* ky ushqen, e paqortueshme.

*Zbritësore: Ton prodhilothenta en ori*

**B**irin e Gjithnjëvirgjërshës

#### *Dërgimësore*

*O uranôn tis austris*

Ti që si Zot sundon fort\* përmbi sa vdiqën dhe sa rrojn<sup>67</sup>,\* prehi shërbëtorët e tu,\* o Shpëtimtar, në tenda lart\* tok me të zgjedhurit; sado\* fajtuan, s'ikën prej teje.

*Tjetër: Jineqes akutisthite*

Shërbyesit e tu prehi\* në vendin e të



gjallëve;<sup>68</sup> nga çdo rënkim, vaj dhe dhimbje,<sup>69</sup> nga çdo dert, jan' arratisur;\* si njeridashës, ji i but\* për çdo faj që në jetë bën;\* vetëm ti je krejt pa mëkat,\* mëshirëploti dhe Zoti\* i çdokujt që vdiq a rron<sup>67</sup> pra.

### *Hyllindësore*

Mari hyjnuse, ndërmjeto\* te Krishti pa pushim për ne,\* për shërbëtorët e tu krejt\* me profetë hyfyloës\* me bashkësi martirësh pra,\* oshënar\*, hierarkë\* dhe me të drejtët mbarë ne\* të jemi trashëgimtarë\* në mbretëri tok me ta lart.

### *Lavdërimi*

#### *Ting. Tërth. IV O en Edhëm Parádhisos*

Të gjith' vëllezërit, përpara fundit ejani ta shikojm'\* dobësinë e natyrës sonë ne;\* s'ka vlerë dheu, trupi hiç,<sup>70</sup> dhe mbarimin ta shohim drejt,\* enën mishërore dhe organet tok,\* se është pluhur njeriu krejt,\* prishje, ushqim për krimbat tmerr,<sup>69</sup> të thata janë kockat<sup>70</sup> keq,\* s'kanë as frymë; shohim dhe\* vare; lavdia pra,\* bukuria, pamja, syri, vetullat,\* dhe e mira gjuh' ku jan'?'\* Të gjitha janë pluhur edhe hi;<sup>71</sup> ndaj të vijë keq për ne, o Shpëtimtar, dhe dhembshurona ti.

I vdekshmi pse mashtrohet kur krenohet? Balta tronditet kot\* dhe pas pak e njëjtë mbetet; pse s'mendon\* ky, dheu, se është brumi yn'\* pluhur,<sup>7</sup> prishje<sup>69</sup> dhe kalbësi,\* hedhje poshtë? Ndaj, në jemi baltë ne,\* o njerëz,<sup>7</sup> pse jemi tretur keq\* përbrenda tokësoreve?\* Ne një natyrë kemi tok\* bashkë me Krishtin,<sup>72</sup> pse te ky\* nuk rendim? Pse s'lëmë\* tërë jetën që kalon me halle plot\* dhe nuk shkojmë pas jetës\* që s'priset? Është Krishti pra ajo,<sup>73</sup> që për shpirtat tanë është drita dhe shkëlqimi përgjithnjë.

O Shpëtimtar, me dorën tënde e gatove Adamin<sup>7</sup> at,\* si kufi mes vdekjes dhe paprshjes ti\* e vure dhe i hoqe krejt\* prishjen; jetën në Hir i dhe,\* e zhvendose në të parën jetë<sup>70</sup> prap'.\* Zot, shërbëtorët e tu që ti\* more prej nesh, t'i prehësh bashk'\* në korin e të zgjedhurve\* tok me të drejtët; transfero\* emrat e tyre pra\* edhe shkruaji në librin jetësor.<sup>74</sup> Kur t'i ngjallësh me zërin\* e kryeengjëllit dhe me borl,<sup>47</sup> lart për mbretërinë tënde qiejlore denjësoji ti.

Nga prangat të parëgatuarin, Adamin, e zgjidhi krejt,\* shkatërroi dhe fuqin' e Hadhit tok\* pra Krishti, kur u ngjall me lavd,\* vdekja vdiq edhe Hadhi mbar\* u plaçkit, prandaj kurajë kini ju\* të gjith' të vdekurit; Zoti Krisht\* ka mbretëruar se u ngjall\* pas kryqëzimit dhe na dha\* neve në mish paprshje, nder\* ngjalljen ai dhuron,<sup>75</sup> për atë lavd po i denjëson krejt sa\* me gëzim dhe me besë\* që s'tundet fare, me devotshmëri,\* e besuan nxehtësisht, e adhuruan me sinqeritet.

### *Lavdi Nekrosim*

#### *Ting. II I Joan Damaskinoit*

Si lule fishket<sup>76</sup> dhe si ëndërr shkon edhe tretet çdo njeri; por, kur të oshëtijë trumbeta, gjithë të vdekurit si me një bashkëtronditje do të ngrihen përsëri<sup>47</sup> që të të dalin përpara, o Krisht Perëndi;<sup>77</sup> atëherë, o Zoti Krisht, vendosi shpirtat e shërbëtorëve të tu që i more prej nesh, ndër tentat e shenjtoreve të tu.\*

### *Tani Hyllindësor*

Gëzohu, o Mari Perëndiilindëse, tempull i pashkatërrueshëm, për më tempër i shenjtë, siç thërret profeti: Është i shenjtë tempulli yt, i çuditshëm në drejtësi.<sup>78</sup>

*Pasvargjet (e Theofanit) sipas Tingullit të javës.*

Lavdi *Nekrosim*

*Ting. Tërth. II I Joan Damaskinoit*

Ishte dhimbje për Adamin shijimi i drurit qëmoti në Eden, kur gjarpi nxori helm<sup>23</sup> nga goja, sepse nëpërmjet tij hyri vdekja<sup>79</sup> dhe hëngri tërë gjininë njerëzore; por, Zoti, kur erdhi, e vithisi dragoin dhe na dhuroi prehe; prandaj le t'i thërrasim: Të të vijë keq, o Shpëtimtar, dhe prehi së bashku me të zgjedhurit e tu ata që i more.

Tani *Hyjlindësor Injëjti*

Ti je Perëndia ynë që i krijon dhe i mbush të gjitha<sup>80</sup> me urtësi,<sup>81</sup> o Krisht, dërgove profetët që ta profetizonin ardhjen tënde dhe apostujt që t'i shpallnin madhësitë e tua; dhe të parët profetizuan ardhjen tënde, ndërsa të tjerët me anën e pagëzimit i ndriçuan kombet; dhe martirët, si vuajtën, arritën ato që aspironin; dhe ndërmjeton pranë teje kori i dyfishtë tok me lindësen tënde; prehi, o Perëndi, shpirtat që more dhe ne na denjëso për mbretërinë tënde, ti që durove Kryq për mua të dënuarin, o çlirimtari im dhe Zoti im.

*Lexim:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin dhe t'i psalim emrit tënd, o i Tërëllartë, që të njoftojmë në mëngjes mëshirën tënde dhe të vërtetën tënde përnatë.<sup>82</sup>

*Trishenjtji dhe Përlëshoret:*

O i vetmi Krijues

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësore*

Ty të kemi dhe mur

*Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i Triodit Ode III dhe VI. Pas Hyrjes, Përlëshoret: O i vetmi Krijues dhe e kishës. Kontaçi Bashkë me shenjtorët prehi. Kungatore:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot, dhe kujtimi i tyre, në gjeneratë dhe gjeneratë. *Pas Uratës mbrapa Amvonit bëhet Trisaji:* Bashkë me shpirtat e të drejtëve që

kanë mbaruar *etj. si u sqarua në fund të Mbrëmësore, deri edhe Uratën O Perëndi i shpirtave dhe i çdo trupi... Menjëherë Emri i Zotit; dhe Përlëshimi.*

CITIME

1. Matth. 25.33
2. Kol. 1.12
3. Matth. 19.16 etj.
4. I Kron. 16.29
5. Lluk. 16.22
6. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak. 17.3
- 6a. Gjen. 3.19
7. Gjen. 2.7-8; II Makk. 7.23; Ps. 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9
8. Ps. 114(115).9
9. Ps. 117(118).15
10. Rom. 11.33
11. Ps. 61(62).8; 72(73).28; 77(78).7
12. Ps. 64(65).5
13. Ef. 5.8; I Thes. 5.5
14. Ps. 67(68).36
15. Mik. 6.4 etj.
16. Eks. 15.1-19
17. Jud. 4
18. Matth. 18.8; 25.41; Jud. 7
19. Tit. 1.2; 3.7
20. I Thes. 5.5,8
21. Mal. 4.2
22. Ligji i Dytë 32.39
23. Gjen. 3.2-6
24. Joan 5.30; Apok. 16.7; 19.2
25. Joan 5.24
26. Lluk. 17.24
27. I Thes. 4.17
28. Ps. 32(33).6; Osia 13.4; Is. 45.12; 48.13
29. I Mbret [Sam.] 2.1
30. II Kor. 4.6
31. II Tim. 4.8
32. I Kor. 3.13; I Petr. 1.7
33. Joan 6.39,44,54; 11.24
34. Ef. 2.5-6; Kol. 2.12; 3.1
35. Neh. 13.22; Ps. 5.8; 68(69).14; 105(106).7,45; Sirak 51.3; Is. 63.15; Vajt. 3.32; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 18
36. Ju. 9.5-6; Ps. 134(135).6; Urt. Sol. 12.18; Mark. 1.40; Hebr. 1.3
37. Abak. 3.3
38. Abak. 3.19
39. Is. 26.9
40. Matth. 25.46
41. Matth. 8.12; 13.42,50; 22.13; 24.51; 25.30; Lluk. 13.28
42. Joan 17.11, 21-23
43. Jona 2.2-11
44. Vep. 3.15
45. Vep. 2.24
46. Hebr. 4.13
47. I Kor. 15.52; I Thes. 4.16
48. Joan 5.29
49. Is. 11.1
50. Joan 12.47; I Tim. 1.15; I Joan 4.14



51. Is. 35.10  
 52. I Tim. 6.16  
 53. Ps. 101(102).26; 118(119).90; Is. 51.13,16  
 54. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28  
 55. Ps. 67(68).16-17; 73(74).2  
 56. Eks. 19.16; II Petr. 1.18  
 57. Eks. 3.2-3; Ligji i Dytë 33.16  
 58. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 64  
 59. Jov. 3.5 etj.  
 60. I Kor. 2.8  
 61. Lluk. 20.36  
 62. Ps. 43(44). 22; Jer. 39(32).17  
 63. Matth. 18.23-24; 25.19  
 64. Ps. 9.5  
 65. Kënga 4.12  
 66. Ps. 86(87).7  
 67. I Petr. 4.5  
 68. Ps. 114(115).9  
 69. Jov. 7.5; 25.6  
 70. Jez. 37.2-4,11  
 71. Jov. 8.9; Urt. Sol. 5.9  
 72. Rom. 6.5  
 73. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20  
 74. Fil. 4.3; Apok. 3.5; 13.8; 20.15  
 75. Joan 6.39-40,44,54  
 76. Is. 40.6-7; Jak. 1.11  
 77. I Thes. 4.17  
 78. Ps. 64(65).5-6  
 79. Rom. 5.12  
 80. Ef. 1.23; 4.10  
 81. Ps. 103(104).24  
 82. Ps. 91(92).2-3



**E DIELA  
 E TË LIDHURIT TË MISHIT\*  
 NË MBRËMËSORE**

*Thirrto*

*6 ngjallësore dhe 4 të Triodit:  
 Ting. Tërth. II Olin apothëmeni*

**Kur** ke për të ardhur ti,\* gjykatës tepër i drejtë,\* që ta bësh të drejtin gjyq,\* mbi fron lavdi do të jesh ulur; lum' me zjarr\* që do shtangë çdokënd,\* para podiumit\* do të rrjedhë tekta do të jenë të pranishëm bri\* forcat engjëjlore<sup>1</sup> dhe njerëzit\* që do gjykohen plot me tmerr,\* kushdo për çdo gjë që ka bërë keq;\* lypim me besim, atëherë, si i dhembshur, na kurse,\* na

denjëso që të marrim pjes',\* Zoti Krisht, me sa shpëtojn'.

**Librat** do të hapen krejt,\* veprimtarit' njerëzore\* do zbulohen para pra\* fort të padurueshmit podium,<sup>1</sup> ndërsa\* ulërima plot tmerr\* do lëshojë frikshëm\* gjith' lugina e vajtimit,<sup>2</sup> duke parë çdo fajtor\* me vendimin tënd mjaft të drejtë, Zot,\* të çohet në dënim, ndëshkim\* të përjetshëm, sado do qajë kot,\* shumëpërdëlyes i vetëm dhe i dhembshur, o i mir';\* ndaj të të vlijë keq, lutemi,\* dhe për ne që të himnojm'.

**Do** kumbojnë fort borit,\* do zbrazen varret,<sup>3</sup> natyra\* njerëzore totalisht\* do të ngjallet duke u trembur, por hare,\* ngazëllim do të ken'\* sa vepruan saktë,\* duke pritur që të marrim rrogë, ndërsa shkelësit\* do të ulërijnë me frikë se\* do ndahen nga të zgjedhurit\* dhe në Ferr do çohen; na mëshiro,\* Zoti i lavdisë,<sup>4</sup> se je i mirë, dhe na denjëso\* të marrim pjesë në qiell ne\* me ata që të deshën.

**Qaj,** vajtoj ndërsa mendoj\* drejt të përjetshmin zjarr,<sup>5</sup> terrin,\* pra të jashtëmin, Ferrin tok\* si dhe kërcëllimin e dhëmbëve<sup>6</sup> me tmerr,\* krimbin<sup>7</sup> e frikshëm mjaft,\* dhimbjen pa ndërprerje,\* në të ardhmen, që do kenë mëkatarët që pa fund\* bëjnë faje dhe me mendim dinak\* të inatosën ty që je\* i mbimirë; unë i mjeri jam\*<sup>8</sup> midis tyre, madje i pari,<sup>9</sup> por, gjykatës, më shpëto\* me përdëllimin tënd, se ti je\* krejt i dhembshur, Shpëtimtar.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

**Oh,** çfarë frike atëherë kur do të vendosen fronet dhe do të hapen librat, dhe Perëndia do të ulet për gjykim, kur do të jenë të pranishëm me tmerr engjëj dhe do të rrjedhë lumë zjarri!<sup>1</sup> Ç'do të bëj-

\*Shih Matth. 25.31-46

më atëherë ne njerëzit që mbajmë përgjegjësi për shumë mëkate? Kur do të dëgjojmë që ai do të thërrasë të bekuarit e Atit në mbretëri, ndërsa do të dëbojë mëkatarët në Ferr, kush do ta durojë atë vendim të frikshëm? Por, o i vetmi njeri-dashës, Shpëtimtar, mbreti i Jetëve,<sup>10</sup> para se të arrijë fundi, mëshiro më duke më kthyer me anën e pendimit.

Tani *Hyjindësore*  
*Dogmatike e Tingullit të javës*

Në Liti

*Idhiomeli i parë i kishës*

Lavdi *Ting. i Rëndë*

Duke i ditur porositë e Zotit, le të jetojmë kështu: Le të ushqejmë të uriturit, le t'u japim ujë të eturve, le të veshim të zveshurit, le të mirëpresim të huajt, le të vizitojmë të sëmurët dhe të burgosurit, që të na thotë dhe neve ai që ka për të gjykuar të tërë dheun:<sup>11</sup> Ejani, të bekuarit e Atit tim, trashëgojeni mbretërinë që u përgatit për ju.

Tani *Hyjindësore*

Nën strehën tënde, o Zonjë, pasi përikim, të gjithë ne të dhelindurit të thërrasim: O Perëndilindëse, shpresa jonë, çlirona nga shkeljet e panurmëta dhe shpëtoji shpirtat tanë.

*Pasvargje ngjallësore*

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Mjerë, o shpirt i zi! Deri kur nuk do të heqësh dorë nga të këqijtat? Deri kur do të dërgësh në dembelizëm? Pse nuk sjell në mend orën e frikshme të vdekjes? Pse nuk trembesh i tëri nga tribuna e frikshme e Shpëtimtarit? Vallë çfarë do të kesh si mbrojtje a çfarë do të përgjigjesh? Veprat e tua janë të pranishme për kritikën tënde, veprat e tua të kontrollojnë duke të qortuar; ndaj, o shpirt, koha erdhi, vrapo, arrí, thirr

besërisht: Mëkatova, o Zot, mëkatova kundër teje,<sup>12</sup> por unë e njoh, o njeridashës, dhembshurinë tënde; o bari i mirë,<sup>13</sup> mos më veço nga qëndrimi në të djathtë tënde, për shkak të përdëllimit tënd të madh<sup>14</sup>.

Tani *Hyjindësore*

Virgjëresh' e panusëruar, që zure trupërisht Perëndinë pa tregim, Nën' e Perëndisë së lartë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu, o e gjithëpanjollëshme. Ti që u fal të gjithëve paqësim mëkatesh, prit lutjet tona tani dhe lutu që të shpëtohen shpirtat tanë.\*

*Përlëshore ngjallësore*



## NË MËNGJESORE

*Në Shërbesën e Mesnatës, pas Kanunit Triadik, Litia, Himne Triadike, Trishenjtë, Ipakoia e Tingullit etj. Në Mëngjesore shërbesa e zakonshme, por, në vend të Kathizmës së tretë të sotme (e të Paqortueshmë, Ps. 118), psalet Polielei: Ps. 136. Bekimoret etj. Kanunet: Ngjallësori në 4, Kryqngjallësori në 2 dhe i Triodit në 8 (Poezi e Theodor Studitit):*

*Ting. Tërth. II*

*Ode I*

*Voithòs që sqepastis*

Trembem kur më vjen në mend dhe parasoh, i tërëpushtetshëm,\* ardhjen tënde, ditën me plot frikë, Zot,\* e cila s'rrëfëhet, kur do utesh që të gjykosësh sa rojnë dhe sa s'rojnë.<sup>15</sup>

Kur të vish me mijëra pa fund pra engjëjsh si dhe pushtetesh\* qiellore,<sup>1</sup> mua të mjerin, o Krisht,\* Zot, më denjëso ti që të dal para teje përmbi re,<sup>16</sup> o Perëndi.

Eja, sill në mendje, shpirt, atë moment, orë edhe ditë,\* kur do të arrijë pra Zoti



dukshëm;\* vajto edhe qaj që, gjatë orës së gjyqit, ti të jesh i pastër krejt.

**M**ë tmerron, më shtang ai zjarr i pashueshëm i Gjehenës,\*<sup>17</sup> krimbi<sup>7</sup> vrer, kërcitja e dhëmbëve<sup>6</sup> tok;\* por, o Krisht, më fal, më ndje, radhitmë në vendin e të zgjedhurve të tu.

**T**a dëgjoj dhe unë qyqi zërin tënd aq të dëshiruar,\* që i fton të shenjtët në gaz<sup>18</sup> dhe kështu\* ta gjej pra shijimin që s'rrëfeket në mbretërinë qiellore<sup>19</sup> lart.

**T**i mos hap gjyq, mos m'i sill ato që duhej t'i kisha bërë,\* duke më kërkuar, Zot, fjal', llogari\* për vrullet, por më shpëto, m'i fal fajet, i Tërëpushtetshëm, dhembshurisht.

#### Triadik

**O** Njësi trihipostate krejt eprore, Zonjë e çdokujt,\* përmbi çdo pushtet, celebruese, Zot,\* shpëtona ti, Atë, Bir edhe Shpirt i Tërëshenjtë, një fuqi, një lavd.

#### Hyjllindësor

**C**ila lindi bir që s'bëri sipas ligjit një atë, veçse\* Ati lind atë, por pa nënë, çudi\* me plot paradoks, se, e Dëllirë, ke lindur Zot-neri njëkohësisht.

#### Zbritësore: Voithós qe sqepastis

»**M**u bë ndihmës, mbrojtës, shpëtimtar, «ky është Perëndia im pra\* dhe do ta lëndoj, «është Zoti ai\* për atin tim, do ta lartësoj «shumë, se u lavdërua plot me lavd.<sup>20</sup>

#### Ode III

#### Steréoson Kirie

**V**jen Zoti, kush do të jet\* i aft' që frikën e tij ta mbajë,\* të dal' para faqes së atij,\* dhe të rrijë? Përgatitu, shpirt, ta takosh atë.<sup>16</sup>

**T**ë qajm', të arrijmë pra\* që të pajtohemi para fundit\* ne me Zotin,<sup>21</sup> se e frikshme

tmerr\* është tribuna, ku të gjithë faqeza<sup>22</sup> do qëndrojm'.

**T**hërras: Përdëlleme, Zot,\* më mëshiro, kur të vish me engjëjt\* të shpërblesh të gjithë njerëzit,\* Perëndi, pas vlerave të punëve<sup>1</sup> që bënë.

**I**natin tënd pa kufi\* në gjyqin tënd si do ta duroj un'\* që s'iu binda urdhërimit tënd?\* Por kursemë,<sup>23</sup> të të vijë keq kur të më hetosh.

**R**ënko, shpirti im mjeran,\* dhe ktheu para se të mbarojë\* jeta, panairi tokësor,\* edhe derën nusërore Zoti ta mbyllë<sup>24</sup> lart.

**K**am bërë mëkate plot,\* aq s'mëkatoi asnjeri tjetër,\* bëra faje më shumë' se çdokush;\*<sup>9</sup> para gjyqit dhembshuromë, o njeridashës Zot.

#### Triadik

**T**rini e pabër', e thjesht',\* natyrë pa nisje, që himnohesh\* lart në treshe hipostazash ti,\* me besim i falemi pushtetit tënd, na shpëto.

#### Hyjllindësor

**H**yjllindëse krejt pa cen,\* e lulëzove me lindje pa far\* Fjalën që rron, me një mi-shërim\* brenda barkut tënd, por s'u ndryshua; lavd Birit tënd.

#### Zbritësore: Steréoson Kirie

»**F**orco zemrën time, Krisht,\*<sup>25</sup> të tundur «keq,<sup>26</sup> përmbi gurin, shkëmbin,\* pra të «urdhrave të tu<sup>27</sup> fort ti,\* se je Zoti i vetëm «dhe i shenjtë; lavdi më ty.

#### Ndenjësore

#### Ting. I Ton tafon su Sotir

**T**ribuna jote është e frikshme, i drejtë\* gjykimi yt,<sup>28</sup> të tmerrshme jan' veprat e mia,\* por ti arri, shpëtomë, o përdëllyes, nga Ferri skrop;\* më çliro, o Zot,\* mua nga pjesa e dhive,\* denjësom' të rri,\*

grykatës tepër i drejtë,\*<sup>28a</sup> në të djathtën tënde lart.<sup>28b</sup>

### *Hyjlindësore*

Përmes Shpirtit Hyjnor,\* e dëllirë, e Virgjër,\* e tërëpaqortueshme, mbajte në mitër\*<sup>29</sup> atë që bëri gjërat mbar\*,<sup>30</sup> Perëndin' tënd, e linde ti\* pa dëm, prishje pra;\* kur e lëvdojmë atë fort,\* të himnojmë ty,\* pallat i mbretit të lavdit,\* shpërblësë e kozmosit.

### *Tjetër Ting. Tërth. II*

Kujtoj ditën e frikshme dhe qaj për veprimet e mia dinake. Si do të mbrohem para mbretit të pavdekshëm? Me çfarë guximi do ta shikoj në sy grykatësin unë i pakorrigjuari? O Atë i dhembshur, Bir i vetëmlindur dhe Shpirt i Shenjtë, mëshiromë.

### *Lavdi*

Në luginën e qarjes, në vendin që rregullove,<sup>2</sup> kur të ulesh, o Mëshirues, që të bësh gjykim të drejtë,<sup>28</sup> mos i nxirr para publikut të fshehtat e mia, as mos më turpëro rëndë para engjëjve,<sup>1</sup> por kursemë, o Perëndi, dhe përdëlleme.<sup>23</sup>

### *Tani Hyjlindësore*

O shpresa e mirë e botës, Hyjlindëse e virgjër, kërkoi mbrojtjen tënde, të vetmen të frikshme; dhembshuroje popullin që është në peripeci, përgjëroju Perëndisë mëshirues që të çlirohen shpirtat tanë nga çdo kërcënim, o e vetmja e bekuar.

### *Ode IV*

#### *Akikoen o profitis*

Arriti dita, tashmë para dyerve është gjykimi; o shpirt, ji gati; atje grumbullohen së bashku mbretër dhe arkondë, të pasur dhe të varfër, dhe çdo njeri do të marrë sipas atyre që ka bërë.

Do të hetohen në grupin e tyre monaku dhe hierarku, plaku dhe i riu, shërbëtori

dhe pronari; e veja dhe virgjëresha do të mbajnë përgjegjësi; dhe është shkruar se të atëhershmet do të jenë të vështira për gjithë ata që nuk e kanë jetën të pajshme.

Gjykimi yt do të jetë i pakorruptuar,<sup>31</sup> katedra jote e pagabueshme nga sofizmat, nuk do të ketë mundësi mashtrimi nga oratorë, as shtrembërim nga dëshmitarë që falsifikojnë të drejtën, sepse para teje, Perëndisë, qëndrojnë të gjitha të fshehurat.

Le të mos vij në tokë qarjeje,<sup>2</sup> le të mos e shoh vendin e errësirës, o Krishti im Fjalë, le të mos lidhem në duar dhe këmbë për t'u hedhur jashtë nusërores sate, sepse unë i tërëmjeri do ta kem të ndotur rrobën<sup>32</sup> e paprishjes.

Kur do të ndash mëkatarët nga të drejtët gjatë gjykimit të botës,<sup>11</sup> pasi të më largosh nga dhitë, rreshtomë si një nga delet e tua, o Njeridashës, që ta dëgjoj atë zërin tënd të bekuar.

Kur do të bëhet shqyrtim dhe do të hapen librat<sup>1</sup> e veprave, çfarë do të bësh, o shpirt i mjerë? Si do të mbrohesh mbi tribunë, duke mos pasur fryte drejtësie<sup>33</sup> që t'i sjellësh Krishtit, Gatuesit tënd?

Duke dëgjuar vajtimin e të pasurit në fllakën e torturës,<sup>34</sup> qaj dhe vajtoj unë mjerrani, sepse jam në të njëjtin dënim; dhe lutem, mëshiromë, o Shpëtimtar i botës,<sup>35</sup> në kohën e gjyqit.

### *Triadik*

Lavdëroj Bir prej Ati dhe Shpirt si dritë dhe rreze dielli: njërin, të lindurin, sepse edhe është lindur; tjetrin, të dalin, sepse edhe ka dalë, pra Trini hyjnore të bashkëpafillim, së cilës i falet tëra Krijesa.



*Hyjlindësor*

**T**i u shfaqe virgjëreshë, ndonëse linde foshnjë, dhe ruajtëse e dëlirësisë kur linde Perëndinë dhe njeriun, një dhe të njëjtin në secllën formë; mrekullia jote, o Virgjëreshë-nënë modeste, habit çdo dëgjim dhe mendje.

*Zbritësore: Akikoen o profitis*

»Dëgjoji për ardhjen tënde\* profeti dhe e «kapi frika, se do të lindësh\* nga e Virgjra, «edhe njerëzve në dhë\* do t' u shfaqesh ti, «do t' u tregohesh krejt,\* dhe thoshte: Zot, «dëgjimin tënd e dëgjova plot tmerr,\* dhe «kam frik\*;<sup>36</sup> lavdi forcës sate pra.

*Ode V**Ek niktós orthrizonta*

**T**merr të parrëfyeshëm dhe frikë do të ketë atje, sepse do të vijë Zoti<sup>18</sup> dhe bashkë me të puna e çdo njeriu; prandaj, kush nuk do të qajë që nga këtu për veten e tij?

**M**ë shqetëson lumi i zjarrtë,<sup>1</sup> më tret, më bren kërcëllimi i dhëmbëve, terri i avushës;<sup>6</sup> dhe si e çfarë të bëj, që ta zbut Perëndinë?

**K**urseje, kurseje, o Zot,<sup>23</sup> shërbëtorin tënd; mos më dorëzo ndonjëherë te torturuesit e hidhur,<sup>37</sup> tek engjëjt e rrëmbyeshëm, atje ku s'është e mundur të gjej prehje prej tyre.

**A**tje mban njësoj përgjegjësi sovranit dhe kreu, i pasuri, i parëndësisimi, i madhi bashkë me të voglin; pra, mjerë për çdo njeri që s'është përgatitur!

**L**ëri, ndjeji, fali, o Zot, sa mëkatova ndaj teje, dhe mos më trego atje, para engjëjve,<sup>1</sup> të dënuar në zjarr,<sup>6</sup> turp pa fund.

**L**e të të vijë keq, le të të vijë keq,<sup>23</sup> o Zot, për krijesën tënde; mëkatova, falmë, sepse ti je i vetmi i pastër nga natyra,<sup>38</sup>

dhe askush tjetër, veç teje, nuk është pa njollë.

*Triadik*

**O** Trini, të himnoj si Njësi në natyrë, pa fillim, pa konceptim, zotëruese, mbretërore, Njësi e përmbipërsosur, Perëndi, dritë dhe jetë, krijuese e kozmosit.

*Hyjlindësor*

**N**ë shtatzëninë tënde të përmbinatyrshme, o Modeste, shfuqizohen qartësisht prej teje ligjet e natyrës, sepse lind pa farë atë që lindti nga Ati, Perëndinë para jetëve.<sup>39</sup>

*Zbritësore: Ek niktós orthrizonta*

»**P**o mëngoj menatë, njeridashës Zot,\* «lutem, ndriçomë ti,\* udhëhiq më në drejtim,\* në urdhrat e tu mua,\*<sup>40</sup> mësomë që «përherë\* të bëj dëshirën tënde.<sup>41</sup>

*Ode VI**Evvoisa en oli kardhia mu*

**K**risht Shpëtimtar,\* do shfaqesh prej qiellit\* përgjatë ardhjes sate pra\* mjaft të frikshme; frone do vihen edhe libra\* do të hapen<sup>1</sup> krejt;\* më kurse<sup>23</sup> atëherë.

**A**tje asgjë\* s'ndihmon, se nuk mundet dot,\* as art, as miqësi, as lavd,\* as nxitim, se është glykatës Perëndia,\* por, o shpirti im,\* forca jote nga veprat.

**A**tje jan' tok\* arkond edhe pushtetar,\* skamës, shpirt, dhe i pasur fort,\* s'ka fuqi, as atë, as nënë ndihmëtare,\* as vëlla çliron\* nga dënimi në jetë.

**O** shpirt, mendo\* hetimin e frikshëm tmerr\* pra të glykatësit, kështu\* nga këtu tmerrrohu dhe fjalën përgatite\* t'mos dënohesh keq\* me zinxhir' të përjetshëm.

**T**ë mos dëgjoj,\* Zot, kur do të më dëbosh:\* «Merr çfarë ke», as tjetër zë:\*<sup>42</sup> «Ik te zjarr, nëma», por zërin që pëlqehet krejt\* të

drejtuar pra\* te të gjithë të drejtët.

Çliromë, Zot,\* nga portat e Hadhit posht\*, kaosi, terri pa ndriçim,\*<sup>42a</sup> zjarri që nuk shuhet,<sup>17</sup> prej çdo dënimi tjetër\* të përjetshëm tmerr\* edhe nga të nëndeshmet.

### Triadik

Himnojt Hyjni,\* Njësi trinisore lart,\* Atin me Birin, Shenjtin Shpirt,\* pra pushtet të cilin e ka një kryesi, Zot,\* që është ndarë tok\* bashk' në tri karaktere.

### Hyjlindësor

Je porta ti\* që vetëm Jisui Bir,\* bërësi i Adamit<sup>43</sup> pra,\* e kaloi, hyri dhe doli, e kulluar,\* por s'i prishi kurr\* kyçet<sup>44</sup> e virgjërisë.

### Zbritësore: Evôisa en oli kardhia mu

»Nga zemra thell\* drejt Zotit, të dhembshurit,\* thirra dhe më dëgjoji ky\* teksa fare poshtë, në Hadh pra, isha unë\* dhe ma ngriti lart\* jetën time prej prishjes.<sup>45</sup>

### Kontaqi Ting. I

Kur të vish, o Perëndi, mbi dhë me lavdi<sup>46</sup> dhe do të trembet Gjithësia, do të rrjedhë para tribunës lumë zjarri, do të hapen librat<sup>4</sup> dhe do të publikohen të fshehurat,<sup>47</sup> atëherë çliromë nga zjarri i pashuar<sup>17</sup> dhe denjësomë të qëndroj në të djathtë të tände, o Gjykatës tepër i drejtë.<sup>28a</sup>

### Shtëpia

Kur sjell ndër mend gjykatën tënde të frikshme dhe ditën e gjyqit, o Zot i përmimirë, tmerrohem dhe frikësohem prej ndërjegjes sime që më kritikon; kur do të ulesh mbi fronin tënd\* për të bërë hetim, atëherë askush nuk do të ketë fuqi t'i mohojë mëkatet, kur do të kontrollojë e vërteta dhe do të pushtojë frika; zjarri i Gjehenës<sup>48</sup> do të lëshojë jehonë të madhe, ndërsa mëkatarët do të dridhen; ndaj mëshiromë para fundit dhe kurse-

më,<sup>23</sup> o Gjykatës tepër i drejtë.<sup>28a</sup>

### Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Në të njëjtën ditë, kujtojmë Ardhjen e Dytë dhe të pakorrupsueshme të Zotit tonë Jisu Krisht.

*Vargje:* O Gjykatës i të gjithave, kur të ulesh që të gjykosësh dheun,/ gjykomë edhe mua si të denjë për fjalën "Ejani". Me anën e njeridashjes sate të parrëfyeshme, o Krisht Perëndi, denjësona dhe ne për zërin tënd të dëshirueshëm, numërona bashkë me ata që do të jenë në të djathtë të tände dhe mëshirona. Amin.

### Ode VII

#### Imärtomen, inomisamen

O besnikë, le të biem në gjunjë dhe le të qajmë para atij gjyqi, kur qlejt do të shkatërrohen,<sup>49</sup> yjet do të bien<sup>50</sup> dhe e tërë toka do të tundet,<sup>51</sup> që ta gjejmë në fund të butë Perëndinë e etërve.<sup>52</sup>

Hetimi është pa rryshfet, vendimi është i frikshëm atje ku ka Gjykatës të pagabueshëm, ku s'ka mundësi të mbahet anë nëpërmjet dhuratash.<sup>31</sup> Ndaj kurseme, o Zot,<sup>23</sup> dhe çliromë prej inatit tënd të tmerrshëm.

Zoti vjen që të gjykojë, kush e duron fanitjen e tij? Frikësohu, o shpirti im mjeran, tmerrohu dhe përgatiti punët e tua për daljen, që ta gjeshtë butë dhe të dhembshur atë, Perëndinë e etërve.<sup>52</sup>

Më mërzit fort zjarri i pashuar,<sup>17</sup> kërcëllimi shumë i hidhur<sup>6</sup> i krimbave,<sup>7</sup> më frikëson Hadhi shpirtprishës, mirëpo fare nuk prekem lehtë për kataniks; kështu, o Zot, o Zot, para fundit më mbështet në frikën tënde.

Bie para teje dhe të sjell si lot fjalët e mia: Mëkatova jo siç mëkatoi Lavirja<sup>53</sup>



dhe fajtova si askush tjetër mbi dhe;<sup>9</sup> mirëpo, o Zot, dhembshuroje krijesën tënde dhe rithirrme.

**K**thehu, pendohu, zbuloji të fshehurat, thuaja Perëndisë, i cili i di të gjitha.<sup>54</sup> Ti, Shpëtimtari i vetëm, i njeh sekretet e mia,<sup>55</sup> ndaj ti më mëshiro sipas përdëllimit tënd, siç psal Davidi.<sup>56</sup>

#### *Triadik*

**I** himnoj që të Tre si një, sipas esencës, dhe Njësinë si tre, sipas Personave; këta janë Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë, një fuqi, mendim dhe energji, një Perëndi i trishenjtë, një mbretëri, monarki e skajshme.

#### *Hyjlindësor*

**D**el nga dhoma, nga barku yt, Perëndi tepër i bukur, porsi perandor i veshur me mantel të hyjthurur nëpërmjet ngjyrës mistike, nëpërmjet gjakrave të tua të tërëdëlira, dhe mbretëron mbi dhë,<sup>57</sup> o e Panusëruar.

#### *Zbritësore: Imärtomen, inomisamen*

»Fajtuam ne,\* mëkatuam ne,\* para te-  
»je bëm' padrejtësi ne,\* s'i ruajtëm ne,  
»s'i zbatuam ne porosit' e tua<sup>58</sup> ne të pa-  
»mendët, o Zot,\* por mos na dorëzo ne në  
»fund ti,<sup>59</sup> o Perëndi i etërve, pra.<sup>52</sup>

#### *Ode VIII*

##### *On stratië uranón*

**D**uke menduar takimin në ardhjen tënde të dytë<sup>16</sup> të frikshme, o Zot, trembem nga kërcënimi yt, frikësohem nga inati yt; thërras: Shpëtomë përjetë nga kjo orë.

**K**ush nga të dhelindurit, duke qenë me pasione, do të ketë durim kur ti, Perëndia, do të gjykos Gjithësinë?<sup>11</sup> Sepse atëherë do t'i kapë të dënuarit përjetë zjarr i pashuar<sup>17</sup> dhe krimbi<sup>7</sup> që kërcëllit<sup>6</sup> shumë.

**K**e ftuar gjithë frymët për gjykim së bashku, o Krisht; atëherë do të jetë e madhe frika, e madhe nevoja, ndërsa do të ndihmojnë përjetë vetëm veprat.

**O** Gjykatës i të gjithëve,<sup>11</sup> Perëndia im dhe Zot, le ta dëgjoj atëherë zërin tënd të dëshirueshëm, le ta shikoj dritën tënde të madhe,<sup>60</sup> le t'i vëzhgoj tendat e tua, le ta shoh lavdinë tënde duke u ngazëlluar përjetë.

**O** Shpëtimtar, gjykatës i drejtë,<sup>28</sup> mëshirromë dhe çliromë nga zjarri dhe kërcënimi që kam për të pësuar drejtësisht në gjykim; falmë para fundit nëpërmjet virtytit dhe pendimit.

**K**ur do të ulesh si gjykatës i dhembshur dhe do ta tregosh lavdinë tënde të frikshme, o Krisht, oh, çfarë tmerri atëherë, kur do të digjet kaminë teksa do të frikësohen të gjithë nga podiumi yt i padurueshëm!

#### *Triadik*

**A**dhuroj një Perëndi sipas esencës, himnoj tri hipostaza që ndahen ndryshëm, por që nuk janë të ndryshme, sepse është një Hyjni në tre Persona, Atë, Bir dhe Shpirt Hyjnor.

#### *Hyjlindësor*

**K**rishti u shkëlqeu një dritë të madhe atyre që ishin në errësirë,<sup>60</sup> pasi doli nga mitra jote e ndritshme, si dhëndri nga dhoma nusërore,<sup>61</sup> sepse, kur feksi si diell drejtësie,<sup>62</sup> e llamburitit botën, o e Dëllirë.

#### *Zbritësore: On stratië uranón*

»E lavdërojm' Zotin lart ushtritë qiellore,  
»e kanë frik' Keruvimet tok\* me Serafi-  
»met; çdo frymë, çdo krijim, bekoje,\* për-  
»mbilartësoje, himnoje në gjith' jetët.<sup>63</sup>

#### *Ode IX*

##### *Asporu silipseos*

Vjen që të dënojë mëkatarët, t'i shpëtojë, porsì Zot, të drejtët;\* të tmerrohemì, të qajmë duke menduar ne\* ditën konkrete; në të\* të fshehtat tona do t'i zbuloj\* dhe sekretet e secilit,\* dhe do të shpërblejë<sup>47</sup> denjësisht.

U tremb, u tmerrua Moisiu kur të pa nga prapa;<sup>64</sup> un' i mjeri\* si do të duroj pra atëherë kur ta shikoj\* fytyrën, kur të vish ti\* nga lart, nga qielli? O i mir',\* të të vijë keq për mua,\* o i dhembshur, me shikim të but'.<sup>23</sup>

U tremb Danieli, Zot, nga ora e hetimit;<sup>65</sup> unë qyqì çfarë\* kam për të pësuar kur në k'të dit' të frikshme tmerr\* do shkoj? Ndaj para vdekjes\* më bëj ti që të adhuroj\* mjaft pëlqyeshëm, kështu pra\* mbretërinë tënde ta fitoj.

Gititet tash zjarri, krimbi rregullohet,<sup>7</sup> por dhe lavdi ngazëllues,\* prehja, drita që s'ka perëndim, gazi plot hare\* për sa të drejtë janë;\* kush është' i lum të shpëtojë drejt\* prej ndëshkimeve të para\* dhe të trashëgojë të dytat?

Mëria, inati yt, të mos më hedhë larg fytyrës sate, o Zot,<sup>66</sup> dhe të mos dëgjoj kur' zërin tënd që rremben dhe hedh,\* dërgon në zjarr.<sup>32</sup> por unë\* të hyj atëherë në haren'\* që ka nusërorja jote\*<sup>24</sup> e paprishshme, me shenjtorët tok.

Mbarimi është' para teje se u dobësua fjala, plag' ka trupit,\* trauma ka mendja dhe sëmundje ka fryma plot,\* jeta po vdes; ç' do bësh ti,\* o shpirt i mjerë, kur për hetim\* do të vijë pra gjyqtari\* që të shohë veprat që bëre?

### Triadik

O Atë i vetëm që ke lindur një, të vetmin Bir, o Fjalë, dritë,\* vezullim<sup>67</sup> i Mendjes,

si dhe dalje e vetme krejt\* nga Ati krejt i vetëm,\* pra Shpirt prej Zotit të vetëm; Zot,\* o Njësi, Trini e shenjtë,\* të theologoj, shpëtomë ti.

### Hyjllindësor

Çudia e lindjes sate më çudit, e Tërë-pacenuar, Zonjë;\* ti pa farë të panxënshmin, thuamë, si e nxë\* si nënë, meqë linde,\* por je e virgjër? Kur të mendosh\* me bes' të përmbinatyrshmen,\* falju Birit tim, se bën sa do.<sup>68</sup>

*Pas Zbritësoreve, i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor dhe Idhiomelet Hapmi dyert; Drejtomë në rrugët; Unë i mjeri (fq. 10).*

Më të nderuarën. *Dhe Zbritësorja:*

### Asporu silpseos

»Pa prishje në bark ka nxënë, nënë pa «burr', lindja s'ka shpjegim, se zënia\* ish «pa farë, Perëndia lind dhe natyrat ky\* i «rinovon; prandaj ne,\* të gjithë brezat,<sup>69</sup> «orthodhoksisht\* ty të madhërojmë plot «mall\* si hyjnuse, Nënë pa qortim.

### Dërgimësore ngjallësore dhe të Triodit:

#### Tis mathitës sinélithomen

O Zot, kur ditën plot me tmerr\*<sup>70</sup> të gjyqit tënd dhe lavdit\* që s'shprehet, e mendoj, kam tmerr,\* frikë, i tëri dridhem,\* thërras: Mbi dhë kur të vish, Krisht,\* o Perëndi, me lavd ti\* të na gjykosh të gjithë ne,\*<sup>11</sup> atëherë çliromë nga çdo ndëshkim,\* se i mjerë jam; denjësomë, o Zot,\* që në të djathtën tënde un'\* të rri si i shpëtuar.

### Tjetër: Jineqes akuitisthite

Ja ditë Zoti plot pushtet\* po vjen; kush do durojë vall'\* frikën e ardhjes së tij pra,\* praninë e tij, se është\* dita e zemërimit vër\*<sup>71</sup> dhe kaminë që digjet tmerr;\* në këto ditë ky gjyqtar\* do ulet dhe do të ndajë\* sipas veprimit të çdokujt.

### Hyjllindësore



Kur orën e hetimit ton\* në ardhjen plot me frikë, tmerr\* të njerdashësit, Zotit,\* e sjell në mend, tërësisht pra\* dridhem, dhe zymtësisht thërras:\* O i drejti gjykatës,\*<sup>28a</sup> mëshirëplot' i vetëm je,\* pranomë se po pendohem,\* porsì Hyjlin-dësja lutet.

*Lavdërime (me Vargjet e së dielës):*

*5 ngjallësore dhe 3 të Triodit:*

*Ting. Tërth. II*

**E** sjell ndër mend atë ditë dhe orë, kur të gjithë lakuriq dhe si të dënuar kemi për të qëndruar para gjykatësit të pakorruptueshëm.<sup>31</sup> Atëherë një trumbetë do të oshtijë fort dhe themelet e dheut do të lëkundin, dhe të vdekurit do të ngrihen nga varret,<sup>3</sup> dhe të gjithë do të bëhen një moshë; dhe të fshehtat e të gjithëve do të jenë të dukshme<sup>72</sup> para teje; dhe do të vajtojnë, dhe do të qajnë dhe do të shkojnë në zjarr më të jashtëm ata që kurrë nuk u penduan; dhe me ngazëllim dhe hare pjesa e të drejtëve do të futet në nusëroren qiellore.<sup>24</sup>

**Oh**, sa e tmerrshme do të jetë ora dhe dita atëherë, kur të rrijë Gjykatësi mbi një fron të frikshëm! Librat hapen,<sup>1</sup> dhe veprat kallëzohen, dhe të fshehtat e errësirës<sup>72</sup> publikohen.<sup>73</sup> Engjëj rendin rrotull, duke përmbledhur gjithë kombet.<sup>74</sup> Ejani, dëgjoni, mbretër dhe krerë, robër dhe të lirë, mëkatarë dhe të drejtë, të pasur e të varfër, se vjen ai që ka për të gjykuar gjithë botën;<sup>11</sup> dhe cili do të durojë faqen e tij, kur t'i rrinë pranë engjëj duke kallëzuar punët, qëllimet, mendimet e natës e të ditës? Oh, çfarë ore do të jetë ajo atëherë! Po, para se t'arrijë fundi, nxito e thirr, o shpirt: O Perëndi, kthemë dhe shpëtomë si i vetmi i mëshirshëm.\*

*Ting. Tërth. IV*

**P**rofeți Daniel, që ish njeri dëshirash,<sup>75</sup> duke parë fuqin' e Perëndisë, thërriste kështu: "U vendos gjykatore dhe librat u hapën".<sup>1</sup> Shih, o shpirti im, a agjëron? Mos nga të afërmin tënd. Largohesh nga të ngrënat? Mos gjyko tët vëlla,<sup>76</sup> që të mos dërgohesh në zjarr e të digjesh si qiri,<sup>77</sup> po të të futë Krishti pa ndalim në mbretërinë e tij.\*

Lavdi *Ting. I*

**L**e të pastrojmë më përpara veten tonë, o vëllezër, me mbretëreshën e virtyeteve, se ja ku arriti duke na sjellë pasuri të mirash; ajo zbut fryrjet e pasioneve dhe pajton me Zotin ata që fajtuat;<sup>21</sup> prandaj le ta mirëpresim me ngazëllim, duke i thirrur Krishtit Perëndi: Ti që u ngjalle së vdekurish, ruana të padënuar ne që të lavdërojmë ty të vetmin të pamëkatshëm.<sup>38</sup>

Tani

E përmbibekuar

*Dhoksologjia e Madhe:*

*Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Triodit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore dhe e kishës. Kontaqi i sotëm Kur të vish, o Perëndi.*



**NË TË NJËTËN TË DIEL NË MBRËMËSORE**

*Thirrto: 3 të Oktoihut dhe 3 të Mujorit.*

Lavdi dhe Tani *Hyjindësore e tij.*

*Nuk bëhet Hyrje. O dritë gazmore. Proqimëni i ditës. Pasvargjet vetëm të mëposhtme Ting. Tërth. IV:*

*Idhiomeli*

**P**ërderisa kishim grykësi, pësuam zhveshjen e parë, meqë u mundëm nga shiji-

mi<sup>78</sup> i hidhur dhe u internuam nga Perëndia;<sup>79</sup> por le të kthehemi drejt pendimit dhe le t'i pastrojmë shqisat, kundër të cilave është lufta, duke ndërfutur kreshmën, duke siguruar zemrat me shpresë hiri, jo me ushqime me të cilat nuk kishin dobi ata që ecën;<sup>80</sup> dhe në natën e hyjshme dhe dritëprurëse të Ngritjes do të hamë Qengjin e Perëndisë,<sup>81</sup> theroren që u soll për ne<sup>82</sup> dhe që u kungua me Nxënësit në mbrëmjen e Misterit<sup>83</sup> dhe që zhduk injorancën e errësirës me dritën e Ngjalljes së tij.

**Varg:** Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

### *Injëjti*

**Varg:** Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

### *Martirik*

**O** martirë të Zotit, shenjtëroni çdo vend dhe shëroni çdo sëmundje; lutemi, dhe tani ndërmjetoni që të çlirohen shpirtrat tanë nga kurthet e armikut.

### *Lavdi dhe Tani Hyjlindësor*

**Q**ieletore të himnojnë, o nënë e panusëruar hirplote, dhe ne e lavdërojmë lindjen tënde të pagjurmësuar; o Perëndilindëse, ndërmjeto që të shpëtohen shpirtrat tanë.

### *Etj. si zakonisht.*

### *CITIME*

Gjykimi i fundit: 25.31-46

1. Dan. 7.9-10  
2. Ps. 83(84).7

3. I Kor. 15.52; I Thes. 4.16  
4. I Kor. 2.8  
5. Matth. 18.8; Jud. 7  
6. Matth. 8.12; 13.42,50; 22.13; 24.51; 25.30; Lluk. 13.28  
7. Mark 9.44,46,48  
8. Rom. 7.24  
9. I Tim. 1.15  
10. Ps. 144(145).13; I Tim. 1.17  
11. Vep. 17.31  
12. Lluk. 15.18-20  
13. Joan 10.11,14; Hebr. 13.20; I Petr. 2.25; 5.4  
14. Num. 14.19 etj.  
15. Vep. 10.42; II Tim. 4.1; I Petr. 4.5  
16. Matth. 24.30; I Thes. 4.17  
17. Matth. 3.12; Mark 9.43,45; Lluk. 3.17  
18. Matth. 25.21,23  
19. Matth. 3.2  
20. Eks. 15.1-2; Sirak 51.2  
21. Rom. 5.10; II Kor. 5.18,20  
22. Hebr. 4.13  
23. Neh. 13.22  
24. Matth. 25.10  
25. I Mbret [Sam.] 2.1  
26. Sirak 48.19  
27. Matth. 7.24-25; Lluk. 6.48  
28. I Petr. 2.23  
28a. Ps. 7.12; II Tim. 4.8  
28b. Matth. 25.31-33  
29. Lluk. 1.35  
30. Sirak 24.8; Joan 1.3; Kol. 1.16  
31. Ligji i Dytë 10.17; II Kron. 19.7; I Petr. 1.17  
32. Matth. 22.11-13  
33. Fil. 1.11; Jak. 3.18  
34. Lluk. 16.22-24  
35. Joan 4.42; I Joan 4.14  
36. Abak. 3.1-2  
37. Matth. 18.34  
38. Joan 8.46  
39. Ps. 54(55).20  
40. Is. 26.9  
41. Ps. 142(143).10; Matth. 7.21  
42. Matth. 20.13  
42a. Amos 5.20  
43. Gjen. 2.7-8  
44. Jez. 44.1-4  
45. Jona 2.3-7  
46. Lluk. 9.26  
47. Rom. 2.16  
48. Matth. 5.22; 18.9; Mark 9.43,45  
49. I Petr. 3.10  
50. Matth. 24.29; Mark 13.25; Apok. 6.13  
51. Matth. 24.7; Mark 13.8; Lluk. 21.11; Apok. 6.12; 16.18  
52. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,8  
53. Lluk. 7.37-38  
54. Joan 21.17  
55. Ps. 43(44).22  
56. Ps. 50(51).3  
57. Apok. 11.15,17; 19.6  
58. III [I] Mbret. 8.47; II Kron. 6.37; Ps. 105(106).6; Dan. 9.5,15; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 5  
59. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 10



60. Is. 9,2; Matth. 4,16  
 61. Ps. 18(19),6  
 62. Mal. 4,2 (3,20)  
 63. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34  
 64. Eks. 33,18-23  
 65. Dan. 7,15  
 66. Ps. 50(51),11,13  
 67. Urt. Sol. 7,26; Hebr. 1,3  
 68. Ju. 9,5-6; Ps. 134(135),6; Urt. Sol. 12,18; Mark 1,40; Hebr. 1,3  
 69. Lluk. 1,48  
 70. Amos 5,18,20; Joel 1,15; 2,1-2,11; 3,4  
 71. Vajit. 1,12  
 72. I Kor. 4,5  
 73. Matth. 10,26; Mark 4,22; Lluk. 12,2  
 74. Matth. 13,39-42,49-50; 24,30-31; Mark 13,26-27  
 75. Dan. 9,23  
 76. Is. 58,3-6,9  
 77. Ps. 67(68),2  
 78. Gjen. 3,6-7  
 79. Gjen. 3,23-24  
 80. Hebr. 13,9  
 81. Joan 1,29,36  
 82. Is. 53,7; Vep. 8,32; I Petr. 1,19; Apok. 5,6,9,12  
 83. Matth. 26,20-29; Mark 14,17-25; Lluk. 22,14-38; Joan kap. 13-17



## E SHTUNA PARA TË LIDHURIT TË DJATHIT

Kujtojmë të gjithë etërit tanë hyjprurës oshënarë, që ndriçuan në asketizëm.

### TË PREMTEN NË MBRËMËSORE

#### *Thirrortë*

#### *Ting. Tërth. IV Dhefte apantes pisti*

**E**jani, të gjithë besimtarët, t'i himnojmë koret e Etërve oshënarë, Andonin korifë, Eftimin e ndritshëm, të gjithë së bashku dhe veçan; dhe, duke studiuar mendërisht sjelljet e tyre si një tjetër parajsë shijimi,<sup>1</sup> le të thërrasim gëzueshëm: Këta janë dru-rët që i mbollti Perëndia<sup>2</sup> ynë, të cilët, pasi lulëzuan frytet e paprishshme të jetës, ia sollën Krishtit dhe ushqejnë shpirtat tanë; atyre le t'u thërrasim: O të lumtur hyjprurës, ndërmjetoni që të shpëtojmë. (2x)

**G**ëzohu, o Egjipt besnik; gëzohu, o Libi oshënarë; gëzohu, o Tebaidë e zgjedhur;

gëzohu, çdo vend, qytet dhe krahinë që ushqyet qytetarët<sup>3</sup> e mbretërisë së qiejve<sup>4</sup> dhe, pasi i rritët përmes vetëpërbajtjes dhe lodhjeve, ia treguat Perëndisë burra të përsosur<sup>5</sup> dëshirash;<sup>6</sup> këta u shfaqën ndriçues të shpirttrave tanë, të njëjtët shkëlqyen mendërisht në të gjitha skajet<sup>7</sup> me anën e lavdisë së mrekullive dhe të çudive të veprave; le t'u thërrasim atyre: O Etër të tërëlumtur, ndërmjetoni që të shpëtojmë. (2x)

**C**ili nga të dhelindurit do t'i tregojë jetët tuaja të çuditshme, o Etër mbarëbotërorë? Dhe cila gjuhë do t'i thotë luftërat tuaja të hyjshme në Shpirt, djersët tuaja, çmimet e virtyteve, tretjen e trupit, palestrat e pasioneve, në agripni, lutjet dhe lotët? Vërtet ju u shfaqët në botë si engjëj, ju vetë i vithisët absolutisht fuqitë e demonëve, pasi bëtë mrekulli të çuditshme dhe të mahnitshme; prandaj ndërmjetoni që të arrijmë dhe në tok me ju, o të tërëlumtur, gëzimin e pafund. (2x)

#### Lavdi *Ting. Tërth. II*

**P**asi e ruajtët të paprekur "Sipas ikonës"<sup>8</sup> dhe e vutë mendjen sunduese<sup>9</sup> kundër pasioneve shkatërruese në mënyrë asketike, u ngjittë sa ishte e mundur në "Sipas ngjashmërisë"<sup>10</sup>, sepse, pasi e dhunuat burrërisht natyrën, e nxitët veten që ta nënshtronit më të keqen poshtë më së mirës dhe t'ia skllavëronit mishin shpirtit; prandaj e populluat shkretëtirën, u dalluat si majë monakësh, trajnerë të atyre që ecin mirë, kanune tepër të sakta virtyti; dhe tani në qiej, pasi ikën pasqyrat,<sup>10</sup> vëzhgoni kthjellët Trininë e Shenjtë, duke ndërmjetuar direkt për ata që ju nderojnë me besë dhe mall.

Tani *Hyjlindësore*

*Dogmatike e Tingullit të javës (që po kalon)*  
O dritë gazmore. *Proqimëni i ditës dhe Profecia:*

Leximi i profecisë së Zaharias  
(8.19-23)

**K**ëto thotë Zoti i tërëpushtetshëm: "Agjërimi i të katërtit dhe agjërimi i të pestit, dhe agjërimi i të shtatit, dhe agjërimi i të dhjetit *muaj* do të *kthehen* në hare dhe ngazëllim dhe në festa të mira për shtëpinë e Judës, dhe do të dëfreni; dhe duajeni të vërtetën dhe paqen". Këto thotë Zoti i tërëpushtetshëm: "Ende do të vijnë shumë popuj dhe ata që banojnë në shumë qytete; dhe ata që banojnë në pesë qytete, do të mblihdhen në një qytet, duke thënë: 'Le të shkojmë t'i lutemi fytirës së Zotit dhe le të kërkojmë fytirën e Zotit të tërëpushtetshëm. – Do të udhëtoj edhe unë'. Dhe do të arrijnë popuj të shumtë dhe kombe të shumta që ta kërkojnë fytirën e Zotit të tërëpushtetshëm në Jerusalem dhe ta zbusin fytirën e Zotit". Këto thotë Zoti i tërëpushtetshëm: "Në ato ditë, nëse kapin dhjetë burra nga të gjitha gjuhët e kombeve, dhe do ta kapin cepin e rrobës së një burri judeas, duke thënë: 'Do të ecim bashkë me ty, sepse kemi dëgjuar se Perëndia është me ju'".

Proqimëni. Ting. Tërth. II.

Le të shpresojë Izraeli mbi Zotin, që nga tani dhe gjër në jetë.

*Varg:* O Zot, nuk u lartësua zemra ime.

Bëna të denjë, o Zot. *etj.*

*Pasvargje Ting. II*  
*Idhiomeli*

**L**e ta pastrojmë, o vëllezër, veten tonë nga çdo ndotje mishit dhe shpirti;<sup>11</sup> llambat e shpirtrave tanë le t'i hijesojmë nëpërmjet dashurisë për të varfrit,<sup>12</sup> duke mos ngrënë ashpër njëri-tjetrin me shpifje, sepse

arriti koha kur Dhëndri do të vijë që t'i shpërblejë të gjithë sipas veprave të tyre;<sup>13</sup> le të hyjmë në Krishtin së bashku me virgjëreshat e urta,<sup>14</sup> duke thirrur drejt tij me fjalët e Kusarit: Na kujto, o Zot, kur të vish në mbretërinë tënde.<sup>15</sup>

*Varg:* Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve *janë* në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë *janë* drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

*Injëjti*

*Varg:* Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë *kohë* u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja *qoftë* te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

*Martirik*

**M**eqenëse martirë e shenjtë ndërmjetojnë për ne dhe himnojnë Krishtin, çdo mashtrim pushon dhe gjinia e njerëzve shpëton me anën e besës.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

**T**urmat e murgjve ju nderojnë tani ju profesorët, o Etër oshënarë, sepse nëpërmjet jush ne mësuam të ecim në udhë vërtet të drejtë;<sup>16</sup> të lum jeni, se i shërbyet Krishtit<sup>17</sup> dhe triumfuat mbi fuqinë e armikut,<sup>18</sup> o shokë engjëjsh, që banoni në të njëjtën tendë me të drejtët dhe shenjtorët; tok me ta ndërmjetoni te Zoti që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësor*

*O tu paradhoksu thávmatos*

**O** thesar dëlirësie, ki gaz; o e pastra banes\* për ndriçimin pa lëndë hiç,\* çështja kryesore je\* për shpëtimin ton', ndaj ki gaz;\* o predikimi apostolik, ki gaz;\* ki gaz, ti mburria e shën martirëve;\* ki gaz,



përmbushja je\* për profetët, o e tëra pa qortim,\* o lavd për asketë, murgj, shpëtim për çdo besnik.

#### *Përlëshore Ting. IV*

**O** Perëndi i etërve tanë,<sup>19</sup> që vepron gjithnjë për ne sipas butësisë sate,<sup>20</sup> mos e largo përdëllimin tënd nga ne,<sup>21</sup> por me përgjërimet e tyre qeverise në paqe jetën tonë.

Lavdi dhe Tani *Hyllindësore ngjallësore*  
Misteri i fshehur prej jete<sup>22</sup> dhe i panjohur ndër ëngjëjtë<sup>23</sup> u shfaq<sup>24</sup> ndër të dheshmit me anën tënde, o Hyllindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier dhe denjoi Kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtrat tanë.\*



#### TË SHTUNËN NË MËNGJESORE

##### *Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore Ting. Tërth. IV To prostahthën mistikës*

**P**asi shkëlqejmë me dritat atërore\* dhe tash po hymjmë\* si në gazin e Parajsës,\* ta provojmë përroin\* e shijimit<sup>25</sup> plot gaz,\* të shtangur, duke menduar arritjet pra\* të Etërve, le të bëjmë\* ne konkurrim\* në virtyt, t'i thërrasim Shpëtimtarit: Zot, bëna pjesëmarrës lart në mbretërin\* qiellore,<sup>†</sup> siç luten k'ta.

#### Lavdi

**T**ë gjithë tok ta himnojmë Pavlin, kreun\* e çdo asketi,\* me Andonin mjaft të urtë,\* me Efthimin dhe gjithë\* Etërit e tjerë,\* nga zemra t'u përgjërohemi pa pushim\* të lypin përherë Krishtin,\* Zotin, për ne\* që kujtojmë ditën e tyre plot me dritë, të shenjtë dhe me këngë lavdërojmë\* Perëndinë, Shpëtuesin.

#### Tani *Hyllindësore*

**O** e kulluar, ty të falënderojmë,\* të madhështojmë\* dhe të falemi gjithmonë,\* lindjen tënde himnojmë,\* o hirplote; themi\* me zë pa pushim: Shpëtona, e Virgjër krejt\* e tërëmeshirshme, Vajzë,\* se je e mir\*;\* na rrëmbe nga hetim tmerrues fort demonësh, në or' shqyrtimi të mos kemi turp,\* ne shërbyesit e tu pra.

##### *Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore Ting. Tërth. IV Anestis ek nekrón*

**A**ndonin dhe Efthimin me gjithë të tjerët,\* pra etërit hyjprurës, tërë ne\* me himne,\* gaz t'i lëvdojmë duke bër' në kujtimin e tyre panair,\* se ndërmjetojn' për botën mbarë te Zoti Krisht, të çlirohemi\* nga nëma krejt e lashtë,<sup>26</sup> pasi të shpëtojm' prej çdo ndëshkimi.

#### Lavdi *To prostahthën mistikës*

**N**e, duke ecur porsì në kopsht me lule,\* pra në virtytet\* e asketëve hyjprurës,\* me aromë të mirë\* mbushemi, se ndeshjet\* e ngasjeve i forcuam dhe morën çmim;\* ndaj shpirtit nënshtuan trupin\* si shërbëtor\*<sup>27</sup> dhe jetesën në dhë e kishin engjëllore, kështu u denjësuam pra\* për gëzim qiellor dhe lavd.

#### Tani *Hyllindësore*

**M**e ndërmjetimet e engjëjve pa trup, Krisht,\* dhe të Prodhromit,\* dhe të shenjtëve të gjithë,\* dhe të çdo oshënarì,\* dhe të çdo martiri,\* të Nxënësve dhe të nënës sate të mir\* pa burr' dhe të çdo profeti,\* zbutu; na bëj\* që të ecim në dritën tënde,<sup>28</sup> denjësona që të arrijm' në mbretërin' tënde\* nëpërmjet dhembshurisë sate.<sup>29</sup>

##### *Psalmi 50 dhe Kanuni i Etërve të shenjtë:*

##### *Ting. Tërth. IV*

##### *Ode I*

##### *Irmosi: Asma anapëmsomen lai*

»Popuj, Perëndisë ton' mahnitës<sup>30</sup> t'i »drejtojmë melodi,\* prej skllavëris' çli-roi Izraelin;<sup>31</sup> krejt ne\* një këngësi triumfi »tok\* psalim; le t'i thërrasim:\* Do këndojmë për ty,<sup>32</sup> Zot i vetëm.<sup>33</sup>

**K**rejt ne t'i himnojm' njëzëri tok me këngë shpirtërore pra\* të shenjtët, Etërit që shndritën si asketë,\* që i nxori çdo krahin',\* çdo vend, qytet, siç janë\* Tebaida, Egjipti, Libia.

**Ki** gaz: o Andon me plot lavd, kryetari i monakëve;\* Amun hyjprurës, lavdi i kreshmimit ishe;\* o forcë në qetësi,\* engjëll, Arsen i madh shumë;\* Amona, o shpirtprurës me famë.

**Kini** gaz: Agathon, shpirt i hyjshëm, enë Zoti krejt vërtet;\* o Ahila, Amoi, lulet e shkretisë;\* Anuv dhe Amonatha\* si dhe Anthim, Alon shenjt,\* në virtyt jeni margaritarë.

**Arin**, llambë dallueshmërie, Apolonin mjaft të madh\* sot t'i himnojmë; ndërsa ish-in drit' në bindje\* Athreu, Akaki tok,\* bashkë me ta ndriçon nur\* Avakiri si yll në mëngjes pra.

**Majë** e jetesës mjaft të lartë at' Afksenti na u shfaq,\* i madhi Abraham atlet dëlirësie;\* me ta Afrodhisi shenjt,\* shtyll' në vetëpërbajtje,\* u tregua me Athinodhorin.

**Shndrit** midis asketëve si yll në qiell lart Amoni shenjt,\* Anini i hyjnueshëm me ta; dhe bashkë\* shkëlqejnë të tjerët nur,\* siç janë Antioku\* mjaft i madh si edhe Agapiti.

**Mburrim** oshënarin Athanas të madh me himn të hyjshëm krejt,\* në Mal, në Athos ish asket i ndrirtshëm fare,\* ndrirtuesi kolosal\* dhe botëror,<sup>7</sup> të gjithë\* ne shpëtojmë me

lutjen e tij pra.

**Etër**, ju të lumtur urtësisht të Kishës, u treguat qart'\* me jetë të hyjfmëzuar si Parajsë\* vërtet; edhe pa pushim\* bëni, të gjith' pas emrit,\* ndërmjetite me Zoti për ne pra.

#### Martirik

**Ejani**, besnikë, që martirët mjaft i doni, t'i nderojm'\* me ode të përvitshme, dhe me këngë bese\* t'i psalim ne Perëndis'\* Krisht himne duke thirrur:\* Do këndojmë për ty,<sup>32</sup> Zot i vetëm.<sup>33</sup>

#### Triadik

**Tre** Persona krejt vetekzistues i himnoj, pra Atin Zot\* që s'lindi, Birin që ka lindur dhe Shën Shpirtin;\* këta jan' një mbretëri\* pa nisje, një pushtet, nder,\* një Hyjni, një natyrë e shenjtë.

#### Hyjlindësor

**Ki** gëzim, i tërëshenjtë tempull, o lëmshe me freskim hyjnor,\*<sup>34</sup> burim fort i vulosur<sup>35</sup> me rrjedhim pa vdekje;\* o Zonjë, qytetin tënd\* ruaje nga rrethimet\* e armiqve të ndryshëm barbarë.

#### Zbritësore: Asma anapëmsomen lai

#### Popuj, Perëndisë ton'

#### Ode II

#### Irmosi: Ìdhetë, idhete oti egò

»Shihni, shihni se unë jam Perëndia »juaj,<sup>36</sup> që llanda para jetëve prej Atit dhe »në fund isha në barkun e Virgjëreshës pa »burrë, dhe e fala si njeridashës mëkatin »e stërgjyshit Adam.<sup>37</sup>

**Tani**, duke rendur si në një tjetër Parajsë, mbushemi me erën e virtyteve të hymbjella të asketëve; ata, oshënarët tepër të shenjtë, lulëzuan me vetëpërbajtje dhe lot, dhe sollën fryte për Perëndinë, me jetë të ndryshme.



Visarioni i madh, që jetonte si zogjtë, ishte si një tjetër engjëll, ndërsa Veniamini i qëndrueshëm, si Jov i ri; por dhe Vitali ishte ndriçues që shpëtonte lavire, për Perëndinë; dhe bashkë me ta le të himnohet Vitimi i hyjshëm dhe Vavila i famshëm.

**O** Benedikt, nëpërmjet lartësisë së jetesës u bëre qiellor, ndërsa bari Vasiani shtëpi urtësie;<sup>38</sup> por edhe një Vasil fitoi kurorë bindjeje, sepse, meqë banoi i gjallë në varr, na tregon shkëlqimin e bindjes.

**H**imn i përket Jelasit të kënduar, mbretit të pasioneve. Lavdërim Gjerasimit, për të cilin punoi si skllav bisha, sepse i nënshtrohej për hir të përsosmërisë së virtutit. Lavdi atë Gjermanoit bashkë me Gain, shërbyesin e urtë të Krishtit.

**D**avidi është çmim dhe krenari e Selanikut. Le të mburret Danieli i hyjzënë, i madhi në çudi, si dhe Danieli i Skitës, Dhii dhe Dalmati, kryetarë të monakëve, mbështetës të besimit me vepra dhe fjalë.

**B**indja e tregoi shumë më të fortë se transparenca e yjeve Dometianin dhe Dometin hymmendës, që na shkëlqejnë si dy ndriçues; tok me ta le të përhimnohen lavdishëm dhe anonimët.

#### *Martirik*

**N**jë pasuri që nuk shteron, pushtoi sarkofagun e besnikëve që garuan besërisht për Krishtin. Ejani, o shpresëplotë, le t'u këndojmë atyre si dëshmorë, duke korrur me anën e besës shërimet e shpirtave dhe të trupave.

#### *Triadik*

**O** Njësi e përmbitërpërsosur, e përmbipërëndishme, trihipostate, Atë i palindur, Bir i vetëmlindur dhe Shpirt që dole prej Atit ndërsa u shfaqe përmes Birit, një

esencë, natyrë, zotëri dhe mbretëri, shpëtona të gjithë ne.

#### *Hyjllindësor*

**V**etëm ti i fute njerëzimit lindje të huaj; vetëm ti nuk pësove prishjen nga natyra duke pësuar pa u prishur lindje pa farë; prandaj detyrimisht ne besëmirët të lavdërojmë, o e dëllirë, si Perëndillindëse.

*Zbritësore: Ëdhe, idhete oti ego*

**S**hihni, shihni se unë

#### *Ode III*

*Irmosi: Uk estin ajios os o Kirios*

»**N**uk ka të shenjtë si Zoti, s'ka të drejt' \*  
»pra si Perëndia ynë,<sup>39</sup> që e përhimnon \*  
»çdo krijesë dhe nuk ka të shenjtë veç \*  
»teje, Zot, \* si ti njeridashës, Shpëtimtar.

**N**ë një Parajsë krejt tjetër futemi,\* ka virtyte plot të Etrve mahnitës mjaft;\* besërisht t'i lëvdojmë ne duke shijuar pra\* jetëdhënëset e saj gjithnjë.

**E**fthimin, yllin e ndritshëm, ta nderojm' \* me Heladin, mëngjesorin yll, Efremin shenjt,\* plot me hyjfrymëzim dhe Evlogjin e madh; gjithkund\* shndritën nur me vepra dhe çudi.

**I**mrekullueshmi Zosima me këng'\* të himnohet, si dhe Zaharia tërë nder,\* Isaia i madh, i lëvduar, Ilia shenjt;\* Zinonin, Zoilin t'i murrin.

**T**ë admirueshmin Theodor në Therm\* me atë në Nëntë, që këndohet, i himnoj,\* tok i psal Theodhulit; madhorin, mahnitësin\* Theodhos me Theonan' i nder.

**S**hën Theoktistin, bariun plot shkëlqim,\* shën Thalasin, mendjen aq të lartë, t'i himnojm'\*; Theodhorin e madh Siqeoq që mbi dhe u duk\* me çudi, shenjë,<sup>40</sup> i lart', i nder.

**T**ë tjera yje plot drit' u ngjitën lasht', \* si

Kolovi shën Joan me tre në Shkallë pra;\* dritëprurës nur ishin me shumë të tjerë tok\* që shkëlqenin me një lavd të madh.

### Martirik

Me ode shpirti<sup>44</sup> dhe këngë ta nderojm',\* ne të mbledhur kremtimdashës, tok, kujtimin pra\* të përvitshëm, të nderur, me lavd të martirëve;\* lypin Krishtin përgjithnjë për ne.

### Triadik

Njësi e mbiperëndishme, o Trini\* e njëqenshme, që në ndarje ke bashkim dhe prap\* në Persona natyrën e ke, na bashko në një,\* që ta duam porosin' tënde.

### Hyjlindësor

Të parashkroi si të hyjbërën tend'<sup>42</sup> Moisiu; kjo të shenjtat e të shenjtave\* i mbulonte me shën Serafimët;<sup>43</sup> qe tip më par',\* Virgjërësh', për Birin tënd pa cen.

### Zbritësore: Uq estin ajtos os o Kirios

Nuk ka të shenjtë si Zoti

### Ndenjësore

#### Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Butësin' e Andonit dhe pastërtin',\* madhëshutin' e Efthimit plot admirim,\* të thjeshtët me qetësi,\* Pavlin si dhe Arsenin shenjt,\* lavdin' e Theoktistit si dhe të brigadave\* të tjera oshënarësh të tërë, besnikë, tok\* le t'i lavdërojmë, dhe të murrin me këngë\* të virgjërën shën Efraksi,\* gjithë gratë hymendëse,\* të thërrasim\* njëzëri pra:\* Ndërmjetoni te Zoti Krisht,\* të na dhurojë ky ndjesën\* e fajeve\* ne që bëjm' kujtimin tuaj me shumë mall.

### Lavdi

Thyet prangat e veseve dhe me mall\* pas së mirës u ngjitet, veshët në Krisht\* një lavd<sup>44</sup> të përmbibotshëm ju,\* përmes lodhjeve tuaja\* e gjetët prehen, si dhe

për shkak të mundimeve\* që ka përmbajtja, jetën e sipërme gjetët lart;\* ndaj bashkëdëfreni denjësisht me Fuqitë\* e sipërme dhe me gaz\* rrimi bri Perëndisë Zot,\* dhe këndonit,\* hyjprurës ju\* Etër, dhe kërkoni pra ndjes'\* për fajet tona; kremtojmë\* me plot dëshir'\* ditën edhe kujtimin tuaj të shenjtë fort.

### Tani Hyjlindësore

Jam i ngulur në baltë pasionesh keq,\* unë s'kam bazament dhe më zhyti tmerr\* stuhia<sup>45</sup> e shkëlqeve;\* por, meqë linde Fjalën Zot,\* të vetmin njeridashës, shikomë me mirësi,\* të lutem un' shërbyesi yt, edhe nga çdo faj\* dhe nga çdo shpirtprishje, ves dhe hall ti çliromë,\* nga çdo keqtrajtim, mundim\* të keqbërësit, që të psal\* me hare, gaz,\* o Zonjë Vajz':\* Ndërmjeto te Zoti yn' Krisht,\* të më dhurojë pra ndjesën\* e fajeve,\* sepse un', shërbëtori yt, të kam shpresë ty.

### Ode IV

#### Irmosi: Eks orus kataskiu

»Prej malit hijeplot',<sup>46</sup> Hyjlindëses së »vetme, o Fjalë, kur ti kishe\* për t'u mi-shëruar,\* me hyjshikim e kuptoi qart' »shën profeti,\* me tmerr lëvdonte forcën »tënde drejt'.<sup>47</sup>

Ilarioni i hyjshëm ishte ndriçues i dukshëm në botë, Justin i madh mal dijeje; me ta le të nderohen të lavdëruarit Jeraksi dhe Ivistioni tok me Josifin.

Edhe Jeremia ndriçoi në jetë, edhe Isklarioni u duk si fuqi e madhe; bashkë me ta shndritnin si pishtar Karioni, Kopri dhe Kastori, ndërsa Kasiani ishte i tërëbukur me të dyja.

I admiroj fjalët e vlefshme të Kalistit, i lavdëroj bamirësitë e Laurentit, i shpall veprat e mira të Longinit dhe i mburr ma-



dhërisht virtytet e Lotit.

**E** himnoj Leontin, thellësinë e theologjisë; i këndoj Maksimit, detit të dogmave, Markianit të hijshëm dhe Markut të bindur e të hydjëguar.

**M**akari i Madh është çmim virtytësh, ndërsa ai Politiku çështje shpresëtarie; së bashku me këta shpallet Marku madhor, dhe tok me Dalmatin Moisi etiopiani.

**I** madhështoj vrapimet dhe arritjet për dëlirësinë të Martinianit dhe të Maikut, aktivizimin e mirë të Markel kryebariut, edhe nderoj Milin e ngjallur prej së vdekurish.

#### *Martirik*

**O** martirë të Krishtit, çojini përgjërime pa pushim Krijuesit për paqen e botës dhe për ata që nderojnë me këngë kujtimin tuaj.

#### *Triadik*

**Ë**shtë e huaj që Hyjnia të jetë një dhe tre; e tëra në tre Persona pandarshmërisht, sepse Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë janë ata të cilëve u falemë në një natyrë.

#### *Hyjlindësor*

**G**ëzohu, o vend i gjerë i Perëndisë; gëzohu, arkë e Dhiatës<sup>48</sup> së Re; gëzohu, shtambë nga e cila iu dha mana<sup>49</sup> qiellore<sup>50</sup> të gjithë njerëzve.

#### *Zbritësore: Eks orus kataskiu*

**P**rej mallit hijeplot'

#### *Ode V*

#### *Irmosi: Tis ton pathón me ahlios*

»Si prej një nate të thellë krejt u çlirova nga mjegulla plot me ves',\* të denjë ma bëj ti shpirtin, Krisht, të mëngojë - lyp -\* në shkëlqim, në urdhrat e tu si në drit' dite nur.<sup>51</sup>

**E**jani të shohim lule të mbjella nga Pe-

rëndia, të cilat ekzistojnë përherë në Parajsën e Edenit,<sup>52</sup> bëmat e Etërve; bujku i tyre është vetëm Zoti.<sup>53</sup>

**M**e rrëketë e fjalëve të Nilit vaditet bollshëm çdo shpirt mendor, shkëlqen me jetën e Nafkratit dhe të Nikonit, ndërsa e ngazëllojnë Nathanailli dhe Nisthenori.

**N**a ndriçon duke shkëlqyer me virtyte Ksenofonti tok me bijtë; Orsisi është i madh, kurse Onufri është edhe më i madh; po Pimenin cili nga të vdekshmit do ta vlerësojë?

**P**amvoja le të lumërohet denjësisht si i lartë në vepra dhe fjalë; Pupli i lavdishëm le të mburret ngaqë dëbonte demonë, dhe në mënyrë të barabartë Pinufri i shkëlqyer.

**L**e të nderohet siç duhet Pafnuti i famshëm vërtet, Piori, Patermuthi, Pavli tejet i thjeshtë, Pitiruni i madh dhe i shquar i Etërve.

**L**e të mburret shkëlqyeshëm ndriçuesi i ndriçuesve, Pahomi, bashkatleti Palamon, Petroni i hyjshëm, dhe tok me ta Pasaroni le të himnohet me ode të shenjta.

#### *Martirik*

**O** martirë të pamposhtur, meqenëse e shpallët në stadium si atletë Krishtin Perëndi, morët kurora dhe kërceni bashkë me koret e patrup.

#### *Triadik*

**H**yjnia është tre në hipostaza, edhe pse një në natyrë; në ta jemi pagëzuar dhe tek ata besojmë, tek Ati, Biri dhe Shpirti<sup>53a</sup> i bashkëqenshëm.

#### *Hyjlindësor*

**O**e Tërëpacenuar, që nëpërmjet fjale linde fjalën<sup>54</sup> me mënyrë përmbi fjalë, të lutemi, mos pusho së përgjëruari atë që ta çlirojë gjithmonë grigjën tënde nga rreziqet.

*Zbritësore: Tis ton pathón me ahlios*

**S**i prej një nate

*Ode VI*

*Irmosi: Sinehómenon dhekse me*

»Njeridashës Zot, më prano mua që «kam\* dhe shtrëngohem aq mjaft\* nga «fajet; edhe si profetin\*<sup>55</sup> shpëtom', se «bie para dhembshurisë sate.

**E**tërit tanë të tërërespektuar janë të çuditshëm, të tyret janë arritjet hyjnore, mundjet, shërimet, sepse kush përveç tyre tregoi fuqi mrekullish?

**L**e të lavdërohet Ravulai i mahnitshëm dhe tok me të Rufi dhe njëkohësisht Siso i barabartë me engjëjt<sup>56</sup> dhe me këta Seridhi i hyjnueshëm dhe Siluani.

**U**duk në dhé qiell me katër ndriçues, sinonimia e katërfishtë, Simeonët, nga të cilët tre ishin në shtylla dhe një i marrë për Krishtin.

**L**iamburiti Sava i Shenjtëruar si dielli mes yjeve,<sup>57</sup> kryetari i të cilëve ishte, dhe pas tij feks me vepra edhe Serapioni bashkë me Siluanin.

**L**e të himnohet Sarmatal, Timotheu, Timoi bashkë me Iperekin, Farmuthin, Fokanë, Haritonin, Herimonin, Psolin dhe Orin e urtë.

**O** shumica e shenjtë dhe e lavdëruar e Etërve që kujtuam, si dhe ajo anonime, çliroi nga rreziqet ata që me mallëngjim kremtojnë kujtimet tuaja.

*Martirik*

**I**çuditshëm je, o njeridashës, në atletët e tu; të tyret janë arritjet e hyjshme, mrekullitë, shërimet; me ndërmjetimet e tyre shpëtona, o Zot.

*Triadik*

**T**ë këndoj ty, o Trini e përbimpushtetshme, Njësi hyjnore, dritë dhe drita, jetë dhe jetë, Mendje, Fjalë dhe Shpirt i Shenjtë, dhe të Shenjta, një Perëndi unik.

*Hyjlindësor*

**O** paraatë Jese, kërce: Nga rrënja jote, nga e Reja e kulluar, lindi lule jete,<sup>58</sup> ai që shpëton botën, Krishti Perëndi.

*Zbritësore: Sinehómenon dhekse me*

**N**jeridashës Zot, më prano

*Kontaqi*

*Ting. Tërth. IV Os aparhás tis fiseos*

**Z**ot, korin e hyjprurësve e hijeshove, se çdo vend\* e shndritën si predikues besimi drejt,\* u bën' turiz' besimi fals,\* ndaj me lutjet e tyre mbroji sa të lëvdajnë, të madhërojnë, ruaji në paqe krejt, të të psalin këng': Aliluia.

*Shtëpia*

**V**ështrova të pëlqyerat e jetës, duke studiuar me mendime ato që bëhen; dhe, kur i llogarita vuajtjet e tyre, e përbuza jetën e vdekatarëve, dhe ju lumërova vetëm ju që zgjodhët pjesën e mirë,<sup>59</sup> të pësonit për Krishtin,<sup>60</sup> të mbetenit me të dhe të psalnit përherë bashkë me profetin David: Aliluia.<sup>61</sup>

*Sinaksari i Mujorit dhe i soiëm:*

Në të njëjtën ditë, kujtojmë të gjithë burrat dhe gratë e shenjta që shkëlqyen në asketizëm.

*Vargje:* Fjalët ua ofroj si fli që mbeten shpirtrave të të drejtëve,/ kujtimi i të cilëve mbetet përgjithmonë.

Me ndërmjetimet e tërë oshënarëve të tu, o Krisht, Perëndia ynë, mëshirona.

*Ode VII*

*Irmosi: O tus Pedhas dhrosisas*

»**T**i e ruajte virgjëresh' pas lindjes\* Nënëntënde dhe Djemtë\* i freskove përbrenda



«furrës,<sup>62</sup> je i bekuar, o Zot, Perëndi i «etërve tan’.<sup>63</sup>

**E**jani t’u ofrojmë himne, siç e kemi detyrë, grave që jetuan me oshënarë dhe njësoj me engjëjt,<sup>65</sup> thërrasim: Me përgjërimet e tyre, o Perëndi, shpëtona të gjithë ne.<sup>64</sup>

**L**e të nderohet Vriena krishtprurëse së bashku me Fevroninë e hyjshme, Thomaidhën dhe Jerien, ndërsa u këndohet besërisht me to edhe Platonidhës me Melanthinë.

**U** përket mburrje Efpaksive me mendje engjëjllore tok me të dyja Theodorat. U përket himnim dhe lavdërim pa pushim Anastasive të tërëpasura, se e adhuruan çuditshëm Perëndinë.

**M**aria egjiptiana ishte dritë në botë dhe ajo që u quajt Marini, u duk yll në kozmos<sup>7</sup> dhe Efosina diell që rezatonte me virtyte.

**T**heodhula është pishtar drite në asketizëm, dhe tok me të shndritin Theodhota me Julitën dhe bashkëshkëlqen me vepra Isidora e tërëpasur.

**L**e të nderohet tani Marina mendjeqjellorja tok me Matronën e madhe dhe le të përhimnohen me këngë si të urta Singlîtikia dhe Sara bashkë me Justën.

**L**e t’u këndohen bashkërisht Pelagjisë, engjëllit të Zotit, dhe Taisisë, llambës së pendimit, dhe cilëso tjetër prej grave që shkëlqeu në asketizëm.

#### *Martirik*

**D**uke kremtuar kujtimin e athloforëve, i përgjërohemi të vetmit Jetëdhënës që t’u dërgojë nga lart himnuesve përdëllim dhe falje shkeljesh.

#### *Triadik*

**I** falemi Birit tok me Atin dhe, duke e lavdëruar me një mendje Shpirtin e Shenjtë, thërrasim besërisht: Lavdi më ty, o Trini Njësi, Perëndia ynë.

#### *Hyllindësor*

**O** Perëndilindëse, Virgjëreshë e bekuar, që linde Shpëtimtarin dhe Zotin e botës,<sup>65</sup> atij lypi gjithmonë që t’i dhembshurojë shpirtrat tanë.

#### *Zbritësore: O tus Pedhas dhrosisas*

**T**i e ruajte virgjëresh’

#### *Ode VIII*

#### *Irmosi: Ton en ori ajo dhokasthenta*

»**K**’të që mbi mal të shenjtë u lëvdua\*<sup>65</sup> «që në ferrën me zjar<sup>67</sup> i shfaqi Moisiut\* «misterin e gjithmonëvirgjëreshës, lëvdoheni pra Zotin\* edhe lartësojeni ju në «gjithë jetët.<sup>68</sup>

**B**arinjtë, Mësuesit e urtë, hierarkët e Kishës së Krishtit tok me oshënarët le t’i përhimnojmë të tërë, duke e himnuar dhe e përmbilavdëruar Zotin në gjithë jetët.<sup>68</sup>

**L**e të himnohet me këngë detyrimisht Vasili i Madh dhe me të Athanasin, vërtet i shumëvuajtur, tok me Grigorin, eporin e të gjithëve në teologji.

**L**e ta lavdërojmë Joanan, gojën fjalartë bashkë me Kirilët, shtyllat e hyjurta, po ashtu dhe Isihun, theolog tjetër, tok me Meletin hyjfolës dhe të hyjshëm.

**L**e të himnohen përjetë tok me Grigorin, lavdin e nisasve, dhe të dy Etërit çudibërës, edhe Epifani i urtë në hyjnoret tok me Amfilokun, ndriçuesin e shkëlqyer.

**L**e ta himnojmë Mitrofanin, lavdinë e përfetërinjve, tok me Nektarin, Attikun, Gjenadin bashkë me Anatollin, dritat e jetës, dhe njëkohësisht Efsevin dhe Proklín, të

tërrurtët.

I këndoj Nikollë predikuesit; Sofronit që e ka gjuhën vërtet si mjaltë, si dhe Evlalit dhe Diadokut, bashkë me Efstathin dhe Juvenalin, korifenj ndër etër.

### *Martirik*

Le të nxjerrim besërisht shërimet e shpirtave dhe të trupave, të cilat i buron si krua sarkofagu i athloforëve, dhe ta himnojmë, dhe ta përmbilartësojmë Zotin në gjithë jetët.

### *Triadik*

Të himnoj si Njësi në esencë, të adhuroj si Trini në Persona, o Atë, Bir dhe Shpirt i Tërëshenjtë; e lavdëroj në jetë pushtetin e pafillim të mbretërisë sate.

### *Hyjlindësor*

Ti, o Hyjlindëse, u tregove si Mali i Perëndisë, në të cilin Krishti, pasi banoi,<sup>69</sup> i bëri tempuj të hyjshëm<sup>70</sup> ata që psalin: Zotin himnojeni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.<sup>68</sup>

*Zbritësore: Ton en ori ajo dhokasithenta*

**K**të që mbi mal të shenjtë

### *Ode IX*

*Irmosi: Ton prodhilothenta en ori*

»Birin e Gjithnjëvirgjërshës, të deklaroar\* që më parë përmes ferrës me »zjarr te një ligjvënës\* mbi një mal<sup>67</sup> për »shpëtim besëmirësh,\* Krishtin,\* pa pushtim e madhështojm' me himn. (2x)

**K**ush do shprehë qartë guximin që kish Ambrozi? \* Kush do flasë për urtinë që kishte Jerotheu,\* për qëndrimin në bes' të të urt've\* Etër\* aleksandrianë, trimave?

Le të përhimnohet i hyjshmi Fedhim, Pammvoi,\* Noni, Jeronimi tok Antipatri dhe Paladhi,\* Spiridhoni hyjprurës, Gjermani\* plot nder,\* ishin shenjtë, hyjndriçues nur.

Të nderohet misti i qieilit, shën Dionisi,\* në hyjnoret ish i fortë, Klementi me mjaft çmime,\* tok Vlavjani dhe Pavli, i madhi;\* ishin\* parashpallës në omologji.

Niqifori dhe Theodhori i madh, Tarasi,\* Mihaili i Sinadhës dhe Theofani bashkë,\* Jeronimi me emër hyjnor krejt,\* mbrojtën\* skicat e krishtera; t'i himnojm'.

Petrin dhe Ignatin hyjprurës vërtet, atletë\* të hyjnueshëm, që ishin pors i apostuj Zoti,\* Qiprianin, martirin e Krishtit,\* edhe\* Polikarpin t'i himnojmë tok.

Hieromartirë dhe Etër me oshënarë,\* hierarkë Zoti, bashkë ju gra të shenja, gjithë\* të dëgjuarit dhe anonimët,\* lypni\* të shpëtojnë shpirtat tanë pra.

### *Martirik*

O martirë, duke shijuar në dhomat sipër,\* qiellore,<sup>71</sup> të lavdisë së Krishtit tok me koret\* e apostujve, çoni te Zoti\* Bërrës\* ju kërkesa për sa jan' mbi dhë.

### *Triadik*

Zot, një në Trini, Perëndi, lavd ty pa ndërprerje;\* edhe pse është' Perëndi çdokush, Zot, je një natyrë,\* por në tri veçori me shkëlqim plot,\* Ati,\* Biri dhe i Tërëshenjt i Shpirt.

### *Hyjlindësor*

Parapa qëmoti në mal, në Sina, profeti\* Moisi një ferr' që digjej, por nuk shkru mohej fare;\*<sup>67</sup> barku yt hyjpranues kjo ishte,\* priste,\* Virgjërshë, zjarrin pa cenim.

*Zbritësore: Ton prodhilothenta en ori*

**B**irin e Gjithnjëvirgjërshës

### *Dërgimësore*

*Jineqes akutishite*

Rreshtime hierarkësh, kor\* martirësh, bashkësi grash tok\* edhe shumic' oshë-



narësh,\* pra Etër që botën mbarë\* kishit mohuar dhe kështu\* ngritët kryqin,<sup>72</sup> na feksni,\* na hijesoni me hare\* që denjësisht ta himnojme\* kujtimin tuaj të ndritshëm.

*Tjetër: Tis mathitës sinëlhomen*

Sa shndritën në asketizim,\* shën Etërit hyjprurës\* dhe hierarkë, gratë tok,\* sa ishin oshënare,\* kor me hierodëshmorët\* me ngazëllim t'i mburrim\* me këngë, që të përfitojm'\* shenjtërim, dhe me lutjet e tyre ne\* ta mbarojmë udhën e kreshmës lehtë,\* siç dhe Perëndilindësja\* po ndër-mjetoj te Biri.

*Lavdërimë*

*Ting. Tërth. IV O en Edhëm Parádhisos*

Ta mburrim, krejt besnikë, me himnim shumicën e Etërve\* që garuan në virtyt, oshënarí,\* t'i lavdërojm' melodikisht\* hierarkët e Zotit Krisht,\* o vëllezër, me hyjmendje, me një zë,\* sa me përmbajtje jetuan drejt,\* bënin kreshmim të pastër nur,\* Ungjillin zotëror ata\* fort na e shpallën dhe me ta\* gratë hyjprurëse\* të shkëlqyera t'i përhimnojmë ne,\* të zilepsim me zemër,\* siç Zoti do, jetesën e tyre,\* që atje të gjejmë faljen e mëkateve me paqësim.

Vëllezër, sa nur shndritën në asketizim, me oshënarí\* krejt në jetë, le t'i mburrim lavdërisht\* se, si vepruan mirë mjaft,\* me besim u shpërngulën lart\* me hare drejt së përjetshmes jetë pra,\* në fund të lum, ku s'ka dëm aspak,\* meqë drejt ecën me virtyt,\* me thjeshtësi; ndaj denjësisht\* tash t'i nderojmë, që kështu\* hir edhe përdëllim\* që nga Zoti ynë të fitojmë ne\* me kërkesën e tyre,\* të kemi lavd dhe gaz përjetësisht,\* të shpëtojmë nga ndëshkimi i pashmangshëm plot me tmerr atje.

O mbledhje e të drejtëve dhe hierarkë të tër' në kor,\* gra me jetë plot besim, aske-të tok\* ta lypni, lutemi, me hir\* Zotin, fortpërdëllyesin,\* dhe të vetmin krejt të mirë, që atij\* t'i vijë keq për ne dhe kështu\* le të shpëtojmë në mbarim\* atje nga çdo ndëshkim, përmes\* lutjeve tuaja drejt tij;\* edhe përherë ne\* të shijojmë ngazëllim të ardhshëm lart\* dhe në jetën që s'ka fund\* dhe t'i thërrasim himne pa pushim\* Jetëdhënësit me lavde, o të urtë plot me nam të madh.

Të bëjmë, o besnikë, panair hyjnisht sot me bujarí\* në kujtimin e të shenjtëve me hir\* për hierarkë dhe për gra\* oshënarë me plot besim,\* hieromartirë dhe asketë tok,\* sepse të prishshmet s'i çmuan hiç,\* sa provizore jan' vërtet,\* si plehra, merimanga krejt\* ishin për ta, fituan pra\* Krishtin,<sup>73</sup> Çliruesin,\* mbretërin' e tij, hyjnore e tij lart\* sa s'dëgjoj kur' veshi\* dhe syri nuk i pa,<sup>74</sup> o Perëndi;\* na shpëto me ndërmjetimet e atyre shpirtrat nga prishja.

*Lavdi Ting. Tërth. II*

O etër oshënarë, në gjithë tokën doli zëri<sup>75</sup> i arritjeve tuaja, prandaj në qiej gjetët shpërbllim<sup>76</sup> për lodhjet tuaja; asgjësuat batalionet e demonëve, arritët rreshtimet e engjëjve, jetën e të cilëve e kishit zili në mënyrë të paqortueshme; duke pasur guxim ndaj Zotit, kërkoni paqe për shpirtrat tanë.

*Tani Hyllindësor*

O Hyllindëse, ti je hardhia e vërtetë,<sup>53</sup> që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me oshënarët dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

*Dhoksologjia e Madhe.*

*Në Liturgji, Antifonet e zakonshme [ose Tipiket dhe Ode III dhe VI nga Kanuni i Triodit].*

*Pas Hyrjes, Përlëshoret: e oshënarëve dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. Kungatore: Në kujtim të përjetshëm.*

## CITIME

1. Gjen. 2.15
2. Gjen. 2.8-9
3. Fil. 3.20
4. Matth. 3.2 etj.
5. Ef. 4.13
6. Dan. 9.23
7. Fil. 2.15
8. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
9. Ps. 50(51).14
10. I Kor. 13.12
11. II Kor. 7.11
12. Matth. 25.7
13. Matth. 16.27; Rom. 2.6
14. Matth. 25.10
15. Lluk. 23.42
16. Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23; Vep. 13.10
17. Vep. 20.19; Rom. 14.18; Kol. 3.24
18. Kol. 2.15
19. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2 etj.
20. Baruh 2.27; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 18
21. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 11
22. Ef. 3.9
23. I Petr. 1.12
24. Kol. 1.26
25. Ps. 35(36).9
26. Gjen. 3.16-19
27. I Kor. 9.27
28. Ps. 88(89).16
29. Lluk. 1.78
30. Ps. 67(68).36
31. Mik. 6.2-4 etj.
32. Eks. 15.1-19
33. Jud. 4
34. Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6
35. Kënga 4.12
36. Ligji i Dytë 32.39
37. Gjen. 3.2-6
38. Fja. Urt. 9.1
39. I Mbret. [Sam.] 2.2
40. Joan 4.48 etj.
41. Ef. 5.19; Kol. 3.16
42. Eks. 25.8; 26.30; Hebr. 9.2
43. Eks. 25.17-19; Hebr. 9.5
44. Is. 52.1
45. Ps. 68(69).3
46. Abak. 3.3
47. Abak. 3.19
48. Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
49. Eks. 16.33; Hebr. 9.4
50. Ps. 77(78).24; Joan 6.31,58
51. Is. 26.9
52. Gjen. 2.8
53. Joan 15.1
- 53a. Matth. 28.19

54. Lluk. 1.28-30
55. Jona 2.2-11
56. Lluk. 20.36
57. Gjen. 37.9
58. Is. 11.1,10; Rom. 15.12
59. Lluk. 10.42
60. Rom. 8.17; Fil. 1.29
61. Ps. 104(105) titull etj.
62. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
63. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
64. Matth. 8.25
65. Joan 4.42; I Joan 4.14
66. II Petr. 1.18
67. Eks. 3.2-3
68. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 64
69. Ps. 67(68).17
70. I Kor. 3.16; II Kor. 6.16
71. Joan 14.2
72. Matth. 16.24; Mark 8.34; 10.21; Lluk. 9.23
73. Fil. 3.8
74. I Kor. 2.9
75. Ps. 18(19).5
76. Matth. 5.12; Lluk. 6.23,35



## E DIELA E TË LIDHURIT TË DJATHIT NË MBRËMËSORE

### Thirrto

### 6 ngjallësore dhe 4 të Triodit:

### Ting. Tërth. II Olin apothëmeni

Zoti im, Gatuesi,\* më mori pluhur nga toka\* dhe me fryrje jete pra\* shpirt të gjall' më bëri,<sup>1</sup> mbi dhé sundues, mbret\* mbi të dukurat mbar\*<sup>2</sup> edhe shok me engjëjt;\* por satani djallëzor përdori si mash' gjarpërin vrer,\* më mashtroi krejt<sup>3</sup> me ushqim të keq,\*<sup>4</sup> kështu prej Perëndisë tim,\* prej lavdis' së tij më ka ndarë keq\* dhe më dorëzoi në vdekjen më të poshtme dhe në dhé,\*<sup>5</sup> por më rithirr si i dhembshur ti,\* Zoti i të gjithave.

Mjerë! Urdhrin tënd hyjnor,\*<sup>6</sup> për shkak këshille armiku,\*<sup>3</sup> s'e dëgjova,<sup>4</sup> Zoti im,\* ndaj un' qyqi zhvesha stolin' e thurur lart\* dhe tani po vesh keq\* gjethe fiku,<sup>7</sup> rrobë\* prej lëkure,<sup>8</sup> i dënuar që ta ha me djersët çurg\* bukën, me mundim, se



më ka mallkim\*<sup>5</sup> dhe toka, që të jap' si fryt\* gjemba plot me thumba dhe rrodhe tok;\*<sup>9</sup> por nga Virgjërësia ti more mish në kohë, tash në fund,\*<sup>10</sup> rithirrme edhe sërish më fut\* në Parajsë, Shpëtimtar.

**O** Parajsë plot me nder,\* o bukuri krejt supreme,\* tendë e hyjbërë lart,\* o hare, shijim i pasosur, çdo profet\* hijeshi të ka ty,\* dhe lavd çdo i drejtë,\* çdo shenjtor të ka banesë; ndaj me zë prej gjetheve\* Bërësin e çdo gjeje lype ti\* që portat që i mbylla keq\* përmes shkëlqes sime,<sup>4</sup> t'i hapë pra,\* të më denjësojë të marr pjes' dhe nga druri jetësor,\*<sup>11</sup> dhe nga i mëparshmi ngazëllim\* që në ty shijova krejt.

**L**arg Parajsës u përzua\*<sup>12</sup> se nuk u bind at' Adami;\*<sup>4</sup> doli nga shijimi krejt,\*<sup>13</sup> se prej fjalësh gruaje u mashtrua keq\*<sup>4</sup> - mjerë! - përballë rri,\* lakuriq vajton mjaft.\*<sup>7</sup> Të përpiqemi të gjithë ne që ta mikpresim drejt\* kohën e bekuar të kreshmës son',\* të bindur ndaj traditave\* ungjillore<sup>14</sup> dhe të pëlqyeshëm\* nëpërmjet këtyre të bëhemi ndaj Krishtit dhe sërish\* të marrim brenda Parajsës lart\* një banesë me gëzim.

#### Lavdi *Ting. Tërth. II*

**U** ul Adami përballë Parajsës<sup>12</sup> dhe, duke qarë për zhvishjen e tij,<sup>7</sup> vajtonte: Mjerë unë që u binda te mashtrimi dinak,<sup>3</sup> që u rëmbeva dhe u largova nga lavdi! Mjerë unë që isha lakuriq për shkak të thjeshtësisë,<sup>7</sup> por tani jam i varfëruar! "Pra, o Parajsë, nuk do ta shijoj më kënaqësinë tënde, nuk do ta shikoj më Zotin Perëndi, Gatuesin tim, sepse do të iki në dhë, nga ku u mora".<sup>5</sup> O përdëllyes i dhembshur, ty të thërras: Përdëllemë mua që rashë.

Tani *Hyllindësore*  
*Dogmatike e Tingullit të javës.*

*Në Liti*

#### *Idhiomeli i parë i kishës*

#### Lavdi *Ting. Tërth. II*

**D**ielli fshehu rrezet, hëna bashkë me yjet u kthyen në gjak,<sup>15</sup> malet u frikësuan dhe kodrat u tmerruan,<sup>16</sup> kur u mbyll Parajsa.<sup>12</sup> Duke dalë, Adami godiste fytyrën me duar dhe thoshte: O përdëllyes, përdëllemë mua që rashë.

#### Tani *Hyllindësore Ting. i njëjtë*

**T**ë përhimnojmë mistikisht, o Hyllindëse Mari, sepse u shfaqe si fron i mbretit të madh, tendë e tërëshenjtë<sup>17</sup> më e gjerë se qiejt, karrocë keruvike,<sup>18</sup> më e lartë se Serafimet, nusërore lavdie,<sup>19</sup> sepse prej teje doli i mishëruar Perëndia i të gjithave;<sup>20</sup> përgjëroju atij që të shpëtojë shpirtrat tanë.

#### *Pasvargje ngjallësore*

#### Lavdi *Ting. Tërth. II*

**A**dami u hodh jashtë Parajsës për shkak të ngrënies,<sup>4</sup> prandaj dhe ndenji përballë saj<sup>12</sup> dhe vajtonte duke ulëritur dhe duke bërtitur me zë të mjerueshëm dhe thoshte: "Mjerë, çfarë pësova unë i shkretit! Shkela një porosi, atë të Zotit,<sup>6</sup> dhe u privova nga të mirat e ndryshme. O Parajsë tejet e shenjtë, e mbjellë për mua<sup>21</sup> dhe e mbyllur<sup>12</sup> për Evën,<sup>4</sup> përgjëroju atij që të bëri ty dhe që më gatoi mua, që të mbushem me lulet e tua". Prandaj i tha Shpëtimtari: "Nuk dua të humbasë krijimi im,<sup>22</sup> por dëshiroj të shpëtojë dhe të vijë në njohjen e së vërtetës,<sup>23</sup> se atë që vjen tek unë, nuk do ta nxjerr jashtë".<sup>24</sup>

#### Tani *Hyllindësore*

**Z**oti Krisht, bërësi dhe shpërblyesi im, o e gjithëpastër, si lindi prej teje i veshur si unë, çliroi Adamin prej mallkimit të parë.<sup>25</sup> Prandaj, o e gjithëpastër, të thërresim pa pushuar si nënë Perëndie dhe virgjërëshë me të vërtetë përsëherë dhe engjëllit.<sup>26</sup>

Gëzohu, o Zonjë, mbrojtje dhe hije, dhe shpëtim i shpirtave tanë.\*

*Përlëshore ngjallësore*



### NË MËNGJESORE

*Në Shërbesën e Mesnatës pas Kanunit Triadik, Litia, Himne Triadike, Trishenjtë, Ipakoia e Tingullit etj. Në Mëngjesore shërbesa e zakonshme, por, në vend të Kathizmës së tretë të sotme (e të Paqortueshmë, Ps. 118), psalet Polielei: Ps. 136, Bekintoret etj. Kanonet: Ngjallësori në 4, Kryqngjallësori në 2, i Hyjllindës në 2 dhe i Triodit në 6 (Poezi e Kristofor Protoasikritit):*

*Ting. Tërth. II*

*Ode I*

*Os en ipiro pezeftsas*

Sot, shpirti im, eja, qaj për sa bëre keq\* dhe kujtoje zhveshjen<sup>7</sup> ti\* të mëparshme në Eden\* për shkak të së cilës – mjer! –\* u hodhe larg gazit të pafund si dhe shijimit<sup>13</sup> pra.

Nga dhembshuria e madhe, plot dashuri\* më dhe më përpara jet!\* posht' prej dheut,<sup>1</sup> Bërësi\* i Krijesës, dhe detyr':\* Me engjëjt të të himnoj fort ty, Gatuesin e madh.

Me pasuri mirësie<sup>27</sup> ti ëndje<sup>13</sup> mbjell<sup>21</sup>\* në Parajsë, në Eden,\* Zot Gatues, dhe më jep\* urdhër t'i shijoj plot gaz\* pra frytet e mira, të kënaqshme, që nuk zduken kurr'.

O shpirt qyqar, mjerë! More prej Perëndis'\* në Eden pushtet<sup>2</sup> të hash,\* të shijosh çdo gjë atje,\* por dhe urdhër të mos hash\* nga fryti i njohjes;<sup>6</sup> pse e shkele ligjin zotëror?

*Hyjllindësor*

O Virgëreshë hyjnënë, je bijë pra\* e Adamit pas gjinis',\* por pas Hirit lindi ti\* Krishtin, Zotin, ndaj tani\* rithirmë se jam i internuar prej Edenit larg.<sup>12</sup>

*Zbritësore: Os en ipiro pezeftsas*

»Si në sterë, Izraeli kaloi leht'\* dhe »më këmbë, duke par'\* Faraonin, ndje- »kësin\* mbrapa gjurmëve të tij,\* të zhy- »tejt, thërriste: Zotit t'i këndojm' këng' »mundëse<sup>28</sup>.

*Ode III*

*Uq estin ajios os si*

Dikur dinaku, gjarpri djall,\* nderin tim e zilepsi,\*<sup>29</sup> ndaj në veshët e Evës murmuriti me dredhi\*<sup>3</sup> dhe, i mashtruar prej saj,\*<sup>4</sup> u dëbova prej të gjallit kor – mjerë!

E zgjata dorën vrazhdësisht,\* pemën e diturisë\* e shijova,<sup>4</sup> sado kish urdhëruar Zoti im\* që të mos haja aspak,\*<sup>6</sup> prej hyjnorit lavd më hodhën tërë vrer.

Si s'more vesh, o shpirt mjeran,\* ti tinëzinë? – mjerë! –\* Si s'kuptove mashtrimin e armikut, xhelozin?'\*<sup>29</sup> U errësore në mend\* dhe e shkele porosin' e Bërësit.<sup>6</sup>

*Hyjllindësor*

E thjeshtë, e Dëllirë, je\* shpresa, përikja ime,\* dhe ti vetëm me lindjen tënde veshë trupin dac\* të atit tonë Adam\*<sup>7</sup> pra dikur; prap' vishmë me pavdekësi.<sup>30</sup>

*Zbritësore: Uq estin ajios os si*

»Nuk ka të shenjtë pra si ti,\* o Perëndia »im, Zot,\* që e ngrite lart bririn e besnikëve »të tu\* dhe na forcove<sup>31</sup> të gjith',\* o i mir', »mbi gurin e pohimit<sup>32</sup> tënd.

*Ndenjësores*

*Ting. IV Kateplaji Josif*

Nga një ngrënie,<sup>4</sup> plot me vrer\* Adami, meqë s'mbajti dot\* porosin' e Perëndis',\*<sup>6</sup> se s'kish përbajtje, keq u flak\*<sup>12</sup> nga



çdo shijim i Parajsës<sup>13</sup> dhe u dënua:\* tokën nga u mor, ta punonte ky mjaft\* dhe ta hante bukën me djersët çurg.\*<sup>5</sup> Ta dëshirojmë ne vetëpërmbytjen,\* që të mos qajm' si ai jashtë\* Parajsës, lavdit,\*<sup>12</sup> por që të hyjmë\* të gëzuar përbrenda.

Lavdi

*O ipsothis en to stavro*

**U** shfaq tani koha\* për garën, virytin,\* Gjyqtari është bri,\* te dera, t'mos jemi\* të zymtë keq, por ejani të sjellim plot lot,\* kreshmë, kataniks, lëmoshë ne,\* duke thirrur: Fajtuam mjaft\* me mëkate më shumë\* sesa rëra e detit,\* por falna ne të gjithë, Çlirimtar,\* ta marrim rrethin,\* kurorën që s'priset lart.\*<sup>33</sup>

Tani *Hyjlindësore*

**N**uk do pushojmë hiç,\* Hyjlindëse, kurrrë\* ne të pavyerit,\* së thëni për forcat\* që ke, se, po të mos qëndroje para nesh ti\* duke ndërmjetuar, kush nga ne\* do shpëtonte nga çdo dëmtim?\* Cili na ka ruajtur\* gjer tani pra të lirë?\* Ndaj s'do largohemi aspak nga ti,\* se shërbëtorët\* e tu i shpëton gjithnjë.

*Ode IV*

*Hristós mu dhinamis*

**U**në mjerani u denjësova për nder prej teje, Zotit, në Eden; mjerë! Si u mashtrova, dhe për shkak të xhelozisë së djallit,<sup>29</sup> u dëbova nga fytyra jote!

**M**ua, të mashtuarin fatkeqësisht dhe të arratisurin nga Perëndia, më qani, o reshtat e engjëjve, bukuritë e Parajsës dhe hijeshia e bimëve të atjeshme.

**O** livadh i lum, bimë të hyjmbjella, ngazëllim i Parajsës, tani pikoni lot nga gjethet si nga sytë për mua të zhveshurin<sup>7</sup> dhe të huajin për lavdinë e Perëndisë.

**O** Parajsë e tërënderuar, nuk do të të shoh më, nuk do ta shijoj llamburitjen tënde tepër të ëmbël hyjnore, sepse jam hedhur lakuriq<sup>7</sup> përtokë, ngaqë e inatosa Bërësin.

*Hyjlindësor*

**O** Zonjë e shenjtë, që i hape për të gjithë besimtarët portat e Parajsës, të cilat i mbylli dikur Adami<sup>12</sup> për shkak të shkeljes,<sup>4</sup> m'i hap portat e mëshirës.

*Zbritësore; Hristós mu dhinamis*

»Fuqia ime Krishti, Perëndia është",\*<sup>34</sup>  
»psal me mendje të pastër edhe thërret,\*  
»siç e meriton pra Zoti, Kisha jon' e vyer  
»fort\* dhe feston në Krishtin me hare.

*Ode V*

*To thio fegji su Agathé*

**A**rmiku që urren njerëzit, meqenëse qëmoti e zilepsi<sup>29</sup> jetën time të lumtur në Parajsë, me pamje gjarpri më minoi<sup>3</sup> dhe më tregoi të huaj për lavdinë e përhershme.

**Q**aj dhe vajtoj me shpirt dhe kërkoj t'u shtohen syve te mi shumica lotësh, kur e shikoj dhe e kujtoj zhveshjen time,<sup>7</sup> që e kam nga shkelja.<sup>4</sup>

**U** gatova me dorë Perëndie prej dheut, dhe dëgjova unë mjerani: "Kthehu përsëri në dhë".<sup>1</sup> Kush nuk do të më qajë mua të dëbuarin larg Perëndisë, që e shkëmbeva Edenin me Hadhin?

*Hyjlindësor*

**T**ë gjithë ne shpresëplotët të shpallim si nusërore<sup>19</sup> mistike, o e tërëpaqortueshme që ishe shtatzënë hyjnisht; ndaj të përgjërohëm, o e Dëllirë, ndonëse rashë, bëmë familjar të nusërores së Parajsës.

*Zbritësore: To thio fegji su Agathé*

»Me drit' hyjnore, i miri ti,\* shpirtrat e »atyre që po mëngojnë<sup>35</sup> me mall për »ty, shndriti – lyp –\* të të njohin, Fjalë e »Perëndis', Zot<sup>36</sup> vërtet,\* që rithërret nga »mjegulla e mëkateve.

### Ode VI

#### Tu viu tin thálasan

Më veshe me një stoli\* të hyjthurur në Eden,\* se je i dhembshur, Shpëtimtar,\* por u shfaqta i zhveshur<sup>7</sup> i ziu un',\* sepse shkela urdhrin tënd,\*<sup>4</sup> kur u binda pa mendje te keqëbërësi.<sup>3</sup>

O shpirti im fort mjeran,\* u largove pa kujdes\* prej Perëndisë, humbe pra\* çdo shijim të Parajsës, u ndave krejt\* nga engjëjt edhe kështu\* re në prishje; ah! Mjerë, ç'rënie ishte kjo!

I tërëpushtetshmi Zot,\*<sup>37</sup> mëshiro dhe dhembshuro\* atë që bëre ti me dor';\*<sup>1</sup> lutem, mos më përbuz mua që jam ndar'\* nga kori i engjëjve,\* nga Fuqitë e tua, o i mirë krejt.

#### Hyllindësore

Mari e hyjftuar, vajz',\* Zonjë e të gjithëve,\* si linde mbretin e çdokujt,\*<sup>38</sup> Zotin Krisht Çlirimtar, mua që jam rob,\* më thirr prapë në lavdin'\* e Parajsës, në jetën e pasosur lart.

#### Zbritësore: Tu viu tin thálasan

»Ja detin e jetës tash\* e shikoj të ngrihet »prej furtune ngasjesh ashpërsisht,\* »te limani yt shumë i qetë rend edhe të »thërras: Ma ngri\* shpirtin tim, o mëshi- »rëplot', nga prishja pra.<sup>39</sup>

#### Kontaqi Ting, Tërth. II

O Zot, udhëheqës i urtësisë,<sup>40</sup> dhënës i mençurisë, edukues i të marrëve<sup>41</sup> dhe mbrojtës i të varfërve, mbështete, urtësoje zemrën time,<sup>42</sup> më jep fjalë ti, o

Fjala e Atit; sepse ja nuk do t'i pengoj buzët e mia<sup>43</sup> të thërrasin: O përdëllyes, përdëllemë mua që rashë.

#### Shtëpia

U ul atëherë Adami përballë<sup>12</sup> luksit të Parajsës<sup>13</sup> dhe qante duke e goditur fytyrën me duar dhe thoshte: O përdëllyes, përdëllemë mua që rashë.

Adami, sapo e pa engjëllin ta shtynte dhe ta mbyllte derën e kopshtit hyjnor,<sup>12</sup> psherëtiu thellë dhe thoshte: O përdëllyes, përdëllemë mua që rashë.

O Parajsë, ki dhimbje së bashku me narinin që u varfërua dhe me jehonën e gjetheve të tua përgjëroju Gatuesit, që të mos të mbyllë. O përdëllyes, përdëllemë mua që rashë.

O Parajsë e tërëvirtytshme, e tërëshenjtë, e tërëpasur, e mbjellë për Adamin<sup>21</sup> dhe e mbyllur për shkak të Evës,<sup>4</sup> përgjëroju Perëndisë për mua të rënin. O përdëllyes, përdëllemë mua që rashë.

#### Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Në të njëjtën ditë, kujtojmë dëbimin e Adamit të parëgatuat<sup>12</sup> nga Parajsa e kënaqësisë.<sup>13</sup>

*Vargje:* Kozmosi le të qajë hidhur tok me krerët e gjinisë./ pasi ra bashkë me të rënë për shkak të ushqimit<sup>4</sup> të ëmbël.

Me anën e zemërdhembshurisë sate të parrëfyeshme, o Krisht, Perëndia ynë, denjësona për shijimin e Parajsës<sup>13</sup> dhe mëshirona si i vetmi njerdashës. Amin.

#### Ode VII

#### Dhrosovolon men tin káminon

O Zot, që sundon të gjithë shekujt, që më gatove<sup>2</sup> nëpërmjet vullnetit tënd mua që pësova xhelozinë e dragoit djallëzor<sup>29</sup> dikur dhe të inatosa, mos më shpërfill, o Perëndi, por rithirrme.



**M**jerë! I veshur me rrobat e turpit<sup>5</sup> në vend të stolisë së ndritshme, qaj për katastrofën time dhe me besim të thërras, o Shpëtimtar i mirë: Mos më shpërfill, o Perëndi, por rithirrme.

**N**ga xhelozia gjarpri tërëdinak<sup>29</sup> e plagosi gjithë shpirtin tim dhe bëri të dëbohesha<sup>12</sup> larg shijimit të Parajsës;<sup>13</sup> por, o Shpëtimtar tejet i dhembshur, si Perëndi që je, mos më shpërfill, por rithirrme.

#### *Hyjlindësor*

**P**ërgjërimit tim lutës pranoje me mirësinë tënde, o e Dëlirë e tërëpaqortueshme, dhe ma jep ndjesën e mëkateve mua që thërras pa pushim me vajtime: Mos më shpërfill, o e mirë, por më rithirr.

#### *Zbritësore: Dhosovolon men tin káminon*

»Nj' engjëll furrën vesëprurëse e bëri për «Djemt' oshënarë, ndërsa kaldenjt',\* me »një urdhër që\* Perëndia dha, u dogjën »krejt.\*<sup>44</sup> Tirani u bind, ndaj të thërret:\* »Je i bekuar ti, o Perëndi i etërve tan'.<sup>45</sup>

#### *Ode VIII*

#### *Ek flogós tis osiis*

**Q**ëmoti e nderove me dhurata të shumëllojshme punën e duarve të tua,<sup>1</sup> o i vetmi Njeridashës, por një dragua i frikshëm e mashtroi<sup>3</sup> me fërshëllimë dhe – mjerë! – e zhveshi nga të mirat që kishte.<sup>7</sup>

**M**jerë, o shpirt i poshtëruar! Pse dëgjoje një këshillë të hidhur<sup>3</sup> dhe dole<sup>4</sup> nga bindja ndaj vendimit hyjnor,<sup>5</sup> duke trishtuar Perëndinë, për të cilin u caktove ta lavdëroje përherë bashkë me engjëjt?

**U** bëre zot zvarranikësh dhe bishash;<sup>2</sup> si komunikove me zvarranikun shpirtprishës, duke e konsideruar si këshilltar të drejtë keqbërësin? O çfarë mashtrimi,<sup>3</sup> shpirti im tërëmjeran!

#### *Hyjlindësor*

**O** Mari hyjhirplote, të përhimnojmë si tendë<sup>17</sup> dritëprurëse të mishërimit të Perëndisë; prandaj ndriçomë me dritën e përdëllimit mua që u errësova fatkeqësisht nga pasionet, o shpresë e të dëshpëruarve.

#### *Zbritësore: Ek flogós tis osiis*

»Vesë nxore prej flakës tek oshënarët, »Zot,\*<sup>44</sup> dhe me ujë e dogje flin' e të drejt' »tit shenjt'<sup>46</sup>;\* vetëm me vullnetin tënd, »o Krisht, bën çdo gjë<sup>47</sup> ti;\* ne në gjithë »jetët të përmbilartësojmë.

#### *Ode IX*

#### *Theón anthropis idhín*

**M**'u duk i ëmbël, i shijshëm në Eden\* fryti i njohjes, hëngra<sup>4</sup> dhe u ngopa, por më në fund\* hidhërim m'u bë, vrer. Bu! Bu! O shpirt mjeran!\* Si mospërmbajtja të ka bërë të huaj ty\* për Parajsën, pra për vatrën e kësaj, për jetën lart?

**O** Perëndi i të gjithave, shiko\* me dhembshuri përuljen time;<sup>48</sup> Zot i mëshirave,<sup>49</sup> ti mos më dëbo tej, larg Edenit hyjnor,\* që, duke parë bukuritë nga rashë keq,\* të nxitoj me qarje që t'i marr sërish sa humba un'.

**R**ënkoj, vajtoj, vuaj, qaj kur unë shoh\* engjëllin Keruvim që u caktua të ruante\* hyrjen e Edenit me të zjarrtën shpatë që të mos hyjn'<sup>12</sup> as të afrohen gjithë shkelësit. Mjerë,\* veçe në e bën ti pa penges' për mua, Shpëtimtar.

**U**n' kam besim të mëshira me bollëk,\*<sup>50</sup> te gjaku yt hyjnor, i mir', që nxore nga brinja, Krisht;<sup>51</sup> krejt natyrën njerëzore, o Shpëtimtar,\* me të e shenjtërove; dyert e mbyllura\* të Parajsës prej Adamit,<sup>15</sup> hap për sa të adhurojn'.

*Hyjlindësor*

Jeder' mendore që s'shkelet, Virgjëresh';\* o e panusëruar dhe Hyjlindëse, hapma pra\* portën e Parajsës që më parë m'u mbyll,\*<sup>12</sup> bëj që me ndërmjetimin tënd, të të lavdëroj\* ty, përkijen time plot fuqi, ndihmën pas Perëndis'.

*Pas Zbritësoreve, i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor dhe Idhiomelet Hapmi dyert; Drejtomë në rrugët; Unë i mjeri (fq. 10).*

Më të nderuarën. *Dhe Zbritësorja:*

*Theón anthropis idhin*

»Nuk munden Zotin ta shohin njerëzit,\*<sup>52</sup>  
 »se rreshta engjëjsh s'kan' guxim ta  
 »shohin,<sup>53</sup> veçse nga ti,\* e dëlirë, njerëzve  
 »iu duk ky njeri,\* Fjala e mishëruar;<sup>54</sup> e  
 »madhështojmë ne,\* dhe të lumërojmë  
 »me ushtritë engjëjlore tok.

*Dërgimësore ngjallësore dhe të Triodit:*

*Jineqes akuitisthite*

O Zot, s'dëgjova<sup>4</sup> porosin'\* që dhe,<sup>6</sup>  
 kështu jam plot me turp\* dhe jam i zhveshur<sup>7</sup>  
 nga lavdi\* dhe dola jashtë<sup>12</sup> shijimit,\*  
 jashtë Parajsës.<sup>13</sup> Obobo!\* Përdëllyes  
 i dhembshur fort\* edhe i mirë, mëshiro\*  
 atë që drejt e ka humbur\* pra, dashurin' tënde. Mjerë!

*Tjetër: Tis mathitës sinëlhomen*

Me Kryqin dhe pësimin tënd\* na fute  
 përsëri ne\* brenda Parajsës ti, o Zot,\*  
 nga ku lasht' me një ngrënie\* prej drurit'  
 larg u zhvendosëm;\*<sup>12</sup> o Shpëtimtar, me  
 Kryqin\* ti na dhuro fuqi dhe hir\* ta mbarojm'  
 kreshmën plot me dëlirësi,\* dhe me  
 ndërmjetimin e nënës sate\* t'i falemi  
 shpëtueses\* Pashkë, hyjnores Ngritje.

*Lavdërime (me Vargjet e së dielës):*

*5 ngjallësore dhe 3 të Triodit:*

*Ting. Tërth. I*

Bërtiti Adami me qarje: Mjerë! Sepse

gjarpri<sup>3</sup> dhe gruaja<sup>6</sup> më nxorën nga guximi  
 hyjnor, dhe ngrënia e frytit të drurit'  
 më bëri të huaj për Parajsën e shijimit.<sup>13</sup>  
 Mjerë! Nuk e duroj dot më turpin: Unë,  
 mbreti i dikurshëm i gjithë krijesave to-  
 kësore të Perëndisë,<sup>2</sup> tani shfaqem i ro-  
 bëruar prej një këshille të paligjshme,<sup>3</sup> dhe  
 unë, i veshuri dikur me lavdi pavdekësie,  
 tani e lëviz vërdallë lëkurën<sup>4</sup> e vdekjes si i  
 vdekshëm dhe i gjorë.<sup>5</sup> Mjerë! Cili do të më  
 përkrahë në vajtime? Por ti, o Njeridashës,  
 që më bërë prej dheut,<sup>1</sup> përdërisa u veshe  
 me zemërdhembshuri, rithirrme nga sklla-  
 vëria e armikut dhe shpëtomë.

Stadiumi i viryeteve u hap: Ju që doni të  
 garoni, hyni duke u ngjeshur me luftën e  
 mirë të kreshmës, sepse ata që garojnë  
 ligjërisht, kurorëzohen drejtësisht,<sup>55</sup> e pa-  
 si të marrim përsipër armatimin e Kryqit,  
 le të luftojmë kundër armikut, duke pa-  
 sur besimin si mur të paçarë, lutjen si  
 parzmore dhe lëmshën si helmetë; në  
 vend të thikës, kreshmën që pret nga ze-  
 mra çdo të keqe; ai që i bën këto, merr  
 prej Krishtit tërëmbret kurorën e vërtetë  
 në ditën e Gjyqit.

*Ting. Tërth. II*

Adami flaket nga Parajsa,<sup>12</sup> sepse, si i  
 pabindur, hëngri ushqim.<sup>4</sup> Moisiu u bë  
 hyjshikues,<sup>56</sup> sepse i pastroi me kreshmë  
 sytë e shpirtit.<sup>57</sup> Prandaj, nëse dëshirojmë  
 të bëhemi banues të Parajsës, le të çli-  
 rohem nga ushqimi i padobishëm, dhe,  
 meqë dëshirojmë ta shohim Perëndinë,  
 le të kreshmojmë dyzet ditë<sup>58</sup> si Moisiu;  
 duke bërë sinqerisht durim në lutje dhe  
 përgjërime,<sup>59</sup> le t'i zbutim pasionet e shpir-  
 tit, t'i largojmë fryrjet, plagët e mishit; le  
 të shkojmë të lehtësuar për në rrugën  
 e sipërme, atje ku koret e engjëjve e  
 përhimnojnë me zëra pareshtur Trininë



e pandarë, duke parë bukurinë e përmbinatyrshme zotërore. O Krisht, Bir i Perëndisë jetëdhënës, ne që besojmë te ti, na denjëso të kërcejmë atje tok me ushtritë e engjëjve me ndërmjetimet e nënës që të lindit, të apostujve, të martirëve dhe të gjithë shenjtorëve.

Lavdi *I njëjti*

Arriti koha, nisja e garave shpirtërore, fitorja ndaj demonëve, pra vetëpërmbajtja e tërarmatosur, hijeshia e engjëjve, guximi para Perëndisë. Nëpërmjet saj<sup>57</sup> Moisiu bashkëbisedoi me Krijuesin dhe i erdhi një zë në vesh pa parë askënd.<sup>56</sup> Përmes saj, denjësona dhe ne, o Zot, t'u falemli pësimeve të tua dhe Ngjalljes sate të shenjtë, si njeridashës.

Tani  
E përmbibekuar

*Dhoksologjia e Madhe.*

*Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Triodit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore dhe e kishës. Kontakti i sotëm O Zot, udhëheqës i urtësisë.*



#### NË MBRËMËSOREN KATANIKTIKE

*Pas Psalmi Nistor (dhe pa Psaltr si në të gjitha të dielat e vitit, përveç Qëndrimit të parë në ditët e shenjtorëve të mëdhenj) dhe Paqësoreve, 10 Thirrortet: 4 Kataniktike të Tingullit të javës, 3 të Triodit (të mëposhtme) dhe 3 të Mujorit.*

*Të Triodit (poezi e zotit Josif):*

*Ting. II. Ængjelos men to here*

Mishin çdokush ta ulë,\* të luftojmë duke u futur ne\* në kreshmë pa njoll', në stadium hyjnor;\* Zotin që na shpëton krejt,\* ta kërkojmë<sup>60</sup> me lutje, lot,\* ta

harrojmë të keqen përfundimisht;\* atij le t'i thërrasim:\* Mëkatuam, na shpëto, o Krisht mbret,\* siç bëre lashtë ti kur\* shpëtove ninevitët,<sup>61</sup> i dhembshur; na bëj\* dhe pjesëmarrës ne\* që të gjith' në mbretërinë tënde në qiejt lart.

Duke kujtuar veprat\* që kam bërë keq, dëshpërohem mjaft;\* për çdo ndëshkim këto jan' të denja, Zot,\* se porosit' e tua,\* të nderuara, Shpëtimtar,\* i përbuza dhe jetën e prisha kot\* në faj;<sup>62</sup> ndaj lyp, pastromë\* përmes shiut të pendimit edhe\* me kreshm' e lutje,<sup>63</sup> se je\* i vetmi përdëllyes, kështu më shkëlqë\* dhe mos më neverit,\* mirëbërës ti i çdokujt dhe i mbimirë krejt.

*Tjetër; e zotit Theodor*

*Ting. II. Ton ipër nun dhoreón*

Kohën e kreshmës le ta nisim me gëzim, duke e nënshtruar veten tonë në gara shpirtërore; le ta dëllirësojmë shpirtin dhe ta pastrojmë mishin; le të agjërojmë si nga gjellët, ashtu dhe nga çdo pasion, duke shijuar virtytet e Shpirtit; duke pasur ato, le të denjësohemi të gjithë ta vëzhgojmë pësimin e tërërespektuar të Krishtit Perëndi si edhe Pashkën e shenjtë, duke u ngazëlluar shpirtërisht.

*Dhe të tria të Mujorit.*

*Lavdi dhe Tani*

*E Mujorit (Hyjllindësore)*

*Hyrje me temjanicë, siç bëhet edhe çdo të diel në Mbrëmësore gjatë Kreshmës, për shkak të Proqimëve të Mëdhenj. O dritë gazmore dhe Proqimeni i Madh:*

*Ting. Tërth. IV*

Mos e kthe mënjane fytirën nga shërbëtori yt, sepse trishtohem; dëgjomë shpejt, vëri re shpirtit tim dhe çliroje.

*Varg: Shpëtimi yt, o Perëndi, më përkrahtë. Mos e kthe mënjane...*

*Varg:* Le të shohin të varfër dhe le të dëfrenjë. Mos e kthe mënjane...

*Lutja e gjatë (Ektenis):* Le të themi të gjithë... Bëna të denjë, o Zot... Le ta plotësojmë lutjen tonë...

### *Pasvargje Ting. IV Idhiomeli*

Shkëlqeu Hiri yt, o Zot, shkëlqeu ndriçimi i shpirtrave tanë. Ja koha e mirëpritur,<sup>64</sup> ja koha e pendimit; le të zmbarsim veprat e errësirës dhe le të veshim armët e dritës<sup>65</sup> që, pasi të përshkojmë detin e madh të kreshmës, të arrijmë në Ngjalljen treditëshe të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht, që i shpëton shpirtrat tanë.

*Varg:* Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

### *I njëjti*

*Varg:* Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

### *Martirik*

**O** Krisht Perëndi, që lavdërohesh në kujtimet e shenjtoreve të tu, me anë të përgjërimeve të tyre, na dërgo përdëllimin e madh.<sup>66</sup>

### *Lavdi dhe Tani Hyjlindësor Os jeneon en mërtisin*

Vajzë, rreshtat e engjëjve\* të lëvdajnë, se linde ti\* mishërisht atë që është përjetësisht\* bashkë me Atin dhe Shpirtin, që i bëri nga zeroja\* me vullnet krejt thjesht ushtrit\* engjëjlore, ndaj lyp atë\* t'i shpëtojë pra,\* t'i ndriçojë, hyjnënë,

shpirtrat e atyre që të përhimojnë orthodhoksisht ty që je pa cen.

Tani përlëshoje, *Trishenji dhe Troparet, duke bërë një metani në secilin prej tyre përveç të fundit që lexohet pa melodi:*

### *Ting. Tërth. I*

**G**ëzohu, o hirplotë Hyjlindëse, Virgjëreshë Mari, Zoti është me ty; e bekuar je ti ndër gratë dhe e bekuar<sup>26</sup> është pema e barkut tënd,<sup>67</sup> se linde Shpëtimtarin e shpirtrave tanë.\*

**O** Pagëzor i Krishtit, kujtona ne të gjithë, që të shpëtojmë nga paligjësitë tona, se ty të është dhënë hiri të ndërmjetosh për ne.\*

### *Lavdi*

**L**utuni për ne, o apostuj të shenjtë dhe ju të gjithë shenjtoret, që të shpëtojmë nga rreziqet e hidhërimit, se ju ju kemi mbrojtës të nxehtë të Shpëtimtari.\*

### *Tani Hyjlindësor*

**N**ën dhembshurinë tënde vrapojmë, o Hyjlindëse, mos i moho lutjet tona në peripeci, po shpëtona nga rreziqet, e vetmja e kulluar, e vetmja e bekuar.\*

*Lexuesi:* Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën... Beko, o atë, në emrin e Zotit.

*Prijji:* Krishti, Perëndia ynë, që është i bekuar, gjithnjë, tani e përherë dhe në jetë të jetëve.

*I pari:* Amin. O Mbret qiellor,<sup>68</sup> siguroji mbretërit tanë besnikë, përmbaje besën, zbuti kombet, paqësoje botën, ruaje mirë këtë shtëpi të shenjtë, etërit dhe vëllezërit tanë që shkuan para nesh, vëri në tenda të drejtësh<sup>69</sup> dhe ne pritna me pendim e me rrefim si i mirë dhe njeridashës.\*

*Tri metanitë e mëdha, duke thënë në çdo*



*metani një Varg nga Urata e shën Efremit (pa dymbëdhjetë të voglat):*

Zot dhe Mjeshtër i jetës sime,<sup>70</sup> mos më jep frymë përtese, kureshtie, lavdidashjeje dhe llafazanërie.

Po falmë mua, shërbëtorit tënd, frymë meçurie, përunjësie, durimi dhe dashurie.

Po, o Zot dhe Mbret, vlerësomë t'i shikoj fajet e mia dhe të mos e gëjkoj tim vëlla, se i bekuar je në jetë të jetëve. Amin.\*

*Dhe Përlëshimi. Ky tip duhet të bëhet çdo të diel deri të Dielën e Dafinave.*

### CITIME

1. Gjen. 2.7; Jov 10.9; Ps. 102(103).14
2. Gjen. 1.28; Ps. 8.7-8; Is. 45.12-13
3. Gjen. 3.1-5
4. Gjen. 3.6
5. Gjen. 3.19; Jov 10.9
6. Gjen. 2.16-17
7. Gjen. 3.7
8. Gjen. 3.21
9. Gjen. 3.18
10. Hebr. 1.2; I Petr. 1.20
11. Gjen. 2.9; 3.22,24
12. Gjen. 3.24
13. Gjen. 2.15
14. Matth. 6.17; 9.15; 17.21; Mark 2.20; 9.29; Lluk. 5.35
15. Joel 3.4 (2.31); Vep. 2.20
16. Jer. 4.24
17. Eks. 25.8; 26.30; Hebr. 9.2
18. Jez. 1.5-23; 10.1
19. Matth. 25.1-10
20. Rom. 9.5
21. Gjen. 2.8
22. Jez. 18.23,32
23. I Tim. 2.4
24. Joan 6.37
25. Gjen. 3.17
26. Lluk. 1.28
27. Rom. 2.4
28. Eks. 14.21-15.1
29. Urt. Sol. 2.24
30. I Kor. 15.54
31. I Mbret. [Sam.] 2.1-2
32. Matth. 16.16-18
33. I Kor. 9.25
34. Abak. 3.19; Joan 20.28
35. Is. 26.9
36. Joan 1.1
37. Apok. 4.8; 11.17; 15.3; 16.7; 19.6; 21.22
38. Est. 4.17b; Ps. 94(95).3
39. Jona 2.7
40. Urt. Sol. 7.15
41. Rom. 2.20

42. Ps. 111(112).8
43. Ps. 39(40).10
44. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 24-26
45. Dan. 3.28
46. III [I] Mbret. 18.38
47. Hebr. 1.3
48. Ps. 24(25).18; 30(31).8; 118(119).153
49. Urt. Sol. 9.1
50. Ps. 5.8; 68(69).14; 105(106).7,45
51. Joan 19.34
52. Eks. 33.20; Joan 1.18
53. Is. 6.2
54. Joan 1.14
55. II Tim. 2.5
56. Eks. 33.23
57. Eks. 34.28
58. Zah. 8.19
59. Vep. 1.14
60. Ligji i Dytë 4.29 etj.
61. Jona 3.10
62. Lluk. 15.13
63. Matth. 17.21; Mark. 9.29; Lluk. 2.37
64. Is. 49.8; II Kor. 6.2
65. Rom. 13.12
66. Num. 14.19 etj.
67. Lluk. 1.42
68. II Tim. 4.18
69. Ps. 117(118).15
70. Sirak 23.1



## FILLIMI I KRESHMËS SË SHENJTË DHE TË MADHE

### TË HËNËN E JAVËS SË PARË NË MËNGJESORE

*Kambana bie më vonë për shkaktë "ngushëllimit" mbrëmësor të djeshëm.*

*Prifti: I bekuar është Perëndia ynë... Lexuesi: Amin. Trishenjti (pa metani)... Prifti: Se jotja është... Lexuesi: Amin. Mëshiro, o Zot (12x) dhe menjëherë Prifti: Lavdi Trinisë së Shenjtë, të njëqenshme... Dhe lexohen Gjashitë Psalmet. Pas Paqësoreve, Psaliët: Alilua (3x) në Tingullin e javës (4x me Vargjet e tyre: a. Qëmenatë mëngon shpirti im për ty, o Perëndi, se urdhërimet e tua janë dritë mbi dhe. b. Mësoni drejtësinë, ju banorët e dheut. c. Smira do ta pushtojë popullin*

e pamësuar dhe tani zjarri do t'i përpijë kundërshtarët. *d. Shtojua të këqijat, o Zot, shtojua të këqijat kryelartëve të dheut,)* dhe Triadiket (shih në fund të librit para Vargëzimeve dhe Ndenjësove), që psalen me melodi, me zë të lartë dhe ngadalë. Pastaj lexohet një Kathizmë e Psaltrit dhe në çdo Qëndrim të saj bëjmë tri metani të vogla. Pra, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret Kataniktike të Tingullit të javës. Lexim nga shën Efrem Siriani.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove, poezi e zotit Josif:*

*Ting. Tërth. II Efsplahnias ipárhusa*

Në fillim pra të kreshmës fort të shenjt,\* kataniks shpirtëror le të fitojm' duke thirrur:\* Zot, prit lutjen tonë si temjan të mir;\* lypim, na çiro nga duhma prishjeje\* edhe nga ndëshkimi tmerr,\* sepse i pajtueshëm\* vetëm ti je, Krishti im,\* Perëndia im dhe Shpëtimtar Jisu.

Lavdi

*E njëjta*

*Tani Kryqhyjllindësove*

Je burim dhembshurie dhe kështu,\* o Hyjllindëse, bëna krejt të denj' për mëshirë:\* popullin që mëkato!<sup>1</sup> shihe ti,\* si gjithnjë tregojë qart' pushtetin tënd;\* meqë ne shpresojm' në ty,\* "Kí gaz", të thërrasim ne\* si një kryegjeneral\* të paturpësh, Gabrieli shenjt, dikur.<sup>2</sup>

*Prapë lexim nga shën Efremi.*

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësove, poezi e zotit Theodor:*

*Ting. II Tin áhranton ikona su*

Përbajtjen e nderuar fort\* ta fillojmë me hare,\* të fëksim ne me rrezet e porosive të Perëndisë Krisht, Zot,\* të shenjtja janë;<sup>2</sup> të lëshojm' shkëlqimin e dashurisë pra,\* dritësimin e lutjes tok,\* dëlirësin' e

pastër nur,\* forcën e guximit; kështu do vijm'\* me drit' në Ngjalljen e triditshme dhe të shenjtë krejt,\* që llamburit me paprishje botën e tërë.

Lavdi

*E njëjta*

*Tani Hyjllindësove*

Meqë kam në vështirësi\* ndërmjetimin tënd të fort\* që s'mposhtet, nga të hidhurat përmbi shpresë çlirohem çuditërisht;\* arrin gjithnjë te sa me besë, nënë e Perëndisë ton',\* të kërkojnë, edhe dëbon\* terr fajesh pra të shumta ti,\* Zonjë, ndaj me gaz të thërrasim ne:\* Prit himn të shkurtër, por falënderues si shpërblim,\* sepse në çdo gjë të kam për-krahëse, ndihmë.

*Pastaj lexim nga Lafaiku. Psalmi 50. Prifti thotë uratën e zakonshme: O Perëndi, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd; vështroje... Me mëshirën, dhembshurinë dhe... Kanuni i Mujorit me Irmoset e tij dhe Triodet në vendin e tyre. Lexohet dhe Ode I biblike. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit (si zakonisht) dhe lexim nga Lafaiku. Pas Odes VI, Martiriku i Tingullit. Sinaksari i Mujorit. Kështu bëjmë në tërë Kreshmën e Madhe.*

*Triodi i zotit Josif*

*Ting. II*

*Ode I*

*Dhefte lai*

Si do ta qaj\* unë tani rënien time, o Zot,\* i dhembshur? Cilën nisje për shpëtim do bëj tash un' që jetova në shturje?<sup>4</sup> Shpëtomë nëpërmjet gjykimeve që di ti.

Ja kohë, mot,\* edhe ja ditë shpëtimi,<sup>5</sup> o shpirt,\* se po hyn kreshma; shfaq gati-shmëri dhe mbylli hyrjet e veseve mirë,\* vepro, bëj duke parë Zotin përherë ti.



Po dimërojmë\* nëpër shtrëngatat e shkeljeve un',\* në dëshpërim, Zot, thell'; kjo më fundos, por rend në detin e pafund përherë\* të përdëllimit tënd; shpëtomë, i miri Zot.<sup>6</sup>

Jam bërë rob\* vetëm un', skllav në mëkat;<sup>7</sup> vetëm un'\* u hapa derë veseve, o e pajtueshmja Fjalë, Zot; por më kthe t'i\* me dhembshurinë tënde, falmë, shpëtomë pra.

### *Hyjlindësor*

Kishe në bark,\* Vajzë, burimin e pafajësis',\* ndaj mua të plagosurin nga veset më shëro, nga e përhershëmja flakë\*<sup>8</sup> rrëmbemë, o e vetmja ti, hyjhirplote krejt.

### *Triodi tjetër; i zotit Theodor*

#### *Tingull dhe Irmosi i njëjtë*

Ejani pra,\* që sot karizmën e kreshmëve ne\* ta mirëpresim si të hydhuruar tok me kohën e mir' të pendimit;\* ta zbutim Shpëtimtarin, popuj, përgjatë saj.

Erdhi tani\* koha e garës dhe nisi për ne;\* të gjithë me gatishmëri pra le të hyjmë në stadiumin e kreshmës,\* virtytet e saj si dhurat' Zotit t'ia blatojm'.

### *Lavdi Triadik*

Njësi e thjeshtë\* dhe me tri drita, pushtet krejt unik,\* tërëfuqi dhe tërëjetë, Zot dhe Perëndi, Atë, forc' absolute,\* o Bir dhe Shpirt, shpëto sa të adhurojnë ty.

### *Tani Hyjlindësor*

Le ta himnojmë\* malin e shenjtë të Zotit,<sup>9</sup> Marin'\* e pacenuar; dielli i drejtësisë lindi<sup>10</sup> prej saj për sa ishin\* në terr,<sup>11</sup> pra lindi Krishti, jeta e neve krejt.<sup>12</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Qerjra me zjarr\* mori llin<sup>13</sup> e çuditshëm, sepse\* ish armatosur fort me kreshmën,<sup>14</sup> ndërsa Moisiun<sup>15</sup> e shfaqti shikues\* misteresh;<sup>16</sup> në e zgjedhim, Krishtin do shohim ne,

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Meqë kish ngrën'\* frytin, Adamin<sup>17</sup> e nxjerr, e flak larg\* Parajsës mospërmbajtja;<sup>18</sup> ndërsa kreshma, si të na marrë, do t'na tregojë\* të denjë për pendim, o Zot njeridashës krejt.

### *Irmosi: Dhefie lai*

»Popuj të gjith',\* ejani që t'i këndojm' »Perëndis',\* pra Krishtit që, si ndau detin, »udhëhoqi popullin që e çlirroi\* nga zgjedha e Egjiptit,<sup>19</sup> se u lëvdua fort.<sup>20</sup>

### *Ode VIII*

#### *Ton en kamino tu pirós*

Mua që u dogja prej kënaqësish dhe m'u errësua shikimi i shpirtit, më përtërit, o Krisht, me zjarrin e frikës sate dhe më shkëlqe me dritën e shpëtimit, që të të lavdëroj në gjithë jetët.

Urreje ngopjen me pasione, shijoji ërëzat e të mirave dhe ëmbëlsohu më tepër me shijimin e kreshmës, duke evituar hidhërimet e kënaqësive, o shpirti im i varfër, dhe jeto përjetësisht.

I ngurtësuar në shpirt dhe i errësuar nga dehja e pasioneve, nuk të vështroj dot fare ty, o i vetmi Perëndi;<sup>21</sup> ndaj dhembshuromë, ndriçomë dhe hapmi portat e pendimit.

### *Hyjlindësor*

O e Kulluar, që e bërë qiell esencën tonë të prishshme tokësore, me ndërmjetimin tënd të nxehtë bëj që të drejtohen lutjet dhe përgjërimet tona ndaj Perëndisë, mbretit tënd dhe të të gjithëve.<sup>22</sup>

### *Irmosi tjetër: Ton pale dhrosisanta*

Le ta presim me ngazëllim hyrjen e kreshmës, o shpërsëplotë, dhe le të mos i zymtojmë fytyrat tona, por le t'i lajmë<sup>23</sup>

me ujë papasionshmërie, duke e bekuar dhe e përmbilartësuar Krishtin në jetë.

**P**asi ta lyejmë kokën<sup>23</sup> e shpirtit me vaj dhembshurie, duke mos bërë lllomotitje<sup>24</sup> ndaj Atit tonë që është në qiej,<sup>25</sup> le t'i drejtojmë lutje duke e bekuar dhe e përmbilartësuar në jetë.<sup>26</sup>

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin.

### Triadik

**L**e ta himnojmë, o besnikë, Atin si të përjetshëm, pa fillim, ndërsa Birin si të bashkëpafillim me të dhe Shpirtin që bashkëndriçoi me Birin prej Atit, të cilët janë Personat e bashkëqenshëm të një autoriteti dhe pushteti të tërëfuqishëm.

### Tani Hyjlindësor

**O** Mari e hyjftuar, je vërtet zbutja për besimtarët, sepse prej teje u transmetohet me bollëk ndjesa të gjithëve; mos resht së zbuturi Birin dhe Zotin tënd për sa të himnojnë.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Meqenëse Zoti agjëroi në një periudhë dyzetditore,<sup>27</sup> i hyjnizoi dhe i shenjtëroi ditët e tanishme, o vëllezër; pasi arritëm në to, thërrasim: Bekojeni dhe përmbilartësojeni Krishtin në jetë.<sup>28</sup>

Himnojmë, bekojmë dhe i falemi Zotit.

### Irmosi: Ton pale dhrosisanta

»Zotin që qëmoti i freskoi Djemtë e hebrenjve në flakë dhe i dogji kalendjtë »habitshëm në të,<sup>29</sup> le ta përhimnojmë »duke thënë: Bekoni dhe përmbilartësoni »në gjithë jetët.

### Ode IX

#### Ton ek Theu Theon Logon

**U** bëftë dita e keshmës, shpirt, largim nga mëkati,\* shenjë pajtimi, familjar-

zim\* me Perëndinë; do ikësh kështu\* nga e keqja, greminat e saj dhe vetëm do të dëshirosh\* udhët që çojnë në lehtësimin e atjeshëm, lart.<sup>29</sup>

**S**i më rrëshqiti keq mendja dhe në mish mëkatova,\* qaj un', vajtoj fort dhe rënkoj, thërras:\* O Zot, shpëtomë, shpëtom', vetëm ti\* s'mban inat, mos më hidh brenda zjarrit të Gjehenës<sup>30</sup> së pafund;\* për dënimin jam i denjë, i mjeri unë, për ndëshkim.

**T**ë veshur nur me këmishën e shkëlqyer të keshmës,\* robën e errët dhe të rëndë gur,\* pra s'thurjen, ne le ta zhveshim;<sup>31</sup> kështu,\* me virtyte të hyjshme do bëhemi të hijshëm dhe me bes'\* do shikojmë pësimet plot drit' të Shpëtimtarit Krisht.

### Hyjlindësor

**M**jerani shpirti im është pa forc', se e sulmuan\* tërë demonët tepër të këqij,\* Zonjë pa cen, ndaj shëroje, meqë\* linde mjekun, pra Krishtin, çlirim<sup>32</sup> për ne që të njohim ty,\* Vajzë, si virgjëreshë pa prishje, të kulluar krejt.

### Irmos tjetër: Tin iperfiôs sarki

**K**oha për keshmim të shenjt'\* erdhi, ta fillojmë tash\* me sjellje fort të mirë,\*<sup>33</sup> sepse siç thotë thënia:\* Për luftë dhe gjykime\* ju mos agjëroni kot.<sup>34</sup>

**P**erëndin' e pa në mal\* shën Ilia, në Horev,\* i pastër përmes keshmës;\*<sup>35</sup> të pastrohemi dhe ne\* në zemër me keshmimin\* dhe do shohim Zotin Krisht.

### Lavdi Triadik

**T**re Persona përhimnoj,\* një natyrë adhuroj,\* një Perëndi mbi çdo gjë,\*<sup>36</sup> Atin, Birin dhe Shpirtin\* e Shenjtë, ndaj i falemi\* një pushteti në amshim.

### Tani Hyjlindësor

«E dëlirë, lind fëmij',\* Virgjëreshë, ti jep



gji,\* si tok i bën të dyja,\* lind sado je e virgjër?\*. \*E bëri Perëndia,\* mos heto mënyrën ti".

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Tërë jeta e çdokujt,\* thotë se një ditë është,<sup>37\*</sup> po dyzet ditë është\* kreshma, ndaj me dëshirë\* të lodhemi, ta mbajmë\* hijesisht dhe me gëzim.

*Irmosi: Tin iperfiós sarkí*

»Le ta madhështojmë ne,\* o besnik', «Hyllindësen\* e vetme që në mitër\* zuri «me mish mbi mendje\* pra Fjalën, që «prej Atit\* parashndriti fort pa koh'.

Të meriton me të vërtetë të të lumërojmë ty Hyllindësen, gjithmonë të lumurën dhe të përbikulluarën dhe mëmën e Perëndisë tonë; më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cenuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë, Hyllindëse, ty të madhërojmë.\*

*Fotogjiku i Tingullit  
Dhe Dhokologjia e Vogël:*

Ty të ka hije lavdi, o Zot, Perëndia ynë, dhe ty ta dërgojmë lavdinë, Atit, Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Lavdi Perëndisë që është në më të lartat dhe mbi dhenë paqe dhe mbi njerëzit mirëdashje. Të himnojmë, të bekojmë, të falemi, të lavdërojmë, ty të falënderojmë për lavdinë tënde të madhe. Zot Mbret, Perëndi qiellor, Atë i tërëfuqishëm, Zot, Bir i vetëmlindur Jisu Krisht, edhe Shpirt i Shenjtë. Zot, Perëndi, qengji i Perëndisë, Bir i Atit që ngre mëkatën e botës, mëshirona, ti që ngre mëkatet e botës. Prano lutjen tonë, ti që rri në të djathtë të Atit, edhe mëshirona. Se ti je shenjt i vetëm, ti je Zot i vetëm Jisu Krishti, për

lavdi të Perëndisë, Atit. Amin. Përditë do të të bekoj dhe do të lavdëroj emrin tënd përjetë e në jetë të jetës. O Zot, u bëre streha jonë brez pas brezi, unë thashë: O Zot, mëshiro më, shëro shpirtin tim se fajtova te ti. O Zot, te ti gjeta strehë, mësomë të bëj dëshirën tënde se ti je Perëndia im. Se pranë teje është burimi i jetës; me dritën tënde do të shohim dritë. Zgjate përdëllimin tënd mbi ata që të njohin. Bëna të denjë, o Zot, që të ruhemi këtë ditë pa ndonjë mëkat. I bekuar je, o Zot, Perëndi i Etërve tanë, dhe emri yt është i himnuar dhe i lavdëruar në jetë. Amin. Le të jetë, o Zot, përdëllimi yt mbi ne, sikurse kemi shpresuar te ti. I bekuar je, o Zot, mësomë porositë e tua. I bekuar je, o Zot, bëmë të mençëm në porositë e tua. I bekuar je, o i Shenjtë, ndriçomë me porositë e tua. O Zot, mëshira jote është përjetë, mos i hiq sytë nga veprat e duarve të tua. Ty të ka hije lëvdata, ty të ka hije himni, ty të ka hije lavdia, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.\*

*Prifit: Le ta plotësojmë etj.*

*Pasvargjet e Lavdërimeve Ting. Tërth. I  
Idhiomeli*

**K**a ardhur kreshma, nëna e mençurisë, qortuesja e mëkatit, dëshmitari mbrojtës i pendimit, sjellja e engjëjve dhe shpëtimi i njerëzve. O shpresëplotë, le të thërrasim: O Perëndi, mëshirona.<sup>38</sup>

*Varg:* U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përulo, të viteve që pamë të këqija; dhe vëshuro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt' e tyre.

*I njëjti*

**Varg:** Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji te ne dhe veprën e duarve tona drejtoje.

*Martirik*

**E** bekuar është ushtria e mbretit të qiejve, sepse, ndonëse athloforët ishin dhelindur, nxitonin të arrinin gradën engjëjlore, pasi i shpërfillën trupat dhe u denjësuan të merrnin me anën e pësimeve çmimin e të patrupëve. Me uratat e tyre, o Zot, shpëtoj shpirtat tanë.

*Lavdi dhe Tani Hyllindësor*

**M**e zëra këngësh të madhështojmë ty, nënën e Perëndisë dhe virgjëreshën e kulluar, më të shenjtën se Keruvimet, sepse me shpirt dhe me gojë të pohojmë si Hyllindëse, meqë veçanërisht linde Perëndi të mishëruar; o e tërëdëlirë, ndërmjeto për shpirtat tanë.

**Lexuesi:** Është mirë ta lavdërojmë Zotin dhe t'i psalim emrit tënd, o i Tërërlartë, që të njoftojmë në mëngjes mëshirën tënde dhe të vërtetën tënde përnatë.<sup>39</sup>

**Trishenjti. Prifti:** Se jotja është. **Lexuesi:** Duke qëndruar në tempullin e lavdisë sate, mendojmë se qëndrojmë në qiell, o Perëndilindëse, portë qiellore;<sup>40</sup> hapna derën e mëshirës sate.

Mëshiro, o Zot (40x). Më të nderuarën... Beko, o atë, në emrin e Zotit.

**Prifti:** Krishti, Perëndia ynë, që është i bekuar, gjithnjë tani e përherë e në jetë të jetëve.

**I pari:** Amin. O Mbret qiellor, siguroji mbretërit tanë besnikë, përmbaje besën, zbuti kombet, paqësoje botën, ruaje mirë këtë shtëpi të shenjtë; etërit dhe vëllezërit tanë që shkuan para nesh, vëri në tenda

të drejtësh<sup>41</sup> dhe ne pritna me pendim e me rrëfim si i mirë dhe njerdashës.\*

*Dhe Uratën e Shën Efremit (fq. 58), duke bërë tri metani të mëdha (dhe 12 të vogla). Dhe menjëherë Ejani t'i falemi dhe Ora e Parë (në Orën e Parë të çdo të hënë të Kreshmës së Madhe nuk lexohet Psaltri).*

*Në Orën e Gjashtë (në Trithektë), Tropari i Profecisë:*

*Ting. Tërth. I*

**O** Zot, o Zot, që të gjitha ta kanë frikën dhe tremben para fytyrës së fuqisë sate, ty të biem në gjuhë, o i pavdekshëm, ty të lypim, o i shenjtë: Shpëtoj shpirtat tanë me ndërmjetimet e shenjtoreve të tu.

*Lavdi dhe Tani**I njëjti*

Proqimen. Ting. IV. Psalm 1.

Di Zot! udhë të drejtësh dhe udhë të pabesësh do të asgjësohet.

**Varg:** Lum ai njeri që nuk shkoi në këshill të pabesësh.

*Këndimi i profecisë së Isaias**(1.1-20)*

**V**egim, të cilin e pa Isaia, biri i Amosit, të cilin e pa kundër Judesë dhe kundër Jerusalemit, gjatë mbretërimit të Ozisë dhe Joathamit, dhe Ahazit, dhe Ezekisë, të cilët mbretëruan në Jude. Dëgjo, o qiell, dhe vër veshin, o dhé, sepse Zoti foli: "Bëra bij dhe i lartësova, ndërsa ata më shpërfillën. Kau e njuh të zotit e tij dhe gomari koritën e zotit të tij, mirëpo Izraeli nuk më njohu dhe populli im nuk më kuptoi". Mjerë, o komb mëkatar, popull plot me mëkate, farë dinake, bij të paligj! E braktisët Zotin dhe e inatosët të shenjtin e Izraelit. Me çfarë do të plagoseni më, duke shtuar paligjësi? Çdo kokë, në dhimbje dhe çdo zemër, në tri-



shtim. Nga këmbët gjer te koka, nuk ka në të tërësi, as traumë, as vurratë, as plagë me flegmon; nuk mund të vendoset sipër as kompresë, as vaj, as fashë. Toka juaj është e shkretë, qytetet tuaja të djegura me zjarr. Vendin tuaj e hanë të huajt para jush, dhe u shkretua ngaqë u shkatërrua nga popuj të huaj. Do të braktiset bija Sion, si tendë në vresht dhe si depo frutash në bostan, si qytet i rrethuar në luftë; dhe nëse Zoti Sabaoth nuk do të na linte farë, do të bëheshim si Sodoma dhe do të ngjanim si Gomorra. Dëgjoni fjalë Zoti, o hegjeomonët e Sodomës; vëri re ligjit të Perëndisë, o popull i Gomorrës. "Pse për mua është moria e filjimeve të tua?", thotë Zoti. "Jam plot me holokauste deshësh dhe dhjamë delesh; dhe gjak demash e cjepsh nuk dua; as kur të vini për t'u shfaqur para meje, sepse kush i kërkoi këto nga duart tuaja? Nuk do shtoni ta shkëlqi nënllinë time; në qoftë se do të sillni majën e miellit, kot; temjani është neveri për mua; ditët tuaja të para të çdo muaji të ri dhe të shtunat dhe ditët të madhe nuk i duroj dot; kreshmë dhe pushim dhe ditët e para të çdo muaji të ri dhe festat tuaja i urren shpirti im; m'u bënë ngopje *me neveritje*, nuk do t'i fal më mëkatet tuaja; kur t'i shtrini duart tuaja drejt meje, do t'i kthej mënjanë sytë e mi; dhe, nëse do të shumëfishoni lutjen, nuk do t'ju dëgjoj, sepse duart tuaja janë plot me gjak. Lahuni dhe bëhuni të pastër; hiqni djallëzitë prej shpirtit tuaj përballë syve të mi, pushoni nga djallëzitë tuaja; mësoni të bëni të mirën, kërkoni fort gjykim, shpëtoni të padrejtësuarin, gjykoni jetimin dhe drejtësoni vejushën. Dhe ejani, dhe le të diskutojmë", thotë Zoti, "dhe nëse mëkatet tuaja do të jenë si purpur, si dëborë do t'i zbardh; dhe nëse

do të jenë si të kuqe, si lesh do t'i zbardh. Dhe nëse doni, dhe do të më dëgjoni, do të hani të mirat e dheut; por, nëse nuk doni, as nuk do të më dëgjoni, do t'ju hajë thika", sepse goja e Zotit i foll këto.

Proqimen. Ting. i Rëndë. Psalmi 2. Shërbejini Zotit me frikë dhe ngazëllohuni në të me tmerr.

*Varg:* Pse u tërbuan kombet dhe popujt menduan kotësira?

*Etj. si zakonisht.*



## TË HËNËN E JAVËS SË PARË NË MBRËMËSORE

*Thirrtoje*

*Poezi e zotit Josif*

*Ting. II Pantas iperevin*

**E** bëra çdo mëkat, i tejkalova të gjithë në shturje. Në qoftë se do të dua të pendohem, nuk kam çurgje lotësh. Nëse do të jetoj dhe tani me përtaci, do të jem nën akuzë për ndëshkim; ndaj më jep korrigjim, o Perëndi, i vetmi i mirë, dhe mëshiomë.<sup>38</sup>

**M**ë jep shira lotësh në ditën e ngazëlluar të kreshmës, o Krisht, që të mbaj zi dhe ta pastroj krejtësisht njollën e shkaktuar prej kënaqësive, që të të paraqitem i pastër kur të vish si gjykatës prej qiellit, o Zot, për të gjykuar vdekatarët<sup>42</sup> si i vetmi gjykatës i drejtë.<sup>43</sup>

*Tjetër, e zotit Theodor*

*Ting. Tërth. I Ósie pater*

**Armë** të fortë, o besnikë, ejani të mbajm',\* pra kreshmën si mburojë, me zell dhe gatishmëri\* të zmbarsim çdo intrigë, mashtrim armiku;\* le të mos kemi frik' nga

ngasjet si zjarr;\* Krishti njeridashës\* për to me çmim durimi\* do të na kurorëzojë nur;\* në gjunj\* i biem ne, me guxim lutemi\* dhe duke thirrur fort:\* "Kërkojmë paqe, falje";\* dhe po ashtu të hedhim poshtë\* krejt pëlqimet\* e vesit tonë, le të mos na joshin kurrë më;\* të kërkojmë për shpirtat tanë\* mëshirën, përdëllimin e madh<sup>44</sup> prej Perëndis'.

*Dhe të tria të Mujorit*

Lavdi dhe Tani

*E Mujorit (Hyjlindësore)*

O dritë gazmore. *Prifti*: Mbrëmje!

*Lexuesi*: Paravarg. Ting. Tërth. II. Psalmi 3. I Zotit është shpëtimi dhe mbi popullin tënd bekimi yt.

*Varg*: O Zot, pse u shumëfishuan ata që më shtrëngojnë?

Këndimi i Gjenezës.

*(1.1-13)*

Në fillim Perëndia bëri qiellin dhe tokën; dhe toka ishte e padukshme dhe e pabërë, dhe errësirë ishte mbi avushë, dhe Shpirt Perëndie sillej mbi ujë. Dhe Perëndia tha: "Le të bëhet dritë". Dhe u bë dritë. Dhe Perëndia pa dritën se ishte e mirë dhe Perëndia e ndau mes dritës dhe mes errësirës. Dhe Perëndia e quajti dritën "ditë" dhe errësirën e quajti "natë"; dhe u bë mbrëmje, dhe u bë mëngjes, një ditë. Dhe Perëndia tha: "Le të bëhet mbështetje në mes të ujit dhe le të ndajë në mes ujin dhe ujin". Dhe kështu u bë. Dhe Perëndia bëri mbështetjen dhe ndau në mes të ujit që ishte poshtë mbështetjes dhe në mes të ujit që ishte sipër mbështetjes. Dhe Perëndia e quajti mbështetjen "qiell" dhe Perëndia pa se ishte e mirë; dhe u bë mbrëmje, dhe u bë mëngjes, dita e dytë. Dhe Perëndia tha: "Le të mblihdet uji që është poshtë qiellit

në një grumbull dhe le të shfaqet stercja". Dhe kështu u bë, dhe u mbloodh uji që ishte poshtë qiellit në mbledhjet e tyre dhe u shfaq stercja; dhe Perëndia e quajti stercenë "tokë" dhe sistemet e ujërave i quajti "dete"; dhe Perëndia pa se ishte e mirë. Dhe Perëndia tha: "Le të nxjerrë toka filiz bari, që mbjell farë sipas gjinie dhe sipas ngjashmërie, dhe pemë pjellore që bën frutë, fara e së cilës të jetë brenda saj sipas gjinie mbi tokë". Dhe kështu u bë. Dhe nxori toka filiz bari, që mbjell farë sipas gjinie dhe sipas ngjashmërie, dhe pemë pjellore që bën frutë, fara e së cilës të jetë brenda saj sipas gjinie mbi tokë; dhe Perëndia pa se ishte e mirë; dhe u bë mbrëmje, dhe u bë mëngjes, dita e tretë.

Paravarg. Ting. Tërth. I. Psalm 4.

Zoti do të më dëgjojë kur do t'i thërras.

*Varg*: Kur të thërrisja, më dëgjoje, o Perëndi i drejtësisë sime.

Këndimi i Fjalëve të Urta

*(1.1-20)*

Proverba e Solomonit, birit të Davidit, i cili mbretëroi në Izrael, për të njohur urtësi dhe edukatë, si dhe për të kuptuar fjalë mençurie, për të pranuar kthesa fjalësh dhe për të kuptuar drejtësi të vërtetë dhe për të qenë i drejtë në gjykim, që të japë ndër të patëkeq zgjuarsit të plotë dhe të një djalë i ri ndjeshmëri dhe konceptim. Nëse do t'i dëgjojë këto ndonjë i urtë, do të jetë më i urtë, ndërsa i mençuri do të fitojë administrim, dhe do të kuptojë paravolë dhe fjalë të errët, thënie të urtësh dhe enigma. Fillim urtësie është frikë Zoti, ndërsa mençuri e mirë ekziston tek ata që e bëjnë; dhe shpresëtar i ndaj Perëndie është fillim ndjeshmërie, ndërsa të pabesët do të përbuzin rëndë urtësi dhe edukatë. "Dëgjoje, o bir, edukatën e atit



tënd dhe mos i zbraps ligjet e nënës sate, sepse do të presësh në kokën tënde kurorë hires dhe gjerdan të artë rreth grykës sate. O bir, të mos të mashtrojnë burra të pabesë, as të mos duash në qoftë se do të të lutën duke thënë: 'Eja me ne, bëhu pjesëmarës në gjak dhe të fshehim në dhë burrë të drejtë padrejtësisht dhe ta gëlltitim atë të gjallë si Hadhi dhe ta heqim nga toka kujtimin e tij; le ta zotërojmë pronën e tij të çmuar dhe le të mbushim shtëpitë tona me plaçka; dhe vëre te ne trashëgimin tënd dhe le të kemi të gjithë një portofol të përbashkët, dhe le të bëhet një kuletë te ne'. Të mos ecësh në udhë me ta, por shmange këmbën tënde nga rrugët e tyre, sepse këmbët e tyre vrapojnë drejt së keqes dhe janë të shpejta për të derdhur gjak, pasi nuk shtrihen padrejtësisht rrjeta për zogj; sepse ata që marrin pjesë në vrasje, e pasurojnë veten e tyre me të këqija, dhe katastrofa e burrave të paligjshëm është e keqe. Këto janë udhët e të gjithë atyre që bëjnë paligjësitë, sepse nëpërmjet pabesisë heqin shpirtin e tyre. Urtësia himnohet nëpër dalje, ndërsa nëpër sheshe sjell guxim".

*Menjëherë* Bëna të denjë, o Zot... Le ta plotësojmë... *etj.*

*Pasvargje Ting. III*  
*Idhiomeli*

Le të mbajmë një kreshmë të pranueshme dhe të pëlqyeshme prej Zotit; kreshmë e vërtetë është shmangia nga të këqijat, përmbajtja e gjuhës, largimi nga inati, ndarja nga dëshirat, përgojimi, gënjeshtria dhe betimi i rremë; mungesa e këtyre është kreshmë e vërtetë dhe e mirëpritur.<sup>45</sup>

*Varg:* Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

*Injëti*

*Varg:* Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

*Martirik*

E madhe është fuqia e martirëve të tu, o Krisht, sepse, sado të shtrirë në varre, ata dëbojnë frymë, pasi e asgjësuan pushtetin e armikut me anën e besimit të Trinia, meqë garuan për shpresëtarinë.

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësor*

O Perëndilindëse, mbrojtja e gjithë nevojtarëve, në ty guxojmë, në ty krenohemi, në ty është e gjithë shpresa jonë; ndërmyeto pranë atij që lindi prej teje për shërbëtorët e tu të pavlefshëm.<sup>46</sup>

Tani përlëshoje. *Trishenjtë.* Se jotja është.

*Dhe Troparet*  
*Ting. Tërth. I*

Gëzohu, o hirëplote Hyjlindëse, Virgjëreshë Mari, Zoti është me ty; e bekuar je ti ndër gratë dhe e bekuar<sup>2</sup> është pema e barkut tënd,<sup>47</sup> se linde Shpëtimtarin e shpirtave tanë.\*

O Pagëzor i Krishtit, kujtona ne të gjithë, që të shpëtojmë nga paligjësitë tona, se ty të është dhënë hiri të ndërmyjetosh për ne.\*

Lavdi

Lutuni për ne, o apostuj të shenjtë dhe ju të gjithë shenjtoret, që të shpëtojmë nga rreziqet e hidhërimet, se ju kemi

mbrojtës të nxehtë para Shpëtimtarit.\*

*Hima:* Tani

Nën dhembshurinë tënde vrapojmë, o Hyjllindëse, mos i moho lutjet tona në përipeci, po shpëtona nga rreziqet, e vetmja e kulluar, e vetmja e bekuar.\*

Mëshiro, o Zot (40x). Lavdi dhe Tani. Më të nderuarën... Beko, o atë, në emrin e Zotit.

*Priifti:* Krishti, Perëndia ynë, që është i bekuar, gjithnjë, tani e përherë dhe në jetë të jetëve.

*I pari:* Amin. O Mbret qiellor, siguroji mbretërit tanë besnikë, përmbaje besën, zbuti kombet, paqësoje botën, ruaje mirë këtë shtëpi të shenjtë; etërit dhe vëllezërit tanë që shkuan para nesh, vëri në tenda të drejtësh<sup>41</sup> dhe ne pritna me pendim e me rrëfim si i mirë dhe njeridashës.\*

*Dhe Uratën e Shën Efremit, duke bërë 3 metani të mëdha dhe 12 të vogla.*

Zot dhe Mjeshtër i jetës sime,<sup>48</sup> mos më jep frymë përtese, kureshtie, lavdidashjeje dhe kotësie.

Po falmë frymë mençurie, përunjësie, durimi dhe dashurie.

Vlerësomë, o Zot dhe Mbret, t'i shikoj fajet e mia dhe të mos e gjykoj tim vëlla. Se i bekuar je në jetë të jetëve. Amin.\*

*Trishenjtë.* Se jotja është. Mëshiro, o Zot (12x)

*Dhe Uratën:*

O Trini e Tërëshenjtë, pushtet i njëqen-shëm, mbretëri e pandarë, shkaku i të gjitha të mirave, ki mirësi pra dhe për mua mëkatarin; mbështete, urtësoje zemrën time dhe ma hiq të gjithë përdhosjen, ndriçoje mendjen time, që të lavdëroj përherë, të himnoj, të falem dhe të them: Një është Shenjt, një është Zot, Jisu Krishti për lavdi të Perëndisë Atë. Amin.

Emri i Zotit qoftë (3x hima).

Lavdi dhe Tani *Psalms 33:*

Do ta bekoj Zotin në çdo kohë, lavdërimi i tij do të jetë gjithnjë në gojën time. Në Zotin do të lavdërohet shpirti im; le të dëgjojnë të butë dhe le të dëfrenjë. Madhështojeni Zotin tok me mua, dhe le ta lartësojmë së bashku emrin e tij. E kërkova Zotin dhe më dëgjoj, dhe më çliroi nga të gjitha shtrëngimet e mia. Afrohuni tek ai dhe ndriçohuni, dhe fytyrat tuaja nuk do të turpërohen. Ky i varfri thirri, dhe Zoti e dëgjoj dhe e shpëtoi nga të gjitha shtrëngimet e tij. Një engjëll Zoti do të fushojë përreth atyre që ia kanë frikën, dhe do t'i çlirojë. Shijoni dhe shihni se Zoti është i mirë. Lum burri që shpreson mbi të. Kijeni frikë Zotin, të gjithë ju shenjtoret e tij, se nuk u privohet gjë atyre që ia kanë frikën. Të pasurit janë varfëruar dhe janë urëtuar, por atyre që kërkojnë Zotin nuk do t'u pakësohet asnjë e mirë. Ejani, bij, dëgjomëni, do t'ju mësoj frikë Zoti. Cili është njeriu që dëshiron jetë, që do që të shohë ditë të mira? Ndaloje gjuhën tënde nga e keqja dhe buzët e tua, që të mos flasim dredhi. Shmangu së keqes dhe bëj të mirën, kërko paqen dhe rend pas saj që ta fitosh. Sytë e Zotit janë mbi të drejtët, dhe veshët e tij në lutjen e tyre. Dhe fytyra e Zotit është mbi ata që bëjnë të këqija, që ta shfarosë kujtimin e tyre nga dheu. Të drejtët thirrën dhe Zoti i dëgjoj dhe i çliroi nga të gjitha shtrëngimet e tyre. Zoti është afër atyre që janë të dërmuar në zemër dhe do t'i shpëtojë ata që janë të përlulur në shpirt. Janë të shumta shtrëngimet e të drejtëve, dhe nga të gjitha këto do t'i çlirojë Zoti. Zoti i ruan të gjitha kockat e tyre, asnjë prej tyre nuk do të dërmohet. Vdekje mëkatarësh do të jetë e dhimbshme, dhe ata që urrejnë të drejtin, do të bëjnë faj. Zoti do t'i çlirojë shpirtat e



shërbëtorëve të tij, dhe nuk do të bëjnë faj të gjithë ata që shpresojnë mbi të.

*[Në çdo rast që shtrajmë trapezë, lexojmë edhe Psalmin 144:*

**“Do të të lartësoj, o Perëndia im, mbreti im, dhe do ta bekoj emrin tënd në jetë dhe në jetë të jetës. Përditë do të të bekoj dhe do ta lavdëroj emrin tënd përjetë e në jetë të jetës”. I madh është Zoti dhe i lavdërueshëm tejet, dhe s’ka fund madhështia e tij. “Gjeneratë dhe gjeneratë do t’i lavdërojnë punët e tua dhe do ta shpallin fuqinë tënde. Do të flasin për madhësinë e lavdisë së shenjtërimit tënd dhe do t’i rrëfejnë të çuditshmet e tua. Dhe do të thonë për fuqinë e të tmerrshmeve të tua dhe do ta rrëfejnë madhërinë tënde. Do ta shprehin kujtimin e shumicës së mirësisë sate dhe do të ngazëllohen në drejtësinë tënde”. I dhembshur dhe përdëllyes është Zoti, zemërgjerë dhe i shumëmëshirshëm. I mirë është Zoti për të gjithë, dhe dhembshur të e tij mbi gjithë punët e tij. “Le të të lavdërojnë, Zot, gjithë punët e tua dhe oshënarët e tu le të të bekojnë. Do të thonë për lavdinë e mbretërisë sate dhe do të flasin për pushtetin tënd, që t’ua njoftojnë bijve të njerëzve pushtetin tënd dhe lavdinë e madhësisë së mbretërisë sate. Mbretëria jote është mbretëria e gjithë jetëve dhe sundimi yt në çdo gjeneratë dhe gjeneratë”. Zoti është besnik në gjithë fjalët e tij dhe oshënar në gjithë veprat e tij. Zoti i mbështet të gjithë ata që rrëzohen poshtë dhe i ngre të gjithë të dërmuarit keq. “Sytë e të gjithëve te ti shpresojnë, dhe ti ua jep ushqimin në kohë të përshtatshme. Ti i hap duart e tua dhe mbush çdo qenie të gjallë me mirëdashje”. I drejtë është Zoti në gjithë**

udhët e tij dhe oshënar në gjithë punët e tij. Zoti është afër të gjithë atyre që e thërrasin atë, të gjithë atyre që e thërrasin në të vërtetë. Do ta bëjë dëshirën e atyre që ia kanë frikën dhe do ta dëgjojë lutjen e tyre, dhe do t’i shpëtojë. Zoti i ruan të gjithë ata që e duan dhe do t’i shfarosë të gjithë mëkatarët. Lavdërim Zoti do ta flasë goja ime dhe le ta bekojë çdo mish emrin e tij të shenjtë në jetë dhe në jetë të jetës.]

*Dhe përlëshimi.*

*CITIME*

1. Jis. N. 7.11; I Mbret. [Sam.] 14.33; II Kron. 6.39
2. Lluk. 1.26-28
3. Rom. 7.12; II Petr. 2.21
4. Lluk. 15.13
5. Is. 49.8; II Kor. 6.2
6. Matth. 14.30
7. Joan 8.34; Rom. 6.17,20
8. Matth. 18.8; 25.41; Jud. 7
9. Ps. 2.6 etj.
10. Mal. 4.2 (3.20)
11. Lluk. 1.79
12. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
13. IV [II] Mbret. 3.11
14. III [I] Mbret. 19.8
15. Eks. 34.28
16. Eks. 33.23
17. Gjen. 3.6
18. Gjen. 3.24
19. Eks. 14.15-30
20. Eks. 15.1
21. IV [III] Mbret. 19.15 etj.
22. Est. 4.17b; Ps. 94(95).3
23. Matth. 6.16-17
24. Matth. 6.7
25. Matth. 5.45 etj.
26. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34 etj.
27. Matth. 4.2; Lluk. 4.2
28. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 22-26
29. Ligji i Dytë 12.9; Hebr. 4.3
30. Matth. 5.22; 18.9; Mark 9.47
31. Rom. 13.11-13
32. I Kor. 1.30
33. Jak. 3.13; I Petr. 3.16; II Petr. 3.11
34. Is. 58.4
35. III [I] Mbret. 19.8-15
36. Ef. 4.6
37. Jov 14.5
38. Ps. 50(51).1; 56(57).1; Is. 33.2
39. Ps. 91(92).2-3
40. Gjen. 28.17

41. Ps. 117(118),15  
 42. Vep. 10,42; II Tim. 4,1; I Petr. 4,5  
 43. Ps. 7,12; II Tim. 4,8  
 44. Num. 14,19 etj.  
 45. Is. 58,5-11; Fil. 4,18  
 46. Lluk. 17,10  
 47. Lluk. 1,42  
 48. Sirak 23,1



## TË HËNËN E JAVËS SË PARË NË PASDARKËN E MADHE

*Pas Dhoknologjisë së Vogël, psalet pjesa e parë e Kanunit të Madh të shën Andreas së Kretës (me Varg\* Mëshihromë, o Perëndi, mëshihromë\* në çdo tropar, përveç dyve të fundit).*

*Ting. Tërth. II  
Ode I*

*Irmosi: Voithós qe sqepastís*

»**M**u bë ndihmës, mbrojtës, shpëtimtar, »ky është' Perëndia im pra\* dhe do ta lëvdoj, »është Zoti ai\* për atin tim, do ta lartësoj »shumë, se u lavdërua plot me lavd.<sup>1</sup> (2x)

**N**ga t'ia nis un' që të qaj për veprat, jetën time të mjerë?\* Cilën nisje tash për vajtimin të bëmë,\* o Krisht? Por, meqë i dhembshur je, jepma faljen për mëkatet që bëra.

**E**ja, shpirt mjeran, me mishin tënd tok, bëj ti rrëfim te Zoti,\* Bërës i gjithçkaje, largohu kështu\* dhe nga marrëzia e mëparshme dhe sill te Perëndia lot, pendim.

**T**ë parëguatarin Adam e kisha zili në shkelje,\*<sup>2</sup> ndaj e mora vesh se e zhvesha veten\*<sup>3</sup> prej Zotit, shijimit,<sup>4</sup> mbretëris' së përjetshme, nga mëkatet që bëra.

**M**jerë, shpirt qyqar! Pse ngjave ti me Evën e parë? Se pe\* keq dhe u plagose vrer, pemën kështu\* e preke edhe me arrogancë shijove një ushqim paranojak.<sup>2</sup>

**P**o mendimi mëkatar në mish m'u bë si

mendorja Evë,\* pra në vend të Evës së ndjeshme dikur.\* Tregon të pëlqyerat, shijon përgjithnjë edhe provon të hidhurat.

**S**hpëtimtar, u flak Adami larg Edenit<sup>5</sup> dikur siç duhej,\* meqë ky nuk ruajti një porosi\* që dhe ti;<sup>2</sup> por un' që vazhdimisht t'i shpërfilla fjalët plot jet', ç'të pësoj?

*Lavdi Triadik*

**M**biesenciale Shën Trini, të falemi në Njësi ne,\* hiq prej meje prangat e rënda<sup>6</sup> plot tmerr\* të fajit edhe më jep mjaft lot kataniksi si e dhembshur plot me hir.

*Tani Hyjlindësor*

**O** Hyjlindëse, je shpresa, mbrojtja ti për sa të himnojnë,\* hiq prej meje prangat e rënda<sup>6</sup> plot tmerr\* të fajit, si Zonjë e dëlirë, pranomë mua që pendohem sinqerisht.

*Ode II*

*Irmosi: Prôshe urané qe laliso*

»**K**i kujdes,\* ti, o qiell, do flas<sup>7</sup> un' dhe do »himnoj Zotin Krisht\* që nga e Virgjra na »erdhi brenda mishi pra. (2x)

**K**i kujdes,\* ti, o qiell, do flas un';<sup>7</sup> o dhe, dëgjoje një zë,\*<sup>8</sup> që po pendohet drejt Perëndis' dhe e himnon.

**P**erëndi,\* Shpëtimtari im, vër re me syrin tënd plot mëshir\* edhe rrëfimin tim mjaft të nxehtë prite ti.

**S**hpëtimtar,\* mëkatova më shumë se çdo njeri, vetëm un'\* fajtova, por dhembshuro krijimin tënd, si Zot.

**B**ëra un'\* keq shëmtinë e vesit me hov instinkti plot epush\* dhe bukurinë e mendjes pra e prisha krejt.

**M**ë shtrengon\* turbullim nga e keqja, por shtrima dorën, o Zot\* i dhembshur, siç bëre me shën Petron, Shpëtimtar.<sup>9</sup>



**N**dotë keq\* këtë: «Sipas ikonës dhe ngjashmëris», Shpëtimtar, \*<sup>10</sup> meqë këmishën e mishit e njolloso mjaft.<sup>11</sup>

**B**ëra terr\* bukurinë e shpirtit me vese, kënaqësi,\* dhe mendjen time të tër\* e bëra pluhur krejt.

**D**ergjem keq\* unë tash, lakuriq,<sup>3</sup> se e grisa robën e par\*, stolin<sup>12</sup> që Bërësi në fillim ma thuri nur.

**J**am plot turp,\* se kam veshur këmishën<sup>13</sup> që me këshillën e tij\* ma thuri gjarprë,<sup>2</sup> këmisha është grisur keq.

**P**araqes,\* Shpëtimtar, dhe un' lotët e Prostitutës,<sup>14</sup> i mir\*, ndaj, Zot i dhembshur, për mua të të vijë keq.

**D**ergjem keq\* lakuriq<sup>3</sup> unë tash dhe kam turp, se pemën kam par'\* dhe bukurinë e saj, mashtrova mendjen pra.<sup>2</sup>

**P**ërбетim\* bënim pra në kurrizin tim krejt eprorët plot tmerr\* dhe vazhdimisht kundër meje shkelnin ligjin keq.<sup>15</sup>

Lavdi *Triadik*

**T**ë himnoj,\* Perëndi i çdogjëje; je tre Persona në një,\* pra Ati, Biri edhe i Tërshenjtë Shpirt.

Tani *Hyllindësor*

**P**a pushim\* përgjërohu për ne të shpëtojmë, o Virgjëresh'\* pa cen, Hyllindëse; krejt himnosh vetëm ti.

*Ode III*

*Irmosi: Epi tin asálefton Hristé*

»Kishën tënde, Krisht, forcoje<sup>16</sup> mbi gurin »e palëkundur\*<sup>17</sup> të urdhrave të tu pra që »na dhe,

**Z**jarr prej Zotit Zoti hodhi dikur si shi dhe e bëri\* më parë tokën e Sodomës shkruab.<sup>18</sup>

**E**dhe ti, shpirt, si ai, pra shën Loti, në mal me vrap ik,\* arrí që në Sigor lart të shpëtosh.<sup>19</sup>

**O** shpirt, ik larg flakës prush të Sodomës, dhe evitoje,\* dhe ik nga prishja dhe hyjnori zjarr.<sup>19</sup>

**M**ëkatova vetëm unë ndaj teje më shumë se çdokush,\* o Krisht dhe Shpëtimtar, mos më shpërfill.

**M**ë kërko, jam delja, ti je bariu i mirë, o Krisht,\*<sup>20</sup> edhe mos më shpërfill se kam humbur.<sup>21</sup>

**J**e i ëmbël ti, Jisu; ti Gatuesi im; me ty, Krisht\* dhe Shpëtimtar, do drejtësohem un'.

**S**hpëtimtar, te ti rrefehem, fajtova pa masë unë,\* por si i dhembshur falmë, ndjemë, Zot.

Lavdi *Triadik*

**P**erëndi, Trini, Njësi, na shpëto nga mashtrimi, hijja,\* nga ngasjet dhe pericëtitë pra.

Tani *Hyllindësor*

**N**gazëllohu bark hyjpritës, o nëna e jetës sonë;\*<sup>22</sup> gëzohu, je fron Zoti, ki hare.

*Ode IV*

*Irmosi: Akikoen o profitis*

»Dëgjoi për ardhjen tënde\* profeti dhe e »kapi frika, se do të lindësh\* nga e Virgjra, »edhe njerëzve në dhë\* do t'u shfaqesh ti, »do t'u tregohesh krejt,\* dhe thoshte: Zot, »dëgjimin tënd e dëgjova plot tmerr,\* dhe »kam frik\*;<sup>23</sup> lavdi forcës sate pra. (2x)

**G**jykatës i drejtë,<sup>23a</sup> veprat\* dhe bërjen tënde mos i lër, mos i shpërfill ti;\* sado vetëm un' fajtova si njeri,\* njeridashës, më fort se të vdekshmit krejt,\* por ke pushtetin e të gjithave – se Zot je –\* që të falësh shkeljet<sup>24</sup> si Perëndi.

Afrohet, o shpirt, mbarimi,\* afrohet fundi dhe s'kujdesesh, nuk je gati,\* koha është' e shkurtër;<sup>25</sup> ngrihu, është bri,\* afër, pranë derës, Zoti yt gjyqtar;\* si lule<sup>26</sup> dhe si ëndërr koha e jetës rend shpejt,\* pse ne shqetësohemi fare kot?

Shpirt, zgjohu, mendoji veprat\* që bëre edhe silli para faqes sate,\* derdh dhe pika lotësh; shprehja qartësisht\* Zotit Krisht çdo punë që ke bërë ti,\* mendimet dhe kujtimet, edhe kështu do marrësh\* edhe drejtësimin me faljen njësh.

Në jetë s'ka as të keqe,\* as vepër, as mëkat që unë nuk e bëra\* si me mendje, me vullnet dhe fjalë tok,\* Shpëtimtar, dhe mëkatova praktikisht\* edhe gjakftohtësisht me punë, plot turp më shumë\* se askush mbi dhe gjer tani, o Zot.

Prandaj ndërgjegjja ime\* më ka gjykuar dhe më ka dënuar mua,\* s'ka asgjë aq shumë' të dhunshme se ajo\* brenda botës, Çlirimtar, gjyqtari im;\* je tërënjohës, më kurse, më çliro pra mua,\* më shpëto, mjeran jam, më përdëlle.

Imadhi ndër patriarkë,\* shpirt, pa qëmoti shkallën<sup>27</sup> që ish tip për hipje\* diturore, ish dhe ngritje në praktik';\* ndaj, në do që të jetosh, bëhu i ri\* me veprën njësh dhe teorinë dhe diturinë,\* përtëritu përmes virtyteve.

Duronte nga varfëria\* dhe vapën ditën, vuante nga ngrica natën\* patriarku, bënte vjedhje në çdo ditë\* dhe kulloste, kryente me mund çdo pun';\* kështu ky do të mernte edhe dy gra së bashku,\* bënte pra përpjekje të lodhshme mjaft.<sup>28</sup>

Mendo si dy gratë, lutem,\* veprimtarin' dhe dijen tok me teorinë,\* Lian, si veprim, se shumë' fëmijë kish,\*<sup>29</sup> si Raketën, dijen

që ka lodhje plot,\*<sup>30</sup> se pa mund nuk arritet fare, o shpirt, as punë\* dhe as teori, s'bëhet dot asgjë.

#### Lavdi *Triadik*

Pa ndarje në esencë,\* pa ngatërrim Personash të teologoj k'shtu,\* një Hyjni, Zot trinisor; tok mbretëron\* edhe je i bashkëfronshëm; të thërras\* të madhen këngë që himnohet në më të lartat,\* edhe trefish<sup>31</sup> ty të këndoju unë.

#### Tani *Hyllindësor*

Dhe lind, dhe je virgjëreshë,\* e virgjër në natyrë mbetesh me të dyja,\* Biri përsërit pra ligjin natyror,\* mitra ka një shtatzëni unike krejt,\* se mposhtet rendi natyror ku do Perëndia,\* meqë bën ai sa do<sup>32</sup> për një çast.

#### Ode V

##### *Irmosi: Ek niktós orthrizonta*

»Po mëngoj menatë, njeridashës Zot,\* »lutem, ndriçomë ti,\* udhëhiq më në drejtëtim,\* në urdhrat e tu mua,\*<sup>33</sup> mësomë që »përherë\* ta bëj dëshirën tënde.<sup>34</sup> (2x)

Jetën e kalova përgjithnjë si nat',<sup>35</sup> meqë për mua ish\* terr dhe mjegullë e thell'\* nata e fajit,<sup>36</sup> por ti\* tregomë, o Shpëtimtar\* i mirë, si bir dite.<sup>37</sup>

Duke imituar keq Ruvinin pra,\* unë i mjeri fort\* bëra kundër Zotit lart\* vendim pa ligj, jasht' normës,\* se bëra pis shtratin tim\* si ky atë të atit.<sup>38</sup>

Të rrëfhem, Krisht mbret, bëra faj, mëkat,\* porsi vëllezërit\* përkundrejt Josifit shenjt\* më parë, që e shitën\* atë,<sup>39</sup> që ishte një fryt\* urtie, pastërtie.<sup>40</sup>

Shpirti fort i drejtë nga të afërmit\* jepej në skllavëri,\* shitej ky i ëmbli mjaft,\*<sup>39</sup> tipi i Zotit ishte;\* ndërsa të tërin, o shpirt,\* të shitën të këqijat.



Imitoje, shpirt mjeran dhe pa sukses,\* mendjen e urtë mjaft,\* të fort drejtin shën Josif,\*<sup>40</sup> mos kurvëro me vrullet\* e palogjikshme, mos bëj\* gjithnjë paligjësi, faj.

Edhe pse banoi brenda gropës keq\* qëlashti, Mjeshtëri Zot,\* shën Josifi paradha\* tip për varrimin, ngjalljen\* që shfaqe,<sup>41</sup> por unë ç'gjë\* të till' dikur të sjell ty?

#### Lavdi *Triadik*

Të lëvdojmë, o Trini, një Perëndi,\* At', Bir, Shpirt; je i shenjt',\* je i shenjtë, je i shenjt'.\*<sup>31</sup> Njësi e thjeshtë, Zoti,\* esenca që përgjithnjë\* të falemi me besë.

#### Tani *Hyjlindësor*

Nënë virgjëresh', pa prishje dhe pa burr'\* prej teje brumin tim\* e ka veshur Zoti im,\* Bërësi i çdo jete;\*<sup>42</sup> e lidhi me veten krejt\* natyrën njerëzore.

#### Ode VI

##### *Irmosi: Evóisa en oli kardhia mu*

»Nga zemra thell'\* drejt Zotit, të dhembshurit,\* thirra dhe më dëgjo ky\* »teksta fare poshtë, në Hadh pra, isha »unë\* dhe e ngriti lart\* jetën time prej prishjes.<sup>43</sup> (2x)

Me pastërti,\* nga sytë lot të ofroj\* dhe psherëtimë thellë krejt,\* Shpëtimtar, kur zemra thërret: Kam faj ndaj teje,\* të të vijë keq,\* Perëndi Zot, për mua.\*<sup>44</sup>

Ke ikur larg\* nga Zoti yt, shpirt, pors'i Dhathani, Avironi tok;\*<sup>45</sup> »Të të vijë keq", thirr nga Hadhi më i poshtëm,\*<sup>46</sup> të mos mbyllesh ti\* nga një plasë e tokës.<sup>45</sup>

Sado me zekth\* mëshjtjerre ke ngjarë mjaft,\* shpirt, me Efremin,<sup>47</sup> por shpëto\* si sorkadhe jetën nga leqet, kur me krahë\*<sup>48</sup> do të bëhesh ti,\* me akt, mend, teori tok.

Na siguron,\* o shpirt, Moisiu ne,\* dora

e tij, se Zoti mund\* ta pastrojë jetën me lebër dhe ta zbardhë;\*<sup>49</sup> mos u dëshpëro\* nëse je i lebrosur.

#### Lavdi *Triadik*

»Triadhë jam,\* e thjeshtë, nuk ndahem hiç,\* por ndahem në Persona un',\* jam Njësi, bashkohem sipas natyrës", thotë\* Ati, Biri tok\* edhe Shpirti Hyjnor, Zot.

#### Tani *Hyjlindësor*

Na lindi Zot\* me pamjen ton', mu si ne\*<sup>50</sup> barku yt, o Hyjlindëse;\* lype, ndërmjeto tek ai që, si Krijues\* i të gjithave,\*<sup>51</sup> të na nxjerrë të drejtë.

#### Kontaqi *Ting. Tërth. II*

##### *(psalet ngadalë)*

O shpirti im, o shpirt im, ngrihu, pse fle gjumë? Po afrohet fundi dhe ke për t'u trazuar; ndaj zgjohu që të të kursejë ty Perëndia, Krishti Zot, që ndodhet kudo dhe i mbush të gjitha.<sup>52</sup>

#### Ode VII

##### *Irmosi: Imártomen, inomisamen*

»Fajtuam ne,\* mëkatuam ne,\* para te- »je bëm' padrejtësi ne,\* s'i ruajtëm ne, »s'i zbatuam ne porosit' e tua,<sup>53</sup> ne të pamen- »dëdt, o Zot,\* por mos na dorëzo më në »fund ne,<sup>54</sup> o Perëndi i etërve, pra.<sup>55</sup> (2x)

Fajtova boll,\* mëkatova keq,\* e shfarosa porosinë tënde,\* i shtova mjaft mëkate, shtova plagët në traumat e mia për tmerrin tim, Zot,\* porse ti si i dhembshur më mëshiro, Perëndi i etërve tan'.<sup>55</sup>

Gjykatës Zot,\* të rrëfeva ty\* çdo të fshtë të që ka zemra ime,\*<sup>56</sup> shiko përluljen time, shih shtrëngimin tim<sup>57</sup> edhe vëri re tash gjykimit tim ti\*<sup>58</sup> dhe kështu si i dhembshur më mëshiro, Perëndi i etërve tan'.<sup>55</sup>

O shpirt, dikur,\* kur Sauli djall\* humbi

larg gomarët e të atit,\*<sup>59</sup> e gjeti mbretërinë rastësisht dhe sundoi;<sup>60</sup> ty të mos të shpëttojë, vër re\* edhe mos prefero hove kafshësh më shumë se mbretërinë e Krishtit.

Qëmoti pra\* bëri një mëkat\* të dyfishtë, shpirt, David hyjati,\*<sup>61</sup> teksa shigjeta e kurorëshkeljes e gjeti dhe u kap nga dënuesi grep,\* se kish vrar\*<sup>62</sup> por ti je i sëmurë më rëndë, me ndërgjegje, me vull.

Davidi mbret\* lidhi faj dikur\* me një tjetër, se përzjeu vrasjen\* me një kurorëshkelje,<sup>62</sup> por menjëher' tregoi drejt pendim<sup>63</sup> të dyfishtë ai,\* por ti bëre, shpirt, vepra më djallëzore dhe s'u pendove në Zot.

Davidi mbret\* shkroi si ikon\*,\* përmendore pra, dikur një himn nur,\* përmes këtij veprimin që kish bë', rëndë e qorton, thërret: Mëshiomë, o Zot,\* se fajtova te ti vetëm, Perëndi i çdo gjëje, ndaj më pastro.<sup>64</sup>

#### Lavdi *Triadik*

"Trini e thjesht",\* e pandarë krejt,\* je Njësi e bashkëqenshme, drita\* të shenjta, dritë - tri të shenjta dhe një e shenjtë", Perëndia himnohet kështu.\* Por himnoje, lëvdoje, shpirt, jetën, jetët, pra Perëndin' e çdokujt.

#### Tani *Hyjlindësor*

Të falemi,\* të himnojmë ne,\* të bekojmë, Hyjnënë, se ti\* ke lindur një nga Shën Triadha krejt e pandarë, Perëndinë, një Bir dhe Zot pra;\* dhe ti vetë për ne tokësorët hape nur qielloret me gaz.

#### Ode VIII

##### *Irmosi: On stratië uranön*

»E lavdërojn'\* Zotin lart ushtrinë qiellore, »e kanë frik' Keruvimet tok\* me Serafi- »met; çdo frymë, çdo krijim, bekoje,\* për- »mbilartësoje, himnoje në gjith' jetët.<sup>65</sup> (2x)

O Shpëtimtar,\* mëkatova, përdëllemë, mendjen ma ngri për kthim, pritmë në pe-

ndim,\* më dhembshuro; thërras: Mëkatova para teje,\*<sup>66</sup> mëshiomë; bëra paudhësi, shpëtomë.

Si mbi karroc'\* ushtarake karrocieri, shenjt i lla, kish hipur mbi virtyt,\* dikur nga tokësoret lart sillej për në qiell;\*<sup>67</sup> shpirt, mendoje ngjitjen e tij dhe lartësohu.

Priti dikur\* shën profeti Elise gëzofin që kish lla dhe hir dyfish\* mori prej Zotit;<sup>68</sup> por ti nuk more prej këtij hir,\* shpirt, se s'ke përmbajtur edhe vazhdon mëkatin.

Lumi Jordan,\* rrjedha, rryma nëpërmjet gëzofit që kish lla, ndaloi krejt\* më parë në dy pjesë, e bëri Eliseu,\*<sup>69</sup> por ti, shpirt, këtë hir s'e ke nga mospërmbajtja.

Mendim të mir'\* Somanitasja pra kish, prandaj mirëpriti, o shpirt, të drejtin kjo;\*<sup>70</sup> por as të huajt, as udhëtarët, ti s'i prite,\*<sup>71</sup> jashtë nusërores<sup>72</sup> do flakesh plot me qarje.

O shpirt mjeran,\* imitove përgjithnjë mendimin e ndotur llum të Jezeut ti;\* qoftë në pleqëri, kopracin' që kishte,<sup>73</sup> zmbrapse,\* shmangu nga Gjhena, zbo zjarrin<sup>74</sup> e së keqes.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin.

#### *Triadik*

At' pa fillim,\* Bir i bashkëpafillim, i miri Ngushëllimtar, Shpirt i drejtë ti,\* prindi i Fjalës, Fjala e Atit pa fillim tok,\* Shpirt i gjall', krijues, Trini, Njësi, shpëtomë.

#### Tani *Hyjlindësor*

O e pacen,\* si me ngjyrë purpuri manteli mendor dhe perandorak, u thur\* përbrenda barkut tënd mish i Emanuelit;\* të nderojmë ty, o Hyjlindëse, vërtet pra.

#### Ode IX

##### *Irmosi: Asporu silipseos*



»Pa prishje në bark ka nxënë nënë pa «burr', lindja s'ka shpjegim, se zënia\* ish «pa farë, Perëndia lind dhe natyrat ky\* i «rinovon; prandaj ne,\* të gjithë brezat,<sup>75</sup> «orthodhoksisht\* ty të madhërojmë plot «mall\* si hyjnuse, nënë pa qortim. (2x)

Sëmuret dhe fryma ime, shpirti u plagos, sëmuret edhe mendja,\* dhe m'u dobësua fjala, vdiq jeta, fundi vjen,\* është te dera, o shpirt;\* kur pra Gjykatësi do të vij\*<sup>76</sup> të hetojë sa veprime,\* çfarë do të bësh, i mjeri ti?

O shpirt, paraqita bërjen e Krijesës, siç e shkroi Moisiu,\*<sup>77</sup> çdo rrëfim që ka ai në të, që të ekspozon\* të drejt' dhe të padrejtë;\* shpirt, imitove të dytët ti,\* jo të parët, duke bërë\* faje kundër Perëndisë Zot.

Në ty nuk vepron Ungjilli, ligji u sëmur, çdo Shkrim u anësua\* dhe profetët janë dobësuar, dhe çdo fjalim\* që than' të drejtët, o shpirt;\* shumëfishuan plagosjet mjaft,\* se s'ka mjek të të shërojë,\* je në gjendje fort të rëndë ti.

Të sjell unë shembuj të së Resë, shpirt, këta të çojn' në kataniks ty;\* mëkatarët evitoji, zileps të drejtët krejt,\* me kreshmë zbutë Krishtin\* si dhe me lutje,<sup>78</sup> me thjeshtësi,\* me dëlirësi së bashku,\* do të glesh kështu shpëtim dhe hir.

Njeri u bë Krishti edhe ftoi për pendim<sup>79</sup> kusarë<sup>80</sup> dhe lavire;\*<sup>81</sup> o shpirt, ki pendim se tashmë dera e mbretëris\* u hap edhe të parët\* që e rrëmbejnë,<sup>82</sup> jan' farisenj,\* tagrambledhës dhe tradhtarë\* bashkëshortësh, që ndryshohen plot.

Njeri u bë Krishti dhe komunikoi, shpirt, me mua, dhe me dashje\* bëri çdo gjë që natyra ka, e zbatoi ky\* përveç mëkatit;<sup>83</sup>

shfaq\* që më përpara ikonën dhe\* tiplin qart' të bashkëzbritjes\* që do bënte ky i dhembshuri.

I ftoi barinj\*,<sup>84</sup> shpëtoi Magët,<sup>85</sup> bashkësit' e foshnjave i shfaq\* Zoti Krisht martirë,<sup>86</sup> lavdëroi një plak,<sup>87</sup> të ve\* mjaft të moshuar,<sup>88</sup> o shpirt;\* ti nuk zilepse vepërimitarin\* dhe as jetën nur që kishin;\* mjerë ti kur të gjykoresh keq!

Pasi kish kreshmuar Krishti dyzet ditë në shkreti, uri i erdhi,\* shfaq pra natyrën e njeriut, ndaj mos u lodh:\* Nëse do të sulmojë\* armiku,<sup>89</sup> zbrapse ti me triumf\* përmes kreshmës, përmes lutjes\*<sup>90</sup> dhe me ndihmën e Jisuit Zot.

#### Lavdi *Triadik*

Me bes' ta lëvdojmë Atin, ta mbilartësojmë Birin si dhe Shpirtin;\* le t'i falemi Triadhës pa ndarje dhe Njësis\* sipas esencës, drita\* dhe dritat, jeta dhe jetët është\*,\* që ndriçon dhe ia jep jetën\* botës mbarë, në çdo cep të saj.

#### Tani *Hyjlindësor*

Qytetin tënd ruaje ti, o e fort dëlirë dhe Hyjnënë Vajzë;\* mbretëron në ty me besë, në ty forcohet pra,\* fiton nëpërmjet teje\* edhe mbi çdo ngasje triumfon\* dhe armiqtë i plaçkit ky,\* mir' i qeveris nënshtetasit.

O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne.

Andrea shenjt, episkop i Kretës, që ke dalë nga Jerusalemi,\* lutu përgjithnjë për sa kuptojnë Kanunin tënd\* hyjnor me bes'; në porta\* do flasë pa turp hiç me armiqtë\*<sup>91</sup> çdokush që e ka kuptuar,\* meqë është më lart se veset.

#### *Pastaj të dyja koret psalin Irmosin:*

#### *Asporu silipseos*

**P**a prishje në bark

*Dhe shërbesa e Pasdarkës së Madhe që mbetet.*

## CITIME

1. Eks. 15.1-2; Sirak 51.2
2. Gjen. 3.3-6
3. Gjen. 3.7
4. Gjen. 2.15
5. Gjen. 3.23-24
6. Fja. Urt. 5.22
7. Ligji i Dytë 32.1
8. Is. 1.2
9. Matth. 14.31
10. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
11. Jud. 23
12. Lluk. 15.22
13. Gjen. 3.21
14. Matth. 26.7; Mark 14.3; Lluk. 7.37-38
15. Ps. 128(129).3
16. I Mbret. [Sam.] 2.1
17. Matth. 7.24; Lluk. 6.48
18. Gjen. 19.24; Ligji i Dytë 29.22; Is. 13.19; Jer. 27(50).40; 29(49).18; Vajt. 4.6
19. Gjen. 19.22-23.30; Lluk. 17.29
20. Joan 10.11
21. Matth. 18.12; Lluk. 15.4
22. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
23. Abak. 3.1-2
- 23a. Ps. 7.12; II Tim. 4.8
24. Matth. 9.6; Mark 2.10; Lluk. 5.24
25. I Kor. 7.29
26. Ps. 102(103).15; Jov 14.2; 15.33; Is. 40.6-7; Jak. 1.10-11; I Petr. 1.24
27. Gjen. 28.12-17
28. Gjen. 29.15; 30.26-31; 31.1,6,26,40-41
29. Gjen. 30.20-21
30. Gjen. 29.27
31. Is. 6.3; Apok. 4.8
32. Ju. 9.5-6; Ps. 134(135).6; Urt. Sol. 12.18; Mark. 1.40; Hebr. 1.3
33. Is. 26.9
34. Matth. 7.21
35. Joan 11.10
36. Rom. 13.12
37. I Thes. 5.5,8
38. Gjen. 35.21; 49.4
39. Gjen. 37.28
40. Gjen. 39.7-13
41. Gjen. 37.24-28
42. Hebr. 1.2
43. Jona 2.3-7; Lluk. 9.26
44. Lluk. 18.13
45. Num. 16.1-33; 26.9; Ligji i Dytë 11.6; Ps. 105(106).17
46. Ps. 85(86).13
47. Osia 4.16-17
48. Fja. Urt. 6.5; Sirak 27.20
49. Eks. 4.6-7
50. Fil. 2.6
51. Sirak 24.8
52. Ef. 1.23
53. III [I] Mbret. 8.47; II Kron. 6.37; Ps. 105(106).6; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 5-6; Dan. 9.5,15

54. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 10
55. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
56. Ps. 43(44).22
57. Ps. 24(25).18; 118(119).153; Vajt. 1.9
58. Ps. 34(35).23
59. I Mbret. [Sam.] 9.3
60. I Mbret. [Sam.] 10.1-2
61. Matth. 1.1 etj.
62. II Mbret. [Sam.] 11.2-17
63. II Mbret. [Sam.] 12.13
64. Ps. 50(51).3-6,9
65. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
66. Lluk. 15.18
67. IV [II] Mbret. 2.11; Sirak 48.9
68. IV [II] Mbret. 2.9-13
69. IV [II] Mbret. 2.14
70. IV [II] Mbret. 4.10
71. Matth. 25.43
72. Matth. 25.10-12
73. IV [II] Mbret. 5.20-23
74. Matth. 5.22; 18.9; Mark 9.43,45
75. Lluk. 1.48
76. Jak. 5.9
77. Gjen. 1.1-2.1
78. Lluk. 2.37
79. Matth. 9.13; Mark 2.17; Lluk. 5.32
80. Lluk. 23.40-44
81. Matth. 21.31-32
82. Matth. 11.12
83. Joan 8.46
84. Lluk. 2.8
85. Matth. 2.1
86. Matth. 2.16
87. Lluk. 2.25-32
88. Lluk. 2.36-38
89. Matth. 2.2-3; Mark 1.13; Lluk. 2.2
90. Matth. 17.21
91. Ps. 126(127).5



## TË MARTËN E JAVËS SË PARË NË PASDARKËN E MADHE

*Pas Dhokologjisë së Vogël, psalet pjesa e dytë e Kanunit të Madh të shën Andreas së Kretës (me Varg "Mëshiomë, o Perëndi, mëshiomë" në çdo tropar, përveç dyve të fundit).*

*Ting. Tërth. II*

*Ode I*

*Irmosi: Voithòs qe sqepastis*

»**M**'u bën ndihmës, mbrojtës, shpëtimtar,  
»**k**'është' Perëndia im pra\* dhe do ta lëvdtoj,



»është Zoti ai\* për atin tim, do ta lartësoj  
»shumë, se u lavdërua plot me lavd.<sup>1</sup> (2x)

Për sa varej nga dëshira, bëra vrasjen e  
neveritshme\* si Kaini<sup>2</sup> dhe me ndërgjegje  
kam vrrar\* un' shpirtin, i dhashë jetë mi-  
shit dhe e luftova me veprim të keq.

O Jisu, në drejtësi nuk ngjava dot me  
Abelin unë,\* nuk të solla kurrë dhuratë të  
mir\* që pritej,<sup>3</sup> as vepra Perëndie, as fli  
të pastër,<sup>4</sup> jetë pa njollë.

Dhe ne si Kaini, shpirt mjeran, Krijuesit  
të çdo gjëje\* i ofruam vepra të ndotura  
mjaft\* dhe fli të qortueshme,<sup>5</sup> me jetë pa  
vlerë; ndaj dhe u dënuam fort.

Ma gatove baltën tok me jetën, o Tje-  
gullar, më fute\* frymë, jetë,<sup>6</sup> kocka dhe  
mish; Zoti im\* Gjykatës, Çlirues, Bërës,  
pritmë, pranomë mua që pendohem pra.

Haptas t'i tregoj, o Shpëtimtar, mëkatet  
që bëra, plagët,\* si në shpirt ashtu dhe  
në trup, që m'i bën\*, m'i futën përbrenda  
si kusarë mendimet vrasëse<sup>7</sup> plot neveri.

Shpëtimtar, fajtova, por e di se je njerida-  
shës, dhe rreh,\* por me dashuri dhemb-  
shuron nxehtësisht,\* si ati sheh Birin pra  
Plangprishës që qan, rend shpejt<sup>8</sup> dhe e  
thërret prapë.

Lavdi *Triadik*

Mbiesenciale Shën Trini, të falemi në  
Njësi ne,\* hiq prej meje prangat e rënda<sup>9</sup>  
plot tmerr\* të fajtit edhe më jep mjaft lot  
kataniksi si e dhembshur plot me hir.

Tani *Hyllindësor*

O Hyllindëse, je shpresa, mbrojtja ti për  
sa të himnojnë,\* hiq prej meje prangat e  
rënda<sup>9</sup> plot tmerr\* të fajtit, si Zonjë e dë-  
lirë, pranomë mua që pendohem sinqe-  
risht.

*Ode II*

*Irmosi: Prôsehe uranë qe laliso*

»Ki kujdes\* ti, o qiell, do flas<sup>10</sup> un' dhe do  
»himnoj Zotin Krisht\* që nga e Virgjra na  
»erdhi brenda mishi pra. (2x)

Faji tmerr\* dhe për mua këmisha lëku-  
re<sup>11</sup> qepi, pasi\* ma zhveshi më parë rro-  
bën e hyjthurur lart.<sup>12</sup>

Veshje, rrob',\* kam stolinë e turpit si  
gjethe fiku,<sup>12</sup> kështu\* kjo më qorton për  
pasionet që i bëj lirshëm.

Mua pra\* më stolisi këmisha plot njollë,  
plot gjak me turp\* nëpërmjet rrjedhjes<sup>13</sup>  
nga jeta me pasion dhe eps.

Rashë keq\* brenda dhimbjes së vesit,  
prishja lëndore më zhduk,\* prandaj tani  
mizorisht më shtyp armiku djall.

Jam tani,\* Shpëtimtar, me zinxhirë të  
rënd', se zgjodha një jet'<sup>9</sup> mikeshe lënde  
dhe pronash, dhe jo mospasjen.

Mishin tim\* si statujë e vështa me lloj-lloj  
rrobash, stolish,\*<sup>14</sup> përmes mendimesh  
të turpshme dhe dënohem fort.

Vetëm për\* bukurinë e jashtme me  
zell kujdesesha un',\* shpërfilla tendën e  
brendshme që ka tip hyjnor.<sup>15</sup>

Shpëtimtar,\* e kam nxirë përmes vesesh  
bukurinë që kish\* dikur ikona,<sup>16</sup> kërko  
dhe gjeje si dhrahmin'.<sup>17</sup>

Të thërras:\* Si Lavirja fajtova ndaj teje  
vetëm un' pra,\* prit dhe nga unë si miro  
lot,<sup>18</sup> o Shpëtimtar.

Të thërras,\* Zot, porsi Doganieri: Kurse-  
më,<sup>19</sup> o Shpëtimtar,\* ndaj teje, si un', s'faj-  
toi asnjë adamian.

Lavdi *Triadik*

Të himnoj,\* Perëndi i çdo gjëje; je tre

Persona në një,\* pra Ati, Biri edhe i Tërëshenjtë Shpirt.

Tani *Hyllindësor*

**P**a pushim\* përgjërohu për ne të shpëtoj-më, o Virgjëresh\* pa cen, Hyllindëse; krejt himnoshesh vetëm ti.

*Ode III*

*Irmosi: Steréoson Kirie*

»Forco zemrën time, Krisht,\*<sup>20</sup> të tundur keq,<sup>21</sup> përmbi gurin, shkëmbin,\* pra të urdhrave të tu<sup>22</sup> fort ti,\* se je Zot i vetëm dhe i shenjtë; lavdi më ty. (2x)

Të kam krua jete ty,\*<sup>23</sup> shkatërrimtarin e vdekjes,<sup>24</sup> me zë\* të them para fundit: Më shpëto,\* mëkatova, të të vijë keq, të më falësh, Zot.

Fajtova te ti, o Zot,\* fajtova, ki dhembshuri për mua,\* s'ka asnjë fajtor mes njerëzve\* që në shkelje nuk e tejkalova, i mjeri un\*.

O Zot, imoralët mbar\* që po jetonin me Noen bashkë,\*<sup>25</sup> i pasova, trashëgova un\* dhe ndëshkim në zhytje, në përmbytje,<sup>26</sup> o Shpëtimtar.

O shpirt, atëvrasësin,\* të poshtrën Ham e ke imituar,\* turpin e të afërmit tënd pra\* s'e mbulove, nuk u ktheve prapa kur ecje ti.<sup>27</sup>

Si Loti të shmangesh ti,\* o shpirt, nga zjarri i fajit, ik larg\* nga Sodoma dhe Gomorra tok,\* evito çdo flakë<sup>28</sup> të oreksit paranojak.

Thërras: Mëshiomë, Zot,\* më përdëlle kur të vish së bashku\* ti me engjëjt e tu të shpërblesh,\* të shpaguash njerëzit pas veprave që bënë.<sup>29</sup>

Lavdi *Triadik*

Natyre e pafillim,\* Njësi e thjeshtë, e

pakrijuar,\* në tri hipostaza të himnojm\* dhe me bes' i falemi pushtetit tënd; na shpëto.

Tani *Hyllindësor*

**T**i Birin pa kohë krejt\* të Atit, pa burrë e ke lindur,\* o Hyjnënë, brenda kohës pra,\* mrekulli e huaj: Dhe gjí, por mbete virgjëresh'.

*Ode IV*

*Irmosi: Akikoen o profitis*

»Dëgjoji për ardhjen tënde\* profeti dhe e «kapi frika, se do të lindësh\* nga e Virgjira, «edhe njerëzve në dhë\* do t'u shfaqesh ti, «do t'u tregohesh krejt,\* dhe thoshte: Zot, «dëgjimin tënd e dëgjova plot tmerr,\* dhe «kam frik'<sup>30</sup> lavdi forcës sate pra. (2x)

Ji gati, shpirt, bëj arritje\* si patriarku më i madh, që të fitosh ti\*<sup>31</sup> vepër tok me njohuri, të bëhesh k'shtu\* dhe një mendje që sheh Perëndinë Zot,\* të shkosh me teori në mjegull pa perëndim hiç\*<sup>32</sup> dhe kështu të bëhesh tregtar i madh.

I madhi ndër patriarkë\* u bë me dymbëdhjetë patriarkë,<sup>33</sup> o shpirt,\* një shkall' ngjitjeje<sup>34</sup> praktike vuri drejt,\* e vendosi mistikisht mjaft ertësisht;\* mbështetjen porsì baza, bijtë porsì shkallesa\* seç i rregulloi për ty saktë.

Meqë ti, o shpirt, zilepse\* Isavin e urryer,<sup>35</sup> bukurin', të drejtën\* e të parëllindurit,<sup>36</sup> mashtruesit\*<sup>37</sup> ia dhe; ndaj re nga bekimi atëror,\* dyfish k'shtu u mashtrave,<sup>38</sup> o mjeran, në praktikë\* dhe në dije, ndaj ki pendim tani.

Isavi, Edhom u quajt\* se kishte epsht të madh për bashkim shpesh me femra,\*<sup>39</sup> se gjithnjë nga mospërmbajtja diglej fort\* dhe njollosej prej kënaqësive keq;\* Edhom u quajt që përkthehet fug', nxehtësi, vap',\*<sup>40</sup> vapë shpirti, shok, mik mëka-



tesh, tmerr.

Dëgjove se u drejt'sua<sup>41</sup> i ulur sipër plehrash Jovi,<sup>42</sup> nuk zilepse\* burrërin' e tij,<sup>43</sup> edhe nuk kishe, shpirt,\* as fuqinë e gatishmëris' së tij\* në çdo gjë pra që dije, njihje si edhe bëje,\* por në ngasje u shfaq pa durim.

Ai që mbi fron përpara\* po ulej, rri tani mbi plehra gjithë plagë,<sup>42</sup> lakuriq ky famëmadi me mjaft bij.\*<sup>44</sup> Befasisht u duk pa bij dhe pa shtëpi.\*<sup>45</sup> Mendonte plehrat si pallat mbretëror plot prehje\* dhe margaritarët mbar', traumat.<sup>42</sup>

#### Lavdi *Triadik*

Pa ndarje në esencë,\* pa ngatërrim personash të theologoj k'shtu,\* një Hyjni, Zot trinisor; tok mbretëron\* edhe je i bashkëfronshëm; të thërras\* të madhen këngë që himnohet në më të lartat,\* edhe trefish,<sup>46</sup> ty të këndoju unë.

#### Tani *Hyjlindësor*

Dhe lind, dhe je virgjëreshë,\* e virgjër në natyrë mbetesh me të dyja,\* Biri përsërit pra ligjin natyror,\* mitra ka një shtatzëni unike krejt,\* se mposhtet rendi natyror ku do Perëndia,\* meqë bën ai sa do<sup>47</sup> për një çast.

#### Ode V

##### *Irmosi: Ek niktós orthrizonta*

»Po mëngoj menatë, njeridashës Zot,\* »lutem, ndriçomë ti,\* udhëhiq më në drejt-tim,\* në urdhrat e tu mua,\*<sup>48</sup> mësomë që »përherë\* ta bëj dëshirën tënde.<sup>49</sup> (2x)

More vesh se dallgë lumi sillnin, shpirt,\* shportën që brenda kish\* Moisiun,<sup>50</sup> kjo si dhom'\* ishte qëmoti; ikte\* nga drama plot hidhërim\* prej urdhri faraoni.<sup>51</sup>

Shpirt mjeran, dëgjove se mamit' dikur\* vrisnin çdo mashkull, djal'\* të papjekur,<sup>50</sup>

– ishte kjo\* vrasja e mençurisë –\* si Moisiu i madh,\*<sup>52</sup> urtin<sup>53</sup> tani ta rritësh.<sup>54</sup>

Mendjen egjiptiane e godite, shpirt,\* si Moisiu shenjt,\*<sup>55</sup> zëmadi,<sup>52</sup> por s'e vrave dot;\* dhe në shkreti pasionesh,\*<sup>4</sup> i mjerë, si do banosh\*<sup>56</sup> përmes pendimit? – thua.

Në shkreti banoi shenjt<sup>56</sup> famëmadi,\* shenjt Moisiu,<sup>52</sup> shpirt;\* eja imitoje ti\* sjelljen e tij, të shohësh\* hyshfaqjen po gjithashtu\* në ferrën<sup>57</sup> që nuk digjej.

Shfaqu si purteka e profetit, pra\* e Moisiut, shpirt,\* detin e goditi kjo,\* fundi u mpiks,<sup>58</sup> me shenjen\* e Kryqit; dhe ti me të\* sukses do të arrish krejt.

Ish autentik krejt zjarri, pa dredhi,\* shpirt, që i sillte drejt\* Aaroni Perëndis',\* por jet' të huaj, pise\* te Zoti sillnin, si ti,\* Ofni dhe Fineesi.<sup>59</sup>

#### Lavdi *Triadik*

Të lëvdojmë, o Trini, një Perëndi,\* At', Bir, Shpirt; je i shenjt',\* je i shenjtë, je i shenjt',\*<sup>46</sup> Njësi e thjeshtë, Zoti,\* esenca që përgjithnjë\* të falemi me besë.

#### Tani *Hyjlindësor*

Nënë virgjëresh', pa prishje dhe pa burr'\* prej teje brumin tim\* e ka veshur Zoti im,\* Bërësi i çdo jete;\*<sup>60</sup> e lidhi me veten krejt\* natyrën njerëzore.

#### Ode VI

##### *Irmosi: Evoísa en oli kardhia mu*

»Nga zemra thell'\* drejt Zotit, të »dhembshurit,\* thirra dhe më dëgjoi ky\* »teksa fare poshtë, në Hadh pra, isha »unë\* dhe e ngriti lart\* jetën time prej pri-shjes.<sup>61</sup> (2x)

Telashe plot\* nga shkeljet e mia krejt\* si Det i Kuq u kthyen fort,\* befasisht më zhytën si treshet në karroca,\* egjiptianët

mbar', \* Shpëtimtar Zot, qëmoti.<sup>62</sup>

**N**uk kishe, shpirt, \* vullnet mirënjohës ti\* si Izraeli në një rast, \* preferove pa mend jo manën krejt të hyjshme,<sup>63</sup> por të hash ves, epsh\* dhe me pangopësi mjaft.

**S**hpirt, preferenc\* për pusët e mendjeve\* të Kanaanit<sup>64</sup> kishe ti\* jo për fyzen, gurin, Jisuin, Zotin,<sup>65</sup> pra kanën\* që buron rrëke\* theologe urtie.<sup>66</sup>

**S**hpirt, preferenc\* për mish derrash dhe kazan\* kishe, ushqim Egjipti pra, \* qiellor ti<sup>63</sup> s'deshe porsì në shkretëtirë\* më par' popullit\* që ish mosmirënjohës.<sup>67</sup>

**E** rrahu fort\* me shkop shërbëtori yt,\* shën Moisiu, gurin,<sup>65</sup> ish\* Shpëtimtar, tip, paraikonizonte brinjën\* jetëbërëse\* që nxjerr<sup>68</sup> pijen e jetës.

**S**piuno, o shpirt,\* heto si Jisui shenjt,\* biri navian, dikur dheun\* e trashëgimisë; shih çfarë, cili është\*<sup>69</sup> dhe bano në të\* dhe vepro ti pas ligjit.

#### Lavdi *Triadik*

"Triadhë jam,\* e thjeshtë, nuk ndahem hiç,\* por ndahem në Persona un',\* jam Njësi, bashkohem sipas natyrës", thotë\* Ati, Biri tok\* edhe Shpirti Hyjnor, Zot.

#### Tani *Hyjlindësor*

**N**a lindi Zot\* me pamjen ton', mu si ne\*<sup>70</sup> barku yt, o Hyjlindëse;\* lype, ndërmjeto tek ai, që, si Krijues\* i të gjithave,\*<sup>71</sup> të na nxjerrë të drejtë.

#### *Kontaqi Ting, Tërth. II* (psalet ngadalë)

**O** shpirti im, o shpirt im, ngrihu, pse fle gjumë? Po afrohet fundi dhe ke për t'u trazuar; ndaj zgjohu që të të kursejë ty Perëndia, Zoti Krisht, që ndodhet kudo dhe i mbush të gjitha.<sup>72</sup>

#### *Ode VII*

#### *Irmosi: Imärtomen, inomísamen*

»Fajtuam ne,\* mëkatuam ne,\* para te-  
je bëm' padrejtësi ne,\* s'i ruajtëm ne,  
«s'i zbatuam ne porosit' e tua,<sup>73</sup> ne të pa-  
mendët, o Zot,\* por mos na dorëzo më në  
«fund ne,<sup>74</sup> o Perëndi i etërve, pra.<sup>75</sup> (2x)

**K**ur sillej, shpirt,\* Arka mbi karroc\* dhe përmysej viçi, Zani krejt thjesht\* e preku vetëm Arkën, dhe pësoi mërin' e Perëndisë, inatin e tij;<sup>76</sup>\* mirë ti adhuroi hyjnorete, shmangu nga arroganca e tij.

**D**ëgjove, shpirt,\* si u ngrit pa mend\* ndaj natyrës pra Abesalomi;<sup>77</sup> të neveritshmet vepra që ky bëri, i di; me to krevatin e atit David\* keq e shau,<sup>78</sup> dhe ti i imitove hovet e vesit, epshin e tij.

**N**ë trupin tënd\* e nënshtrove keq\* gradën tënde të pamposhtur, o shpirt,\* se gjete si një tjetër Ahitofel armikun, i pranove mendimet e tij;<sup>79</sup> por ato vetë Krishti i zhdukua krejt, që ti me çdo kusht të shpëtosh.

**S**hpirt, ishte plot\* me urti dhe hir\* Solomoni<sup>80</sup> i çuditshëm, por, kur\* dinakërin' e bëri para Zotit dhe Perëndis' dikur, u largua prej tij;<sup>81</sup> ti njësoj bëre jetë të neveritshme dhe të mallkuar si ky.

**Z**varritej, shpirt,\* nga një vesk epshor,\* nga pasionet e tij, ndotej - mjerë! -\* i dashuruari pas urtësisë<sup>82</sup> u bë i dashuruar pas grash pa moral\*<sup>83</sup> dhe i huaj për Zotin;<sup>84</sup> e imitove me vese turpi në mend.

**Z**ilepse, shpirt,\* Rovoamin ti;\* pa mend s'bëri ç'deshte ati,<sup>85</sup> si dhe\* Jerovoamin, shkelësin e keq, skllavin<sup>86</sup> që më parë bëri grusht shteti mjerisht;<sup>87</sup> lëre pra imitimim e tyre, thirr: Zot, fajtova, më dhembshuro.

#### Lavdi *Triadik*



“Trini e thjesht’,\* e pandarë krejt,\* je Njësi e bashkëqenshme, drita\* të shenjta, dritë, – tri të shenjta dhe një e shenjtë”, Perëndia himnohet kështu.\* Por himnoje, lëvdoje, shpirt, jetën, jetët, pra Perëndin’ e çdokujt.

Tani *Hyjlindësor*

Të falemi,\* të himnojmë ne,\* të bekojmë, Hynjënë, se ti\* ke lindur një nga Shën Triadha krejt e pandarë, Perëndinë, një Bir dhe Zot pra;\* dhe ti vetë për ne tokësorët hape nur qielloret me gaz.

*Ode VIII*

*Irmosi: On stratie uranon*

»E lavdërojn’\* Zotin lart ushtritë qiellore, »e kanë frik’ Keruvimet tok\* me Serafi- »met; çdo frymë, çdo krijim, bekoje,\* për- »mbilartësoje, himnoje në gjith’ jetët.<sup>88</sup> (2x)

Kishe zili,\* shpirt, Ozinë, ndaj dyfish e ke brenda teje lebrën e tij,<sup>89</sup> sepse\* gjë- ra pa vend mendon ti dhe bën dhe të paligjshme;\* iëri sa ke edhe vrapo shpejt drejt pendimit.

Dëgjove ti\* se pendoheshin me thasë, hi para Perëndis’ ninevitët mbar’;<sup>90</sup> s’i imi- tove, u shfaqe më i trashë nga sa\* mëka- tuan para si dhe pas Ligjit, o shpirt.

Dëgjove, shpirt,\* Jereminë që në gropë balte<sup>91</sup> po qante fort për Sionin pra;\* thë- rriste, kritikonte qytetin, lot kërkonte;\*<sup>92</sup> imitoje jetën e tij me vaj, shpëton k’shtu.

Shenjtji Jona\* drejt Tharsisë rendi shpejt,<sup>93</sup> se njohu pendimin ninevitan më par’,\* se dinte si profet dhembshurin’ e Perëndisë,\*<sup>94</sup> kish zell të mos dilte si false profecia.

Dëgjove, shpirt,\* për Danielin si në gropë kish mbyllur goja bishash,<sup>95</sup> dhe more vesh\* si shuan me besim flakë furre që po digjej,\* sa rreth Azarias po rrinin la-

shtë, Djemtë.<sup>96</sup>

Krejt njerëzit\* e së Vjetrës Dhiatë para teje i kam vendosur si shembull, shpirt;\* sa Zoti do, çka bënëin të drejtët, imitoji,\* veçse shmang mëkatet që bënë dredha- rakët.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin.

*Triadik*

At’ pa fillim,\* Bir i bashkëpafillim, i miri Ngushëllimtar, Shpirt i drejtë ti,\* prindi i Fjalës, Fjala e Atit pa fillim tok,\* Shpirt i gjall’, krijues, Trini, Njësi, shpëtomë.

Tani *Hyjlindësor*

O e pacen,\* si me ngjyrë purpuri mante- li mendor dhe perandorak, u thur\* për- brenda barkut tënd mishi i Emanuelit;\* të nderojmë ty, o Hyjlindëse, vërtet pra.

*Ode IX*

*Irmosi: Asporu silipseos*

»Pa prishje në bark ka nxënë nënë pa »burr’, lindja s’ka shpjegim, se zënia\* ish »pa farë, Perëndia lind dhe natyrat ky\* i »rinovon; prandaj ne,\* të gjithë brezat,<sup>97</sup> »orthodhoksisht\* ty të madhërojmë plot »mall\* si hynuse, nënë pa qortim. (2x)

Ngacmohej Jisui Krisht, fort djalli e tundonte duke shfaqur gurë\* për t’u bërë bukë dhe e ngjiti atë në mal\* të shihte mbretëritë\* e botës mbarë në çast.<sup>98</sup> O shpirt,\* nga kjo dramë ki frik’, lutju\* në çdo kohë Zotit, ji gati.

Lëshoi zë, thirr<sup>99</sup> si turtull që do shkretin’ kandili zotëror nur,\*<sup>100</sup> predikonte ky pendim,<sup>101</sup> Herodi paligjësi\* kish me Herodiadën.\*<sup>102</sup> O shpirt, shih kurthet që ngrënë keq\* të paligjëjt, të mos biesh,\* por pendimin përqafoje drejt.

Prodhromi i Hirit në shkreti banoi<sup>101</sup> dhe

Judea mbarë si dhe\* Samaria, si dëgjoni, rendnin, rrëfenin krejt\* shkeljet që kishin bërë\* dhe pagëzoheshin<sup>103</sup> plot me zell,\* me gatishmëri; por ti, shpirt,\* nuk i imitove, ndaj ke faj.

**Shpirt**, kurorëzimi ka nder, shtrati nuk ka njollë,<sup>104</sup> se të dyja Krishti,\* si njeri, kur hante, i bekoi në Kanë krejt\* përpara, gjatë dasmës,\* e ktheu ujin në verë pra,\* shfaql qart' çudin' e parë,\*<sup>105</sup> që ti të zhvendosesh me ndryshim.

**Forcoi** paralitikon Krishti dhe ai e ngriti shtratin,<sup>106</sup> o shpirt,\* ngjalli djal' të vdekur, bir vejushe pra ish ai,\*<sup>107</sup> bëri me centurionin\* të njëjtën<sup>108</sup> gjë; dhe kur qart' u shfaq\* te Samaritania, të dha\* si në skicë adhurim në frym'.<sup>109</sup>

**Shëroi** gjakrrjedhësen Krisht Zoti kur ia preku cepin e mantelit;\*<sup>110</sup> ngriti sa çalonin dhe të verbrit i shndriti, shpirt,\* lau sa kishin lebër,\* të shurdhrit edhe memecët<sup>111</sup> njësh,\* të kërrusurën me fjalë\* e shëroi,<sup>112</sup> që, qyq, të shpëtosh.

#### Lavdi *Triadik*

**Me** bes' ta lëvdovmë Atin, ta mbilartësojmë Birin si dhe Shpirtin;\* le t'i falemi Triadhës pa ndarje dhe Njesis'\* sipas esencës, drita\* dhe dritat, jeta dhe jetët është',\* që ndriçon dhe ia jep jetën\* botës mbarë, anëmbanë pra.

#### Tani *Hyjlindësor*

**Qytetin** tënd ruaje ti, o e fortëdlirë dhe Hyjnënë Vajzë;\* mbretëron në ty me besë, në ty forçohet pra,\* fiton nëpërmjet teje\* edhe mbi çdo ngasje triumfon\* dhe armiqtë i plaçkit ky,\* mir' i qeveris nënshtetasit.

#### *I shën Andreas*

O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne. **Andrea** shenjt, episkop i Kretës, që ke

dalë nga Jerusalemi,\* lutu përgjithnjë për sa kuptojnë Kanunin tënd\* hyjnor me bes'; në porta\* do flasë pa turp hiç me armiq\*<sup>113</sup> çdokush që e ka kuptuar,\* me që është më lart se veset.

*Pastaj të dyja koret psalin Irmosin: Asporu silipseos*

## **P**a prishje në bark

*Dhe shërbesa e Pasdarekës së Madhe që mbetet.*

### *CITIME*

1. Eks. 15.1-2; Sirak 51.2
2. Gjen. 4.8; 1 Joan 3.12
3. Gjen. 4.4; Hebr. 11.4; 1 Joan 3.12
4. Mal. 1.11
5. Gjen. 4.5-7
6. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 118(119).73; Jov 10.8-9
7. Lluk. 10.30
8. Lluk. 15.20
9. Fja. Urt. 5.22
10. Ligji i Dytë 32.1
11. Gjen. 3.21
12. Gjen. 3.7
13. Jude 23
14. Ps. 143(144).12
15. Eks. 25.39
16. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
17. Lluk. 15.8
18. Lluk. 7.37-38
19. Lluk. 18.13
20. 1 Mbret. [Sam.] 2.1
21. Sirak 48.19
22. Matth. 7.24-25; Lluk. 6.48
23. Jer. 2.13
24. II Tim. 1.10; Hebr. 2.14
25. Gjen. 6.5-12
26. Gjen. 7.17; II Petr. 2.5
27. Gjen. 9.20-24
28. Gjen. 19.22-24
29. Matth. 16.27
30. Abak. 3.1-2
31. Gjen. 30.29,43
32. Ligji i Dytë 4.11; 5.22(19); Sirak 45.5; Hebr. 12.18
33. Gjen. 49.28 etj.
34. Gjen. 28.12-17
35. Mal. 1.3; Rom. 9.13
36. Gjen. 25.31-34
37. Gjen. 25.26; 27.36; Osia 12.4
38. Gjen. 27.1-37
39. Gjen. 26.34
40. Gjen. 25.25
41. Jov 42.7-8
42. Jov 2.8
43. Jov 2.10



44. Jov 1.2-3  
 45. Jov 1.14-19  
 46. Is. 6.3; Apok. 4.8  
 47. Ps. 134(135).6  
 48. Is. 26.9  
 49. Matth. 7.21  
 50. Eks. 2.3  
 51. Eks. 1.15-16,22; Vep. 7.19  
 52. Eks. 2.11; Hebr. 11.24  
 53. Vep. 7.22  
 54. Eks. 2.9  
 55. Eks. 2.12  
 56. Eks. 2.15; 3.1  
 57. Eks. 3.2-6  
 58. Eks. 14.15-22 etj.  
 59. I Mbret. [Sam.] 1.3; 2.12-17,22-25; 4.17  
 60. Hebr. 1.2  
 61. Jona 2.3-7; Lluk. 9.26  
 62. Eks. 14.27 etj.  
 63. Eks. 16.14-31; Ps. 77(78).24; 104(105).40  
 64. Gjen. 26.20-21  
 65. Eks. 17.6; Num. 20.11; Ligji i Dytë 8.15; Ps. 77(78).15-16; 104(105).41; 113(114).8; I Kor. 10.4  
 66. Fja. Urt. 9.1-2  
 67. Eks. 16.2-3  
 68. Joan 19.34  
 69. Num. 13.2-17; Ligji i Dytë 1.22-24; Jis. N. 14.7; Hebr. 11.31; Jak. 2.25  
 70. Fil. 2.7-8  
 71. Sirak 24.8  
 72. Ef. 1.23  
 73. III [I] Mbret. 8.47; II Kron. 6.37; Ps. 105(106).6; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 5-6; Dan. 9.5,15  
 74. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 10  
 75. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28  
 76. II Mbret. [Sam.] 6.6-7; I Kron. 13.9-10  
 77. II Mbret. [Sam.] 15.1,12-14  
 78. II Mbret. [Sam.] 16.22  
 79. II Mbret. [Sam.] 16.21,23; 17.1-3  
 80. III [I] Mbret. 2.35a etj.  
 81. III [I] Mbret. 11.4-8  
 82. Urt. Sol. 7.30-8.2  
 83. III [I] Mbret. 11.1-3  
 84. III [I] Mbret. 11.9  
 85. III [I] Mbret. 12.14; 24  
 86. III [I] Mbret. 11.26  
 87. III [I] Mbret. 12.20  
 88. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34  
 89. II Kron. 26.16-21  
 90. Jona 3.5-8; Matth. 11.21; Lluk. 11.32  
 91. Jer. 45(38).6; Vajt. 3.53  
 92. Jer. 9.1  
 93. Jona 1.3  
 94. Jona 4.2  
 95. Dan. 6.18  
 96. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23-26  
 97. Lluk. 1.48  
 98. Matth. 4.3-9; Lluk. 4.2-7  
 99. Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23  
 100. Joan 5.33-35  
 101. Matth. 3.1-2; Mark 1.4; Lluk. 3.2-3

102. Matth. 14.3-4; Mark 6.17-18; Lluk. 3.19  
 103. Matth. 3.5-6; Mark 1.5; Lluk. 3.7  
 104. Hebr. 13.4  
 105. Joan 2.1-11  
 106. Matth. 9.6-7; Mark 2.10-12  
 107. Lluk. 7.12-15  
 108. Lluk. 7.2-10  
 109. Joan 4.7-24  
 110. Matth. 9.20-22; Mark 5.25-29; Lluk. 8.43-44  
 111. Matth. 4.24; 11.5; 15.30-31; Mark 7.37; Lluk. 4.18-19; 7.21-22; Joan 10.21  
 112. Lluk. 13.11-13  
 113. Ps. 126(127).5



## TË MËRKURËN E JAVËS SË PARË NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve, Alihuiat dhe Triadiket e Tingullit të javës. Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove Kryqësore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove Ting. II O efskimon Iosif*

**N**jeridashëm, me sa vuajte, na dhe ti pasionshmëri të gjithë neve,\* me Kryqin tënd hyjnor pasionin tim mishor ma vri,\* më bëj të denj' ta shoh pësimin tënd krejt hyjnor\* me kreshm' të të kënaq, ta mburr, Zot, lavdin tënd,\* ta marr përdëllimin e madh<sup>1</sup> mjaft pasurisht.

Lavdi

*E njëjta*

*Tani Kryqhyjindësore  
Efsplahnias ipårhusa*

**K**ur të pa të tendosur mbi një dru\* dhe të vdekur, e Virgjra nëna jote po qante,\* o Krisht, hidhur thoshte: Ç'është ky mister\* plot tmerr, Biri im? Si përmbi Kryq po vdes\* me vdekte të turpshme krejt,\* me dashje<sup>2</sup> ti që dhuron\* jetë të përjetshme nur\* te të gjithë<sup>3</sup> pranë teje në amshim?

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësove Ting. II Ton zoopiòn su stavròn*

**K**ohën dritëbërëse të vetëpërmbytjes,

që tani e veçove dhe na e dhurove ti, o Zot, denjësona që të gjithë ta mbarojmë sinqerisht me kataniks, me paqe nëpërmjet fuqisë së Kryqit, o i vetmi njeridashës.

Lavdi  
*E njëjta*

Tani *Kryqhyjlindësore*  
*Efsplahnias ipårhusa*

Përmes Kryqit të Birit tënd, o Zonj\* e dëlirë, Hyjlindëse, fort ruhemi, zmbarsim\* lehtë gjithë sulmet e armikut djall;\* ndaj detyrimisht të lumërojmë ty\* si nënën e dritës\* son',\* si shpresën e vetme krejt\* pra për shpirtat tanë, Vajz;\* je e lavdëruar, e kulluar fort.

*Pastaj lexim në Lafaik. Psalmi 50. Prifti thotë uratën e zakonshme: O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën, dhembshurinë dhe... Kanuni i Mujorit dhe Triodet në vendin e tyre. Lexohet dhe Ode III biblike.*

Triodi  
Ting. II  
Ode III

*Eksinthesen i ërimos*

T'i kryqëzojm' gjymtyrët ne\*<sup>5</sup> me vetëpërbajtje dhe me lutje plot gatishmëri,\* siç është\* shkruar,<sup>6</sup> me sjellje pas gjurmës\* së të pësuarit<sup>7</sup> që vrau veset pra.

Si nxorëm me të vjellën ne\* fajin mjaft të hidhur, të nxitojmë që t'i japim gaz\* Zotit Krisht që me dashje<sup>2</sup> vrer në Kryq\* shijoi<sup>8</sup> dhe e shembi kryekeqin djall.

M'u bë zakon mëkati keq,\* më zvarrit drejt zhdukjes absolute, por ti më çliro\* nga ai, i shumë mëshirshmi Zot,\* i dhembshuri, me Kryqin dhe pësimin tënd.

*Hyjlindësore*

Meqë sundon mbi çdo krijim,\* se, o Zonjë, linde Zotin, më çliro prej skllavëris\*<sup>4</sup>

së dinakut dredhak, se vetëm ky\* armik, djall, është me urrejtje vrasëse.

*Kanuni tjetër Ting. i njëjtë*  
*Steréoson imás en si Kirie*

Luloi druri shenjt i Kryqit në bot'\* përmabajtjen, atë me mall ta qafojmë,\* t'i shijojmë frytet mbarë ne\* të porosive hyjnore të Zotit Krisht.

Tani që kemi vetëpërbajtje ne\* pa vese, për Zotin ta kryqëzojmë\* mishin<sup>5</sup> dhe të gjithë ta tregojm'\* mentalitetin e tij,<sup>9</sup> vrar' me shenjten jet'.

Lavdi *Triadik*

Personat me një pamje po i lëndoj,\* pra Atin dhe Birin me Shpirtin, një forc\* të Hyjnisë, mbretërinë lart,\* ndriçimin mbi çdo gjë; nder tre Persona tok.

Tani *Hyjlindësore*

E frikshme është lindja jote, plot tmerr:\* I linduri pa mot prej Atit është\* Zot i mishëruar, që në fund\* në bark e kishe pa burrë, o e Dëllir'.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Himnoj, Krisht, kryqëzimin, plagën me shtiz\* që kishe në brinjën hyjnore;<sup>10</sup> nxjerr un'\* pijen plot pavdekësi kështu\* dhe shenjtërohëm çdo ditë me hir të madh.

*Irmosi: Steréoson imás en si*

»Forcona, sigurona, o Zot, në ty,\*<sup>11</sup> pra »ti që ke vrarë me dru mëkatin,\*<sup>11a</sup> edhe »frikën tënde na e mbill\* në zemrat tona, »që të lavdërojmë ty.

*Ode VIII*

*Káminos poté pirós*

Kaminë pasionesh e flakëron shpirtin tim, por me freskinë e mëshirës sate ta vyshkësh<sup>12</sup> ti që, kur po kryqëzohesh, burove nga brinja jote e pacen kroje<sup>10</sup> papsionshmërie nga bashkëzbritja e madhe, o



Mirëbërës.

**M**e lartësimin tënd mbi Kryq, o Krisht, na ngrite ne të rënë në të keqe; prandaj mua që rrëshqita në gremina mëkati, nxirrme lart dhe mbështetmë në gur shpëtimi, që ta lavdëroj pushtetin tënd.

**M**e shtizën tënde, o Krisht,<sup>10</sup> pastroje kalbëzimin e pasioneve të zemrës sime, shëromë të tërin mua që më plagosi<sup>13</sup> gjarpri me dhëmbë helmuese dhe bëmë të eci pa u lëkundur në udhët e hyjshme.

### *Hyjindësor*

**T**ë gjithë, duke bekuar Birin tënd, o e bekuar pa cen, të mburrin ty, llambadhen e shkëlqyer, kandilin ku banoi zjarri i Hyjnisë,<sup>14</sup> i cili shndriti ata që u kapën nga prishja e errët.

### *Tjetri: Ton en ti vato Mosi*

**A**të që u kryqëzua mbi dru në mes të kusarëve<sup>15</sup> dhe u shpua me shtizë në brinjën<sup>10</sup> jetërrjedhëse, himnojeni, bekojeni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.<sup>16</sup>

**T**i që gjykon tërë dheun,<sup>17</sup> qëndrove në gjyq, more shuplaka, u talle dhe u vare në Kryq duke më çliuar nga prishja e mëkatit të vjetër në gjithë jetët.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin  
e Shenjtë, Zotin.

### *Triadik*

**O** Trini, një Hyjni, natyrë e pandashme, por që ndahesh në Persona, pushtet i pashkatërrueshëm, Atë, Bir dhe Shpirt, të përhimnojmë në gjithë jetët.

### *Tani Hyjindësore*

**O** Hyjnënë e kulluar, porta qiellore,<sup>18</sup> dera shpëtimtare e tërë të krishterëve, pranoje lutjen e atyre që të lumërojnë në gjithë jetët.<sup>19</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **O** Kryq i Krishtit, që udhëhoqe Kusarin drejt besimit,<sup>20</sup> denjësomë dhe më jep fuqi në rrugën e kreshmës, që të arrij në faljen tënde dhe të gjallërohem.

Himnojmë, bekojmë dhe i falemi Zotit.

### *Irmosi: Ton en ti vato Mosi*

»Te Moisiu, në mal,\* në Sina, para-  
»shfaqiq\* mrekullin' e së Virgjërës në një  
»ferrë<sup>21</sup> Zoti Krisht;\* himnojeni, bekojeni,\*  
»përmbilartësoni atë në gjithë jetët.<sup>16</sup>

### *Ode IX*

### *Anarhu jenitoros*

**I** shumëndriçuari hir, kreshma, feks më me shumë gaz,\* hijeshi, lavd, se dielli, dhe ungjillëzon\* te të gjithë rrezet e Kryqit, shkëlqimet nur\* që pësimi aq i nderuar ka, ditën krejt\* shpëtimtare të shën Ngjalljes tok.

**T**a duam me mall dëlirësin', t'i shmangim shturjet krejt\*<sup>22</sup> edhe me mençuri le të ngjishemi në mes,\* që të pastër të Shpëtimtari të shfaqemi;\* ky është i vetmi i pastër edhe kërkon\* nga të gjithë pastërti në shpirt.

**K**risht, mishrat e mia nguli përmes frikës sate<sup>23</sup> ti,\* se mbërtheve në Kryq fajin<sup>24</sup> e Adamit pra,\* zgjidhe lidhjen e të këqijave krejt që kam;\* Zot, me heshtën tënde<sup>10</sup> dërmo çdo shigjet' të lig',\* dhe shpëtom' nga çdo dëm djallëzor.

### *Hyjindësor*

**E** Virgjër, që linde pra gjykatësin e drejtë<sup>25</sup> krejt,\* Krishtin, Zotin, që vetëm pajtohet lehtësisht,\* më çliro nga gjyqi, ndëshkimi dhe zjarri tok,\* që më ka shkaktuar shijimi i fajeve,\* e dëlira Vajzë me mjaft hir.

*Tjetri: Tin agnin qe áhranton*

Oh, dhembshuria jote! Se ti durove Kryq, gozhdë dhe shtizë<sup>10</sup> për mua që meritoj dënim për shkak të prishjes, o Zot; prandaj të himnoj, o Krisht.

Të himnojme me ode, o Krisht, duke iu falur ne, gjithë populli, Kryqit, kallamit,<sup>26</sup> gozhdëve dhe heshtës,<sup>10</sup> pësimëve të tua jetësore.

#### Lavdi *Triadik*

O Njësi trihipostate, Trini që je një absolutisht, sundim, natyrë e njëlavdishme, Atë, Bir dhe Shpirt Hyjnor, na shpëto të gjithë ne.

#### Tani *Hyjlindësor*

Gëzohu, o Hyjlindëse, zbutje e botës; kur përikim te ti, tërë ne mëkatarët gjejmë përgjithmonë pajtim me Perëndinë.<sup>27</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Pasi të më forcosh edhe mua me Kryqin tënd, o Zot i mirë, më bëj që ta mbaroj me fuqi periudhën e kreshmëve.

#### *Irmosi: Tin agnīn qe àhranton*

»Ne shpresëplotët mbarë me melodi »këngësh e madhështojmë besërisht si »Perëndilindëse nënën dhe Virgjëreshën »e dëlirë e të pacen.

#### *Fotagjoku i Tingullit të javës Dhe Dhoksologjia e Vogël (fq. 62)*

#### *Pasvargjet e Lavdërimeve Ting. Tërth. IV Idhiomeli*

Ejani t'i sklavërojmë me anën e kreshmës pasionet e mendimeve, duke u mbrojtur nëpërmjet krahëve shpirtërorë, që ta kalojmë lehtë turbullimin që shkakton armiku dhe të bëhemi të denjë t'i falemi Kryqit të Birit të Perëndisë, i cili u ther vullnetarisht për botën,<sup>2</sup> dhe ta kremojmë shpirtërisht ngjalljen prej së vdekurish të Shpëtimtarit; duke u ngjitur në mal, le ta

lavdërojmë bashkë me Nxënësit atë që mori çdo pushtet,<sup>28</sup> njeridashësin Bir të lindur nga Ati në Shpirtin e Shenjtë.

*Varg:* U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dërfreshim në vend të ditëve që na përulë, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt' e tyre.

#### *In njëjti*

*Varg:* Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji te ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

#### *Martirik*

O martirë të pamposhtur të Zotit, që mundët mashtërmin nëpërmjet fuqisë së Kryqit me shpresë që të ngjallni në jetën e amshuar,<sup>29</sup> nuk u frikësuar nga kërcënimet e tiranëve, dëfrenit kur po plagoseshit nga torturat; vetëm me preken e pluhurit shëroni shpirtin dhe trupin, si të ngjallur, o përkrahës të nxehtë të besimtarëve.

#### Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësor*

#### *O tu paradhoksu thávmatos*

«Ç'është pamja që po shfaqet, o Zot, para syve të mi? Ti që mbarë Krijesën mban,\* si u vare mbi një dru,\* vritesh ti që kudo jep jet'?!»,<sup>3</sup> tha me vaj, qarje, kështu Hyjlindësja,\* e fort dëlira dhe Vajza kur e pa\* njeriun-Perëndi\* që prej saj shkëlqeu krejt pashprehimisht,\* ndërsa ish mbërthyer në një Kryq si kriminel.

*Lexuesi:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin... *etj. si të hënën në mëngjes (fq. 63).*

*Në orën e Gjashtë (në Triahtë), Tropari i Profecisë:  
Ting. IV*

O njeridashës, ti e di gatimin tonë, e di do-



bësinë tonë; mëkatuam, por nuk u distancuam nga ti, o Perëndi, as i ngremë duart tona drejt një perëndie të huaj,<sup>30</sup> na kurse<sup>31</sup> me anën e mirësisë sate, o i dhembshur.

Lavdi *dhe* Tani  
*Injëjti*

Proqimen. Ting. IV. Psalmi 9.  
Do të të lavdëroj, o Zot, me gjithë zemrën time.

*Varg:* Do të dëfroj dhe do të ngazëllohem në ty.

Këndimi i profecisë së Isaias  
(2.3-11)

**K**ëto thotë Zoti: "Nga Sioni do të dalë një ligj dhe një fjalë Zoti nga Jerusalemi". Dhe do të gjykojë në mes të kombeve dhe do të kontrollojë një popull të madh; dhe do të presin thikat e tyre në parmenda dhe shtizat e tyre në drapërinj, dhe nuk do të marrë thikë një komb kundër një tjetër kombi, dhe nuk do të mësojnë më të luftojnë. Dhe tani, o shtëpia e Jakovit, ejani të ecim në dritë Zoti, sepse e la popullin e tij, shtëpinë e Izraelit, ngaqë u mbush me orakuj, si që nga fillimi, vendi i tyre porsì vendi i të huajve, dhe u bënë me shumë fëmijë të huaj, sepse u mbush vendi i tyre me argjend dhe ar dhe nuk numëroheshin dot thesaret e tyre; dhe u mbush toka me kuaj dhe nuk numëroheshin dot karrocacat e tyre luftarake; dhe u mbush toka me neveritë e punëve të duarve të tyre, dhe iu falën atyre që bënë gishtërinjtë e tyre; dhe u përkul njeriu, dhe u përul burri, dhe nuk do t'i ndjej ata. Dhe tani hyni në gurë dhe fshihuni në tokë nga fytyra e frikës së Zotit dhe nga lavdia e fuqisë së tij, kur do të ngrihet ta dërrmojë tokën, sepse sytë e Zotit janë të lartë, ndërsa njeriu i ulët; dhe do të ulet lartësia e njerëzve dhe do të lartësohet vetëm Zoti në atë ditë.

Proqimen. Ting. Tërth. II. Ps. 10.  
I drejtë është Zoti dhe deshi drejtësi.

*Varg:* Mbi Zotin kam besim; si do t'i thoni shpirtit tim?



## TË MËRKURËN E JAVËS SË PARË NË MBRËMËSORE

*10 Thirrortë*  
*Ting. Tërth. IV Idhiomeli*

**D**uke kreshmuar, o vëllezër, trupërisht, le të kreshmojmë dhe shpirtërisht; le të zgjidhim çdo lidhje padrejtësie; le të thyejmë shtrembërime marrëdhëniesh të dhunshme, le të grisim çdo padi të padrejtë, le t'u japim bukë të uriturve dhe le të futim në shtëpi të varfrit e pastrehë,<sup>32</sup> që të marrim prej Krishtit përdëllimin e madh.<sup>1</sup>

*Varg:* Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

*Injëjti*

*Varg:* Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

*Martirike*

**N**ë ka ndonjë virtut dhe në ka ndonjë lavdërim, këto u përkasin shenjtorëve, sepse i ulën qafat te shpata për ty që i ule qiejt dhe zbritë;<sup>33</sup> derdhën gjakun e tyre për ty që zbraze veten dhe more pamje shërbëtori;<sup>34</sup> u përlulën deri në vdekje, duke imituar varfërinë tënde;<sup>35</sup> me lutjet e

tyre, o Perëndi, mëshirona sipas shumicës së dhembshurive të tua.<sup>36</sup>

*Të tjerë, të zotit Josif  
Ting. II Os orathis Hristë*

Jisui, dielli vërtet mendor, pasi ju dërgoi në tërë botën si rrufe dritëprurëse, me anën e shkëlqimeve të predikimit tuaj të perëndishëm pakësoi terrin e mashtrimit dhe feksi të mbajturit djallëzish në errësirën e paditurisë,<sup>37</sup> o apostuj hyjshkues; përgjëroju atij të na dërgojë edhe neve ndriçimin dhe përdëllimin e madh.<sup>1</sup>

Kur hipi në karrocë hyjnore virtytësh, pasi shkëlqeu përmes kreshmës,<sup>38</sup> Ilija çohet sipër, drejt lartësisë qiellore,<sup>39</sup> atë ki zili, o shpirti im i ulët, dhe kreshmo nga çdo e keqe, smirë, konflikt dhe ushqim i kënaqshëm epshor që rrjedh, që t'i shmangesh dhimbjes së tmerrshme, të përjetshme të Gjehenës, duke i thirrur Krishtit: O Zot, lavdi më ty.

*Tjetër, e zotit Theodor  
Ting. Tërth. I Ósie pater*

O ndërmjetuesit e nxehtë të kozmosit\* dhe mbrojtësit, apostujt e orthodhoksëve mbar',\* bri Zotit tonë, Krishtit, guxim plot kenit\* si dhe fuqi, ndaj përgjërohuni ju,\* lypni që dhe kohën\* e kreshmëve të mira\* ta përjetojm' lehtë, me bollëk\* dhe prej Trinisë së njëqenshme të presim\* dhe Hirin që ka kjo,\* o krejt të respektuar\* dhe të hyjnueshëm me plot lavd,\* predikues,\* shenjtore shumë të mëdhenj, fort lutuni për ne,\* të shpëtojnë pra shpirtat tanë,\* t'u jepet ndjesë fajesh, mëshirë, përdëllim.

*Dhe katër të Mujorit*

Lavdi dhe Tani

*E Mujorit (Hyjlindësore)*

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Prifti:* Mbrëmje!  
*Lexuesi:* Proqimen. Ting. Tërth. I. Psalmi 11.  
Ti, o Zot, të na ruash dhe të na mbash.  
*Varg:* Shpëtomë, o Zot, se s'mbeti asnjë oshënar.

Këndimi i Gjenezës

(1.24-2.3)

Perëndia tha: "Le të nxjerrë toka shpirt të gjallë sipas çdo gjinie, katërkëmbështa dhe zvarranikë dhe egërsirat e dheut sipas çdo gjinie". Dhe u bë kështu. Dhe Perëndia bëri egërsirat e tokës sipas çdo gjinie dhe kafshët sipas gjinisë së tyre dhe të gjithë zvarranikët e tokës sipas gjinisë së tyre. Dhe Perëndia pa se *ishin* të mira. Dhe Perëndia tha: "Le të bëjmë një njeri sipas ikonës dhe sipas ngjashmërisë sonë, dhe le të sundojnë mbi peshqit e detit dhe zogjtë e qiellit dhe kafshët dhe tërë tokën dhe tërë zvarranikët që zvarriten mbi tokë". Dhe Perëndia e bëri njeriun; sipas ikonës së Perëndisë e bëri atë, maskull dhe femër i bëri. Dhe Perëndia i bekoj duke thënë: "Shtohuni dhe shumëfishohuni dhe mbushni tokën dhe pushtojni gjithsej atë dhe sundoni mbi peshqit e detit dhe zogjtë e qiellit dhe të gjitha kafshët dhe tërë tokën dhe tërë zvarranikët që zvarriten mbi tokë". Dhe Perëndia tha: "Ja, ju dhashë çdo barishte me farë, që mbjell farë, e cila është mbi tërë tokën; dhe çdo pemë, që ka brenda vetes fryt fare që mbillet, do të jetë si ushqim për ju dhe për të gjitha egërsirat e tokës dhe për të gjithë zogjtë e qiellit dhe për çdo zvarranik që zvarritet mbi tokë, që ka jetë brenda vetes, shpirt jete, *ju dhashë* dhe çdo kashtë të njomë për ngrënie". Dhe u bë kështu. Dhe Perëndia i pa të gjitha sa bëri, dhe ja *ishin* shumë të bukura. Dhe u bë mbrëmje dhe u bë mëngjes, dita e gjashtë. Dhe u kryen



përsosmërisht qielli dhe toka dhe çdo zbukurim i tyre. Dhe Perëndia i bëri në ditën e gjashtë veprat e tij që bëri dhe pushoi plotësisht në ditën e shtatë nga të gjitha veprat e tij që bëri. Dhe Perëndia e bekoj ditën e shtatë dhe e shenjtëroi, sepse në të Perëndia pushoi krejtësisht nga të gjitha veprat e tij që kishte filluar të bënte.

Proqimën. Ting. Tërth. II. Psalm 12.

Mbikëqyr, dëgjomë, o Zot, Perëndia im.

*Varg:* Deri kur, o Zot, do të më harrosh përfundimisht?

Këndimi i Fjalëve të Urta

(kap. 2)

**O** bir, nëse, pasi ta pranosh thënien e porosisë sime, do ta fshehësh pranë vetes sate, veshi yt do të dëgjojë urtësi dhe do ta vendosësh zemrën tënde për mençuri, do ta vendosësh atë në birin tënd për urtësim. Sepse, nëse do ta thërrësësh urtësinë dhe do t'ia japësh zërin tënd mençurisë, dhe do ta kërkosh ndjeshmërinë me zë të lartë dhe, nëse do ta kërkosh atë si argjend dhe do ta hulumtosh si thesare, atëherë do ta kuptosh frikën e Zotit dhe do ta gjesh dijen e Perëndisë; sepse Zotí jep urtësi dhe nga fytyra e tij vjen njohuri dhe mençuri, dhe të suksesshmit i pasuron me shpëtim, do të mbrojë udhën e tyre që të ruajnë udhë të drejtash dhe do të ruajë udhë të atyre që janë të devotshëm ndaj tij; atëherë do të kuptosh drejtësi dhe gjykim, dhe do të arrish sukses në të gjitha drejtimet e mira; sepse, në qoftë se urtësia do të vijë në mendjen tënde, ndërsa ndjeshmëria do të duket si e bukur në shpirtin tënd, një vendim i mirë do të të ruajë dhe mendim oshënar do të të mbajë, që të të çlirojë nga udha e keqe dhe nga burri që

nuk flet asgjë të besueshme. Oh! Ata që braktisin udhë të drejta që të shkojnë në udhë errësire, ata që dëfrenë mbi të këqija dhe gëzohen mbi shtrembërim të keq; rrugët e tyre janë të shtrembra dhe të ecurit rumbullake, që të të largojnë prej udhe të drejtë dhe të të bëjnë të huaj për mendimin e drejtë. O bir, të mos të pushtojë mendim i keq që la mësim rinie dhe harroi besëlidhje hyjnore; sepse e vu-ri pranë vdekjes shtëpinë e tij dhe pranë Hadhit me të dhelindurit drejtimet e tij. Të gjithë sa ecin në të, nuk do të kthehen dhe as nuk do të arrijnë në udhë të drejta, sepse nuk kapën prej vitesh jete; sepse, nëse do të ecnin në rrugë të mira, do të gjenin rrugë të sheshta drejtësie. Të mirët do të jenë banues në dhé, dhe të patë-keqët do të mbeten në të, sepse të drejtët do të fushojnë në tokë dhe oshënarë do të mbeten në të. Udhë të pabesësh do të zhduken nga dheu, dhe të paligjët do të dëbohen nga ai.

Le të drejtohet lutja ime *dhe shërbesa e të Parashenjtëruarave që mbetet.*

*Shënim:* Nëse nuk bëhet Liturgia e të Parashenjtëruarave në ndonjë të mërkurë, atëherë në Thirrtores: jo Idhiomeli dhe Martiriku pas tij, por të 3 Thirrtores pas tyre dhe 3 të Mujorit. Lavdi dhe Tani e Mujorit. Nuk bëhet Hyrje. Leximet etj. Në Pasvargje, Idhiomeli i mbetur dhe Martiriku i mbetur. Lavdi dhe Tani një Hyjllindësor (jo Kryqhyjllindësor) në Tingullin e Pasvargjeve (gjeje në VARGËZIME DHE NDEJËSORE sipas Tingullit, në fund të librit) etj. të Mbrëmësorese së Kreshmëve.

Nëse nuk bëhet Liturgia e të Parashenjtëruarave në ndonjë të premte, atëherë në Thirrtores: 3 Martirike (të parat) të Tingullit të javës (gjeje në VARGËZIME DHE NDE-

*NJËSORE sipas Tingullit, në fund të librit) dhe 3 të Mujorit. Lavdi Nekrosime, dhe Tani Hyjlindësore Ngjallësore (gjeji po në VARGËZIME DHE NDNJËSORE). Nuk bëhet Hyrje. Leximet etj. Në Pasvargje, Idhiomeli i mbetur dhe Martiriku i mbetur (i katërti). Lavdi dhe Tani Hyjlindësor nga Okaithu, nga e premtja në Mbrëmësore sipas Tingullit të këtyre Pasvargjeve. Përlëshoret e së shtunës.*

## CITIME

1. Num. 14.19 etj.
2. Joan 10.15,17-18
3. Joan 10.28; 17.2
4. Joan 1.4.9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
5. Gal. 5.24; Kol. 3.5
6. I Petr. 4.7
7. I Petr. 2.21
8. Matth. 27.34
9. Rom. 8.6
10. Joan 19.34
11. I Mbret. [Sam.] 2.1
- 11a. I Petr. 2.24
12. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 22-26
13. Gjen. 3.1-7
14. Ligji i Dytë 4.24; Hebr. 12.29
15. Matth. 27.38; Mark 15.27; Lluk. 23.33; Joan 19.18
16. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
17. Gjen. 18.25 etj.
18. Gjen. 28.17
19. Lluk. 1.48
20. Lluk. 23.40-43
21. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
22. I Kor. 6.18
23. Ps. 118(119).120
24. Kol. 2.13-14
25. Ps. 7.12; II Tim. 4.8
26. Matth. 27.29-30; Mark 15-19
27. II Kor. 5.20
28. Matth. 28.16-18
29. Tit. 1.2; 3.7
30. Ps. 43(44).21
31. Est. 4.17z; Joel 2.17
32. Is. 58.6-7
33. II Mbret. [Sam.] 22.10; Ps. 17(18).10; 143(144).5
34. Fil. 2.7
35. Matth. 8.20; Lluk. 8.3; 9.58; II Kor. 8.9
36. Ps. 50(51).3; 68(69).17; Is. 63.15
37. III Makk. 5.27
38. III [I] Mbret. 19.8
39. IV [II] Mbret. 2.11

TË MËRKURËN E JAVËS SË PARË  
NË PASDARKËN E MADHE

*Pas Dhokologjisë së Vogël, psalet pjesa e tretë e Kanunit të Madh të shën Andreas së Kretës (me Varg "Mëshiroinë, o Perëndi, mëshiroinë" në çdo tropar; përveç dyve të fundit).*

## Ting. Tërth. II

## Ode I

*Irmosi: Vouhòs qe sgepastis*

»M'u bë ndihmës, mbrojtës, shpëtimtar, «ky është Perëndia im pra\* dhe do ta lëvdoj, «është Zoti ai\* për atin tim, do ta lartësoj «shumë, se u lavdërua plot me lavd.<sup>1</sup> (2x)

Prej rinis' i flaka porosit' e tua<sup>2</sup> dhe tërë jetën\* e kalova me dembelizëm, pasion,\* shkujdesje, ndaj të thërras ty: Qoftë në fund, shpëtomë, Shpëtimtari im.

Unë dergjem tash përpara derës sate, sado që jam plak,\* mos më hidh<sup>3</sup> në Hadh, në boshllëkun e tij,\* por si njerdashës falli fajet e mia para fundit, Shpëtimtar.

E shpenzova pasurinë tënde, o Shpëtimtar, në shturje,\* kam shkreti virtytesh të mira, kështu\* i urët<sup>4</sup> thërras: Arri, o atë i dhembshurive,<sup>5</sup> dhembshuromë pra.

Unë jam, o Shpëtimtar, ai që ra ndër kusarë, o Krisht,\* ndër mendime, nga k'to i tëri tani\* jam keq i plagosur plot me trauma, vetë ti arri<sup>6</sup> dhe më shëro.

Në fillim, një prift më pa, kaloi anës; dhe një levit pas,\* kur pa në ç'tmerr isha, i zhveshur, as ky\* s'më dha rëndësi, por eja<sup>6</sup> dhe dhembshuromë, ti që linde prej Maris'.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. Ti më jep hir dritëplotë nga kujdesja hyjnore që lart,\* që të evitoj errësir' vesesh pra\* edhe t'i këndoje me zell rrëfimet e je-





tës sate gjithë hir, Mari.

Lavdi *Triadik*

**M**biesenciale Shën Trini, të falemi në Njësi ne,\* hiq prej meje prangat e rënda<sup>6a</sup> plot tmerr\* të fajit edhe më jep mjaft lot kataniksi si e dhembshur plot me hir.

Tani *Hyjllindësor*

**O** Hyjllindëse, je shpresa, mbrojtja ti për sa të himnojnë,\* hiq prej meje prangat e rënda<sup>6a</sup> plot tmerr\* të fajit, si Zonjë e dëlirë, pranomë mua që pendohem sinqerisht.

*Ode II*

*Irmosi: Prôshe urané qe laliso*

»**K**i kujdes\* ti, o qiell, do flas<sup>7</sup> un' dhe do »himnoj Zotin Krisht\* që nga e Virgjra na »erdi brenda mishi pra. (2x)

**S**hpëtimtar,\* si Davidi rrëshqita në shturje, jam bërë pis,\*<sup>8</sup> por ti me lotët e mi më laj edhe mua.<sup>9</sup>

**N**uk kam lot,\* as pendim, kataniks, mirëpo ti si Perëndi\* ato m'i jep pra, o Shpëtimtar, plot mirësi.

**H**umba keq\* hijeshin', bukurinë e bërë qysh në fillim,\*<sup>10</sup> më parë, dergjem tani i zhveshur keq, me turp.<sup>11</sup>

**M**os ma mbyll\* derën tënde, Zot, Zot, atëherë përfundimisht;\*<sup>12</sup> për mua hape, se po pendohem drejt teje.

**Z**ot, dëgjo\* psherëtimat e shpirtit tim, shih dhe lotët si çurg\* që derdhin sytë e mi,<sup>13</sup> më ndje dhe më shpëto.

**T**i që do\* të shpëtoj më të gjithë,<sup>14</sup> o Njeri-dashës, sërish\* pors i mirë, më thirr, më prit, jam plot pendim.

*Hyjllindësor*

**P**a pushim\* përgjërohu për ne të shpëtoj më, o Virgjëresh' pa cen, Hyjllindëse;

krejt himnohesh vetëm ti.

*Irmos tjetër: Ëdhetë, idhetë oti egó  
I njëjti*

»**S**ihni ju, shihni ju, se unë jam Zot, Perëndi,\*<sup>15</sup> që hodha manën si shi<sup>16</sup> edhe »nxora qëmoti\* për popullin tim në shkretë »prej guri ujë<sup>17</sup> me vetë forcën time, me të »djathtën time pra.

«**S**ihni ju, shihni ju, se unë jam Zot, Perëndi,\*<sup>15</sup> thërret, shpirt, Zoti; ndaj dëgjo, largohu nga faji\* që bëje, kije frikë si hetues edhe gjykatës dhe si Perëndi të drejtë me fuqi.

**M**jerë! Shpirt shumëfajtor, ti me cillin Kain ngjan?\* Me k'të të parin,<sup>18</sup> a me tjetrin, Lamehun? Dhe ti\* me gurë vrave<sup>19</sup> trupin, me keqbërje; vrave dhe shpirtin përmes hoveve paranojake krejt.

**K**ot tejkalove çdokënd që ish para Ligjit, shpirt;\* me Sithin<sup>20</sup> ti nuk ngjave, s'imitove Enosin\*<sup>21</sup> dhe as Enohun në zhvendosje,<sup>22</sup> dhe as Noen,<sup>23</sup> të varfër nga jetesa e të drejtëve të shoh.

**V**etë ti hape, o shpirt, kataraktet plot inat\* të Perëndisë tënd: Si dhë i mbyte të tëra,\*<sup>24</sup> pra mishin, veprat, jetën; ndaj kështu ke mbetur përjashta arkës shpëtimtare,<sup>25</sup> por pendohu ti.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. **G**atishmërisht, me mall rende drejt Krishtit pra, pasi\* me neveri le udhën e mëparshme të fajit;\* ushqeheshe në shkretëtira të pashkelura, bëje porositi' e tij hyjnore pastër boll.

Lavdi *Triadik*

**P**ritmë, se jam plot pendim, o Trini pa kohë, mot,\* e pakrijuar; o Njësi pa ndarje, shpëtomë;\* sado fajtova, por krijimi yt jam, mos më shpërfill, kursemë; nga dëni-

mi, zjarri më çliro.

Tani *Hyllindësor*

Zonjë, hyjnënë, pa cen, ti je shpresë për sa vijm',\* përikin pranë teje, je liman për sa janë\* në dallgët e shtrëngatës; Birin tënd, Krijuesin tënd përdëllimtar, për mua lype, zbutë pra.

*Ode III*

*Irmosi: Stereón Kirie*

»Forco zemrën time, Krisht,\*<sup>26</sup> të tundur «keq,<sup>27</sup> përmbi gurin, shkëmbin,\* pra të «urhrave të tu<sup>28</sup> fort ti,\* se je Zot i vetëm dhe «i shenjtë; lavdi më ty. (2x)

Bekimin e Sithit,<sup>29</sup> shpirt\* i mjerë, s'e trashëgove; pronën\* nuk e kishe hiç të gjerë ti,\* siç e kish Jafethi<sup>30</sup> shenjt, në dheun e faljes pra.

Nga toka e fajit dil\* si nga Harani, o shpirt i mjerë,\* eja ti në tokën që gjithnjë\* rrjedh<sup>31</sup> paprishje, jet', që Abrahami kish trashëgim.<sup>32</sup>

Dëgjove, o shpirti im,\* se Abrahami lashtë la dheun\* atëror dhe emigrant u bë,\*<sup>32</sup> imito vullnetin që kish plot predispozicion.

Shën engjëjt i priti mir'\* në valanidh, në Mamvri, prandaj dhe\* trashëgoi gjahun, djaln, bir,\* sado kish kaluar patriarku mjaft pleqërin'.<sup>34</sup>

Meqë Isaakun, shpirt,\* di që ish bërë fli, holokaust,\* mistikisht te Zoti,<sup>35</sup> o i mjer',\* imito vullnetin që kish plot predispozicion.

U flak Izmaili, shpirt,\* e ke dëgjuar, si bir i sklaves,\*<sup>36</sup> ki gatishtëri edhe kujdes,\* shih të mos pësosh diçka të tillë po të kesh eps.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. Furtuna po më shtrëngon\* me dallgë shkëlqesh, prandaj shpëtomë\* dhe ti vetë

futmë që tani\* në një gjë pendimi të hy-nueshëm, o nënë.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. Ti hyrjet hyjnore lart\* tani m'i hap pra, o oshënare,\* duke sjellë ndërmjetimin tënd,\* përgjërëm me lutje tek e mira Hyllindëse.

Lavdi *Triadik*

Natyre e pafillim,\* Njësi e thjeshtë, e pakrijuar,\* në tri hipostaza të himnojm'\* dhe me bes' i falemi pushtetit tënd; na shpëto.

Tani *Hyllindësor*

Ti Birin pa kohë krejt\* të Atit, pa burrë e ke lindur,\* o Hyjnënë, brenda kohës pra,\* mrekulli e huaj: Dhe gjë, por mbete virgjëresh'.

*Ode IV*

*Irmosi: Akikoen o profitis*

»Dëgjoi për ardhjen tënde\* profeti dhe e «kapi frika, se do të lindësh\* nga e Virgjra, «edhe njerëzve në dhë\* do t'u shfaqesh ti, «do t'u tregohesh krejt,\* dhe thoshte: Zot, «dëgjimin tënd e dëgjova plot tmerr,\* dhe «kam frik';<sup>37</sup> lavdi forcës sate pra. (2x)

U ndota në trup, njollosa\* dhe shpirtin mjaft, i tëri un' jam i plagosur,\* por si mjek, Krisht, m'i shëro të dyja; Zot,\* me pendimin tim, pastroji, laji krejt\* dhe çndoti, Shpëtimtari im, dhe këto tregoji\* më të pastra se bora,<sup>38</sup> Perëndi.

Flijove për ne të gjithë,\* o Fjal', kur kry-qëzohesh, trupin dhe gjakun,\*<sup>39</sup> trupin tënd që të më rigatuash ti,\* ndërsa gjakun tënd që t'më lash dhe pastroshe;\*<sup>40</sup> e dorëzove shpirtin,<sup>41</sup> o Krisht, që të më sjellësh,\* o Jisu, te Prindi yt, Ati yt.<sup>42</sup>

I dhembshur, shpëtim punove\* në mes të dheut<sup>43</sup> që t'shpëtojmë, dhe me dashje\* ti në dru u kryqëzove<sup>39</sup> dhe kështu\* na u



hap Edeni që ish mbyllur krejt;<sup>44</sup> të sipërmet, të poshtmet, kombet mbar', pra Krijesa,\* si shpëtoi, o Zot, të falet ty.

**U** bëftë si kolimvithër\* për mua, Fjalë, gjaku që nga brinja jote\* kishte rrjedhur tok me pijen që më dha,\* më buroi ujë<sup>45</sup> ndjese dhe kështu\* do lahem me të dyja mir' kur të lyhem, do pi\* si një pije fjalën plot jet' që the.<sup>46</sup>

**E** ka brinjën tënde Kisha\* si kanë, është jetëprurëse, buroi\* për ne kroin e dyfishtë,<sup>45</sup> dituri\* edhe falje porsì një simbolizim\* të dy pra Dhiatave, së Vjetrës, së Resë bashkë,\* o Zot Shpëtimtar, na dhurove hir.

**I**zhveshur jam për martesën,<sup>47</sup> i zhveshur dhe për darkën,<sup>48</sup> dhe për nusëroren;<sup>47</sup> llamba s'kish vaj dhe u shua,<sup>49</sup> dhe m'u mbyll\* dhoma nusërore,<sup>12</sup> sepse filija gjum';<sup>50</sup> mbaroi darka edhe mua më hodhën jashtë,\* si m'i lidhën duart dhe këmbët tok.<sup>51</sup>

#### Lavdi *Triadik*

**P**a ndarje në esencë,\* pa ngatërrim personash të theologoj k'shtu,\* një Hyjni, Zot trinisor; tok mbretëron\* edhe je i bashkëfronshëm; të thërras\* të madhen këngë që himnohet në më të lartat,\* edhe trefish<sup>52</sup> ty të këndoju unë.

#### Tani *Hyjindësor*

**D**he lind, dhe je virgjëreshë,\* e virgjër në natyrë mbetesh me të dyja,\* Biri përsërit pra ligjin natyror,\* mitra ka një shtatzëni unike krejt,\* se mposhtet rendi natyror ku do Perëndia,\* meqë bën ai sa do<sup>53</sup> për një çast.

#### *Ode V*

##### *Irmosi: Ek niktós orthrizonta*

»Po mëngoj menatë, njerdashës Zot,\* lutem, ndriçomë ti,\* udhëhiq më në drejt-tim,\* në urdhrat e tu mua,<sup>54</sup> mësomë që

»përherë\* ta bëj dëshirën tënde.<sup>54a</sup> (2x)

**M**eqë kam logjik' të zhytur si në det,\* në mend i rëndë jam\* si në shpirt edhe në trup,\* Janisi jam, Jamvrisi<sup>55</sup> për faraonin plot vrer,\* por ti, o Zot, ndihmomë.

**E** përzjeva mendjen tok me baltë un',\* të përgjërohem pra\* përmes lotëve të mi:\* Jam qyq, më laj si me dush,\* stolin' e shpirtit tim, Zot,\* ma zbardh porsì dëborë.<sup>38</sup>

**P**o të hulumtoj veprimet që kam bër',\* o Shpëtimtar, do shoh\* unë se krejt njerëzit\* në faj i tejkalova,\* se mëkatova me shpirt,\* me dije, jo pa dije.

**T**ë të vijë keq, Zot, për krijimin tënd,\* ndaj më kurse,<sup>56</sup> më fal,\* mëkatova; vetëm ti\* je në natyr' i pastër,\* veç teje s'ka tjetër pra\* pa njollë dhe pa ndotje.<sup>57</sup>

**U** formove, Shpëtimtar, si ne<sup>58</sup> për ne;\* si Zot ke bër' çudi\* dhe shërove lebrën ti,<sup>59</sup> forcove paralizën\*<sup>60</sup> dhe ndale hemorragjin'\* e gruas që të preku.<sup>61</sup>

O oshënore e Perëndisë, ndërmjeto për ne. **K**ur kalove rrymën e Jordanit ti,\* prehje pa dhimbje krejt\* në mish gjete, meqë pra\* shmange kënaqësi, epush;\* shpëtona ne nga ato\* me lutjen tënde, nënë.

#### Lavdi *Triadik*

**T**ë lëvdojmë, o Trini, një Perëndi,\* At', Bir, Shpirt; je i shenjt',\* je i shenjtë, je i shenjt',<sup>52</sup> Njësi e thjeshtë, Zoti,\* esenca që përgjithnjë\* të falemi me besë.

#### Tani *Hyjindësor*

**N**ënë virgjëresh', pa prishje dhe pa burr'\* prej teje brumin tim\* e ka veshur Zoti im,\* Bërësi i çdo jete;<sup>62</sup> e lidhi me veten krejt\* natyrën njerëzore.

#### *Ode VI*

##### *Irmosi: Evóisa en oli kardhia mu*

»Nga zemra thell\* drejt Zotit, të dhembshurit,\* thirra dhe më dëgjo ky\* teksta fare poshtë, në Hadh pra, isha unë\* dhe e ngriti lart\* jetën time prej pri-shjes.<sup>63</sup> (2x)

Bëj rezistenc\*,\* lufto si luftoi fort\* Jisui Amalikun,\*<sup>64</sup> kundërshtoji veset në mish, gabaonitët,\* çdo mendim dinak\*<sup>65</sup> dhe fito përgjithmonë.

Si Arka, shpirt,\* më parë, ti ta kalosh\* natyrën që kalon shpejt, pra\* rrjedh,<sup>66</sup> të kohës; Zoti kështu të urdhëron ty,\* trashëgoje drejt\* këtë dhë të premtimit.<sup>67</sup>

Siç, Shpëtimtar,\* shën Petron kur thirri fort:\* "Arri, shpëtom!", e ndihe krejt,\*<sup>68</sup> më çliro nga bisha, tendose dorën tënde,\* jashtë nxirrme ti\* që nga fundi i fajit.

Të di liman\* të qetë, o Zot, o Zot,\* arri të më çlirosh, o Krisht,\* që nga fundi ku nuk arrin gjë, nga mëkati\* që sjell dëshpërim\* dhe që ka fund të tmerrshëm.

#### Lavdi *Triadik*

«Triadhë jam,\* e thjeshtë, nuk ndahem hiç,\* por ndahem në Persona un',\* jam Njësi, bashkohem sipas natyrës», thotë\* Ati, Biri tok\* edhe Shpirti Hyjnor, Zot.

#### Tani *Hyjlindësor*

Na lindi Zot\* me pamjen ton', mu si ne\*<sup>68</sup> barku yt, o Hyjlindëse;\* lype, ndërmjeto tek ai që, si Krijues\* i të gjithave,\*<sup>69</sup> të na nxjerrë të drejtë.

#### *Kontaqi Ting. Tërth. II* (psalet ngadalë)

O shpirti im, o shpirt im, ngrihu, pse fle gjumë? Po afrohet fundi dhe ke për t'u trazuar; ndaj zgjohu që të të kursejë ty Perëndia, Zoti Krisht, që ndodhet kudo dhe i mbush të gjitha.<sup>70</sup>

#### Ode VII

##### *Irmosi: Imärtomen, inomisamen*

»Fajtuam ne,\* mëkatuam ne,\* para te-  
»je bëm' padrejtësi ne,\* s'i ruajtëm ne,  
»s'i zbatuam ne porosit' e tua,<sup>71</sup> ne të pa-  
»mendët, o Zot,\* por mos na dorëzo më në  
»fund ne,<sup>72</sup> o Perëndi i etërve, pra.<sup>73</sup> (2x)

Stivove, shpirt,\* me gjakftotësi\* krimet  
krejt që Manasiu bëri,\* i kreve veset mu si  
tempuj plot neveri, i shtove idhujt, ledhin  
shpirtëror;\*<sup>74</sup> ngrohtësisht ti pendimin e  
tij<sup>75</sup> zilepse dhe përfito kataniks.

Në neveri\* – mjerë! – shpirti im,\* ke zile-  
psur Ahaavin,<sup>76</sup> meqë\* u ktheve në bodrum  
me njolla mishi dhe enë fort të turpshme  
pasionesh plot faj;\* Perëndisë rrëfeja të  
gjitha shkeljet,<sup>77</sup> prej thellësis' psherëti.

U mbyll për ty,\* o shpirt, qielli;\* të pu-  
shtoi etja ty për Zotin,\* kur nuk iu binde  
fjalëve që tha shën Ilia, ky thesviti si  
mbreti dikur,\* Ahaavi pra;<sup>78</sup> ngajji krejt  
Serafthisë, ushqe ti shpirt profetik.<sup>79</sup>

Ilia shenjt\* lasht' i bëri shkumb\* dy her'  
pesëdhjetë të dërguar\* prej Jezabelës,<sup>80</sup>  
kur krejt i shfarosi të turpshmit priftërinj;  
ky qortonte kështu\* Ahaavin,<sup>81</sup> o shpirt,  
larg nga imitimi i tyre dhe merr fuqi.

#### Lavdi *Triadik*

«Trini e thjesht',\* e pandarë krejt,\* je Njësi  
e bashkëqenshme, drita\* të shenjta, dritë, –  
tri të shenjta dhe një e shenjtë», Perëndia  
himnohet kështu.\* Por himnoje, lëvdoje,  
shpirt, jetën, jetët, pra Perëndin' e çdokujt.

#### Tani *Hyjlindësor*

Të falemi,\* të himnojme ne,\* të bekojmë,  
Hyjnënë, se ti\* ke lindur një nga Shën  
Triadha krejt e pandarë, Perëndinë, një Bir  
dhe Zot pra;\* dhe ti vetë për ne tokësorët  
hape nur qielloret me gëz.



## Ode VIII

Irmosi: *On stratie uranôn*

»E lavdërojn\* Zotin lart ushtritë qiellore, »e kanë frik' Keruvimet tok\* me Serafi- »met; çdo frymë, çdo krijim, bekoje,\* për- »mbilartësoje, himnoje në gjith' jetët.<sup>82</sup> (2x)

O Shpëtimtar\* dhe gjyqtar i drejtë,<sup>83</sup> më- shiromë, çlirom' nga çdo zjarr dhe kërcë- nim\* që kam për të pësuar në gjyq un' drejtësisht krejt,\* falmë para fundit,<sup>84</sup> do kem virtyt, pendim tok.

Ty të thërras\* si Kusari "Më kujto!";<sup>85</sup> si shën Petro hidhur po qaj;<sup>86</sup> "Më fall" thërras\* si Doganieri;<sup>87</sup> kam, Shpëtimtar, lot Prostitute;\*<sup>88</sup> qarjen Kananease pri- te,<sup>89</sup> prit dhe timen.

O Shpëtimtar,\* kalbësin' e shpirtit tim të ulët shëroje ti, o i vetmi mjek;\* vëre kompresën, vajin me verën,<sup>90</sup> veprat, aktet\* e pendimit,<sup>91</sup> lotët me kataniks përbrenda.

Po imitoj\* Kananeasen, thërras drejt Birit davidian "Mëshiomë, ti!";<sup>89</sup> cepin e veshjes mu si Gjakkrrdhësja e prek pak,\*<sup>61</sup> qaj porsí Maria dhe Marta për Lazarin.<sup>92</sup>

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin  
e Shenjtë, Zotin

## Triadik

At' pa fillim,\* Bir i bashkëpafillim, i miri Ngushëllimtar, Shpirt i drejtë ti,\* prindi i Fjalës, Fjala e Atit pa fillim tok,\* Shpirt i gjall', krijues, Trini, Njësi, shpëtomë.

Tani *Hyllindësor*

O e pacen,\* si me ngjyrë purpuri manteli mendor dhe perandorak, u thur\* përbrenda barkut tënd mishi i Emanuelit,\* të nderojmë ty, o Hyllindëse, vërtet pra.

## Ode IX

Irmosi: *Asporu silipseos*

»Pa prishje në bark ka nxënë nënë pa

»burr', lindja s'ka shpjegim, se zënia\* ish »pa farë, Perëndia lind dhe natyrat ky\* i »rinovon; prandaj ne,\* të gjithë brezat,<sup>93</sup> »orthodhoksisht\* ty të madhërojmë plot »mall\* si hijnuse, nënë pa qortim. (2x)

Shëronte të çalët<sup>94</sup> dhe ungjillëzonte te të varfrit,<sup>95</sup> dhe shëndoshte\* të sëmuret,<sup>96</sup> dhe me doganierët seç hante tok\* Fjala Krisht, bisedonte\* me mëkatarët;<sup>97</sup> me prekje, dor',\* ktheu shpirtin e zhvendosur\* të së bijës së Jairit pra.<sup>98</sup>

Një grua Lavire urtësohej,<sup>99</sup> Doganieri seç shpëtohej, ndërsa\* Fariseu që me mburrje fliste, dënohej keq;\* një thoshte "Dhembshuromë!";\* një tjetër "Më përdë- lle!"; por ky\* veç krenohej dhe bërtiste\* "Zot, faleminderit!", fjal' pa mend.<sup>100</sup>

Zakheu qe doganier, por po shpëtohej;<sup>101</sup> ishte farise Simoni,\* por gabonte;<sup>102</sup> Prostituta ndjesën e fajeve\* e merrte prej Jísuit\*<sup>99</sup> që ka fuqi që t'i falë krejt\* shke- ljet,<sup>103</sup> të dhurojë ndjesë;\* shpirt, nxito ta imitosh gruan.

Nuk kishe zili, o shpirt mjëran, Laviren që, si mori miro,\* alabastër, leu tok me lot këmbët e Zotit,\* me flokët mir' i fshiu,\*<sup>88</sup> teksa ai griste për atë\* dorëshkrimin që kish krimet\* e mëparshme,<sup>104</sup> që pat me tepri.

E di si u nëmën, shpirt, qytetet te të ci- lat dha Ungjillin Krishti,\* ki frik' nga ky shembull, që të mos bëhesh si ato;\* Zoti tha: Ishin njësoj\* k'to me Sodomën, ngja- nin me të,\* edhe i dënoi rëndë,\* që të zbrisnin gjer në Hadh këto.<sup>105</sup>

Të mos shfaqesh më i keq se Kananea- sja prej dëshpërimit, o shpirt;\* more vesh për besën që kish, iu dha shërimi krejt\* vajzës me fjalë Zoti;\* nga thellësia e zemrës ti\* si ajo thirr fort drejt Krishtit.\*

Biri i Davidit, më shpëto.<sup>106</sup>

O shenjt i Perëndisë, ndërmyeto për ne.

**A**ndrea i respektuar, episkop i Kretës dhe profet i pasur\* i së Resë Dhiatë, pa pushim lutju Zotit Krisht,\* pra Perëndisë tonë,\* që të çlirohen nga çdo shtrengim\* sa me mençuri dhe besë\* psalin odet e kanunit tënd.

### Lavdi *Triadik*

**M**e bes' ta lëvdojmë Atin, ta mbilartësojmë Birin, si dhe Shpirtin,\* le t'i falemi Triadhës pa ndarje dhe Njesis\* sipas esencës, drita\* dhe dritat, jeta dhe jetët është,\* që ndriçon dhe ia jep jetën\* botës mbarë, anëmbanë pra.

### Tani *Hyjlindësor*

**Q**ytetin tënd ruaje ti, o e fortëdëlirë dhe Hyjnënë Vajzë;\* mbretëron në ty me besë, në ty forcohet pra,\* fiton nëpërmjet teje\* edhe mbi çdo ngasje triumfon\* dhe armiqtë i plaçkon ky,\* mir' i qeveris nënshitetasit.

*Pastaj të dyja koret psalin Irmosin:*

*Asporu silípseos*

**P**a prishje në bark

*Dhe shërbesa e Pasdarkës së Madhe që mbetet.*

### CITIME

1. Eks. 15.1-2; Sirak 51.2
- 1a. Ligji i Dytë 21.23; Gal.3.13
2. Jer. 3.25; 39(32).30
3. Ps. 70(71).9
4. Lluk. 15.13-14
5. II Kor. 1.3
6. Lluk. 10.30-34
- 6a. Fja. Urt. 5.22
7. Ligji i Dytë 32.1
8. II Mbret. [Sam.] 11.2-17
9. Ps. 6.7
10. Gjen. 1.31
11. Gjen. 3.7
12. Matth. 25.10
13. Jov 16.20
14. I Tim. 2.4
15. Ligji i Dytë 32.39

16. Ps. 77(78).24
17. Eks. 17.6 etj.
18. Gjen. 4.8; I Joan 3.12
19. Gjen. 4.23
20. Gjen. 4.25; Sirak 49.16(19)
21. Gjen. 4.26
22. Gjen. 5.24; Hebr. 11.5
23. Gjen. 5.29; 6.22; Hebr. 11.7; II Petr. 2.5
24. Gjen. 7.11-20; Matth. 24.38-39; Lluk. 17.27; I Petr. 3.20
25. Gjen. 7.23
26. I Mbret. [Sam.] 2.1
27. Sirak 48.19
28. Matth. 7.24-25; Lluk. 6.48
29. Gjen. 9.26
30. Gjen. 9.27
31. Eks. 3.8 etj.
32. Gjen. 12.1-7; Vep. 7.3
33. Gjen. 18.1-8
34. Gjen. 18.10-11; 21.1
35. Gjen. 22.1-10; Hebr. 11.17; Jak. 2.21
36. Gjen. 21.10-14; Gal. 4.30
37. Abak. 3.1-2
38. Ps. 50(51).9
39. Joan 10.15,17-18
40. I Joan 1.7
41. Lluk. 23.46
42. Rom. 5.2; Ef. 2.18; 3.12
43. Ps. 73(74).12
44. Gjen. 3.23-24
45. Joan 19.34
46. Joan 6.63,68
47. Matth. 22.10-12
48. Lluk. 14.16-24
49. Matth. 25.8
50. Matth. 25.5
51. Matth. 22.13
52. Is. 6.3; Apok. 4.8
53. Ps. 134(135).6
54. Is. 26.9
- 54a. Matth. 7.21
55. II Tim. 3.8
56. Neh. 13.22
57. Jov 14.4; Fja. Urt. 20.9
58. Fil. 2.7-8
59. Matth. 11.5; Lluk. 7.22
60. Matth. 4.24
61. Matth. 9.20-22; Lluk. 8.43-47
62. Hebr. 1.2
63. Jona 2.3-7
64. Eks. 17.13
65. Jis. N. 9.3-22
66. Jis. N. 3.17
67. Num. 27.12; Ligji i Dytë 32.49
68. Matth. 14.29-31
69. Sirak 24.8
70. Ef. 1.23
71. III [I] Mbret. 8.47; II Kron. 6.37; Ps. 105(106).6; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 5-6; Dan. 9.5,15
72. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 10
73. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28



74. IV [II] Mbret. 21.2-18; II Kron. 33.2-9  
 75. II Kron. 33.12-16  
 76. III [I] Mbret. 16.30-33  
 77. Is. 43.26  
 78. III [I] Mbret. 17.1-7; Lluk. 4.25; Jak. 5.17  
 79. III [I] Mbret. 17.13-16  
 80. IV [II] Mbret. 1.9-12  
 81. III [I] Mbret. 18.17-40  
 82. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34  
 83. Ps. 7.12; II Tim. 4.8  
 84. Ps. 38(39).14  
 85. Lluk. 23.42  
 86. Matth. 26.75; Lluk. 22.62  
 87. Lluk. 18.13  
 88. Lluk. 7.37-38  
 89. Matth. 15.22; Mark 7.25-26  
 90. Lluk. 10.34  
 91. Vep. 26.20  
 92. Joam 11.19,31-33  
 93. Lluk. 1.48  
 94. Matth. 11.5; 15.30-31; Lluk. 7.22  
 95. Is. 61.1; Lluk. 4.18  
 96. Matth. 4.23-24; Mark 1.34; Lluk. 4.40; 6.17; 7.21  
 97. Lluk. 5.30  
 98. Matth. 9.25; Mark 5.41; Lluk. 8.54-55  
 99. Lluk. 7.47-48  
 100. Lluk. 18.10-14  
 101. Lluk. 19.1-9  
 102. Lluk. 7.37-46  
 103. Matth. 9.6; Mark 2.10; Lluk. 5.24  
 104. Kol. 2.13-14  
 105. Matth. 11.2-24; Lluk. 10.12-15  
 106. Matth. 15.22-28



## TË ENJTEN E JAVËS SË PARË NË PASDARKËN E MADHË

*Pas Dhoksologjisë së Vogël, pσαlet pjesa e katërt e Kanunit të Madh të shën Andreas së Kretës (me Varg "Mëshiomë, o Perëndi, mëshiomë" në çdo tropar, përveç dyve të fundit).*

*Ting. Tërth. II*

*Ode I*

*Irmosi: Voithós qe sqepastís*

»M'u bë ndihmës, mbrojtës, shpëtimtar,  
 »ky është Perëndia im pra\* dhe do ta lëvdoj,  
 »është Zoti ai\* për atin tim, do ta lartësoj  
 »shumë, se u lavdërua plot me lavd.<sup>1</sup> (2x)

**N**griji prangat fort të rënda të mëkatit<sup>2</sup>

nga unë, o Krisht,\* qengj i Perëndisë, që  
 ngre çdo mëkat\* të njerëzve mbarë<sup>3</sup> edhe  
 lot kataniksi si i dhembshur ti më jep.

**N**griji prangat fort të rënda të mëkatit,<sup>2</sup>  
 Jisu, nga unë,\* bie para teje, fajtova te  
 ti;\* më fal, të të vijë keq, pendim kam,  
 ndaj si i dhembshur, Perëndi, pritmë.

**Z**ot, në gjyq mos hyr me mua,<sup>4</sup> mos më  
 sill krejt sa duhej t'bëja\* dhe për hovet  
 mos më kërko llogari;\* i tërëfuqishëm,  
 m'i shpërfill si i dhembshur fajet tmerr  
 dhe më shpëto.

**N**griji prangat fort të rënda të mëkatit<sup>2</sup>  
 nga unë, o Krisht,\* koha e pendimit tash  
 është, kështu\* te ti rend, o Bërësi in, lot  
 kataniksi si i dhembshur pra më jep.

**N**ë mëkat shpenzova pasurin' e shpirtit,  
 jam i shkretuar\* prej virtytish bese, kështu  
 kam uri;\*<sup>5</sup> thërras: Ti ari dhe dhembshu-  
 romë, o dhënësi i përdëllimit, Zot.

O oshënore e Perëndisë, ndërmjeto për ne.  
**K**ur u binde ti ndaj ligjeve hyjnore të  
 Shpëtimtarit,\* hovet fort të vullshme të  
 epshit i le;\* si shkove te Krishti, krejt vir-  
 tytet i bëre me kushtim, porsi një pra.

*Lavdi Triadik*

**M**biesenciale Shën Trini, të falemi në  
 Njësi ne,\* hiq prej meje prangat e rënda<sup>2</sup>  
 plot tmerr\* të fajit edhe më jep mjaft lot  
 kataniksi si e dhembshur plot me hir.

*Tani Hyjllindësor*

**O** Hyjllindëse, je shpresa, mbrojtja ti për  
 sa të himnojnë,\* hiq prej meje prangat  
 e rënda<sup>2</sup> plot tmerr\* të fajit, si Zonjë e  
 dëlirë, pranomë mua që pendohem sin-  
 qerisht.

*Ode II*

*Irmosi: Ídhetë, ídhetë otí egó*

*I njëjti*

»Shihni ju, shihni ju, se unë jam Zot Pe-  
rëndi\*<sup>6</sup> që hodha manën si shi<sup>7</sup> edhe  
»nxora qëmoti\* për popullin tim në shkreti  
»prej guri ujë<sup>8</sup> me forcën time vetë, me të  
»djathtën time pra. (2x)

Duke vajtuar Lamehu keq: «Vrava një të  
ri\* për trauma për veten dhe një burrë për  
plagë»,<sup>9</sup> thërriste ky; por ti nuk trembesh  
që u ndote në mish dhe u njollose mjaft  
në mendje, shpirti im.

Shpirt, keq mendove të ngrije një pirq,  
të bëje ti\* për dëshirimet një fortifikatë,  
në Zoti\* drejt nuk do ta ndërlikte krejt  
mendimin<sup>10</sup> tënd dhe dredhit\* e tua nuk  
do t'i rrafshonte krejtësisht.

Oh, si zilepsa Lamehun, pra vrasësin  
dikur!\* Si një të ri e vrava shpirtin tim,  
mendjen time\* si burrë<sup>9</sup> edhe si Kaini vrasës,  
trupin, vëllanë<sup>11</sup> dhe me epshet, dhe  
me vrulllet plot mani.

Zoti, qëmoti prej Zotit kish hedhur zjarr  
si shi,<sup>12</sup> dhe shturjen e paudhë të Sodomës<sup>13</sup>  
e dogji;\* por zjarrin e Gjehenës<sup>14</sup> ti  
e ndeze, o shpirt, në të ke për t'u djegur  
me tmerri dhe hidhërim.

Ja pra shigjetat që hodhi armiku, jam  
krejt plagë;\* në shpirt, në trup më shpuan;  
ndaj ja traumat, plagët\* dhe sakatimet  
po thërrasin, deklarojnë goditjet e pasio-  
neve që bëra me vullnet.

Ooshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne.  
Drejt Perëndisë së dhembshur i shtrive  
duart ti,\* Mari, kur ishe zhytur në avushë  
të keqe;\* ashtu si Petros, dorë, ndihm' të  
dha,<sup>15</sup> pra meqë patjetër e kërkonte kthi-  
min tënd, shpëtimin tënd.<sup>16</sup>

Lavdi *Triadik*

Pritmë se jam plot pendim, o Trini pa

kohë, mot,\* e pakrijuar; o Njësi pa ndarje,  
shpëtomë;\* sado fajtova, por krijimi yt  
jam, mos më shpërfill, kursemë; nga  
dënimi, zjarri më çliro.

Tani *Hyllindësor*

Zonjë, hyjnënë, pa cen, ti je shpresë për  
sa vijn',\* përikin pranë teje, je liman për  
sa janë\* në dallgët e shtrëngatës; Birin  
tënd, Krijuesin tënd përdëllimtar, për  
mua lype, zbutë pra.

*Ode III*

*Imrosi: Steréson Kirie*

»Forco zemrën time, Krisht,\*<sup>17</sup> të tundur  
»keq,<sup>18</sup> përmbi gurin, shkëmbin,\* pra të  
»urdhrave të tu<sup>19</sup> fort ti,\* se je Zot i vetëm  
»dhe i shenjtë; lavdi më ty. (2x)

Shpirt, ngjan me Agarën ti,\* pra egjipti-  
anen e lashtë, meqë\* në vullnet u skilla-  
vërove<sup>20</sup> keq\* dhe e linde arrogancën si  
Ismail<sup>21</sup> të ri.

E di që po shfaqej, shpirt,\* nga toka drejt  
qiellit lart shkalla\* e Jakovit,<sup>22</sup> pse s'e  
kishe ti\* porsì bazë të sigurt mjaft edhe  
të fort' besën?

Ndër njerëz, shpirt, imito\* ikonizimin e  
Krishtit, Zotit,\* brenda jetës tokësore, pra\*  
të veçuarin mbret si dhe pfitin e Perëndis'.<sup>23</sup>

Imjeri shpirt, psherëti\* dhe kthehu para se  
të mbarojë\* jeta, panairi tash, këtu,\* para  
se ta mbyllë Zoti derën e dasmës lart.<sup>24</sup>

Kolon' kripte, shpirti im,\* ti mos u bëj  
dhe as mos u kthe pas,\* frikësohu ti nga  
shembulli\* i Sodomës,<sup>25</sup> mirëpo shpëto  
në Sigorin lart.<sup>26</sup>

O Zot njeridashës krejt,\* mos e hidh  
poshtë keq përgjërimin\* e himnuesve të  
tu, ki dhembk',\* jepu falje meqë e kërk-  
ojnë me besë plot.



Lavdi *Triadik*

Natyrë e pafillim,\* Njësi e thjeshtë, e pakrijuar,\* në tri hipostaza të himnojm\* dhe me bes' i falemi pushtetit tënd; na shpëto.

Tani *Hyjlindësor*

Ti Birin pa kohë krejt\* të Atit, pa burrë e ke lindur,\* o Hyjnënë, brenda kohës pra,\* mrekulli e huaj: Dhe gjí, por mbete virgjëresh'.

*Ode IV**Irmosi: Akikoen o profitis*

»Dëgjoji për ardhjen tënde\* profeti dhe e «kapi frika, se do të lindësh\* nga e Virgjira, «edhe njerëzve në dhë\* do t'u shfaqesh ti, «do t'u tregohesh krejt,\* dhe thoshte: Zot, «dëgjimin tënd e dëgjova plot tmerr,\* dhe «kam frik';<sup>27</sup> lavdi forcës sate pra. (2x)

Zot, koha e jetës sime\* e shkurtër është,<sup>28</sup> plot dinakëri dhe dhimbje;\* por më prit, Zot, me pendim dhe më rithirr\* në ndërgjegjësim, që të mos bëhem un'\* ushqim as pronë e të huajit, Shpëtimtar Krisht;\* ndaj më dhembshuro vetë ti, Jisu.

I drejtë krejt një njeri ish,\* dhe vishej me purpur, në grad' mbret me kurorë,\* me kope, me pasuri të bollshme tok\* dhe me shumë prona; mirëpo u bë\* i varfër befasisht dhe humbi lavdin' e tërë\* si dhe mbretërinë vërtet mjerisht.<sup>29</sup>

Në ky që i drejtë ishte,\* i paqortueshëm më shumë' se kushdo tjetër\*<sup>30</sup> dhe nga kurthet, sprovat e mashtruesit\* nuk shpëtoi,<sup>31</sup> ti që je mik faji keq\* mjeran shpirt, çfarë do të bësh kur të ndodhë ngasje,\* kur gjë që s'e pret do të sulet fort?

Tash jam arrogant në zemër,\* kot, humbazi, fodull në fjalë dhe në mendje,\* por me Fariseun, Zot, mos më dëno,\* për më tepër ma dhuro përlulësin\* e Tagrambledhësit,<sup>32</sup> gjykatës i drejt',<sup>33</sup> i saktë\*

dhe i dhembshur, më numëro me të.

E di qart' se mëkatova,\* i dhembshur, poshtërova enën time, mishin,\*<sup>34</sup> por më prit, Zot, me pendim dhe më rithirr\* në ndërgjegjësim, që të mos bëhem un'\* ushqim as pronë e të huajit, Shpëtimtar Krisht;\* ndaj më dhembshuro vetë ti, Jisu.

E bëra krejt veten idhull,\* sepse njolllosa rëndë me pasione shpirtin,\* por më prit, Zot, me pendim dhe më rithirr\* në ndërgjegjësim, që të mos bëhem un'\* ushqim as pronë e të huajit, Shpëtimtar Krisht;\* ndaj më dhembshuro vetë ti, Jisu.

S'u binda, s'dëgjova zërin\* as Shkrimin tënd që ti, Ligjvënës, na dhe neve,\* por më prit, Zot, me pendim dhe më rithirr\* në ndërgjegjësim, që të mos bëhem un'\* ushqim as pronë e të huajit, Shpëtimtar Krisht;\* ndaj më dhembshuro vetë ti, Jisu.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. S'u kape kur kishe rënë\* në thellësi veprimesh pa vend, veçse rende\* me mendim të mirë shumë lart, Mari,\* drejtas kulmit të virtutit qartësisht\* përmes praktikës së çuditshme dhe e habite,\* shtange dhe natyrën e engjëjve.

Lavdi *Triadik*

Pa ndarje në esencë,\* pa ngatërrim personash të teologoj k'shtu,\* një Hyjni, Zot trinisor; tok mbretëron\* edhe je i bashkëfronshëm; të thërras\* të madhen këngë që himnohet në më të lartat,\* edhe trefish,<sup>35</sup> ty të këndoju unë.

Tani *Hyjlindësor*

Dhe lind, dhe je virgjëreshë,\* e virgjër në natyrë mbetesh me të dyja,\* Biri përsërit pra ligjin natyror,\* mitra ka një shtatzëni unike krejt,\* se mposhtet rendi natyror ku do Perëndia,\* meqë bën ai sa do<sup>36</sup> për

një çast.

### Ode V

*Irmosi: Ek niktós orthrizonta*

»Po mëngoj menatë, njerdashës Zot,\*  
»lutem, ndriçomë ti,\* udhëhiqme në drej-  
»tim,\* në urdhrat e tu mua,\*<sup>37</sup> mësomë që  
»përherë\* ta bëj dëshirën tënde.<sup>38</sup> (2x)

O shpirt, imitoje të Kërrusurën\* dhe  
gjunjëzohu ti\* ndaj Jisuit, si t'i vish,\* që  
të të rimëkëmbë,\*<sup>39</sup> të ecësh drejt në çdo  
udh\* të Zotit, Perëndisë.

Ti, meqë je pus i thellë, Zoti im,\* m'i nxirr  
dhe rrjedhat plot,\* nga damari yt<sup>40</sup> hyjnor\*  
pa cen; buron, rrjedh jetë,\* të pi, të mos  
kem rreshk un',\* porsì Samaritania.<sup>41</sup>

Mua pra m'u bëfshin lotët Siloam,\* o  
Krisht Zot, që t'i laj\* bebet zemërore  
krejt,\* që të të shoh<sup>42</sup> ty që je\* shkëlqimi,  
o Shpëtimtar,\* dhe drita para jetës.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne.

Me një dashuri pa krahasim, Mari,\* de-  
she t'i faleshe\* drurit, Kryqit, denjësisht,\*  
realizove mallin;\* dhe mua më denjëso\*  
që të arrij në lavd lart.

### Lavdi Triadik

Të lëndojmë, o Trini, një Perëndi,\* At',  
Bir, Shpirt; je i shenjt',\* je i shenjtë, je i  
shenjt',\*<sup>35</sup> Njësi e thjeshtë, Zoti,\* esenca  
që përgjithnjë\* të falemi me besë.

### Tani Hyllindësor

Nënë virgjëresh',\* pa prishje dhe pa  
burr'\* prej teje brumin tim\* e ka veshur  
Zoti im,\* Bërësi i çdo jete;\*<sup>43</sup> e lidhi me  
veten krejt\* natyrën njerëzore.

### Ode VI

*Irmosi: Evóisa en oli kardhia mu*

»Nga zemra thell'\* drejt Zotit, të  
»dhembshurit,\* thirra dhe më dëgjo ky\*  
»teksta fare poshtë, në Hadh pra, isha

»unë\* dhe e ngriti lart\* jetën time prej pri-  
»shjes.<sup>44</sup> (2x)

O Shpëtimtar,\* o Fjalë Zot, unë jam\*  
drahamia mbretërore pra\* që dikur kish  
humbur, por ndiz si llamb<sup>45</sup> Prodhromin,\*<sup>46</sup>  
më kërkto, më gjej,\*<sup>45</sup> jam ikona që bëre.<sup>47</sup>

Bëj rezistenc',\* lufto siç luftoi fort\* Jisui  
Amalikun,\*<sup>48</sup> kundërshtoji veset në mish,  
gabaonitët,\* çdo mendim dinak\*<sup>49</sup> dhe fito  
përgjithmonë.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne.

Gjithnjë, Mari,\* ti nxirrje çurg lotësh lum\*  
të shuaje zjarr, flakërim\* vesesh brenda  
shpirtit që digjej; edhe mua,\* shërbëtorit  
tënd,\* jepm' lot, hirin e tyre.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne.

Fitove ti,\* o nën', papasionshmëri\* mbi-  
qiellore, si mbi dhë\* ekstremisht jetove;  
ndaj për sa të himnojnë,\* lyp dhe ndër-  
mjeto\* të shpëtojnë nga veset.

### Lavdi Triadik

»Triadhë jam,\* e thjeshtë, nuk ndahem  
hiç,\* por ndahem në Persona un',\* jam  
Njësi, bashkohem sipas natyrës", thotë\*  
Ati, Biri tok\* edhe Shpirti Hyjnor, Zot.

### Tani Hyllindësor

Na lindi Zot\* me pamjen ton', mu si ne\*<sup>50</sup>  
barku yt, o Hyllindëse;\* lype, ndërmjeto  
tek ai, që, si Krijues\* i të gjithave,\*<sup>51</sup> të  
na nxjerrë të drejtë.

### Kontaqi Ting. Tërth. II

(psalet ngadalë)

O shpirti im, o shpirt im, ngrihu, pse fle  
gjumë? Po afrohet fundi dhe ke për t'u  
trazuar; ndaj zgjohu që të të kursejë ty  
Perëndia, Zoti Krisht, që ndodhet kudo  
dhe i mbush të gjitha.<sup>52</sup>

### Ode VII



*Irmosi: Imártomen, inomísamen*

»Fajtuam ne,\* mëkatuam ne,\* para te-  
»je bëm' padrejtësi ne,\* s'i ruajtëm ne,  
»s'i zbatuam ne porosit' e tua,<sup>53</sup> ne të pa-  
»mendët, o Zot,\* por mos na dorëzo më në  
»fund ne,<sup>54</sup> o Perëndi i etërve, pra.<sup>55</sup> (2x)

Mbaruan, shpirt,\* ditët që ti ke\* mu si  
ëndrra e atij që zgjohet;\*<sup>56</sup> lotoj si Ezekia  
përmbi shtratin tim të më shtohen dhe ca  
vjet jetë. Por kush\* do qëndrojë bri meje  
si Isaia,<sup>57</sup> veç Zotit tim, të çdokujt?

Të ulem ty\* dhe si lot të sjell\* fjalën time;  
mëkatova unë\* jo si Lavirja<sup>58</sup> dhe fajtova,  
Zot, si askush pra tjetër mbi dhe, por më  
dhembshuro\* dhe më thirr përsëri, meqë  
jam krijesa që bëre, o Shpëtimtar.

Kam prishur keq\* urdhërimin tënd,\* dhe  
ikonën tënde<sup>47</sup> e kam nxirë;\* e tërë bukuria<sup>59</sup>  
vdiq dhe llamba u shua<sup>60</sup> përmes veseve, o  
Shpëtimtar;\* por, siç psalte Davidi, më jep  
galdim ti, o Zot,<sup>61</sup> dhe më dhembshuro.

Pendohu shpejt,\* kthehu dhe zbulo\* çka  
i ke të fshehura, t'i thuash\* te Perëndia  
që i njehtë gjitha.<sup>62</sup> I vetmi Shpëtimtar, ti  
e di çdo sekret;\*<sup>63</sup> mëshiro më dhe mua,  
si psal Davidi, pas përdëllimit tënd, Zot.<sup>64</sup>

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne.  
Më parë ti\* thirre drejt asaj\* që s'ka  
cen, Hyjnënës, edhe zbrapse\* tërbimin  
e pasionit shqetësues, të dhunshëm, tur-  
përove mashtruesin tënd\* djall, armikun;  
tani jepi shërbëtorit tënd - mua - ndihm',  
se kam dert.<sup>65</sup>

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne.  
Nga Krishti yt,\* që e deshe aq,\* pate  
mall, dhe mishin tënd e trete,\* tani për  
shërbëtorët ti kërko që të zbutet, për krejt  
ne; dhe porsì dhurëti\* ky të japë te sa po  
e adhurojnë jetesë paqeje plot.

Lavdi *Triadik*

“Trini e thjeshtë,\* e pandarë krejt,\* je Njësi  
e bashkëqenshme, drita\* të shenjta, dritë,  
- tri të shenjta dhe një e shenjtë”, Perëndia  
himnohet kështu.\* Por himnoje, lëvdoje,  
shpirt, jetën, jetët, pra Perëndin' e çdokujt.

Tani *Hyjlindësor*

Të falemi,\* të himnoj më ne,\* të bekoj-  
më, Hyjnënë, se ti\* ke lindur një nga  
Shën Triadha krejt e pandarë, Perëndinë,  
një Bir dhe Zot pra;\* dhe ti vetë për ne  
tokësorët hape nur qielloret me gaz.

*Ode VIII**Irmosi: On stratie uranón*

»E lavdëroj'n\* Zotin lart ushtrinë qiellore,  
»e kanë frik' Keruvimet tok\* me Serafi-  
»met; çdo frymë, çdo krijim, bekoje,\* për-  
»mbilartësoje, himnoje në gjith' jetët.<sup>66</sup> (2x)

O Shpëtimtar,\* derdh mbi kokën tënde  
mu si miro un' alabastrin e lotëve,\* thë-  
rras porsì Lavirja<sup>58</sup> që donte përdëllim  
pra,\* lutjen sjell, kërkoj që të marr hir,  
ndjesë fajesh.

Sado askush\* s'mëkatoi si un', por ti  
mua më prit, i dhembshuri Shpëtimtar,\*  
më frikë po pendohem, thërras me mall:  
Fajtova,\* bëra shkellej vetëm te ti,<sup>67</sup> por  
përdëllemë.

O Shpëtimtar,\* të të vijë keq<sup>68</sup> për bërjen  
tënde, për delen e humbur, si bari\*<sup>69</sup>  
kërkoje<sup>70</sup> dhe rrëmbeje prej ujkut dhe  
vendose\* brenda mandrës sate me delet  
që ke ti, Zot.

Kur si gjyqtar\* do të ulesh, o i dhembshur,  
Krisht, dhe do shfaqësh lavdin plot trembë  
ti,\* oh, atëherë ç'tmerr kur kaminë do të  
ndizet,\*<sup>71</sup> podium i frikshëm do llahtarisë  
çdokënd!

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne.

Të feksi nur,\* nënë, nëna e ndriçimit<sup>72</sup> pa perëndim, nga veset të zgjidhi ty,\* Hirin e Shpirtit prite,<sup>73</sup> kështu, Mari, shkëlqej<sup>\*</sup> dhe nga terri nxirri sa të himnojn' me besë.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. Çudi të re\* pa vërtet në ty, nën', Zosimai i hyjshëm; shtangej se shihte pra\* engjëll me trup dhe mbushej i tëri nga habia,\* duke e himnuar në jetë Krishtin, Zotin.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin.

### Triadik

At' pa fillim,\* Bir i bashkëpafillim, i miri Ngushëllimtar, Shpirt i drejtë ti,\* prindi i Fjalës, Fjala e Atit pa fillim tok,\* Shpirt i gjall', krijues, Trini, Njësi, shpëtomë.

### Tani Hyjlindësor

O e pacen,\* si me ngjyrë purpuri manteli mendor dhe perandorak, u thur\* përbrenda barkut tënd mishi i Emanuelit;\* të nderojmë ty, o Hyjlindëse, vërtet pra.

### Ode IX

#### Irmosi: Asporu sillpseos

»Pa prishje në bark ka nxënë nënë pa «burr', lindja s'ka shpjegim, se zënia\* ish «pa farë, Perëndia lind dhe natyrat ky\* i «rinovon; prandaj ne,\* të gjithë brezat,<sup>74</sup> «orthodhoksisht\* ty të madhërojmë plot «mall\* si hyjnuse, nënë pa qortim. (2x)

O Bir i Davidit, përdëllim të kesh për mua, dhembshurom', shpëtomë,\* mëshiroim<sup>75</sup> ti që me fjal' shërove sa kishin djall,\*<sup>76</sup> frazën që mirësisht the\* drejtas Kusarit, ma thuaj, Zot:\* Them: «Amin! Do jesh me mua\* në Parajsë kur të vij me lavd'». <sup>77</sup>

Të theologonte një Kusar, ndërsa një tjetër të qortonte ashpër,\* varur që të dy në kryq me ty,<sup>78</sup> përdëllyes fort;\* hap dhe për mua derën\* e mbretëris' sate plot

lavdi,\* siç e bëre për Kusarin\* besimtar që ty të njohu, Zot.<sup>77</sup>

Shtrengohej Krijesa kur të shihte ty që kryqëzoheshë, nga frika\* çaheshin shkëmbinj dhe male, toka lëkundej fort,\*<sup>79</sup> Hadhi po zhvishej, ndërsa\* gjat' ditës drita u bë si terr,\*<sup>80</sup> o Jisu, kur të shikonte\* mbi dru të mbërthyer keq në mish.

Zot, fryte të denja për pendim<sup>81</sup> mos më kërko, sepse fuqia ime\* u shterua brenda meje;<sup>82</sup> zemër me plot dërmim\*<sup>83</sup> gjithnjë më jep, dhuromë\* dhe varfëri shpirtërore<sup>84</sup> tok,\* të t'i sjell ato, i vetmi\* Shpëtimtar, si fli të pritur mir'.<sup>85</sup>

Gjykatës, o njohësi im, kur ke për të ardhur përsëri me engjëjt\* të gjykoshe krejt botën,<sup>74</sup> shihm' atëher' me sy të but'\* dhe të të vijë keq ty;<sup>86</sup> më dhembshuro mua, o Jisu,\* se më fort se krejt natyra\* njerëzore mëkatova pra.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne.

Habite të gjitha rendet engjëllore dhe sistemet njerëzore,\* o Mari, përmes jetesës sate të huaj krejt;\* jetove si e pa-lënd'\* përmbi natyrë; u shfaqe qart'\* e çmaterializuar,\* kur më këmbë ecje mbi Jordan.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne.

Ndërtuesin zbutë për ne që të mburrim, o Mari, nën' oshënare,\* dhe çlirona nga çdo keqtrajtim si dhe çdo shtrengim\* nga sa përqark sulmojnë;\*<sup>86</sup> kështu, të lirë nga ngasjet<sup>87</sup> krejt,\* pa pushim ta madhërojmë\* Zotin që të lavdëroi ty.

O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne.

O atë shpirtprurës, i nderuar dhe bar i Kretës, shën Andrea,\* pa pushim ti ndër-mjeto te Krishti, pra Zoti yn',\* për ne që të himnojmë,\* të evitojmë krejt çdo mëri,\*



të çlirohemi nga fajet\* ne që bëjm' kujtimin tënd gjithnjë.

*Lavdi Triadik*

**M**e bes' ta lëvdojmë Atin, ta mbilartësojmë Birin, si dhe Shpirtin;\* le t'i falemi Triadhës pa ndarje dhe Njësis\* sipas esencës; drita\* dhe dritat, jeta dhe jetët është\*,\* që ndriçon dhe ia jep jetën\* botës mbarë, anembanë pra.

*Tani Hyjlindësor*

**Q**ytetin tënd ruaje ti, o e fortdehërit dhe Hyjnë në Vajzë;\* mbretëron në ty me besë, në ty forcohet pra,\* fiton nëpërmjet teje\* edhe mbi çdo ngasje triumfon\* dhe armiqtë i plaçkit ky,\* mir' i qeveris nënshtetasit.

*Pastaj të dyja koret psalin Irmosin:*

*Asporu silipseos*

**Pa** prishje në bark

*Dhe shërbesa e Pasdarkës së Madhe që mbetet.*

**CITIME**

1. Eks. 15.1-2; Sirak 51.2
2. Fja. Urt. 5.22
3. Is. 53.4-7; Joan 1.29,36
4. Ps. 142(143).2
5. Lluk. 15.13-14
6. Ligji i Dytë 32.39
7. Ps. 77(78).24
8. Eks. 17.6 etj.
9. Gjen. 4.23
10. Gjen. 11.3-7
11. Gjen. 4.8; I Joan 3.12
12. Gjen. 19.24; Lluk. 17.29; II Petr. 2.6
13. Gjen. 18.20; II Petr. 2.7; Juda 7
14. Matth. 5.22; 18.9; Mark 9.47
15. Matth. 14.30-31
16. Jez. 18.23
17. I Mbret. [Sam.] 2.1
18. Sirak 48.19
19. Matth. 7.24-25; Lluk. 6.48
20. Gjen. 16.1,3,5
21. Gjen. 16.15
22. Gjen. 28.12
23. Gjen. 14.18; Hebr. 5.6.10; 6.20; 7.1-3.11-21
24. Matth. 25.10
25. Gjen. 19.26; Lluk. 17.31-32
26. Gjen. 19.17,22,30
27. Abak. 3.1-2
28. Jov 10.20

29. Jov 1.3,14-17
30. Jov 1.1,8; 2.3
31. Jov 1.9-12; 2.4-7
32. Lluk. 18.10-14
33. Ps. 7.12; II Tim. 4.8
34. I Thes. 4.4-5
35. Is. 6.3; Apok. 4.8
36. Ju. 9.5-6; Ps. 134(135).6; Urt. Sol. 12.18; Mark. 1.40; Hebr. 1.3
37. Is. 26.9
38. Matth. 7.21
39. Lluk. 13.11-13
40. Joan 19.34
41. Joan 4.15
42. Joan 9.7
43. Hebr. 1.2
44. Jona 2.3-7
45. Lluk. 15.8-9
46. Joan 5.35
47. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
48. Eks. 17.13
49. Jis. N. 9.3-22
50. Fil. 2.6
51. Sirak 24.8
52. Ef. 1.23
53. III [I] Mbret. 8.47; II Kron. 6.37; Ps. 105(106).6; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 5.6; Dan. 9.5,15
54. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 10
55. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
56. Ps. 72.20
57. IV [II] Mbret. 20.1-6
58. Lluk. 7.37-38
59. Gjen. 1.31
60. Matth. 25.8
61. Ps. 50(51).14
62. Joan 21.15
63. Ps. 43(44).22
64. Ps. 50(51).3
65. Ps. 59(60).13
66. Dan. kap. 3 Lutje e Azarias 34
67. Ps. 50(51).6
68. Neh. 13.22
69. Joan 10.11
70. Matth. 18.11-12; Lluk. 15.4; 19.10
71. Dan. 7.9-10; II Thes. 1.7-9
72. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
73. II Kor. 6.1
74. Lluk. 1.48
75. Matth. 9.27; 15.22; 20.30-31; Mark 10.48; Lluk. 18.38-39
76. Mark 1.23-26; 5.8-13; 9.25-26; Lluk. 4.33-35
77. Lluk. 23.43
78. Lluk. 23.39-42
79. Matth. 27.51
80. Lluk. 23.44
81. Matth. 3.8; Lluk. 3.8
82. Ps. 37(38).11; 70(71).9
83. Ps. 50(51).19
84. Matth. 5.3
85. Is. 56.7
86. Ps. 3.7-8
87. II Petr. 2.9

TË PREMTEN E JAVËS SË PARË  
NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve, Aliluat dhe Triadiket e Tingullit të javës, dhe pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove Kryqësore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove, poezi e zotit Josif:*

*Ting. II O efskimon Iosif*

Njeridashës, me sa vuajta na dhe ti pasionshmëri të gjithë neve,\* me Kryqin tënd hyjnor pasionin mishëror ma vrit\* dhe ngjalljen tënde aq të nderur më denjëso\* ta shoh edhe unë, që pasurisht të marr,\* o Zot, ndjesë plot hir dhe përdëllim të madh.<sup>1</sup>

Lavdi

*E njëjta*

Tani *Kryqhyjlindësore*  
*Efsplahnias ipárhusa*

Përmes Kryqit të Birit tënd, o Zonj!\* e dëlirë, Hyjlindëse, fort ruhemi, zmbra-psim\* lehtë gjithë sulmet e armikut djall;\* ndaj detyrimisht të lumërojmë ty\* si nënën e dritës<sup>1a</sup> son\*, si shpresën e vetme krejt\* pra për shpirtat tanë, Vajz\*! je e lavdëruar, e kulluar fort.

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësove, poezi e zotit Theodor:*

*Ting. II Efsplahnias ipárhusa*

Je për dëlirësinë si burim,\* ndaj na ruaj me kreshmë, përdëllyes, dhe shihna\* ne që biem para teje gjunjazi;\* duart që ngrem\*,<sup>2</sup> shihi ti që shtrive gjer\* pëllëmbët në dru, në Kryq,\* kur po kryqë-zoheshe\* për të vdekshmit mbarë ne,\* o i vetmi Zot i të patrupëve.

Lavdi

*E njëjta*

Tani *Kryqhyjlindësore*  
*Efsplahnias ipárhusa*

Kur të pa të tendosur mbi një dru\* dhe të vdekur, e Virgjra nëna jote po qante,\* o Krisht, hidhur thoshte: Ç'është ky mister\* plot tmerr, Biri im? Si përmbi Kryq po vdes\* me vdekje të turpshme<sup>2a</sup> krejt\* me dashje<sup>3</sup> ti që dhuron\* jetë të përgjeshme nur\* te të gjithë<sup>4</sup> pranë teje në amshim?

*Psalmi 50. Prifti thotë uratën e zakonshme: O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën, dhembshurinë dhe... Kanuni i Mujorit dhe Triodet në vendin e tyre. Lexohet dhe Ode V biblike.*

*Triodi*

*Ting. II*

*Ode V*

*O fotismòs ton en skoti*

Tinëzari, duke parë mëkatën brenda meje, nxiton dhe basikëpunon me fajin, sepse gëzon me të vërtetë për katastrofën time; por lutem, ti, o Shpëtimtar, më jep korrigjim që ta asgjësoj atë.

Ti që triumfove në Kryqin tënd përmbi autoritetet<sup>5</sup> e errësirës,<sup>6</sup> çliromë nga kriminaliteti i tyre mua që rashë në fund të mëkatit dhe në gropën e veprave të pavend, por shpresoj të shpëtoj me anën e përdëllimit tënd.

Ti që u vrave i tendosur në Kryq, ngjalle shpirtin tim që u vra për shkak të mëkatit dhe denjësomë të arrij me paqe në ngjalljen tënde të respektuar, duke zbatuar me kujdes të drejtat e tua, Krisht.

*Hyjlindësore*

O e kulluar, ndriçimi i errësirës sime, shpëtimi i shpirtit tim të nxirë, shpëtomë mua që po shkatërrohem dhe vishmë me këmishën e paprishjes, se u prisha për shkak të shkeljeve të tmerrshme.



*Kanuni tjetër Ting. i njëjtë  
Tis niktós dhieithusis*

**P**ranove, o Zot, i vetmi i pavdekshëm, të kryqëzohesh në mish në vendin e Kalvarit, duke e bërë të pavdekshme dhe duke e riformuar gjlininë njerëzore.

**K**rijesa, duke parë pësimin tënd të poshtë, o Zot, ndryshohej e tëra<sup>7</sup> dhe qante për vrasjen e neveritshme që bënë judenjtë; por ti durove që të shpëtosh Gjithësinë.

*Lavdi Triadik*

**O** Trini e Tërëshenjtë, ti je adhurimi, përkja dhe përforcimi ynë; dërgoju zbutje shkëlqesh<sup>8</sup> atyre që të përhimnojnë në një natyrë.

*Tani Hyllindësor*

**G**ëzohu, o Vajzë Perëndilindëse me shumë epitete: arkë,<sup>9</sup> shtambë,<sup>10</sup> tryezë,<sup>11</sup> kandil dritëprurës,<sup>12</sup> ferrë zjarrpamëse<sup>13</sup> si dhe mal hijeplotë i Perëndisë.<sup>14</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **P**asi t'i themi "Lamtumirë!" botës dhe atyre që janë në botë, tani, si të kryqëzuar së bashku me Krishtin, le të durojmë sharje, tallje dhe të tjera, që të lavdërohemi bashkë me të.

*Irmosi: Tis niktós dhieithusis*

»Pasi nata kaloi,\* dita pra është afër\*<sup>15</sup>  
»dhe shkëlqeu drita në botë<sup>16</sup> nur,\* dhe  
»prandaj të himnojnë\* rreshta engjëllorë\*  
»dhe të lavdërojnë, o Krisht Perëndi.

*Ode VIII*

*Ton en kamino tu pirós*

**T**i që e përulë veten, u lartësove në Kryq<sup>17</sup> nga dhembshuria, duke e ngritur të rënin për shkak të ngrënies së drurit dikur,<sup>18</sup> prandaj, o i vetmi i përmbimirë, të himnojmë ty, të lavdëruarin, në jetë.

**P**ër shkak se dremita nga pakujdesia,

më zuri gjumi i rëndë i mëkatit; por ti, o Krishti im, që ke fjetur mbi Kryq për mua, ngrimë mua të rënin, që të mos më pushtojë nata e vdekjes.

**M**eqenëse u verbova nga kënaqësitë ephshore, unë e sorollat shpirtin tim të errësuar dhe armiku tinëzar qesh kur më shikon; prandaj, o Krisht, më ndriço dhe më çliro nga e keqja e tij në jetë.

*Hyllindësor*

**P**ërderisa e shpenzova jetën në indiforentizëm, u rëndova në shpirt nga dremitja e mëkatit, mirëpo përiki te ndërmjetimi yt i pafjetur; mos më dorëzo të fle për vdekje, o Vajzë e tërëpacenuar.

*Tjetri: Ton en ti vato Mosi*

**K**ur u kurorëzove me gjemba dhe veshe stoli purpuri, u paraqite, o Krisht, krejt i bukur me hijeshi më shumë se gjithë bijtë e njerëzve,<sup>19</sup> dhe i shkëlqyer me lavdi.

**M**eqenëse pive vrer dhe uthull, ti u derdh dy rrëke, pra jetë dhe pavdekësi, nga brinja jote hyjnore<sup>20</sup> atyre që të himnojnë besërisht dhe të lavdërojnë në gjithë jetët.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin  
e Shenjtë, Zotin.

*Triadik*

**O** Hyjni unike, Trini, natyrë e pandarë, por e ndarë në Persona, pushtet i pashkëtrrueshëm, Atë, Bir dhe Shpirt, të përhimnojmë në gjithë jetët.

*Tani Hyllindësor*

**O** Hyjnënë e dëlirë, derë qiellore,<sup>21</sup> portë shpëtimtare e gjithë të krishterëve, pranoje lutjen e atyre që të lumërojnë në gjithë jetët.<sup>22</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **O** Kryq, shtëpitë e Krishtit, bri i Kishës, fitore e mbretërve, rojë i të krishterëve, ti

je ndriçimi im, ti je dhe mburrja ime në gjithë jetët.

Himnojmë, bekojmë dhe i falemi Zotit.

*Irmosi: Ton en ti vato Mosi*

»Te Moisiu, në mal,\* në Sina, para-  
»shfaqti\* mrekullin' e së Virgjërës në një  
»ferrë<sup>23</sup> Zoti Krisht;\* himnojeni, beconi,\*  
»përbilartësoni atë në gjithë jetët.<sup>23</sup>

*Ode IX*

*I ton pro iliu*

Shpirtin tim plot lebër nga veprat,\* nga  
kujtimet pa vend, ma pastro\* përmes  
spërkatjes, Fjalë Zot, të gjakut tënd,\*<sup>24</sup>  
pjesëmarrës drejt të lavdisë sate<sup>25</sup> bëme,  
Krishti im,\* që ke duruar kryqëzim\* pa  
lavd, të turpshëm mjaft për mua ti.

Krisht, jam i kërrusur i tëri\* tash nga pe-  
sha e veprimeve\* pa vend; o njeridashës,  
un' i zymt' thërras:\* O Zot, plagët e pa-  
shërueshme të shpirtit m'i shëro\* me  
gjakun tënd të çmuar krejt,\* që ta himnoj  
Hyjninë tënde drejt.

Bëra pije pakujdesinë\* dhe ushqim të  
keqen qyqi un'\* që mbetem në të gjitha  
i pandrequr krejt\* dhe pa vend ngazëllo-  
hem kot për shmangien e ushqimeve;\*  
tha Krishti: Si kreshmimi im\* kurrë mos  
qoftë një i tillë pra!<sup>26</sup>

*Hyjllindësor*

Asgjësove, Vajzë, vendimin\* tej të lasht',  
të prerë,<sup>27</sup> ndreqe ti\* stërnënën,<sup>28</sup> shka-  
ku je ti që gjinia jon'\* prap' me Zotin u  
familjarizua,<sup>29</sup> edhe urë je\* drejt Perëndis',  
Krijuesit;\* të madhërojmë me respekt të  
madh.

*Tjetri: Tin agnin qe àhranton*

Kur u kryqëzove në dru, Krijesa tundej,<sup>30</sup>  
megjithëse ishte Perëndi, pësive mishë-  
risht nga dhembshuria, që të na shpëtosh.

Fuqia e Kryqit tënd, o Zot, është e ma-  
dhe, sepse, sa e formojmë në veten tonë,  
menjëherë zmbarsim forcën e demonëve.

*Lavdi Triadik*

O Njësi trihipostate, absolutisht një Trini,  
sundim, natyrë e njëlavdishme, Atë, Bir  
dhe Shpirt Hyjnor, shpëtona gjithë ne.

*Tani Hyjllindësor*

Gëzohu, o Hyjllindëse, zbutje e botës; kur  
përikim te ti, gjithë ne mëkatarët pajto-  
hemi përherë me Perëndinë.<sup>31</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

O Zot, me fuqinë hyjnore të Kryqit tënd  
përforcomë që të ta ofroj të paqortuar  
dhe të kulluar kohën e kreshmës.

*Irmosi: Tin agnin qe àhranton*

»Ne shpresëplotët mbarë me melodi  
»këngësh e madhështojmë besërisht si  
»Perëndilindëse nënën dhe Virgjërëshën  
»e dëlirë dhe të pacen.

*Fotogjiku i Tingullit të javës*

*Dhe Dhoksologjia e Vogël (fq. 62)*

*Pasvargjet e Lavdërimeve Ting. Tërth. IV*

*Idhiomeli*

Le ta mirëpresim me ngazëllim lajmin e  
kreshmës, sepse, nëse do ta kishte mbaj-  
tur stërgjyshi,<sup>32</sup> nuk do të kishim rënë  
nga Edeni.<sup>33</sup> Ishte i bukur në pamje dhe  
i mirë në shije fryti<sup>28</sup> që më vrau.<sup>27</sup> Le të  
mos rrëmbehemi nga qepallat,<sup>34</sup> as të  
mos ëmbëlsohet laringu<sup>35</sup> ynë nga gje-  
llët e nderuara, të cilat, pas ngrënies, ja-  
në të çnderuara; le t'i shmangemi mos-  
përbajtjes dhe le të mos nënshtrohemi  
ndaj pasioneve me lakmi; le të shënohe-  
mi me gjakun e atij që për ne shkoi vull-  
netarisht drejt vdekjes<sup>3</sup> dhe nuk do të  
na prekë shfarosësi;<sup>36</sup> dhe le ta hamë  
Pashkën tepër të hyjshme të Krishtit<sup>37</sup> për



shpëtimin e shpirtit tanë.

**Varg:** U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përule, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt' e tyre.

### *Injëjti*

**Varg:** Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoje te ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

### *Martirik Ti imás kalésomen ájii*

**Çfarë mund t'ju quajm', shenjtore, ne?\*** Keruvime? Se u preh përmbi ju Krishti Perëndi.\*<sup>37a</sup> Serafime? E lëduvat\* pa pushim atë me himn.\*<sup>37b</sup> Dhe engjëj? Se shpërfillët trupin, mishin pra.\* Dhe Forca? Se veproni me çudi<sup>37c</sup> gjithnjë\* dhe keni emra të shumtë ju,\* karizma fort të mëdha me hir,\* ndaj ndërmjetim\* bëni të shpëtohen shpirtat tan'.

### *Lavdi dhe Tani Kryqhyjindësor O tu paradhoksu thávmatos*

**Sapo të pa,** Shpëtimtar, të kryqëzuar lart në Kalvar,\* Gjithësia ndryshohej keq\* dhe shtrengohej, tundej fort,\*<sup>7</sup> se s'duronte dot pra; ndërsa\* e ëma jote e virgjër, e dëlir,\* duke vajtuar, drejt teje thirri fort:\* Mjerë! O Biri im,\* çilrimtar i ëmbël, ç'është kjo çudi,\* pamje paradoksi dhe e re, e huaj krejt?

**Lexuesi:** Është mirë ta lavdërojmë Zotin...  
*etj. si të hënën e parë në mëngjes (fq. 63).*

### *Në orën e Gjashtë (në Trithektë), Tropari i Profecisë:*

### *Ting. Tërth. IV*

**O** Zot, përmes dhembshurive arri para<sup>38</sup> jetës sonë shumë mëkatore dhe sjelljes së papenduar, sepse veç teje nuk njohim

dikë tjetër që dominon mbi jetën dhe vdekjen; shpëto si njeridashës.

### *Lavdi dhe Tani*

### *Injëjti*

Proqimën. Ting. IV. Psalm 17.

Do të të dua, o Zot, fuqia ime.

**Varg:** Perëndia im është ndihma ime dhe do të shpresoj mbi të.

Këndimi i profecisë së Isaia

### *(3.1-14)*

**Ja** pra Zoti sundimtar, Sabaothi, do të heqë nga Judea dhe nga Jerusalem çdo të fuqishëm dhe të fuqishme, fuqi buke dhe fuqi uji, gjigant dhe të fortë, dhe njeri luftëtar, dhe gjykatës, dhe profet, dhe intelektual, dhe të moshuar, dhe krye pesëdhjetësheje, dhe këshilltar të çuditshëm, dhe arkitekt të urtë, dhe dëgjues të mençur. "Dhe do të vendosë adoleshentë si pushtetarë të tyre dhe tallës do të zotërojnë mbi ta; dhe do të bjerë tok populli, njëri drejt tjetrit dhe njëri drejt të afërmit të tij, do të bjerë fëmija drejt plakut dhe i parëndësishmi drejt të nderuarit, se do ta kapë njëri vëllanë e tij ose familjarin e atit të tij duke thënë: 'Ke robë, bëhu kryetari ynë dhe ushqimi im le të jetë nën ty'. Dhe, kur të përgjigjet në atë ditë, do të thotë: 'Nuk do të jem kryetari yt, sepse s'ka në shtëpinë time as bukë, as robë; nuk do të jem kryetari i këtij populli!'. Sepse do të braktiset Jerusalem, dhe Judea ka rënë bashkë, dhe gjuhët e tyre flisnin me paligjësi, ishin të pabindur ndaj Zotit, sepse tani u përul lavdia e tyre, dhe turpi i fytyrës së tyre u doli kundër, ndërsa mëkatin e tyre e lajmëruan dhe e paraqitën si atë të Sodomës; mjerë për shpirtin e tyre! Sepse kanë menduar mendim djallëzor kundër vetes së tyre, duke thënë: "Le ta lidhim të drejtin, sepse

vështirë se përdoret nga ne”. Prandaj do të hanë prodhimet e punëve të tyre. Mjerrë për të paligjshmin! Do t'i ndodhin të dhimbshme sipas punëve të duarve të tij. “O populli im, taksambledhësit tuaj jua korrin të gjitha; dhe ata që kërkojnë me dhunë, ju sundojnë; o populli im, ata që ju lumërojnë, ju mashtrojnë dhe trazojnë udhën e këmbëve tuaja”. Por tani do të qëndrojnë për gjykim Zoti dhe do të vendosë për gjykim popullin e tij. Vetë Zoti do të vijë për gjykim me pleqtë e popullit dhe me të parët e tij.

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 18.  
O Zot, përkrahësi im dhe çlirimtari im.  
*Varg:* Qiejt rrëfejnë lavdi Perëndie.



## TË PREMTEN E JAVËS SË PARË NË MBRËMËSORE

*Nëse nuk bëhet Liturgjia e të Parashenjtëruarave, atëherë në Thirrtores: 3 Martirike (të para) të Tingullit të javës (gjeji në VARGËZIME DHE NDENJËSORE sipas Tingullit, në fund të librit) dhe 3 (të parat) të shën Theodorit. Lavdi e shën Theodorit. Tani Hyj lindësore Ngjallësore (e Ting. të javës që po kalon). Nuk bëhet Hyrje. Leximet etj. Në Pasvargje, Idhiomeli që ka mbetur dhe Martiriku: O martirë të tërëfamshëm (kërkoje TË PREMTEN NË MBRËMËSORE, Ting. Tërth. I, po në VARGËZIME DHE NDENJËSORE, fq. 363). Lavdi: Idhiomeli i katërt i shën Theodorit: O Theodor, tri herë i lumur, Tani: Gjith' shpresën time e besoj të ti, o nën' e Perëndisë, ruajmë nën strehën tënde. Përlëshore e shën Theodorit dhe Hyj lindësorja e tij.*

10 Thirrtores

### *Ting. Tërth. I Idhiomeli*

Ejani, o besnikë, t'i kryejmë në dritë punët e Perëndisë,<sup>39</sup> të ecim si ditën<sup>40</sup> me modesti; ne vetë t'ia heqim të afërmit çdo shkrim të padrejtë,<sup>26</sup> duke mos i vënë gur pengese për skandal; le ta lëmë mirëqenien e mishit, le t'i shumëfishojmë karizmat e shpirtit; le t'u japim bukë të varfërve<sup>41</sup> dhe le të vijmë pranë Krishtit me pendim, duke thirrur: O Perëndia ynë, mëshirona. (2x)

*Pastaj 4 Martirikët e Tingullit të javës dhe këto 4 Idhiomelet e zotit Theodor:*

### *Ting. II*

Ejani, të gjithë, o martirdashës, le të dëfremë shpirtërisht dhe le të bëjmë pavnair, sepse sot martir Theodhori shtron para tryezë mistike që na kënaq ne kremtimdashësit, që t'i thërrasim: Gëzohu, o athlofor i pamposhtur, që i dërrmove mbi dhë kërcënimet e tiranëve; gëzohu, ti që trupin e baltë<sup>42</sup> ua dhe torturave për Krishtin Perëndi; gëzohu, ti që në rreziqe të llojllojshme u tregove ushtar i sprovuar i ushtrisë qiellore; ndaj të përgjrohemi: O bukuria e dëshmorëve, ndërmjeto për shpirtat tanë.

Hirin tënd të hydhuruar, o martir Theodor, ua shpërdan gjithë atyre që përikin te ti besërisht; me të të mburrim dhe themi: Çliron të robëruarit, shëron të sëmurët, pasuron të varfrit, shpëton marinarët; pengon arratisjen e kotë të shërbëtorëve dhe u shfaq dëme atyre që u kanë vjedhur; edukon ushtarët që të shmangen nga rëmbimi; fëmijëve ua plotëson me dashuri kërkesat; shfaqesh mbrojtës i nxehtë për ata që kremtojnë kujtimin tënd të hyjshëm; për ta edhe për ne që e përhimnojmë martirizimin tënd, o atlet tepër i hyjnueshëm, kërko prej Kri-



shtit përdëllimin e madh.<sup>1</sup>

**O** martir Theodor, u tregove dhuratë e skajshme e Perëndisë, sepse, edhe pas vdekjes, ua plotëson si i gjallë kërkesat atyre që rendin pranë teje; prandaj, sapo erdhi një vejushë, e lagte me lot kishën tënde për hir të birit të saj, i cili u rrëmbye pasi u robërua në ushtrinë e një tjetër feje; dhe ti, si i dhembshur, pasi hiqe mbi kalë të bardhë, erdhe padukshëm dhe e shfaqe djalin e saj; dhe pas kësaj, nuk ndalove së kryeri çudi; kërko prej Krishtit Perëndi të shpëtojë shpirtat tanë.

**O** Theodor, tri herë i lumur, të lëvdoj si sinonim me dhuratë hyjnore, sepse, meqë u tregove ndriçues i paperëndueshëm i dritës hyjnore, shkëlqeve me arritjet e tua gjithë Krijesën;<sup>43</sup> dhe përdërisa u duke më i fortë se zjarri, shove flakën dhe e dërrmova kokën e dragoit<sup>44</sup> tinëzar; ndaj Krishti, si u përkul me anën e arritjeve të tua, kurorëzoi kokën tënde të hyjshme, o atlet, martir i madh; meqenëse ke guxim para Perëndisë, lyp pa pushim për shpirtat tanë.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

**K**eqdashësi, duke përdorur si vegël tiranin bashkëshkelës, përpiquej me dredhi të ndërlikuar ta ndotte, nëpërmjet ushqimeve të njollosura nga flijimet e papastra, popullin shpresëplotë që pastrohej përmes kreshmës; por ti, me një mendim më të zgjuar, e asgjësove intrigën e tij kur shkove dukshëm te kryeprihti i atëhershëm dhe ia zbulove mendimin e thellë, duke i lajmëruar kotësinë e atentatit; ndaj, duke flijuar për ty himne falënderuese, të deklarojmë si shpëtimtar, duke kremtuar kujtimin e përvitshëm të ndodhisë dhe duke kërkuar të shpëtojmë edhe në të ardhmen pa u

dëmtuar nga dinakëritë e të ligut përmes ndërmjetimeve të tua drejt Perëndisë, o martir i madh Theodor.

Tani *Hyjlinësore Dogmatike e Tingullit të javës (që po kalon)*

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Prihti:* Mbrëmje!  
*Lexuesi:* Proqimen. Ting. Tërth. I. Psalm 19.  
Të dëgjoftë Zoti në ditë shtrëngimi.  
*Varg:* Të mbroftë emri i Perëndisë të Jakovit.

Këndimi i Gjenezës  
(2.20-3.20)

**A**dami u vuri emra të gjitha kafshëve dhe të gjithë zogjve të qiellit, dhe të gjitha bishave të arës, ndërsa për Adamin nuk u gjet ndihmës i ngjashëm me të. Dhe Perëndia vuri ekstatë mbi Adamin dhe ai fjeti; dhe mori njërin brinjë të tij dhe e plotësoi me mish në vendin e saj; dhe Perëndia ndërtoi brinjën, që e mori prej Adamit, në grua dhe e çoi drejt tij. Dhe tha Adami: "Kjo tani është kockë nga kockat e mia dhe mish nga mishi im; ajo do të quhet grua, sepse kjo u mor nga burri i saj; për këtë arsye njeriu do të braktisë atin dhe nënën, dhe do të ngjitet drejt gruas së tij dhe do të bëhen të dy në një mish". Dhe ishin që të dy lakuriq, edhe Adami, edhe gruaja e tij, dhe nuk u vinte turp. Dhe gjarpri ishte më i zgjuar se të gjitha bishat mbi tokë, të cilat i bëri Zoti Perëndi. Dhe gjarpri i tha gruas: "Pse Perëndia tha: 'Nuk do të hani nga çdo dru i Parajsës?'". Dhe gruaja i tha gjarpri: "Nga fruta e drurit të Parajsës do të hamë, por nga fruta e drurit që është në mes të Parajsës, Perëndia tha: 'Nga ky nuk do të hani, as do ta prekni, që të mos vdisni.'" Dhe gjarpri i tha gruas: "Nuk do të vdisni me vdekje, sepse Perëndia e dinte se ditën që do të hani nga ky, do të hapen sytë

tua dhe do të jeni si perëndi, duke ditur të mirën dhe të keqen". Dhe gruaja pa se druri *qe* i bukur për t'u ngrënë dhe i kënaqshëm te sytë për t'u parë dhe se *qe* i bukur për t'u perceptuar; dhe, pasi mori nga fruta e tij, hëngri dhe i dha burrit të saj pas saj dhe hëngrën. Dhe u hapën sytë e të dyve dhe njohën se ishin lakuriq; dhe qepën gjethe fiku dhe bënë mbështjellëse për veten e tyre. Dhe dëgjuan edhe Adami, edhe gruaja e tij zërin e Zotit Perëndi që shëtiste në Parajsë në mbrëmje dhe u fshehën në mes të drurit të Parajsës nga fytyra e Zotit Perëndi. Dhe Zoti Perëndi e thirri Adamin dhe i tha: "Adam, ku je?". Dhe i tha: "Dëgjova zërin tënd kur shëtisje në Parajsë dhe u frikësova, sepse jam lakuriq dhe u fsheha". Dhe Perëndia i tha: "Kush të njoftoi se je lakuriq? Veç nëse hëngre nga druri nga i cili të porosita nga ky vetëm të mos hash?". Dhe Adami tha: "Gruaja që dhe që të jetë me mua, kjo më dha nga druri dhe hëngra". Dhe Zoti Perëndi i tha gruas: "Pse e bërë këtë?". Dhe gruaja tha: "Gjarpri më mashtroi dhe hëngra". Dhe Zoti Perëndi i tha gjarprit: "Meqë e bërë këtë, ti do të jesh i mallkuar nga të gjitha kafshët dhe nga të gjitha bishat që janë mbi dhe; do të ecësh mbi gjoksin dhe barkun tënd dhe do të hash dhë në tërë ditët e jetës sate; dhe do të vendos armiqësi në mes teje dhe në mes të gruas, dhe në mes të spermës sate e në mes të spermës së saj; ai do të ngrejë pusi kundër kokës sate dhe ti do të ngresh pusi kundër thembres së tij". Dhe gruas i tha: "Duke shumëfishuar, do t'i shumëfishoj trishtimet e tua dhe rënkimin tënd; me trishtime do të lindësh fëmijë dhe drejt burrit tënd do të jetë kthimi yt dhe ai do të mbizotërojë mbi ty". Dhe Adami i tha: "Përderisa e dëgjova zërin e gruas

sate dhe hëngre nga druri, nga i cili të porosita vetëm nga ai të mos haje, ti hëngre nga ai, ndaj do të jetë e mallkuar toka në punët e tua; me trishtime do ta hash atë në të gjitha ditët e jetës sate; do të të lindë gjemba dhe rrodhe, dhe do të hash kashtën e arës; me djersën e fytyrës sate do ta hash bukën tënde, derisa të kthehesh në dhë nga u more, sepse dhë je dhe në dhë do të ikësh". Dhe e quajti Adami emrin e gruas së tij "Jetë", sepse ajo është nëna e tërë të gjallëve.

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 20.

Lartësohu, o Zot, me fuqinë tënde.

*Varg:* O Zot, me fuqinë tënde do të dëfresë mbreti.

Këndimi i Fjalëve të Urta

(3.19-34)

Perëndia, me anën e urtësisë, themeloi dheun dhe me anën e mençurisë përgatiti qiejt. Me ndërgjegjësime u çanë avusha dhe re rrodhën vesë. O bir, mos rridh; dhe ruaje mendimin dhe kuptimin tim, që të rrojë shpirti yt dhe të jetë hir rreth qafës sate, dhe do të jetë shërim për mishrat e tua dhe përkujdesje për kockat e tua, që të ecësh me siguri në paqe në të gjitha udhët e tua, ndërsa këmba jote nuk do të pengohet; sepse, nëse do të ulesh, do të jesh pa frikë, dhe, nëse do të flesh, ëmbël do të flesh dhe nuk do të frikësohesh prej tmerrit që sulmoi dhe as prej vrullësh sulmuese të pabesësh, sepse Zoti do të jetë mbi të gjitha udhët e tua dhe do ta mbështetë këmbën tënde që të mos lëkundesh; mos iu shmang bërjes së të mirës ndaj një të varfri për sa kohë dora jote do të ketë diçka për të ndihmuar; mos thuaj: "Duke u kthyer, ti ktheu, do të jap nesër", megjithëse ke mundësi ta bësh të mirën, sepse ti nuk



di se çfarë do të lindë e nesërmja; mos sajo të këqija ndaj mikut tënd që banon pranë teje dhe ka besim mbi ty; mos u bë kot grindavec ndaj *ndonjë* njeriu, që të të mos të bëjë *ndonjë* të keqe; mos fito turpe burrash të këqij as mos i ki zili udhët e tyre, sepse i papastër është para Zotit çdo i paligjshëm dhe nuk ulet mes të drejtësh; mallkim Perëndie ka në shtëpi të pabesësh, por shtëpi agrare të drejtësh bekohen. Zoti u kundërvihet kryelartëve, ndërsa të përlururve u jep hir.

Le të drejtohet lutja ime *dhe Shërbesa e të Parashenjtëruarave që mbetet.*

*Pas mbarimit të Liturgjisë hyjnore të të Parashenjtëruarave, d.m.th. pas Uratës prapa Amvonit dhe, pasi të vëmë para grurin e shën Theodorit, themi Psalmin 142 (O Zot, dëgjo faljen time) dhe Përlëshoren e shenjtit:*

#### Ting. II

Të mëdha janë arritjet e besës! Në burimin e flakës si mbi prehje uji ngazëllohej martiri i shenjtë Theodor, sepse, pasi u bë holokaust, iu soll Trinisë si bukë e ëmbël. Me përgjërimit e tij, o Krisht Perëndi, shpëtoji shpirtat tanë.

Lavdi

*E njëjta*

Tani *Hyllindësore*

Të gjitha përmbi mendim, të gjitha të përmbilavdishme misteret e tua, o Hyllindëse. E vulosur me pastërti dhe e ruajtur me virgjëri, u njohe nën' e vërtetë duke lindur Perëndin' e vërtetë. Atij iu lut të shpëtohen shpirtat tanë.\*

*Psalmi 50, Kanuni i shenjtë që ka Akrostihidhë (pa Hyllindësoret): "Të këndo ty, o sinonim me dhuratë Perëndie" (poezi e Joan Damaskinoit):*

Ting. Tërth. IV

Ode I

#### *Igrán dhiodhefsas*

Pasi të njohe, o Theodor, si dashurues pas Perëndisë dhe pasi u lidha prej mallëngjimit tënd të pashmangshëm, të përkushtoj shpirtin edhe trupin, si dhe fjalët e lavdërimeve.

Po shkruhej dekret hyjnyres, që të ofrohej flijim tek idhujt dhe jo te Perëndia i gjallë,<sup>44a</sup> por u solle, o athlor, jo për të flijuar, por për t'u ofruar te Perëndia.

Meqenëse u mbërtheve prej dashurisë hyjnore të Perëndisë së tërëllartë, u mobilizove<sup>45</sup> për Birin e vetëmlindur,<sup>46</sup> o martir Theodor, dhe nuk dështove në çmime.

#### *Hyllindësor*

Rreshtim engjëllor si dhe njerëzor, nënë e panusëruar, pa pushim të lëvdajnë, se Krijuesin e tyre kishe në prehrin tënd, si një foshnjë e mbajte ti.

#### Ode III

##### *Si i to sterëoma*

Po sjell himn nga buzët e mia dhe lutje nga zemra ime me dhimbje; atë dhembshuroje shumë, o athlor Theodor.

Mishin ia nënshtrove mendjes sundimtare,<sup>47</sup> o martir i lavdishëm, dhe me të dya i shërben Krijuesit.

Qëndrove mbi podium tiranik duke theologuar për mbretin Krisht, sepse mohove të flijojte te të rremët.

#### *Hyllindësor*

Të gjithë të kemi ty përkije dhe mur bashkë; çdo i krishterë pra, të lavdëron fort pa pushim, o Hyjnënë Zonjë.

#### Ode IV

##### *Isakikoa Kirie*

Kur shijove mençurisht misteret hyjnore të lindjes së Perëndisë, o martir Theodor,

shpalle shpëtim që nuk turpëron.

**A**dhuruesit e pasioneve e konsideronin Hyjninë si me pasione; ata i kritikove, o atlet Theodor, i ndriçuar nga Shpirti.

**P**ërgjërrohemi, o Theodor i lumtur, që, përmes lutjes së atyre që të përhimnojnë, të na çlirosh nga peripeci të shumëllojshme dhe pasione.

#### *Hyjindësor*

**O** Perëndilindëse, arë e palëruar që nxore kallirin jetëbërës,<sup>48</sup> i cili i jep botës jetë,<sup>49</sup> shpëtoji ata që të himnojnë.

#### *Ode V*

##### *Orthrizontes voomen si*

**O** atlet Theodor, u thërrisje bashkatletëve të tu martirë: Kini mall për Zotin që ka mall.

**S**apo u flakërove në zemër me zell, o athlofor, e shkrubove perëndeshën e rreme bashkë me tempullin.

**M**e fuqi të pamposhtur, o athlofor Theodor, asgjësoje arrogancën e barbarëve dhe pasionet e mia.

#### *Hyjindësor*

**O** Hyjindëse, të himnojmë si virgjëreshë pas lindjes, sepse Fjalën Perëndi<sup>50</sup> kishe në bark për hir të botës.

#### *Ode VI*

##### *Ilësthi mi, sotir*

**S**a i paralizuar, sa i pafuqishëm ishte tërbimi i perëndive të kotë! Për mbrojtjen e tyre nevojiteshin njerëz dhe mundeshin nga rezistenca e martirëve të sinqertë, të cilët predikonin të vërtetën. (2x)

**P**asi u përforcove nga fuqia e Perëndisë, o Theodor, lavdia e martirëve, shtrembërimet e të pabesëve i shikoje si shigjetime foshnjash,<sup>51</sup> duke paraparë amshi-

min e të ardhshmeve, o i lum.

#### *Hyjindësor*

**L**e të çlirohemi pra nga shkeljet e rënda, o Hyjnë e kulluar, ne kreyt dhe me përgjërimit tënd të gjejmë ndriçim hyjnor nga ai që mori mish prej teje, Biri i Perëndisë.

#### *Kontaqi Ting. Tërth. IV*

**P**asi e more besimin e Krishtit si parzmore<sup>52</sup> brenda zemrës sate, i shkele tërësisht fuqitë kundërshtare, o shumë triumfues, dhe u kurorëzove përjetësisht me rreth qiellor, si i pamposhtur.

#### *Ode VII*

##### *I ek tis Iudheas*

**U** fshikullove në trup për hir të Fjalës që u fshikullua po në trup për ne, dhe atij i ngazëlluar i thërrisje me hare, o athlofor Theodor: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>53</sup>

**S**i Çlirimtari i gjithçkaje u vendos në varr dhe u vulos vullnetarisht, edhe ti, athlofor Theodor, qëndrove në burg të vulosur dhe thërrisje: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>53</sup>

**P**asi vdiqe dhe i hodhe larg lirshëm pasionet e mishit,<sup>54</sup> o athlofor, duke u ushqyer jo me gjellë, por me mallin hyjnor, këndoje: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>53</sup>

**S**iç ndodhi në kaminë dikur me të Rinjtë, njëri nga Trinia e pacen të inkurajon dhe ty në burg, o athlofor, si t'u shfaq<sup>55</sup> teksta këndoje: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>53</sup>

#### *Hyjindësor*

**P**ër shpëtimin e botës, në pëqi virgjëror ke banuar ti, o Jisu, dhe Nënë Virgjëreshë, e cila të ka lindur, na e bote ne mbrojtëse. O Perëndi i etërve, o Zot je i bekuar.<sup>53</sup> \*



*Ode VIII**Eptaplasios káminon*

I pari i të paligjëve, i sakatuar në mendje, të qortonte pabesisht ty shpresëplotin: "O idiot, pse i vure shpresat kot te një njeri vdekatar?". Por ti thërrisje: O Djem, bekojeni; priftërinj, përhimnojeni; popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.<sup>56</sup>

Si administrator i mençur dhe i urtë i Hirit,<sup>57</sup> me hirin që t'u dhurua prej Perëndisë, o Theodor, i thërrisje atij që të urdhëronte pabesisht: Kjo qoftë turp për mua dhe për ata që këndojnë: O Djem, bekojeni; priftërinj, përhimnojeni; popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.<sup>56</sup>

Garove si i ri, kritikove prerë dhe i thërrisje tiranit: Pse bëhesh idiot, duke urdhëruar të adhurojnë në mënyrë false krisjesat, duke braktisur Krijuesin?<sup>58</sup> Por unë i këndo atij, Krishtit, të cilin Djemtë e bekojnë, priftërinjtë e përhimnojnë, popujt e përmbilartësojnë, në jetë.<sup>56</sup>

*Hyjindësor*

O Virgjëreshë, hyjfolësit e paralajmëronin lindjen tënde të përmbinatyrshme dhe të habitshme, me pamje trupore, enigma të larmishme dhe shfaqje simbolike e tipike; prandaj, duke u ngazëlluar, ty të përhimnojmë besërisht dhe Krishtin e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

*Ode IX**Se tin apirógamon*

Si lëndë e martirizimit tënd, o Theodor, ishte malli për Perëndinë; kështu, për ty trupi u bë i përshtatshëm për zjarrin lëndor, nëpërmjet të cilit u zhvendose i ngazëlluar drejt zjarrit hyjnor, o athlofor Theodor, shërbyes i Perëndisë.

O martir i tërëkënduar, shkrubove, por nuk të shkrumbuan dot, sepse ti e

dogje mashtrimin dhe qëndron i gjallë pranë Perëndisë<sup>59</sup> duke dëfryer tek ai si dëshmor, o athlofor Theodor, shërbyes i Perëndisë.

Si një të njohim ty, Krishtin, që je njëri prej Trinisë, në dy natyra të përsosura; këtë popull që e fitove me gjakun tënd<sup>60</sup> të çmuar, shpëtoje me lutjet e athlofor Theodorit.

*Hyjindësor*

Ne që jemi në peripeci, të madhërojmë ty që mbajte në prehër Perëndinë e pa-dukshëm, që himnohet në qiej nga çdo Fuqi dhe që na dhuron nëpërmjet jeje shpëtim përherë.

*Irmosi: Se tin apirógamon*

»Ty të madhërojmë me lëvdata pa-»shim, e virgjër,\* më e larta se Fuqitë pa»cen, që kishe pa burrë në bark\* përmes»fjalës<sup>61</sup> Fjalën Perëndi të vërtetë krejt\*»përmbi mendje; je nëna pra e Perëndisë»Zot.

*Trishenjtë dhe Përlëshorja**Ting. II*

Të mëdha janë arritjet e besës! Në bu-»rimin e flakës si mbi prehje uji ngazë-»llohej martiri i shenjtë Theodor, sepse,»pasi u bë holokaust, iu soll Trinisë si bukë»e ëmbël. Me përgjërimit e tij, o Krisht»Perëndi, shpëtoji shpirtat tanë.

## Lavdi

*Kontaqi Ting. Tërth. IV*

Pasi e more besimin e Krishtit si parzmo-»re<sup>52</sup> brenda zemrës sate, i shkele tërësisht»fuqitë kundërshtare, o shumë triumfues,»dhe u kurorëzove përjetësisht me rreth»qjellor, si i pamposhtur.

*Tani Hyjindësore*

O Mari, nënë-»virgjëreshë e tërëdëlirë,»shpëtimi i të krishterëve, të gjithë në fajto-

rët e kemi ndihmën tënde të nxehtë si mbrojtje dhe përkrahje të fuqishme; ndaj mos pusho së përgjyruari Shpëtimtarin për ne, që të na dhurojë ndjesë.

*Bekimi i grurit. Emri i Zotit qoftë i bekuar (3x). Psalmet 33 dhe 144 (fq. 67) dhe Përlëshimi.*

### CITIME

1. Num. 14.19 etj.
- 1a. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.40
2. Ps. 140.(141).1-2
- 2a. Ligji I Dytë 21.23; Gal. 3.13
3. Joan 10.15,17-18
4. Joan 10.28; 17.2
5. Kol. 2.15
6. Ef. 6.12
7. Matth. 27.51; Lluk. 23.44
8. I Joan 2.2; 4.10
9. Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
10. Eks. 16.33; Hebr. 9.4
11. Eks. 25.22-29; 39.18; 40.2; Lev. 24.6; Hebr. 9.2
12. Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
13. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
14. Abak. 3.3
15. Rom. 13.12
16. Joan 1.9
17. Fil. 2.8
18. Gjen. 3.6
19. Ps. 44(45).3
20. Joan 19.34
21. Gjen. 28.17
22. Lluk. 1.48
23. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28
24. Hebr. 9.13-14; 12.24; I Petr. 1.2
25. I Petr. 5.1
26. Is. 58.6
27. Gjen. 3.16-19
28. Gjen. 3.4-6
29. Ef. 2.19
30. Matth. 27.51
31. II Kor. 5.20
32. Gjen. 2.17; 3.3
33. Gjen. 3.22-23
34. Fja. Urt. 6.25
35. Fja. Urt. 24.13
36. Eks. 12.7, 12-13,22-23; Hebr. 11.28
37. Matth. 26.17; Mark 14.12
- 37a. IV [II] Mbret. 19.15; Is. 37.16; Jez. 10.1; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 31
- 37b. Is. 6.2-3; Apok. 4.8
- 37c. Matth. 14.2; Mark 6.14; Gal. 3.5
38. Ps. 78(79).8
39. I Kor. 16.10
40. Rom. 13.12-13
41. Is. 58.7

42. Gjen. 2.7; Ps. 102(103).14; Jov 10.9
43. Fil. 2.15
44. Gjen. 3.15
- 44a. Ligji i Dytë 4.33 etj.
45. II Tim. 2.3
46. Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
47. Ps. 50(51).14; IV Makk. 1.7,13,30; 16.1
48. Joan 6.33-35,48-51,58
49. Joan 11.25; I Joan 5.12
50. Joan 1.1
51. Ps. 63(64).8
52. I Thes. 5.8
53. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
54. Gal. 5.24; Kol. 3.5
55. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25
56. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
57. Lluk. 12.42; I Petr. 4.10
58. Rom. 1.25
59. III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
60. Vep. 20.28
61. Lluk. 1.28



### TË SHITUNËN E JAVËS SË PARË NË MËNGJESORE

*Pas Perëndia është Zoti, Përlëshorja e shën Theodorit (2x) dhe Hyjlindësorja e tij Të mëdha janë (fq. 110).*

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove  
Martirike e Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret e shenjtij  
Ting. III Thias pïsteos*

**O** martir plot lavd,\* zell për besimin\* orthodhoks kishe,\* shove krejt hilen\* e besimit fals dhe zhduke idhujtarin\* dhe ateizmin e saj; holokaust ti\* hyjnisht u bëre, freskon me çudi çdo skaj,\* botën mbarë; përgjyruhu te Krishti Perëndi,\* të na dhurohet përdëllim i madh<sup>1</sup> dhe hir.

### Lavdi

**Si** dhurim hyjnor\* në botë Zoti\* për shpëtim të dha\* kur të forcoi,\* Theodor martir, në garë, ai shëron\* sëmundjet pra shpirtërore si edhe flak\* me plot triumf dhe pësimet e trupave;\* athlofor, ti për-



gjërohu te Krishti Perëndi,\* të na dhurohet përdëllim i madh<sup>1</sup> dhe hir.

Tani *Hyllindësore*

Virgjëresh' pa cen,\* që brenda mitrës\* mbajte Perëndin',\* krejt të panxënin\* që pa farë lindi përpara jetëve\* prej Atit, Birin e njëqenshëm, Fjalën Zot\* enipostat, përgjëroju atij bashkë\* me profetët dhe martirët, asketët oshënar,\* të drejtët, të na japë ndjesë fajesh krejt.

*Kanunet: i shenjtit të kishës në 6 dhe të dy të shën Theodorit në 8.*

*Kanuni i shën Theodorit (poezi e oshënar Joanit të Eskaitës), i cili ka Akrostihidhë në troparet e para: "Joani", ndërsa në të tjerat: "Tironi i famshëm, është lavdi për të shtunën e parë". Në troparin e parë të çdo Ode të Kanunit të parë si dhe në Hyllindësorin e tij, Varg: "E Përbishenjtë Hyllindëse, shpëtona", në të tjerat: "O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne"; në dy troparet e fundit të çdo Ode: Lavdi edhe Tani, si zakonisht.*

*Ting. IV*

*Ode I*

*Aniko to stoma mu*

I qeni më tej se çdo gjë, të ka vënë përpara ty\* nga tërë të zgjedhurit e tij, meqë linde pra\* parrëfyeshëm;\* fillojmë, e himnuar,\* nga ti sot t'i i psalm të kurorëzuarit.

Atletin e ndritshëm fort, të madhin midis martirëve,\* dhe tepër të famshëm, të dëgjuar, që është pra\* shenjt i shquar mjaft\* përmes çudish në çdo skaj\* mbi dhé, Theodorin, himnoj edhe këng' i psal.

Një ditë gëzimi lindi mes atyre që kan' trishtim\* edhe krejt e zhduku zymtësin' e tyre, se shndrit\* nur, paraprakisht\* nga larg plot hir kremtimi\* i shën Theodorit, martir, athlofor me lavd.

Flijimi i shenjtë Kishën e spërkat, e pastron me gjak;\*<sup>1a</sup> për vete i theruri Krisht Zot e mori si fli,\* e pranoi, se\* ai garoi fort mjaft\* për lavdin e tij të shkëlqyeshëm dhe hyjnor.

*Hyllindësore*

Mendoj se, sado që s'puqet hiç me kohën kremtimi yn',\* por është i mir', se Zonja që stolisi çdo gjë,\* na tregon tani\* se merr pjes' në festimin\* e shenjtit që ish në rrezik dhe dha gjak për të.

*Kanuni tjetër, poezi e të njëjtit Joan*

*Ting. Tërth. II*

*Os en ipiro pezefas*

O i çuditshmi ndër shenjtë vërtet,<sup>1b</sup> o Krisht\* Perëndi, ma shfaq qart', Zot,\* mrekullisht mëshirën ti,\*<sup>2</sup> duke më dhuruar fjal',\* të mburr, të himnoj mjaft të çuditshmet e martirit tënd.

Ke shfaqur stabilitet dhe durim në gar',\* athlofor i Zotit Krisht\* Theodor, në dhimbje pra\* dhe nga ana tjetër ti\* zbulove përkrahjen tënde aq të shpejtë drejtas nesh.

Zmbrapsi tirani nga shpirti i tij i keq\* besën atërore pra\* që e mirë është krejt;\* deshi një mendim pa fe,\* të ecte gjithnjë si kundërshtar i Perëndisë Zot.

*Hyllindësore*

Qart' u përbushën në ty, Nënë-virgjëresh',\* sa qëmoti parathan'\* burra shenjt', hyjfolës mjaft,\* se ke lindur mbi mendim,\* habitshëm dhe tmerrshëm Perëndi, Zot të vërtetë krejt.

*Zbritësore: Aniko to stoma mu*

»Ja gojën e çel tani i frymëzuar prej »Shpirtit<sup>3</sup> Shenjt\* dhe këngë do t'i këndoju »nënës së madhe mbi fron;\*<sup>4</sup> dhe do ta »kremtoj\* me valle buzëqeshur,\* me zë »do t'i shpall kudo gjithë çudit' e saj.\*

*Ode III**Tus sus innologus*

Të ka, Zonjë, ty dhe athloforin tënd plot lavd si parafigurim,\* parakremtim vet' populli me emrin shenjt të Birit tënd,\* edhe do që ta shohë ditën e tij,<sup>5</sup> ndaj po kremton tani.

Përmbizotërojnë më të mirat në çdo rast; atleti më i madh\* pra, në hare e ktheu zymtësinë që ka moti vet';\* tensionin e kreshmimit plot ndriçim e ktheu në lehtësim.

Ke vënë themel të mirë, o i shkëlqyer, përmes arritjesh mjaft;\* mposhte më të çuditshmen trimëri ti, bishën, djallin tmerr\* shfarosës që fryn vrasje dhe zjarr,<sup>6</sup> e shpërfille, se pa forc' qe.

*Hyllindësor*

U mbush dheu mbarë, o e Virgjër, prej dijes së Zotit<sup>7</sup> që lu shfaq\* botës nga ti, por nder, lavd u përket martirëve të shenjt',\* të hyjshëm, se forcan të vërtetën me jetën që bënë.

*Tjetri: Uq estin ajios os si*

Përpara, gjarpri shpifarak\* Evës i pëshpëriti\* mu në vesh, dhe me të Adamin e mashtrioi keq;<sup>8</sup> po ky tani për dredhi\* e hedh helmin e së keqes djallëzisht.

Dhe veten e mashtronte ky,\* kishte inat, mëri keq\* ndaj të mirëve, dhe kërkonte të përshtatshmen koh',\* që ta ushtronte dredhisht,\* i paligjshmi krejt, urrejtjen vrer të tij.

Arriti koha për kreshmim,\* ditët e shenjt, kur pra\* me mjaft vetëpërmbajtje zellshëm veten e pastron\* çdo i krishter', ikën larg,\* distancohet, nga çdo gjë që e dëmton.

*Hyllindësor*

E Tërëshenjta Virgëresh',\* streha dhe mbrojtja, shpresa\* e fuqishme e botës, o e mirë, mos shpërfill\* çdo lutje që bëjn' me mall\* shërbëtorët që të lumërojn' gjithnjë.

*Zbritësore: Tus sus innologus*

»O Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim i pasosur jetësor, ti siguroji gjith' ata që të këndojnë plot me zell; dhe lart në q'ell »ku mbretëron kurorëzoi me çdo lavdi.\*

*Ndenjësores**Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon*

More ti armatimin<sup>9</sup> hyjnor, kështu\* e rrëzove mashtrimin, idhujt pa shpirt,\* dhe engjëjt i nxite mjaft\* ta lëvdonin luftimin tënd,\* se mendja jote digjej prej mallit të hyjshëm krejt,\* dhe me fuqi shpërfille dhe vdekjen në zjarr plot tmerr;\* ndaj te sa kërkojnë, jep karizma të hyjshme\* sipas emrit, Theodor\* athlofor, shenjt: dhurim, shërim\*<sup>10</sup> në sëmundje dhe në lëngat';\* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,\* të na dhurojë ky ndjesën\* e fajeve\* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

*Lavdi*

Maksimini s'të joshi dot me miklim,\* u forcove me fjalët e Zotit Krisht\* dhe tempujt paganë bosh\* i shkrumbove me flakë, zjarr;\* fitove mbi armikun porsin një atlet i mir',\* profetikisht përshkove në zjarr dhe në ujë<sup>11</sup> ti;\* si shpërbllim për garat denjësisht nxjerr edhe jep\* shërim te sa besërisht\* e kërkojnë, o Theodor\* i lëvduar\* dhe athlofor,\* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,\* të na dhurojë ky ndjesën\* e fajeve\* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

*Tani Hyllindësore*

Vajzë, Zonjë dhe nuse krejt e pacen\*<sup>12</sup> e Krijuesit, nënë që burrë s'njeh,\* na linden e Çlirimtar,\* o Hyllindëse, enë je\* e



Shpirtit Shenjt dhe Ngushëllimtar;<sup>13</sup> por un' jam vërtet\* bodrum i turpshëm paligjësish, jam me dijeni\* lodër djalli, e tërëhimmuar, nxito pra,\* shpëtomë nga çdo dhunim\* që pësoj, dhe shndërromë krejt\* në banesë\* të ndritshme nur\* të virtytit edhe dëbo\* çdo re pasionesh prej meje;\* më denjëso\* të fitoj lartësi dhe dritë që s'perëndon.

#### Ode IV

##### *O kathimenos en dhoksi*

**O**h! Një përzjerje e re dhe paradoksale: Perëndinjeriu, kur lindi, bashkoi lindjen me virgërinë, ndërsa ditët e zymta i përzjeu me të sotmen e ngazëllueshme dhe e nderoi atletin e tij.

**S**hih sa e donte<sup>14</sup> Krishtin ai që mobilizohej për të!<sup>15</sup> Sepse armiqtë e tij i shfarosi me zell dhe zjarr, dhe në fund e dha veten me gatishmëri si fli të pëlqyeshme dhe të mirëpritur prej tij.<sup>16</sup>

**T**rimi u largua nga të këtejshmet si fitimtar me triumfe, pasi i çuditi spektatorët me guximin e fjalëve dhe përbuzjet e torturave dhe pasi u bë një pamje e re dhe paradoksale në tërë Krijesën.<sup>17</sup>

**N**uk u dërrmua asnjë kockë e Perëndisë, Zotit tim,<sup>18</sup> – o çfarë zemërgjerësie! – kur ai pësonte dhe pas vdekjes;<sup>18a</sup> ndërsa ushtarin e tij që vuajti zjarr, kur vdiq, rrota e respektit dhe nuk e preku.

#### *Hyllindësor*

**S**hërbyesit që vdiqën tok me Zotin e jetës<sup>19</sup> dhe u ngjallën së bashku,<sup>20</sup> jetojnë tani me të përjetësisht dhe si bij e lavdërojnë bashkë Nënë, duke bekuar Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë.

#### *Tjetri: Hristós mu dhinamis*

**M**jerani tepër pa fe ka një mendim dhe

e studion. Me të vërtetë është i frikshëm, sepse vendos të njollosë rëndë popullin e Krishtit nëpërmjet ushqimeve të fëlliqura.

**E** bëri vepër mendimin e paligjshëm kur urdhëroi të mblidheshin ushqimet e pastra që ishin shtruar përpara, dhe të vendoseshin ato që ai i kishte njollosur shumë me gjakra.

**F**aji u bë i dëgjuar ndër tërë të krishterët dhe u përbuz prej tyre; prandaj dhe ata rendën të gjithë së bashku në kishën e shenjtë të Zotit kur mësuan për ty.

#### *Hyllindësor*

**T**ani ne besimtarët e vëmë para teje si ndërmjetëse atë që të kishte në bark ty të parajetshmin që llinde prej Atit; i përkulur në lutjet e saj, bëhu i butë për shërbëtorët e tu.

#### *Zbritësore: O kathimenos en dhoksi*

»**T**i që rri midis lavdisë\* përmbi fronin<sup>20a</sup> «e hijëshëm,\* nga një re e lehtë\*<sup>21</sup> erdhe, «o Jisu i përjetëshëm\* dhe na shpëtove «me dorën jetëdhënëse;\* të thërresim «pra,\* nder dhe lavdi gjithënjë mbi ty.\*

#### Ode V

##### *Eksesti ta simpanta*

**U** hapën sot portat e Hirit dhe kjo ditë e pushimit e parakonizon ditën e ngjalljes; meqë është shumë dritëprurëse, ajo mburr Zonjën e shkëlqyer dhe martirin e lavdishëm.

**A**tyre që duan shfaqjen e të dashurit që u duk,<sup>22</sup> Perëndia u dhuron dhuratën sinonime, Theodorin, që kreu çudi hyjnore, si bërës veprash paradoksale.

**O** armik i shpëtimit të njerëzve, s'ishin asgjë për martirin harkat dhe shigjetat e tua, sepse, ndonëse i vdekur, jeton, është në gatishmëri dhe, duke u rezistuar krime-

ve të tua, shpëton çdo të krishterë.

### *Hyjlindësor*

Çudia e Hybijës shkaktonte habitje më parë, por me dëshmitë e atletëve u bë e besueshme, e padyshimtë; dhe e besueshmja mbetet përgjithmonë e admirueshme dhe asaj i falemi besërisht.

### *Tjetri: To thio feji su agathë*

Kryepifti i atëhershëm pra, pasi u çudit i tëri sapo mori vesh mendimin e të pabesit, gjithë natën me himne i lypte Perëndisë që të mos e shpërfillte përfundimisht<sup>23</sup> popullin, trashëgimin e tij.

Dhe ai që vërtet është ndihmëtar i shpejtë i atyre që e thërrasin me lutje të nxehtë me sinqeritet, nuk neglizhon fare; por ua realizon tepër shpejt asgjësimin e atentatit.

Nga më të lartat dërgohet në tokë tepër shpejt përkrahësi, athlofor Theodhori, dhe i paraqitet kryebariut duke i mësuar asgjësimin e mendimit të paligjshëm.

### *Hyjlindësor*

Askush që rend ngrohtësisht drejt përkrahjes sate, o Zonjë, kurrë nuk turpërohet; por kërkon Hirin dhe merr dhuratën shumë shpejt, sipas interesit të kërkuesit.

### *Zbritësore: Eksesti ta simpanta*

»Të gjithë i habite ti me një çudi dhe një »lavdi, ti, o Virgjëreshë' e pamartuar, Zotin »e jetës që mbretëron<sup>24</sup> lart në q'ell si »një bir e mbajte në pëqi dhe shpëtim që »lartazi u dhurove besnikëve.\*

### *Ode VI*

### *Tin thian taftin qe pântimon*

Nuk mund, o Zot, Shpëtimtar, që të kreshmojnë miqtë,<sup>25</sup> bijtë e nusërores sate, meqë ti\* je i pranishëm,<sup>26</sup> të presin pra\* dhe të shërbejnë' ty, Dhëndrit,<sup>27</sup> me nënën,

mikun tok.

Nga Perëndia shpëtues<sup>28</sup> u largua, meqë humbi krejt mendjen, kundër besës ngrihej fort;\* bëri i keqi mjaft marrëzi,\* por gjeti famëmadrin në vend të saj ai.

Veprroi trimi me ngrohtësi, kështu që më i urtë nga veshët; meqë ish ushtruar mir',\* kundër tiranësh luftoi fort,\* triumfet s'i pushoi, sado i vdekur është'.

### *Hyjlindësor*

Shpëtuam sot nga rrezik shpirtprishës, Zonjë, me çudinë e athloforit tënd, se ti për ne\* ke providencë të hyjshme pra,\* ndaj ju falënderojmë të dy dhe ju lëvdojm'.

### *Tjetri: Tu viu tin thálasan*

Kur shfaqesh çuditërisht,\* kryepiftin e habit,\* të pyet: O zot, kush je ti\* që me mua po flet? Na mëso, na bëj\* të njohur se si të gjejm'\* sa më shpejt ndihmë në rrezik edhe shpëtim.

I tha Theodhori shenjt:\* Qartësisht atlet jam un',\* dëgjo, të ziesh grurë ti\* dhe ta ndash midis popujve dhe kështu\* nga gjellët e ndotura\* të të papastrit do shpëtoni sigurisht.

Çudi mjaft e madhe është'\* ndihma jote plot habi\* dhe paradoks, o Theodhor,\* ndaj besim sinqerisht kemi shumë' te ti,\* përkim te ti krejt ne;\* shërbëtorët e tu shpëtoji, lutemi.

### *Hyjlindësor*

U bëre banes', shtëpi\* drite, en' e pastër nur\* e Fjalës Krisht, kur Shenjti Shpirt\* erdhi me mirëdashjen e Atit Zot\* te ti, Vajz',<sup>29</sup> ndriçomë pra,\* e kulluar, e virgjër dhe Hyjlindëse.

### *Zbritësore: Tin thian taftin*

»Këtë të kremte e lusim sot për Zo-



»njën edhe nënën Hyllindëse, gjithë hyj-  
mendësit, eni trokisni pra duartë dhe  
»lavdëroni Zotin që lindi prej asaj.\*

#### *Kontaqi Ting. Tërth. IV*

**P**asi e more besimin e Krishtit si parzmor-  
re<sup>30</sup> brenda zemrës sate, i shkele tërësisht  
fuqitë kundërshtare, o shumë triumfues,  
dhe u kurorëzove përjetësisht me rreth  
qiejlor, si i pamposhtur.

#### *Shtëpia*

**T**ë himnojme me kënaqësi besërisht  
ty që ke hipur mbi fron drite,<sup>31</sup> sepse ke  
dhuruar dhunti hyjnore, Theodhorin, tri-  
min në arritje, tri herë të lumtur në jetë,  
meqë ishte luftëtar i së vërtetës;<sup>32</sup> sepse,  
përderisa e fitoi Krishtin me mendim  
besëmirë,<sup>33</sup> u tregua fitimtar i pushtet-  
shëm ndaj tinëzarit, si i pamposhtur.

#### *Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:*

Në të njëjtën ditë, të Shtunën e Javës së  
Parë të Kreshmëve, kremtojmë mreku-  
llinë paradoksale me anën e grurit, të  
martirit të madh, të shenjtë dhe të lavdi-  
shëm, Theodhor Tironi.

*Vargje:* Me ushqim gruri, Tironi gostit  
qytetin/ duke shfuqizuar shijim të njollosur.  
Me ndërmjetimet e tij, o Perëndi, mëshirona  
dhe shpëtona. Amin.

#### *Ode VIII*

#### *Uq elatrefsan*

**O** Zot i drejtë, ti the se nuk ka ligj për të  
drejtët<sup>34</sup> e tu; prandaj nëna jote dhe ai,  
shërbyesi yt i shumadmirueshëm, mënja-  
nojnë sot ligjet e keshmës nga ngazëllimi  
i kujtimit të tyre.

**S**a i ëmbël, i madh dhe ngazëllues është  
panairi i tanishëm, të cilin na e organizoi  
tani më i bukuri dhe më i madhi i mar-  
tirëve nëpërmjet një çudie, kur e ktheu të  
pacen nga të papastrat popullin e Krishtit!

**A**të që kundërshtoi dragonjtë e tmerr-  
shëm dhe fitoi tashmë mbishpirtprishësin,  
shkatërruesin e trupave me frymë, le ta  
kurorëzojmë me këngë triumfuese dhe  
rrathë lavdërimesh.

#### *Hyllindësor*

**K**ryetari i gjinisë, ndonëse e dinte që  
më parë ushqimin shpirtvrasës, nuk u  
distancua prej tij,<sup>35</sup> por populli yt besnik,  
sapo mësoi më parë prej martirit tënd, e  
evitoi ushqimin shkatërrues dhe bëri fli  
shpëtimi te ti, o Zonjë, së bashku me të.

#### *Tjetri: Dhrosovolon men tin káminon*

**U**shfaqe, o i lavdëruar, si re freskie<sup>35</sup>  
kundër topitjes dhe flakërimit, dhe nga  
kamina tiranike i shpëtove<sup>36</sup> të gjithë  
shpresëplotët që këndonin: I bekuar je, o  
Perëndi i etërve tanë.<sup>37</sup>

**O** mbret tepër ilegal, të të vijë turp, dhe  
t'u mbylltë<sup>38</sup> ajo gojë, që shqiptoi men-  
dim të paligjshëm kundër nesh, sepse  
e shkatërroi fuqinë tënde Mbreti i mbre-  
tërve dhe Zoti i të gjithave.<sup>39</sup>

**O** Julian idiot, zemra jote, që intrigoj tinëz  
kundër nesh, është e tëra e mbushur me  
të keqe, helmohet dhe ndalohet prej Pe-  
rëndisë tonë të urtë,<sup>40</sup> ndërsa ai na jep  
haptas hir neve që thërrasim drejt tij.

#### *Hyllindësor*

**Z**ënia jote u bë përmbi fjalë dhe lindja  
jote përmbi mendje, o e Tërëpaqortuar,  
sepse linde Perëndi në mish që na shpë-  
toi të gjithë nga prishja; prandaj tani të  
lavdërojmë, o Hyllindëse e bekuar.

#### *Zbritësore: Uq elatrefsan*

»Nuk u faleshin krijesave hyjmendësit,  
»por Krijetarit<sup>41</sup> lart,\* dhe kërcënimin me  
»zjarr\* e shkelën me trimëri, psalnin me  
»brohori:\* Zot, lavdi më ty;\* o Perëndi i

«etërve,\* ti je vetëm i bekuar.<sup>37\*</sup>

### Ode VIII

#### Litrotá tu pantós

Ajo që me lindjen e mbushi me gëzim Gjithësinë, qielloret dhe tokësoret, i jep hir të përshtatshëm zymtësisë së kohës, duke e bërë shkëlqyeshëm krenmtimin për hir të të kurorëzuarit.

O njerëz, le të çlodhemi sot,<sup>42</sup> duke pshuar nga lodhjet<sup>43</sup> e djeshme, për shkak të atij që e bekoj këtë ditë me pushim<sup>44</sup> dhe me panairin e tanishëm të martirit.

Me të vërtetë kjo është e para ndër të shtuna<sup>45</sup> dhe mund të quhet e shtuna e të shtunave, se është mbushur plotpërplot me hir dhe fuqi hyjnore dhe është rithirrje e shpëtimit shumë të madh.

I pastr, nëpërmjet ushqimeve të pastra të Mbretit Perëndi, i shfuqizoi në mënyrë paradoksale çudibërëse ndotjet e mbretit të paligjshëm dhe e shenjtëroi ditën e shtatë të shenjtë.<sup>46</sup>

### Hyjlindësor

Vdekja me gatishmëri e martirëve e vërteton misterin tënd, o Vajzë, sepse, meqë e besuan si Perëndi atë që lindi, ndonëse duroi vullnetarisht pësim,<sup>47</sup> për këtë e flijuan veten e tyre ata trimat.

### Tjetri: Ek flogós tis osiis

Siç u çlirove nga flaka me fuqi hyjnore, o martir Theodor, kështu dhe tani na shpëtove ti vetë nga vendimi i paligjshëm intrigant me ardhjen tënde.

Në darkë i kapi qarja shërbëtorët e tu për shkak të pusisë dinake të shkelësit tonë, mirëpo në mëngjes shkëlqeu hareja<sup>48</sup> me anën e ndihmës sate të ngrohtë, o martir i durueshëm.

O martir i Krishtit, athlofor Theodor, ne

që ramë në rreziqe, të patëm çlirimtar dhe shpëtues nga dredhia e armikut; të lavdërojmë në gjithë jetët.

### Hyjlindësor

O e dëlirë, s'ka mënyrë që mendja e njerëzve ta shprehë misterin e shtatzënisë sate; dhe kështu të nderojmë me plot besim si Perëndilindëse dhe të lavdërojmë në gjithë jetët.

### Zbritësore: Pedhas evajis en ti kamino

»Djemtë e dënuar për t'u djegur, prej zjarrit i ka shpëtuar lindja e Zotit Krisht, si simbol në lashtësi<sup>36</sup> edhe si veprim tani »dhe tërë botën po e mbledh për këng' »e lavdërim; himnojeni ju, veprat e Zotit, »dhe e lartësoni përmbi të gjitha jetët.<sup>49\*</sup>

### Ode IX

#### O tokos su áfthoros edhihti

Me vrap mbildhen turmat nga çdo vend për në Tendën që ka dëshmitë,<sup>50</sup> hirin\* brenda saj; këtë hirin e martirit që me lavdshndrit para çdo shenjtë,\* e madhërojmë\* tok me Zonjën e të gjithave.

O Kishë e Krishtit, fuqizohu, sundo përmbi sa kot të luftojnë,\* sepse miqtë e tij<sup>51</sup> prezentë edhe joprezentë të mbrojnë mirë,\* si trimi ynë\* që po e falënderon me gaz.

Ai që u duk se vdiq më par', faktet po e tregojnë se jeton, rron,\* pas mbarimit dhe mbron sërish besimin nëpërmjet të njëjtit zell shenjtë;\* e madhërojmë,\* se është pasje mirëbërësi.

### Hyjlindësor

Të sjell, të vendos mbi himnet vulë të hyshme ty, librin e vulosur\* të Jisuit Zot, dhe mbledh lavdërimin e drejtuar te ti, e Virgjër,\* edhe më tepër\* po mburr unë dhe martirin tënd.



*Tjetri: Theon anthropis idhin*

**U** shfaqe mbrojtës i mirë, ndihmëtar\* me forcë, o i lavdëruar krejt për ne që tani\* e nderojm' kujtimin tënd plot famë, respekt\* tok me arritjet gjatë garave, o atlet,\* dhe përkrahjen e hyjnueshme që na u bë neve.

**Ç**udia jote e kryer pasurisht,\* si shenjtë shi madhor ajo këndohet kudo mbi dhé,\* Theodor i tërëlumtur, mblidhemi pra\* çdo vit dhe i drejtojmë lavd Krishtit Perëndi,\* që të lartësoi dhe të bëri të mahnitshëm ty.

**M**artir i Krishtit, meqë sheh mallin ton',\* ne që të mburrim, na shpërble me hirin e bollshëm ti,\* se e di sa besë kemi, ndaj pa pushim\* j! për ne, shfaqu ndërmjetues i ngrohtë fort,\* dëshmitar te Perëndia, o i lavdëruar shumë'.

*Hyjlindësor*

**S'**pushojm', e Virgjër, të të himnojmë ty,\* strehën, përkrahjen dhe të shpejtën ndihmë dhe mbrojtësen\* e paturpëruar, që kujdesesh për ne;\* ne shërbëtorët e tu ruana nga çdo hall,\* na çliro gjithnjë nga çdo dredhi, rrezik, dert djallëzor.

*Zbriëso: Apas jjenis*

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazëllim tek »drit' e Shpirtit Shenjt',\* eni lavdërojeni,\* »engjëjt e q'ellit eni kremtojeni\* këtë të »shenjtë panair të Kryezonjës Mari\* dhe »thërrisni: Ti je më e lumura,\* Virgjëresh' »e kulluar Hyjlindëse.\*

*Dërgimësore*

*Tis mathitës sinélthomen*

**J**e i kurorëzuar ti,\* i shenjtë, dhe me engjëjt\* qëndron tani, o athlofor,\* lart, pranë podiumit\* të Krishtit,\*<sup>52</sup> mbushesh me dritë\* atje; ndaj pa ndërprerje\* për botën mbarë ndërmjeto,\* paqe të ketë dhe ne

shpëtim me hir\* se kujtimin tënd dritë-prurës plot lavd\* me bes' kremtojmë, Theodor,\* zëmadvh, martir i pasur.

*Hyjlindësore*

**N**ë barkun tënd vullnetarisht,\* siç dinte, ndenji Zoti,\* nga prishja ta riftonte pra\* botën që po humbiste;\* ndaj, si e gjetëm shpëtimin,\* gjithë ne të thërrasim\* si engjëlli me plot lavd ty,\* o Hyjlindëse: Je e bekuar ti\* midis tërë grave; gëzohu,<sup>53</sup> Vajzë,\* sepse ke lindur ngazëllim\* për mbarë sferën, dheun.

*Lavdërime*

*Ting. I Ton uranion tagmaton*

**T**a mburrim ne të shkëlqyerin në ushtrinë lart\* si luftëtar të fortë\* për besimin e mirë,\* o besnikë që u mblodhëm me gaz,\* me një zë odet mistikisht\* t'ia themi: Lutu për sa të nderojn', martir\* i Jisuit; ty të admirojm'.

**D**huratë Zoti, sipas emrit tënd vërtet, i dhe\* si ngushëllim secilit\* që shtrëngohet në dhimbje,\* o shën Theodor i lumtur tri her';\* se çdokush që vjen sinerisht\* te kisha jote, me gaz merr shpërblim nga ti,\* plot çudi, dhe lavdëron Krishtin.

**U** pasurove me pasje besimi dhe ndriçim\* me lodhje atletizmi\* dhe ia dhe Perëndisë\* tërë forcën tënde porsi dhurat' \* të pranueshme,<sup>16</sup> si ofrim;\* dhe ftesën tënde, dhuratën nga Zoti Krisht,\* e përmbushe me luftim plot zell.

**T**ë gjithë në panairin fort të ndriçueshëm\* të shenjtit, të martirit,\* me gaz, bes' të dëfremjë\* dhe le ta nderojmë ditën e tij,\* të mbarimit të tij, ka hir\* dhe, kremtimdashës, Jisuin ta përhimnojm'\* që kujtimin ia lëvdoi krejt.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Si dhuratë shenjtërimi dhe pasuri jete hyjnore u shfaqe në botë, o Theodor, sepse Krishti e lavdëroi kujtimin tënd, o i urtë; gjatë tij, shprespëlotët himnojmë me ngazëllim dhe me një zë luftërat e mundimeve të tua.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,<sup>54</sup> që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me athloforin dhe me gjithë shenjtoret, që të mëshirohen shpirtat tanë.

*Pasvargje Idhiomele të Lavdërimeve  
Ting. Ting. III*

Koret e martirëve kërcëjnë me hare tani në kishën tënde, o athlofor Theodor, dhe rendet e engjëjve duatrokasin për trimëritë e rezistencës sate; dhe vetë Krishti kurorëdhënës është i pranishëm duke iu dhuruar me të djalhtëm himnuesve karizmat që pasurojnë; Krishtin me mallëngjim e kërkoje, o shenjt, dhe, sapo e gje-te, komunikove me të siç dëshirove me mallëngjim; atij përgjëroju që t'i shpëtojë dhe t'i ndriçojë shpirtat tanë.

*Varg:* Do të dëfrejë i drejtë në Zot.

Kreshma e pastër dhe e tërëpaqortueshme, pasi na erdhi tani, futi edhe ceremoni mrekullish martirike, sepse nëpërmjet kreshmimit pastrohemi nga njollat dhe ndotjet shpirtërore, dhe me anën e çudive e të arritjeve të dëshmorëve përforcohemi burrërisht e trimërisht kundër pasioneve; prandaj, duke u ndriçuar prej hirit të vetëpërbajtjes së hyjshme dhe çudibërjeve të martirit Theodor, mbështetemi në besimin e Krishtit, duke i kërkuar që t'u dhurojë shpëtim shpirtave tanë.

*Varg:* I drejti si palmë do të lulëzohet dhe

si kedër në Liban do të shumëfishohet.

Me guximin tënd martirik para Perëndisë, o Theodor, e asgjësove dredhinë e Shkëlësit kundër besimit të Krishtit, meqë u bërë luftëtar i popullit besëmirë, përdërisa me ardhjen e frikshme e çlirove nga ushqimet e njollosura prej flijimeve idhujtare; ndaj të nderojmë si rrëzues të idhujve, rojë dhe shpëtimtar të grigjës së Krishtit si dhe mbrojtësin tonë që na dëgjon shpejt; dhe lypim me këngë që t'u dhurohet përmes teje zbutje dhe ndriçim shpirtave tanë.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Pasi u armatose besërisht me trimëri atletike dhe adhurim të arsyeshëm,<sup>55</sup> o athlofor i Krishtit, me fuqinë e tij si luftëtar mistikisht e faktove pabesinë e idhujve dhe si të dobët egërsinë e tiranëve, kur shpërfillje torturat dhe zjarrin e përkohshëm; ndaj, o emër dhe realitet dhuratash hyjnore, shpëtoji me ndërmjetimin tënd nga çdo peripeci ata që e kretmojnë kujtimin tënd.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, priti lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirova ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

*Dhe shërbesa që mbetet.*

*Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanunet e shenjtë Ode III e Kanunit të parë dhe Ode VI e Kanunit të dytë. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e shenjtë Të mëdha janë arritjet dhe e kishës. Kontakti Mbrojtje e paturpëruar. Kungatore Në kujtim të përjetshëm.*

CITIME

1. Num. 14,19 etj.

1a. Lev. 14,13-17; Hebr. 9,13,21-22

1b. Ps. 67(68),36

2. Ps. 16(17),7

3. Ps. 118(119),131

4. Ps. 44(45),2,10



5. Joan 8.56
6. II Makk. 9.7
7. Is. 11.9
8. Gjen. 3.1-6
9. Ef. 6.11,13
10. I Kor. 12.9,28
11. Ps. 65(66).12
12. Kënga 4.7-8
13. Lluk. 1.30-35
14. Joan 11.36
15. II Tim. 2.3
16. Sirak 35(36).6; Is. 56.7; Fil. 4.18
17. I Kor. 4.9
18. Eks. 12.46; Num. 9.12; Joan 19.36
- 18a. Joan 19.34
19. Sirak 23.1
20. Rom. 6.8; II Tim. 2.11
- 20a. II Kron. 18.18; Is. 6.1; Dan. 7.10
21. Is. 19.1
22. II Tim. 4.8
23. Ps. 88(89).47
24. Rom. 9.5
25. Joan 3.29
26. Matth. 9.15; Mark 2.19; Lluk. 5.34
27. Joan 3.29; Apok. 21.2
28. Ps. 7.11; 105(106).21; Sos. 60
29. Lluk. 1.35
30. I Thes. 5.8
31. Is. 6.1; Jez. 1.13-26
32. Sirak 4.28
33. IV Makk. 1.1 etj.
34. I Tim. 1.9
35. Is. 18.4
36. III Makk. 6.6; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 22-26
37. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
38. Rom. 3.19
39. I Tim. 6.15; Apok. 17.14; 19.16
40. Ps. 57(58).6
41. Rom. 1.25
42. Lev. 23.32; Hebr. 4.9
43. Eks. 16.23; 35.2; Lev. 16.31; 23.3
44. Gjen. 2.2-3
45. Matth. 28.1; Mark 16.2,9; Lluk. 24.1; Joan 20.1,19; Vep. 20.7
46. Jer. 17.22-27; Jez. 20.20
47. Joan 10.15,17-18
48. Ps. 29(30).5
49. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
50. Eks. 25.9 etj.
51. Lluk. 12.4; Joan 15.13-15
52. III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II] Mbret. 3.14; 5.16; II Kron. 18.18
53. Lluk. 1.28-29
54. Joan 15.1
55. Rom. 12.1



**E DIELA E ORTHODHOKSISË  
TË SHTUNËN NË MBRËMËSOREN E VOGËL**

### *Thirrtoe (Poezi e Nikollës)*

#### *Ting. I Ton uranion tagmaton*

**T**ani drita e besimit të mirë u përhap mbi të gjithë, duke shpërndarë si re mashtrimin e pabesisë dhe duke feksur zemrat e shpresëtarëve. Ejani, të gjithë orthodhoksët, të gjuhëzohemi me devotshmëri duke iu falur ikonave të nderuara të Krishtit.

**K**isha e Krishtit si nuse e stolitur<sup>1</sup> zbukurohet tani me ikona të hyjptuara dhe na fton të gjithë që të kremtojmë shpirtërisht; le të mblidhemi ngazëllueshëm me një mendje dhe besim, për të madhëruar Zotin.

**O** botë e tërë, dëfre, sepse ja Zoti me përkujdesje të parrëfyeshme e vithisi nga lartësia pushtetin e keqbesimit dhe ne të përlulur u lartësuam<sup>2</sup> sot drejt besimit orthodhoks, të udhëzuar prej mbretëreshës shpresëtare.

**V**asili thotë se nderimi i ikonës shkon te prototipi; prandaj ne i nderojmë relativisht ikonat e Krishtit Shpëtimtar dhe të të gjithë shenjtorëve, me qëllim që, duke i mbajtur tani, të mos i nënshtrohemi asnjëherë keqbesimit.

#### *Lavdi dhe Tani Hyjindësore*

**O** Vajzë, prej gjakrave të tua të dëlira u shfaq për shkak të dhembshurisë së skajshme si vdekatar i padukshmi nga natyra e pafillim hyjnore; duke skicuar ikonën e mishit të tij, i falemi me nder e besim dhe e madhësojmë gjithë ne besimtarët.

### *Pasvargje*

#### *Ting. II Ikos tu Efrathá*

**O** besëmirë, meqenëse u shmagëm nga prishja shkatërruese e keqbesëve, le të ndriçohemi në zemër me shkëlqim orthodhoksie, duke lavdëruar Perëndinë.

*Yarg:* Sillini Zotit, o bij të Perëndisë.

**U** shfaros mashtrimi i turbullt i Ariosit, Maqedonit, Petrit, Sevirit dhe Pirros; dhe shkëlqeu Drita trediellore.

*Yarg:* Faljuni Zotit në oborin e tij të shenjtë. **N**uk krenohet më dogma false e keq-besëve, sepse Perëndia, me aprovimin e Theodorës, u jep orthodhoksëve shkop fuqie.<sup>3</sup>

Lavdi dhe Tani *Hyllindësor*

**O** Hyllindëse, kur linde Fjalën Perëndi, e lartësove bririn<sup>3a</sup> e të përlurve, prandaj të madhështojmë duke të nderuar të gjithë besërisht.

*Përlëshore*

Ikonës sate të pacenuar.

Lavdi dhe Tani *Hyllindësore*

**T**ë gjitha përmbi mendim.



## NË MBRËMËSOREN E MADHE

*Thirrto*

*6 ngjallësore dhe 4 të Triodit:*

*Ting. Tërth. II Olin apothëmeni*

**Z**ot, që s'të kuptojmë dot,\* që fekse prej barkut pa trup\* dhe pa lëndë të Atit\* para Dritëprurësit<sup>4</sup> dhe pa nisje krejt,\* të parathanë ty\* pra të frymëzuar\* që nga Shpirti yt profetët se do mishërohesh\* si fëmij' nga Vajza pa burrë ti,\*<sup>5</sup> do lidheshe me njerëzit,\* dhe mbi dhë do shfaqesh te të gjith'\*,<sup>6</sup> nëpërmjet profetëve si i dhembshur denjësona, Krisht,\* për shndritjen tënde, se e himnojm' \* ngjalljen plot nder, pa shpjegim.

**P**ërfituan jet' pa fund\* profetët, shenjtët hyjfolës,\* se të predikuan fort\* me fjal', dhe me vepra ty të nderuan mjaft;\* me

durim donin, Zot,\* që të adhuronin\* jo Krijesën, por ty, pra Krijuesin,<sup>7</sup> ndaj botën krejt\* e shpërfillën siç do Ungjilli<sup>7a</sup> yt;\* e imituan gjithashtu\* dhe pësimin tënd që e parathan';\* stadiumin, vetëpërbajtjen denjësona, siç kërkohj',\* drejt, pa qortim ta kalojmë ne,\* fortpërdëllimtar unik.

**S**ado ishe pa përshkrim\* sipas natyrës hyjnore,\* o Krisht Zot, pranove ti\* kur u mishërove, që të përshkruheshe\* tash në fund; more tok\* tërë veçoritë\* që ka mishi, ndaj relativisht ne puthim tipin tënd,\* pamjen që ti kishe, që e skicojm';\* drejt dashurisë sate ne\* ngrihem i dhe nxjerrim prej saj shërim\* edhe hir,<sup>8</sup> kështu shkojmë pas traditave të hyjshme krejt\* që na i lanë apostujt shenjt',\* dhe të adhurojmë drejt.

**S**i stoli të çmuar fort\* e mori Kisha e Krishtit\* rivendosjen, hijeshin'\* plot hir të ikonave të nderuara,\* të hyjnueshme mjaft,\* me respekt të plotë\* të çdo shenjtji, të Hyjnënës dhe të Shpëtimtarit Krisht;\* nga kjo merr hir, ka gaz dhe mburret krejt,\* hordhin' e heretikëve\* e dëbon, e flak dhe me ngazëllim\* Zotin njeri-dashës, i cili, me dëshirë për këtë,\* pësim duroi,<sup>9</sup> e lavdëron\* dhe i falet besërisht.

Lavdi *Ting. II*

**S**hkëlqeu hiri i së vërtetës: Ato që qëmoti paraskicoheshin si në hije,<sup>10</sup> tani u zbatuan haptas, sepse ja Kisha u vesh me ikonën trupore të Krishtit si me stoli përmbibotërore, duke parashkuar tipin e Tendës së Dëshmisë<sup>11</sup> dhe duke poseduar besën orthodhokse, me qëllim që ne, duke mbajtur edhe ikonën e atij që respektojmë, të mos mashtrohemi; le të vishen me turp<sup>12</sup> ata që nuk besojnë kështu, sepse për ne lavdi është pamja e



të mishëruarit, së cilës i falemi besërisht, duke mos e hyjnizuar; o besnikë, duke e puthur me mallëngjim, le të thërresim: O Perëndi shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd.<sup>13</sup>

Tani *Hyjllindësore*  
*Dogmatike e Tingullit të javës*

Në Liti  
Idhiomeli i parë i kishës  
Lavdi *Ting. II*

Ngazëllohuni, o profetë të çmuar, që e rregulluat mirë ligjin e Zotit dhe u shfaqët shtylla të paepura, të pamposhtura në besim, sepse ju u dukët edhe ndërmjetës të Dhiatës së Re të Krishtit;<sup>14</sup> dhe meqë u shpërngulët në qiell, përgjërojeni atij që ta paqësojë botën dhe t'i shpëtojë shpirtat tanë.

Tani *Hyjllindësor*  
Gjithë shpresën time e vë te ti, o Nënë e Perëndisë, ruamë nën mbrojtjen tënde.

*Pasvargjet ngjallësore*  
Lavdi *Ting. II*

Ne që nga pabesimi kaluam në shpresëtarë dhe shkëlqyam përmes dritës së dijes,<sup>15</sup> le të trokasim duart psalmikisht,<sup>16</sup> duke i sjellë Perëndisë lavdërim falënderues; dhe le t'u falemi me nder ikonave të hyjshme të Krishtit, të së Tërëdëlirës dhe të gjithë shenjtoreve, të cilat u vijosen në mure, në dru dhe në enë të shenjta, duke hedhur tej fenë e rreme të besëkëqijve; sepse nderi i ikonave shkon te prototipi, siç thotë Vasili. Kërkojmë, o Krisht, Perëndia ynë, që, me ndërmjetimet e nënës sate të pacenuar dhe të të gjithë shenjtoreve, të na dhurohet përdëllimi i madh.<sup>17</sup>

Tani *Hyjllindësor*  
O çudi e re mbi gjithë çuditë qëmotil! Se cili njohu nënë të ketë lindur pa burrë dhe

të mbajë në pëqi atë që përmban tërë Krijesën? Është vullnet Perëndie ai që lindi, të cilit, o e gjithëpastër, meqë e mbajte në krahët e tu si foshnjë dhe meqë ke guxim para tij si nënë, mos pusho së luturi për ata që të nderojnë, që të na mëshirojë dhe të shpëtojë shpirtat tanë.\*

*Përlëshore ngjallësore dhe e Triodit:*  
Lavdi *Ting. II*

Ikonës sate të pacenuar i falemi, o i Mirë, duke kërkuar ndjesën e shkëlqeve tona, o Krisht Perëndi, sepse vullnetarisht deshe me mirëdashje të ngjiteshe në Kryq,<sup>18</sup> që t'i çlirosh ata që gatove<sup>19</sup> nga skllavëria e armikut; ndaj me kënaqësi të thërrasim: I mbushe me hare të gjitha, o Shpëtimtari ynë, kur erdhe që ta shpëtosh botën.<sup>20</sup>

Tani *Hyjllindësore*  
Të gjitha përmbi mendim, të gjitha të përmbilavdishme misteret e tua, o Hyjllindëse. E vulosur me pastërti dhe e ruajtur me virgjëri, u njohe nën' e vërtetë, duke lindur Perëndin' e vërtetë. Atij iu lut të shpëtohen shpirtat tanë.\*



## NË MËNGJESORE

*Shërbesa e zakonshme. Kanunet: Ngjallësori në 4, Kryqngjallësori në 2, i Hyjllindësës në 2 dhe në 6 i Triodit që ka Akrostihidhë: "Sot erdhi lavdia e shpresëtarisë së hyjndriçuar" (Poezi e zotit Theofan):*

*Ting. IV*  
*Ode I*

*Thalasis to erithreon*

Besnikë,\* le të thërresim sot me gaz duke kërcyer nur:\* Sa të çuditshme janë veprat, Krisht,\* që ke bërë<sup>21</sup> dhe forca që ke,\* se ke krijuar harmoninë tonë, në një mendje na ke sjellë.

Të bëjmë\* një ditë plot hare, gaz, ejani; dhe qielli\* me tokën, edhe rreshti engjëllor,\* dhe sistemi i njerëzve\* dëfrejnë<sup>22</sup> tash, veçanërisht kremtojnë besërisht dhe me kërcim.

Meqë pra\* gjymtyrët e shpërndara keq të Krishtit i shikojm'\* në unitet të mbledhura,<sup>23</sup> me gaz\* le të duartrokasim<sup>16</sup> fort\* dhe Zotin që dha paqen dhe të madhen mirëbërje, ta lëvdojm'.

Fitorja\* në Kishë sot u dha me aprovim dhe me vendim\* si dhe me nxitje prej Hyjnisë Zot,\* drejtas mbretërve tan' Mihail\* dhe Theodhora që po ndjekin besën saktë dhe shpresëtarisht.

#### *Hyjllindësor*

Mbaruan\* qart' shpata herezish<sup>24</sup> të kota, dhe gëzohemi\* tërëhyjnisht sepse vëzhgojmë ne\* me një besë të plotë tani,\* që po stoliset kisha jote me ikona, e Dëllirë krejt.

#### *Zbritësore: Thalasis to erithreon*

»Formonte\* me duar Moisiu kryq, kështu »dhe populli,\* i vjetri Izrael, me këmbë »pra\* të palagura Detin e Kuq\*<sup>25</sup> e shke- »li, prishi dhe fuqin' e Amalikut nëpër »shkretëtir'.<sup>26</sup>

#### *Ode III*

##### *Efrënete epi si*

Tani kurrë s'ngrihet më\* pra vetull<sup>26a</sup> heretikësh besëkëqij,\* se Orthodhoksinë ton'\* e forcoi forca e Perëndis'.

Sot retë profetikisht\* me qielloren, jetëbërësen ves'\* le të na spërkatin<sup>27</sup> ne,\* se u ngjall, u ngrit lart besimi yn'.

Borit' e apostujve\* të Krishtit, ëmbël, mistikisht, përmbi mend\* le të trumbeojnë fort\* ngritjen e ikonave plot me nder.

Siç duhet, ne Zotin Krisht\* le ta himnojmë, sepse shfaqti te ne\* mbretëreshë plot besim\* me bir të hyjkurorëzuar tok.

#### *Hyjllindësor*

Tash, krejt e Dëllirë, ne\* besnikët si në tendën tënde të shenjt'\* erdhëm, na feks - lutemi:\* Na shkëlqe me hir të ndriçueshëm.

#### *Zbritësore: Efrënete epi si*

»Dëfrehet në ty,<sup>28</sup> o Krisht,\* dhe të »thërret pra Kisha jote me gaz:\* Streha, »përforcimi im\* dhe fuqia ime je ti, o »Zot.<sup>29</sup>

#### *Ndenjësore*

##### *Ting. I Horos angelikós*

Kur bëjmë në ikon'\* pamjen tënde hyjnore,\* Krisht, shpallim fort dhe haptazi lindjen, çuditë\* që nuk rrëfehen, kryqëzimin me dashje;<sup>18</sup> demonët pra\* zmbra- psen plot me tmerr,\* besëkëqij\* plot me qarje,\* plot me zymtësi,\* se janë shokët e tyre\* dhe komunikojn' me ta.

#### *Lavdi*

Shkëlqen me lavd mendor\* që ka Dhëndri mendor krejt\*<sup>30</sup> dhe nusja,<sup>1</sup> shën Sioni e sipërme,<sup>31</sup> nëna,<sup>32</sup> stoliset me fytyra profetësh, pamje apostujsh tok\* agji- ografi\* hyjnisht, martirësh të shenjtë\* dhe me pikturim,\* ikona të shumëllojshme\* të gjithë të shenjtëve.

#### *Tani Hyjllindësore*

Modeste, rojëse\* shfaqu, mbrojtje e fortë\* për sa ikonën tënde të shenjt' e nderojnë\* me mall dhe shpallim me një zë se je nëna e Perëndis'\* mjaft vërtet edhe\* me bes' të falen; dëbon tej,\* larg prej tyre pra,\* çdo të vështirë, sepse mund\* t'i bësh ti të gjitha drejt.

#### *Ode IV*



*Eparhenta se idhusa*

**O** Fjalë e shumë-mëshirshme e Perëndisë, me përmbiardi-hyjnore të Ngushëllimtarit shenjtëroje kishën tënde dhe me praninë e tij zmbrespse mashtrimin e herzisë.

**P**asi e çlrove popullin tënd nga keqbesimi i dhunshëm, tregoje të djegur prej zellit të shpresëtarisë duke thirrur me besim: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

**N**gazëllohemi me hyjndijtet duke parë tentat e hyjshme të shkëlqejnë nëpërmjet skicimeve hyjpmëse të ikonave të Krishtit dhe të tipareve të Perëndilindëses.

**M**brëtëresha e stolisur me kurorë, meqenëse e dëshiroi mbretërinë e vërtetë të Krishtit,<sup>33</sup> pikturoi ikonën e tij të pacenuar dhe pamjet e shenjtëroëve.

*Hyjlindësor*

**K**ur linde të mishëruar Perëndinë Fjalë,<sup>34</sup> u tregove si shenjtërore e përshtatshme për Zotin, o Hirplotë, prandaj inaugurojmë kishën tënde dritëpamëse.

*Zbritësore: Eparhenta se idhusa*

»**K**isha, kur të pa ty, Diellin e drejt' sisë\*<sup>35</sup> që ishe ngritur përmbi Kryq,\* për hirin e »saj pra,\* mbeti e çuditur në vend;\*<sup>36</sup> thërriste siç duhej fort:\* Lavd fuqisë sate, o »Zoti Krisht.

*Ode V**Si Kirié mu fos*

**O** Zot, vendosi Kishës sate përforcim, që të mbetet në jetë të jetëve e palëkundur nga trazira e herezive.

**S**hkëlqeu në mbarë dheun hijeshia e ngazëllimit dhe e përkrashjes hyjnore që lu dha besëplotëve nga sipër.

**O** i vetmi i Mirë dhe burim i mirësisë, ngrije bririn e mbretërve orthodhoksë<sup>37</sup>

që nderojnë ikonën tënde.

**N**a lindi drita e paperëndueshme e besimit të saktë me anë të dekretit të hyj-frymëzuar dhe të aprovimit hyjmenës të mbretërve shpresëplotë.

*Hyjlindësor*

**O** Hyjnënë e tërëpacenuar, na ripërtërit hijeshinë e lashtë<sup>38</sup> dhe shenjtëroje këtë shtëpinë tënde me hirin tënd.

*Zbritësore: Si Kirié mu fos*

»**S**i dritë, Zoti im,\* në mbar' botën »ke ardhur ti,\*<sup>39</sup> si shndritje e shenjtë, »që nxjerr\* nga padija e errët<sup>40</sup> sa të »himnojnë me besim.

*Ode VI**Thiso si metá fonis*

**B**esërisht\* ikonën zotërore e bëjmë ne,\* i falemi, ndërsa Kisha\* ka sërish guxim edhe Shpëtimtarin\* e lëvdon mjaft,\* dhe e nder bukur tipin e tij me gaz.

**M**bushet plot\* me hirin dritëprurës, të hyjshëm mjaft,\* se vesh këmishën e gazit,\*<sup>41</sup> si u zhvesh nga terri dhe zymtësia\* heretike\* edhe stoliset Kisha e Zotit Krisht.

**M**ori drit\* krejt bashkësia e orthodhoksëve,\* lavdi të lashtë me lejen\* që dha Theodhora perandoreshë\* tok me birin,\* pra Mihailin, mbret shpresëtar, besnik.

*Hyjlindësor*

**V**irgjëresh\*, në ty rri, në mendoren tënde ai\* që urdhëroi të bëhej\* Tenda e Dëshmisë qëmoti,<sup>42</sup> është\* krejt i vetmi\* plot lavd dhe kishën tënde nder me çudi.

*Zbritësore: Thiso si metá fonis*

»**D**o flijoj\* me zë himnimi,<sup>42</sup> Kisha thërret »te ti,\* o Zot, sepse përmes gjakut,\* që »nga brinja jote për përdëllim rrjedh,\*<sup>43</sup> »u pastrua\* nga çdo pisllek prej gjakrash

»demonësh kjo.

### *Kontaqi Ting. Tërth. IV*

Fjala e papërshkrueshme e Atit u përshkrua prej teje, o Perëndilindëse, duke u mishëruar; dhe pasi e riformoi siç ishte në lashtësi<sup>38</sup> ikonën<sup>44</sup> e ndotur, e përzjeu me bukurinë hyjnore; ndaj, duke pohuar shpëtimin, e paraqesim atë me punë dhe fjalë.

### *Shtëpia*

Kur qëmoti kuptuan me hyfrymëzim këtë mister të Ekonomisë, i cili ka lidhje me ne që arritëm në fund të jetëve,<sup>45</sup> profetët e parashpallën pasi u ndriçuan prej tij; meqë pra fituam me anën e tij dituri hyjnore, njohim një Zot, Perëndinë,<sup>46</sup> që lavdërohet në tri hipostaza dhe, duke e adhuruar vetëm atë<sup>47</sup> dhe duke pasur një besim, një pagëzim,<sup>48</sup> ne e kemi veshur Krishtin;<sup>49</sup> ndaj, duke pohuar shpëtimin, e paraqesim atë me punë dhe fjalë.

### *Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:*

Në të njëjtën ditë, të Dielën e Parë të Kreshmëve, kujtojmë ringritjen e ikonave të shenjta e të respektuara, që u bë prej perandorëve të gjithmonëkujtuar të Konstandinopojës, Mihallit dhe nënës së tij Theodhora, gjatë patriarkisë së shenjtorit dhe omologjetit Metod.

*Vargje:* Ikonave të internuara siç nuk duhej/ gëzohem duke parë t'u falemi siç duhet.

O Ikonë e njëllojtë me Atin,<sup>50</sup> me ndërmjetimet e omologjetëve të tu të shenjtë, mëshirona. Amin.

### *Ode VII*

#### *En ti kamino avramiei*

Ushtria e engjëjve me mallëngjim hyjnor le të kërcejë për shkak të hijeshisë së Kishës, duke kënduar hyjmenërisht: Zot, je i bekuar ti në tempullin e lavdit tënd,

Perëndi.<sup>51</sup>

**P**anairi dhe Kisha e të parë lindurve<sup>52</sup> gëzohen duke parë tanë popullin e hyjnueshëm të këndojë me një mendje: Zot, je i bekuar ti në tempullin e lavdit tënd, Perëndi.<sup>51</sup>

**P**asi u çliruar nga mjegulla e herezisë së mëparshme nëpërmjet aprovimit të Theodorës, mbretëreshës dinjitoze, këndojmë: Zot, je i bekuar ti në tempullin e lavdit tënd, Perëndi.<sup>51</sup>

### *Hyj lindësor*

**U** lavdërove më lart se koret e sipërme, o e Tërëkulluar, se vetëm ti u bërë nëna e Gjithëbërësit,<sup>53</sup> prandaj të ngazëlluar thërrsim: E bekuar je ti mes grash,<sup>54</sup> o Zonjë e tërëpaqortueshme.

### *Zbritësore: En ti kamino avramiei*

»Në zjarr kamine\* persiane, Djemtë »abrahamianë pra\* prej një malli shpre- »sëtar digjeshin më fort\* se prej flakës, »ndaj thërrisnin: Zot,\* je i bekuar ti në »tempullin e lavdit tënd, Perëndi.<sup>51</sup>

### *Ode VIII*

#### *Hiras ekpetasas Dhaniil*

**D**uke ruajtur rregullat atërore të Kishës, pikturojmë ikonat e Krishtit dhe të shenjtorëve të tij dhe i puthim me buzë, zemër dhe vullnet duke thirrur: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.<sup>55</sup>

**D**uke e transferuar qartësisht lart, drejt origjinalit, nderimin dhe faljen e ikonës, kështu adhurojmë dhe, duke shkuar pas mësimdhënieve të hyjfolësve, thërrsim për Krishtin besërisht: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.<sup>55</sup>

**M**bretëresha e nderuar, kur u ndriçua në mendje nga vezullimi i Shpirtit Hyjnor dhe duke pasur frytë hyjmenëse, e de-



shi hijeshinë dhe bukurinë e Kishës<sup>56</sup> së Krishtit, duke e bekuar së bashku me besimtarët Jisuin Perëndinjeri.

### Hyjlindësor

Shtëpia jote e hyjshme, duke u llamburitur me rrezet e dritës mendore, i hijeshon thellë të gjithë tani përmes resë<sup>57</sup> së Shpirtit dhe i shenjtëron besnikët që psalin njëzëri: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.<sup>55</sup>

### Zbritësore: Hiras ekpetasas Dhanil

»Duke\* ngritur duart, Danieli mbylli gojë të e luanëve në grop\*;<sup>58</sup> dhe shuan forcën e zjarrit krejt,<sup>59</sup> kur u ngjeshën me virtyt, »Djemtë,\* pra miqtë e shpresëtaris\*, tok »duke thirrur me gaz: Bekoni,\* ju, gjithë »veprat e Zotit, pra Zotin ton\*.<sup>55</sup>

### Ode IX

#### Lithos ahirōtmitos orus

Duke parë prapë të jetë stolisur Kisha e nderuar\* me hyjpiturim, me ikona plot hir,\* krejt ne me shpresëtarit të rendim\* dhe t'i thërresim Zotit Krisht:\* Të madhërojmë, i Trishenjtë ty.

Duke pasur lavd edhe nder bashkë Kryqin tënd si dhe ikonat\* që i respektojm\*, pikturimet me hir\* të shenjtëve, Kisha të larton, Zot,\* me predispozicion të mir\*, dhe me gëzim të madhëron, o Krisht.

Zot i dhembshur, mbretërit tanë, me lavdin tënd hyjnor shkëlqejt\* edhe me rreshtimet e engjëjve\* rrethojt, si dhe me armët mbarë;\* nënshtroje tek ata me forc\* çdo arrogancë, sulm të kombeve.

### Hyjlindësor

O Hyjlindëse, u shfaros krejt dënimi stërnënor i Evës,<sup>60</sup> se, o e dëlirë, pa fare shpjegim\* e linde ti Zotin e çdo gjëje;\*<sup>61</sup> e Virgjër, po e puthim ne\* pamjen e tij përmbi ikonat pra.

*Pas Zbritësoreve, i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor dhe Idhiomele Hapmi dyert; Drejtomë në rrugët; Unë i mjeri (fq. 10). Më të nderuarën. Dhe Zbritësorja:*

#### Lithos ahirōtmitos orus

»Si një gur i prerë pa dorë nga mali yt »i palatuar,\* Virgjërsh\*, u pre pors i gur<sup>62</sup> »qosheje,\*<sup>63</sup> pra Krishti, i cili i bashkoi\* »natyrat krejt të kundërta,<sup>64</sup> ndaj me »gëzim të madhështojmë ty.

#### Dërgimësore ngjallësore dhe të Triodit:

##### Jineqes akutisthite

Trokëni duart<sup>65</sup> me gëzim,\* këndonit dhe kërceni ju\* duke i thënë fort Krishtit:\* Sa të çuditshme i ke ti\* veprat<sup>21</sup> dhe sa të huaja!\* Kush ka forc\* t'i rrëfjë\* forcat e tua, Shpëtimtar,\*<sup>66</sup> që e bashkove në një Kish\* bashkimin tonë mendor pra?

#### Hyjlindësore

Tani mbaruan shpatat krejt\* të kundërshares herezi;\* humbi kujtimi i saj plot\* me zhurmë<sup>24</sup> se, kur shikojmë\* që kisha jote është nur\* e stolisur me hijeshi\* me hirin e ikonave\* të respektuara, gazi\* na mbush<sup>66</sup> të gjith', e Dëlirë.

#### Lavdërime (me Vargjet e së dielës):

##### 5 ngjallësore dhe 3 të Triodit:

##### Ting. IV Édhokas simiosin

Kisha tash ka gaz në ty, o njeridashës, Krijuesin\* si dhe Dhëndrin e saj,<sup>30</sup> sepse\* nga idhujt, mashtrimi helm\* me vullnet hyjnor krejt\* e çlirove edhe me veten e bashkove, Krisht,\* me gjakun tënd mjaft të çmuar ti, o Zot;\* shijon kjo hijesisht vendosjen, ngritjen prap' të ikonave,\* ka hare edhe besërisht\* të himnon dhe të lavdëron.

Duke ngritur pamjen tënde mishërore sërish, o Zot,\* ne e puthim relativisht,\* e shfaqim misterin tënd\* të Ekonomisë\* madhështore; se, jo siç thon' hyjkundër-

shtarët kot,\* bij të Manentit, në pamje vetëm thjesht\* u duke, Njeridashës, por natyrë kishe me mish vërtet,\* ndaj drejt mallit tënd ngjitemi\* me të, drejt dashurisë sate.

**Sot** u shfaq një ditë ngazëllimi që me hare u mbush:\* Hijeshia e dogmave\* të tërë-vërteta feks,\* Kisha po shkëlqen nur\* me ringritjen tash të ikonave hyjnisht,\* me pikturimet e krejt shenjtoreve,\* kështu me llamburitje fort stoliset Kisha e Perëndisë,\* Zoti Krisht mbar' besnikëve\* ua dha harmoninë si çmim.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

**Moisiu**, në kohën e vetëpërmbajtjes, mori një Ligj<sup>67</sup> dhe fitoi një popull.<sup>25</sup> Ilija, kur agjëroi,<sup>68</sup> mbylli qiejt,<sup>69</sup> ndërsa Tre Djem abramianë me anën e kreshmës<sup>70</sup> fituan përmbi një tiran që shkelte ligjin.<sup>71</sup> O Shpëtimtar, përmes saj, denjësona dhe ne të arrijmë në Ngjallje, duke thirrur kështu: Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt<sup>72</sup> i pavdekshëm, mëshirona.

Tani  
E përmbibekuar

*Dhoksologjia e Madhe.*

*Në Liturgji, [Tipiket. Lunërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Triodit, ose] Antifonet:*

*Antifoni i parë*

*Varg a):* Zoti mbretëroi, u vesh me hijeshi. Zoti u vesh dhe u ngjesh me fuqi. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

*Varg b):* Sepse i dha fuqi botës, e cila nuk do të lëkundet.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

*Varg c):* Kush do të flasë për fuqitë e Zotit, kush do t'i bëjë të dëgjua të gjitha himnimet e tij?

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

*Varg d):* Le të thonë të çliruarit prej Zotit,

të cilët i çliroi nga dora e armikut. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Lavdi *dhe* Tani

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

*Antifoni i dytë*

*Varg a):* Le t'i lavdërojnë mëshirat e tij dhe të çuditshmet e tij ndër bijtë e njerëzve.

Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, që u ngjalle prej së vdekurish, ne që të psalim alluilua.

*Varg b):* Le ta lartësojnë atë në mbledhje populli dhe në katedër pleqsh le ta lavdërojnë.

Shpëtona.

*Varg c):* Sy Zoti janë mbi ata që shpresojnë mbi mëshirën e tij.

Shpëtona.

*Varg d):* Që të dëgjojnë rënkimin e të lidhurve, që t'i zgjidhë bijtë e të vrarëve.

Shpëtona.

Lavdi *dhe* Tani

O i vetëmlindur.

*Antifoni i tretë*

*Varg a):* Le ta himnojnë atë qiejt dhe toka, deti dhe të gjitha sa zvarriten në të.

Ikonës sate.

*Varg b):* Kjo është dita që bëri Zoti, le të ngazëllohem dhe le të dëfremë në të.

Ikonës sate.

*Varg c):* O Zot, Perëndia im, do të të lavdëroj në jetë.

Ikonës sate.

*Hyrto* Ejani t'i falemi... që u ngjalle prej së vdekurish. *Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Triodit dhe e kishës. Kontaçi* Përlufteshës. *Kungatore* Lavdëroni. Pamë dritën. Emri i Zotit.

*Pas Përlëshimit të Liturgjisë Hyjnore (më saktë, menjëherë pas Dhoksologjisë së Mëngjesores) priftërinjtë (dhe laikët), duke mbajtur ikona të shenjta, qëndrojnë në Solea.*



*Dhjaku [nëse ekziston]:* Bekoje, o Kryezot [Zot] hyrjen e shenjtë.

*Kryepriifti [ose prifti i parë] që mban kryqin:* E bekuar është hyrja e të shenjtave të tua, gjithnjë, tani e përherë dhe në jetë të jetëve.  
*Kori:* Amin.

*Kryepriifti [ose prifti i parë gjithnjë, nëse nuk ka kryepriifti, nga dera qendrore e Ajodhimës]:* Ky është falënderim i përvitshëm që i detyrohem Perëndisë gjatë ditës që fituam Kishën e Perëndisë tok me argumentimin e dogmave të shpresëtarisë dhe katastrofën e besimeve të këqija.

Duke shkuar pas thëniesh profetike, duke u bindur në nxitje apostolike dhe duke mësuar prej ndodhish ungjillore, e kremtojmë ditën e ripërtëritjes; dhe në të, duke dëfryer me lutje e litanit dhe duke u ngazëlluar bashkë, thërresim me psalme dhe këngë.

*Litania nis drejt derës veriore të kishës, duke paraprirë ata që mbajnë qirinjtë, lavarar (bajrakët), llambat dhe eksapterigat (gjashtëkrahëshet). Pasonjë psaltët, ata që mbajnë ikonat dhe klerikët. Dhjakët temjanisin Kryepriiftin që vjen pas. Kori psal ngadalë Përlëshoren, pjesën e parë:* Ikonës sate të pacenuar i falemi, o i Mirë, duke kërkuar ndjesën e shkeljeve tona, o Krisht Perëndi. *Tashmë Kryepriifti ka arritur në derën veriore, ku litania ndalon, dhe prifti (i parë) lexon Simbolin e Besimit nga fillimi deri te të padukurave.*

*Kryepriifti (me zë të lartë gjithnjë):* Kujtimi i atyre që pohonin me shkrim dhe ikona, përmes fjalës, gojës, zemrës dhe mendjes praninë në mish të Fjalës Perëndi, qoftë i përjetshëm.

*Kori (populli):* I përjetshëm kujtimi. (3x)

*Kryepriifti:* Kujtimi i atyre që e dinin ndryshimin në esencën e vetë hipostazës së Krishtit, e cila ishte një, dhe e dinin se

ajo ishte edhe e krijuar, edhe e pakrijuar, e dukshme dhe e padukshme, pësues dhe jopësues, e përshkruar dhe e papërshkruar, të cilët i përshtatnin esencës hyjnore pamundësinë e krijimit dhe të tjera të ngjashme, ndërsa pohonin edhe me fjalë dhe ikona përshkrimin, edhe të tjera në natyrën njerëzore, qoftë i përjetshëm.

*Kori (populli):* I përjetshëm kujtimi. (3x)

*Kryepriifti:* Kujtimi i atyre që besonin dhe shpallnin, d.m.th. ungjillëzonin fjalët në shkrime dhe gjëra mbi skica, ku secila nga këto të dyja, shpallja përmes fjalëve dhe sigurimi i së vërtetës përmes ikonave, kontribuon në një dobi, qoftë i përjetshëm.

*Kori (populli):* I përjetshëm kujtimi. (3x)

*Litania nis përsëri drejt derës perëndimore të kishës, teksa kori vazhdon Përlëshoren:* Sepse vullnetarisht deshe me mirëdashje të ngjiteshe në Kryq,<sup>18</sup> që t'i çlirosh ata që gatove<sup>19</sup> nga skllavëria e armikut.

*Në derën perëndimore litania ndalon dhe prifti vazhdon Simbolin e Besimit deri nuk do të ketë mbarim.*

*Kryepriifti:* Profetët siç panë, apostujt siç na mësuan, Kisha siç mori në dorëzim, mësuesit siç dogmatizuan, kozmosi siç ra dakord, Hiri siç shkëlqeu, e vërteta siç u argumentua, gënjeshtra siç u flak fort, urtësia siç guxoi, Krishti siç dha çmim, kështu mendojmë, kështu flasim, kështu shpallim Krishtin, Perëndinë tonë të vërtetë, dhe shenjtoret e tij, duke i nderuar me fjalë, me shkrime, mendime, fli, kisha, ikona; atij i falemi dhe e adhurojmë si Perëndi dhe Zot, ndërsa ata i nderojmë për hirin e Zotit të përbashkët, si shërbëtorët e tij autentikë, dhe u falemi relativisht. Ky është besimi i Apostujve, ky është besimi i Etërve, ky është besimi i orthodhoksëve, ky besim e përforcoi botën.

*Litania nis përsëri drejt derës jugore të*

*kishës, teksa kori mbaron Përlëshoren:*

Ndaj me kënaqësi të thërrasim: I mbushe me hare të gjitha, o Shpëtimtari ynë, kur erdhe që ta shpëtosh botën.<sup>20</sup>

*Në derën jugore litania ndalon dhe prifti vazhdon Simbolin e Besimit deri në fund.*

**Kryepriifti:** Kujtimi i mbretit orthodhoks Mihailit dhe Theodorës, nënës së tij të shenjtë, qoftë i përjetshëm.

**Kori (populli):** I përjetshëm kujtimi. (3x)

**Kryepriifti:** Kujtimi i Vasilit, Kostandinit, Leontit, Aleksandrit, Kristoforit, Niqiforit, Andronikut, Isaakiut, Aleksit dhe Theodorit, të cilët e shkëmbyen mbretërinë tokësore me atë qiellore, qoftë i përjetshëm.

**Kori (populli):** I përjetshëm kujtimi. (3x)

**Kryepriifti:** Kujtimi i Ignatit, Fotit, Stefanit, Andonit, Josifit dhe i të gjithë patriarkëve tepër të shenjtë që luftuan për besën tonë, qoftë i përjetshëm.

**Kori (populli):** I përjetshëm kujtimi. (3x)

**Kryepriifti:** Duke lu përgjëruar Perëndisë, që të edukohemi dhe të përforcohemi me trimëritë, garat dhe mësimdhëniet e tyre deri në vdekje për hir të shpësëtarisë<sup>73</sup> dhe që të tregohemi deri në fund imitues të sjelljes së tyre të perëndishme, le të denjësohemi për ato që kërkojmë përmes dëmbshurive dhe Hirit të Kryepriiftit të Madh dhe të Parë, Krishtit, Perëndisë tonë të vërtetë, me ndërmjetimet e Zonjës sonë të përmbilavdëruar, Hyllindëses dhe gjithmonëvirgjëreshës Mari, të engjëjve hyjpmës dhe të të gjithë shenjtoreve.

**Kori:** Amin. *Dhe psal tërë Përlëshoren, teksa litania kthehet në Solea, ku Kryepriifti, nga dera qendrore e Ajodhimës, psal:* Cila Perëndi është aq e madhe... *E përsërisin nga një herë të dyja koret. Dhe* Me uratat e etërve tanë. *[Nëse litania bëhet pas Dhokologjisë, pas Cila Perëndi (3x), Sot erdhi shpëtimi,*

*dhe fillon Liturgia Hyjnore].*

## NË TË NJËTËN TË DIEL NË MBRËMËSOREN KATANIKTIKE

*Pas Psalmit Nistor (dhe pa Psaltr si çdo të diel) dhe Paqësoreve, 10 Thirrtoret: 4 Kataniktike të Tingullit të javës, 3 të Triodit (të mëposhtme) dhe 3 të Mujorit.*

*Të Triodit, poezi e zotit Josif*

*Ting. IV Ëdhokas simiosin*

**Fuqplot'** Jisu, më jep shumë kataniks, korrigjim total,\* m'i dëbo të këqijat larg,\* se jam zhytur thellë tash\* në truporet vese\* dhe jam distancuar prej teje, Zot dhe tërëmbret,\* dhe nga asnjë nuk kam shpresë, më shpëto\* mizorin, mua, Krisht dhe Shpëtimtar i shpirtave tanë pra,\* më shpëto meqë ke, o Zot,\* mirësi mjaft të madhe ti.

**Pa** të dëshiruarin<sup>74</sup> kur me kreshmim<sup>67</sup> u pastrua mjaft\* i çuditshmi shën Moisi,\* zilepse, o shpirti im,\* shpirti im i mjerë,\* dhe nxito në ditë vetëpërmbytjeje, pastro\* nga çdo e keqe ti veten, që tani\* ta shohësh Krishtin të të japë ndjesë si njeri-dashës Zot,\* vet' i tërëfuqishmi Krisht\* dhe i miri në përdëllim.

*Tjetër, i zotit Theodor*

*Ting. Tërth. II Arhangjelikës animnisomen*

**Le** të fillojmë të kryejmë tani me ngazëllim koriditë, o vëllezër, javën e dytë të Kreshmëve, duke bërë çdo ditë për vete karrocë zjarri si Ilija Thesviti,<sup>75</sup> katër virtyte të mëdha:<sup>76</sup> Le ta lartësojmë mendjen me papasionshmëri, mishin le ta armatosim me dëlirësi, duart me lëmoshë dhe këmbët t'i zbukurojmë me predikim;<sup>77</sup> le ta zmbarsim armikun dhe ta mundim.



*Dhe 3 të Mujorit.*Lavdi *dhe* Tani e tij (*Hyjindësore*).*Hyrje me temjanicë.* O dritë gazmore *dhe* Proqimëni i Madh:*Ting. Tërth. IV*

U dhe trashëgim atyre që e kanë frikë emrin tënd, o Zot.

*Varg:* Nga skajet e tokës thirra drejt teje. U dhe trashëgim...*Varg:* Do të mbulohem në strehën e kraheve të tu.

U dhe trashëgim...

*Lutja e gjatë (Ektenis):* Le të themi, të gjithë... Bëna të denjë, o Zot... Le ta plotësojmë lutjen tonë...*Pasvargje Ting. Tërth. IV  
Idhiomeli***E**jani ta pastrojme veten tonë me lëmoshë dhe dhembshuri ndaj të varfërve,<sup>78</sup> duke mos trumbetuar, duke mos e shpallur të mirën që bëjmë; le të mos e dijë e majta punën e së djathtës, që të mos e shpërdorjë lavdidashja false frytin e lëmoshës, por fshehtazi le t'i thërresim atij që njeh të fshehtat:<sup>79</sup> O Atë, fali shkeljet tona si njeridashës.*Varg:* Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.*Injëjti**Varg:* Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.*Martirik***O** martirët e Zotit, shenjtëroni çdo vend

dhe shëroni çdo sëmundje; dhe tani ndër-mjetoni që të çlirohen shpirtrat tanë nga kurthet e armikut, lutemi.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjindësor***Q**ielloret të himnojnë, o Hirplate, nënë e panusëruar, dhe ne e lavdërojmë lindjen tënde të pagjurmësuar; o Perëndilindëse, ndërmjeto që të shpëtojë shpirtrat tanë.*Dhe shërbesa që mbetet sikundër të Dielën e të Lidhurit të Djathtët (fq. 57).**CITIME*

1. Apok. 21.2,9; 22.17
2. Lluk. 1.52
3. Ps. 109(110).2
- 3a. I Mbret. [Sam.] 2.1 etj.
4. Ps. 109(110).3
5. Is. 7.14
6. Baruh 3.38
7. Rom. 1.25
- 7a. I Joan 2.15
8. I Kor. 12.9,28,30
9. Joan 10.15, 17-18
10. Hebr. 8.5
11. Eks. 25.8-9 etj.
12. I Makk. 1.28; Ps. 34(35).26; 70(71).13; 131(132).18; Jov. 8.22
13. Ps. 27(28).9
14. Hebr. 9.15; 12.24
15. Osia 10.12; II Kor. 4.6
16. Ps. 46.2 etj.
17. Num. 14.19 etj.
18. Matth. 20.18-19; 26.2; Lluk. 24.6-7
19. Gjen. 2.7-8; 15; Ps. 118(119).73; 138(139).5; Jov. 10.8-9; II Makk. 7.23
20. Joan 3.17; 12.47
21. Eks. 34.10; Tov. 12.22; Sirak 11.4
22. I Kron. 16.31; Ps. 95(96).11; Is. 49.13
23. Joan 11.52
24. Ps. 9.7
25. Eks. 14.29
26. Eks. 17.8-13
- 26a. Fja. Urt. 24.36 (Mas. 30.13); Is. 10.12
27. Is. 45.8
28. Est. 4.17ff
29. Ps. 17(18).2
30. Matth. 9.15; Mark 2.20; Lluk. 5.35
31. Gal. 4.26
32. Ps. 86(87).5
33. Ef. 5.5; II Tim. 4.1,18; II Petr. 1.11
34. Joan 1.1
35. Mal. 4.2 (3.20)
36. Jis. N. 10.12; Abak. 3.11
37. I Mbret. [Sam.] 2.10 etj.
38. Gjen. 1.27-31
39. Joan 3.19; 12.46

40. Vep. 26.18  
 41. Is. 61.10  
 42. Jona 2.10  
 43. Joan 19.34; Hebr. 9.13-14; I Petr. 1.7; Apok. 1.5  
 44. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3  
 45. I Kor. 10.11  
 46. Ligji i Dytë 6.4; Mark 12.29  
 47. Ligji i Dytë 6.13; Matth. 4.10; Lluk. 4.8  
 48. Ef. 4.5  
 49. Gal. 3.27  
 50. II Kor. 4.4; Kol. 1.13-15  
 51. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 30  
 52. Hebr. 12.23  
 53. Joan 1.3  
 54. Lluk. 1.29  
 55. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34  
 56. Ps. 25(26).8  
 57. Num. 9.15-22; 10.36; Urt. Sol. 19.7  
 58. Dan. 6.18  
 59. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26  
 60. Gjen. 3.16  
 61. III Makk. 2.2  
 62. Zah. 9.16; Dan. 2.34-35, 44-45  
 63. Is. 28.16; Ef. 2.20; I Petr. 2.6  
 64. Rom. 5.10-11; II Kor. 5.18-19; Ef. 2.17-18  
 65. Ps. 105(106).2  
 66. Vep. 13.52  
 67. Eks. 34.28  
 68. III [I] Mbret. 19.8  
 69. III [I] Mbret. 17.1.7  
 70. Dan. 1.12  
 71. Dan. 3.19-23  
 72. Is. 6.3  
 73. Sirak 4.28  
 74. Eks. 33.21-23  
 75. IV [II] Mbret. 2.11; Sirak 48.9  
 76. Urt. Sol. 8.7  
 77. Is. 52.7; Rom. 10.15  
 78. Dan. 4.24  
 79. Matth. 6.2-4



## TË MËRKURËN E JAVËS SË DYTË NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve, Ali-  
luia dhe Triadiket e Tingullit të javës, dhe  
pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore Kryqë-  
sore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore  
Ting. I Ton tafon su Sotir*

**Ti** vdiqe kur mbi Kryq\* u tendose, e vra-  
ve\* armikun, gjarprin, djallin, të keqin

nga nisja,\*<sup>1</sup> kështu, ringjalle sa kish vde-  
kur, o Krisht, me kafshim ai;\* ndaj lyp,  
shpirtin tim\* të vdekur ngjalle se lutet,\*  
kreshmë, Shpëtimtar,\* po mban dhe të  
përgjërohet;\* drejt teje me dhimbje sheh.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjindësore*

**Kur** shqerra të pa ty,\* qengjin, mes krimi-  
nelësh\* të varur përmbi Kryq, Krisht,<sup>2</sup>  
thërriste me plot lot,\* vajtonte hidhur tërë  
klithma: "O im Bir i dashur fort,\* ç'pamje  
është? Çudi!". Por u përgjigje ti, o Zot:\*  
"Nënë pa cenim,\* do njihet se është jeta\*  
e botës së tërë kjo".

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësore  
Ting. III Tin oreótita*

**Me** këngë si bori\* të trumbetojmë fort\*  
në dit' të shquar<sup>3</sup> nur,\* duke kaluar ne\*  
drejt kohën e vetëpërbajtjes, të themi  
duke thirrur:\* "Vdekjen e pasioneve\* kjo  
e vyshku në botë, pra\* lulëzoi jetën ton".\*  
Me fuqinë e Kryqit tënd\* në të na ruaj, o  
Krisht Zot, Fjalë,\* ne shërbëtorët e tu pa faj.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjindësore*

**Vullnetarisht,** o Krisht\*<sup>4</sup> i mirë, kryqë-  
zim,\* vdekje të turpshme<sup>5</sup> mjaft,\* fort  
po duroje ti,\* ndaj, duke e shikuar, nëna  
jote plagosej si prind;\* brenda zemrës  
vuante\* dhe vajtonte; shpëto botën\* për-  
mes lutjeve të saj\* meqë ke përdëllim të  
thell',\*<sup>6</sup> se mbarëbotërorin mëkat, faj,\* ti  
po e ngre,<sup>7</sup> ndaj dhembshurona.

*Psalmi 50. Prifti thotë uratën e zakonshme:  
O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën,  
dhembshurinë dhe... Kanuni i Mujorit dhe  
Triodet në vendin e tyre. Lexohet dhe Ode  
III biblike.*

*Triodi, poezi e Josifit*

*Ode III*

*Ting. I*

*Stereothito i kardia mu*



I përmbimiri Fjalë Perëndi,\* në Kryq i tendose pëllëmbët dikur,\* shfarose fajin, shtrirje dore që bëri Adami keq\* drejtas bimës, pra dru njohjeje,\*<sup>8</sup> veprave prej dhembshuris'.<sup>9</sup>

Ma përforco mendjen se tundet kjo\* fort nga xhelozia e gjarprit,<sup>10</sup> pusho\* përmes pësimit tënd tallazet e veseve, meqë ti\* ke pësuar dhe besnikëve\* u fal pasionshmëri.

Shkëlqeu hiri i kreshmimit nur,\* mos-përmbajtjen, terrin e saj e dëbon;\* ja është koha që pranohet me gaz, dita për shpëtim;\*<sup>11</sup> të tregojmë fryt pendimi<sup>12</sup> pra,\* dhe do të jetojmë ne.

#### *Hyjlindësor*

O e Dëlrë, ngritja për sa ran',\* rashë në gremin' ephshesh, kënaqësish\* dhe në humnerë fajesh shumë të ndyra, ndaj nxirrme ti,\* dhe në jetë udhëhiqme drejt,\* te Biri yt, Zot! Krisht.

*Kanuni tjetër, poezi e Theodorit*

#### *Ting. III*

*Stereoson Kirie tas kardhias*

Përforcoji, o Zot, zemrat tona<sup>13</sup> në Kryqin tënd, që të mos devijojnë nga ti drejt mendimeve dinake ose veprave të neveritshme.

O Zot, kur qielli<sup>14</sup> dhe dheu<sup>15</sup> ndjenë pësimin tënd, u ndryshuan qartas, duke të treguar me të vërtetë si mbret të universit.

Lavdi *Triadik*

O Trini e Tërëshentë, tre Persona që nderohen barazi, pa nisje, jetëbërëse dhe Njësi, drita që nga fillimi, Atë, Bir dhe Shpirt, më shpëto.

Tani *Hyjlindësor*

O nënë, pa burrë, e Perëndisë, vetëm ti

lind Perëndi duke mos u prishur në dëlirësinë e virgërisë, por duke mbetur modeste, siç ishte pikërisht para lindjes.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. I falem dhe e përhimnoj mantelin tënd të kuq,<sup>16</sup> gozhdët, Kryqin, sfungerin<sup>17</sup> dhe shtizën,<sup>18</sup> të cilat dhanë jetë të çdo gjë, o Jisu.

*Irmosi: Stereoson Kirie tas kardhias*

Përforcoji, o Zot, zemrat tona<sup>13</sup> dhe ndriçoji për himnimin tënd, që të të lavdëroj në ty, o Shpëtimtar, në jetë të jetëve.

#### *Ode VIII*

*Ton tus immolous*

Ti që pranove të llogaritesh tok me të paligjshmit<sup>19</sup> nga shumica e përdëllimit,<sup>20</sup> shuaji mëkatet e mia, që të të lavdëroj me besë në gjithë jetët.

O Zot, me shtizën tënde<sup>18</sup> shqyeje dorëshkrimin e mëkateve të mia,<sup>21</sup> dhe shëroji dhimbjet e zemrës sime, që u plagos me shigjetën e sërë keqes së demonëve dinakë.

O Krishti im, me anën e gjakut që pikon prej brinjës sate,<sup>18</sup> shpërlaje zemrën time të nxirë nga gjaku zgjyrë i mëkatit, që të të lavdëroj në gjithë jetët.

*Hyjlindësor*

O Virgëreshë, që nxore pa kultivim kallirin qiellor, që me pushtet hyjnor ushqen<sup>22</sup> Gjithësinë, ngope zemrën time të varfër, që ka uri.

*Tjetri: Ton en floji tis Pesì*

Gëzohu, o Kryq, përmes të cilit u njoh në një çast si theolog Kusari që thërriste: "Kujtomë, o Zot, në mbretërinë tënde".<sup>23</sup> Tregona pjesëmarrës në të.

Kur u godite me shtizë, o Krisht,<sup>18</sup> e ktheve mbrapsht shpatën e përflaktë dhe e rihape plotësisht Parajsën për vdekata-

rët;<sup>24</sup> dhe ne, kur hymë në të, shijojmë përjetësisht jetën tënde<sup>25</sup> të pavdekshme.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin  
e Shenjtë, Zotin.

### Triadik

**B**ashkë me Atin i falemi Birit dhe Shpirtit të Shenjtë në një esencë, duke thirrur pa pushim me gojë balte: Lavdi Perëndisë Trinisor, që është në më të lartat.<sup>26</sup>

### Tani *Hyjlindësor*

**L**ind fëmijë duke qenë e virgjër, o Hyjhirpote e vetme; misteri është i madh, i frikshëm dhe kolosal, sepse linde Perëndi të mishëruar, Shpëtimtarin e botës.<sup>27</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

**O** Kryq i Krishtit, shpresa e anëve të dheut, denjësona që me qeverisjen tënde të tejkalojmë me qetësi detin e keshmës së tërëmirë, pasi të na shpëtosh nga shtrëngatat e shkeljeve.

### *Rmosi: Ton en floji tis Pes!*

»Zotin që zbriti në flakë dhe u shfaq tok  
»me Djemtë e hebrejve<sup>28</sup> nëpërmjet fuqi-  
»së hyjnore, o priftërinj, bekojeni dhe për-  
»mbilartësojeni në gjithë jetët.<sup>29</sup>

### Ode IX

#### *Tin zoodhohon pijin*

**K**ur Eliseu keshmoi, ringjalli pra\* një djal' të vdekur, siç shkruhet;<sup>30</sup> besnikë, tok\* të nxitojmë edhe ne\* që t'i vrasim me keshmim\* mentalitetet e mishit,<sup>31</sup> të arrijmë\* atje në qiell lart jetën, ta përfitojm'.

**S**hpirt, mjerë! Është gjykata e frikshme krejt,\* është vendimi plot tmerr i Gjykatësit,\* ndaj nxito, pendohu ti \* dhe pajtohu me Krishtin\* që, kur për ty lart u var në Kryq, shpëtoi\* besnikët mbar' nga dënimi në Ferr të zi.

**M**ë mbyll, Krisht, hyrje pasionesh si edhe

hap\* për mua porta pendimi; ia shfaqe qart',\* përmes kryqëzimit tënd,\* Krisht, Kusarit mjaft të leht'\* lart hyrjen, sipër pra derën e Parajsës,\*<sup>32</sup> që ta lëndoj mirësin' tënde, Zoti im.

### *Hyjlindësor*

**N**ë thellësi të së keqes u hodha un',\* po dimëroj nga mendimet e kundërta,\* te demonët bindem krejt,\* skllav jam te kënaqësit',\* ndihmomë, nënë e virgjër, dhe drejtomë,\* o e dëlirë, në udhë shpëtimi<sup>33</sup> ti.

### *Tjetri: En Sineo to ori*

**D**uke dashur u dhe, Zot, te vrasësit,\* dorëzove veten ti,\*<sup>34</sup> ndenje mbi podium kur të rrihni ty\*<sup>34</sup> duart që gatove vet'\*<sup>35</sup> dhe në Kryq, kur u ngjite,\* talleshe;<sup>36</sup> me shtizë ty\* t'shpuan,<sup>36</sup> pësoi keq\* trupi yt; durove çdo gjë që të na shpëtosh.

**B**ashkësit' engjëllore u trembën fort\* kur të panë ty mbi Kryq,\* humbën dritën ndrëçuesit,<sup>34</sup> dheu tok\* po lëkundej<sup>35</sup> dhe çdo gjë\* tundej, Zot, kur të tallnin;\* Perëndi, shpëtim për ne\* bërë,<sup>37</sup> na dhe çlirim\* nëpërmjet pësimit tënd të hyjnueshëm.

### Lavdi *Triadik*

**N**ë esencë, Njësi është, s'ndahet hiç\* Shën Trinia mbi çdo zot,\* në natyrë bashkohet, por ndahet kjo\* në Persona veç e veç\* edhe pse s'ndahet, ndahet,\* një në treshe është pra,\* një Perëndi, Hyjni\* - Ati, Biri, Shpirti i gjall' - që ruan çdo gjë.

### Tani *Hyjlindësor*

«Kush dëgjoji se lindi një virgjëresh'\* dhe pa burrë është nën'»? Ti e kreve, Mariam, aktin kolosal,\* si e bërë? Thuamë!'.\* «Mos heto lindjen time,\* ka një thellësi pa fund,\* është e vërtetë krejt,\* është' mbi çdo mendim njerëzor koncepti i saj!.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.



U shëruam nga veset e fajeve\* përmes plagës sate, Zot,\*<sup>7</sup> e plagose armikun nga nisja ti\* kur u ngjite përmbi Kryq;\* pa dënim denjësona\* Ngjalljen ta arrijmë ne,\* si të kalojmë mir\*,\* drejt të gjithë kohën e kreshmës plot me virty.

*Irmosi: En Sineo to ori*

»Moisiu në malin Sina të pa\* në një ferrë, se në bark\* zure, pa u shkumbuar hiç, zjarrin tmerr\*<sup>38</sup> të Hyjnisë, ndërsa mal\* pa latim Danieli\* të pa,<sup>39</sup> Isaia shenjt\* shkop pra të thirri ty\* që do mbijë prej rrënjës së Davidit shenjtior.<sup>40</sup>

*Fotagojiku i Tingullit të javës*

*Pasvargjet e Lavdërimeve*

*Ting. i Rëndë Idhiomeli*

O Zot, që me anën e Kryqit tënd zgjidhe vdekjen<sup>41</sup> që u fut në botë për shkak të ngrënies nga druri, gjë që ishte e ndaluar në Parajsë,<sup>8</sup> ty të lutemi: Nëpërmjet kësaj kreshme, çlirona nga çdo kënaqësi shpirtprishëse dhe denjësona të punojmë për ushqimin që mbetet në jetën e amshuar,<sup>42</sup> që të arrijmë kurorat e shijimit të paprishëm, të cilat i përgatite për keshmuesit e vërtetë.<sup>43</sup>

*Varg:* U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfryshim në vend të ditëve që na përule, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt' e tyre.

*I njëjti*

*Varg:* Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji te ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

*Martirik*

Martirët athlororë u dalluan si ndriçues të planetit<sup>44</sup> duke i thirrur Krishtit: O Zot, lavdi më ty.

Lavdi dhe Tanë *Kryqhyjlindësore*

*Uqeti koliometha*

Sapo të pa e Tërëpaqortueshmja të ngulur në dru vullnetarisht,<sup>4</sup> himnonte duke vajtuar pushtetin tënd.

*Lexuesi:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin etj. si të hënën e javës së parë në mëngjes (fq. 63).

*Në orën e Gjashtë (në Tërthektë), Tropari i Profecisë:*

*Ting. Tërth. II*

O Perëndi i tërëllartë, Shpëtimtari ynë, që banon në qiej,<sup>45</sup> që krijove çdo frymë,<sup>46</sup> mëshirona, sepse në ty shpresuam.

Lavdi dhe Tanë

*I njëjti*

Proqimen. Ting. Tërth. I. Psalm 29. Drejt teje do të thërras, o Perëndia im.

*Varg:* Do të të lartësoj, o Zot, sepse më mbështete.

Këndimi i profecisë së Isaia

*(5.16-25)*

Do të lartësohet Zoti Sabaoth në glykim, dhe Perëndia i shenjtë do të lavdërohet në drejtësi. Dhe do të kullotin si dema të rrëmbyerit, dhe shkretëtirat nga të cilat u morën, do t'i hanë qengjat. Mjerë ata që i heqin mëkatet si litar i gjatë dhe paligjësitë si rrip zgjedhe mështjerre, të cilët thonë: "Le të afrohen shpejt ato që do t'i bëjë, që të shohim, dhe le të vijë vendimi i të shenjtit të Izraelit, që të njohim". Mjerë ata që thonë dinaken si të mirë dhe të mirën si dinake, ata që vendosin errësirën si dritë dhe dritën si errësirë, që vënë të hidhurën si të ëmbël dhe të ëmblën si të

hidhur. Mjerë të mençurit në veten e tyre dhe dijetarët para vetes së tyre. Mjerë të fortët tuaj, që e pinë verën, dhe pushtetarët që përziejnë pijet alkooolike, ata që e drejtësojnë të pabesin për shkak ryshfetes, dhe e marrin të drejtën e të drejtit. Për këtë, në atë mënyrë që do të digjet kallam prej qymyr zjarri, dhe do të digjet prej flake të lartësuar rrënja e tyre, si push do të jetë, dhe lulja e tyre si pluhur do të ngjitet, sepse nuk e duan ligjin e Zotit Sabaoth, por e acaruan thënien e të shenjtit të Izraelit. Dhe u inatos me mëri Zotit Sabaoth kundër popullit të tij, dhe e vuri dorën e tij mbi ta, dhe i goditi. Dhe u inatosën malet, dhe të vdekurit e tyre u bënë si pleh në mes udhe; dhe në këto të gjitha nuk u kthye inati i tij, por akoma është e lartë dora e tij.

Proqimën. Ting. Tërth. II. Psalm 30.  
Përmbi ty, o Zot, shpresova, le të mos turpërohem përjetë.

*Varg:* Në drejtësinë tënde çliromë dhe nxirrme.



## TË MËRKURËN E JAVËS SË DYTË NË MBRËMËSORE

### 10 Thirrtore

#### Ting. I Idhiomeli

**O** vëllezër, duke marrë përsipër keshmën shpirtërore, me gjuhë mos flisni dinaket, as mos i vini pengesë vëllait për skandal,<sup>47</sup> por me anën e pendimit, duke hlijësuar llambën e shpirtit<sup>48</sup> përmes lotëve, le t'i thërrasim Krishtit: Fali shkeljet tona<sup>49</sup> si njerdashës. (2x)

*Martirike  
Panëfimi märtires*

**M**artirë të famshëm krejtësisht,\* toka nuk ju fshehu dot,\* por ju mikpriti lart qielli, ju hapën plotësisht\* dyert e Parajsës\* dhe, si hytë brenda, po shijoni drurin, pemën e jetës,<sup>50</sup> Krishtit përgjërojuni\* që në shpirt të na dhurohet hir,\* paqe edhe përdëllim i madh<sup>51</sup> gjithnjë.

#### Të tjera, të zotit Josif

#### Ting. III Megali ton martiron su

**M**e lutjet e apostujve të hyjshëm, Zoti Krisht,\* ta kryejm' mirë kohën e keshmës denjësona ne\* dhe të kemi kataniks në mendje, se je\* i dhembshur, përdëllyes,\* të të lëvdojmë gjithë ne duke shpëtuar.

**D**o jetë ardhja jote, Krisht, e madhe dhe plot tmerr,\* kur do t'na bësh gjykimin e drejtë, si të ulesh ti;\*<sup>52</sup> i dënuar jam, mos më gjyko, por si Zot,\* nga ndërmjetimet që pret\* prej krejt apostujve të tu, kursemë mua.<sup>20</sup>

#### Tjetër, e zotit Theodor

#### Ting. Tërth. II Olin apothëmeni

**O** apostuj zotëror\*,\* ndriçues pra për të vdekshmit,\* pasuroní kozmosin\* si thesar me tërë hyjdijen urtësisht;\* nga çdo ngacmim, përmes\* lutjeve që bëni\* aq të shenjta, na çlironi ne që ju këndojmë mjaft;\* bëni që në paqe ta kryejmë\* dhe kohën e keshmimit ton',\* të jetojm' lirisht, larg së keqes ne\* që, kur te pësimi i Krishtit të arrijm' siç do ai,\* t'i sjellim himne me plot guxim\* Perëndisë tonë Zot.

#### Dhe katër të Mujorit

#### Lavdi dhe Tani

#### E Mujorit (Hyjlindësore)

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Prifti:* Mbrëmje!  
*Lexuesi:* Proqimën. Ting. Tërth. II. Psalm 31.  
Dëfreni në Zotin dhe ngazëllohuni, të drejtë.

*Varg:* Lum ata që u janë falur paudhësitë.



## Këndimi i Gjenezës

(4.16-26)

Doli Kaini nga fytyra e Perëndisë dhe banoi në tokën Naidh, përballë Edenit. Dhe Kaini e njohu gruan e tij dhe, si ajo u ngjiz, lindi Enohun; dhe ishte duke ndër-tuar qytet, dhe e quajti qytetin me emrin e birit të tij, Enoh. Dhe Enohut i lindi Gajdhadhi, dhe Gajdhadhiti i lindi Maleleelit, dhe Maleleelit i lindi Mathusala, dhe Mathusalës i lindi Lamehu. Dhe Lamehu mori për vete dy gra; emër për njërin ishte Adha dhe emër për të dytën Sela. Dhe Adha lindi Jovilin; ai ishte ati i blegtorëve që banonin në tenda. Dhe emri në vëllanë e tij ishte Juval; ai ishte ai që tregoi psaltir dhe kitarë; ndërsa Sela lindi dhe ajo Thovelin dhe ishte bakërpunues, farkëtar hekuri; ndërsa motër e Thovelit ishte Noema. Dhe Lamehu u tha grave të tij: "O Adhë dhe Selë, dëgjoni zërin tim; gra të Lamehut, vërin veshin fjalëve të mia, sepse vrava një burrë në traumën time dhe një të ri në plagën time; sepse nga Kaini u morën hakmarrje shtatë herë, ndërsa nga Lamehu shtatëdhjetë herë shtatë". Dhe Adami e njohu Evën, gruan e tij, dhe ajo, si u ngjiz, lindi një bir dhe e quajti emrin e tij Sith, duke thënë: "Sepse më ngriti Perëndia një farë tjetër në vend të Abelit, të cilin e vrau Kaini". Dhe Sithit u bë një bir dhe e quajti emrin e tij Enos; ky shpreso i thërriste emrin e Zotit Perëndi.

## Proqimën. Ting. I. Psalm 32.

Le të bëhet, o Zot, përdëllimi yt mbi ne.

*Varg:* Ngazëllohuni, të drejtë, në Zotin.

## Këndimi i Fjalëve të Urta

(5.15-6.3)

Bir, pi ujëra nga enët e tua dhe nga burimi i puseve të tua; të mos të derdhen ujëra dhe të mos rrjedhin nga burimi yt, por

ujërat e tua të ecin në sheshet e tua, të ekzistojnë vetëm për ty, dhe asnjë i huaj të mos marrë pjesë tok me ty. Burimi yt i ujit le të jetë yt dhe dëfre bashkë me gruan që është që nga rnia jote; drenushë miqësie dhe pulisht i hireve të tua le të flasë me ty, dhe lotja le të jetë para teje, dhe le të jetë tok me ty në çdo kohë, sepse, duke u endur brenda miqësisë së saj, do të jesh shumë i madh. Mos ji i madh drejt një gruaje të huaj, as mos u mba në gjirin e asaj që nuk është lotja, sepse udhë burri janë para syve të Perëndisë, dhe ai mbikëqyr në të gjitha trajektoret e tij. Paliqësi kapin si gjah çdo burrë dhe cilldo shtrëngohet me vargonjtë e mëkateve të tij. Ky vdes bashkë me të paedukuarit dhe u hodh jashtë shumicës së pasurisë së tij, dhe u shfaros për shkak idiotësie. Bir, nëse do të bëhesh garant për mikun tënd, do ta dorëzosh dorën tënde tek armiku, sepse për çdo burrë buzët e veta janë kurth i fortë, dhe robërohet prej buzëve të vetë gojës së tij. Bir, bëji ato që unë të porosis dhe shpëto.

Le të drejtohet lutja ime *dhe shërbesa e të Parashenjësuarave që mbetet.*

## CITIME

1. Apok. 12.9
2. Matth. 27.38; Mark 15.27; Lluk. 23.33; Joan 19.18
3. Ps. 80(81).4
4. Joan 10.15,17-18
5. Ligji i Dytë 21.23; Gal. 3.13
6. Lluk. 1.78
7. Is. 53.4-5; I Petr. 2.24
8. Gjen. 3.1-6
9. Fil. 2.1; Kol.3.12
10. Urt. Sol. 2.24
11. Is. 49.8; II Kor. 6.2
12. Matth. 3.8; Lluk. 3.8
13. I Mbret. [Sam.] 2.1
14. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
15. Matth. 27.51
16. Matth. 27.28; Mark 15.17; Lluk. 23.11; Joan 19.2
17. Matth. 27.48; Mark 15.36; Joan 19.29
18. Joan 19.34
19. Is. 53.12; Mark 15.28; Lluk. 22.37

20. Ne. 13.22 etj  
 21. Kol. 2.14  
 22. Joan 6.50-58  
 23. Lluk. 23.42  
 24. Gjen. 3.24  
 25. Joan 1.4  
 26. Lluk. 2.14  
 27. Joan 4.42  
 28. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25  
 29. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61  
 30. IV [II] Mbret. 4.35  
 31. Rom. 8.6  
 32. Lluk. 23.43  
 33. Vep. 16.17  
 34. Matth. 26.57,67; Joan 18.22  
 35. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5;  
 Jov 10.8-9; II Makk. 7.23  
 36. Matth. 27.29; Mark 15.18; Lluk. 22.63-65; Joan 19.2-3  
 37. Ps. 73(74).12  
 38. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16  
 39. Dan. 2.34-35  
 40. Is. 11.1  
 41. Gjen. 3.19  
 42. Joan 6.27  
 43. Is. 58.6-7  
 44. Fil. 2.15  
 45. Ps. 2.4; 122(123).1  
 46. Fja. Urt. 24.12  
 47. Rom. 14.13  
 48. Matth. 25.7  
 49. Matth. 6.12; Ef. 1.7  
 50. Gjen. 2.9; 3.22,24; Apok. 3.7; 22.2,14  
 51. Num. 14.19 etj.  
 52. Dan. 7.9-11

## TË PREMTEN E JAVËS SË DYTË NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve, Aliluat dhe Triadikët e Tingullit të javës, dhe pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove Kryqësore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove  
Ting. IV Tahi prokatálave*

**N**ga veset e ulëta me kreshm' të ngrihemi lart,\* që ta lartësojmë Zotin<sup>1</sup> që u ngrit përmbi Kryq dhe botën e ngriti tok,\* pijen e kataniksit\* me ndërgegje ta pjmë\* dhe ta mendojmë kohën si dhe ditën

e orën,\* tekta do qëndrojmë mu përpara Gjykatësit.<sup>2</sup>

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësore*

**E** panusëruara nën' përmbi Kryq kur të pa,\* o jeta e çdokujt,<sup>3</sup> ty të varur, fliste, të thoshte, Zot, me vaj hidhur ty:\* Ç'pamje e re, e huaj,\* është kjo, Fjalë? Si pra\* gozhdët e fajit pa dashur i shkuli hordhia\* që s'ka ligj, kur ty të nguli siç deshe, me vullnet!<sup>4</sup>

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësove  
Ting. Tërth. I Lampi simeron*

**L**lamburit, o Zot, hiri i Kryqit tënd, duke shkëlqyer tërë rruzullin; zhduk fuqinë e demonëve dhe hijeson tani udhën e agjërimit, duke na përforcuar në të; mëshirona.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësore  
Ton sinánarhon Logon*

**K**ur jot ëmë që pa dhimbje ty të lindi,<sup>4a</sup> t'pa\* të ngritur lart përmbi dru, qante dhe me klithmë e vaj\* të thërriste: Mjerë, Bir, i ëmbli shumë Zot!\* Duke të parë përmbi Kryq,\* po plagosem shpirtërisht, se shoh që je i mbërthyer\* midis dy kriminelësh<sup>5</sup> porsì një kriminel tani dhe ti.

*Psalmi 50. Prifti thotë uratën e zakonshme:  
O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën,  
dhembshurinë dhe... Kanuni i Mujorit dhe  
Triodet në vendin e tyre. Lexohet dhe Ode V  
biblike.*

*Triodi, poezi e Josifit  
Ode V  
Ting. IV  
Asevis uk ópsonte*

**O** Zot, vullnetarisht u lartësove në Kryq<sup>4</sup> dhe e vithise vullshëm armikun; prandaj, nëpërmjet dhembshurisë sate, më ringri mua që, po vullnetarisht, rashë në humnera kënaqësish.



O Jisu, ti që errësove diellin<sup>6</sup> duke u tendosur në Kryq dhe fekse të gjitha tërësitë e kozmosit, ndriçomë mua që u errësova në shpirt me pasione pa vend.

Denjësomë, o Krisht, që të lundroj me qetësi mbarë detin e kreshmës, duke paqësuar dallgët e mendjes sime, dhe ankoromë në limanin e Ngjalljes.

### *Hyjlindësor*

Le ta nderojmë me mendje të dëlirë të Kulluarën, bukurinë e Jakovit,<sup>7</sup> duke u zbukuruar me vepra të perëndishme, le ta himnojmë besërisht si nënën e Perëndisë tonë.

### *Triodi tjetër, poezi e Theodorit Ting. Tërth. I*

#### *Tus ek niktós prosqinuntas*

Ti, përderisa u kryqëzove, më çliron nga prishja; dhe, meqenëse u shpove me shtëzë,<sup>8</sup> më bën të pavdekshëm; e lavdëroj përdëllimin tënd të pashprehshëm, sepse erdhe, o Krisht, që të më shpëtosh.<sup>9</sup>

Kur i tendose pëllëmbët e tua në Kryq, o Zot, e vrave Amalikun<sup>10</sup> mendor, duke shpëtuar popullin tënd; ndaj e himnoj më pushtetin tënd.

### *Lavdi Triadik*

Le ta himnoj më Hyjninë e tërëpërmblqenshme në tre Persona dhe një autoritet, Atin pa fillim, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë.

### *Tani Hyjlindësor*

Atë që nuk mund ta nxinte qielli, ti, pasi e nxure në bark, e linde; o mrekulli e frikshme dhe e pashprehshme! Për këtë të himnoj më të gjithë, o e pacenuar.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Ti që për hirin tim durove kryqëzim, pive uthull<sup>11</sup> dhe the "Mbaroi",<sup>12</sup> mbaroje garën time të kreshmës, duke më denjësuar ta

shikoj Ngritjen tënde.

### *Irmosi: Tus ek niktós prosqinuntas*

»Ata që të falen qëmenatë, o Krisht, »mëshiroji dhe dhuroju paqe, sepse ur- »dhërimet e tua janë dritë<sup>13</sup> dhe u bënë »shërime për shërbëtorët e tu, o njeri- »dashës.

### *Ode VIII*

#### *Pedhas evajis*

Kur u mbërtheve në Kryq nga dhembshuria, e hape Parajsën për Kusarin;<sup>14</sup> dhe tani mua që më rrëmbeu dredhia e demonit dhe jam i plagosur tërësisht në shpirt, shëromë<sup>15</sup> pasi të m'i çelësh portat e pendimit me anën e njerdashjes sate.

Meqë e ndriçam mishin me anë të kreshmës, le ta forcojmë shpirtin me anë të virtyteve; le të ushqejmë të varfrit, duke fituar në qiell pasuri<sup>16</sup> që nuk shteron dhe le të thërrasim: Zotin bekojeni, o vepra, dhe përbilartësojeni në gjithë jetët.<sup>17</sup>

O Shpëtimtar i përbimirë, gjatë pësimit tënd krijesa u tund sapo të pa që mbërtheheshe mbi Kryq,<sup>18</sup> prandaj të përgjërohëm: O i dhembshur, forcoje në gurin e pathyeshëm të vullneteve të tua<sup>19</sup> mendjen time, që gjithmonë tundet nga sulmet e gjarprit.

### *Hyjlindësor*

O Hyjhirpote, porta e mbyllur e Perëndisë, të cilën e kaloi vetëm Zoti,<sup>20</sup> më drejto në udhë të hyjshme dhe m'i hap dyert e shpëtimit, sepse drejt teje përiki, o Virgjëreshë, mbrojta e vetme e gjinisë së njerëzve.

### *Tjetri: Ton piitín tis ktiseos*

Duke e himnuar drurin e tërëshenjtë në të cilin u kryqëzove, o Krishti im, të përbimbekoj në gjithë jetët.

Të paligjshmit të vranë, o Krisht, kur të kryqëzuan në Golgotha, mirëpo rron dhe na shpëton në jetë.<sup>21</sup>

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin  
e Shenjtë, Zotin.

### Triadik

Trinia ndahet në mënyrë të çuditshme dhe mbetet e pandarë si Perëndi, të cilin e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

### Tani Hyllindësor

O e Tërëpacenuar, bëj përgjërëm për hir të atyre që të himnojnë, që të çlirohen nga ngasjet dhe rreziqet e shumëllojshme.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

O Zot, pasi të më forcosh me fuqinë e Kryqit tënd, denjësomë që ta përfundoj me guxim udhën e kreshmës.

### Irmosi: Ton piitën tis ktiseos

»Bërësin e Krijesës, që e kanë frikë »engjëjt,<sup>22</sup> përhimnojeni, o popuj, dhe për- »mbilartësojeni në gjithë jetët.

### Ode IX

#### Lithos ahirōtmitos orus

Të parashikoi profeti si gur të prerë prej një mali,<sup>23</sup> pra prej Virgjërëshës, o Zot, Shpëtimtar,\* që gurë ti theve përmes Kryqit;<sup>24</sup> çliromë, o i dhembshur krejt,\* se apatia më rëndon si gur.

Dashurin' hyjnore shijoje si nga e keqja të kreshmosh, shpirt,\* për idetë mbarë të mira ti hap\* një derë, si të bllokosh krejt hyrjen\* e djallëzisë nëpërmjet\* vetëpërmbytjes edhe lutjes tok.

Mua të dënuarin, Zot, Shpëtimtar, çliromë, se dënove\* ti armiqësinë përmes Kryqit tënd,\* fajtor për Gjehenën mos më shfaq pra\* të ziun prej mëkateve,\* që u njolloso prej pasioneve.

### Hyllindësor

Të të vijë keq, Krisht, kursemë,<sup>24</sup> kur me lavdi të vish për gjyqin\* mbarëbotëror, zgjidhe mjegullën pus,\* të keqen që kam nëpërmjet lypjes\* së nënës; lart në qiell bëm'\* trashëgimtar në mbretërin' tënde.<sup>25</sup>

### Tjetri: Isaia hōreve

Prap' Parajsën ti e hap\*<sup>26</sup> si u ngjite\* përmbi Kryq një her';\* dhe, kur në të marr pjesë, shijoj me gaz\* un' jetën, çlirohem dhe nga vdekja<sup>27</sup> tmerr në amshim, kjo është'\* mosbindje; ndaj si Zot\* njeridashës ty të madhështoj.

Vula përshpëtim u shfaq\* vegël nëme,\*<sup>28</sup> jetëbërësi\* Kryq, Perëndia Krisht; marrim jetë plot\* sa herë mbi të të shohim ne që vdiqëm më parë keq;\* të përhimnojmë ty\* dhe të madhështojmë ne si Zot.

### Lavdi Triadik

O Trini, në një esenc'\* të himnoj ty;\* o e pafillim,\* Njësi e respektuar, pa ndarje hiç,\* eplore në jetë, Atë që nuk linde, o Fjalë, Bir\* që linde, Shenjti Shpirt\* sa të psalim, na shpëto krejt ne.

### Tani Hyllindësor

O Hyjnënë, linde Bir\* përmbi mendje,\* meqë zure ti\* pa burr', se Perëndi ish i linduri,\* prandaj edhe shtatzënia jote ish virgjërore nur;\* të lumërojmë ty\* dhe e madhërojmë Krishtin ne.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

Kryq i çmuar, forca je,\* streha ime,\* bëhu dhe ndriçim\* tani përmes përmbajtjes dhe më dëfre,\* pastromë, nga ngasjet më çliro, që un' të të lavdëroj,\* Zotin tim Perëndi,\* Krishtin njeridashës, Shpëtimtar.

### Irmosi: Isaia hōreve

»Isaia vallëzo,\* Virgjërësha,\* Zonja Shën »Mari\* na lindi Jisu Krishtin Emanuel,\*<sup>29</sup>



«njeri edhe Perëndi; dhe emër ka Lindjen<sup>30</sup>  
«që na ndrit.\* Pra, madhështojm' atë,\*  
«lumërojmë dhe Hyjlindësen.\*

*Fotagojiku i Tingullit të javës*

*Pasvargjet e Lavdërimeve*

*Ting. Tërth. IV Idhiomeli*

**K**reshma e tanishme pasionvrasëse premtton të shërojë ata që pësuan keq prej mëkatit. Pasi t'i pranojmë me anën e Moisiut pllakat e hyjshkruara,<sup>31</sup> le ta nderojmë agjërimin si ndihmës nga Perëndia, të mos preferojmë mospërmbajtjen që i thërmoi ato,<sup>32</sup> të mos bëhemi pjesëmarrës me ata, të cilëve u ranë kofshët në shkretëtirë;<sup>33</sup> të mos vrenjtemi në mënyrë judaike,<sup>34</sup> por le të hijeshohemi në mënyrë kishtarë, të mos kemi hipokrizi në mënyrë farisiane,<sup>35</sup> por le të zbukurohemi në mënyrë ungjillore, duke u mburrur me Kryqin e Krishtit,<sup>36</sup> Çlirimtarit të shpirtave tanë.

*Varg:* U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përulë, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt' e tyre.

*Injëjti*

*Varg:* Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji te ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

*Martirik Ti imas kalësomen ajji*

**Ç**farë mund t'ju quajm', shenjtorë, ne?\* Keruvime? Se u preh përmbi ju Krishti Perëndi.\*<sup>37</sup> Serafime? E lëvduat pa pushim atë me himn.\*<sup>38</sup> Dhe engjëj? Se shpërfillët trupin, mishin pra.\* Dhe Forca? Se veproni me çudi<sup>39</sup> gjithnjë\* dhe keni emra të shumtë ju,\* karizma fort të mëdha me hir,\* ndaj ndërmjetim\* bëni të shpëtohen shpirtat tan'.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësor*  
**Z**otit i thërriste e Virgjira Zonj!\* porsi nënë: Ç'është kjo gjë e çuditshme, kjo habi? Dhimbjet që s'i ndjeva, o Bir,\*<sup>4a</sup> kur të linda, vijnë fort\* të ashpra brenda zemrës sime; nuk duroj\* në Kryq lart të të shoh të ngulur ty që Je\* ndriçim për sytë e mi, o Krisht;\* siç the, ngjallu<sup>40</sup> që me botën tok\* Ekonomin\* që ke bërë frikshëm, ta lëvdoj.

*Lexuesi:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin etj. si të hënën e javës së parë në mëngjes (fq. 63).

*Në Orën e Gjashtë (në Trithektë), Tropari i Profecisë:*

*Ting. I*

**N**atë e ditë të biem ndër këmbë, o Zot, që t'u japësh ndjesë mëkatesh shpirtave tanë, që të të falemi me paqe dhe të lavdërojmë, o njeridashës.

Lavdi dhe Tani

*Injëjti*

Proqimen. Ting. IV. Psalm 37.

O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd, as mos më mudo në mërinë tënde.

*Varg:* Se shigjetat e tua m'u ngulën dhe dora jote rëndon mbi mua.

Këndimi i profecisë së Isaias.

*(7.1-14)*

**U** bë në ditët e Ahazit të Joathamit, të birit të Oziut, mbretit të Judës, u ngjiti Rasimi, mbret i Aramit, dhe Faqeeu, biri i Romellut, mbreti i Izraelit, kundër Jerusalemit që ta luftonin, dhe nuk mundën ta rrethonin me sukses. Dhe iu njoftua shtëpisë së Davidit duke thënë: "Ra dakord Arami ndaj Efremit". Dhe u shtang shpirti i tij dhe shpirti i popullit të tij, në mënyrë që ashtu si një dru në pyll do të lëkundet prej erës. Dhe Zoti tha drejt Isaias: "Dil për takim me Ahazin ti dhe Jasuvi, biri yt që mbeti, drejt rezervuarit të

udhës së sipërme të arës së përpunuesit të leshit, dhe do t'i thuash: 'Ruhu, që të qetësohesh dhe mos u frikëso, as të mos dobësohet shpirti yt prej këtyre dy drurëve, pishtarëve që lëshojnë tym, sepse, kur të bëhet zemërimi i inatit tim, përsëri do të shëroj'. Dhe biri i Aramit, dhe biri i Romeliut, meqë menduan vendim dinak për ty, duke thënë: 'Do të ngjitemi në Jude dhe, si të bisedojmë me ta, do t'i kthejmë drejt nesh dhe do të vendosim si mbret për ta birin e Taveelit"', këto thotë Zoti Sabaoth: "Nuk do të qëndroj ky mendim, as nuk do të jetë më, por kreu i Aramit do të jetë Damasku dhe kreu i Damaskut Rasimi; por ka ende gjashtëdhjetë e pesë vjet dhe do të zhduket mbretëria e Efremit nga populli; dhe kreu i Efremit do të jetë Somora, dhe kreu i Somorës biri i Romeliut; dhe, në qoftë se nuk do të besoni, as do të kuptoni". Dhe Zoti i shtoi së foluri Ahazit duke thënë: "Kërko për vetë shenjë prej Zotit, Perëndisë tënd, në thellësi a në lartësi". Dhe Ahazi tha: "Nuk do të kërkoj, as nuk do ta ngas Zotin". Dhe tha: "Dëgjoni pra, o shtëpia e Davidit: Mos ju duket gjë e vogël t'u jepni luftë njerëzve? Dhe si i jepni luftë Zotit? Prandaj vetë Zoti do t'ju japë shenjë".

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 38.  
Dëgjo, o Zot, faljen time.

*Varg:* Thashë: Do t'i ruaj udhët e mia.



## TË PREMTEN E JAVËS SË DYTË NË MBRËMËSORE

*10 Thirrtoje*  
*Ting. IV Idhiomeli*

Tani është kohë e mirëpritur, tani ditë shpëtimi;<sup>41</sup> nga shumica e mëshirës sate<sup>42</sup> vizitoje shpirtin tim dhe ndjeje ngarkesën

e paligjësi të mia, o i vetmi Njeridashës.  
(2x)

*Pastaj 4 Martirikët e Tingullit të javës dhe 4 të Mujorit. Lavdi Nekrosime dhe Tani Hyjindësore po të Tingullit (kërkoji në fund të librit).*

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Priifti:* Mbrëmje!  
*Lexuesi:* Proqimen. Ting. IV. Psalm 39.  
Mëshira jote, o Zot, dhe e vërteta jote.  
*Varg:* Duke duruar, durova duke pritur Zotin.

## Këndimi i Gjenezës (5.32-6.8)

Noeu ishte pesëqind vjeç dhe i lindën tre bij, Simi, Hami dhe Jafethi. Dhe u bë që, kur njerëzit filluan të bëheshin të shumtë mbi tokë, dhe atyre iu lindën bija. Dhe, kur bijtë e Perëndisë panë bijat e njerëzve se ishin të bukura, morën për veten e tyre gra nga të gjitha që ata zgjodhën. Dhe tha Zoti Perëndi: "Nuk do të mbetet absolutisht shpirti im në këta njerëz në jetë, sepse ata janë mishra, dhe ditët e tyre të jetës do të jenë njëqind e njëzet vjet". Ndërsa gjigantët ishin mbi dhë në ato ditë; dhe pas kësaj, kur hynin bijtë e Perëndisë drejt bijave të njerëzve, dhe u lindnin fëmijë. Ata ishin gjigantët që nga jeta, njerëzit emërmëdhën. Dhe kur Zoti Perëndi pa se u shumëfishuan të këqijat e njerëzve mbi tokë dhe se cilido mendon në zemrën e tij kujdesshëm mbi djallëzoret në gjithë ditët, dhe Perëndia kujtoi se bëri njeriun mbi tokë dhe mendoi; dhe Perëndia tha: "Do ta shfaros nga faqja e dheut njeriun që bëra që nga njeriu deri te kafshët dhe nga zvarranikët deri te zogjtë e qiellit, sepse u pendova që i bëra". Por Noeu gjeti hir para Zotit Perëndi.

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 40.  
Unë thashë: O Zot, mëshiro më.

*Varg:* I lum ai që kupton për të varfër.



## Këndimi i Fjalëve të Urta

(6.20-7.1)

O bir, ruaji ligjet e atit tënd dhe mos i zbraps rregullat e nënës sate. Lidhi ato mbi shpirtin tënd përgjithmonë dhe vëri si varëse rreth qafës sate. Kur ecën, sille atë, dhe le të jetë me ty; kur fle, të ruajttë që, kur të ngrihesh, të flasë me ty, sepse porosi ligji është llambë dhe dritë, udhë jete dhe kontroll dhe edukim që të të ruajë prej gruaje të martuar dhe prej shpifjeje gjuhe të huaj. Të mos të të mundë dëshirë bukurie, as të mos bëhesh pre përmes syve të tu, as të rëmbehesh nga qepallat e saj, sepse çmimi i një lavireje është sa ai i një buke, dhe gruaje kap gjah shpirta të nderuar burrash. Ndokush do të lidhë zjarr në gjoksin e tij, por nuk do t'i shkrumbojë rrobat? Ose dikush do të ecë mbi qymyre zjarri, por nuk do t'i djegë këmbët? Kështu, ai që u fut drejt gruaje të martuar, nuk do shpallet i pafajshëm; as kushdo që e prek. Nuk është e çuditshme nëse dikush do të kapet duke vjedhur, sepse, ngaqë ka uri, vjedh që të mbushë shpirtin, por, nëse kapet, do të paguajë shtatëfish dhe, si të japë gjithë kamjen e tij, do ta shpëtojë veten; ndërsa kurorëshkelësi, për shkak të varfërisë së mendjes, i dhuron shfarosje shpirtit të tij; vuan dhe dhimbje, dhe çnderime, ndërsa turpi i tij nuk do të shuhet në jetë, sepse inati i burrit të saj është i mbushur plot me xheloz; nuk do ta kursejë në ditë gjykimi, nuk do ta shkëmbejë me asnjë shpërblim armiqësinë, as nuk do të shpërbëhet me shumë dhurata. O bir, ruaji fjalët e mia, dhe porositë e mia fshihni në veten tënde. Bir, nderoje Zotin dhe do të fuqizohesh dhe, përveç atij, mos ki frikë asnjë.

Le të drejtohet lutja ime dhe shërbesa e të Parashenjtëruarave që mbetet.

## CITIME

1. Ps. 98(99).5
2. Rom. 14.10
3. Joan 1.4; 11.25;14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
4. Joan 10.15,17-18
- 4a. Is. 66.7
5. Matth. 27.38; Mark 15.27; Lluk. 23.33; Joan 19.18
6. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
7. Ps. 46(47).5
8. Joan 19.34
9. Lluk. 9.56; Joan 3.17; 12.47
10. Eks. 17.11-13
11. Matth. 27.34,48; Mark 15.36; Lluk. 23.36; Joan 19.29
12. Joan 19.30
13. Is. 26.9
14. Lluk. 23.42-43
15. Lluk. 10.29-35
16. Matth. 19.21; Mark 10.21; Lluk. 18.22
17. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
18. Matth. 27.51
19. Matth. 7.24; Lluk. 6.47-48
20. Jez. 44.1-4
21. Hebr. 7.25
22. Ps. 88(89).8
23. Dan. 2.34-35
24. Ne. 13.22
25. Mark 10.17; Lluk. 10.25; 18.18
26. Gjen. 3.24
27. Gjen. 3.17-19
28. Ligji i Dytë 21.23; Gal. 3.13
29. Is. 7.14
30. Zab. 6.12
31. Eks. 31.18; 32.16
32. Eks. 32.19
33. Num. 14.29-33; Hebr. 3.17
34. Matth. 6.16
35. Lluk. 18.11
36. Gal. 6.14
37. IV [H] Mbret. 19.15; Is. 37.16; Jez. 10.1; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 31
38. Is. 6.2-3; Apok. 4.8
39. Matth. 14.2; Mark 6.14; Gal. 3.5
40. Matth. 16.21; 27.63; Lluk. 9.22
41. Is. 49.8; II Kor. 6.2
42. Ps. 5.8; 68.14; 105(106).45; Sirak 51.3; Is. 63.15; Vajt. 3.32; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 18

TË SHTUNËN E JAVËS SË DYTË  
NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve  
psalim në Ting. II  
Ailulua (3x)*

*Të dytën me Varg: Të lumtur ata që i zgjidhe*

dhe i more, o Zot.

Alilua (3x)

*Të tretën me Varg:* Dhe kujtimi i tyre në jetë të jetëve.

Alilua (3x)

*Ting. II*

**O** apostuj, martirë, profetë, hierarkë, oshënarë dhe të drejtë, që e kryet mirë garën dhe e ruajtët besën,<sup>1</sup> duke pasur guxim para Shpëtimtarit, lutemi, lypini për ne atij që, si i mirë, t'i shpëtojë shpirtat tanë.

Lavdi *Nekrosime*

**K**ujto, o Zot, si i mirë shërbëtorët e tu dhe ndjeji sa mëkatuan në jetë, sepse askush nuk është i pamëkatshëm, përveç teje<sup>2</sup> që mund t'u japësh ngjalljen atyre që u shpërngulën.

Tani *Hyjindësore*

**O** nënë e shenjtë e dritës<sup>3</sup> së pashprehshme, të madhërojmë duke të nderuar me himne engjëlllore.

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret Martirike dhe Hyjindësorja e Tingullit të javës. Pastaj [i Paqortueshmi, Ps.118, në dy Stanca dhe] Bekimtoret Nekrosime (fq. 245 Uratore e Vogël). Prifti: Mëshirona, o Perëndi... etj. O Perëndi i shpirtave dhe i çdo trupi... Pastaj psalti:*

*Ndenjësore Ting. Tërth. I*

**P**rehi, o Shpëtimtari ynë, bashkë me të drejtët shërbëtorët e tu dhe fushoji në avllitë e tua siç është shkruar,<sup>4</sup> duke mos i vënë re, si i mirë, paudhësitë e tyre të bëra me dashje dhe pa dashje, dhe të gjitha ato me dije dhe pa dije, o njeridashës.

Lavdi

**D**he të gjitha ato me dije dhe pa dije, o njeridashës.

Tani *Hyjindësore*

**O** Krisht Perëndi, që nga një Virgjëreshë

linde si diell për botën, pasi të na shfaqësh me anën e saj bij drite,<sup>5</sup> mëshirona.

*Pas Psalmit 50, Kanuni i Mujorit dhe Tetraodet në vendin e tyre. Lexohen dhe Odet VI, VII, VIII dhe IX biblike.*

*Tetraodi, poezi e Josifit, që ka Akrostihidhë: "Ky himn është i Josifit".*

*Ode VI*

*Ting. Tërth. IV*

*Tin dhëisin ekheo*

**S**henjtorët, Zot,\* me tortura tepër mjaft\* Shpëtimtar, u denjësuat të mposhtnin\* mijëra pra\* prej armiqtë të shumtë\* edhe fituan të mirat që bollshëm ke;\* zhduk fajet që kam me shumic\* si i mirë me lutjet e tyre, Krisht.

**L**e t'i himnojm\* athlorët guximtar\* pra të Krishtit, me një zë t'u thërrasim:\* Në shpirta ju\* çdo pasion na shëroni\* se imituar pësimet e Zotit Krisht,\* na jepni forcë për kreshmim\* nga zakoni i keq, mëkatar me faj.

**E**ktheve krejt\* vdekjen, dhimbjen e kësaj,\* në një fjetje, Krisht, kur fjeten në varr ti;\* fale kështu\* te të vdekurit jetë,\* ndaj, Shpëtimtar, denjësoji të ikurit\* të rrinë me të zgjedhurit;\* athlorët të lusin ty shenjtërisht.

*Hyjindësor*

**F**orcomë ti,\* Vajzë, mua të kreshmoj,\* të largohem nga çdo shkelje, se kisha\* në barkun tënd\* të fuqishmin Zot, Fjalën\* e pamëkatshme që pashprehshëm mori trup,\* e tërëpaqortueshme,\* dhe më jep lot për larjen e njollave.

*Tetraodi tjetër, poezi e Theodorit*

*Ting. III*

*Vithòs mi ton pathòn*

**K**remtojmë perëndishëm kujtim, fest\*<sup>6</sup>



martirësh, ejani, sa i doni,\* të ngazëllohemi tok\* dhe t'i kurorëzojmë me rreth,\* himn, duke bekuar Krishtin që jep çmim.

**J**u hoqët fshikullime më parë,\* më vonë u goditët me gurë\* dhe u sharruat,<sup>6</sup> si gjah\* bishash u dhat', si dele në Krisht\* u therët, por, athlofor', rroni gjithnjë.

#### Lavdi *Triadik*

**I** lidh në një natyrë të tre un',\* e pres Njësinë në tre Persona,\* Hyjnia janë ata;\* ndaj nga të barabartat grema,\* Ariosi dhe Saveli, shpëtoj drejt.

#### Tani *Hyjlindësor*

**U** shfaqe dhe pas lindjes e virgjër,\* sërish je e dëlir', tok pra dy ke;\* Hyjnënë je, lindëse,\* pamja e huaj është në ty\* dhe kur e mendojmë, dhe kur e themi.

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

#### *Martirik*

**L**yp Zotin pa pushim, o martirë,\* pra gjaku i durimit që kishit,\* për ne lut; ndaj me fuqi\* lutuni të kreshmojmë tani\* nga veset e poshtërit, çnderimit.

*Varg:* Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mira.

#### *Nekrosim*

**I** Tërëdhembshur, që botën mbarë\* ti ke për ta gjykuar,<sup>7</sup> kur afër\* do të kesh mijëra pra\* engjëj atje,<sup>8</sup> sa fjetën me bes',\* pa faj denjësoji të rrin' bri teje.

#### *Irmosi: Vithós mi ton pathón*

»**U** ngrit fort ndaj meje avusha\* e vesit, »më trazon er' e kundërt,\* por ti arri, »më shpëto,\* o Shpëtimtar, nga prishja; »shpëtom'\* ashtu si nga egërsira profetin.<sup>9</sup>

#### *Kontaqi Ting. Tërth. IV*

**B**ashkë me shenjtoret prehi, o Krisht, shpirtrat e shërbëtorëve të tu, atje ku nuk

ka as dhembje, as helme, as psherëtim,<sup>9a</sup> por vetëm jetë të pambaruar.\*

#### *Sinaksari i ditës*

#### *Ode VII*

#### *Pedhes Evreon en kamino*

**O** të tërëkënduar, me shira gjakrash e shuat flakën e mashtrimit, o athloforë të Zotit; tani, me ndërmjetimet pranë Krishtit, çironani nga zjarri i ardhshëm.

**M**eqenëse i mbyllët gojë të luanëve<sup>10</sup> dhe e duruat zjarrin e torturave, trashëgoni shijimin më të mirë, o athloforë; lutuni që ta arrijmë dhe ne përjetësisht.

**P**ërderisa u ndriçuat rreth e rrotull me tërë dritën e Shpirtit, o athloforë trima, për shpresëplotët që u zhvendosën, kërkoni të kenë prehje, të hyjnë në Parajsë dhe të marrin pjesë në jetë.

#### *Hyjlindësor*

**T**ë ofroj himn ty, o Virgjëreshë, mos më shpërfill mua që mbahem nga të këqijat, por më jep, o e kulluar, korrigjim të përsosur me anë të keshmës dhe të çdo mënyre të mirë sjelljeje.

#### *Tjetri: O tin floga dhrosisis*

**M**eqë, o athloforë, e konsideruat si shijim zjarrin, shpatën dhe bishat, i çuditët vrasësit tuaj kur e përhimnonit Perëndinë e etërve tuaj.

**O** martirë të Krishtit, pasi jua copëtuan çdo gjymtyrë dhe ju dogjën, ju iu ofruat Jisuit si filijim tepër erëmirë;<sup>11</sup> ndërmjetoni pranë tij përgjithmonë për ne.

#### Lavdi *Triadik*

**L**avdëroj një Perëndi në Trini, Atin, Birin dhe Shpirtin, Njësi të thjeshtë, Triadhë të nderuar, autoritet të parapafillim dhe të bashkëqenshëm.

Tani *Hyjlindësor*

**O** Zonjë e tërëshenjtë Hyjlindëse, pasi t'i presësh lutjet e shërbëtorëve të tu, shpjerja Perëndisë së të gjithave, që të na shpëtojë nga çdo ngasje.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

*Martirik*

**O** bashkësi të martirëve, pasi të vini prej qiellit pranë nesh, ata që ju përhimnojnë, bekojini, shenjtërojini që ta mbarojnë me gatishmëri kohën e kreshmëve.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

*Nekrosim*

**Ti** që i kupton veprat e njerëzve<sup>12</sup> dhe i fal shkeljet e vullnetshme dhe të pavullnetshme të atyre që erdhën pranë teje, prehi si Perëndi.

*Irmosi: O tin floga dhrosisas*

»**Ti** që e freskove flakën e kaminës dhe i shpëtove nga djegia Djemtë, je i bekuar në jetë, o Zot, Perëndia i tërëve tanë.<sup>13</sup>

*Ode VIII**Nikitë tiranu*

**O** athlororë, u shfaqët mjekë të sëmurësh, meqë, edhe pse me dobësi trupi, duruat lloj-lloj torturimesh; prandaj thërras: Përmes pendimit në kohën e kreshmës, shërojeni shpirtin tim të sëmurë.

**M**jerë, si kaluan tërë ditët e mia me indiferencë! Dhe ja ku arrin fundi i pafund duke thirrur që të më marrë. O martirë, që e kryet mirë udhën,<sup>1</sup> përgjërohuni që të kem fund të mirë.

**O** athlororë të hyjshëm, me pika gjakrash shuat zjarrin e ateizmit; dhe për të larguarit nga kjo jetë kërkoni me të vërtetë prehjen hyjnore dhe ndjesën e veprave

në përjetësi.

*Hyjlindësor*

**E**zekieli të parapa, o e Dëllirë, si portë të pashkelur,<sup>14</sup> që hap dyer pendimi për gjithë të dëshpëruarit; prandaj të lyp, m'i hap udhët që çojnë në prehjen e atjeshme.

*Tjetri: Ton eks anarhu*

**D**ëfreni, o atletë, që duruat lloj-lloj plagosesh për shumë çmime: disa kur u dogjët, disa kur u sharruat, disa kur ju prenë,<sup>6</sup> dhe ju këndonit për hir të Krishtit: Himnoni, bekonit dhe përmbilartësoni në gjithë jetët.<sup>15</sup>

**P**ërmes gjakrave tuaja shenjtëroni skajet, duke u buruar me pika të vogla të gjithëve rrjedha shërimesh, o martirë të tërëfamshëm; ndaj thërrisni gjithmonë: Himnoni, bekonit dhe përmbilartësoni në gjithë jetët.<sup>15</sup>

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin.

*Triadik*

**N**jësi trihpostate, Atë, Bir dhe Shpirt i gjallë, një Hyjni, një mbretëri, të himnojnë ushtritë e engjëjve ty, dritën e paperënduar; dhe ne mbi tokë himnojmë, bekojmë dhe përmbilartësojmë në gjithë jetët.<sup>15</sup>

Tani *Hyjlindësor*

**Ja** ku tërë ne gjeneratat të lumërojmë, o e pacenuar, duke vëzhguar madhëshitë<sup>16</sup> e tua, sepse ti lind përmbinatyrshëm Bërrësin e të gjithave<sup>17</sup> që është Perëndi<sup>18</sup> dhe njeri; ndaj të bekojmë dhe të përmbilartësojmë në gjithë jetët.<sup>15</sup>

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

*Martirik*

**K**ini dhembshuri, o kori i athlororëve, që të na shpëtoni duke bërë dhe tani përgjërime ndaj Shpëtimtarit që ta adhuroj-



më sinqerisht përmes vetëpërbajtjes. Himnojeni, bekojeni dhe përbilartësojeni në jetë.<sup>15</sup>

*Varg:* Shpirtat e tyre do të rrinë në të mira. Ata që fjetën besërisht me shpresën e ngjalljes, denjësoji, o Zot, të ngrihen për jetën e amshuar që të të himnojnë sinqerisht dhe të lavdërojnë psalmikisht.<sup>19</sup> Himnoni, bekonit dhe përbilartësoni në gjithë jetët.<sup>15</sup>

*Irmosi: Ton eks anarhu*

»Perëndinë që lindi para jetëve prej Atit  
»pa fillim dhe në fund prej Hyllindëses pasi  
»veshi mish, si njeri të përsosur dhe Perëndi  
»prej Perëndisë, himnojeni, bekojeni dhe  
»përbilartësojeni në gjithë jetët.<sup>15</sup>

*Ode IX*

*Orus parilthes tis fiseos*

U dukët si qymyre të hyjshme që dogjët bashkë lëndë djallëzore ateizmi dhe pretë me shpatë hordhitë e demonëve, o athloforë trima dhe dritësjellës të zemrave tona.

Tejkaluat terr torturash dhe u shpërngulët në ndriçim mendor, athloforë trima, prandaj shkëlqejeni shpirtin tim të varfër, të errësuar nga paudhësitë.

Vuanin duke ofruar dhimbjet e trupit athloforët e tërëlavdishëm, dhe tani kërkojnë për shpresëplotët e shpërngulur prehen pa dhimbje dhe shijimin e Parajsës.

*Hyllindësor*

Shfaqu, o Zonjë e pacenuar, bashkëpunëtoresh hyjnore me shërbyesit e tu të pavlefshëm<sup>20</sup> në kohën e vetëpërbajtjes, duke ia shpënë lutjet tona Zotit që mbretëron mbi jetët.<sup>21</sup>

*Tjetri: Se tin athánton*

O athloforë të Krishtit, kur u futët prej Perëndisë si zjarr në tokë,<sup>22</sup> shkrumbuat çdo mashtrim të idhujve, pasi ndezët në cepat e planetit pishtarë shpresëtarie.

O atletë, ju nuk ju ndanë dot nga dashuria e Krishtit as flakët, as therjet,<sup>23</sup> as rrotat, as veglat e shtrembërimit ose të shtypjes, as sharrimet, as ndonjë tjetër torturë e hidhur.

*Lavdi Triadik*

E përhimnoj besërisht Hyjninë si një dhe tre, duke e bashkuar në Persona pamjen, por dhe duke e ndarë: Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë janë Një.

*Tani Hyllindësor*

O e Pacenuar, e Dëlirë, ty, purtekën që mbive nga rrënja e Jeseut dhe e paraatit David,<sup>24</sup> të madhërojmë sepse i shpëton shpirtat tanë.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

*Martirik*

O shumica e respektuar e martirëve, përgjëroju Krishtit, me qëllim që ne, duke përbushur me paqe udhën e kreshmëve, t'i vëzhgojmë dhe t'u falemë pësimeve të tij.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

*Nekrosim*

Si Perëndi i të vdekurve dhe i të gjallëve, që e vrave vdekjen dhe me ngjalljen tënde u dhe të gjithëve jetë, prehi edhe shërbëtorët e tu që i shpërngule.

*Irmosi: Se tin athánton*

»O e Dëlirë, ty, burimin e pavdekshëm që i jep shërime përmes shenjtëve gjinise së njerëzve, të madhështojmë, sepse »i shpëton shpirtat tanë.

*Pastaj Fotagojiku i Tingullit të javës (2x),*

duke plotësuar mbarimin e tij kështu: Në të parën: Me ndërmjetimet e shenjtoreve të tu, o Zot. Në të dytën: Me ndërmjetimet e Perëndilindëses, o Zot. *Dhe Dërgimësore Nekrosime:*

*O uranôn tis astris*

Ti që si Zot sundon krejt\* përmbi sa vdiqën dhe sa rojtn\*,<sup>25</sup> prehi shërbëtorët e tu,\* o Shpëtimtar, në tenda lart\* tok me të zgjedhurit; sado\* fajtuan, s'ikën prej teje.

*Hyjllindësore*

*Ton mathiôn oronton se*

»Hyjllindëse, krenohemi fort në ty ne\* dhe »pranë Perëndisë të kemi mbrojtje;\* shtrije dorën tënde që s'luftohet dot,\* dërrmoji pra armiqtë krejt;\* nga Shenjtërorja »dërgoju\* ndihmë shërbyesve të tu.\*<sup>26</sup>

*Lavdërimet, Martiriket e Tingullit të javës. Lavdi, Nekrosim në vazhdim. Tani Hyjllindësore (kërkoji në fund të librit). Ty të ka hije lavdi. Dhe Dhoksologjia e Vogël (fq. 62). Pasvargjet e zotit Theofan (të Tingullit të javës gjithashtu). Është mirë ta lavdërojmë Zotin, Trishenjti, 3 Përlëshoret, (ato të fillimit të Mëngjesores).*

*Në Liturgji, Antifonet e zakonshme. Pas Hyrjes, dy Përlëshoret e para dhe e kishës. Kontakti (Nëse do të bëhet dhe Trisaji). Bashkë me shenjtoret. Dhe) Ting. Tërth. IV sipas Os aparhás tis fiseos: Je mbjellës i Krijesës, Zot, ndaj bota të ofron si fli,\* aparkë pra, prej natyrës, martirët shenjt\* hyjmbajtës; përmes lutjeve,\* përgjërimit të tyre ruaje, i mëshirshëm, në paqe shumë të thellë Kishën tënde me ndërmjetimet krejt të Hyjllindëses.*

*Kungatore: Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot. Aliluia. Nëse ka dhe grurë për të fjeturit, pas Uratës prapa Amvonit, si zakonisht, psalen 4 troparet Bashkë me shpirtrat etj. dhe kujtohen nga prifti emrat e të fjeturve.*

*Menjëherë Emri i Zotit etj.*

*Shënim: Ky tip ndiqet edhe të Shtunën III dhe IV të Kreshmëve (nëse nuk bie kremtimi i Dyzet Martirëve ose i Ungjillëzimit), por natyrisht me ndërrimin e Ndenjësoreve, Fotagojikëve, Martirikeve dhe Nekrosimeve, sipas Tingullit të javës.*

*CITIME*

1. II Tim. 4.7
2. Joan 8.46
3. Joan 1.4.9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
4. Ps. 64(65).5
5. Lluk. 16.8; Ef. 5.8; I Thes. 5.5
6. Hebr. 11.37
7. II Tim. 4.1; I Petr. 4.5
8. Dan. 7.10
9. Jona 1.4; 2.7-11
- 9a. Is. 35.10
10. Dan. 6.18; Hebr. 11.34
11. Lev. 1.9 etj.
12. Ps. 32(33).15
13. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-28
14. Jez. 44.1-4
15. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34 etj.
16. Lluk. 1.48-49
17. Joan. 1.3
18. Joan. 1.1
19. Ps. 85(86).9
20. Lluk. 17.10
21. Apok. 11.15
22. Lluk. 12.49
23. Rom. 8.35
24. Is. 11.1; Rom. 15.12
25. I Petr. 4.5
26. Ps. 19(20).3



E DIELA E DYTË  
E ATIT TONË NDËR SHENJTORË GRIGOR  
PALLAMAI, KRYEPISKOP I SELANIKUT  
NË MBRËMËSORE

*Këtë shërbesë e shkroi patriark Filothen në v. 1368, kur kremtimi i shenjtorit u caktua për sot. Por Kanunin e shkroi Gjergji, siç duket në Akrostihidhën e Hyjllindësoreve të tij.*

*Thirrto*



6 ngjallësore dhe 3 të Triodit (në 4):

*Ting. II Piiis efimion ásmasin*

**M**e ç'psalm\* dhe këngë lavdie pra\* hierarkun ne ta përhimnojmë?\* Është si bori për thelogji\* dhe shtyll' që s'tundet për Kishën krejt;\*<sup>1</sup> Hiri e ka si goj' që fryn zjarrin;\* është gaz\* mjaft i madh për rruzullin, për kozmosin,\* dhe lum'\* mjaft urti dhe llambë me ndriçim, shkëlqim,\* enë plot nder që ka Shpirti,\* është yll ndriçues\* që Krijesën mbarë e feks;\*<sup>2</sup> atij Perëndia Krisht\* i dha çmim në mbretërinë lart.

(2x)

**M**e ç'psalm\* dhe lule melodie\* hierarkun ta kurorëzojmë,\* mbrojtësin e besës së saktë fort\* dhe kundërshtarin e mosbesimit,\* luftëtarin e Orthodhoksisë?\* I madh\* dhe i zellshëm ishte në udhëheqje,\* edhe\* ish mësues, lirë harmonike krejt\* në Shpirt dhe gjuhë e artë,\* dhe burim që nxirte\* për besnikët rrjedh' shërimesh;\* ky është Grigori shenjt,\* i madh dhe i admirueshëm.

**N**jerëz\* prej dheu, ne, me ç'buzzë\* hierarkun ta mburrim? Ky është\* bukuri e madhe në murgjëri\* si dhe hyjmisti i Shën Trinisë;\* predikonte mritën e Hyjnisë\* edhe\* ishte dhe mësues për Kishën tonë;\* shkëlqen\* ky dhe në praktikë, dhe në teori;\* lavd, nder e ka Selaniku,\* bashkëqytetar ka\* mirovlitin, martir i madh\* në qiell Dhimitër, shenjt\* i hyjshëm, i admirueshëm.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

**O** oshënar tri herë i lumur, atë tepër i shenjtë, bari i mirë<sup>3</sup> dhe nxënës i kryebariut Krisht,<sup>3a</sup> që vure shpirtin për dhen-të,<sup>3</sup> ti dhe tani, o ati ynë hyjmbajtës Grigor, kërko me ndërmjetimet e tua që të na dhurohet përdëllimi i madh.<sup>4</sup>

Tani *Hyjlindësore*

*Dogmatike e Tingullit të javës*

*Pasvargje ngjallësore*

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

**G**juha jote e shpejtë për mësimdhënie, duke jehuar në veshët e zemrave, i ngre shpirtat e dembelëve dhe përmes fjalëve të tua të hyjthëna ngjan si një shkallë që çon lart te Perëndia<sup>5</sup> ata që janë tokësorë; ndaj, o Grigor, çudia e Thesalisë, mos pu-sho së ndërmjetuari pranë Krishtit që të shkëlqejnë me ditë hyjnore ata që të nderojnë.

Tani *Hyjlindësore*

**V**irgjeresh' e panusëruar që zure trupërisht Perëndinë pa tregim, nën' e Perëndisë së lartë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu, o e gjithëpanjollëshme, ti që u fal të gjithëve paqësim mëkatesh, prit lutjet tona tani dhe lutu që të shpëtohen shpirtat tanë.\*

*Përlëshore ngjallësore dhe e shenjtii:*

*Ting. Tërth. IV*

**O** Grigor çudibërës, ndriçues i Orthodhoksisë, mbështetje dhe mësues i Kishës, bukuri e murgjve, mbrojtës i pamposhtur i thelogëve, krenari e Selanikut, predikues i Hirit, përgjërohu përherë që të shpëtojnë shpirtat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

**T**i që linde për ne prej Virgjereshës dhe durove kryqëzim, o i mirë, që plaçkove vdekjen me vdekje dhe rrefeve ngjalljen si Perëndi, mos i zhvështro ata që gatove me dorën tënde; trego njeridashjen tënde, o mëshirëplotë, prit Hyjlindësen që të lindi, të ndërmjetojë për ne dhe shpëto, o Shpëtimtari ynë, një popull të dëshpëruar.\*



## NË MËNGJESORE

*Shërbesa e zakonshme. Kanonet: Ngjallësori në 4, Kryqngjallësori në 2, i Hyllindësës në 2 dhe i shenjtii në 6:*

*Ting. IV*

*Ode I*

*Aniko to stoma mu*

Hyjfolëset gojë, oratorët e perëndishëm tok\* eporët e thelogëve si një bashkësi,\* e jani, të gjith\* të mbledhur, ta himnoni\* Grigorin hyjnor, orator Shpirti denjësisht.

Grigori i madh dhe mbrojtësi i Kishës, e forta shtyll\* e besës, bariu i shkëlqyer në Selanik,\* që për bashkësin\* e kryepiftërinjve\* vërtet ish stoli, të lëvdohet për gazin tim.

Që foshnjë e doje jetën më të mirë dhe prite, at',\* me mall të përsosurin mendim ti që mjaft i ri,\* u tregove pra\* në mendje, në mënyrë,\* njësoj me adashin, Grigorin hyjnor të shenjt'.

*Hyjllindësor*

Mu bëj, Zonjë, udhë jete<sup>6</sup> dhe drejtomë në tendat lart\* hyjnore, se humba;<sup>7</sup> në gremina unë rrëshqas,\* në të keqen thell',\* me ndërmjetimin tënd pra,\* o e paqortueshme krejt, nxirrme dhe shpëtom'.

*Zbritësore: Aniko to stoma mu (fq. 114)*

**J**a gojën e çel tani

*Ode III*

*Tus sus innologus*

Kur rrjedhjen e mësimdhënies sate të shenjtë e ruajmë, Grigor,\* ne evitojmë çdo dredhi dhe djallëzi të herezis'\* me sa hyjnisht ke shkruar, zmbropsim çdo kolonë të tyre fort.

E zhbëre ti herezin', urtin' boshe, kishë në zemër, o i lum,\* enipostaten urtësi të Perëndisë,<sup>8</sup> përmes saj\* plot zhurm' dërr-

move<sup>9</sup> çdo tërbim të kalbur të keqbesimit pra.

Si çdo neps të mishit që krejt priset e vrave<sup>10</sup> me asketizëm ti,\* ndaj dhe jet' te lëvizjet brenda shpirtit tënd, edhe kështu\* e shfaqë instrument hyjnor thelogjije, i urti shenjt.

*Hyjllindësor*

Kam dashur me zell një jet' të shturur, me dije, mendim, ndërgjegjësisht,\* veçse pra lidhmë ti në dashurin' e Birit tënd mua,\* me ndërmjetimin tënd të hyjshëm, o Hyjnuse, e virgjër nur.

*Zbritësore: Tus sus innologus (fq. 115)*

**O** Zonjë dhe nën' e Perëndisë

*Ndenjësore*

*Ting. IV Tahi prokatálave*

E bëre shkruamb hilen e besëkëqjive, i urt',\* e shpalle fuqishëm, mirë, ti besimin e orthodhoksëve, dhe kështu\* botën e shndrite shumë,\* shtyll' u shfaqë për Kishën\*<sup>11</sup> dhe fitimtar triumfi, hierark i vërtetë;\* lyp Krishtin gjithnjë të na shpëtojë të tërë ne.

Lavdi

*E njëjta*

Tani *Hyjllindësore*

O Zonjë pa cen, prano shpejt lutjet që të ofrojm',\* blatoji këto te Perëndia, Biri yt, o e fortpaqortueshme;\* zhduk fjalë të këqija,\* çdo dredh', peripeci tok,\* mposhti dhe ateistët, arrogancën e tyre,\* se po armatosen ndaj shërbyesve të tu pra.

*Ode IV*

*Tin aneksihniaston*

Sapo e çele gojën tënde, o atë i urtë, e shpalle urtësinë e Perëndisë,<sup>11</sup> të cilën e studioje në zemrën tënde përherë; dhe Varlaamin kokëbosh e tregove si të pamend dhe pranojak.



O diell tepër i ëmbël, mbi dhë perëndove sipas ligjit të natyrës, por do të lindësh ti në mëngjes bashkë me Krishtin, si dielli i paperëndueshëm, duke na parë të gjithë me anën e ndërmjetimeve të tua.

O i lum i Perëndisë, Hiri të tregoi mburrje dhe mbështetje tepër të madhe të orthodhoksëve, bari të mirë, theolog të dytë dhe rojë të pafjetur të grigjës.<sup>3</sup>

#### *Hyjlindësor*

O nënë e Perëndisë, që linde atë që përpara i hapi veshët e të shurdhrit,<sup>12</sup> hapmi veshët e shpirtit dhe denjësomë t'i dëgjoj fjalët hyjnore e t'i përmbush.

*Zbritësore: Tin aneksihniaston (fq. 380)*

Të pagjurmësuarin plan

#### *Ode V*

#### *Eksesti ta simpanta*

Me draprin e fjalëve të tua dhe me shkriimet e hyjnueshme preve herezi gjembashe dhe filiza bastardë barërash të egra, dhe mbolle farat e besës së mirë të Orthodhoksisë, o hierark Grigor.

Fjalët e tua dhe shkrimet e nderuara, o i tërurtë, janë për ata që i lexojnë vesë qiellore,<sup>13</sup> mjaltë guri,<sup>14</sup> bukë engjëjsh,<sup>15</sup> nektar, ëmbëlsi, kënaqësi dhe burim ujë të gjallë,<sup>16</sup> o Grigor.

Dheu dhe deti të njohin si mësues të përbashkët, përmendore të hyjshme Orthodhoksie, depo të respektuar armësh për dogma hyjnore, theolog të urtë, të shenjtë, pjesëtar apostujsh, me sjellje të ngjashme dhe në një tendë me ta.

#### *Hyjlindësor*

O Virgjëreshë e pacenuar, me rrëke kataniksi shpërlaji njollat e zemrës sime dhe më dhuro sjellje pendimi me lutjet e tua të

hyjshme ndaj Perëndisë së dhembshur, të cilin e linde parrëfyeshëm.

*Zbritësore: Eksesti ta simpanta (fq. 117)*

Të gjith' i habite ti.

#### *Ode VI*

#### *Tin thian taftin*

U ça tërbimi i kotë si dhe gjuha e të marrit, pra Varlaam, nëpërmjet dogmave\* dhe zgjuarsisë së fjalëve\* të mbretit mjaft të urt' dhe të tuave, Grigor.

Me himn ta mburrim borinë që fuqishëm shpalli dogmat, misteret e Hyjnisë, është gjuh'\* theologjje, kitarë, lir'\* hyjnore e Shën Shpirtit, në Selanik kokë.

I paraprije si shtyllë zjarri popullit,<sup>17</sup> i dogje armiqtë e besimit ti dikur,\* por tërësit' e besnikëve\* i shndrite, o hyjmenndës dhe atë, shën Grigor.

#### *Hyjlindësor*

M'u bëj liman ngushëllimi, qetësi dhe më kalo tek i hyjshmi gji pa dallgë, turbullim,\* Zonjë e tërëdëlirë ti,\* si dhe ma zbut shtrengatën e veseve që kam.

*Zbritësore: Tin thian taftin (fq. 117)*

Këtë të kremte e lusim sot.

#### *Kontaqi*

#### *Ting. Tërth IV Ti ipermaho*

Ne instrumentin\* e nderuar, të hyjnueshëm\* të urtësisë\* dhe trumbetën e shkëlqyeshme\* theologe, pra hyfolësin ta himnojm' tok;\* bri së parës mendje, Zotit, rri si mendje ti,\* na drejto mendimin tek ai, atë Grigor,\* të thërrasim ty:\* G'zohu, shpallësi i Shenjtit Hir.

#### *Shtëpia*

U shfaqe engjëll mbi dhë, duke iu lajmëruar fort hyjoret vdekatarëve, sepse, duke përdorur zërat e të patrupëve përmes

mendjes dhe mishit njerëzor, na shtange dhe na binde që të të thërrasim, o hyfolës, këto:

Gëzohu, ti me anën e të cilit u dëbua terri; gëzohu, ti me anën e të cilit hyri si kundërshtim drita.

Gëzohu, o engjëll i Hyjnisë së pakrijuar; gëzohu, o kritikë vërtet e së krijuarës dhe e kotësisë.

Gëzohu, ti që e shpalle natyrën e Perëndisë si lartësi që nuk shkelet; gëzohu, ti që the për energjinë se është thellësi që vështirë shikohet.

Gëzohu, sepse e the mirë lavdinë e Perëndisë; gëzohu, sepse i hoqe besimet e kriminelëve.

Gëzohu, o ndriçues që tregove Diellin; gëzohu, o kanë, dhënës i nektarit.

Gëzohu, ti përmes të cilit shkëlqeu e vërteta; gëzohu, ti përmes të cilit u errësua gënjeshtria.

G'zohu, shpallës i Shenjtir Hit.

#### *Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:*

Në të njëjtën ditë, të Dielën e Dytë të Kreshmëve, kujtojmë atin tonë ndër shenjtorë Grigor Pallamanë, kryepiskop i Selanikut.

*Vargje:* Burim drite e çon tani drejt shkëlqimit të paperënduar/ predikuesin e shkëlqyer vërtet e të madh të dritës.

Me ndërmjetimet e tij, o Perëndi, mëshiro-na dhe shpëtona. Amin.

#### *Ode VII*

##### *Uk elátrefsan*

**A**ta që kanë kontakt me fjalët dhe shkrimet e tua, o Grigor, bëhen miste të njohurisë së Perëndisë, shfaqen të mbushur me urtësi shpirtërore<sup>18</sup> dhe theologojnë Hirin dhe energjinë e pakrijuar të Zotit.

**D**ërrmove krejtësisht shpatën, shigjetat e besëkëqjive<sup>19</sup> si dhe vetullën e Varla-

amit, ndërsa si gur kolosal, o hierark, e shpërndave tërë fuqinë e heretikëve porsirjetë merimange.

**O** Grigor, besimi i shpresëplotëve u vulos me anën e fjalëve, dogmave dhe shkrimeve të tua; u ndal arroganca e herezisë dhe u hoq pezullimi i Orthodhoksisë si dhe fuqia e besëkëqjive.

#### *Hyjindësor*

**N**e që po tretemi nga sëmundjet e pasioneve, meqë njohim vërtet se je burim shërimesh, nxjerrim rrjedha shpëtimtare dhe të hyjshme, dhe thërrasim: I bekuar është, o e Tërëdëlirë, fryti i barkut tënd.

#### *Zbritësore: Uk elátrefsan (fj. 118)*

**N**uk u faleshin

#### *Ode VIII*

##### *Pedhas evajis*

**T**i qëndron tani pranë fronit të të tërëdhembshurit<sup>20</sup> së bashku me theologët si i ngjashëm me ta dhe me të njëjtën sjejlje, o Grigor i tërurtë, kryetar i Selanikut, bukuri e hierarkëve, i lavdëruar shkëlqyeshëm me lavdinë e hierarkisë dhe e adhuron Perëndinë.

**P**erëndia, duke e njohur që para se të ishte në bark, para zënies, pastërtinë e mendjes sate, i foli fuqishëm mbretit shpresëtar dhe të hyjshëm se ishte luftëtar i pamposhtur i Kishës; prandaj me siguri ligjore u vulose me miron e kryepiftërisë.

**H**umb fuqishëm dhe rrezikon grumbulli i Polikindhinit, o Grigor i lavdëruar, kryetar i Selanikut, me anë të mendjemprehtësisë dhe fjalëve të tua të urta dhe, si zhduket tymi, u zhduk<sup>21</sup> banda e kalbur nëpërmjet gjuhës sate theologe me oshtimë bubullime.



*Hyjlindësore*

**O** Virgjëreshë, Fjala e Perëndisë riformoi brenda teje nga mirësia e tejskajshme natyrën e goposur të të vdekshmëve për shkak të pasioneve, e rinovoi dhe e shenjtëroi të tërën; ndaj ne që shpëtuam me anën tënde, të lavdërojmë në gjithë jetët.

*Zbritësore: Pedhas evajis (fq. 119)*

Djemat e dënuar për t'u djegur

*Ode IX**Apas jijenis*

**O** Grigor, pasqyrë Zoti u bëre, se pa njollë ruajte\* drejt "sipas ikonës" ti\*<sup>22</sup> dhe burrërisht e vure si kundërshtar\* përballë vesesh trupi sundimtare mendje,<sup>23</sup> ndaj\* more "sipas\* ngjashmërisë" dhe banes\*<sup>24</sup> e shkëlqyer u bëre për Shën Trinin'.

**M**breti shpresëplotë shfaqsi se fluturoje lart me krah', se qe\* aleat me të, meqë\* i tëri ishe mbushur me Shenjtin Shpirt;\* qe aleati ndaj të marrit, Varlaamit bosh,\* që mjaft fliste\* kundër Zotit<sup>24</sup> pa të drejt',\* në lartim<sup>25</sup> pra, ti ligjshëm e munde fort.

**Si** i tëri me urtin' më të fortë ishe mbushur, fekse nur\* nëpër botë dritësim,\* meqë ti nxore dogma orthodhoksisht;\* me dashurinë e filozofisë më të mir'\* në bark zure\* frikën e hyjnueshme,\* linde fjalët e Shpirtit,<sup>26</sup> o lavdimadh.

*Hyjlindësore*

**O** Hyjnënë, të ofrojmë me një zë himn falënderimi ty;\* nëmën ton' të lashtë krejt\*<sup>27</sup> e zgjidhe; nëpërmjet teje gjithë ne\* fitojmë të hyjnueshmin shpëtim, ndrëçimin tok\* me mëshirën,\* të përjetshmin ngazëllim\* dhe bekim, ndaj besnikët të nderin mjaft.

*Pas Zbritësoreve, i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor dhe Idhiomelet Hapmi dyert;*

Drejtomë në rrugët; Unë i mjeri (fq. 10).

Më të nderuarën. *Dhe Zbritësorja:*

*Apas jijenis (fq. 120)*

**G**jithë njerëzit

*Dërgimësore ngjallësore dhe të Triodit:*

*Tis mathitës sinëlhomen*

**G**az kî, shtëpia e urtis\*<sup>28</sup> dhe kulmi i mësuesve,\* goja e theologëve,\* tenda e qetësisë;\* të kanë Etërit mburrje,\* o det i fjalës; kî gaz,\* o lartësi në teori,\* instrumenti i veprës, praktikës pra;\* tempulli i Shpirtit,<sup>29</sup> kî gaz; shëroje\* sëmundje njerëzore ti\* kur rroje dhe pas vdekjes.

*Hyjlindësore*

**N**ëpër rreziqe ti mbërrî,\* o tërëmbretëreshë;\* në pikëllime ti mbërrî,\* pran' qëndro, kur të kemi\* nevojt' në ditën e fundme,\* të mos na marrë djalli,\* satani, Ferri, humbja krejt,\* por pa faj të qëndrojmë, hyjnënë, ne\* para podiumit të frikshëm shumë\* të Birit tënd, ti ndërmyeto,\* o e dëlira Jonjë.

*Lavdërime: 5 ngjallësore dhe 3 të shenjtit:*

*Ting. I*

*Ton uranion tagmaton*

**P**ërshkove jetën e lumtur në botë dhe tani\* dëfren me bashkësitë\* e të lumturve, atë;\* si i but' banon, Grigor hierark,\* në krahinë të butësh<sup>30</sup> lart,\* nga Zoti je pasuruar me hir çudish,\* te sa të nderojnë, jepen ti.

*Varg:* Goja e të drejtit do të studiojë urtësi.

**T**humb heretik shkule, mbolle dogmat orthodhoksisht,\* shumëfishove farën\* e besimit fort mirë;\* solle pra te Perëndia kallinj\* njëqind herë më tepër<sup>31</sup> ti\* nëpërmjet shiut të fjalëve krejt që the\* si bujk me eksperiencë plot.

*Varg:* Priftërinjtë e tu, o Zot, do të vishen me drejtësi.

I lum, shkëlqimi i jetës që bëre pa qortim\* çuditi bashkësitë\* engjëllore në qiell\* si dhe njerëzore mbi dhé, meqë\* me vullnet u tregove ti\* atlet i fortë, asket, hierark i denj\*, mik i çiltër,<sup>32</sup> shërbëtor Zoti.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Tek ata që ecnin në errësirë mëkatesh, linde si dritë, o Krisht, në kohën e vetëpërmabajtjes; na trego edhe ditën e shënuar të pësimiit tënd, që të të thërrasim: Ngrihu, o Perëndi,<sup>33</sup> mëshirora.

Tani  
E përmbibekuar

*Dhokologjia e Madhe.*

*Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të shenjtit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi Përlufteshës. Kungatore Lavdërojani [dhe Në kujtim të përjetshëm].*



NË TË NJËJTËN TË DIEL  
NË MBRËMËSOREN KATANIKTIKE

*Pas Psalmi Nistor (dhe pa Psaltri si çdo të diel) dhe Paqësoreve, Thirrtoret 10: 4 Kataniktike të Tingullit të javës, 3 të Triodit (të mëposhtme) dhe 3 të Mujorit.*

*Të Triodit, poezi e zotit Josif*

*Ting. Tërth IV Amëtritos iparhi*

Meqenëse fajtova ndaj teje pafundësisht, pres ndëshkime të panumërta, kërcëllim dhëmbësh, qarje<sup>34</sup> pa ngushëllim, Gjehe në zjarri,<sup>35</sup> errësirë<sup>34</sup> dhe angërr; prandaj, o Gjykatës tepër i drejtë,<sup>36</sup> më dhuro lot, me anën e të cilëve të gjej faljen dhe zgjidhjen e të këqijave të mia duke kreshmuar dhe duke thirrur: O Zoti Krisht, dhembshurorë nga përdëllimi i madh<sup>4</sup>

dhe i pasur.

O Fjalë, më kërko mua që humba mbi male<sup>7</sup> shkeljesh të frikshme dhe më rithirr drejt teje, duke zmbarsur për hirin tim larg mendjes sime zakone djallëzore; mua që vdiqa, ringjallmë; dhe pastromë me kreshmim mua që me qarje të vazhdueshme thërras dhe them: O Zoti Krisht, dhembshurorë nga përdëllimi i madh<sup>4</sup> dhe i pasur.

*Tjetër; i zotit Theodor*

*Injëti Tin ëndhokson*

Pasi e filluam javën e tretë të kreshmës, ne besimtarët le ta mburrim Triadhën e respektuar, duke e përshkuar me gëzim atë që vijon; dhe pasi t'i vyshkim pasionet e mishit në shpirtrat tanë, le të korrim lule të hyjshme që të thurim kurora për ditën më kryesore, që ta përhimnojmë të kurorëzuar që të gjithë Krishtin si fitimtar.

*Dhe 3 të Mujorit.*

Lavdi dhe Tani e tij (Hyjlindësore)

*Hyrje me temjanicë. O dritë gazmore dhe Proqimëni i Madh.*

*Ting. Tërth. IV*

Mos e kthe mënjane fytyrën nga shërbëtori yt, sepse trishtoem; dëgjomë shpejt, vëri re shpirtit tim dhe çliroje.

*Varg:* Shpëtimi yt, o Perëndi, më përkrahtë. Mos e kthe mënjane...

*Varg:* Le të shohin të varfër dhe le të dëfrenjë. Mos e kthe mënjane...

*Lutja e gjatë (Ektenis):* Le të themi, të gjithë... Bëna të denjë, o Zot... Le ta plotësojmë lutjen...

*Pasvargje*

*Ting. IV Idhiomeli*

Frerët atërorë, pasi i hodha poshtë me mendje të paqëndrueshme, bashkëjeto-va me mendime kafshore të mëkatit, pasi



shpenzova tërë pasurinë time në mënyrë të shtthurur unë i mjeri; dhe, përderisa më mungonte ushqimi që forconte zemrën, shijoja kënaqësi që më undyoste përko-hësisht; por, o atë i mirë, mos ma mbyll dhembshurinë njeridashëse, por, pasi të ma hapësh, pranomë si Birin Plangprishës dhe shpëtomë.<sup>37</sup>

**Varg:** Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

### Injëjti

**Varg:** Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

### Martirik

O martirë të Zotit, shenjtëroni çdo vend dhe shëroni çdo sëmundje; dhe tani ndër-mjetoni që të çlirohen shpirtat tanë nga kurthet e armikut, lutemi.

### Lavdi dhe Tani Hyjlindësor

Qielloret të himnojnë, o nënë e panusëruar hirplote, dhe ne e lavdërojmë lindjen tënde të pagjurmësuar; o Perëndilindëse, ndër-mjeto që të shpëtojnë shpirtat tanë.

*Dhe shërbesa që mbetet sikundër të Dielën e të Lidhurit të Djathitit (fq. 57).*

### CITIME

1. Gal. 2.9
2. Fil. 2.15
3. Joan 10.11
- 3a. I Petr. 5.4
4. Num. 14.19 etj.
5. Gjen. 28.12-17
6. Ps. 15(16).11; Vep. 2.28
7. Matth. 18.12
8. I Kor. 1.24

9. Ps. 9.7
10. Gal. 5.24; Kol. 3.5
11. II Kor. 3.7
12. Matth. 9.32; 12.22; Mark 7.32; 9.25-26
13. Gijyk. 5.4; Zah. 8.12
14. Ligji i Dytë 32.13; Ps.80(81).17
15. Ps. 77(78).25
16. Jer. 2.13
17. Eks. 13.21; Num. 14.14; Ne. 9.12,19; Urt. Sol. 18.3
18. Kol. 1.9
19. Ps. 75(76).4
20. III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
21. Ps. 67(68).3
22. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
23. Ps. 50(51).14
24. Ps. 74(75).6
25. Ps. 72(73).8
26. Is. 26.18
27. Gjen. 3.16-19
28. Fja. Urt. 9.1
29. I Kor. 3.16; 6.19; II Kor. 6.16
30. Matth. 5.5
31. Matth. 13.8,23; Mark 4.8; Lluk. 8.8
32. Lluk. 12.4; Joan 15.14-15
33. Ps. 73(74).22; 81(82).8
34. Matth. 8.12; 13.42,50; 22.13; 24.51; 25.30; Lluk. 13.28
35. Matth. 5.22, 29-30; 18.9; Mark 9.43-48; Lluk. 12.5
36. Ps. 7.12; II Tim. 4.8
37. Lluk. 15.11-21



## TË MËRKURËN E JAVËS SË TRETË NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve, Aliluait dhe Triadiket e Tingullit të javës, dhe pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores Kryqësore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores, poezi e zotit Josif*

### Ting. III Tin oreótita

Me një dru shove ti,\* Zot, flakë shkelje-je\*<sup>1</sup> kur ishe lart në Kryq\* dhe, kur vullnetarisht\* u vrave,<sup>2</sup> vrave, Krisht, armikun, ndaj ty të përgjërohëm:\* Vritma çdo dëshir\* që ka\* mishi im<sup>3</sup> dhe ma gjallë-ro\* zemrën time mjaft të mjer\*,\* si me kreshm' që pasione vret,\* nga çdo pisllek, zhul të më pastrosht krejt,\* o Shpëtimtar,

porsi i dhembshur.

Lavdi *dhe* Tani *Kryqhyjlindësore*  
**D**urove vdekjen keq,\* plot turp, i dhembshur fort,\* vullnetarisht në dru\*<sup>2</sup> kur kryqëzohesh,\*<sup>4</sup> të cilën kur e shihte nëna jote, o Krisht, plagosej\* dhe vajtonte brenda saj\* porsi nënë dhe qante mjaft;\* ndaj nga dhembshuria pra\* përmes lutjeve të kësaj\* shpëto me përdëllimin tënd botën\* ti që e ngre mëkatin e saj.<sup>5</sup>

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësores, poezi e Theodorit*

*Ting. II Anastás ek tu mnimatos*

**D**uke përshkruar dëfrimin e gëzueshëm të kreshmëve, thërراسim: O Zot, ruana të gjithë në paqe pasi të na çlirohsh prej çdo dredhie të armikut dhe denjësona si i përmbimire ta puthim me frikë Kryqin tënd të respektuar, ti që përmes tij i jep kozmosit përdëllimet e tua, o i vetmi i shumëmëshirshëm.

Lavdi *dhe* Tani *Kryqhyjlindësore*  
*Efsplahnias ipárhusa piji*

**K**ur të pa të tendosur mbi një dru\* dhe të vdekur, e Virgjra nëna jote po qante,\* o Krisht, hidhur, thoshte: Ç'është ky mister\* plot tmerr, Biri im? Si përmbi Kryq po vdes\* me vdekje të turpshme<sup>4</sup> krejt\* me dashje<sup>2</sup> ti që dhuron\* jetë të përgjeshme nur\* te të gjithë<sup>3</sup> pranë teje në amshim?

*Psalmi 50. Prifti thotë uratën e zakonshme: O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën, dhembshurinë dhe... Kanuni i Mujorit dhe Triodet në vendin e tyre. Lexohet dhe Ode III biblike.*

*Triodi, poezi e zotit Josif*

*Ode III*

*Ting. III*

*To sterëoma ton epi si*

**L**e të vrasim çdo\* gjymtyr' të mishit<sup>6</sup> me kreshmë\* e lutje njësh,\*<sup>7</sup> duke qen' të kryqëzuar\* me atë që\* për ne u kryqëzua<sup>8</sup> keq.

**Z**ot, me kryqëzim\* e hoqe gjëmbin e fajit,\*<sup>9</sup> ndaj ti ma hiq\* çdo mendim me gjëmbat që ka\* mendja ime,\* Shpëtimtari im Perëndi.

**M**endjet tona ne\* t'i armatosim me kreshmë,\* të zmbropsim fort\* shthurje, çdo hordhi demonësh\* si prej Kryqit\* të rrethohemi me fuqi.

*Hyjlindësore*

**F**jala mori trup,\* o e pacen, edhe doli\* prej teje pra,\* se nga dhembshuria<sup>10</sup> ndreqte\* rënien poshtë\* të stëretërve shkelës keq.<sup>1</sup>

*Triodi i jetët, poezi e zotit Theodor*

*Ting. II*

*Sterëoson imás en si*

**P**ra, është vul' shpëtimi, Zot, Kryqi yt\* se është' jetëbërës dhe, duke zhdukur\* me të unë kundërshtarin djall,\* të përhimnoj si të fortin krejt Perëndi.

**N**ë botë solli jet' të përgjeshme krejt\* pra fryti i drurit të Kryqit, o Krisht,\* dhe çlirohemi nga vdekja ne\* kur e shijojmë me frikë dhe me hare.

Lavdi *Triadik*

**I**mburr të tre Personat që kan' një form',\* dhe Atin, dhe Birin, dhe Shenjtin Shpirt pra;\* një pushtet unik Hyjnia ka,\* se mbretëron si monark dhe si Perëndi.

Tani *Hyjlindësore*

**M**odeste, lindja jote e frikshme është;\* ai që njeri u bë, është Zoti\* që nga Ati lindi pa fillim\* edhe në fund ti e kishe pa burr' në bark.



Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Në botë parashndrit nga Kryqi yt hir,\* i dhembshur, të gjith' na fton te pësimet\* e hyjnueshme që vuajte,\* na denjëso që t'u falemí besërisht.

*Irosi: Stereoson imás en si*

»Forcona, siguron, o Zot, në ty,\*<sup>11</sup> pra »ti që ke vrarë me dru mëkatin,\*<sup>11a</sup> edhe »frikën tënde na e mbill\* në zemrat tona, »që të lavdërojnë ty.

*Ode VIII*

*Asteko piri enothentes*

Pasi ngrite triumfin me Kryq kundër autoriteteve dhe pushteteve të territ,<sup>12</sup> o dritëdhënës, kur të vish me fuqi që të gjykosh botën e tërë,<sup>13</sup> mos i zbulo haptas të fshehtat e mia, o Fjalë, që ta lavdëroj dhembshurinë tënde të madhe.

Ti, gjykatësi, qëndrove si i një i akuzuar para tribunës<sup>14</sup> dhe dënove armiqësinë përmes Kryqit tënd,<sup>15</sup> o gjykues i drejtë dhe zemërgjerë;<sup>16</sup> ndaj çliroji nga ndëshkimi i përjetshëm<sup>17</sup> ata që me frikë thërrasin dhe e përmbilartësojnë njeridashjen tënde.

Kur qëmoti u fuqizuan si në fonderi me zjarr kreshme Djem besëmirë,<sup>18</sup> shuan vërtet me vesë hyjnore flakën e lartësuar;<sup>19</sup> dhe ne, duke agjëruar, le t'i shuajmë absolutisht kaminat e gjithë pasioneve që të shpëtojmë nga flaka e Gjehenës.

*Hyjlindësor*

Urtësia e Perëndisë<sup>20</sup> me bashkëzbritje të parrëfyshme u mishërua, kur ndërtoi shtëpi për vete prej teje,<sup>21</sup> o Vajzë pa përvojë dasme; sepse vetëm ti e paprishur u zgjodhe nga të gjitha gjeneratat si banesë e Fjalës së paprishme.

*Tjetri: Ton en ti vato Mosi*

O Krisht, që mban Gjithësinë përmes fja-

lës, duron për mua çdo gjë,<sup>22</sup> shuplaka, pështyma<sup>23</sup> dhe kryqëzim; i himnoj madhësitë e njeridashjes sate në gjithë jetët.

Flijohesh, o Krisht, si qengj,<sup>24</sup> pasi u shpove me shtizë në brinjë,<sup>25</sup> që të më shpëtosh mua, delen e humbur,<sup>26</sup> nga gjahu i djallit dhe të më rreshtosh në mandrën tënde të mirë në përjetësi.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin.

*Triadik*

O Trini, një Hyjni e pandarë nga natyra, por e ndarë në Persona, pushtet i përjetshëm, Atë, Bir dhe Shpirt, të përhimnojmë në gjithë jetët.

*Tani Hyjlindësor*

O Hyjshtatzënë e dëlirë, porta qiellore,<sup>27</sup> dera shpëtimtare e tërë të krishterëve, pranoje lutjen e atyre që të lumërojnë në gjithë jetët.<sup>28</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Me Kryqin tënd, o Krisht, priftërinj mburren, mbretër përforcohen, çdo besëmirë ndriçohet; më denjëso që ta shoh atë, t'i falem dhe t'i këndoj në jetë.

*Irosi: Ton en ti vato Mosi*

»Te Moisiu, në mal,\* në Sina para- »shfaq i\* mrekullin' e së Virgjërës në një »ferrë<sup>29</sup> Zoti Krisht;\* himnojeni, bekonit,\* »përmbilartësoni atë në gjithë jetët.<sup>30</sup>

*Ode IX*

*En nomo sqia qe grámati*

Krisht, kur Moisiu ngriti lart\* gjarpurin në dru,<sup>31</sup> ty të shfaqti lasht,\* sepse me dashje ti mbi Kryq u ngjite<sup>2</sup> dhe i dhe shuplak\* së keqes fort të helmuar të dredharakut satan;\* drejt teje hoqe vdekatarët nga poshtë, njeridashës Zot.

Në shpirt ti ma ndiz, Krisht, dashurin\* tënde hyjnore, si ta pastrosh\* me zjarrin, pra me frikën tënde; dhe me Kryqin tënd, o Zot,\* rrethomë, se tinëzisht më mashtroi me epshe keq\* i vjetri krejt pengues,<sup>1</sup> që e ka nxirë mendjen time pus.

Vëllezër, le ta pastrojmë mjaft\* zemrën nga krejt të këqijat ne\* edhe nga çdo epsh me mendime, të kreshmojmë nga ato;\* si krah t'i kemi virtytet hyjnore, të shmangemi\* nga çdo e keqe, vrull i ulët, të madhen Pashk' ta shohim drit'.

#### *Hyllindësor*

Nga ti veshi varfërinë ton',\* o Virgjëreshë, vullnetarisht\* i pasuri<sup>32</sup> sipas natyrës; ndaj i dukshëm na u bë\* ai që padukurisht përhimnohet nga koret lart,\*<sup>33</sup> prej mirëdashjes rigatuan ikonën e dërrmuar<sup>34</sup> keq.

#### *Tjetri: Se tin noitin*

Të gjithë ne, që përmes teje gjetëm hyrjen për tek Ati, o Bir i Perëndisë, të madhështojmë ty që i tendose duart në Kryq dhe i bëre të tuat të katra skajet e botës.

O Krisht, të paligjshmit, pasi të kurorëzuan me gjemba,<sup>35</sup> të godisnin<sup>36</sup> dhe të kryqëzuan; gjatë këtyre lëkundej e gjithë toka<sup>37</sup> që është nën qiell, ndërsa ne, meqë shpëtuam, të madhërojmë.

#### *Lavdi Triadik*

Me himne të pareshtura të madhërojmë ty, Trininë e Shenjtë të trishkëlqyer, që mban dhe ruan Gjithësinë përherë, pra Atin, Birin dhe Shpirtin që rron.

#### *Tani Hyllindësor*

Me himne të madhështojmë ty, Perëndilindësen, renë e ndritshme<sup>38</sup> të Shpirtit; prej teje na shkëlqeu drita e pafreshme,<sup>39</sup> Krishti, Dielli i madh i

drejtësisë.<sup>40</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. O Kryq i Krishtit, ti je drita jonë, parulla e shenjtë, trofeu i fitores; ti na e ëmbëlso shumë vetëpërbajtjen dhe na denjëso që të të falemi.

#### *Irmosi: Se tin noitin*

»Me himne të pareshtura të madhështojmë ty, shkallën mendore dhe të »gjallë, në të cilën mbështetej Perëndia<sup>41</sup> »ynë, me anën e të cilit e gjetëm ngjijten »drejt qiellit.

#### *Fotogojiku i Tingullit të javës*

#### *Pasvargjet e Lavdërimeve*

#### *Ting. Tërth. II Idhiomeli*

Sado që isha i nderuar si bir i një Ati të mirë, unë i pamendí nuk e kuptova, por e privova veten nga lavdia kur e shpërdoro keq pasurinë e Hirit; dhe, meqë më mungonte ushqimi hyjnor, u bëra parazit pranë një qytetari të ndyrë; ky më dërgoi në arën e tij shpirtprishëse ku, duke jetuar në mënyrë të shturur, kullotja bashké me kafshët dhe, duke punuar si skllav te kënaqësitë, nuk ngopesha; por, si të kthehem, do t'i thërras Atit të dhembshur e të mirë: Mëkatova para qiellit dhe para teje, mëshiromë.<sup>42</sup>

*Varg:* U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përulle, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt' e tyre.

#### *I njëjti*

*Varg:* Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji te ne, dhe veprën e duarve tona



drejtoje.

*Martirik*

**B**ashkësitë e martirëve të tu, të përgjërrohen, o Krisht; mëshirona si njeridashës.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjindësor*

*Ote ek tu ksilu*

Vajzë,\* po lotoje me vajtim\* dhe pësoje dhimbje të shumta, rënkoje thellë në shpirt\* kur po kryqëzohet Bir i y dhe Perëndi,\* fort e shenjtë e pacen, thoshe: "Mjer', Bir i ëmbël!\* Si padrejtësisht po vuan varur përmbi dru,\* ti që dheun mbarë e mbush plot?!",\*<sup>42a</sup> Ndaj të lypim, Zonjë, me besë\* zbutë ti atë me dhembshuri për ne.

*Lexuesi:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin...  
*etj. si të hënën e javës së parë në mëngjes (fq. 63).*

*Në Orën e Gjashtë (në Trithektë), Tropari i Profecisë:*

*Ting. Tërth. IV*

**N**uk kemi bazë veprash,<sup>43</sup> o Zot; je përdëllyes, o njeridashës, punët e duarve të tua mos i shpërfill,<sup>44</sup> o i pamëkatshëm.

Lavdi dhe Tani

*I njëjti*

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 49.

Flijoji Perëndisë therore lavdërimi.

*Varg:* Perëndi perëndish foli dhe e thirri dheun.

Këndimi i profecisë së Isaias

*(10.12-20)*

**D**o të jetë që Zoti, pasi t'i mbarojë së bëri të gjitha në malin Sion dhe në Jerusalem, do të godasë fuqishëm mbi mendjen e madhe, mbi eprorin e asirianëve dhe mbi lartësinë e lavdisë së syve të tij, sepse tha: "Do të veproj me forcë, dhe me urtësinë e mençurisë do të heq kufi kombesh dhe fuqinë e tyre do ta plaçkit, dhe do të lëkund

qytete të banuara dhe tërë sferën do ta kap me dorë si fole, dhe do ta ngre si vezë të braktisura dhe s'ka kush të më shpëtojë ose të flasë kundër". Mos do të lavdërohet një kazmë pa atë që pret me të? Ose do të ngrihet sharra pa atë që e heq? Në të njëjtën mënyrë, nëse dikush do të ngrejë shkop ose dru; dhe jo vetëm kështu, por Zoti Sabaoth do t'i dërgojë çnderim nderit tënd dhe në lavdinë tënde do të flakërojë zjarr i ndezur; dhe do të jetë drita e Izraelit në zjarr dhe do ta shenjtërojë në zjarr që digjet, dhe do ta hajë materialin si kashtë. Atë ditë do të shuhen malet dhe kodrat, dhe pyjet, dhe do të bahet tërësisht nga shpirti deri në mishra; dhe ai që ikën, do të jetë si ai që ikën larg flakës që digjet; dhe ata që mbeten prej tyre, do të jenë një numër, dhe një fëmijë do t'i shkruajë ata; dhe do të jetë në atë ditë nuk do të shtohet më mbetja e Izraelit, dhe të shpëtuarit e Jakovit nuk do të kenë më besim mbi ata që u bënë atyre padrejtësi, por do të kenë besim vërtet mbi Perëndinë e shenjtë të Izraelit.

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 50.

Përdëllemë, o Perëndi, sipas përdëllimit tënd të madh.

*Varg:* Krijoi zemër të pastër tek unë, o Perëndi.



TË MËRKURËN E JAVËS SË TRETË  
NË MBRËMËSORE

*10 Thirrto*

*Ting. IV Idhiomeli*

**S**hkapërderdha në shturje pasurinë time atërore, u bëra i shkretë pasi bano-va në vendin e qytetarëve djallëzorë; për shkak të marrëzisë u bëra i ngjashëm me

kafshët e pamend dhe u zhvesha nga çdo hir hyjnor; ndaj, si u ktheva, të thërras ty, Atit të dhembshur dhe të mirë: Mëkatova, pranomë mua që po pendohem, o Perëndi, dhe mëshiro më.<sup>42</sup> (2x)

### Martirike

O filjime të gjalla, holokauste me logjikë,<sup>45</sup> martirë Zoti, therorë të përsosur Perëndie, dele që e njihni Perëndinë dhe jeni të njohura prej Perëndisë.<sup>46</sup> mandra e të cilave nuk shkelet nga ujçërit, ndër-mjetoni që të kullosim edhe ne bashkë me ju në ujë prehjeje.<sup>47</sup>

### Të tjera, të zotit Josif

#### Ting. Tërth. II Olin apothëmeni

Qart' nga dielli mendor\* shndritje u shfaqët, apostuj\* hyshikues, ndaj ndrëçim\* për krejt shpirtat tanë kërkoni dhe çlirim\* nga çdo terr, mjegull, tym\* që na sjell pasioni;\* ndër-mjetoni ta shikojmë ditën shpëtimtare ne,\* si me ndër-mjetime dhe lutje njësh\* të lajmë zemrën që ka plag'\* prej dinakut djall, që t'ju lavdërojm'\* besërisht gjithnjë të shpëtuar, meqë tërë botën pra\* me predikime të urta fort\* e shpëtuat; ju mburrim.

Ika larg në vend të lig\* i ndyri unë, keq prisha,\* o i dhembshur, ati im,\* pasurinë tënde që ma dhe, tretëm tmerr\* nga uri veprash pra\* plot dobi, të mira,\* ja i veshur jam me turp nga shkeljet, se prej Hirit tënd\* lakuriq jam, ndaj unë të thërras:\* Fajtova, por, meqë e di\* mirësinë tënde, pranomë, Krisht,\* si një rrogëtar ndër punonjësit e tu,<sup>42</sup> përdëllimtar,\* siç ndër-mjetojnë apostujt fort\* që të donin shumë, Zot.

*Tjetër, e zotit Theodor  
I njëjti Ek dheksiôn tu Sotiros*

“O apostuj të Shpëtimtarit, ndrëçues të planetit,<sup>48</sup> mirëbërës dhe shpëtimtarë, që rrëfeni si qiej lavdin e Perëndisë,<sup>49</sup> të stolitur me vjet e mrekullive dhe me çuditë e shërimeve, çojini Zotit për hirin tonë përgjërime të gjata, që të pranohen lutjet tona si aromë e pacenuar dhe që të denjësohemi ta shohim dhe ta përqafojmë të gjithë me frikë Kryqin jetëprurës”. Neve që i falemi atij, na dërgo nga lart mëshirat e tua, o Shpëtimtar, si njeridashës.

### Dhe katër të Mujorit

#### Lavdi dhe Tani

#### E Mujorit (Hyjlindësore)

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Prifti:* Mbrëmje!  
*Lexuesi:* Proqimen. Ting. IV. Psalm 51.  
Shpresova përmbi mëshirën e Perëndisë në jetë.

*Varg:* Pse krenohet me të keqen i fuqishmi?

### Këndimi i Gjenezës

#### (7.6-9)

Noeu ishte gjashtëqind vjeç dhe përmbytja e ujërave u bë mbi tokë. Dhe hyri Noeu, dhe bijtë e tij, dhe gruaja e tij, dhe gratë e bijve të tij bashkë me të në arkë, për shkak të ujit të përmbytjes; dhe nga zogjtë e pastër, dhe nga zogjtë e papastër, dhe nga kafshët e pastra, dhe nga gjithë zvarranikët mbi tokë dy nga dy u futën drejt Noeut në arkë, mashkull dhe femër, ashtu siç i porositi Perëndia Noeut.

Proqimen. Ting. IV. Psalm 52.  
Kur po e kthente Zoti robërinë e popullit të tij.

*Varg:* Tha një i pamend në zemrën e tij: S'ka Perëndi.

### Këndimi i Fjalëve të Urta

#### (9.12-18)



**Bir**, nëse do të bëhesh i urtë për veten tënde, do të jesh i urtë dhe për të afërmit; ndërsa, nëse do të katandisesh i keq, do të nxjerrësh vetëm të këqija. Ai që mbështetet mbi gënjeshtër, ai kullot erëra, dhe po ai do të ndjekë pas zogj që fluturojnë, sepse i la udhët e vreshtit të tij dhe i humbi boshtet e vetë arës së tij; dhe përshkon mes shkretëtire pa ujë dhe toke të sistemuar në vende që kanë etje, dhe mbledh me duar pafrytshmëri. Gruaja pa mend dhe arrogante bëhet e varfër për bukë, e cila nuk di turp. U ul në dyert e shtëpisë së saj mbi stol dukshëm në sheshe, duke ftuar ata që kalonin dhe drejtoreshin në rrugët e tyre: "Kush nga ju është më i pamend, le të devijojë, të vijë drejt meje; dhe ata që janë të varfër në mençuri, unë i nxit duke thënë: 'Prekni kënaqshëm bukë të fshehura dhe ujë të ëmbël vjedhjeje'". Por ai s'e di se të dhelindur u zhdrukën pranë saj, dhe ai përfundon mbi dërrasat e shtëpisë së Hadhit. Por hidhu përpjetë, ik, mos u vono në vend, as mos e ngul syrin tënd drejt saj, sepse kështu do të përshkosh ujë të huaj dhe do të kapërcesh lumë të huaj; dhe nga uji i huaj largohu, dhe nga burimi i huaj mos pi, që të jetosh shumë kohë dhe që të të shtohen vite jete.

Le të drejtohet lutja ime *dhe shërbesa e të Parashenjësuarave që mbetet.*

### CITIME

1. Gjen. 3.3-6
2. Joan 10.15,17-18
3. Joan 1.13
4. Ligji i Dytë 21.23; Gal.3.13
5. Joan 1.29
6. Kol. 3.5
7. Lluk. 2.37
8. Gal. 2.20
9. I Kor. 15.56
10. Kol. 3.12
11. I Mbret. [Sam.] 2.1
- 11a. I Petr. 2.24

12. Ef. 6.12
13. Vep. 17.31; II Tim. 4.1
14. Matth. 27.11,19
15. Ef. 2.16
16. Ps. 7.12; II Tim. 4.8
17. Hebr. 6.2
18. Dan. 1.8-14
19. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
20. I Kor. 1.24
21. Fja. Urt. 9.1
22. Matth. 26.67; Mark 14.65; Joan 19.22; 19.3
23. Matth. 26.67; 27.30; Mark 14.65; 15.19
24. Is. 53.7; Vep. 8.32
25. Joan 19.34
26. Matth. 18.11-12; Lluk. 15.4; 19.10
27. Gjen. 28.17
28. Lluk. 1.48
29. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
30. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34 etj.
31. Num. 21.9; Joan 3.14
32. II Kor. 8.9
33. Is. 6.2-3; Ps. 148.1-2
34. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
35. Matth. 27.29; Mark 15.17; Joan 19.2,5
36. Matth. 27.30; Mark 15.19; Lluk. 22.64
37. Matth. 27.51,54
38. Eks. 13.21-22 etj.
39. I Tim. 6.16
40. Mal. 4.2(3,20)
41. Gjen. 28.12-17
42. Lluk. 15.11-21
- 42a. Ef. 1.23; 4.10
43. Ps. 68(69).2
44. Ps. 137(138).8
45. Lev. 1.3; 17.4; Is. 56.7; Rom. 12.1
46. Joan 10.4
47. Ps. 22(23).2
48. Fil. 2.15
49. Ps. 18(19).2



### TË PREMTEN E JAVËS SË TRETË NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve, Aliluat dhe Triadiket e Tingullit të javës, dhe pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore Kryqësore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore Ting. Tërth. I Ton sinanarhon Logon*

**P**ërmes drurit të ngrenies<sup>1</sup> dikur në njerëzit\* seç vdiqëm,<sup>2</sup> por përmes Kryqit

tënd u ringjallëm, i mir;\* me fuqin' e tij, o zemërdhembshur, na forco\* vetëpërmbytjen, kohën tash\* ta kalojmë drejt me kataniks, që dëshirën tënde\* ta zbatojmë,<sup>3</sup> ta shohim ditën e ngjalljes sate dritëprurëse, Zot.

Lavdi  
E njëjta

Tani *Kryqhyjlindësore*

**K**ur të shihthe mbi Kryq nëna jote, Zoti Krisht,\* që me dëshirë<sup>4</sup> po vareshe mes kusarësh me trup.\*<sup>5</sup> keq në shpirt si nënë po vajtonte, thoshte pra:\* Si u mbërtheve përmbi Kryq,\* Bir i pamëkatshëm,<sup>5a</sup> si keqbërës padrejtësisht ti,\* duke dashur, si i mbimirë, ta gjallërosh gjinin' e njerëzve krejt?

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësore  
Ting. I Tu lithu sfracjsthenos*

**P**ërmes vetëpërmbytjes, si mishin ta pastroj<sup>më</sup>,\* si dhe përmes lutjes në shpirt të ndriçuar, denjësona,\* o Krisht, ta shikojmë Kryqin tënd\* të çmuar dhe t'i falemi me frik,\* duke psalur me himnim, duke thënë ne:\* Lavd Kryqit tënd jetëbërës,\* lavde hyjnore sate heshtë<sup>6</sup> tok\* përmes të cilave sërish,\* Zot, u ngjallëm, njeridashës i vetëm; lavdi më ty.

Lavdi  
E njëjta

Tani *Kryqhyjlindësore*

**K**ur shqerra të shikonte ty, qengjin, mes kusarësh\*<sup>5</sup> që po kryqëzohesh,<sup>7</sup> Fjalë, mbi dru me shtiz' në brinjë\* të shpohesh,<sup>6</sup> thirri me vajtim,\* me klithmë pors i nënë: O Jisu,\* Biri im, ç'mister i huaj, i frikshëm është? Si mbyllesh në varr ti, Zoti,\* që s'ke përshkrim? Kjo ngjarje s'shprihet dot;\* o Biri im i ëmbël krejt,\* mos më lër pra të vetmuar keq, o zemërgjeri Krisht.

*Psalmi 50. Prifti uratën e zakonshme: O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën, dhembshurinë dhe... Kanuni i Mujorit dhe Triodet në vendin e tyre. Lexohet dhe Ode V biblike.*

*Triodi, poezia e zotit Josif  
Ode V*

*Ting. Tërth. I  
O anavalómenos*

**S**apo të pa të vareshe mbi dru në mish, o Krisht, dielli e ktheu dritën në terr,<sup>8</sup> toka u lëkund dhe gurët u çanë.<sup>9</sup>

**M**e traumën tënde më shëro,<sup>10</sup> o Zot, dhe do të shërohem<sup>11</sup> pasi të m'i pastrosh plagët e shpirtit tim, o Krisht, që pranove pësime në trup.

**O** Zot, shpirtin tim që, për shkak të ideve të çdollojshme të pasioneve, nxori gjemba dhe u bë djerr, pastroje ti që u kurorëzove me gjemba<sup>12</sup> nga mirësia ekstreme.

*Hyjlindësor*

**O**e Tërdëllirë, linde si foshnjë Gatuesin tim; lutem, përgjëroju atij që të më ripërtërijë mua që u vjetërova mes të këqijash të shumta.<sup>13</sup>

*Triodi tjetër, poezi e zotit Theodor  
Ting. I*

*Ek niktós orthrizontes*

**O** Krisht, kur të kryqëzuan në vendin e Kalvarit, judenjtë<sup>14</sup> tundnin kokat e tyre<sup>15</sup> duke qeshur dhe duke u tallur;<sup>16</sup> por ti i duroje që të na shpëtoje.

**O** Krisht, kur shkroi tri mbishkrime mbi Kryq,<sup>17</sup> Pilati pa dashur të deklaroi si një nga Trinia, ty që pësove vullnetarisht<sup>4</sup> për shpëtimin e të gjithëve.

Lavdi *Triodik*

**O** besëmirë, le ta himnojmë Hyjninë tre-diellorë të Trinisë së përbindritshme, duke nderuar Atin, duke lavdëruar Birin



dhe duke shpallur Shpirtin si dritë.

### Tani *Hyjlindësor*

**A**i që lindi prej teje, të sfaqti, o modeste, më të lartë se engjëjt, sepse atë prej të cilit këta tremben ta shohin si Perëndi,<sup>18</sup> ti e përqafton si Birin tënd, o e Kulluar.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

**O** Kryq i tërërespektuar, rojë shpëtimtar i botës, ruajmë mua që po kreshmoj dhe denjësomë për faljen tënde të pacenuar.

### *Irmosi: Ek niktós orthrizontes*

»Duke u ngritur qëmenatë,<sup>19</sup> të përhimnojmë, o Krisht Perëndi, që u varfërove për ne<sup>20</sup> dhe durove në mishin tënd dhe Kryq, dhe vdekje.

### *Ode VIII*

#### *Si to panturgó*

**O** Krisht, i tendose në Kryq pëllëmbët e tua, duke e shfuqizuar mospërmbajtjen e dorës së paraatit,<sup>1</sup> ndërsa me dru e shërove mallkimin<sup>21</sup> e drurit;<sup>2</sup> prandaj të himnojmë në gjithë jetët.

Të biem në gjunjë ty që e do shpëtimin,<sup>22</sup> o Fjalë; hiqi shpejt nga zemra ime vullnetet tepër dredharake, ti që me dashje pësove si Kryq edhe pësime.<sup>4</sup>

**U**në i shtururi u nxiva meqenëse dëshiroja jetë imorale dhe sjellje të ndotur; më shndrit me rreze kthimi,<sup>23</sup> o Fjalë, që, kur pësoje, e nxive shkëlqimin e diellit.<sup>5</sup>

### *Hyjlindësor*

**O** nënë e Krishtit Perëndi, ndaloje çdo lëndim të zemrës sime të shumëvuajtur dhe dërrmoji shigjetat dhe harqet e demonëve që luftojnë<sup>24</sup> shpirtin tim të përulur.

### *Tjetri: Ton tus innlogus*

**N**e mjeranët çfarë të të ofrojmë ty, Zotit të të gjithëve,<sup>25</sup> që pësove? Sepse për ne

pranove Kryq, o Krisht; e himnojmë hirin e mëshirës sate të jashtëzakonshme.

**E**dhe pse, o Krisht, judenjtë e paligjshëm për shkak të xhelozisë<sup>26</sup> të vranë mbi dru të mallkuar,<sup>27</sup> nuk e prishën dot pushtetin e lavdisë sate,<sup>28</sup> sepse ti je Zoti i të gjithëve,<sup>25</sup> që pësove vullnetarisht.<sup>4</sup>

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin.

### *Triadik*

**A**dhuroj tre Personat e Hyjnisë së përbimsubstancshme, Atin e parapafillim, Birin dhe Shpirtin e shenjtë, esencë të pandarë në natyrë, dhe i lavdëroj në jetë.

### Tani *Hyjlindësor*

**M**ë të lartën se qiejt, më supremen se Keruvimet, të parën ndër shenjtorë dhe Vajzën e panjollshme të Perëndisë së të tërëve,<sup>29</sup> e himnojmë dhe e përbimlartësojmë në gjithë jetët.<sup>30</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

**O** Kryq tri herë i lumtur i Krishtit, fitorja e shkruar në qiell, ti mbive nga dheu për hirin tonë; denjësona gjithë ne për faljen tënde, pasi të pastrohemi me kreshmë.

### *Irmosi: Ton tus innlogus*

»Atë që ruajt në kaminë Djemtë që himnonin dhe e ktheu në vesë furrë<sup>31</sup> që bubulonte,<sup>32</sup> Krishtin Perëndi e himnojmë dhe e përbimlartësojmë në gjithë jetët.<sup>30</sup>

### *Ode IX*

#### *Isaia hórove*

Shpëtimtari im, pastro\* ngurtësinë\* që kam un' në shpirt,\* më jep burim të hyjshëm, plot kataniks,\* i dhembshur, që nxore jetë që nga brinja<sup>6</sup> për hirin tim,\* Krisht Zot, dhe hoqe lart\* njerëzinë tonë drejt teje.

**H**odha, Zot, në thellësit\* e mëkatit\* veten time keq,\* si lashë lartësin' e virty-

teve;\* por hiqme, shpëtomë, Krisht, ti që u ngjite mbi Kryq edhe\* hoqe drejt teje lart\* njerëzinë tonë dhembshurisht.

Je kënaqësi, o Krisht, \* ëmbëlsi je, \* mu si Krijimtar,\* por vrerin e shijove<sup>33</sup> për korrigjim,\* për rënien që erdhi pas kënaqësis'; adamanët,<sup>3</sup> ne,\* ti na shpëtove krejt\* me pësimin tënd, ndaj të himnoj'm'.

### Hyjlindësor

O e Tërëshenja Zonj', \* shpresa ime\* dhe përkija je,\* në mendje më jep paqe dhe më shëro\* çdo plagë të shpirtit, të himnoj dhe unë me ngazëllim\* çdo madhësi të që ke,\*<sup>34</sup> Virgjëresh' gjithnjë, Hyjlindëse.

### Tjetri: Se inper idhe Moisis

Të gjithë ne besnikët të madhërojmë me himne, o Krisht, ty që të paligjshmit të veshën duke u tallur me purpur<sup>35</sup> dhe kurorë<sup>12</sup> si mbret, dhe të godisnin me kallam në kokë<sup>36</sup> kur të kryqëzonin nga xhelozia<sup>26</sup> dhe të ujitnin me vrer.<sup>33</sup>

O Krisht Shpëtimtar, të madhërojmë me himne ty që, sapo dielli të pa që vuaje në Kryq, e fshehu dritën,<sup>8</sup> kur Krijesa e tërë lëkundej, për shkak të sharjeve ndaj Zotit, dhe gurët çaheshin.<sup>9</sup>

### Lavdi Triadik

Njësia trediellore është dritë, jetë, gjithëbërëse, Perëndi dhe Zot, i cili feks prej një drite, duke llamburitur përmes tri karaktereve në një Hyjni; atë të gjithë ne besëmirët e madhësojmë.

### Tani Hyjlindësor

O nënë e dëlirë, të madhërojmë me himne ty që Davidi melodist të parashpalli si Sion ku banoi<sup>37</sup> i panxënshmi në qiej dhe krijoi nga mishi yt zbutjen e botës.<sup>38</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

O Zot, denjësona që, duke rendur përmes

vetëpërmbajtjes, të arrijmë ta vëzhgojmë dhe t'i falemi për shenjtërimin tonë Kryqit tënd shpëtimtar, ndriçuesit të besnikëve, që të të madhësojmë me anën e tij.

### Irmosi: Se inper idhe Moisis

»O Nënë e kulluar, të madhësojmë me himne ty që Moisiu të pa si ferrë të padjegshme,<sup>39</sup> dhe Jakovi si shkallë të gjallë dhe portë qiellore<sup>40</sup> përmes së cilës kaloi Krishti, Perëndia<sup>41</sup> ynë.

### Fotagojiku i Tingullit të javës

#### Pasvargjet e Lavdërimeve Tërth. II Idhiomeli

Pasi shkapërderdha pasurinë e dhuratës atërore, e shpenzova jetën në shturje, dhe u rëmbeva prej mendimeve të këqija të mëkatit tim; duke u kënaqur nga ëmbëlsia e pasionit, u bëra i ngjashëm me kafshët e pamend, për shkak të shkeljes së porosive shpëtimtare; por, o Krisht Perëndi, që deshe nga mirësia të vareshe mbi Kryq për hirin tim, mos më shpall të zhbërësuar, por pranomë si Birin Plangprishës mua që po kthehem dhe shpëtomë.<sup>23</sup>

Varg: U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përulë, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt' e tyre.

### Injëjti

Varg: Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji te ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

### Martirik

O Zot, në kujtimin e martirëve të tu tërë Krijesa kremton, qiejt ngazëllohen njësh me engjëjt dhe toka dëfren bashkë me



njerëzit; me lutjet e tyre, mëshirona.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësor*  
*Triimeros anestis Hristë*

Sapo të pa të varur mbi Kryq,\* vajtonte e Dëllira krejt\* porsi nënë,\* duke thënë: Biri im,\* o Perëndi dhe Zot, o fëmijë fort i ëmbël,\* si po duron pësim të turpshëm ti?<sup>27</sup>

*Lexuesi:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin *etj. si të hënën e javës së parë në mëngjes (fq. 63).*

*Në Orën e Gjashtë (në Tritohtë), Tropari i Profecisë:*  
*Ting. Tërth. IV*

O Perëndi, me fjalë përmes fuqisë sate i bëre të tëra<sup>42</sup> përsosmërisht<sup>43</sup> dhe nga mosqenia na solle në qenie; mos na dorëzo<sup>44</sup> te paligjësitë tona, lutemi, o Zot i pamëkatshëm.

Lavdi dhe Tani  
*I njëjti*

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 57.  
Nëse vërtet pra flisni të drejtën, gjykoni të drejtat, o bij të njerëzve.

*Varg:* Do të dëfrojë një i drejtë kur të shohë hakmarrjen.

Këndimi i profecisë së Isaias  
*(13.2-13)*

Këto thotë Zoti: "Mbi mal fushor ngrini shenjë, lartësojeni zërin për ta, mos kini frikë, nxisni me dorë, hapni ju të parët; unë i rreshtoj dhe unë i udhëheq ata; vijnë gjigantë duke u gëzuar dhe njëkohësisht duke sharë, që ta pëmbushin inatin tim; dëgjohej zë kombesh të shumta mbi male, i ngjashëm me zë kombesh të shumta, zë mbretërisht dhe kombesh të mbledhura". Zoti Sabaoth urdhëroi një komb luftëtar që të vijë prej tokës nga larg, nga cepi i themelit të qiellit,

Zoti dhe luftëtarët e tij që ta prishë krejtësisht të gjithë sferën. Vajtoni me klimta sepse është afër ditë Zoti, dhe do të arrijë dërmim nga Perëndia. Prandaj çdo dorë do të paralizohet dhe çdo shpirt njeriu do të frikësohet, dhe do të trazohen ambasadorët, dhe ata do të kenë dhimbje si ato të gruas që lind, dhe do të ngatërrohen me njëri-tjetrin, dhe do të shtangen, dhe do ta ndryshojnë si flakë fytyrën e tyre; sepse ja po vjen ditë e passhëruar Zoti, ditë zemërimi dhe inati, që planetin ta vendosë të shkretuar dhe që t'i zhdukë nga ai mëkatarët; sepse yjet e qiellit dhe Orioni, dhe e tërë stolia e qiellit nuk do ta japin dritën e tyre dhe do të errësohet kur të lindë dielli, dhe hëna nuk do ta japë dritën e saj. "Dhe do të porosis të këqija për gjithë sferën dhe për të pabesët mëkatet e tyre; dhe do të zhduk arrogancë të paligjës dhe do të përul arrogancë kryelartësh; dhe ata që do të mbeten, do të jenë të çmuar më shumë se ari që nuk kaloi nga zjarri dhe njeriu do të jetë më i çmuar se guri prej Sufiri", sepse qielli do të inatoset dhe toka do të tundet nga themelet e saj për shkak të inatit të zemërimit të Zotit Sabaoth, ditën kur do të sulmojë inati i tij.

Proqimen. Ting. i Rëndë. Psalm 58.  
Më çliro nga armiqtë e mi, o Perëndi.  
*Varg:* O Perëndi, je përkrahësi im; o Perëndia im, mëshira ime.



TË PREMTEN E JAVËS SË TRETË  
NË MBRËMËSORE

*10 Thirrto*  
*Ting. i Rëndë Idhiomeli*

Si Plangprishës u largova nga hiri yt,

o Zot, dhe, pasi e harxhova pasurinë e mirësisë, vrapova te ti, o i dhembshur, duke të thirrur: O Perëndi, mëkatova,<sup>23</sup> mëshiomë.  
(2x)

*Pastaj 4 Martirikët e Tingullit të javës dhe 4 të Mujorit. Lavdi Nekrosime, Tani Hyjlindësore po të Tingullit (kërkoji në fund të librit).*

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Prifti:* Mbrëmje!  
*Lexuesi:* Proqimen. Ting. IV. Psalm 59.  
Jepna ndihmë nga trishtimi dhe është i kotë shpëtimi i njeriut.  
*Varg:* O Perëndi, na zmbapse dhe na rrëzove.

Këndimi i Gjenezës  
(8.4-21)

**U**l arka në muajin e shtatë, në njëzet e shtatë të muajit, mbi malet Ararat. Dhe uji pakësohej deri në muajin e dhjetë; dhe në muajin e dhjetë, në të parën e muajit, u dukën kokat e maleve. Dhe u bë që, pas dyzet ditësh, Noeu hapí frëngjinë e arkës që bëri, dhe dërgoi korbin të shihte nëse ndaloj uji; dhe, pasi doli, ai nuk u kthye derisa u tha uji nga toka. Dhe e dërgoi pëllumbeshën prapa tij që të shihte nëse ndaloj uji nga toka; dhe, meqë pëllumbesha nuk gjeti prehje për këmbët e saj, u kthye drejt tij në arkë, sepse uji ishte mbi tërë faqen e tokës; dhe, si e tendosi dorën, e mori atë dhe e futi drejt vetes në arkë. Dhe, pasi u përmbajt akoma shtatë ditë të tjera, përsëri e dërgoi pëllumbeshën nga arka; dhe pëllumbesha u kthye drejt tij rreth mbrëmjes, dhe kishte gjethe ulliri, një bisk në gojën e saj, dhe Noeu kuptoi se ka ndaluar uji nga toka. Dhe, pasi u përmbajt akoma shtatë ditë, përsëri e dërgoi pëllumbeshën, dhe nuk shtoi të kthehej më drejt tij. Dhe u bë në vitin gjashtëqind e një në jetën e Noeut, në një të muajit të

parë shteroi uji nga toka; dhe Noeu e zbuloi çatinë e arkës që bëri dhe pa se shteroi uji nga faqja e tokës; ndërsa toka u tha në muajin e dytë, në njëzet e shtatë të muajit. Dhe tha Zoti, Perëndia, drejt Noeut duke thënë: "Dil nga arka ti dhe gruaja jote dhe bijtë e tu dhe gratë e bijve të tu bashkë me ty, dhe të gjitha bishat, sa janë me ty dhe çdo mish, që nga zogjtë deri te kafshët; dhe çdo zvarranik që lëviz mbi tokë, nxirre tok me veten tënde, dhe shtohuni dhe shumëfishohuni mbi tokë". Dhe doli Noeu dhe gruaja e tij, dhe bijtë e tij, dhe gratë e bijve të tij tok me të. Dhe të gjitha bishat, dhe të gjitha kafshët, dhe çdo zog, dhe çdo zvarranik që lëvizte mbi toka sipas gjinisë së tyre, dolën nga arka. Dhe i ndërtoi Noeu altar Zotit dhe mori nga të gjitha kafshët e pastra dhe nga të gjithë zogjtë e pastër dhe i ngriti mbi altar për holokaust. Dhe Zoti Perëndi nuhati erë të këndshme.

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 60.  
Dëgjoje, o Perëndi, faljen time, vëri re lutjes sime.

*Varg:* Kështu do të psal në emrin tënd përjetë.

Këndimi i Fjalëve të Urta  
(10.31-11.12)

**G**oja e të drejtit pikon urtësi, ndërsa gjuha e të padrejtit do të shfaroset. Buzë burrash të drejtë pikojnë hire, ndërsa gojë të pabesësh neveritet. Peshore djallëzore janë të neveritshme para Zotit, ndërsa gur i drejtë peshimi është i pranueshëm prej tij. Atje ku do të futet krenaria, atje edhe çnderimi, ndërsa çdo gojë të përlurish studion urtësi. Përsosmëri të drejtësh do t'i udhëheqë dhe shkelja e atyre që bëjnë gjëra të çrregullta, do t'i plaçkitë vetë ata. Pasja nuk do të sjellë dobi në



ditë mërie, ndërsa drejtësia do të çlirojë nga vdekja. I drejti, kur vdiq, ia pendim, ndërsa katastrofë të pabesësh bëhet e lehtë dhe e gëzueshme. Drejtësia hap drejt udhë të paqortueshme, ndërsa pabesia bie në padrejtësi. Drejtësia e burrave të drejtë i çliron vetë ata, ndërsa illegalë pushtohen nga katastrofa e tyre. Kur vdiq burrë i drejtë, nuk humbi shpresë, ndërsa mburrja e të pabesëve u zhduk. I drejti del nga kurthi, ndërsa në vend të tij dorëzohet i pabesi. Në gojë të pabesësh ka kurth për qytetarë, ndërsa ndjeshmëri të drejtësh ecën mirë. Në të mira të drejtësh u ngrit një qytet, ndërsa me gojë të pabesësh u gërmua krejtësisht. Çdo i varfër në mend tallet me qytetarë, ndërsa çdo burrë i mençur sjell qetësi.

Le të drejtohet lutja ime *dhe shërbesa e të Parashenjësuarave që mbetet.*

#### CITIME

- Gjen. 3.2-6
- Gjen. 3.19
- Ps. 39(40).9 etj.
- Joan 10.15,17-18
- Matth. 27.38; Mark 15.27; Lluk. 23.33; Joan 19.18
- Joan 8.46
- Joan 19.34
- Is. 53.7; Vep. 8.32; I Petr. 1.19; Apok. 5.6; 7.14; 12.11
- Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
- Matth. 27.51
- Is. 53.5
- Jer. 17.14
- Matth. 27.29; Mark 15.17; Joan 19.2,5
- Sosana 52
- Matth. 27.33; Mark 15.22; Lluk. 23.33; Joan 19.21
- Matth. 27.39; Mark 15.29
- Lluk. 23.35
- Matth. 27.37; Mark 15.26; Lluk. 23.38; Joan 19.21
- Is. 6.2
- Is. 26.9
- II Kor. 8.9
- Gjen. 3.16-19
- I Tim. 2.4
- Lluk. 15.11-21
- Ps. 75(76).4
- Jov 5.8; Urt. Sol. 6.7; 8.3
- Matth. 27.18; Mark 15.10
- Ligji i Dytë 21.23; Gal. 3.13
- Kol. 1.11

- Sirak 36(33).1
- Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34 etj.
- Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-27
- Dan. 3.19; kap. 3 Lutja e Azarias 22-23
- Matth. 27.34
- Lluk. 1.49
- Matth. 27.28; Mark 15.17; Lluk. 23.11; Joan 19.2
- Matth. 27.30; Mark 15.19; Lluk. 22.64
- Ps. 131(132). 13-14; 134(135).21
- Rom. 3.25; I Joan 2.2; 4.10
- Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
- Gjen. 28.12-17
- Jez. 44.1-4
- Gjen. 1.2 etj.
- Gjen. 1.31
- Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 10



#### TË SHTUNËN E JAVËS SË TRETË NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve psalim në Ting. II*

Alliulia (3x)

*Të dytën me Varg:* Të lumtur ata që i zgjedhë dhe i more, o Zot.

Alliulia (3x)

*Të tretën me Varg:* Dhe kujtimi i tyre në jetë të jetëve.

Alliulia (3x)

#### Ting. II

O apostuj, martirë, profetë, hierarkë, oshënarë dhe të drejtë, që e kryet mirë garën dhe e ruajtët besën,<sup>1</sup> duke pasur guxim para Shpëtimtarit, lutemi, lypini për ne atij që, si i mirë, t'i shpëtojë shpirtat tanë.

#### Lavdi *Nekrosime*

Kujto, o Zot, si i mirë, shërbëtorët e tu dhe ndjeji sa mëkatuan në jetë, sepse askush nuk është i pamëkatshëm, përveç teje<sup>1a</sup> që mund t'u japësh ngjalljen atyre që u shpërngulën.

#### Tani *Hyllëndësore*

O nënë e shenjtë e dritës<sup>1b</sup> së pashpre-

hshme, të madhërojmë duke të nderuar me himne engjëlllore.

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret Martirike dhe Hyjlindësorja e Tingullit të javës. Pastaj [i Paqortueshmi (Ps.118) në dy Stanca dhe] Bekimoret Nekrosime (sq. 245 Uratore e Vogël). Prifti: Mëshirona, o Perëndi... etj. O Perëndi i shpirtave dhe i çdo trupit... Pastaj psalti:*

*Ndenjësore Ting. Tërth. I*

**P**rehi, o Shpëtimtari ynë, bashkë me të drejtët shërbëtorët e tu dhe fushoji në avllitë e tua siç është shkruar,<sup>1c</sup> duke mos i vënë re, si i mirë, paudhësitë e tyre të bëra me dashje dhe pa dashje dhe të gjitha ato me dije dhe pa dije, o njeridashës.

Lavdi

**D**he të gjitha ato me dije dhe pa dije, o njeridashës.

*Tani Hyjlindësore*

**O** Krisht Perëndi, që nga një Virgjëreshë linde si diell për botën, pasi të na shfaqësh me anën e saj bij drite,<sup>1d</sup> mëshirona.

*Psalmi 50, Kanuni i Mujorit dhe Tetraodet në vendin e tyre. Lexohen dhe Odet VI, VII, VIII dhe IX biblike.*

*Tetraodi që ka Akrostihidhë: «I këndon këto Josifi».*

*Ode VI*

*Ting. IV*

*Ilthon is ta vathi*

**Z**emrat e besnikëve me pikat e gjakut i vaditët,\* ndërsa me këtë kolon' pa besë\* ju mbytët qart',\* o të admirueshmit\* athloforë të lëvdueshëm.

**O** atletë, lavdi i besnikëve, ndihma fort e madhe,\* pa pushim ju mburreni tani drejt,\* se Perëndin'\* në gjymtyrët tuaja\* e lëvduat,<sup>2</sup> ky sundon mbi dhe.

*Nekrosim*

**B**renda gropës mjaft të thell' u vure, te sa me besë vdiqën\* pra, ti jep, o Zot dhe Fjalë, prehe\* si dhe çlirim\* nga çdo faj me lutjet mbar'\* të atletëve të shenjtë krejt.

*Hyjlindësor*

**V**ajzë, që me zëra të fuqishëm të të lëvdojm', të mburrim,\* priti këta zërat tanë, lype\* fort Birin tënd,\* të na japë ndjesë plot\* për mëkatet, "borxhin" tonë pra.

*Kanuni tjetër, poezi e zotit Theodor*

*Ting. Tërth. IV*

*Sinhòmenon dhekse me*

**P**anair kan' martirët tash, të rendim tok,\* Krishtin ta përhimnojm'\* sepse u dha kurora lavdi;\* t'i lumërojmë ne arritjet me mjaft nder.

**S**i u ndezët prej dashurisë hyjnore krejt,\* pra të Krishtit, në zjarr,\* martirë, ecnit mbi qymyre,\* të lumtur, si mbi ves' dhe e himnonit fort.

Lavdi *Triadik*

**O** Trini përbisunduese, Njësi hyjnore, dritë dhe drita, të këndoju ty, jetës dhe jetëve, Mendjes, Fjalës, Shpirtit, së shenjtës dhe të shenjtëve, një Perëndie.

*Tani Hyjlindësor*

**O** stërgjysh Jese, kërce; nga rrënja jote, nga e Reja e dëlirë, lindí si lule jete<sup>3</sup> ai që shpëton botën, Krishti Perëndi.

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

**N**uk u trembët nga zjarri, shpatat, vdekja ju,\* Krishti pra ju dha forc',\* kështu pohimin e shpëtimit,\*<sup>4</sup> të lumtur, krejt e ruajtët me siguri.

*Varg:* Shpirtat e tyre do të rrinë në të mira. Kryetari i jetës<sup>5</sup> dhe i vdekjes je,\* ndër të vdekur i lir',\* ata që more, njeridashës,\*



fushoji, prehi në avllit' e tua,<sup>1c</sup> Zot.

*Irmosi: Sinehómenon dhekse me*

»Njeridashës, më prit porsì profetin pra\*  
»mua që mbahem fort\* prej shumë shke-  
»llesh, Zot, dhe bie\* përpara dhembshuri-  
»së sate, më shpëtò.<sup>6</sup>

### Ode VII

*Nei tris en Vaviloni*

Me cilin, o shpirt, u bëre i ngjashëm duke pranuar vërtet pasionet e të palogjikshmëve? Cilin e kishe si më të madh në mëkate? Thirri Krishtit: Shpëtómë, o i mirë.

O shenjtore, gjatë këtyre ditëve të shenjta kërkoni vazhdimisht nga ai që prehet ndër shenjtore<sup>7</sup> që t'i shenjtërojë mendimet e të gjithë besëmirëve.

### Nekrosim

O i Tërëllartë, i pasur në mëshirë<sup>8</sup> dhe i mirë, jepu falje shërbëtorëve të tu që fjetën më parë, duke i radhitur bashkë me koret e shenjtoreve si njeridashës.

### Hyjlindësor

O e Pacenuar, pa ligje natyre linde Gatusin që u bë njeri; atij pra lypì që të mos i llogaritë paligjësitë dhe shkeljet e të gjithëve.

*Tjetri: O dhi angelu Pedhas*

Ti që ia tregove Kishës kujtimet e martirëve të nderuar si hare dhe ngazëllim shpirti, i bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.<sup>9</sup>

“Nuk të zhgënjëjmë, o Krisht, as të mohojmë”, thërrisnin martirët në mes të torturave, duke i habitur gjykatësit e paligjshëm.

Lavdi *Martirik*

Adhurojmë në tre Persona një natyrë të Atit, Birit dhe Shpirtit duke thirrur profetikisht: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.<sup>9</sup>

Tani *Hyjlindësor*

“Si linde si nënë dhe mbete e virgjër?”. – “Që linda Perëndi, mos ma kërkò mënyrën, sepse ai bën sa do”,<sup>10</sup> thërret Hyjbija.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

O kor martirik i hyjshfaqur, denjësoji shërbëtorët e tu që t'i falen Kryqit hyjnor dhe jetëbërës të Shpëtimtarit.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

O mbret i pavdekshëm, arkëtar i jetës, shërbëtorët e tu që i zgjodhe në besim dhe shpresë, denjësoji për jetën e amshuar.<sup>11</sup>

*Irmosi: O dhi angelu Pedhas*

»Ti, që përmes engjëlli freskove Djem  
»në kaminë, dhe furrën që bubulonte<sup>12</sup> e  
»ktheve në vesë,<sup>13</sup> i bekuar je, o Perëndi i  
»etërve tanë.<sup>9</sup>

### Ode VIII

*Litrotá tu pantós*

O martirë, duke ecur me moral të pampopshur drejt arenash të lodhshme, pësuar dhimbje mishi dhe, pasi u zhvendosët në fund që s'ka dhimbje, lehtësoni çdo dhimbje zemre.

O martirë të hyjshëm, që shkëmbyet të prishshmet me të sipërmet, mua që prishem për shkak të pasioneve mishore, shpëtómëni me anën e kreshmës dhe të lutjeve melodike, duke iu përgjëruar Perëndisë së të gjithëve.

### Nekrosim

Me përgjërimit e martirëve të tu, o Krisht, dërgoju nga lart mëshirat e tua të gjithëve, dhe jepu ndjesën e mëkateve dhe prehenj e hyjnueshme atyre që u shpërngulën nga jeta drejt teje të dhembshurit.

*Hyjlindësor*

Përderisa linde Perëndi të pamëkatshëm, shuaji mëkatet tona me ndërmjetimet e tua nënore, o Hyjlindëse, dhe shpëtova ne që thërrasim: Bekojeni, ju veprat e Zotit, Zotin.<sup>9a</sup>

*Tjetri: I theorimones Pedhes*

Pasi pësuar tortura me djegie si freskim, o athloforë, me gëzim thërrisnit: Bekojeni, ju veprat e Zotit, Zotin.<sup>9a</sup>

Kolona e hyjmobilizuar e martirëve, pasi triumfoi kundër mashtrimit, thërriste ngadhënjimisht: Bekojeni, ju veprat e Zotit, Zotin.<sup>9a</sup>

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin  
e Shenjtë, Zotin.

*Triadik*

Duke iu falur Atit tok me Birin edhe me Shpirtin e Tërëshenjtë, të gjithë le të thërrasim besërisht: O Trini në Njësi, shpëtoji shpirtat tanë.

*Tani Hyjlindësor*

Ti, o e tërëdëlirë, u tregove edhe Virgjëreshë, edhe nënë kur e kishë në mitër Perëndinë e të gjithave,<sup>14</sup> prandaj përgjëroju atij që t'i shpëtojë shërbëtorët e tu.

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

Me ndërmjetimet e athloforëve të tu, o Krisht Shpëtimtar, denjësoji shërbëtorët e tu që ta shohin dhe t'i falen Kryqit jetëbërës të mirësisë sate.

*Varg:* Shpirtat e tyre do të rrinë në të mira.

Ti që e shkatërrove pushtetin e vdekjes me ngritjen tënde prej të vdekurve, prehi bashkë me të zgjedhurit e tu të shpërngulurit, që të të himnojnë ty, Zotin.

*Irmosi: I theorimones Pedhes*

»Përbrenda furrës hyjfolësit Djem<sup>15</sup> e sheke-  
»Inin\* bashkë me zjarrin dhe flakën,<sup>13</sup> dhe

»psalnin hirshëm me butësi:\* Bekojeni, ju  
»veprat e Zotit, Zotin.<sup>9a</sup>

*Ode IX*

*Eva men to tis parakois*

S'u rrëzuar posht' nga çdo dredhim armi-  
qësor,\* athloforë, se mbi gur mendor\*  
kishit mbështetur ju mendimin,\* ndaj  
mua që drejt vesesh shpirtprishëse\* po  
kthehem, mbështetmëni përmes lutjeve\*  
dhe përgjërimit ndaj Hyjnisë Zot.

Mbledhje dritëprurëse vërtet, e hyjshme  
nur\* e martirëve, ti lype fort\* Zotin e përm-  
bimirë, falje\* mëkatesh t'na dhurojë  
të gjithëve\* në kohën e kreshmës, vetë-  
përmbytjes pra,\* t'na japë gazin e përjet-  
shëm njësh.

*Nekrosim*

Shërbëtorët e tu, që me shpres' për  
ngjalljen pra\*<sup>16</sup> të përjetshme fjetën, për  
ndriçim\* pa perëndim ti denjësoji\* të  
marrin pjes' në kënaqësi, shijim,\* në jet',  
njeridashës, unik i mirë, Zot\* që frikshëm  
të të madhështojmë ne.

*Hyjlindësor*

O e Tërëshenjtë, e dëlirë krejt, u bë\* mitra  
jote një shtëpi për drit',\*<sup>1b</sup> ndaj besërisht  
thërras drejt teje:\* Ti bebëzat e shpirtit tim  
shndriti fort\* dhe mua që sinqerisht ty të  
lumëroj,\* udhën e drejtë, Zonjë, ma trego.<sup>17</sup>

*Tjetri: Megalinomën se tin mitera*

Le ta kremtojmë, o besëmirë, kujtimin e  
martirëve, që të marrim pjesë në lavdinë  
e tyre duke mburrur çmimet për luftërat  
që bënë.

Burrërinë tuaj e kishin shumë frikë bishat,  
u tërhoq zjarrin, u dërrmuan harka;<sup>18</sup> në ju,  
o athloforë, është i çuditshëm Perëndia.<sup>19</sup>

Lavdi *Triadik*

O natyrë e përbipushtetshme, Njësi tri-



hipostate, Atë, Bir dhe Shpirt i Shenjtë, dritë, jetë, hyjkryesi, ruaji ata që të lavdërojnë.

Tani *Hyjlindësor*

Të bekojmë ty, Perëndinë e Izraelit, që u shfaqe në botë nga Virgjëresha dhe na ngrite bri shpëtimit.<sup>20</sup>

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

O ndërmjetues të botës, athloforë të Krishtit, na denjësoni të gjithë ne që, me përgjërimet tuaja, ta shohim Kryqin e t'i falemi.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

Ata që zhvendosen drejt teje, o Bir i Perëndisë, rregulloji atje ku del burim<sup>21</sup> jete dhe mbikëqyr ndriçimi i fytyrës sate.

*Irmosi: Megalinómën se tin mitera*

»Të madhërojmë ty, nënën e dritës,<sup>1b</sup>  
»dhe të lavdërojmë, o Perëndilindëse e  
»virgjër, se linde Krishtin, Shpëtimtarin e  
»shpirtrave tanë.

*Fotogjiku i Tingullit të javës (2x), duke plotësuar mbarimin e tij kështu: Në të parin: Me ndërmjetimet e shenjtoreve të tu, o Zot. Në të dytin: Me ndërmjetimet e Perëndilindëses, o Zot. Dhe Dërgimësore Nekrosime:*

*O uranón tis astris*

Ti që si Zot sundon krejt\* përmbi sa vdiqën dhe sa rojn',<sup>22</sup> prehi shërbëtorët e tu,\* o Shpëtimtar, në tenda lart\* tok me të zgjedhurit; sado\* fajtuan, s'ikën prej teje.

*Hyjlindësore*

*Ton mathiôn oronton se*

Hyjlindëse, krenohemi fort në ty ne\* dhe pranë Perëndisë të kemi mbrojtje,\* shtrije dorën tënde që s'luftohet dot,\* dërmoji pra armiqtë krejt;\* nga Shenjtërorja dër-

goju\* ndihmë shërbyesve të tu.<sup>23</sup>

*Dhe të tjerat si të Shtunën II të Kreshmëve (fq. 149).*

CITIME

1. II Tim. 4,7
- 1a. Joan 8.46
- 1b. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
- 1c. Ps. 64(65),5
- 1d. Lluk. 16.8; Ef. 5.8; I Thes. 5.5
2. I Kor. 6.20
3. Is. 11.1
4. Rom. 10.10
5. Vep. 3.15
6. Jona 2.2-11
7. Is. 57.15
8. Ef. 2.4
9. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
- 9a. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
10. Ju. 9.5-6; Ps. 134 (135),6; Urt. Sol. 12.18; Mark. 1.40; Hebr. 1.3
11. Tit. 1.2; 3.7
12. Dan. 3.19; kap. 3 Lutja e Azarias 22-23
13. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
14. Sirak 36(33),1
15. Dan. 3.16-18
16. Vep. 23.6
17. Ps. 26(27),11
18. Ps. 36(37),15; 45(46),9
19. Ps. 67(68),36
20. Lluk. 1.69
21. Gjen. 2.6
22. I Petr. 4.5
23. Ps. 19(20),3



E DIELA E TRETË E KRESHMËS SË MADHE,  
E FALJES SË KRYQIT

TË SHTUNËN NË MBRËMËSOREN E VOGËL

*Thirrto*

*Ting. Tërth. II E angeliqë*

Tani ushtritë engjëjlore rreshtohen duke rrethuar me shpësëtarë drurin e respektuar dhe duke i ftuar tok gjithë besimtarët për falje. Ejani, pra, pasi u hijesuan prej kreshmës, t'i gjunjëzohemi me ngazëllim dhe frikë duke thirrur besërisht: Gëzohu, o Kryq i çmuar, siguria e botës. (2x)

Që ta zhdukësh mallkimin e Adamit,<sup>1</sup> ti, o

Jisu i përbimire, merr pa njollë<sup>2</sup> mishin tonë dhe kryqëzohesh, dhe vdes; prandaj Kryqin tënd, heshtën,<sup>3</sup> sfungjerin,<sup>4</sup> kallamin<sup>5</sup> dhe gozhdët i nderojmë besërisht dhe kërkojmë që ta shikojmë ngjalljen tënde.

Gjarpi e mbylli qëmoti Edenin<sup>6</sup> përmes drurit,<sup>7</sup> ndërsa druri i Kryqit e hap përsëri për të gjithë ata që duan të pastrohen me kreshmë dhe lot. E jani, pra, o besnikë, duke e parë para nesh, t'i gënjëzohemi atij me frikë duke thirrur: O Kryq, hap porta qiejsh për ata që kanë mall për ty.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjindësore*  
*E ngjashme*

**K**ur të shihte të mbërthyer në Kryq, o Fjalë e Perëndisë, ajo që të lindi pa farë vajtonte me klithma: Mjerë! O Bir tepër i ëmbël! Ç'është përulesia jote, o Perëndia im? Si ti që nuk pëson, duron pësimin me vendim të padrejtë? E himnoj bashkëzbrictjen tënde të frikshme dhe të skajshme.

*Pasvargje*  
*Ting. II Ikos tu Efrathá*

**M**eqenëse përmes drurit të Kryqit u zgjidhëm nga prangat e dënimit<sup>1</sup> të qëmotshëm, o besimtarë, le ta lavdërojmë Krishtin që u ngul në të.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë, dhe faljuni nënkëmbëzës së këmbëve të tij.

**E**ja tani bashkë me ne, o David, bjeri lirës duke psalur: Lartësoni Krishtin, o besnikë, dhe faljuni nënkëmbëzës së tij.<sup>8</sup>

*Varg:* Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

**L**e ta shohim, o popuj, drurin që është para nesh, me anën e të cilit Krishti na jep shpëtimin, dhe le ta puthim besërisht.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjindësore*  
*I ngjashëm*

**O** Virgjëreshë, kur e shikojë Birin tënd të lartësuar në Kryq për hir të vdekatarëve, thërrisje duke qarë: Lavdi dhembshurisë sate.

*Përlëshore*

**O** Zot, shpëtoje popullin tënd



NË MBRËMËSOREN E MADHE

*Thirrtoje*

*6 ngjallësore dhe 4 të Kryqit:*  
*Ting. Tërth. I Heris askitikon*

**O** Kryq i Zotit, feks dritësim\* prej llamburitjeve të hirit tënd, na shkëlqej\* dhe zemrat; me dashuri mjaft të hyjshme të përfaqojm',\* të nderojmë ty që bota krejt të do;\* zyrtimin dhe lotët tok\* i ke zhdukur; prej kurtheve\* dhe vdekjes, humbjes\* u çliuam, kaluam pra\* në një gaz pa fund;\* hijeshinë e bukuris'\*<sup>9</sup> që disponon, tregoje, dhe shpërblimet për kreshmën ton',\* vetëpërbajtjen, na jep se na ke shërbyes ne, besërisht\* kërkojmë fort mbrojtjen\* me bollëk që ke si dhe përdëllimin tënd të madh.<sup>10</sup>

**G**'zohu, Kryq jetëprurës plot nder;\* Pa-rajs' e bukur shumë për Kishën tonë je;\* o dru i paprishjes, ke lulëzuar për ne shijim\* lavdi të përjetshëm;<sup>11</sup> me ty zmrapsim shpejt\* kolona demonësh pra,\* dhe rreshtimet e engjëjve\* dëfrenjë bashkë\* teksa bëjnë krentrim të madh,\* edhe njerëzit,\* bashkësitë e tyre tok;\* armë e paluftueshme, fuqi e pamposhtur je,\* mbretër të kanë fitore dhe priftërinj mburrje; bëj tani\* që ne të arrijmë\* në pësimin dhe në ngjalljen e Krishtit Perëndi.

**G**'zohu, Kryq jetëmbajtës vërtet,\* që je



trofe i besës, ti që nuk mposhtesh dot;\* dhe der' e Parajsës ti je, mbështetje për çdo besnik,\* mur fortifikimi je rreth Kishës son';\* përmes teje u shfaros\* dhe u zhduk prishja plotësisht,\* dhe u gëlltit prap\* forca e vdekjes përgjithnjë,\* dhe u ngjitem ne\* lart në qiej nga toka posht';\* armë e paluftueshme, armik i demonëve,\* lavd i martirëve dhe zbukurim i krejt oshënarëve,\* liman i shpëtimit,\* që dhuron në botë hir edhe përdëllim të madh.<sup>10</sup>

Dyshe e parabërë dikur,\* që prej zilis<sup>12</sup> së njerivrasësit<sup>13</sup> ratë keq\* prej korit lart nga shijimi i drurit me hidhërim,\* që qëmoti ndodhi prej kënaqësis',\*<sup>7</sup> tash ejani se po del\* dru vërtet me respekt të madh,\* drejt tij vraponi,\* përqafojeni me gëzim,\* thirrni tek ai\* me besim: Ndihma jonë je,\* Kryq i nderuar tepër; ne, si hëngrëm nga fryti yt,\* morëm, arritëm paprishjen dhe të mëparshmin Eden sërisht\* e kemi fituar,\* sigurisht dhe përdëllimin e madh<sup>10</sup> përjetësisht.

Lavdi *Ting. III*

*I Joan Monakut*

**O** Krisht, Perëndia ynë, që denjove kryqëzim vullnetar<sup>14</sup> për ngjalljen e përbashkët të gjinisë së njerëzve, dhe me kallamin e Kryqit,<sup>4</sup> si i përgjake gishtërinjtë e tu me ngjyrë të kuqe, i firmose për ne me njerdashje si mbret amnistitë, mos na shpërfill ne që rrezikojmë përsëri ndarjen prej teje; por ki dhembshuri, o zemërgjerë, për popullin tënd në peripeci dhe ngrihu, lufto kundër atyre që na luftojnë si i tërëfuqishëm.<sup>15</sup>

Tani *Hyjlindësore*

*Dogmatike e Tingullit të javës*

*Në Liti*

*Idhiomeli i parë i kishës*

Lavdi *dhe Tani Ting. Tërth. I*

**Kur** të pa mbarë Krijesa të varur e të zveshur mbi Kryq ty, Bërësin dhe Krijuesin e të gjithave,<sup>16</sup> ndryshohej prej frikës dhe vajtonte. Dielli e fshihte dritën,<sup>17</sup> toka lëkundej, gurët çaheshin,<sup>18</sup> hijesia e Tempullit<sup>19</sup> grisej, të vdekurit ngriheshin nga varret<sup>20</sup> dhe fuqitë e engjëjve habiteshin duke thënë: O sa çudi! Gjykuesi<sup>21</sup> gjykohej dhe pëson me dëshirë për shpëtimin dhe rigatimin e botës.

*Pasvargje ngjallësore*

Lavdi *dhe Tani Ting. IV*

**O** Zot, që bërë aleancë me Davidin tepër të butë, që ta nënshtronte të huajin,<sup>22</sup> lufto bashkë me mbretin tonë shumë besnik dhe me armën e Kryqit fito mbi armiqtë tanë; na trego, o i dhembshur, mëshirat e tua të lashta<sup>23</sup> dhe le të njohim me të vërtetë se ti je Perëndi<sup>24</sup> dhe, duke e pasur në ty shpresën, fitojmë tekta ndërmjeton zakonisht Nëna jote e pacenuar, që të na dhurohet përdëllimi i madh.<sup>10</sup>

*Përlëshore: Ngjallësore*

Lavdi e *Kryqit*

*Ting. I*

**O** Zot, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd,<sup>25</sup> dhuroju shpresëtarëve fitore mbi barbarët dhe ruaje shtetin tënd me anën e Kryqit tënd.\*

Tani *Hyjlindësore*

**Gabrieli** kur të tha, Virgjëreshë, gëzo-hu,<sup>25a</sup> bashkë me zërin mishërohej Zot' i Gjithësisë<sup>25b</sup> te ti arka e shenjtë, siç tha Davidi i drejtë.<sup>25c</sup> U rrëfeve më e gjerë se qiejtë, duke mbajtur krijuesin tënd. Lavdi atij që ndenji te ti. Lavdi atij që lindi prej teje. Lavdi atij që na çliroi me lindjen tënde.\*

## TË DIELËN NË MËNGJESORE

*Shërbesa e zakonshme.**Ndenjësores ngallësore.**Pas Polieleit, Ndenjësores**Ting. Tërth. IV To prostahthën mistikós*

Me dru, armiku më parë në Parajsë\*<sup>7</sup> më zhveshi,<sup>26</sup> solli\* vdekje nga shijimi;<sup>1</sup> një dru,\* Kryqi, solli rrob' jete\* te krejt njerëzia,\* tekta përmbi dhë u ngul; bota mbarë pra\* u mbush tërë gaz; ndaj Kryqin,\* kur e shikojm'\* dhe i falemi, popuj, me besim, me një zë le t'i thërrasim Perëndisë Zot;\* Ti shhtëpinë plot lavd e ke.<sup>27</sup>

Lavdi dhe Tani

*E njëjta*

*(Bekimtores nuk psalen). Ipakoia. Shkallesat. Proqimeni i Tingullit. Psalet vetëm Kanuni i Triodit, i shën Theodor Studitit (me Vargje: në troparin e parë): Lavdi ngjalljes sate të shenjtë, o Zot; në të tjerat: Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty; dhe në dy të fundit: Lavdi dhe Tani. Irmoset si zakonisht pa Vargj. Irmoset që psalen në fillim të Odeve janë të njëjta me Zbritësores.*

*Ting. I**Ode I**Anastáseos imera*

Është ditë panairi, se e kotë u shfaq\* vdekja, agimi lindi me ngritjen e Jisuit Krisht,\* me gëzim Adami që u ngjall, po kërcen,\* me zë të bërtasim ne\* dhe me këngë fituese.

Krejt ju, ejani te Kryqi fort i çmuar, sepse\* dita e faljes së tij pra është, para nesh u vu\* dhe shkëlqim nga ngjallja e Jisuit Zot shndrit;\* tani le ta puthim ne\* të gëzuar në shpirt thellë.

Shfaqu, Kryq i madh i Zotit, ma trego bukurin',\* pamjen hyjnore që ke tani, që denjësisht me nder\* të të falem, se porsi të gjallë të flas\* dhe të përqafoj me mall,\* ti ke forcë dhe përdëllim.

Të himnojnë toka, qielli,<sup>28</sup> me një zë të dy;\* Kryqi i tërëlum është para gjithë neve tash,\* mishërisht në të u ngul si fli Zoti Krisht;\*<sup>29</sup> me gaz shpirtëror atë\* le ta puthim plot dashuri.

Lavdi *Triadik*

O Trini në karaktere, por në pamje Njësi,\* Atë, Bir, Shpirt, Njësi krejt e njëfuqishme në vullnet,\* në vendim dhe në pushtet, pra një kryesi,\* na jep paqe, ruaje\* botën tënde me siguri.

Tani *Hyjlindësor*

E dhe pse, e Virgjër, burrë nuk ke njohur aspak,\* pa farë lind një foshnjë dhe sjell bir pa cen, Krishtin ti,\* Perëndinë, Bërësin e çdo gjëje pra,\*<sup>16</sup> atë lyp që kozmosit\* paqësim t'i dhurojë mjaft.

*Zbritësores në Tingull dhe Irmos të njëjtë sipas Anastáseos imera*

»Moisiu fort i hyjshëm parashfaq i hyjnisht\* Kryqin tënd kur në Detin e Kuq »kaloi popullin,\* Izraelin, dhe kur ujin »ndau me shkop\* dhe këngën për daljen »pra,\* Perëndi Krisht, të psalte ty.<sup>30</sup>

*Ode III**Dhefte poma piomen*

Ejani të psalim këng' të re\*<sup>31</sup> për shfarosjen e Hadhit, të bëjmë panair,\* prej varrit Krishti u ngjall\* dhe vdekjen e vrau, dhe kështu\* shpëtoi Krijesën krejt.

Ejani, besnikë, nxirrni uj\* jo prej guri, i cili pra priset, por burim\* me drit', prej faljes me nder\* të Kryqit të Krishtit Perëndi;\* me të ne po mburremi.<sup>32</sup>



Përqafojmë Kryqin tënd tani\* që pëllëmbët qëmoti të Moisiut, Krisht,\* simbolizonin, dhe ne\* shpëtojm' dhe mendorin Amalik\* e mposhtim<sup>33</sup> me të, o Zot.

Psalmi melodi me plot hare\* kur me buzë e sy të dëlirë dhe me gaz,\* besnik', i falemi ne\* me duartrokijtje dhe me këng'\* shën Kryqit të Zotit Krisht.

#### Lavdi *Triadik*

Në tri hipostaza adhuroj\* dhe nder një Perëndi pa fillim, që s'ndahet hiç\* përmes esencës në form',\* pra Atë, Bir, Shpirt të gjallë tok;,\* në ta u pag'zuam ne.<sup>34</sup>

#### Tani *Hyjlindësor*

O e Thjeshtë, Moisiu pa\* me simbolin qëmoti misterin tënd në ferr';\* s'e dogji barkun tënd hiç\* Hyjnia me zjarrin e saj krejt\* si as flaka ferrën pra.<sup>35</sup>

*Zbritësore sipas Dheste poma piomen*  
»Zot, më siguro me Kryqin tënd\* »përmbi gurin e besës, të mos lëkundem,<sup>36</sup> Krisht,\* mendjen ta kem pa tundim\* prej sulmeve të armikut tmerr,\* »sepse shenjt je vetëm ti.<sup>37</sup>

#### *Ndenjësores Kryqësore*

##### *Ting. Tërth. II*

Kryqi yt, o Zot, u shenjtërua, sepse në të bëhen shërime për ata që sëmuren nga mëkate; përmes tij të biem ndër këmbë; mëshirona.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

Sot u përmbush thënia profetike, sepse ja po falemi në vendin ku qëndruan këmbët e tua, o Zot;<sup>38</sup> dhe, si shijuaam dru shpëtimiti, fituam çlirim prej pasioneve të mëkatit, me anën e ndërmjetimeve të Perëndilindëses, o i vetmi njeridashës.

Lavdi

Vetëm sa u ngul druri i Kryqit tënd, o Zoti Krisht, themelet e vdekjes u tundën, sepse atë që Hadhi e përpiu me dëshirë, e lëshoi me tmerr; na tregove shpëtimitin tënd,<sup>39</sup> o i Shenjtë, ndaj të lavdërojmë; Bir i Perëndisë, mëshirona.

#### Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse e virgjër, përgjëroju Birit tënd, Krishtit, Perëndisë tonë, që u mbërthye vullnetarisht:<sup>44</sup> në Kryq dhe u ngjall prej së vdekurish, që të shpëtohen shpirtat tanë.

#### *Ode IV*

##### *Epi tis thias flagjës*

Një engjëll u thotë grave miropurëse: Ja, u ngjall Krishti, mos qani; shkoni dhe thojuni apostujve:<sup>40</sup> »Gëzohuni, sot erdhi shpëtimiti në botë, tirania e armikut u asgjësua përmes vdekjes".

O Krisht, duke mikpritur sot ngazëllimin e faljes së Kryqit tënd jetëpurës, ecim paraprakisht drejt pësimit tënd të tërëshenjtë që hoqe dhe bëre shpëtimitin<sup>41</sup> e botës, o Çlirimtar, si i tërëfuqishëm.

Sot ka hare në qiell dhe mbi dhé, se shenja e Kryqit i shfaqet sferës, Kryqi i trilumtur; sepse ai, pasi u vu para buron hir të përjetshëm për ata që i falen.

Çfarë të të ofrojmë, o Krisht, që na dhe Kryqin e çmuar që t'i falemi? Në të derdh plotësisht gjaku yt; në të gjithashtu u mbërthye me gozhdë mishi yt; duke e puthur atë tani, ty të falënderojmë.

#### Lavdi *Triadik*

Himnojmë tri hipostaza të një Hyjnie pa ndarje, duke e dogmatizuar Atin në natyrë të thjeshtë, pa fillim, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, një sundim të bashkëfronshëm, një pushtet të përjetshëm bashkëmbretëror.

Tani *Hyllindësor*

Vetëm ti nga gratë, o e Dëlrirë, u dallove si diçka e gjithëçuditshme, gjë e frikshme, sepse e ripërtërite natyrën kur ishe me barrë pa farë dhe mbete prapë e virgjër si më parë; sepse ai që lindi prej teje, është Perëndi i vërtetë.

*Zbritësore sipas Epi tis thias filaqis*

»Sapo të pa mbi Kryq, ndriçuesi i madh »pra ndjeu tmerr,\* dhe i fshehu rre- »zet;<sup>17</sup> dhe çdo gjë,\* Gjithësia, zemërgje- »rësinë tënde, o i Fort',\* plot frikë e lëndoi, »sepse krejt\* i tërë dheu u mbush plot me »himninin tënd.<sup>42</sup>

*Ode V*

*Orthrisomen orthru vatheos*

O Zot, linde si diell prej varrit dhe i shkëlqeve botës dritën e paperënduar, papri-shjen, dhe e pakësove anembanë zym-tësinë e vdekjes, si i dhembshur.

Të pastruar nëpërmjet vetëpërbajtjes, le të shkojmë pranë drurit të tërëshenj-të, ta përqafojmë ngrohtësisht dhe ta himnojmë; në të Krishti, kur kryqëzohej, shpëtonte botën si i dhembshur.

Kërcejnë me ngazëllim rende engjëjsh sot, gjatë faljes së Kryqit; në të, o Krisht, i çave kolonat e demonëve dhe e shpëtove njerëzinë.

Si një tjetër Parajsë, si më parë, u shfaq Kisha, duke pasur dru jetëprurës,<sup>43</sup> Kryqin tënd, o Zot; prej tij marrim pavdekësi nëpërmjet prekjës.

Lavdi *Triadik*

Lavdëro tre të bashkëpafillim, Perëndi të një esence, Atin, Birin dhe Shpirtin, një dritë tejet të trishkëlqyer, mbretëri të njëpushtetshme në Njësi të papërzier.

Tani *Hyllindësor*

Ishe shtatzënë sipas ligjit natyror, por edhe përmbi ligjin, sepse vetëm për ty lindja ishte pa farë, dhe mënyra e lindjes e frikshme edhe kur e mendojmë, edhe kur flasim për të, o e Tërëpaqortueshme.

*Zbritësore sipas Orthrisomen orthru vatheos*

»Si, o Shpëtimtari i botës,<sup>44</sup> me Kryqin »tënd gjetëm paqe, të zgjuar shpejt, që- »menatë,<sup>45</sup> të himnojmë, se me Kryq »gjinin' na e rilinde ti,\* drejt dritës që s'pe- »rëndon na çon.

*Ode VI*

*Katilthes en tis katotias*

U ngrite si dërrmave vdekjen, o Krisht,\* porsì mbret i madh, edhe na rithirre nga arkat e Hadhit, që ta shijojm'\* mbretërinë pra\* qiellore përmbi tokën e pavdekësisë.

Besnikë, t'i trokasim duart me zë\* brohoritjeje dhe këngë të hyjshme drejt Zotit kur puthim Kryqin e tij,\* sepse nxjerr bu- rim\* shenjtërimi për të gjithë sa jemi në botë.

Përmbushet zë shkrimtari kompozitor,\* ja i falemi, i Tërëpushtetshmi Zot, Kryqit fort të nderuar me lavd,\* drurit, plot me mall,\* tmerr, nënkëmbëzës në këmbët e tua<sup>9</sup> të pacen.

I dhembshur, puthim drurin tënd, Kryqin shenjt,\* që e di qarashi midis profetëve, se brenda bukës sate u fut;<sup>46</sup> i himnojmë ne\* prangat, shtizën<sup>3</sup> dhe varrimin, dhe gozhdët e tua.

O Krisht, e përqafojmë Kryqin tënd fort\* dhe fuqi kundër armiqsh të padukshëm ne marrim, meqë pranove mbi sup\* që këtë të shenjt'\* ta mbash,<sup>47</sup> mishin në të ta ngresh dhe të kryqëzohesh.

Lavdi *Triadik*



Himnoj Triadhën që i falemi ne,\* një natyrë dhe Njësi, por me tri karaktere, të tria tok Perëndi,\* dielloren drit\* të trefishtë, Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë.

Tani *Hyjlindësor*

O shqerrë e panjollë, në ty u duk\* mrekullia më e madhe nga krejt mrekullitë, se llinde qengjin që ngre\* fajin botëror;<sup>48</sup> përgjëroju vazhdimisht për sa të përhimnojnë.

*Zbritësore sipas Katilthes en tis katotais*

»Jonai e paraskicoi dikur\* me pëllëmb' »të shtrira shenjë e shenjtit Kryq brenda në bark, në peshkun e madh\* dhe »kërceu jasht'\* me fuqinë tënde, Fjalë, i »gjallë nga bisha.<sup>49</sup>

*Kontaqi Ting, i Rëndë*

Nuk e ruan më shpatë e flaktë portën e Edenit,<sup>6</sup> sepse i erdhi një shuarje paradoksale, druri i Kryqit. Thumbi i vdekjes dhe fitorja e Hadhit u zmbarsën<sup>50</sup> shpejt, ndërsa arrite, o Shpëtimtari im, tek ata që ishin në Hadh duke thirrur: Futuni përsëri në Parajsë.

*Shtëpia*

Tri kryqe nguli në Golgotha Pilati, dy për kusarët dhe një për Jetëdhënësin,<sup>51</sup> të cilin e pa Hadhi dhe u tha të poshtëmve: O shërbyesit e mi dhe fuqitë e mia, kush është ai që më nguli gozhdë në zemër dhe më shpoi befasisht me heshtë druri? Po çahem, kam dhimbje brenda meje, më ther barku dhe shqisat; shpirti im ka mani dhe detyrohem të nxjerr nga goja Adamin dhe ata që dolën nga Adami, të cilët m'u dorëzuan përmes drurit, sepse një dru i fut përsëri në Parajsë.

*Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:*

Në të njëjtën ditë, të Dielën e Tretë të

Kreshmëve, kremtojmë faljen e Kryqit të çmuar dhe jetëbërës.

*Varg:* Dheu i tërë le t'i falet Kryqit,/ përmes të cilit mësoi të të falet ty, Fjalë.

Me fuqinë e tij, o Krisht Perëndi, ruana dhe ne nga ndikimet e dinakut dhe denjësona t'u falemi pësimeve të tua hyjnore dhe ngjalljes jetëprurëse, pasi të tejkalojmë lehtësisht stadiumin dyzetditor; dhe mëshirona si i vetmi i mirë dhe njeridashës.

*Ode VII*

*O Pedhas ek kaminu*

U ngjalle pas tri ditësh nga varri si dikush që fjeti, o Zot, pasi i godite<sup>52</sup> rojat e portave të Hadhit me forcë hyjnore dhe i ngrite stërgjyshërit e vjetër qëmoti ti, i vetmi Perëndi i bekuar dhe i përmbilavdëruar i etërve.<sup>52a</sup>

Duke kërcyer me lirën e këngëve, le të ngazëllohemi sot, o popuj, në faljen e Kryqit, duke e lavdëruar Krishtin që u mbërthye mbi të, të vetmin Perëndi të bekuar dhe të përmbilavdëruar të etërve.<sup>52a</sup>

O i tërëdhembshur, që e tregove mjetin e vdekjes, Kryqin tënd, si punishte jete, të cilin e puth bota, shenjtëroji ata që i falen atij, ti, i vetmi Perëndi i bekuar dhe i përmbilavdëruar i etërve.<sup>52a</sup>

O Jisu, i vetmi përdëllyes dhe i dhembshur, ndriçoji, shenjtëroji ata që i falen besërisht Kryqit tënd dhe pësimeve të hyjshme, ti, i vetmi Perëndi i bekuar dhe i përmbilavdëruar i etërve.<sup>52a</sup>

*Lavdi Triadik*

Himnoj Hyjninë si Njësi në tri hipostaza, sepse dritë është Ati, dritë Biri, dritë Shpirti, ndonëse drita mbetet e pandarë dhe shkëlqen me bashkim natyror dhe me tri reze Personash.

Tani *Hyjlindësor*

Ti je predikimi me shumë epitete i mbarrë profetëve, se u tregove portë Perëndie,<sup>53</sup> shtambë e artë,<sup>54</sup> tokë e shenjtë,<sup>55</sup> o Virgjëreshë hyjnuse, pasi kishe në bark me mish Jisu Krishtin, Perëndinë e përmbilavdëruar të Etërve.<sup>52a</sup>

*Zbritësore sipas O Pedhas ek kamiru*

»Kur mori\* mish dhe erdhi mbi dhë,  
»edhe mbi Kryq u mbërthye keq,\* na  
»dhuroi pra shpëtim ai që në kamin'\* i  
»shpëtoi Tre Djemtë në furrën zjarr,\*<sup>56</sup> i  
»vetmi Zot, Perëndi i bekuar\* edhe me  
»lavd, i etërve.<sup>52a</sup>

*Ode VIII*

*Afti i kliti qe ujia*

“Pse mbani fort në duar mirot? Dhe cilin kërkoni?”, thërret tani i riu që u duk në varr. “U ngjall Krishti<sup>40</sup> dhe Perëndia ynë, pasi e ngjalli natyrën e të vdekshmëve nga shpellat e Hadhit”.

Gëzohu, o Kryq, dru tri herë i lumtur dhe hyjnor, drita e atyre që janë në errësirë;<sup>57</sup> ti që paratregon me shkëlqimin tënd llamburitjet e ngjalljes së Krishtit në të katër cepat e botës, denjësoji të gjithë besnikët të arrijnë në Pashkë.

Në këtë ditë lëshon aromë kutia e hyshme e miros, pra druri i jetës erëkëndshme, Kryqi i Krishtit; le ta nuhatim erën e tij të hyfrymëzuar duke iu falur besërisht në jetë.

Eja, profet Elise, thuaje qartë: “Ç’ishte ai dru që e hodhe në ujë?”. – “Kryqi i Krishtit, nëpërmjet të cilit u tërhoqëm nga thellësia<sup>58</sup> e prishjes sipër duke iu falur atij besërisht në jetë”.

Qëmoti Jakovi, duke paraikonizuar Kryqin tënd, o Krisht, i falej majës së shkopit të hyshëm të Josifit,<sup>59</sup> duke e parashikuar

atë si skeptër të frikshëm të mbretërisë sate; tani i falemi atij besërisht në jetë.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin  
e Shenjtë, Zotin (*Triadik*).

Lavdëroj një esencë me tri karaktere, pa përzier, veç e veç të Tre Personat, dhe nuk pres me pamje Atin, Birin dhe Shpirtin, sepse janë një Perëndi përmbi të gjitha<sup>60</sup> në jetë.

Tani *Hyjindësor*

O Mari hyjnuse, në mes të nënave u tregove e virgjër vetëm ti që linde pa burrë Krishtin Shpëtimtar, pasi e ruajte vulën e dëllirësisë; të lumërojmë ne besëmirët në jetë.<sup>61</sup>

*Zbritësore sipas Afti i kliti qe ujia*

»Kur dikur profeti i madh, Danieli,\* i  
»hedhur në një gropë luanësh, shtriu  
»gjer’ duart\* në tip kryqi, pa cen\* mbe-  
»ti dhe shpëtoi, meqë s’e hëngrën  
»dot;\*<sup>62</sup> bekonte në jetë fort Krishtin, Pe-  
»rëndinë.

*Ode IX*

*Fotizu, fotizu*

Në varr zbritë, Zot jetëdhënës, dhe i theve krejt\* tërë bravat dhe shulat,\* ngjalle pra të vdekurit.\* “Krisht fuqiptot’, Shpëtimtar Perëndi,\* lavd ngjalljes sate!”, ata thërri-snin,\* me ngazëllim brohorisnin fort.

Buroi për mua, Krisht, varri yt një jetë, se,\* te banorët në varre\* kur atje arri-te, ti\* thirre, sundues i jetës, kështu:\* Un’ si shpërblësë për botën erdha,\* ju, të prangosur, krejt zgjidhuni.

Meqë shohin drurin e Kryqit sot të pu-thet mjaft,\* tërë drurët e pyllit\* dhe të ngjashmit me këtë,\* le të kërcejnë me himn, se në të,\* siç paratha mbreti shenjt, Davidi,\* e ngriti lart kokën<sup>63</sup> Zoti Krisht.



Në dru vdiqa, por si dru jete<sup>43</sup> pra të gjeta ty,\* Kryq krishtmbajtës, ndaj rojë\* të pathyeshme të kam,\* kundër demonëve forcë të plot\*,\* sot të thërras un' duke t'u u falur:\* Me lavdin tënd shenjtëromë ti.

O Kisha e Krishtit dhe Perëndisë, ki dëfrim;\* ki gaz duke iu falur\* drurit fort të pasur sot,\* Kryqit të tërëshenjt' dhe zotëror,\* pranë tij rrin' rreshtat engjëllorë\* me frikë dhe i shërbejnë tok.

#### Lavdi *Triadik*

I falem Trinis' në Persona, por në një natyr',\* Shën Hyjnisë, pra Atit,\* Birit dhe të Shenjtit Shpirt;\* jeni ju një kryesi, mbretëri\* që dominon dhe sundon përmbi ne,\* përmbi Krijesën e tërë tok.

#### Tani *Hyjllindësor*

Je mali i madh ku banoi Krishti, Virgjëresh',\* siç të thirri profeti\* shën David,<sup>64</sup> sepse me ty\* ne lart në qiej u ngritëm me gaz,\* teksa nga Shpirti u adoptuam,\*<sup>65</sup> e tërëlum, e kulluar krejt.

*Pas Zbritësoreve, i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor dhe Idhiomele* Hapmi dyert; Drejtomë në rrugët; Unë i mjeri (fq. 10).

Me të nderuarën *Dhe Zbritësorja sipas*

#### *Fotizu, fotizu*

»O nënë e virgjër edhe Hyjllindëse vërtet,\* ti pa farë ke lindur\* Perëndinë tonë »Krisht,\* që mishërisht përmbi Kryq seç u »ngrit,\* ndaj denjësisht krejt ne besimtarët\* të madhështojmë me të tani.

*Dërgimësore ngjallësore dhe të Triodit:*

#### *Tis mathitës sinëlhomen*

E pamë Kryqin zotëror,\* të çmuar para nesh sot,\* t'i falem dhe besërisht\* le të dëfremjë duke\* e puthur me mallëngjim plot\* dhe t'i kërkojmë Krishtit,\* të kryqëzuarit mbi të\* lart me dashje,<sup>14</sup> të na de-

njësoj' krejt ne\* ta nderojm' të çmuarin Kryq me falje,\* në ngjallje të arrijmë tok\* pa qortim që të gjithë.

#### *Hyjllindësore*

Modeste krejt, me besë tash\* i falem i drurit\* ku kish tendosur Biri yt\* duart e tij të pacen,\* kur lart u ngul për ne mbarë;\* paqe ti jepna neve,\* pësimet e nderuara\* shpëtimtare në bot' t'i arrijmë drejt,\* ditës dritëprurëse, kryesore,\* gjithkund gazmore, plot shkëlqim\* t'i falem i, pra Pashkës.

*Lavdërime: 4 ngjallësore dhe 4 të Triodit:*

#### *Ting. IV*

#### *Os jeneon en märtisin*

Përmes odesh të madhërojm',\* me zë të brohorasim<sup>66</sup> fort\* kur e puthim Kryqin e çmuar plot lavdi\* dhe të thërrasim drejt tij: O Kryq i tërënderuar pra,\* me fuqinë tënde ti\* shenjtëro shpirtat, trupat tan';\* si dhe nga dëmtim\* i llojllojshëm që vjen nga kundërshtarët, sa të falen besërisht, ruaji pa plagë, pa trauma. (2x)

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë, dhe faljuni nënkëmbëzës së këmbëve të tij.

Përmes hirit të shenjtit Kryq\* dalin rrjedhat që s'mbrapsen dot;\* si të vini, merrni ju duke parë pra,\* ja mu përpara, hyjnorin dru, burimin e hireve,\* që me ujin, gjakun tok\*<sup>3</sup> prej Sunduesit botëror\*<sup>66a</sup> po vaditet boll;\* sepse Zoti u ngrit vullnetarisht<sup>14</sup> mbi të dhe ngriti vdekëtarët nga poshtë sipër, drejt qiellit.

*Varg:* Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

Përforcimi i mbretërve,\* sigurimi i Kishës Je,\* mburrja murgërore, shpëtimi ti, o Kryq;\* ndaj sot dhe ne, kur të falem i, në zemër, në trup shkëlqejm'\* nëpërmjet hyjnorit Hir\* të atij që në ty u ngul\* dhe

shfarosi krejt\* forcën edhe pushtetin e dinakut tinëzar, dhe zhduku nëmën;<sup>1</sup> o dru, i tërënderuar je.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Zoti i të gjithave na mësoi me parabola ta evitojmë mentalitetin kryelartë të farisenjve shumë të këqij dhe na edukoi të gjithë të mos mendojmë për vete të lartat, në vend që të mendojmë siç duhet.<sup>67</sup> Ai vetë, duke u bërë shembull dhe tip,<sup>68</sup> deri në Kryq dhe vdekje e zbrazi veten;<sup>69</sup> prandaj, duke e falënderuar, së bashku me Doganierin le të themi: Ti që pësove për ne dhe mbete Perëndi pa pësim, çlirona nga pasionet dhe shpëtojti<sup>70</sup> shpirtat tanë.

Tani  
E përmbibekuar

*Dhoksologjia e Madhe (në Tingull "ajia").*

*Pas mbarimit të saj dhe pasi fillon Shenjt Perëndi (Asmatik), prifti, pasi e temjanis Kryqin e çmuar që është mbi një dhisk me lule mbi Tryezën e Shenjtë, e merr sipër kokës, del nga Hierorja dhe, duke paraprirë gjastëkrahëshet, llambadhet dhe temjanicat, e sjell në mes të kishës, ku është rregulluar që më parë një tryezë e vogël katërkëmbëshe. Pasi e rrotullon tri herë rreth saj, thotë me fytyrë nga lindja dhe me zë të lartë: "Urtësi, drejt".*

*Dhe e vendos Kryqin mbi tryezë. Temjanis në formë kryqi duke lëvizur tri herë rreth tryezës dhe duke psalur një herë: O Zot, shpëtoje popullin tënd... që e përsërisin të dyja koret, një herë njëri, një herë tjetri. E lë temjanicën dhe i falet tri herë duke psalur: Kryqit tënd i falemi, o Zot, dhe ngjalljen tënde të shenjtë e lavdërojmë.*

*Kur ai puth Kryqin, e përsërisin himnin të dyja koret, një herë njëri dhe një herë tjetri:*

*dhe në vazhdim e puth populli, ndërsa psalen Idhiomelet, poezi e mbretit Leon:*

*Ting. II*

Ejani, o besnikë, le t'i falemi drurit jetë-bërës, në të cillin Krishti, mbreti i lavdisë, duke i shtrirë duart vullnetarisht,<sup>14</sup> na lartësoi te lumturia e lashtë ne që më parë armiku, duke na vjedhur përmes kënaqësisë,<sup>7</sup> na ka bërë të jemi të internuar larg Perëndisë;<sup>6</sup> ejani, o besnikë, le t'i falemi drurit, nëpërmjet të cilit u denjësuam t'i dërmojmë krerët e armiqve<sup>71</sup> të padukshëm. Ejani, të gjitha fiset e kombeve, ta nderojmë me himne Kryqin e Zotit. Gëzohu, o Kryq, që je çlirimi absolut i Adamit të rënë; më ty mbretërit tanë tepër besimtarë mburren se me forcën tënde nënshtrojnë fuqishëm popull ismailit; të krishterët, duke të puthur tani me frikë, lavdërojnë Perëndinë që u gozhdua në ty, duke thënë: O Zot, që u kryqëzove në të, mëshirona si i mirë dhe njeridashës.

*Ting. Tërth. IV*

Sot, Sundimtari i Krijesës<sup>71a</sup> dhe Zoti i lavdisë<sup>72</sup> ngulet në Kryq dhe shpohet në brinjë;<sup>3</sup> shijon vrer dhe uthull<sup>73</sup> ëmbëlsia e Kishës; vë kurorë gjëmbash<sup>74</sup> ai që mbulon qiellin<sup>42</sup> me re;<sup>75</sup> vishet me mantel talljeje<sup>76</sup> dhe pranon shuplaka prej dore balte<sup>77</sup> ai që me dorë e gatoi njeriun;<sup>78</sup> fshikullohet<sup>79</sup> në shpinë ai që mbështjell qiellin me re;<sup>75</sup> pranon pështyma<sup>80</sup> dhe kamxhikime,<sup>81</sup> poshtërime<sup>82</sup> dhe goditje në zverq,<sup>80</sup> dhe i duron të gjitha për mua të dënuarim çlirimtari dhe Perëndia im, që ta shpëtojë botën nga mashtrimi, si i dhembshur.

Lavdi

Sot, i paafreshmi në esencë, më bëhet i afreshëm dhe pëson të këqija për të më çliruar nga pasionet. Ai që u jep të



verbërve dritë,<sup>83</sup> pështyhet<sup>80</sup> prej buzësh të paudha dhe e jep shpinën në kamxhikime<sup>81</sup> për hir të të robëruarve. Nëna e dëllirë, duke e parë mbi Kryq, fliste dhimbshëm: Mjerë, o Biri im, pse e bërë këtë?! O i bukur me hijeshi më shumë se të gjithë njerëzit,<sup>84</sup> dukesh pa frymë, pa formë duke mos pasur pamje, as stoll.<sup>85</sup> Mjerë, o drita ime! Nuk mund të të shikoj dot duke fjetur; plagosem brenda meje dhe një shpatë e tmerrshme ma tejkalon zemrën;<sup>86</sup> i përhimnoj pësimet e tua, i falem dhembshurisë sate; o Zot, zemërgjerë, lavdi më ty.

Tani *Ting. Tërth. II*  
*Irmologjikisht*

**S**ot u përmbush thënia profetike, sepse ja po falemi në vendin ku qëndruan këmbët e tua, o Zot;<sup>38</sup> dhe, si shijua dru shpëtimit, fituam çlirim prej pasioneve të mëkatit me anën e ndërmjetimeve të Perëndilindëses, o i vetmi njeridashës.

Sot erdhi.

*Në Liturgji, [Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe nga Kanuni i Kryqit Ode III dhe VI, ose Antifonet:]*

*Antifoni i parë*

*Varg a):* U shënua mbi ne drita e fytyrës sate, o Zot.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

*Varg b):* U dhe shenjë atyre që të kanë frikë, që të ikin prej faqe harku.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

*Varg c):* U ngjite në lartësi, robërove robëri, more dhënie në njerëz.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

*Varg d):* U dhe trashëgim atyre që e kanë frikë emrin tënd, o Zot.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Lavdi *dhe* Tani

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

*Antifoni i dytë*

*Varg a):* E panë të gjitha anët e dheut shpëtimin e Perëndisë tonë.

Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, që u ngjalle prej së vdekurish, ne që të psalim. Aliluia.

*Varg b):* Do të hyjmë në tendat e tij, do të falemi në vendin ku qëndruan këmbët e tij.

Shpëtona.

*Varg c):* Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut. Shpëtona.

*Varg d):* Pushoni dhe njihni se unë jam Perëndia; do të lartësohem në kombe, do të lartësohem në tokë.

Shpëtona.

Lavdi *dhe* Tani

O i vetëmlindur Bir.

*Antifoni i tretë*

*Varg a):* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë, dhe faljuni nënkëmbëzës së këmbëve të tij.

O Zot, shpëtoje popullin tënd.

*Varg b):* Shpëtoje, o Perëndi, popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd.

O Zot, shpëtoje popullin tënd.

*Varg c):* Dhe kulloti dhe ngriji ata gjer në jetë.

O Zot, shpëtoje popullin tënd.

*Hyrto* Ejani t'i falemi... që u ngjalle prej së vdekurish. *Pas Hyrjes, Përlëshoret: Ngjallësore, e Kryqit dhe e kishës. Kontakti Përluftshës. Në vend të Trishenjitit, Kryqit tënd i falemi. Liturgjia e Shën Vasilit. Kungatore* U shënua mbi ne drita e fytyrës sate, o Zot. Aliluia. *Në vend të* Pamë dritën,

O Zot, shpëtoje popullin tënd. Emri i Zotit.



NË TË NJËJTËN TË DIEI  
NË MBRËMËSOREN KATANIKTIKE

*Pas Psalmi Nistor (dhe pa Psaltri si në çdo të diel) dhe Paqësoreve, Thirrtoret 10: 4 Kataniktike të Tingullit të javës, 3 të Triodit (të mëposhtmet) dhe 3 të Mujorit.*

*Të Triodit*

*Ting. Tërth. IV Kirie i qe kritirio*

*Poezi e zotit Josif*

Zot, që mbi Kryq vullnetarisht<sup>14</sup> ti pëllëmbët i shtrive, na denjëso, i mir',\* t'i falemi me kataniks, mall\* brenda zemrës ne të shndriturit\* me lutje dhe me kreshmim,\* dhe me bamirësi, virtyt,\* vetëpërbajtje, si njeridashës\* plot me dhembshuri dhe përdëllim.

Shuaje, Zot i dhembshur krejt, ti sasinë e fajit tim sipas dhembshurisë\* që ke me shumic',<sup>87</sup> bëmë mua\* mjaft të denjë ta shoh Kryqin tënd,\* ta përqafoj çiltërisht\* me shpirt në të tanishmen jav'\* me pen-dim dhe vetëpërbajtje,\* si i miri njeridashës, Krisht.

*Tjetër, e zotit Theodor*

*Ting. III Mëjiston thavma*

Çudi e madhe! Shihet druri ku u kryqëzua në mish Krishti. Falet bota dhe, duke u ndriçuar, thërret: Oh! Fuqia e Kryqit! Dhe, kur shikohet, djeg demonë; dhe, kur vizatohet, tregon që flakërohen. Të lumëroj, o dru pa cen, e nderoj, i falemi me frikë dhe e lavdëroj Perëndinë që përmes teje ma dhuron jetën pa mbarim.

*Dhe 3 të Mujorit. Lavdi dhe Tani e tij (Hyjlindësore).*

*Hyrje me temjanicë. O dritë gazmore dhe Proqimeni i Madh:*

*Ting. Tërth. IV*

U dhe trashëgim atyre që e kanë frikë emrin tënd, o Zot.

*Varg:* Nga skajet e tokës thirra drejt teje. U dhe trashëgim...

*Varg:* Do të mbulohem në strehën e kraheve të tu.

U dhe trashëgim...

*Lutja e gjatë (Ektenis):* Le të themi, të gjithë... Bëna të denjë, o Zot... Le ta plotësojmë lutjen tonë....

*Pasvargje Ting. Tërth. IV*

*Idhiomeli*

Unë i mjeri nuk guxoj ta vështroj dot me sy qiellin, për shkak të veprave të mia djallëzore, por, pasi psherëtitva si Doganieri, të thërras: O Perëndi, të të vijë keq për mua mëkatarin dhe nga hipokrizia farisiane<sup>70</sup> çliromë si i vetmi i dhembshur.

*Varg:* Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

*Injëjti*

*Varg:* Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

*Martirik*

O martirë të Zotit, shenjtëroni çdo vend dhe shëroni çdo sëmundje; dhe tani ndër-mjetoni që të çlirohen shpirtat tanë nga kurthet e armikut, lutemi.

Lavdi dhe Tani Hyjlindësore



**Q**ielloret të himnojnë, o nënë e panusëruar hirplote, dhe ne e lavdërojmë lindjen tënde të pagjurmësuar; o Perëndilindëse, ndërmjeto që të shpëtojë shpirtat tanë.

*Dhe shërbesa që mbetet sikundër të Dielën e të Lidhurit të Djathtit (fq. 57).*

### CITIME

1. Gjen. 3.17-19
2. Joan 8.46
3. Joan 19.34
4. Matth. 27.48; Mark 15.36; Joan 19.29
5. Matth. 27.29-30; Mark 15.19
6. Gjen. 3.24
7. Gjen. 3.3-6
8. Ps. 98(99).5
9. Ps. 49(50).2
10. Num. 14.19 etj.
11. II Kor. 4.17; I Petr. 5.10
12. Urt. Sol. 2.23
13. Joan 8.44
14. Joan 10.15,17-18
15. Ps. 34(45).1
16. Sirak 24.8
17. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
18. Matth. 27.51
19. Eks. 26.31-37
20. Matth. 27.52
21. II Tim. 4.8; Jakov 5.9
22. I Mbret. [Sam.] 17.40-51
23. Ps. 88(89).50
24. Ps. 45(46).11; 99(100).3
25. Ps. 27(28).9
- 25a. Lluk. 1.28
- 25b. Urt. Sol. 8.3
- 25c. Ps. 131(132).8
26. Gjen. 3.7
27. Is. 6.1
28. Ps. 68(69).35
29. I Kor. 5.7
30. Eks. 14.15-15.1 etj.
31. Ps. 32(33).3; 95(96).1; 149.1
32. Gal. 6.14
33. Eks. 17.11-13
34. Matth. 28.19
35. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
36. Matth. 7.24-25; Lluk. 6.48
37. I Mbret. [Sam.] 2.2
38. Ps. 131(132).7
39. Ps. 90(91).16
40. Matth. 28.5-7; Mark 16.5-7
41. Ps. 73(74).12
42. Abak. 3.3
43. Gjen. 2.9; 3.22, 24; Apok. 2.7; 22.14,19
44. Joan 4.42; I Joan 4.14
45. Is. 26.9

46. Jer. 11.19
47. Joan 19.17
48. Joan 1.29
49. Jona 2.11
50. Osia 13.14; I Kor. 15.55
51. Matth. 27.38; Mark 15.27; Lluk. 23.33; Joan 19.18
52. Ps. 77 (78). 65-66
- 52a. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
53. Jez. 44.1-4
54. Eks. 16.33; Hebr. 9.4
55. Eks. 3.5
56. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
57. Rom. 2.19
58. IV [II] Mbret. 6.5-6
59. Gjen. 47.31
60. Rom. 9.5
61. Lluk. 1.48
62. Dan. 6.16-18
63. Ps. 109(110).7
64. Ps. 67(68).16-17
65. Rom. 8.15
66. Ju. 14.9
- 66a. Jov 5.8; Urt. Sol. 6.7; 8.3
67. Rom. 12.3
68. I Petr. 2.21
69. Fil. 2.7
70. Lluk. 18.10-13
71. Gjen. 3.15
- 71a. III Makk. 2.2
72. I Kor. 2.8
73. Matth. 27.34
74. Matth. 27.29; Mark 15.17; Joan 19.2,5
75. Ps. 146.8
76. Matth. 27.28; Mark 15.17; Lluk. 23.11; Joan 19.2
77. Matth. 26.67; Mark 14.65; Joan 18.22; 19.3
78. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9; II Makk. 7.23
79. Matth. 27.26; Mark 15.15
80. Matth. 26.67; 27.30; Mark 14.65; 15.19
81. Joan 19.1
82. Matth. 27.29; Mark 15.18; Lluk. 22.63-65; Joan 19.2-3
83. Matth. 11.5; 15.30; 21.14; Lluk. 7.21; Joan 10. 20-21
84. Ps. 44(45).3
85. Is. 53.2
86. Lluk. 2.35
87. Ps. 50(51).3

### TË MËRKURËN E JAVËS SË KATËRT NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve, Ali-luiat dhe Triadiket e Tingullit të javës dhe, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores Kryqësore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores, poezi e zotit Josif.*

*Ting. Tërth. II Elpis tu kosmu agathi*  
**H**ijnorin Kryq që ka plot nder,\* është para për falje,\* vetëpërbajtjen, këtë koh,\* seç po e shenjtëron pra,\* t'i shkojmë afër me ndërgegje të dëlir,\*<sup>1</sup> të nxjerrim shenjtërim dhe dritësim, kështu\* me frikë të thërrasim: Zot,\* lavd dhembshuris' që ke,\* Shpëtimtar njeridashës.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësore*  
**I**sh pranë Kryqit të atij\* që pa farë e lindi,\* sado e pamartuar qe,\* nëna edhe "Bir", thirri,\* "një shpat' tejshepo zemrën tî-me,<sup>2</sup> se s'duroj\* në dru të varur të të shoh ty; dridhet fort\* Krijesa para teje, se\* krijuesi Zot je".\* O zemërgjerë, lavd ty.

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësores, poezi e zotit Theodor.*

*Ting. I Apegnosmenin*  
**T**e veshur ndritshëm me viryete, le të vijnë pasi fituam pastërtinë e kreshmës, dhe le t'i falemi Kryqit të çmuar duke thirrur: Shenjtëroji trupat dhe shpirtrat tanë, na denjëso dhe për pësimin tënd të pacenuar, duke na dhuruar dhe mëshirat e tua, o i vetmi Perëndi i të gjithave.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësore*  
*Ton tafon su sotir*

**K**ur nëna pa qortim\* të shikonte mbi dru ty\* të shtrirë dhe të vdekur, thërriste: Im Bir, je\* i bashkëpafillim me Atin dhe Shpirtin Shenjt, ç'është pra\* ky pësimi yt,\* Ekonomia që s'shprehet?\* Bërjen që me dor\* pa cen e kreve,<sup>3</sup> i dhembshur,\* me të e shpëtove, Krisht.

*Psalmi 50. Prifti thotë uratën e zakonshme: O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën, dhembshurinë dhe... Kanuni dhe Triodet në vendin e tyre. Kanunin e Mujorit e psalim në Pas-*

*darkë.*

*Kanuni i Kryqit që ka Akrostihidhë: "Le t'i falemi drurit të tërërespektuar".*

*Poezi e zotit Theodor*

*Ting. IV*

*Ode I*

*Irmosi: Anikso to stoma mu (fq. 114)*

**N**e drurit të shenjtë ku pëllëmbët Krishti i shtriu lart\* edhe mbi eprorë kundërshtarë korri triumf,\* le t'i falemi\* me kreshm', të hijeshuar,\* për himnin, lavdin' e të tërëpushtetshmit Zot.

**P**o shohim se është para shpëtimtari Kryq; shenjtërim\* na jep, t'i afrohem si të pastrojim' trupin ne\* si dhe zemrën tok,\* kështu që do të nxjerrim\* shpëtim gjithashtu dhe hir' që po buron ai.

**M**e zjarrin e urdhrave të tu, ti, o njeridashës Zot,\* pastrom'; ma jep Kryqin tënd, pësimin tënd shpëtimtar\* që ta shoh tani,\* me mallëngjim t'i falemi,\* të fortifikohem, të ruhem përmes tij pra.

*Kryqhyjlindësor*

**A**jo që të kish në bark, kur ty të varur në kryq të pa,\* fort thirri me klithmë, njeridashës, dhe me vajtim:\* Si shikohet lart,\* i varur, i dënuar\* ky Zoti i lavdit\* që çdokënd do ta gjykoj\*<sup>o</sup>

*Ode III*

*Irmosi: Tus sus innologus (fq. 115)*

**M**e u' kreshme, si pastruam zemrën, me besë ta përqafojmë ne\* drurin e Kryqit, ku u kryqëzua Krishti për çdokënd\* si mirëbërës, ujin e çlirimit, ndjesën buroi' mjaft.

**U**bëmë me krahë me direkun e Kryqit, përshkuam mesin, ja\* gjysmën e pasurisë shpëtimtare mjaft të kreshmës, Zot;\* në portin e pësimit tënd, Jisu Mesi, me të futna ne.



**O** Kryq, të skicoi Moisiu në mal për shfarosje kombesh krejt,\*<sup>8</sup> ne të vijojmë duke të shikuar përmes zemrës son';\* me forcën tënde, kur të falemi, largojmë armiq pa trup.<sup>9</sup>

### *Kryqhyllindësor*

**A**jo që të lindi, thoshte: Sado je Bërësi Zot i Gjithësis',\*<sup>10</sup> vullnetarisht njeri u bëre dhe tani të shoh mbi Kryq\* të varur dhe plagosem brenda zemrës, o Krisht, o Biri im.

### *Triodi, poezi e Josifit Ting. Tërth. II Kiros on panton*

**E**dhe pse për krejt ne je bërës Krisht, Zot,\*<sup>11</sup> mu mes dheut<sup>12a</sup> mbi një Kryq u ngjite, ngrite drejt vetes ti\* dhe esencën e njerëzve që ra\* me një këshill' të keqe armiku;\*<sup>12</sup> ndaj me besë të lëndojmë dhe forcohem me pësimin tënd.

**S**i pastruam shqisat me kreshmë, me drit',\* me mendoret rreze që nga Kryqi, të shkëlqejm' pasurisht,\* shumë, o besimtarë, dhe sot që\* e shohim para shpresëtarisht krejt\* ne me buzë, gojë, zemra të dëlira, me bes' t'i falemi.

**K**u qëndruan këmbët e Krishtit Jisu,\* ne atje t'i falemi<sup>13</sup> të shenjtit Kryq, edhe të kërkojm'\* që, mbi gurin e ligjit zotëror,\* dhe shpirti, këmbët le t'i mbështesë\* dhe në hir hyjnor drejt edhe paqeje<sup>14</sup> t'i drejtojë hapat tan'.<sup>15</sup>

### *Kryqhyllindësor*

**L**inde nga një Vajzë pa burrë, kur trup\* me logjikë dhe shpirt prej saj more, o Krisht; zhduke kështu,\* Zot, armikun me Kryqin tënd dhe prap'\* esencën njerëzore të prishur\* ti e përsërite, ndaj e lavdëron dhembshurinë tënde fort.

### *Triodi tjetër, poezi e Theodorit Ting. I*

#### *Sterëoson Kirie tin eklisian*

**G**jithë skajet e sferës, duartrokisni me himne duke vëzhguar të falurit ndaj drurit në të cilin Krishti u var dhe djalli u plagos.

**S**ot vendoset para jetëprurësi. Ejani t'i falemi me hare dhe me frikë Kryqit të çmuar të Zotit, që të marrim Shpirtin e Shenjtë.<sup>16</sup>

#### *Lavdi Triodik*

**O** diell me tri rreze, dritë me tri lavdi tepër të mëdha, Perëndi, Atë, Bir dhe Shpirt i Shenjtë, natyra dhe lavdia pa fillim, çliroji nga reziqet ata që të himnojnë.

#### *Tani Hyllindësor*

**T**ë himnojnë rende engjëjsh, o Perëndilindëse e bekuar, e tërëhimnuar dhe e virgjër; së bashku me to, ne gjinia e njerëzve të lavdërojmë tani si të panusëruar.

**L**avdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **K**ur erdha që të të prek, o Kryq jetëprurës, m'u drodh gjuha dhe m'u trondit mendja, duke menduar se në ty u derdh gjaku hyjnor i Zotit tim.<sup>7</sup>

#### *Irmosi: Sterëoson Kirie tin eklisian*

»**S**iguroje, o Zot, Kishën tënde që e fitove me fuqinë e Kryqit tënd, sepse me anën e tij triumfove mbi armikun dhe e ndriçove kozmosin.

#### *Ndënjësore Ting. Tërth. II*

**S**ot u përmbush thënia profetike, sepse ja po falemi në vendin ku qëndruan këmbët e tua, o Zot,<sup>13</sup> dhe, si shijuam dru shpëtimiti, fituam çlirim prej pasioneve të mëkatit, me anën e ndërmjetimeve të Perëndilindëses, o i vetmi njeridashës.

#### *Lavdi*

**K**ryqi yt, o Zot, u shenjtërua, sepse në të

bëhen shërime për ata që sëmuren nga mëkate; përmes tij të biem ndër këmbë; mëshirona.

Tani

Vetëm sa u ngul druri i Kryqit tënd, o Zoti Krisht, themelet e vdekjes u tundën, sepse atë që Hadhi e përpiu me dëshirë, e lëshoi me tmerr; na tregove shpëtimin tënd,<sup>16a</sup> o i Shenjtë, ndaj të lavdërojmë; Bir i Perëndisë, mëshirona.

#### Ode IV

*Irmosi: O kathimenos en dhoksi (fq. 116)*

Si me enigmë për tipin e Kryqit, Jakovi i kënduar i tendosi qëmoti duart kryqthi mbi nipërit duke i bekuar<sup>17</sup> dhe duke simbolizuar se bekimi shpëtimtar do të kalojë mbi të gjithë ne.

Duke u ruajtur me vulën e Kryqit, dhe duke e puthur me ngazëllim shpirti këtë Kryq që ndodhet para nesh, le të nxitojmë drejt pësimeve shpëtimtare, pasi t'i vrasim pasionet shkatërruese të mishit.

Ty, armën shpëtimtare, trofeun e pamposhtur, shenjën e gazit, përmes të cilit u vra vdekja, të përqafojmë duke shkëlqyer me lavdinë e atij që u mbërthye në ty, o Kryq i tërërespektuar.

#### Kryqhyllindësor

Nëna e Krishtit thoshte: O Jisu, Biri im, kur more prej meje mish si hua, unë të pushë ty, të paafreshmin për engjëjt; dhe tani vajtoj duke të parë të mbërthyer në dru.

#### Ode V

*Irmosi: Eksesti ta simpanta (fq. 117)*

O Shpëtimtar, jeta dhe çlirimi i të gjithëve,<sup>18</sup> vdiqe kur të ngulën mbi Kryq; bëna që ta përqafojmë me shpirt të pastruar dhe t'i vëzhgojmë duke u ngazëlluar pësimet e tua shpëtimtare.

O dru i dhuruar nga Jeta, rendet e të patrupëve qëndrojnë pranë teje duke u dridhur,<sup>19</sup> sepse në ty Krishti derdhi gjakun<sup>7</sup> e çmuar dhe hoqi njolla të neveritshme gjaku, i cili iu ofrohej demonëve për shkatërrimin e krijimit.

Thërras: Me gjakun tënd, o Fjalë, shëromë mua që u plagosa me shpatën e keqdashësit; dhe me shtizën<sup>7</sup> grise shpejt, Shpëtimtar, dorëshkrimin<sup>20</sup> e mëkateve të mia, duke më regjistruar si i dhembshur në librin e atyre që shpëtojnë.

#### Kryqhyllindësor

O Shpëtimtar, shqerra që të lindi, duke vajtuar dikur me klithma nënore, të thërriste: O bistak i pjekur, si varesh mbi dru? O diell i lavdisë, si u lartësove duke e errësuar dritën e diellit me pësimin tënd?<sup>21</sup>

#### Ode VI

*Irmosi: Evoise protipón (shih në fundin e Odes)*

Kur nguleshe,\* ti banesën e Hadhit e tundje fort,\* dhe u bërë\* bazë e palëkundur për çdo besnik,\* dhe strehim i fortë,\* Kryq i tërënderuar i Zotit Krisht.

Me fryte plot,\* me virtyt, si u bëmë, të vjelim ne\* fryte jete\* nga hyjnorë Kryq, që dolën kur në të\* u tendos Jisu,\* vet' hardhia<sup>22</sup> pjellore me fryte mjaft.

Jisu, himnojm'\* mirësinë që ke me shumicë ti;\* Kryqit, shtizës\*<sup>7</sup> dhe kallamit<sup>23</sup> u falemi, se me to\* ti mesmurin zhduke,\*<sup>24</sup> çarjen, armiqtësinë, i dhembshur fort.

#### Kryqhyllindësor

Të kish në bark\* Virgjërësja, si lum' rrjedhës jete ty,\* si burimin\* që ka nxjerr' rrigatimin ton', se në Kryq\* kur që shtrirë, çurgjet\* e shpëtimtarëve për çdo njeri.



*Irmosi: Evôise protipôn*

»Varrimin tënd\* të triditshëm e para-  
»skiconte qart\* duke thirrur,\* kur në një  
»peshk të madh lutej, o Jisu,\* shën Jona  
»profeti:\*<sup>25</sup> Mbret i forcave,<sup>26</sup> prej prishjes  
»më çliro.<sup>27</sup>

*Kontaqi* Nuk e ruan më shtatë e  
flaktë (fq. 178)

*Ode VII**Irmosi: Uk elátrefran (fq. 118)*

O Krisht, kazma që nxori Eliseu nga Jordani,<sup>28</sup> deklaronte Kryqin, me anën e të cilit i nxore nga fundi i kotësisë kombet që këndonin: O Zot dhe Perëndi i etërve, je i bekuar.<sup>29</sup>

Ngazëllohen qielloret bashkë me tokën në faljen tënde, o Kryq, sepse nëpërmjet teje u bë bashkimi i engjëjve me njerëzit që thërrasin: O Zot, Perëndi i tërëfuqishëm, je i bekuar.

Duke ofruar dhembshuri si qiparis, besim erëkëndshëm si kedër dhe dashuri të vërtetë si pishë,<sup>30</sup> le t'i falemi Kryqit të Zotit, duke lavdëruar Çlirimtarin që u mbërthye në të.

*Kryqhyllindësor*

Perëndia fushoi në mitrën tënde duke mos i tundur qiejt, o qytet i zgjedhur i Perëndisë,<sup>31</sup> ndërsa, kur u var në Kryq, e tundi Krijesën;<sup>21</sup> përgjëroju atij, që të ruhëm në gurin e tij të palëkundur.

*Ode VIII**Irmosi: Pedhas evajis en ti kamino (fq. 119)*

Tendose duart mbi dru, duke asgjësuar mëkat dore të papërmbajtur<sup>32</sup> dhe u shpove me shtizë,<sup>7</sup> duke e plagosur rëndë me të armikun, o Zot; shijove vrer<sup>33</sup> duke shfarosur kënaqësinë e së keqes; të dhanë uthull ty,<sup>34</sup> ngazëllimit të të gjithëve.

Me mendje dhe ndërgjegje të pastër, si t'i afrohem shkëlqyeshëm Kryqit, le t'i falemi; ndodhet para nesh druri i çmuar dhe i nderuar, përmes të cilit Krishti pësoi vdekjen e turpshme, duke u dhënë nder më të madh atyre që u çnderuan frikshëm përmes shkeljes.<sup>32</sup>

Me dru mëkati vdiq dhe me shijim të kënaqshëm<sup>32</sup> u vrava;<sup>35</sup> gjallëromë, o Zot, ngrimë mua që dërgjem, bëmë t'i falemi pësimeve të tua dhe tregomë pjesëmarrës në ngritje hyjnore dhe trashëgimtar bashkë me ata që të duan.<sup>36</sup>

*Kryqhyllindësor*

Virgjëresha e tërëdëlirë thërriste: Të shikoj të lartësuar pa bukuri, pa pamje,<sup>37</sup> për shkak të pësimi ty që, kur trupëzohesh, të njoha shumë më të bukur se bijtë e njerëzve,<sup>38</sup> o Bir i vetëmlindur; tregoje lavdinë tënde, o shpëtimi i të gjithëve.<sup>18</sup>

*Triodi**Ting. Tërth. II Nomon patroon*

O i dhembshur, kur kryqëzohesh vullnetarisht<sup>39</sup> në mes të ditës<sup>40</sup> mes dheut,<sup>11a</sup> i shkëpute skajet e kozmosit nga mesi i laringut të dragoit;<sup>41</sup> ndaj, në javën e mesme të Kreshmëve të hyjshme, duke iu falur Kryqit tënd të çmuar, e lavdërojme duke thirrur: Zotin himnoveni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.<sup>42</sup>

O shenjë hareje, armë e pamposhtur, mur i Kishës, krenari e martirëve, bukuri e apostujve, fuqi e kryepiftërinjve, pasi ta forcosh shpirtin tim të dobësuar, denjësomë që të të falemi dhe të këndoju duke thirrur: Zotin himnoveni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.<sup>42</sup>

Qaj, lotoj dhe vajtoj kur sjell në mendje gjyqin pa korrupsion, o Zemërgjerë, me-

qenëse jam fajtor; ndaj le të të vijë keq për mua<sup>43</sup> dhe lehtësoji prangat e shpirtit tim, që i kam sipër meje, që të thërras i gëzuar: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përbilartësojeni në gjithë jetët.<sup>42</sup>

### *Kryqhyllindësor*

**O** Vajzë e tërëpacenuar, ferra ikonizante misterin përmbi mendje të lindjes sate, sepse si ajo mbete e padjegur,<sup>44</sup> ndonëse linde zjarrin, Krishtin Shpëtimtar, që u lartësua në Kryq; lypi që të çlirohem nga zjarri i amshuar duke thirrur: Zotin himnojeni dhe përbilartësojeni në gjithë jetët.<sup>42</sup>

### *Triodi tjetër*

#### *Ting. I Afti i kliti*

**E**jani ta përqafojmë me mallëngjim Kryqin e Zotit, i cili ndodhet para nesh, pasi të pastrohemi me kreshmë, sepse është thesar shenjtërimi dhe fuqie për ne; përmes tij e përhimnojmë Krishtin në jetë.

**Ky** Kryq i madh me tri pjesë, megjithëse duket i shkurtër, është i gjatë deri në qiej. Me fuqinë e tij i ngre përherë njerëzit drejt Perëndisë; përmes tij e bekojmë Krishtin në jetë.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin (*Triadik*).

**D**uke besuar një esencë në tri karaktere, Atin, Birin dhe Shpirtin, nuk i ngatërroj në një Person të tria, as nuk e ndaj pamjen e saj, se një është Perëndi përmbi të gjitha,<sup>45</sup> ai në Trini.

### *Tani Hyllindësor*

**V**etëm ti u shfaqe e virgjër mes nënash, o Mari hyjnuse, kur linde pa burrë Krishtin Shpëtimtar, i cili e ruajti vulën e dëlirësisë sate; ty të lumërojmë ne besnikët në jetë.<sup>46</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

**Q**ëmoti profeti thirri fort: Të nderohet ky dru i tërëshenjtë, që u vendos në bukën<sup>47</sup> e Krishtit prej izraelitëve që e kryqëzonin. Atë e përbilartësojmë në gjithë jetët.

*Irmosi: Hiras en to lako (Ting. I, sipas Tingullit të Kanunit pikërisht më sipër, si zakonisht)*

»Kur u vu në gropë luanësh i madhi pro-  
«fet\* dikur, i shtriu duart në formë kryqi,  
«ndaj mbeti\* pa dëmtim\* se s'e hëngrën,  
«shpëtoi\* ky shenjtër, Danieli pra.\*<sup>48</sup> Zotin  
«botëror\* e bekonte drejt në jetë.<sup>45</sup>

### *Ode IX*

#### *Irmosi: Apas jjenis (fq. 120)*

**K**ur u shpua brinja jote me shtizë,<sup>7</sup> derdhe ndjesë plot për ne,\* njeridashës, si burim;\* dhe, kur në mes të dheut<sup>11a</sup> u ngule ti,\* dënimin që nga druri e pushove; ndaj puthim,\* mu mes kreshmës,\* përqafojmë Kryqin tënd\* dhe himnojm' mirësin' tënde, o Krisht Zot.

**G**az pikoni plot me mall male, kodra; ëmbëlsi<sup>49</sup> dhe ju, o dru,\* në livadhe; dhe kedra\* përmbi Liban,<sup>50</sup> në mal hidhni valle, pra:\* Sot Kryqit ne i falemi, është jetëprurës ky;\* dhe kërceni,\* o profet', apostuj shenjt',\*me martirë dhe shpirtra të drejtësh tok.

**P**opullit tënd, trashëgimit tënd, jepi shenjë, të himnon me tmerr,\* se për të pësive ti\* me dashje vdekje,<sup>39</sup> ndaj mos e mposhtë dot\* shumica e së keqes sonë mirësin' që ke\* pa fund; krejt ne,\* i mbimirë, na shpëto\* përmes Kryqit tënd si njeridashës Zot.

### *Kryqhyllindësor*

«Me një shenjë e tund fort botën<sup>51</sup> e dukshme gjatë kryqëzimit tënd\*<sup>21</sup> dhe



i varur mbetesh lart", me qarje thoshte Perëndilindësja.\* "Do që mendimet mëkatore t'i zbërthesh, o Krisht,\* fajet që kish\* i parëguatuar;\* t'ia shërosh mirësisht dhe dërrmimin, Zot".

### Triodi

#### Apori pasa glosa

Eliseu qëmoti,\* kur nga lumi po nxirrte\* me një dru kazmën,<sup>28</sup> Kryq, të figuronte ty, dru që dhurove jetën;\* dhe kur Krishti u mbërthye mbi ty, nxori kombet\* nga fundi i manisë, nga idhujt, me ty pra;\* duke t'u falur ty, lavdërojm' pushtetin e tij me gaz.

Shpëtimtar, u shndërrua\* drita, dielli në terr\* në kryqëzimin tënd,<sup>21</sup> u fik me tmerr, o Fjal', ndriçimi nur i hënës,\*<sup>52</sup> u ndryshuan tërë elementet; të thërras ty;\* Mendimet m'i ndriço me të djathtën tënde t'i,\* se jam ndryshuar prej errësire vesesh, shpëtomë, Krisht.

Krisht, me traumën tënde\* m'i shëro<sup>53</sup> veset në shpirt,\* pushojt plagët e demonëve me shpimin keq të brinjës sate,\*<sup>7</sup> kanë dhembk'; zbërtheji me gozhdët e tua epshet,\* orekset mëkatore; më bëj që pa pasion,\* o Zot, pësimi tënd plot respekt dhe ngjalljes t'u falem un'.

#### Kryqhyllindësor

Ty e bukura Vajzë\* të kish lindur të bukur,\*<sup>38</sup> kur në pësimin tënd të shihje ty pa bukuri, pa pamje,<sup>37</sup> thoshte,\* Shpëtimtar, me qarje: Biri im Krisht, më habit fort\* përlësia jote mbi mendje dhe me të\* po e shpëton esencën e njerëzisë që poshtë ra.

#### Tjetri: Fotizu, fotizu

O popull i tërë i Perëndisë, ki gëzim;\* eja puthe me frikë\* drurin, Kryqin që po sheh,\* para nesh është, merr ti gaz, hare,\* mburre gjithnjë Zotin e lavdisë<sup>55</sup> që u

mbërthye, u ngjit në të.

Je arma hyjnore e jetës sime ti, o Kryq;\* si u ngjit në ty, Zoti\* më shpëtoi, ndërsa gjak\* dhe uj' buroi nga brinja e tij\* kur u godit;<sup>7</sup> kur marr prej këtyre,\* kam gaz edhe e lëvdoj atë.

#### Lavdi Triadik

I falem Trinis' në Persona që ka një natyr',\* pra së shenjtës Hyjni, ty\* Atit, Birit, Shpirtit Shenjt;\* një mbretëri që sundon mbi çdo gjë\* dhe një pushtet, autoritet tok,\* ata vet' janë; u japim lavd.

#### Tani Hyllindësor

I madhi mal ku kish banuar Krishti, siç e tha\* me zë mbreti David,<sup>54</sup> shenjt,\* ti je, Zonja Virgjëresh';\* në përmes teje u ngritëm mjaft lart,\* drejt qiejve, kur u birësuam\* nëpërmjet Shpirtit,<sup>55</sup> e tërëlum.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Kryq, skeptër hyjnor pra i mbretit je dhe burrëri\* për ushtrinë; kur kemi\* ne besim te ti, fitojm',\* zmrapsim armiqtë; na jep përgjithnjë\* kundër barbarësh fuqi, fitore,\* ty po të falem me kushtim.

#### Irmrosi sipas Fotizu, fotizu

»O nënë e virgjër, me të vërtet' Hyj-  
«lindëse,\* ti pa farë e linde\* Krishtin,  
«Perëndinë ton',\* që u ngrit përmbi një  
«Kryq trupërisht;\* ndaj denjësisht krejt  
«ne besimtarët\* të madhështojmë me të  
«tani.

#### Fotagojiku i Tingullit të javës dhe

#### Dërgimësore:

#### En Pnëvmati to ierō

Në mes të keshmës krejt i fton\* sa pasionet e tyre\* i zhdukin denjësisht përmes\* çdo pësimi të Krishtit,\* i fortnderuari shën dru\* fton për falje; e jani,\* besnikë të gjithë, dru\* të misterit tërë tmerr\* le t'i fa-

lemi me mall,\* me frikë, devotshmëri tok.

*Kryqhyjlindësore*

**M**e klithma e dëlira fort\* vajz' e panu-sëruar\* dhe nëna e Jisuit Fjal'\* Perëndi, qante, thoshte:\* Të tilla lajme të mira\* gazi, Gabrieli shenjt\* më solli,<sup>56</sup> o Bir? Pra, shko ti\* të zbatosh Ekonomi\* të hyjnueshme, vendim\* të parrëfyeshëm kurrë.

*Pasvargjet e Lavdërimeve  
Ting. Tërth. IV Idhiomeli*

**P**asi arritëm në mes të udhës së Kreshmës, e cila çon drejt Kryqit tënd të çmuar, na denjës me mirëdashjen tënde ne që, të çliuar nga armiku përmes besës, ta soditim ditën tënde, të cilën e pa Abrahami dhe u gëzua,<sup>57</sup> kur të gjallë e mori Isaakun prej mallit<sup>58</sup> si prej varri; dhe të kungohemi nga darka mistike duke thirrur në paqe: O drita dhe Shpëtimtari ynë,<sup>59</sup> lavdi më ty.

*Varg:* U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlmuam dhe u dëfruem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përulë, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt' e tyre.

*I njëjti*

*Varg:* Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji te ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

*Martirik*

**O** martirë të pamposhtur të Zotit, që mundët mashtrimin nëpërmjet fuqisë së Kryqit, e fituat hirin e jetës së amshuar,<sup>60</sup> nuk u frikësuar nga kërcënimet e tiranëve, dëfrenit kur po plagoseshit nga torturat; vetëm me prekjen e pluhurit shëronit shpirtin dhe trupin, si të gjallë, o

përkrahës të nxehtë të besimtarëve.

*Lavdi dhe Tani*

*Idhiomel Ting. Tërth. IV*

**M**e qenëse arritëm në mes të detit të vetëpërmabajtjes, e presim limanin e shpëtimtimit, kohën e pësimtimit tënd vullnetar,<sup>5</sup> o Zot; dhe, si i dhembshur plot simpati, denjësona ta shikojmë në paqe edhe ditën e ngjalljes sate të lavdëruar, o njeridashës.

*Lexuesi:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin etj. si të hënën e javës së parë në mëngjes (fq. 63).

*Në Orën e parë bëhet falja e Kryqit si të dielën. Në orën e Gjashtë (në Trithektë), Tropari i Profecisë:*

*Ting. Tërth. II*

**K**ryqin tënd i falemi, o Zot, dhe ngjalljen tënde të shenjtë e lavdërojmë.

*Lavdi dhe Tani*

*I njëjti*

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 69.

Le të ngazëllohen dhe le të dëfrenjë mbi ty të gjithë ata që të kërkojnë, o Perëndi.

*Varg:* O Perëndi, vër re në ndihmën time.

Këndimi i profecisë së Isaias

(26.21-27.9)

**J**a që Zoti e drejton nga i shenjt i inatin mbi ata që banojnë mbi dhë, dhe do ta zbulojë toka gjakun e saj dhe nuk do t'i mbulojë të vrarët mbi të. Në atë ditë, Perëndia do ta drejtojë thikën e shenjtë dhe të madhe dhe të fuqishme mbi dragoin gjarpër që ikën, mbi dragoin gjarpër të shtrembër dhe do ta vrasë dragoin. Në atë ditë, një vresht i mirë, gjë e dëshirueshme, do të fillojë ndaj saj. "Unë jam qytet i fortifikuar, qytet që rrethohem nga armiq", kot e vadit, sepse do të mposhtet natën, ndërsa ditën do të vithiset muri. S'ka asnjë që nuk e kapi.



"Cili do të më vendosë të ruaj kallam në arë? Për shkak të kësaj armiqësie, e mohova; pra, për këtë i bëri Zot/ të gjitha sa urdhëroi. U dogja rëndë", do të thërrasin ata që banojnë në të, "le të bëjmë paqe me të, le të bëjmë paqe". Ata që vijjnë, fëmijë të Jakovit, do të mbijnë, dhe do të lulëzojë Izraeli, dhe do të mbushet sfera nga fryti i tij. Mos siç goditi ai, kështu dhe do të plagoset ai dhe, siç vrau ai, kështu do të vritet? Duke luftuar edhe duke tallur, do t'i dëbojë. Nuk ishe ti që me shpirtin e ashpër mendoje t'i vrisje ata me shpirt mërie? Prandaj do të hiqet paudhësia e Jakovit; dhe kjo gjë është bekimi i tij, kur unë do ta heq mëkatën e tij, kur do t'i vendosin të gjithë gurët e altarëve, të copëtuar si pluhur i hollë. Dhe nuk do të mbeten pemët e tyre; dhe idhujt e tyre do të jenë të prerë si pyll larg.

Proqimën. Ting. Tërth. II. Psalm 70.

Mbi ty, o Zot, shpresova; le të mos turpërohem në jetë.

*Varg:* Në drejtësinë tënde më çliro dhe më shpëto.



## TË MËRKURËN E JAVËS SË KATËRT NË MBRËMËSORE

### 10 Thirrortë Ting. IV Idhiomeli

**K**reshma, shkaktare e të mirave, arriti tani në mesin e saj pasi na kënaqi në ditët e mëparshme dhe e vuri para dabinë e të mëpasshmeve, sepse zgjatja e të vlefshmeve e bën më të madhe mirëbërjen; ndaj, duke qenë të pëlqyer para Krishtit, dhënësit të të gjitha të mirave, le të thërrasim: Ti që kreshmove<sup>61</sup> për ne

dhe durove Kryq, denjësona të marrim pjesë pa dënim në Pashkën tënde hyjnore duke jetuar me paqe dhe duke të lavdëruar ty bashkë me Atin dhe Shpirtin, siç e meritoni.

### Tjetër Ting. Tërth. I

**A**ta që i praktikojnë shtehtas virtytet, duke pritur shpërblime shpirtërore, nuk i publikojnë në mes të shesheve, por madje i depozitojnë brenda zemrave; dhe ai që sheh veprat e fshehta<sup>62</sup> të të gjithëve, na jep pagën e vetëpërbajtjes; le të kreshmojmë pa zyrtuar fytyrat,<sup>63</sup> por me përgjërëm në dhomat e brendshme të shpirtave,<sup>64</sup> le të thërrasim pa pushim: Ati ynë që je në qiej, mos na shtjer në ngasje, por shpëtona nga i ligu,<sup>65</sup> të lutemi.

### Martirike I njëjti

**M**e predispozicion të pangopur shpirti, nuk e mohuat Krishtin, o martirë të shenjtë; përdërisa duruat tortura të ndryshme, i mposhtët arrogancat e tiranëve; pasi e ruajtët besimin të paepur dhe të pagjymtuar, u zhvendosët në qiej; prandaj, meqë gjetët guxim para tij, kërkoni që t'i dhurojë paqe botës dhe shpirtave tanë përdëllimin e madh.<sup>66</sup>

### Të tjera të Kryqit

#### Ting. I Panëfimi martires

**M**e ujin e kreshmës, gjithë ne\* le t'i lajmë<sup>67</sup> shpirtat tan\* dhe me besim duke ardhur afër, le t'i falemi\* Kryqit të fortçmuar\* me plot nder të Zotit, duke nxjerrë të hyjnueshmin dritësim tanë dhe do fitojm'\* dhe shpëtim përherë,<sup>68</sup> paqe tok\* dhe të madhin përdëllim<sup>66</sup> me mirësi.

**J**e mburrje apostujsh ti, o Kryq,\* të rrethojnë Forcat ty\* me Kryeengjëjt, Pushtetet; sa të falen besërisht,\* nga çdo dëm

çliroji;\* denjësona, mirë ta kalojmë stadiumin e hyjshëm të vetëpërbajtjes tash,\* të arrimj' kështu në shenjtën dit' \* shpëtimtare;<sup>69</sup> ne me të shpëtohem.

### Tjetër

*Ting. i Rëndë Simeron grigori o Iudhas*

**D**uke iu falur Kryqit të Zotit,\* të thërrasim sot: Ki hare,\* o dru jete<sup>70</sup> dhe shkatërrues i Hadhit;\* gaz për botën, ki gaz, shfarosës i prishjes;\* ki hare, shpërdan demonë përmes forcës sate ti;\* për besnikët je mbështetje, armë që s'mposhtet dot;\* sa të puthin – lusim – shenjtëroji dhe ruaji me hirin tënd.

### Dhe katër të Mujorit

Lavdi dhe Tani

*Idhiomel Ting. Tërth. IV*

**S**ot, i paafreshmi në esencë, më bëhet i afreshëm dhe pëson të këqija për të më çliuar nga pasionet. Ai që u jep të verbërve dritë,<sup>71</sup> pështyhet prej buzësh të paudha<sup>72</sup> dhe e jep shpinën në kamxhikime<sup>73</sup> për hir të të robëruarve. Nëna e dëlirë, duke e parë mbi Kryq, fliste dhimbshëm: Mjerë, o Biri im, pse e bërë këtë?! O i bukur me hijeshi më shumë se të gjithë njerëzit,<sup>38</sup> dukesh pa frymë, pa formë duke mos pasur pamje, as stoli.<sup>37</sup> Mjerë, o drita ime! Nuk mund të të shikoj dot duke fjetur; plagosem brenda meje dhe një shpatë e tmerrshme ma tejkalon zemrën;<sup>2</sup> i përhimnoj pësimet e tua, i falem dhembshurisë sate; o Zot, zemërgjerë, lavdi më ty.

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Priifti:* Mbrëmje!

*Lexusi:* Proqimen. Ting. IV. Psalm 71.

Qoftë i bekuar Zoti, Perëndia i Izraelit, i vetmi që bën mrekulli.

*Varg:* O Perëndi, jepi mbretit gjykimin tënd.

### Këndimi i Gjenezës

*(9.18-10.1)*

Bijtë e Noeut që dolën nga arka ishin Simi, Hami dhe Jafethi; dhe Hami ishte ati i Hanaanit. Këta të tre janë bijtë e Noeut, nga këta u bë diaspora mbi tërë dhun. Dhe filloi Noeu, njeri bujk toke, dhe mbolli vresht. Dhe piu nga vera dhe u deh, dhe u zhvesh lakuriq në shtëpinë e tij. Dhe pa Hami, ati i Hanaanit, lakuriqësinë e atit të tij dhe, si doli, lajmëroi të dy vëllezërit e tij që ishin jashtë. Dhe, pasi Simi dhe Jafethi morën rrobën, e mbivendosën mbi dy kurrizet e tyre dhe ecën mbrapsht dhe mbuluan bashkë lakuriqësinë e atit të tyre, dhe fytyra e tyre ishte mbrapsht, dhe nuk e panë lakuriqësinë e atit të tyre. Dhe, pas verës, Noeu u kthjellua dhe njohu sa i bëri biri i tij më i ri; dhe tha: "Qoftë i mallkuar Hanaan; do të jetë shërbëtor, skllav te vëllezërit e tij". Dhe tha: "I bekuar është Zoti, Perëndia i Simit, dhe Hanaan do të jetë shërbëtor, skllav i tij. Le të zgjerojë Perëndia për hir të Jafethit dhe le të banojë në shtëpitë e Simit, dhe Hanaani le të bëhet shërbëtor i tij". Dhe pas përmytjes, Noeu jetoi treqind e pesëdhjetë vjet. Dhe u bënë të gjitha ditët e Noeut nëntëqind e pesëdhjetë vjet, dhe vdiq. Dhe këta janë brezat e bijve të Noeut, Simit, Hamit, Jafethit; dhe atyre iu lindën bij pas përmytjes.

Proqimen. Ting. IV. Psalm 72.

Ndërsa për mua, ngjitja me Perëndinë është e mirë.

*Varg:* Sa i mirë është Perëndia për Izraelin, për të drejtët në zemër!

### Këndimi i Fjalëve të Urta

*(12.23-13.9a)*

**Burri** i mençur është fron ndjeshmërie, ndërsa çdo zemër të pamendësh do të



ndeshet me mallkime. Çdo dorë të zgjedhurish do të mbizotërojë lehtësisht, ndërsa djallëzorët do të plaçkiten. Një fjalë e frikshme e trazon zemrën e një burri të drejtë, ndërsa një lajm i mirë e dëfren. I drejti i mençur do të jetë mik i vetes së tij, ndërsa opinionet e të pabesëve janë të ashpra. Ata që bëjnë mëkate, do t'i ndjekin të këqija, ndërsa udha e të pabesëve do t'i mashtrojë ata. Një djallëzor nuk do të kapë gjah, ndërsa pasje e çmumar është një burrë i çiltër. Në udhë drejtësie ka jetë, ndërsa udhët e atyre që mbajnë mëri, çojnë në vdekje. Një bir i zgjuar është i bindur tek ati, ndërsa një bir i pabindur shkon në zhdukje. Një i mirë do të hajë prej frytësh drejtësie, ndërsa shpirtra të paligjësish do të zhduken para kohe. Ai që e ruan gojën e tij, e ruan shpirtin e tij, ndërsa arroganti me buzë do ta tmerrojë vetveten. Çdo dembel është në dëshira, ndërsa duar trimash janë në zell. Një i drejtë urren çdo fjalë të padrejtë, ndërsa një i pabesë turpërohet dhe nuk do të ketë guxim. Ka nga ata që e pasurojnë veten pa pasur gjë, dhe ka nga ata që e përuhin veten në pasuri të shumtë. Shpërblea e shpirtit të burrit është pasuria e tij, ndërsa një i varfër nuk pëson kërcënim. Te të drejtët ka dritë përherë, ndërsa dritë të pabesësh fiket. Shpirtra djallëzorë enden në mëkate, ndërsa shpirtra të drejtësh iu vjen keq dhe bëjnë lëshoshë.

Le të drejtohet lutja ime dhe shërbesa e të Parashenjësuarave që mbetet.

### CITIME

1. I Tim. 3.9; II Tim. 1.3
2. Lluk. 2.35
3. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9; II Makk. 7.23
4. Tit. 2.11

5. I Kor. 2.8; Jak. 2.1
6. Vep. 17.31; II Tim. 4.1; I Petr. 4.5
7. Joan 19.34
8. Eks. 17.11-13
9. Ef. 6.12
10. Joan 1.3; Kol. 1.16
11. Sirak 24.8
- 11a. Ps. 73(74).12
12. Gjen. 3.4-5
13. Ps. 131(132).7
14. Lluk. 1.79
15. Ps. 39(40).2
16. Vep. 8.15; 10.47; 19.2
- 16a. Ps. 90(91).16
17. Gjen. 48.13-15
18. Vep. 4.12; 13.47; Hebr. 5.9
19. Ps. 88(89).8
20. Kol. 2.14
21. Math. 27.45; Lluk. 23.44
22. Joan 15.1,5
23. Math. 27.48; Mark 15.36
24. Ef. 2.14
25. Math. 12.40
26. Ps. 67(68).13
27. Jona 2.7
28. IV [III] Mbret. 6.6
29. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2.28
30. Is. 60.13
31. Ps. 47(48).2,9
32. Gjen. 3.6
33. Math. 27.34
34. Math. 27.48; Mark 15.36; Lluk. 23.36; Joan 19.29-30
35. Gjen. 3.19
36. Rom.8.17
37. Is. 53.2
38. Ps. 44(45).3
39. Joan 10.15,17-18
40. Math. 27.45; Mark 15.33; Lluk 23.44; Joan 19.14
41. Apok. 12.3 etj.
42. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34 etj.
43. Ne. 13.22
44. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
45. Rom. 9.5
46. Lluk. 1.48
47. Jer. 11.19
48. Dan. 6.16-22
49. Amos 9.13; Joel 3(4).18
50. Ps. 95(96).12
51. Ps. 103(104).32
52. Joel 2.10,31(3,4); 3(4).15; Jez. 32.7
53. Is. 53.5; I Petr. 2.24
54. Ps. 67(68).17
55. Rom. 8.15; Gal. 4.5
56. Lluk. 1.28
57. Joan 8.56
58. Gjen. 22.1-12
59. Ps. 26(27).1
60. Math. 19.16 etj.
61. Math. 4.2; Lluk. 4.2
62. Math. 6.4-5,18
63. Math. 6.16

64. Matth. 6.6  
 65. Matth. 6.9-13; Lluk. 11.2-4  
 66. Num. 14.19 etj.  
 67. Matth. 6.17  
 68. Hebr. 5.9  
 69. Is. 49.8; II Kor. 6.2  
 70. Gjen. 2.9; 3.22-24; Fja.Urt. 3.18; Apok. 2.7; 22.2.14  
 71. Matth. 15.30-31; Lluk. 7.21-22  
 72. Matth. 26.67; 27.30; Mark 14.65; 15.19  
 73. Matth. 27.26; Mark 15.15; Joan 19.1



## TË PREMTEEN E JAVËS SË KATËRT NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve, Aliluait dhe Triadiket e Tingullit të javës dhe, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove Kryqësore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret e zotit Josif.*

*Ting. IV O ipsothis en to stavro*

**Sot** shfaqet Kryqi, dru\* i tërënderuar,\* dhe shenjtëron kohën\* e vetëpërmbajtjes,\* i falemi, thërrasim: Njeridashës Zot, Krisht,\* bëj që, me përkrahjen e këtij,\* ta kalojm' periudhën\* që na mbetet për kreshmim,\* mirë me kataniks, zell,\* pësimin tënd plot jetë ta shikojm',\* jemi çliruar,\* shpëtuar përmes këtij.

*Lavdi dhe Tani Kryqhyjindësore*

**Ajo** që mishërisht\* së fundmi të lindi,\* ty që prej Atit pa\* fillim fare linde,\* kur të pa varur përmbi Kryq, thërriste, o Krisht:\* O Jisu i shtrenjt', i dashur fort,\* kryqëzohesh nga njerëz\* të paligj vullnetarisht\*<sup>1</sup> ti tani, që lëvdohesh\* si Perëndi nga engjëjt; të himnoj,\* ty zemërgjerin\* edhe njeridashësin.

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësove*

*Ting. IV Tahî prokatâlave*

**Meqë,** Krisht, po shohim tash dritën e shpirttrave ne,\* pra Kryqin pa cen, plot gaz

duke iu falur le të thërrasim me hijeshi:\* Lavd ty, Zot, që u ngjite\* përmbi të me dëshirë,\*<sup>1</sup> lavdi ty që ndriçove me të gjithë Krijesën,\* për hir të tij të lëvdojmë pa pushim me himnim.

*Lavdi dhe Tani Kryqhyjindësore*

**Kur** ty nëna jote e pacen të pa përmbi Kryq\* të varur, thërriste me vajtim nënor drejt, o Fjalë e Perëndisë, Zot:\* O sa çudi e huaj,\* e re është, im Bir, kjo?\* Si, jeta e të gjithave,<sup>2</sup> ke lidhje me vdekjen?\* Se do, si i dhembshur, që të ngjallësh të vdekurit.

*Psalmi 50. Prifti uratën e zakonshme: O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën, dhembshurinë dhe... Kanuni dhe Triodet në vendin e tyre. Kanunin e Mujorit e psalim në Pasdarkë.*

*Kanuni i Kryqit që ka Akrostihidhë: "Të gjithë himnojmë drurin të cilit i falemi.*

*Josif". Ting. Tërth. IV*

*Ode I*

*Irmosi: Armatilatin Faraó*

»Qëmoti e përmbyti Faraonin me karrocat çuditërisht\* shkopi moisiak,\* kur në formë kryqi e goditi detin që u nda;\* »Izraelin që ikte më këmbë, ky e shpëtoi »krejt,\* ndaj një këngë psalte për Perëndin'.<sup>2a</sup>

**Shpresëtarisht** me predispozicion dhe mendje të pastruar krejt sot,\* ejani ju afër\* që t'i falemi tok Kryqit zotëror, përpara është,\* dhe dhuron tek ata që i falen, lavd, shenjtërim, shpëtim\* si dhe përdëllim edhe dritësim.

**Jetëdhuruesi** Kryq që po shohim para nesh, lavdi me shkëlqim\* dhe hir rrezaton fort,\* t'i afrohem i të marrim dritësim, hare dhe gaz,\* ndjesë edhe shpëtim, duke sjellë himne me lavdërim\* dhe dhokso-



logji ndaj Jisuit Zot.

Për sa shikojnë, është para pamje fort e huaj, Kryqi plot nder;\* si burim gufon, nxjerr,\* mjaft karizma shpirtërore, fajet i ndërpret, shëron\* dhe sëmundje, forcon mendjet e atyre që sinqerisht\* vijnë pranë tij me shpresëtarë.

Një shkop detprerës<sup>3</sup> e simbolizonte Kryqin dhe trofeun e tij;\* besërisht me të ne\* pa rrezik lundrojm' në ujën e trazuar keq në jet',\* tërë rrymat e fajit i evitojmë dhe mbushemi\* plot me qetësi të hyjnueshme.

#### *Kryqhyjlindësor*

“Shpëtova, Bir, nga dhimbja teksa parrëfyeshëm të lindja<sup>3a</sup> un' ty;\* si tani e tëra\* mbushem plot me dhimbje, se të shoh si kriminel mbi dru\* ty të varur, sado që pa lidhje vare ti tokën, dhen'?!”<sup>4</sup> – thoshte me vajtim e Dëlira krejt.

#### *Ode III*

*Irmosi: O stereosas kat' arhás (shih në fundin e Odes)*

Si dhënës shfaqet shenjtë Kryq,\* na jep të gjitha të mirat\* kur i falemi; Krijesa me plot gaz\* po feston dhe po shkëlqen me hirin, lavdin e atij\* që në të me dëshirë\* është ngritur<sup>2</sup> lart, Perëndisë Zot.

Duke shkëlqyer me ndriçim\* nga llamburitjet e Kryqit,\* nga mëkate, terri, le të shpëtojme,\* duke qenë mes së shenjtës kreshmë, të thërërasim ne:\* O dritë për të gjithë,\* o Zot<sup>5</sup> i dhembshur, lavdi më ty.

Kryq, të himnojmë me besim,\* të përqafojmë, kërkojmë:\* Na çliro me forcën tënde nga kurthet\* e armikut dhe drejtona gjithë ne që të nderojm'\* drejt gjirit të shpëtimit,\* pra drejt limanit me mirësi.

#### *Kryqhyjlindësor*

Teksa të vdekur mbi një Kryq\* e shihite jetën<sup>2</sup> e thjeshta,\* Virgjëresha, nuk duronte dot dhimbjen\* në shpirt thellë, ndaj tronditej dhe thërriste: Biri im,\* – mjerë! – si të shpagoi\* një bashkësi të paligjështy?!

#### *Irmosi: O stereosas kat' arhás*

»Ti që formove në fillim\* me mençuri dhe »mend qiejt,\*<sup>5a</sup> dhe mbi ujëra bazove fort »dheun,\*<sup>5b</sup> më forco mbi gurin,<sup>5c</sup> Krisht, »të porosive që na dhe,\* o njeridashës, »sepse\* veç teje tjetër të shenjtë s'ka.<sup>5d</sup>

#### *Ndenjësore Ting. Tërth. II*

Vetëm sa u ngul druri i Kryqit tënd, o Zoti Krisht, themelet e vdekjes u tundën, sepse atë që Hadhi e përpiu me dëshirë, e lëshoi me tmerr; na tregove shpëtimin tënd,<sup>5</sup> o i Shenjtë, ndaj të lavdërojmë; Bir i Perëndisë, mëshirona.

Lavdi

*E njëjta*

#### *Tani Kryqhyjlindësore*

Sot u përmbush thënia profetike, sepse ja po falemi në vendin ku qëndruan këmbët e tua, o Zot;<sup>7</sup> dhe, si shijuar dru shpëtimi, fituam çlirim prej pasioneve të mëkatit me anën e ndërmjetimeve të Perëndilindëses, o i vetmi njeridashës.

#### *Ode IV*

*Irmosi: Si mu iskiís (fq. 318)*

Streha e fortë dhe rimëkëmbja e njerëzve, arma e pamposhtur e besimit, Kryqi shpëtimtar, ja ku ndodhet para nesh dhe i shenjtëron e i ndriçon me hir zemrat e gjithë atyre që i afrohen me besë.

O njeridashës i përmbimirë, duke qenë përpara dhe mes të gjithëve, gjatë mesit të vetëpërmbajtjes, Kryqi i çmuar, në të cilin u lartësove vullnetarisht<sup>1</sup> në mes të

dheut,<sup>8</sup> e shenjtëron botën kur i falet dhe i dëbon kolonat e demonëve.

Qielli dhe toka mbarë bashkëdëfrenë.<sup>9</sup> Athloforë, martirë, apostuj, shpirtira të drejtësh me hare të thellë tani ngazëllohen, duke soditur drurin jetëdhënës që është në mes dhe para nesh, i cili i shpëton të gjithë dhe i shenjtëron shprespëlotët me hir.

Duke mos i zbatuar ligjet e tua, në i pandërgjegjshmi, o Zot, kam për t'u dënuar kur të vish nga qielli që të gjykosh veprat e njerëzve,<sup>10</sup> prandaj të thërras: Si të më kthesh me fuqinë e Kryqit tënd, shpëtomë duke më dhënë lot pendimi.

#### *Kryqhyllindësor*

“O Bir, të linda prej mitrës virgjërore dhe, duke të parë të varur në dru, çuditëm dhe nuk e kuptoj lartësinë e misterit dhe thellësinë e gjykimeve të tua të shumta!”, thërriste e Tërdëllira. Me zëra të pareshtur e lumërojmë si nënë Perëndie.

#### *Ode V*

#### *Irmosi: Ina ti me aposo (fq. 318)*

Brohorisni, o kombe, këndonit dhe psalnit; o fise, kërcenit për Perëndinë që na dha Kryqin si mbështetje të palëkundur; këshu bëni sa dëfreni tani në kohën e vetëpërbajtjes, duke ushqyer shpirtin dhe mendjen.

Të gjitha ushtritë mendore të rrethojnë, o Kryq i tërëshenjtë; dhe ne të vdekshmit, duke të prekur sot me buzë balte, nxjerrim me mallëngjim shenjtërim dhe bekim, duke e lavdëruar atë që u karfos në ty.

O Zot i dhembshur, shëroji pasionet kronike të shpirtit tim dhe më denjëso t'u falem pësimeve të tua të shenjta, pasi të përmirësohem gjatë kohës së keshmës

dhe të largohem nga të këqijat,<sup>11</sup> o i përbimirië.

#### *Kryqhyllindësor*

Duke parë në Kryq atë që lindi nga mirësia prej teje pëmbi mendje, o e Tërëpaqortueshme, plagoseshe thellë në shpirt dhe thoshe: Vaj, o Bir hyjnor! Si heq dhimbje fort për hir të të gjithëve? I falemi dhembshurisë sate.

#### *Triodi, poezi e Josifit*

#### *Ting. IV Eksesti ta simpanta*

O i vetmi i drejtë, ndriçuesit e fshihnin dritën e tyre kur të shihnin që mbërtheheshe në dru padrejtësisht<sup>12</sup> ti, Zemërgjeri, dhe i ndëshkoje me fuqinë tënde pushtetet e errëta të të ligut.

Le t'i lajmë fytyrat me ujë<sup>13</sup> kreshme dhe le ta përqafojmë drurin në të cilin u lartësua uniku mes të gjithëve, Krishti, i veshur me mish të vdekshëm, që ta vriste<sup>14</sup> atë që na vrau.<sup>15</sup>

Kryq i fortndëruar, mburrje apostujsh, armë athloforësh, lavd priftërinjsh, fortifikim oshënarësh, roja e krejt besnikëve, mbroji, shenjtëroji sa të falen me besë.

#### *Kryqhyllindësor*

Virgjëresha, kur e pa të varur në dru bistakun, hardhinë që lulëzoi, thërriste: O Bir, piko muшт që ta ndalosh dehjen e armiqve që të kryqëzuan kot ty, zemërgjerin me të gjithë.

#### *Triodi tjetër, poezi e Theodorit*

#### *I njëjti Ek niktós orthrizonta*

Sot vendoset para Kryqit yt, një dru jete,<sup>16</sup> i cili meriton t'i falemi; dhe bota, duke e puthur me mallëngjim, ngazëllohet përmes ardhjes së Shpirtit.

Shërbyesit e qiejve, duke soditur Kryqin tënd që është përpara, o Zot, të himnojnë



ty, dhe demonët frikësohen se nuk e durojnë dot pushtetin tënd.

Lavdi *Triadik*

Le ta lavdërojmë orthodhoksisht Trinën: bashkë Atin, Birin edhe Shpirtin e Shenjtë, një Hyjni, Njësi trihipostate.

Tani *Hyjindësor*

Ne besnikët të pohojmë orthodhoksisht ty nënën dhe Virgjëreshën, që kishe parrefyeshëm gjatë shtatzënisë Krishtin, Perëndinë tonë, të vetmin të shumëmeshirshëm.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. O Bir i Perëndisë që u kryqëzove në pishë, kedër dhe qiparis,<sup>17</sup> na shenjtëro të gjithë dhe na denjëso ta shikojmë pësimin tënd jetëprurës.

*Irmosi: Ek niktós orthrizonta*

»O Kryq jetëbërës i Krishtit, mua që ngrihem qëmenatë,<sup>18</sup> mua që të falem me frikë, ndriçomë duke lindur përherë për mua ditë shpëtimtare.<sup>19</sup>

*Ode VI*

*Irmosi: Ilásthiti mi Sotír (shih në fund të Odes)*

Në dhë kur Kryqi u ngul,\* u bë rënia e demonëve. Dhe, kur e shohim tani\* të jetë lavdishëm para nesh dhe e puthim ne,\* ngrihemi nga rënia\* e mëkatit dhe shpëtohem.

Të lartësojmë si mbret,\* si Zot, Krisht, dhe Kryqin që na fale si mur që s'çahet dot\* po e përqafojmë ne mes vetëpërbajtjes pra\* - kjo e hyjshme është -\* puthim Kryqin plot me ngazëllim.

Dhurata mjaft të mëdha\* jep Kryqi i Zotit te të gjithë duke qen' para nesh,\* i dukshëm; o njerëz, bri t'i vijmë, të nxjerrim nur\* dritësim për zemrën\*<sup>20</sup> dhe për shpirtin, hir dhe falje njësh.

*Hyjindësor*

O e Dëlir', na forco\* që nga çdo e keqe të kreshmojmë;<sup>21</sup> nga veprimi dinak,\* i turpshëm, të jemi larg; na jep përgjithnjë fuqi,\* meqë ti je mbrojtja\* e të gjithë njerëzve mbi dhë.

*Irmosi: Ilásthiti mi Sotír*

»Mëkatet që kam, jan' shum',\* ndaj »le të të vijë keq, o Zot, për mua; lutem, »më nxirr\* nga fundi i vrereve, sepse »thirra fort te ti\*<sup>21a</sup> dhe dëgjomë mua,\* »Perëndia i shpëtimit tim.

*Kontaqi* Nuk e ruan më shpatë e flaktë (fq. 178)

*Ode VII*

*Irmosi: Theú singatávasin*

»Dikur zjarri kishte turp\* në Babilonë, »kur bashkëzbriti pra Zot,\*<sup>21b</sup> brenda fu- »rrës; ndaj Djemtë,\* si në lëndinë, me »këmb' të lumura fort\* kërcenin tok duke »psalur: O Perëndi\* dhe Zot i Etërve tanë, »i bekuar je ti.<sup>21c</sup>

Ai që është përtej kohëve, shfaqet pasi veshi mish në kohë dhe, nga mirësia, i shëron pasionet tona kronike në periudhën e vetëpërbajtjes, në të cilën është para ky Kryq hyjnor duke na shenjtëruar.

O Zot, e himnojmë, e lavdërojmë dhe e madhësojmë pushtetin tënd duke iu falur, sepse na e dhe neve, shërbëtorëve të tu, Kryqin hyjnor si shijim të pashtershëm dhe si rojë të shpirtave dhe të trupave tanë.

O Zot, mos më trego si fajtor për të këqijat në ditën e shqyrtimit; mos më hidh të turpëruar larg fytyrës sate,<sup>22</sup> por dhembshuromë dhe shpëtomë me anën e Kryqit tënd të çmuar, si i përbimirë.

Moisiu simbolizonte hirin tënd, o Kryq, kur me dru i ëmbëlsonte ujërat tepër të

hidhura,<sup>23</sup> sepse me fuqinë tënde u çliruan nga hidhërimi i pasioneve; ndaj na ëmbëlso tani që të puthim me mall dhe me kataniks shpirti.

### *Hyjlindësor*

**O** Zonjë, me ndërmjetimin tënd zgjeroje ngushtësinë e mendjes sime, ti që i ngushtove të gjitha marifetet e armikut; dhe më nxirr që të eci përmes udhës së ngushtë<sup>24</sup> drejt zgjerimit të jetës, o nënë Perëndie.

### *Ode VIII*

#### *Irmosi: Eptaplasios káminon*

»E dogji furrën shtatë her\* në Kalde »një tiran i saj\* me mani për Djemtë\* që »nderonin Perëndin';\*<sup>24a</sup> por, kur të shpë- »tuar krejt\* i pa nga një fuqi më e fort',\* »thirri ky kështu;\*<sup>24b</sup> Po Çlirimtarin Ndër- »tues,\* o Djem, ju ta bekonit;\*<sup>21c</sup> priftërinj, »ta himnoni;\*<sup>25</sup> ju popull, lartësojeni pra »për gjithë jetët.

Dikur me dru nxori hekurin nga lumi Eli- seu<sup>26</sup> i hyjnueshëm, që të të parashkruante që nga larg, o Kryq i tërënderuar; sepse, pasi prej fundit të mashtrimit u lartësuam përmes teje drejt besimit të sigurt, sot denjësohemi të të shikojmë dhe të të falemi besërisht, duke vjelë shpëtim.

Jakovi, në bekime, të sinjalizon disi<sup>27</sup> që nga larg tejet fuqishëm, o Kryq i tërënderuar, ndërsa ne që u denjësuam me hir që të të soditim, afrohemi të gjithë me besim pa hezitim dhe, duke të prekur, vjelim bekim të pasur, dritë, shpëtim dhe ndjesë fajesh.

Të veshur me të bardha, me vepra të virtutshme, le të afrohemi të ngazëlluar gjatë mesit të vetëpërbajtjes dhe le ta përqafojmë besërisht Kryqin e Zotit, që, duke ecur mirë me fuqinë e tij, ta mba-

rojmë udhën<sup>28</sup> me gatishmëri të mirë dhe të arrijmë të shkëlqyer në pësimin hyjnor.

### *Triadik*

**D**uke himnuar të gjithë një natyrë të bashkëqenshme, të bashkëpafillim, të bashkëkamshuar, të bashkëfronshme, të thjeshtë, por që ndahet në Persona, Atë të palindur, Bir dhe Shpirt të Shenjtë, esencë të pakrijuar dhe Hyjní, këndojmë: O priftërinj, bekonit;<sup>25</sup> o popull, përmbilartësoni në gjithë jetët.

### *Kryqhyjlindësor*

»Tani që të shikoj të varur si qengj të patëkeq dhe të mbërthyer në Kryq nga të paudhët, o Biri im i parapafillim, vajtoj me therje dhe pushtohem prej dhimbjeve nënore,» thërriste e Tërëkulluara, të cilën e himnojmë me zëra të pareshtur, siç e kemi për detyrë, në gjithë jetët.

### *Tjetri: Pedhas evajis*

**O** Zemërgjerë, Krijesa bashkëpësonte me ty të papësuarin, duke parë pësimin tënd; dielli venitej<sup>22</sup> dhe gurët çaheshin, tërë dheu lëkundej<sup>29</sup> duke thirrur me frikë: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.<sup>30</sup>

**O** Perëndia im i dhembshur, qortoji bishat e tmerrshme të kallamit;<sup>31</sup> më shtrëngojnë brenda meje, o Shpëtimtar Krisht që, duke u goditur me kallam,<sup>32</sup> e durove sharjen e poshtëruar, se preferove t'i nderosh tërë të çnderuarit përmes shkeljes së lashtë.<sup>33</sup>

**K**ur sjell në mendje gjykatën tënde të tmerrshme,<sup>34</sup> o gjykues tepër i drejtë,<sup>35</sup> dridhem dhe shtangem, frikësohem dhe vajtoj, se e kuptoj që veprat e mia e meritojnë gjyqin; prandaj, o Shpëtimtar, shumica e të këqijave të mia të mos fitojë mbi dhembshurinë tënde të madhe.



*Kryqhyjindësor*

«Ndonëse të linda pa dhimbje,<sup>3a</sup> vuaj dhimbje gjatë kryqëzimit tënd; brenda meje flakërohem, sepse je karfosur me gozhdë dhe je shpuar në brinjën tënde,<sup>3b</sup> o Zemërgjerë», thërriste Virgjëresha e tërëdëlirë, të cilën me një zë e përhimnojmë si Perëndilindëse.

*Tjetri: Panta ta erga*

Le të çahen mendërisht malet dhe të burojnë<sup>37</sup> drejtësi, ndërsa kodrat ngazëllohen, duke parë që po i falemi drurit të Kryqit, o Krisht, që të përmbilartësojmë në jetë.

Hiri i Kryqit tënd është i frikshëm, sepse i shporr shpejt kolonat e demonëve, duke u dhënë njerëzve rrjedha shërimesh; prandaj të përhimnojmë, o Krisht, në jetë.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin (*Triadik*).

Le ta përhimnojmë Atin pa fillim dhe Birin tok me Shpirtin e Shenjtë, Trininë e bashkëqenshme, një autoritet dhe Perëndi; duke e himnuar, i psallim në jetë.

*Tani Hyjindësor*

Çdo gjuhë e të dhelindurve të himnon, o Virgjëreshë, se shkëlqeve dritën<sup>5</sup> e pafrueshme<sup>38</sup> që llamburit botën, Krishtin, Perëndinë, që e përmbilartësojmë përherë në jetë.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Ngazëllohen anët e tokës në faljen e Kryqit tënd, o njeridashës; engjëjt në qiej kërcejnë bashkë sot, duke të himnuar me ne, o Krisht, në jetë.

*Irmosi: Panta ta erga*

«Të gjitha veprat e Perëndisë dhe çdo «krijesë bekojeni Zotin,<sup>30</sup> oshënarë dhe «të përulur në zemër, popuj, himnojeni,

«dhe përmbilartësojeni në jetë.<sup>39</sup>

*Ode IX**Irmosi: Eksesti epi tuto o uranós*

«U shtang dhe u shastis qielli me të,<sup>\*39a</sup> «u habitën dhe anët e botës mbar’, se «Perëndi\* trupërisht u duk<sup>39b</sup> të të vdek- «shmit ne\* dhe, Zonjë, barku yt u bë\* më «i gjerë se qiejt, se çdo vend; \* Hyjindëse «e Virgjër,\* rreshtimi engjëllor si\* dhe nje- «rëzor të madhështojnë ty.

Dërrmimin ma shërove,<sup>40</sup> i mirë krejt,\* kur me gozhdë dikur u karfose ti, o tërëmbret,\* Krisht, mbi Kryq në duar dhe këmbë tok,\* në brinjë kur u shpove keq<sup>\*36</sup> dhe të dhanë uthull me vrer ty, Zot,\*<sup>41</sup> o gaz për ne të gjithë,\* lavdi dhe ëmbëlsi, nder,\* çlirimi ynë i përherëshëm<sup>42</sup> je.

Je më i bukur se çdo ar dhe safir,\* dru hyjnor, dhe shkëlqen pors dielli, dhe përgjithnjë\* frikshëm je rrethuar nga Forcat Iart,\* dhe tërësit\* e kozmosit\* i ndriçon me rreze, me vezullim\* prej llamburitjes sate,\* prej forcës sate, o Kryq,\* e cila është e hyjnueshme.

Për sa në dimër janë, Kryqi është port,\* udhëzues, mbështetje të humburish, për Krishtin lavd,\* forcë për apostujt, profetët tok,\* fuqi atletësh, streh’ e shenjt\* për të gjithë njerëzit; ndaj çdokush\* që e shikon shën Kryqin\* që ndodhet mes nesh, para,\* e puth përmes vetëpërbajtjes drejt.

Mbi dhë kur të na vish si gjyqtar, o Zot,\* të gjykos tërë botën që bëre vet’<sup>10</sup> do paraprijn’\* forca dhe ushtri engjëllorë<sup>43</sup> plot,\* dhe Kryqi do shkëlqejë fort,\* më fort se ndriçimet e diellit;\* shpëtomë, dhembshuromë,\* me forcën e tij mua\* që, më shumë se çdokush, fajtova keq.

*Kryqhyllindësor*

“Pa prishje të kam lindur, Biri im, ty\* që nga barku të ka lindur Ati yt para<sup>44</sup> jete,\* si pra njerëz prishës të masakrojnë,\* me shtizë brinjën tënde shpojnë\*,<sup>36</sup> të karfosin duart dhe këmbët tok\* me gozhdë çnjerëzish ty!”, e Fortdëlira thoshte\* me zë; e madhështojmë denjësisht.

*Tjetri: Apas jijenis*

Flakën e mëkatit, o Krisht, e fike me një dru, me Kryqin tënd,\* me dor’ të mbërthyer keq\* ti e çlirove çka kish armiku rob\* në duart e tij, se ky pa vetëpërmbytje hiç\* shtriu duart,\* hëngri frytin<sup>33</sup> që i the,\* veç nga ky të mos hante,<sup>15</sup> mëshirëmadh.

Krisht, na denjëso: Pësimin tënd që buroi papasionshmëri\* te të gjithë njerëzit,\* shpresëtarisht ta shohim sa pa pasion\* nderojmë Kryqin tënd të çmuar dhe mëkatet krejt\* ti shpërfilli,\* bëna bij të ngjalljes<sup>45</sup> ne\* si dhe të së vërtetës, i miri Zot.

Ti me ngjalljen tënde sipër na ngrite ne që ram’ në vdekje keq,\* e shfarose vdekjen krejt\* edhe me Atin tënd na pajtove ne\*<sup>46</sup> kur gjakun tënd e dhe, o mirëbërës; ndaj si Zot\* Perëndi, Krisht,\* të tërëfuqishëm, ty,\* çlirimtar, të lëvdojmë me tmerr dhe mall.

*Hyllindësor*

Lutem: Ti e vetmja që Urtësi enipostate, Perëndin’,<sup>47</sup> mu në bark e kishe pra,\* më urtëso të shmangem prej kurtheve,\* keqdashjes, djallëzisë së atij që shpiku tmerr\* çdo të keqe,\* Vajz’ pa burr’, Hyllindëse,\* strehë plot me fuqi e besnikëve.

*Tjetri: Ton ásponon tokon su*

Kryqin e çmuar që e rrethojnë ushtri engjëjsh, edhe ne, duke iu falur, e madhështojmë.

E madhështojmë drurin e pacenuar, Kryqin e Shpëtimtarit, me anën e të cilit u bëmë pjesëtarë të jetë ne që më parë vdiqëm.<sup>15</sup>

*Lavdi Triadik*

E madhështojmë Atin e pafillim, Birin e bashkëpafillim dhe Shpirtin e bashkëfronshëm, Trininë e Shenjtë.

*Tani Hyllindësor*

O e thjeshtë, të përhimnojmë të gjithë si nënë të panusëruar dhe Virgjëreshë, sepse pa farë e linde Krijuesin.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. O Kryq i Krishtit, ata që u denjësuat të të shikojnë dhe të të përqafojnë, ndihmoji të arrijnë në pësimin e tërëshenjtë.

*Irmosi: Ton ásponon tokon su*

»Birin tënd pa farë, Krishtin, Perëndinë »tonë, o Hyllindëse e pacenuar, pareshtur »me himne e madhështojmë.

*Fotagojiku i Tingullit të javës**Pasvargjet e Lavdërimeve  
Ting. IV Idhiomeli*

O Zot, hetues i së vërtetës dhe njohës i të fshehurave,<sup>48</sup> e dënove Fariseun që mposhte nga lavdidashja e rreme dhe drejtësohej me vepra virtytesh; por e drejtësove Doganierin që qortohej prej tij, dhe lutej me kataniks,<sup>49</sup> të zellshëm për pendimin e tij na trego dhe ne ti, i kryqëzuar, dhe na denjëso për ndjesën si njeridashes.

Varg: U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përulë, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt’ e tyre.

*I njëjti*



*Varg:* Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji te ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

### *Martirik*

**K**ush nuk habitet duke parë, o martirë të shenjtë, luftën e mirë që bëtë?<sup>27</sup> Se, ndonëse ishit me trup, fituat mbi armikun e patrup, kur e pohuat Krishtin<sup>50</sup> dhe u armatosët me kryq; prandaj, denjësisht u treguat dëbues demonësh dhe luftëtarë barbarësh; ndërmjetoni pa pushim që të shpëtojë shpirtat tanë.

### Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

**S**ot, Sundimtari i Krijesës<sup>51</sup> dhe Zoti i lavdisë<sup>52</sup> ngulet në Kryq dhe shpohet në brinjë,<sup>56</sup> shijon vrer dhe uthull<sup>41</sup> ëmbëlsia e Kishës; vë kurorë gjembash<sup>53</sup> ai që mbulon qiellin<sup>53a</sup> me re,<sup>53b</sup> vishet me mantel talljeje<sup>54</sup> dhe pranon shuplaka prej dore balte<sup>55</sup> ai që me dorë e gatoi njeriun,<sup>56</sup> fshikullohet<sup>57</sup> në shpinë ai që mbështjell qiellin me re,<sup>58</sup> pret pështyma<sup>32</sup> dhe kamxhikime,<sup>57</sup> poshtërimë<sup>59</sup> dhe goditje në zverk,<sup>60</sup> dhe i duron të gjitha për mua të dënuarin Çlirimtari dhe Perëndia im, që ta shpëtojë botën nga mashtrimi, si i dhembshur.

*Lexuesi:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin etj., si të hënë e javës së parë në mëngjes (fq. 63).

*Në Orën e Gjashtë (në Tritektë), Tropari i Profecisë.*

### *Ting. Tërth. II*

**K**ryqit tënd i falem, o Zot, dhe ngjalljen tënde të shenjtë e lavdërojmë.

Proqimen. *Ting. Tërth. II. Psalm 77.*

Ai është i dhembshur dhe i vjen keq për mëkatet tona.

*Varg:* Vëri re, o populli im, ligjit tim.

Këndimi i profecisë së Isaias

(29.13-23)

**K**ëto thotë Zoti: "Më afrohet ky popull në gojën e tij dhe më nderon në buzët e tyre, por zemra e tij është shumë larg meje; kot më respekton duke dhënë porosi dhe mësimë njerëzish; prandaj ja, unë do të shtoj ta zhvendos këtë popull dhe do ta shpërngul, dhe do ta shfaros urtësinë e të urtëve, dhe do ta fsheh mençurinë e të mençurve". Mjerë ata që bëjnë thellësisht mendim dhe jo përmes Zotit! Mjerë ata që bëjnë vendim fshehtazi dhe veprat e tyre do të jenë në errësirë dhe do të thonë: "Cili na ka parë? Dhe cili do të na njohë ne ose ato që bëjmë ne?". Nuk do të llogariteni si balta e tjegullarit? Mos do t'i thotë gatimi gatuesit të tij: "Nuk më gatove ti?". Ose bërja bërësit: "Nuk më bëre mençurisht?". Nuk do të zhvendoset në pak kohë Libani si mali Hermel, dhe Hermeli do të llogaritet në pyll? Dhe do të dëgjojnë në atë ditë shurdhe fjalë libri, dhe ata që janë në errësirë dhe sytë në mjegull të të verbërve do të shikojnë; dhe do të ngazëllohen të varfër për Zotin në hare, dhe të dëshpëruar e njerëzve do të mbushen me hare. U zhduk çdo i paligj dhe humbi çdo kryelartë, dhe u shfarosën ata që bënin paligjësi për të keqen, dhe ata që i bënin njerëzit të mëkatonin në fjalë, dhe te të gjithë ata që kontrollojnë nëpër porta, do të vendosin një pengesë, se e çuan tërthoras të drejtën mbi të padrejtët. Prandaj, këto thotë Zoti kundrejt shtëpisë së Jakovit, të cilën e veçoi nga Abrahami: "Nuk do të turpërohet tani Jakovi, as nuk do ta ndryshojë tani fytyrën Izraelit, por, kur t'i shohin bijtë e tyre veprat e mia, falë meje do ta shenjtërojnë emrin tim dhe do ta shenjtërojnë të shenjtin e Jakovit, dhe do ta kenë frikë Perëndinë e Izraelit".

Proqimen. Ting. Tërth. I. Psalm 78.  
Na ndihmo, o Perëndi, Shpëtimtari ynë.  
*Varg:* O Perëndi, erdhën kombe në trashëgiminë tënde.

*Bëhet dhe sot falja e Kryqit pas Përlëshimit të Orëve, njësoj si të dielën. Pastaj hiqet Kryqi i Çmuar.*



### TË PREMTEN E JAVËS SË KATËRT NË MBRËMËSORE

*10 Thirrortë  
Ting. i Rëndë Idhiomeli*

Përderisa ua skllavërova pasioneve ofiqin e shpirtit tim, u bëra si kafshë dhe nuk mund të shoh dot drejt teje, o i Tërë-lartë; por, duke parë poshtë, o Krisht, si Tagrambledhësi lutem duke të thirrur: O Perëndi, le të vijë keq për mua dhe shpëtomë.<sup>49</sup> (2x)

*Pastaj 4 Martirikët e Tingullit të javës dhe 4 të Mujorit. Lavdi Nekrosime, Tani Hyjlinësore po të Tingullit (kërkoji në fund të librit).*

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Prifti:* Mbrëmje!  
*Lexuesi:* Proqimen. Ting. IV. Psalm 79.  
Ti që ulesh mbi Keruvimet, shfaqu.  
*Varg:* Ti që e kullot Izraelin, vër re.

Këndimi i Gjenezës  
(12.1-7)

**Zoti** i tha Abramit: "Dil nga dheu yt dhe nga fisi yt, dhe nga shtëpia e atit tënd, dhe eja në dheun që do të të tregoj; dhe do të të bëj në komb të madh, dhe do të të bekoj, dhe do ta madhëroj emrin tënd, dhe do të jesh i bekuar; dhe do t'i bekoj ata që të bekojnë, dhe do t'i mallkoj ata që të mallkojnë; dhe do të beko-hen në ty të gjitha fiset e dheut". Dhe

shkoi Abramí sikundër i foli Zotí, dhe Lotí hipte dhe shkante bashkë me të. Dhe Abramí ishte shtatëdhjetë e pesë vjeç kur doli nga Harani. Dhe Abramí mori Sarën, gruan e tij, dhe Lotin, birin e vëllait të tij, dhe të gjitha kamjet e tyre, sa fituan, dhe çdo shpirt që e fituan nga Harani dhe dolën që të shkonin në tokën Hanaan. Dhe Abramí e përshkoi tokën në gjerësinë e saj deri në vendin Sihem, mbi velanidhën e lartë, ndërsa hananitët banonin atëherë në tokë. Dhe Zotí iu shfaq Abramit dhe i tha: "Farës sate do t'ia jap këtë tokë". Dhe Abramí ndërtoi atje një altar për Zotin, i cili iu shfaq.

Proqimen. Ting. II. Psalm 80.  
Ngazëllohuni në Perëndinë, ndihmësin tonë.  
*Varg:* Merrni psalm dhe jepni psalm.

Këndimi i Fjalëve të Urta  
(14.15-26)

**Burri** i patëkeq beson në çdo fjalë, ndërsa i zgjuari vjen në pendim. I urti, meqë u frikësua, devijoi nga i keqi, ndërsa i pamendí, duke pasur besim te vetja, përzihet me të paudhin; inatçiu vepron pa u menduar, ndërsa burri i urtë duron shumë. Të pamendët do të ndajnë për veten të keqen, ndërsa të zgjuarit do të zotërojnë ndijim. Të këqijtë do të rrëshqasin para të mirëve dhe të pabesët do të shërbejnë në dyert e të drejtëve. Miq do t'i urrejnë miq të varfër, ndërsa miq të pasurish janë të shumtë. Ai që çnderon të varfër, mëkaton, ndërsa ai që përdëllen të vobektë, është i denjë për lumturim. Të mashtruarit ngrënë të këqija, ndërsa të mirët ngrënë mëshirë dhe të vërtetë. Nuk dinë përdëllim dhe besueshmëri bërës të këqijash, ndërsa lëmoshë dhe besueshmëri ndodhen pranë bërës të mirë. Te kushdo që përkujdeset, ka tepriçë, ndër-



sa i ëmbli apatik do të jetë në varfëri. Kurorë të urtësh do të jetë pasuria e tyre, ndërsa jetesa e të pamendëve do të jetë e keqe. Do të çlirojë një shpirt nga të këqijat një dëshmitar i besueshëm, ndërsa djallëzori ndez gënjeshtër. Në frikë Zoti ka shpresë fuqie; dhe në bijtë e tij lë mbështetje.

**Le të drejtohet lutja ime dhe shërbesa e të Parashenjtuaraqe që mbetet.**

### CITIME

1. Joan 10.15,17-18
2. Joan 1,4; 11.25;14.6; Kol. 3,4; I Joan 1,2; 5,12,20
- 2a. Eks. 14.15-15.21
3. Eks. 14.16-21
- 3a. Is. 66.7
4. Jov 26.7
5. Joan 1,4,9; 3,19; 8,12; 9,5; 12,46
- 5a. Ps.32(33),6
- 5b. Ps. 135(136),6
- 5c. Ps. 39(40),3
- 5d. I Mbret. [Sam.] 2.2
6. Ps. 90(91),16
7. Ps. 131(132),7
- 7a. Joan 1,18
- 7b. II Kor. 8,9
8. Ps. 73(74),12
9. I Kron. 16.31; Ps. 95(96),11; Is. 49.13
10. II Tim. 4,1; I Petr. 4,5; Apok. 20.12-13
11. Jov 2,3; 28,28
12. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
13. Matth. 6.17
14. II Tim. 1.10; Hebr. 2.14
15. Gjen. 2.17; 3.19
16. Gjen. 2.9; 3.22,24; Fja. Urt. 3.18; Apok. 2,7; 22.2,14
17. Is. 60.13
18. Is. 26.9
19. Is. 49.8; II Kor. 6.2
20. II Kor. 4.6
21. Jov 1,1,8
- 21a. Jona 2.2
- 21b. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
- 21c. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,27-28
22. Ps. 50(51),13
23. Eks. 15.23-25
24. Matth. 7.14
- 24a. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 19-22
- 24b. Dan. 3.31-33
25. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
26. IV [II] Mbret. 6,4-6
27. Gjen. 48.14-15
28. II Tim. 4.7 29. Matth. 27.51
30. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
31. Ps. 67(68),31

32. Matth. 27.30; Mark 15.19
33. Gjen. 3.6
34. Dan. 7.9-10
35. Ps. 7.12; II Tim. 4.8
36. Joan 19.34
37. Is. 49.13
38. I Tim. 6.16
39. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 64
- 39a. Jer. 2.12
- 39b. I Tim. 3.16; Kol. 2.9
40. Is. 61.1
41. Matth. 27.34,48; Mark. 15.36; Lluk. 23.36; Joan 19.29
42. Hebr. 9.12
43. Matth. 25.31; Lluk.9.26
44. Ps. 109(110),3
45. Lluk. 20.36
46. Rom. 5.10; II Kor. 5.18
47. I Kor. 1.24
48. Dan. Sosana 42
49. Lluk. 18.10-14
50. Matth. 10.32; Lluk. 12.8
51. III Makk. 2.2
52. I Kor. 2.8
53. Matth. 27.29; Mark 15.17; Joan 19.2-5
- 53a. Abak. 3.3
- 53b. Ps. 146.8
54. Matth. 27.28; Mark 15.17
55. Matth. 26.67; Mark 14.65; Joan 18.22; 19.3
56. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 102(103),14; 118(119),73; 138(139),5; Jov 10.8-9; II Makk. 7.23
57. Matth. 27.26; Mark 15.15; Joan 19.1
58. Ps. 146(147),8
59. Matth. 27.29; Mark 15.18; Lluk. 22.63-65; Joan 19.2-3
60. Matth. 26.67; 27.29; Mark 14.65; 15.18- 20; Joan 19.2



### TË SHITUNËN E JAVËS SË KATËRT NË MËNGJESORE

*Pas Gjashhtë Psalmeve dhe Paqësoreve, psalim në Ting. II*

**Aliluia (3x)**

*Të dytën me Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

**Aliluia (3x)**

*Të tretën me Varg:* Dhe kujtimi i tyre në jetë të jetëve.

**Aliluia (3x)**

*Ting. II*

**O** apostuj, martirë, profetë, hierarkë,

oshënarë dhe të drejtë, që e kryet mirë garën dhe e ruajtët besën,<sup>1</sup> duke pasur guxim para Shpëtimtarit, lutemi, lypini për ne atij që, si i mirë, t'i shpëtojë shpirtat tanë.

Lavdi *Nekrosime*

**K**ujto, o Zot, si i mirë shërbëtorët e tu dhe ndjeji sa mëkatuan në jetë, sepse askush nuk është i pamëkatshëm, përveç teje<sup>2</sup> që mund t'u japësh ngjalljen atyre që u shpërngulën.

Tani *Hyjlindësore*

**O**nënë e shenjtë e dritës<sup>3</sup> së pashprehshme, të madhërojmë duke të nderuar me himne engjellore.

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret Martirike dhe Hyjlindësorja e Tingullit të javës. Pastaj [i Paqortueshmi (Ps. 118) në dy Stanca dhe] Bekimoret Nekrosime (fq. 245 Uratore e Vogël). Prifti: Mëshirona, o Perëndi... etj. O Perëndi i shpirtave dhe i çdo trupi... Pastaj psalti:*

*Ndenjësore Ting. Tërth. I*

**P**rehi, o Shpëtimtari ynë, bashkë me të drejtët shërbëtorët e tu dhe fushoju në avllitë e tua, siç është shkruar,<sup>4</sup> duke mos i vënë re, si i mirë, paudhësitë e tyre të bëra me dashje dhe pa dashje, dhe të gjitha ato me dije dhe pa dije, o njeridashës.

Lavdi

**D**he të gjitha ato me dije dhe pa dije, o njeridashës.

Tani *Hyjlindësore*

**O** Krisht Perëndi, që nga një Virgjëreshë linde si diell për botën, pasi të na shfaqësh me anën e saj bij drite,<sup>5</sup> mëshirona.

*Psalmi 50, Kanuni i Mujorit dhe Tetraodet në vendin e tyre. Lexohen dhe Odet VI, VII, VIII dhe IX biblike.*

*Tetraodi që ka Akrostihidhë: "Himn për martirë".*

*Poezi e zotit Josif.*

*Ode VI*

*Ting. IV*

*En pelaji tu viu*

**T**ejkaluat kushte mishi, o atletë, me durim të madh, duke vuajtur dhimbje ndëshkimi, prandaj lehtësoni çdo dhimbje dhe shtrëngim të atyre që ju përhimnojnë.

**N**jë ushtri atletësh të shenjtë u bashkua me mijëra e mijëra engjëj dhe, meqë e kënaqën Krishtin, i përgjërohen Perëndisë së tërëshenjtë që të na çlirojë nga mijëra e mijëra mëkate të rënda.

*Nekrosim*

**K**ur vdiqe dhe flete në varr, o Krisht, i ngjalle të vdekurit, dhe atyre që vdiqën me besim, ti u shpërndan pasuri mirësie, prehjen së bashku me gjithë shenjtët.

*Hyjlindësore*

**F**jala e Perëndisë, Perëndia, duke kërkuar ta hyjnizojë njeriun, mishërohet prej teje, o e Dëllirë, dhe shfaqet si njeri; lype atë pa pushim që të gjejmë mëshirë<sup>6</sup> në kohën e apologjisë.

*Tjetër, i zotit Theodor*

*I njëjti*

*Ton ptesmaton ti zali*

**M**eqenëse nuk e kursyet mishin dhe gjakun, o shenjtore, qëndruat të pamposhtur para çdo torture, duke mos e mohuar Krishtin; prandaj jua dërgoi kurorat nga qiejt.

**T**ë veshur me vepra të bardha, le ta presim panairin e martirëve dhe le të thërrasim me këngë të hyjfrymëzuara: Me të vërtetë, ju jeni si ylli i mëngjesit mbi dhë, o dëshmorë të Krishtit.



Lavdi *Triadik*

O Trini e Shenjtë, të lavdëroj ty, natyrë pa fillim, një Perëndi dhe Zot, tre Persona, Ati, Biri dhe Shpirti, pra të palindurin, të lindurin dhe të dalin, të njëjtin dhe të amshuarin.

Tani *Hyjindësor*

O Hyjnuse e lumtur, si ke lindur pa burrë dhe ke mbetur si më parë? Sepse linde Perëndi, gjë e frikshme dhe kolosale; kërkoi që të shpëtojë ata që të himnojnë.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

*Martirik*

Duke parë prerjet e gjymtyrëve tuaja, kënaqeshit të ngazëlluar me gjakrat; përgjeroni Zotit vazhdimisht për ne, o martirë të gjithnjënderuar.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

*Nekrosim*

O Zot, që më gatove prej dheut dhe më dhe jetë<sup>7</sup> dhe the të kthehem sërish në dhe,<sup>8</sup> prehi shërbëtorët e tu që i more dhe nxirri nga prishja<sup>9</sup> e vdekjes.

*Irmosi: Ton ptesmaton ti zali*

»Duke u zhytur nga turbullimi i shkeljeve,<sup>10</sup> duke u mbajtur si në barkun »e peshkut të madh, të thërras bashkë<sup>11</sup> me profetin: Nxirre jetën time »nga prishja<sup>9</sup> dhe shpëtomë.

*Kontaqi i Mujorit, nëse ekziston, ndryshe:**Ting. Tërth. IV Os aparhás tis fiseos*

Je mbjellës i Krijesës, Zot, ndaj bota të ofron si fli,\* aparkë ty prej natyrës, martirë shenjt\* hyjmbajtës; përmes lutjeve,\* përgjërimit të tyre, ruaje, i mëshirshëm, në paqe mjaft të thellë Kishën tënde me ndërmjetimet pra të Hyjindësës.

*Dhe (Ting. i njëjtë)*

Bashkë me shenjtoret prehi, o Krisht, shpirtrat e shërbëtorëve të tu, atje ku nuk ka dhembje, as helme, as psherëtimë,<sup>12a</sup> por jetë të pambaruar.\*

*Ode VII**Ti ikoni ti hrisi*

O atletë, pasi e veshët perëndishëm si stoli pavdekësinë përmes zhveshjes së mishit<sup>12</sup> të prishshëm, tani qëndroni me kënaqësi pranë atij që mori mish për ne prej gruaje të paprishur; prandaj më vishni me veshje të hyjnueshme mua që u zhvesha keq.<sup>13</sup>

Bashkësia e athlorëve, pasi u soll me vetëpërmbytje, na përforcon të vrapojmë pa pengesë në stadiumin e vetëpërmbytjes, meqë predikoi burrërisht Krishtin në stadium; dhe, duke qëndruar pranë podiumit, shijon e kurorëzuar mendërisht së bashku me engjëjt.

*Nekrosim*

O Perëndi, me përgjërimit e martirëve të tu të shenjtë, shërbyesit e tu besnikë që fjetën, tregoji qytetarë të Parajsës, dhe denjësoji për dritën mendore ata që të thërrasin pa pushim: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.<sup>14</sup>

*Hyjindësor*

Të përgjeroni ty, së vetmes së mirë, përmirësona ne të keqtrajtuarit, dhe lyp gjithnjë Krishtin, që është i mirë nga natyra, ta përmbushim kohën e vetëpërmbytjes duke bërë të mira dhe duke e himnuar atë.

*Tjetri: O en to ori Moisi*

O Zot, që i madhërove të gjithë shenjtoret e tu dhe i bërë të mrekullueshëm në botë me anën e çudive,<sup>15</sup> je i bekuar në jetë, o Perëndi i etërve tanë.<sup>14</sup>

Pasi tejkaluat çdo lloj torturash dhe nuk u bindët t'i gjuhëzoheshit Baalit,<sup>16</sup> fituat kurora lavdie prej Perëndisë,<sup>17</sup> o martirë të Krishtit.

Lavdi *Triadik*

O Trini, esencë që të falemi në njësi, Atë, Bir dhe Shpirt, ruaji ata që të himnojnë, o Perëndi i etërve tanë.

Tani *Hyjlindësor*

O Zonjë, nënë e virgjër, Vajzë e tërëndritshme, i vetmi ndërmjetim pranë Perëndisë, mos pusho së përgjëruari që të shpëtojme.

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

Kur u mobilizuat për mbretin<sup>18</sup> e pavdekshëm dhe treguat besnikëri të përsosur ndaj tij, e derdhët gjakun tuaj për të, o martirë.

*Varg:* Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mira. Atje pranë, ku buron drita e jetës sate, vendosi shërbëtorët e tu besnikë që i shpërngule nga të përkohshmet, o Zot, Perëndia i etërve tanë.

*Irmosi: O en to ori Moisi*

»Ti që bisedove në mal me Moisiun dhe e »tregove ferrën<sup>19</sup> si simbol të Virgjërshës, »je i bekuar, o Zot, Perëndi i etërve tanë.<sup>14</sup>

*Ode VIII*

*En piri flogos*

O atletë emërmëdhenj të Krishtit dhe të nderuar më Perëndinë, me përgjërimit tuaja të gjata drejt tij, çlirojin nga krimet e mëdha dhe torturat e atjeshme<sup>20</sup> të gjithë ata që i përhimnojnë kujtimet tuaja.

O ushtri e hyjmbledhur dhe vërtet e fortë e Krishtit Perëndi, bashkësi martirësh, me përgjërimit tuaja të shenjta, shenjtë-rojeni mendjen dhe zemrën tonë në këto

ditë të shenjta të kreshmës.

*Nekrosim*

Të gjithë ata që i more me besim, o Zot, çliroji nga krimbi që ndëshkon,<sup>21</sup> nga kërcëllimi i dhëmbëve dhe nga errësira tepër e jashtme<sup>22</sup> pa llamburitje fare dhe renditi atje ku shkëlqen drita e fytyrës sate,<sup>23</sup> o Krisht, në jetë.

*Hyjlindësor*

O Perëndillindëse e dëlirë, pasi pamë Kryqin e çmuar të Krishtit dhe iu falëm nga zemra, me ndërmjetimet e tua pranë Zotit na denjëso t'i shikojmë, të pastruar nga pasionet, edhe pësimet e nderuara.

*Tjetri: Ji qe panta ta en afti*

O shkëmbim tejet i mirë! Me këtë gjetet jetën nëpërmjet vdekjes, o hieromartirë të Krishtit, meqë nuk u tmerruat kurrë nga zjarri, shpatat, të ftohtët dhe egërsirat, dhe thërrisni: Himnojeni dhe përmbilartësojeni Zotin në gjithë jetët.<sup>24</sup>

Sipër kori engjëllor dhe poshtë ne të mbdheshmit, o martirë të Krishtit, himnojmë trimëritë e jashtëzakonshme dhe luftërat e burrërisë suaj, duke e bekuar, duke e himnuar dhe duke e përmbilartësuar Zotin në gjithë jetët.<sup>24</sup>

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin (*Triadik*).

Të adhuroj ty, dritë, një jetë<sup>25</sup> dhe tri jetë, Atin, Birin dhe Shpirtin që del, një natyrë, tri hipostaza, duke i kënduar një Perëndie: Të bekoj, të himnoj ty, Zotin, dhe të përmbilartësoj në gjithë jetët.<sup>24</sup>

Tani *Hyjlindësor*

O pëllumbeshë e panjollë, e dëlirë, cili nga të dhelindurit do të të himnojë? Sepse ti e kishe për ne në shtatzëni dritën e madhe,<sup>3</sup> pasurinë e jetës, Jisuin Shpëtim-



tar; atë e himnojme, duke e mburrur si Zot, dhe e përmbilartësojmë në gjithë jetët.<sup>24</sup>

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

**O** martirë, duke i lavdëruar ndeshjet tuaja të çuditshme, e bekojmë dhe i falemi mirëbërësit Perëndi, që ju përforcoi në stadiumin e ndeshjeve; atë e përmbilartësojmë në gjithë jetët.<sup>24</sup>

*Varg:* Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mira. Ti, përderisa je Zoti dhe Perëndia i vdekjes dhe i jetës, pasi t'i ngresh ata që u zhvendosën besërisht, vëri atje, në tendat e të drejtëve,<sup>26</sup> duke të bekuar, duke të himnuar dhe duke të përmbilartësuar në gjithë jetët.<sup>24</sup>

*Irmosi: Ji qe pante ta en afti*

» Toka dhe të gjitha në të, deti dhe gjithë burimet, qiejt e qiejve, drita dhe »errësira, të ftohtët dhe vapa, bijtë e »njerëzve, priftërinj, bekojeni Zotin edhe »përmbilartësojeni në gjithë jetët.<sup>27</sup>

*Ode IX*

*Oti epiisë mi megalia*

**O** atletë, duke qenë ndriçues të pamashtrueshëm të Krishtit, ndriçojini mendimet tona dhe na forconi që të zbatojmë vullnetet e shkëlqyera dhe të pastra të Perëndisë.

**O** atletë trima të Zotit, dukeni si shpatat që therin fort keqdashësit; na çlironi nga shigjetat e të ligut<sup>28</sup> me mbrojtjet tuaja.<sup>28</sup>

*Nekrosim*

**O** i Dhembshur, prehi në gjirin e Abrahamit<sup>29</sup> shërbëtorët e tu që besërisht u shpërngulën nga ne drejt teje, Krijuesit të çdo gjëje dhe të përmbimirë.

*Hyjlindësor*

**Bëji** të vdekura lëvizjet e mishit tim, ti që linde përmbi mendje në mish Perëndi, dhe jepi ndriçim mendjes sime, o e Dëlirë, meqë je re drite.<sup>30</sup>

*Tjetri: Megalinomen pantes*

**Të gjithë** ne u këndojmë kujtimeve tuaja, o martirë të tërëfamshëm, duke parë arenat e trimërive tuaja të hyjshme dhe, duke u çuditur, e madhërojmë Krishtin.

**Duke** garuar, athloforët i thoshin njëritjetrit: Të mos e kursejmë mishin, ejani të vdesim për Krishtin, që të jetojmë në përjetësi, duke kërcyer pa fund.

*Lavdi Triadik*

**O** Trini, Atë i palindur, Bir i lindur dhe Shpirt që del, ata që të përhimnojnë në një natyrë, ruaji të padëmtuar me mëshirën tënde.

*Tani Hyjlindësor*

**Gëzohu**, e Dëlirë e tërëhjeshtë, krenari e virgjërisë, mbështetje e nënave, ndihmë e njerëzve dhe gëzim i botës, Mari, nënë dhe shërbëtores e Perëndisë<sup>31</sup> tonë.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

**O** kor i shenjtoreve, pranoje lutjen time dhe kërkoi nga Krishti që, siç u denjësova ta puth Kryqin, t'i falem gjithashtu dhe pësimin shpëtimtar.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

**Lëri**, falli, o i Dhembshur, ata që u zhvendosën drejt teje, njeridashësit, dhe prehi në tendat e të drejtëve, se ti je jeta dhe ngjallja.<sup>32</sup>

*Irmosi: Megalinomen pantes*

» **E** madhështojmë të gjithë njeridashjen »tënde, o Zot, Shpëtimtari ynë, lavdia e

»shërbëtorëve të tu dhe kurora e besë-  
»mirëve, që e madhërove kujtimin e lindë-  
»ses sate.

*Pastaj Fotagojiku i Tingullit të javës (2x), duke e plotësuar mbarimin e tij kështu: Në të parin: Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Zot. Në të dytin: Me ndërmjetimet e Perëndilindëses, o Zot. Dhe Dërgimësore Nekrosime:*

*O uranón tis astris*

Ti që si Zot sundon krejt\* përmbi sa vdiqën dhe sa rojnj\*,<sup>33</sup> prehi shërbëtorët e tu,\* o Shpëtimtar, në tenda lart\* tok me të zgjedhurit; sado\* fajtuan, s'ikën prej teje.

*Hyjllindësore*

*Ton mathitón oronton se*

Hyjllindëse, krenohemi fort në ty ne\* dhe pranë Perëndisë të kemi mbrojtje;\* shtrije dorën tënde që s'luftohet dot,\* dërmoji pra armiqtë krejt;\* nga Shenjtërorja dërgoju\* ndihmë shërbyesve të tu.<sup>34</sup>

*Dhe të tjerat si të Shtunën II të Kreshmës (fq. 149).*

**CITIME**

1. II Tim. 4.7
2. Joan 8.46
3. Joan 1.4.9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
4. Ps. 64(65).5
5. Lluk. 16.8; Ef. 5.8; I Thes. 5.5
6. II Tim. 1.18
7. Gjen. 2.7
8. Gjen. 3.19; Jov 10.9
9. Jona 2.7
10. Jona 1.4,10
11. Jona 2.1
- 11a. Is. 35.10; 51.11
12. Kol. 2.11
13. Gjen. 3.7
14. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
15. Ps. 15(16).3
16. III [I] Mbret. 19.18; Rom. 11.4
17. I Petr. 5.4
18. II Tim. 2.3
19. Eks. 3.2-5
20. Lluk. 16.28
21. Mark 9.44,46,48
22. Matth. 8.12; 13.42,50; 22.13; 24.51; 25.30; Lluk. 13.28

23. Ps. 88(89).16
24. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34 etj.
25. Joan 1.4
26. Ps. 117(118).15
27. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28-67
28. Ef. 6.16
29. Lluk. 16.22
30. Eks. 13.21-22 etj.
31. Lluk. 1.38
32. Joan 11.25
33. I Petr. 4.5
34. Ps. 19(20).3



E DIELA E KATËRT  
E ATIT TONË OSHËNAR JOANI I SHKALLËS  
TË SHTUNËN NË MBRËMËSORE

*Thirrtores*

*6 ngjallësore dhe 4 të oshënarit:  
Ting. Tërth. IV O tu paradhoksia  
thávματος*

Atë oshënar Joan, gjithnjë mbaje në gojë vërtet\* lartësimet e Perëndis\*<sup>1</sup> dhe studioje, kryeje\* dhe të hyfrymëzuarat\* fjalë; me hirin që nga andej buron,\* u pasurove, u bëre ti i lum,\* zhdruke, shfarose krejt\* çdo mendim të të gjith' të pabesëve,\* o i tërurti shenjt,\* ndaj të lëvdojmë ne. (2x)

At' hyjmendës plot lavd, o Joan, shpirtin e laje, i lum,\* me burimet e lotëve,\* tërë natën rrije drejt\* dhe në këmbë, e zbutje fort\* Krisht Perëndinë, me krah' u bëre, shenjt,\* për dashurinë dhe bukurin' e tij,\* ndaj denjësisht tani\* po shijon me ngazëllim, hir pa mbarim\* tok me bashkatletët që ti kishe, oshënar.

Atë oshënar Joan, logjikës sate krahë i dhe,\* që të ngrihej drejt Perëndis\* me besim, dhe çdo trazim\* tokësor që s'qëndron, e le,\* e neverite, e more kryqin tënd,\* ndoqe kështu pas<sup>2</sup> Tërëshikuesin,\* trupin



që s'bindet leht',\* e stërvite me ushtrim, ndaj mendjes pra\* e nënshtrove me fuqi nga Shpirti Shenjt, Hyjnor.

*Lavdi Ting. Tërth. I I Studitit*

**O** atë oshënar, sapo dëgjove zërin e Ungjillit të Zotit,<sup>3</sup> e le botën, duke e llogaritur për hiçgjë pasurinë dhe lavdinë; ndaj u thërrisje të gjithëve: "Doni Perëndinë dhe do të gjeni hir të amshuar; mos preferoni asgjë mbi dashurinë e tij, që, kur të vijë në lavdinë e tij,<sup>4</sup> të gjeni prehe<sup>5</sup> bashkë me gjithë shenjtoret".<sup>6</sup> Me përgjërimet e tij, o Krisht, ruaji dhe shpëtoji shpirtat tanë.

*Tani Hyjlindësore  
Dogmatike e Tingullit të javës*

*Pasvargje ngjallësore*

*Lavdi Ting. II*

**Le** ta nderojmë Joanin, engjëllin mbi dhë, njeriun e Perëndisë në qiej, stolinë e kozmosit, shijimin e të mirave dhe të virtyteve, mburrjen e asketëve; sepse, i mbjellë në shtëpinë e Zotit, lulëzoi drejtësisht; dhe, si kedër në shkretëtirë, i shumëfishoi<sup>7</sup> grigjat e deleve të logjikshme të Krishtit me oshënarit dhe drejtësi.<sup>8</sup>

*Tani Hyjlindësore*

**O** çudi e re mbi gjithë çuditë qëmoti, se cili njohu nënë të ketë lindur pa burrë dhe të mbajë në pëqil atë që përmban tërë krijesën? Është vullnet Perëndie ai që lindi, të cilit, o e gjithëpastër, meqë e mbajte në krahët e tu si foshnjë dhe meqë ke guxim përpara tij si nënë, mos pusho së luturi për ata që të nderojnë që të na mëshirojë dhe të shpëtojë shpirtat tanë.\*

*Përlëshoret: ngjallësore dhe e oshënarit  
Ting. Tërth. IV*

**Me** lot të derdhur si rrëke, shkretëtirën e

thatë e vadite për lërim, dhe me vajtim dhe psherëtim', gjer njëqind herë pemë mblo dhe<sup>9</sup> për çdo mundim; u shfaqe pra si yll, dhe e ndriçove botën<sup>10</sup> me çdo çudi, Joan i shenjtë, atë dhe oshënar, lutju Zotit Krisht Perëndi, të shpëtohen shpirtat tanë.\*

*Lavdi dhe Tani Hyjlindësore*

**Ti** që linde për ne prej Virgjëreshës dhe durove kryqëzim, o i mirë, që plaçkove vdekjen me vdekje dhe rrëfeve ngjalljen si Perëndi, mos i zhvështro ata që gatove me dorën tënde, trego njeridashjen tënde, o mëshirëplot'. Prit Hyjlindësen që të lindi, të ndërmjetojë për ne dhe shpëto, o Shpëtimtari ynë, një popull të dëshpëruar.\*



**NË MËNGJESORE**

*Shërbesa e zakonshme.*

*Kanunet: Ngjallësori në 4, Kryngjallësori në 2, i Triodit në 4 dhe i oshënarit në 4.*

*Ode I*

*Kanuni i Triodit*

*Ting. Tërth. I To sotiri Theo*

**Me** atë, Krisht, që ra\* në dorë kusarësh po ngjaj;\* pors i vdekur\* nga goditjet tmerr\* që lënë,<sup>11</sup> Shpëtimtar, kështu jam i plagosur keq\* dhe unë për shkak të mëkateve që bëra.

**Po** thërriste me vaj:\* "Mos më shpërfill, Shpëtimtar,\* jam mjaft sëmurë\* sepse humba pra,\* Zot, pasurinë tënde<sup>12</sup> ndër kusarë"; edhe un'\* kështu përgjerohem, shpëtomë, i dhembshur fort.

**Më** shpëto, Shpëtimtar,\* si shumëpërdëllimtar,\* Krisht, dhe shëromë,\* i goditur jam\* në mendje nga mëkatet dhe

nga fshikullimet keq,\* nga vjedhës<sup>11</sup> të padrejt', mendimet dinake mjaft.

### *Hyjlindësor*

**N**dërmjeto pa pushim\* te Perëndia që kurr\* s'iku prej gjirit\* atëror,<sup>13</sup> sado\* u mishërua nga ti, Nën' pa cen e Krishtit Zot,\* dhe lyp t'i shpëtojë sa bëri, nga çdo mjerim.

### *Kanuni i oshënarit*

#### *Poezi e Ignatit.*

#### *Ting. Tërth. IV Igrán dhiodhefsas*

**M**e lutjet e tua drejt Zotit Krisht\* fexsmë si lart rende te ndriçimi pa lënd', mendor,\* oshënar Joan, kur u largove\* nga errësira që ka çdo material.

**K**ur thithe si qumësht ti ëmbëlsin'\* e vetëpërbajtjes, zbrapse helmin e epsheve,\* ndaj kënaq, o atë, shqisat tona\* më fort se mjalti dhe hojet,<sup>14</sup> o shën Joan.

**K**ur mbi lartësin' e virtyteve\* hipe, oshënar, at' shenjt, përbuze kënaqësit'\* mjaft të poshtra, ndaj te grigja jote\* u shfaqe si ëmbëlsi shpëtimtare ti.

### *Hyjlindësor*

**P**ashprehshëm e linde Fjalën, Urtin'\* pra të Atit,<sup>15</sup> traumën e rëndë të shpirtit tim\* ti shëroje edhe zbutë dhimbjen\* që kam në zemër, o Zonjë Hyjlindëse.

#### *Zbritësore: Anikso to stoma mu*

Ja gojën e çel tani (fq. 114)

### *Ode III*

#### *I Triodit: Dhinami tu stavru su*

**K**ur ecja, Krisht,\* në udhë, në jet',\* keq u plagosa\* prej kusarëve,\*<sup>11</sup> prej mjaft pasioneve; lyp kështu:\* Ngrimë dhe shpëtomë, Çlirimtar.

**M**e plagë, Krisht,\* në shkelje, më lan'\* gjysmë të vdekur,\* si ma vodhën krejt\* hajdutët<sup>11</sup> mendjen, ndaj ti, o Zot,\* më

shëro, përdëllimtari im.

**M**ë zhveshën, Krisht,\* nga urdhrat që dhe,\* pasionet, epsheet.\* Shpëtimtari im,\* më kamxhikuan;<sup>11</sup> mbi mua hidh\*<sup>16</sup> përdëllimin, se je i mirë krejt.

### *Hyjlindësor*

**L**yp pa pushim\* atë që ka dal'\* prej mi-trës sate\* që, nga hilja tmerr\* e djallit pra, t'i shpëtojë sa\* të himnojn', Hyjnuse e dëlir'.

#### *I oshënarit: Si i to strerëoma*

**E** dogje, o oshënar,\* gjëmbin e veseve me qymyr,\* me çdo ushtrim,\* asketizëm, ndaj ngroh\* tërësit' e monakëve.

**A**romë e këndshme fort\* për Zotin<sup>17</sup> tënd krejt u bëre ti,\* o oshënar,\* miro shenjtërimi\* nga aromat asketike.

**S**tudioje në rregulla,\* ligj<sup>15</sup> asketizmi, fundose pra\* veset, o shenjt,\* si faraoni-tët\* e mëparshëm,<sup>19</sup> me lotët çurg.

### *Hyjlindësor*

**O** Nënë e Perëndis',\* trazirën pa qëndrueshmëri\* të mendjes ti\* ma pusho, drejtomë,\* e dëlirë, te Biri yt.

#### *Zbritësore: Tus sus innologus*

O Zonjë dhe nën' (fq. 115)

#### *Ndenjësore E Triodit*

#### *Ting. Tërth I To ksenon tis Parthenu*

**S**i armë shpëtimtare, o Çlirimtar,\* e kemi Kryqin tënd pa cen dhe me të\* të thërrasim si shumëpërdëllimtar.\* Na shpëto se pësive vullnetarisht\* për ne,<sup>20</sup> Perëndi,\* Zot i të gjithave.

#### *Lavdi E oshënarit*

#### *Ting. IV O ipsothis en to stavro*

**U**përforcove me\* të mirat dhe fekse\* në qiell qartazi,\* arrite në fund pra\* të teorist' së tërë besërisht, o Joan;\* demaskove



gjithë pritat tmerr\* të demonëve dhe i mbron\* njerëzit nga çdo dëmtim\* që shkaktojnë, sepse ti\* je shkalla e virtyteve, o shenjt;\* lyp të shpëtojm' ne\* shërbyesit e tu krejt.

Tani *Hyjindësore*

**Ai** që rri përmbi\* një fron Keruvik<sup>21</sup> lart,\* njëkohësisht është në gjirin e Atit\*<sup>13</sup> dhe ulet trupërisht në gjirin tënd si mbi fron\* mjaft të shenjtë, Zonj', në prehrin tënd,\* Perëndia, edhe kështu\* mbretëron përmbi çdo komb,\* dhe tani mençurisht ne\* i psalim;<sup>22</sup> përgjëroju fort atij\* që të shpëtojm' ne\* shërbyesit e tu krejt.

*Ode IV*

*I Triodit: Isakikoa Kirie*

**Kusarët** ma vodhën punën e perëndishme dhe më lanë të dënuar prej plagëve.<sup>11</sup>

**Mendimet** e mia të paqëndrueshme më zhveshën nga porositë e tua, o Shpëtimtar, prandaj jam fshikulluar prej mëkateve.<sup>11</sup>

**O Shpëtimtari** im, një levit, sapo më pa të plagosur nga goditjet, kaloi anës,<sup>23</sup> por ti më shpëto.

*Hyjindësore*

**Të** lavdërojmë kryesisht ty, o Perëndilindëse e panusëruar, dhe përikim në limanin tënd ne besnikët.

*I oshënarit: Isakikoa Kirie*

**Si** livadh shumë erëkëndshëm dhe paraj-së të gjallë të virtyteve, e lulëzove vetëpërmbajtjen, me të cilën i ushqeve ata që të nderojnë.

**Të** lumërojmë ty, o atë, duke të pasur vërtet si Moisiun<sup>24</sup> dhe Davidin,<sup>25</sup> si ligjëvënës asketizmi dhe kanun tepër të butë të murgjve.

**Meqenëse** u mbolle në ujërat<sup>26</sup> e vetë-

përmbajtjes, o atë i lumtur, u duke si hardhi tepër e gjallë duke nxjerrë bistakë besimi.

*Hyjindësore*

**O** Hyjnënë, na linde atë që shkëlqeu pa kohë prej Atit, i cili u krijua brenda kohës; atij lyp që t'i shpëtojë ata që të himnojnë.

*Zbritësore: Tin aneksihniaston*

**Të** pagjurmësuarin plan (fq. 380)

*Ode V*

*I Triodit: Ek niktós orthrizontes*

**O** Jisu, vizitoji traumat e shpirtit tim, si qëmoti atë që ra në duart e kusarëve, dhe ma shëro<sup>27</sup> dhimbjen, të lutem, o Krisht.

**Shpirti** im u sëmur dhimbshëm prej kamxhikëve të paudhësive, prandaj dërgjem lakuriq,<sup>11</sup> pa virtytet e perëndishme; të përgjërohëm: Shpëtomë.

**Sapo** më panë, një prift<sup>28</sup> dhe një levit nuk kishin fuqi qartazi, se nuk ndaluan,<sup>23</sup> por ti si i dhembshur më shpëtove tani.

*Hyjindësore*

**Të** lyp, o Zot, mos më shpërfill mua të mjerin, që u kamxhikova dhimbshëm në mendje prej hajdutëve,<sup>11</sup> por dhembshurromë, o Shpëtimtar, me ndërmjetimet e asaj që të lindi.

*I oshënarit: Ina ti me aposo*

**Pasi** i shove të gjitha pasionet me vesën e ndeshjeve të tua, o atë i lum, e ndeze pasurisht llambën e vetëpërmbajtjes për dashurinë dhe besimin, dhe ishte ndriçim papasionshmërie dhe bir drite.<sup>29</sup>

**O** atë, e rrite me kultivim hyjnor bistakun e besës, e vendose në tork, e shtype me mundime asketizmi dhe, pasi e mbushe kanën shpirtërore të vetëpërmbajtjes, i dëfren thellë zemrat e grigjës sate.

Përderisa i durove me trimëri sulmet dhe plagët e armiqve kundërshtarë, u tregove shtyllë durimi, duke e siguruar grigjën tënde me shkop të hyjshëm dhe duke e ushqyer në livadhe vetëpërbajtjeje dhe me ujë, o i lumtur.

#### *Hyjlindësor*

Të lumërojmë duke shkuar pas thënieve të buzëve të tua, o e Tërëkulluar, sepse Zoti, meqë bëri realisht vepra madhështore me ty, të madhëroi<sup>30</sup> dhe, përderisa lindi prej barkut tënd, të tregoi me të vërtetë nënë Perëndie.

#### *Zbritësore: Eksesti ta simpanta*

Të gjith' i habite ti (fq. 117)

#### *Ode VI*

#### *I Triodit: Ekiklosë me avisos*

E prisha në pasione, o Zot, jetën<sup>12</sup> e hyjshme, prandaj tmerrisht\* prej shkeljeve unë fshikullohem, kështu te ti\* përika, lyp: Dhembshuromë dhe shpëtomë, Krisht.

Kusarët kamxhikuan mendjen time me vese, dhe pasurin\* ma vodhën, ma zhvatën, si të vdekur më lanë<sup>11</sup> keq;\* më dhembshuro, më shpëto me simpati, o Zot.

Leviti s'kish durim t'i shihte plagët e mia, ndaj iku larg,\* i ndjeu ky dhimbjet e goditjeve,<sup>23</sup> Zot, por ti\* më derdhe,<sup>16</sup> o njerdashës, pasurisht mëshir'.

#### *Hyjlindësor*

Si ferrë të padjegshme,<sup>31</sup> mal<sup>32</sup> dhe shkallë të gjallë dhe hyrje lart,\* në qiell,<sup>33</sup> o shën Mari e famshme, ne denjësisht\* të lavdërojmë, Je mburrja e Orthodhoksis'.

#### *I oshënarit: Ilásthiti mi Sotir*

Dëllirësi mu në shpirt,\* shenjt, pate dhe lutje pa qortim, dhe agripni me fuqi,\* dhe

vetëpërbajtje plot me dhimbje e modesti,\* pasuri hyjnore;\* si shtëpi, tend' Zoti,<sup>34</sup> njihesh ti.

Materialin pa vler',\* të poshtëm, ti e përbuze; mendjes i dhe krahë, i urt',\* me lutjen pa lëndë; ndaj u shfaqë trashëgimtar\* lart i përfundimit,\* përmes jetës me përsosmëri.

Me djers' në asketizim\* i shove qymyret, tër' shigjetat e armiqve<sup>35</sup> vërtet;\* e shndrite ti zjarrin e besimit, e bëre shkumb\* çdo tërbim të pafe,\* heretik, të remë edhe bosh.

#### *Hyjlindësor*

Me të pashprehshmin bashkim,\* nga ti, e panusëruar, feksi nga Sioni, pasi\* e veshi mishoren pamje vet' hijeshia,<sup>36</sup> lavd\* i të Tërëllartit,\* dhe ndriçoi botën, kozmosin.

#### *Zbritësore: Tin thian taftin*

Këtë të kremte (fq. 117)

#### *Kontaqi*

#### *Ting. IV Epefanis simeron*

Si yll të qëndrueshëm\* në lartësinë\* e vetëpërbajtjes, ty\* vërtet të vuri Zoti yt,\* që të ndriçosh anëmbanë<sup>40</sup> fort,\* o profesor, ati ynë, o shën Joan.

#### *Shtëpia*

O atë, me të vërtetë e bëre veten tënde si shtëpi Perëndie<sup>34</sup> përmes virtyteve të tua të hyjshme dhe e stolise bukur e qartë, pasi i tregove si ar llamburitjeje rregullat hyjnore, besimin, shpresën dhe dashurinë<sup>37</sup> autentike, përderisa praktikove si i patrup vetëpërbajtjen dhe përfitove urtësi, burrëri, mençuri<sup>38</sup> dhe përulesi, me anën e së cilës u lartësove; ndaj u ndriçove me lutje të vazhdueshme dhe arrite në tendat e qiellit, o profesor, ati ynë, o shën Joan.



*Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm  
(Nëse kjo e diel bie më 30 mars, meqë  
atëherë kremtohet palëvizshëm oshënari,  
lihet Sinaksari që vijon, dhe lexohet vetëm  
sinaksari i tij në Mujor).*

Në të njëjtën ditë, të Dielën e Katërt të Kreshmëve, kujtojmë atin tonë oshënar Joani, autor i Shkallës.

**Vargje:** Joani, i cili, edhe kur jetonte, që i vdekur në mish,/ jeton përjetësisht, megjithëse u duk i vdekur pa frymë.

Duke lënë një libër, Shkallën për ngjitje,/ shfaq ecjen e tij drejt lartësimi.

Me ndërmjetimet e tij, o Perëndi, mëshiro-  
na dhe shpëtona. Amin.

### Ode VII

#### *I Triodit: O iperipsúmenos*

Kusarët ranë mbi mua të mjerin dhe me kamxhikime më lanë si të vdekur pa frymë,<sup>11</sup> ndaj të përgjerohem: O Perëndi, vizitomë.<sup>39</sup>

Logjikën time e vodhën mendimet e paqëndrueshme dhe, pasi më goditën me pasione, më lanë të vdekur<sup>11</sup> nga shumica e paudhësive; por, o Shpëtimtar, më shëro.<sup>16</sup>

Kur më pa që vuaja nga plagët, leviti iku larg, duke mos duruar traumat, se ishin të pashërueshme,<sup>23</sup> o Shpëtimtari im; por ti më shëro.<sup>16</sup>

### Hyjlindësor

Ti, o Krisht, që u mishërove nga Virgjëresha, më shpëtove duke derdhur mbi traumat e mia<sup>16</sup> përdëllimin e pasur të dhembshurive të tua, prandaj të lavdëroj.

#### *I oshënarit: I ek tis Iudheas*

Në blerimin e mbretërisë së sipërme e rrite grigjën tënde, o atë dhe, si i përzure bishat e heretikëve me purtekën<sup>40</sup> e dogmave, psalje: O Perëndi i etërve tanë, je i

bekuar.<sup>41</sup>

Hyre në dëfrimin e sipërm nusëror të mbretit Krisht, i veshur me stoli të denjë për atë që ftonte;<sup>42</sup> në të u shtrove për të ngrënë duke thirrur: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>41</sup>

O atë, meqenëse nuk u lage prej mëkateve, u tregove si lumë vetëpërmbajtjeje, i mbyt mendimet dhe i pastron njoilat e atyre që thërrasin me besë: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>41</sup>

### Hyjlindësor

Pasi u mishërua, Zoti i të gjithave doli nga barku yt, o Virgjëreshë; kështu, duke të konsideruar orthodhoksisht si Hyjlindëse, i thërrasim Birit tënd: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>41</sup>

#### *Zbritësore: Uk elatrefsan*

Nuk u faleshin (fq. 118)

### Ode VIII

#### *I Triodit: Si to panturgo*

Me fshikullime shkëlqesh e prisha jetën time nga mendimet e mia vjedhëse, o Shpëtimtar; prandaj u zhvesha<sup>11</sup> nga ikona jote hyjnore,<sup>43</sup> e Perëndisë njeridashës; mirëpo dhembshurorë.

Erdhe mbi dhë nga më të lartat, o Shpëtimtar, meqë më dhembshurove mua të plagosurin tërësisht nga goditjet e kamxhikëve të paudhësive, dhe derdhe mbi mua<sup>16</sup> përdëllimin tënd, o Krisht.

Ti, o Zot Shpëtimtar, e dhe si shpërblese për mua trupin dhe shpirtin<sup>44</sup> dhe, si i mëshirshëm, më shpëtove mua të plagosurin tërësisht me plagë të pashërueshme nga hordhitë e shkeljeve.

### Hyjlindësor

Ty që përmbi mendje, me logjikë hyjburri,

linde Zotin dhe je Virgjëreshë, të bekojmë dhe të përmbillartësojmë me të gjitha veprat në gjithë jetët.<sup>45</sup>

*I oshënarit: Ton vasilea ton uranôn*

**T**ë gjithë e nderojmë kujtimin tënd, o atë Joan, sepse të kemi si përmendore vërtet të gjallë dhe ikonë vetëpërmbajtjeje.

**N**gazëllohet kori i monakëve dhe kërcen bashkësia e oshënarëve dhe e të drejtëve, sepse more denjësisht kurorë bashkë me ta.

**I** zbukuruar me virtyte, hyre bashkë me vajzat e urta në nusëroren<sup>46</sup> e lavdisë së parrëfyeshme, duke i kënduar himn Krishtit në jetë.

*Hyjlindësor*

**M**os i harro kurr, 'Virgjëresh', sa të luten, të himnojnë me bes' e me shpresë, dhe të lartësojnë me zë për gjithë jetët.\*

*Zbritësore: Pedhas evajis*  
**D**jemat e dënuar (fq. 119)

*Ode IX*

*I Triodit: Isaia horeve*

**M**e gjakftohtësi, o Zot,\* s'i zbatova\* urdhrat që ti dhe,\* nën vese epshi pra u nënshtrava keq,\* u zhvesha nga Hiri, lakuriq me plagë po dergjem posht';<sup>41</sup> ndaj dhe kërkoj nga ti,\* Shpëtimtar, të më shpëtosh mua.

**P**lagët s'mundi një levit\* të m'i fshinte,\*<sup>23</sup> por me dhembshuri\* drejt meje si i mir' erdhe, Shpëtimtar,\* mëshirë dhe simpati të plotë derdhe mbi mua,<sup>16</sup> Krisht,\* ndaj më shërove krejt\* si një mjek i fortshkëlqyer, Zot.

**M**eqë je i mirë ti,\* keq të erdhi,\* më shpëtove, Krisht;\* më kishin fshikulluar kusarët mjaft\* dhe dhimbshëm,<sup>41</sup> o Çli-

rimtar, por si shpërbles' dy dinarë dhe,\* pra shpirtin tënd, o Zot,\* tok me trupin tënd; lavdi më ty.

*Hyjlindësor*

**O** Hyjnënë, linde Bir\* përmbi mendje,\* se u ngjize ti\* pa burr', se Perëndi ish i linduri,\* prandaj edhe shtatzënia jote ish virgjërore nur;\* të lumërojmë ty\* dhe e madhërojmë Zotin Krisht.

*I oshënarit: Tin agnîn endhoksos*

**O** i lum, prej Zotit u shfaqe ti\* dëbues dhe ndjekës\* frymësh djallëzore, si mjek sëmudjesh prej mëkatesh;\* ndaj të lumërojmë me hare dhe nder.

**T**okën si banes' prishjeje e le,\* edhe mu në vendin\* ku të butët janë, fushove dhe gëzon me ta tok,\* atë, dhe shijon<sup>47</sup> dëfrim hyjnor dhe lavd.

**D**itë feste sot është, meqë fton\* edhe mbledh së bashku\* tërë murgjit, grigjat e tyre, për kor shpirtëror mjaft,\* ngrënie në tryezë pa cen, jetë, gaz.

*Hyjlindësor*

**N**ë ty Zoti ndenji, fort e pacen,\* si mposhti atë që\* te të parët vuri stërkëmbës dhe<sup>48</sup> është njerivrasës\* që më par';<sup>49</sup> kur lindi, na shpëtoi krejt.

*Pas Zbritësoreve, i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor dhe Idhiomele Hapmi dyert; Drejtomë në rrugët; Unë i mjeri (fq. 10).*

Më të nderuarën. *Dhe*

*Zbritësorja: Apas jijenis*  
**G**jithë njerëzit (fq. 120)

*Dërgimësore ngjallësore dhe e oshënarit:*

*Jinekes akutisthite*

**E** evitove, oshënar,\* si dhimbje mirëqenien\* që bota ka, dhe me keshmë\* e trete mishin, ndaj forcën\* në shpirt e për-



tërte drejt;\* lavdi në qiell, famëmadh,\* të pasuroi fort, kështu\* ti ndërmjeto pa pushuar\* për ne, o atë Joan shenjt.

### *Hyjlindësore*

**O** Zonjë, të pohojmë ne\* Hyjlindëse krejt, se me ty\* kemi shpëtuar, se kisha\* në bark pashprehshëm Zot, Krishtin;\* vdekjen e zhduku ky me Kryq,\* edhe hoqi drejt vetes sakt'\* kor oshënarësh; tok me ta\* të përhimnojmë, e Virgjër,\* je tip i dëlirësisë.

*Lavdërimi: 4 ngjallësore dhe 4 të oshënarit (ato të Mbrëmësore në 4, me Vargje, në të tretin: I lumtur ai burrë që ka frikë Zotin; dhe në të katërtin: E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarit të tij.)*

### Lavdi *Ting. I*

**E**jani të punojmë në vreshtin<sup>50</sup> mistik, duke dhënë në të fryte pendimi,<sup>51</sup> duke mos u munduar për të ngrëna dhe për të pira, por duke arritur virtyte me lutje dhe agjëri; sepe, duke u kënaqur me to, Zoti i punës jep një dinar,<sup>52</sup> me të cilin çliron shpirtrat nga borxhi i mëkatit ai, i vetmi i shumëmëshirshëm.

Tani  
E përmbibekuar

### *Dhoksologjia e Madhe*

*Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kamunit të Triodit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e oshënarit dhe e kishës. Kontaqi Përlufteshës.*



### NË TË NJËJTËN TË DIEL NË MBRËMËSOREN KATANIKTIKE

*Pas Psalmi Nistor (dhe pa Psaltr si çdo të*

*diel) dhe Paqësoreve, 10 Thirrtore: 4 Kataniktike të Tingullit të javës, 3 të Triodit (të mëposhtmet) dhe 3 të Mujorit.*

### *Të Triodit, poezi e zotit Josif Ting. III Megali tu stavrú su*

**M**undime të mëdha në koh' vetëpërmbajtjeje\* të shfaqim, besëmirë, që të arrijmë lavd të madh\* prej madhorit Perëndi, mbret,<sup>53</sup> të shpëtojme\* nga flaka e Gjehenës\* si dhe nga çdo ndëshkim, ta evitojmë zjarrin.

**T**ani që e kaluam mesin pra të Kreshmëve,\* të shfaqim qart' një nisje lavdie të hyjnueshme,\* të nxitohemi me zell që të arrijmë\* në kulmin e jetesës,\* me plot virtyt, të marrim një shijim që s'ka fund.

### *Tjetër, i zotit Theodor*

### *Ting. I Rëndë Katafronisantes panton*

**P**ërderisa e kaluam mesin e kësaj periudhe të hyjshme të Kreshmës, le të ecim saktë me gëzim drejt së ardhmes, duke i lyer shpirtrat me vaj mirëbërjeje, që të denjësohemi të arrijmë edhe t'u falemë pësimeve hyjnore dhe Ngjalljes së frikshme dhe të shenjtë të Krishtit, Perëndisë tonë.

### *Dhe 3 të Mujorit. Lavdi dhe Tani e tij (Hyjlindësore)*

*Hyrje me temjanicë. O dritë gazmore dhe Proqimeni i Madh:*

### *Ting. Tërth. IV*

**M**os e kthe mënjanë fytyrën nga shërbëtori yt, sepe trishtohem; dëgjomë shpejt, vëri re shpirtit tim dhe çliroje.

*Varg:* Shpëtimi yt, o Perëndi, më përkrahtë.

Mos e kthe mënjanë...

*Varg:* Le të shohin të varfër dhe le të dëfrejnë.

Mos e kthe mënjanë...

*Lutja e gjatë (Ektenis):* Le të themi, të gjithë... Bëna të denjë, o Zot... Le ta plotësojmë lutjen...

### *Pasvargje*

#### *Ting. i Rëndë Idhiomeli*

Është afër Shpëtimtari që e mbolli vreshtin dhe i ftoi punëtorët.<sup>54</sup> Ejani, o luftëtarë të kreshmës, të marrim shpërblimin, sepse dhënësi është i pasur dhe përdëllimtar; pasi të punojmë pak, do të fitojmë mëshirën e shpirtit.

*Varg:* Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

#### *Tjetër Idhiomel*

#### *Ting. Tërth. II Poezi e Stefanit*

Meqë ra në mendime kusare, Adami u vodh në mendje, pasi u plagos në shpirt, dhe dergjej i zhveshur,<sup>41</sup> pa përkrahje; as prifti para Ligjit nuk i dha rëndësi,<sup>28</sup> as leviti<sup>23</sup> pas Ligjit nuk ia hodhi sytë, veçse ti, Perëndia, që arrite jo nga Samaria, por nga Maria Hyjlindëse; o Zot, lavdi më ty.

*Varg:* Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

#### *Martirik I njëjti*

Martirët e tu, o Zot, nuk të mohuan, nuk u larguan nga porositë e tua; me ndër-mjetimet e tyre mëshirona.

#### *Lavdi dhe Tani Hyjlindësor I njëjti*

Le ta përhimnojmë në mënyrë kryeengjëlli, o besnikë, dhomën nusërore e qiello-

re dhe portën e vulosur<sup>55</sup> me të vërtetë. Gëzohu, ti që linde Shpëtimtarin e të gjithëve, Krishtin<sup>56</sup> jetëdhënës dhe Perëndi; mposhti tiranët ateistë, armiqtë tanë, me dorën tënde, o Zonjë e pacenuar, shpresa e të krishterëve.

*Dhe shërbesa që mbetet sikundër të Dielën e të Lidhurit të Djathit, (fq. 57).*

#### *CITIME*

1. Ps. 149.6
2. Matth. 10.38; 16.24; Mark 8.34; Lluk. 9.23; 14.27
3. Matth.19.21
4. Matth. 25.31; Lluk. 9.26
5. Ruth.1.9 etj.
6. I Thes. 3.13
7. Ps. 91(92),13-14
8. Lluk. 1.75
9. Matth. 13.8; Mark 4.8; Lluk. 8.8
10. Fil. 2.15
11. Lluk. 10.30
12. Lluk. 15.12-13
13. Joan 1.18
14. Ps. 118(119).103
15. I Kor. 1.24
16. Lluk. 10.34
17. Gjen. 8.21 etj.
18. Ps. 1.2; 118(119).70
19. Eks. 14.27
20. Joan 10.15,17-18
21. Jez. 1.13-26; 10.1; IV [II] Mbret. 19.15; II Kron. 18.18; Is. 6.1
22. Ps. 46(47).8-9
23. Lluk. 10.32
24. Num. 12.3
25. Ps. 131(132).1
26. Ps. 1.3
27. Lluk. 10.33-34
28. Lluk. 10.31
29. I Thes. 5.5
30. Lluk. 1.48-49
31. Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6
32. Abak. 3.3; Dan. 2.34-35
33. Gjen. 28.12-17
34. Joan 14.23
35. Ef. 6.16
36. Ps. 49(50).2
37. I Kor. 13.13
38. Urt. Sol. 8.7
39. Jer. 15.15
40. Ps. 22(23).1-4
41. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
42. Matth. 22.1-11
43. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
44. Lluk. 10.35
45. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
46. Matth. 22.1-11; 25.1-10



47. Ps. 36(37).11; Matth. 5.5  
 48. Gjen. 3.2-6  
 49. Joan 8.44  
 50. Matth. 20.1; 21.28  
 51. Matth. 3.8; Lluk. 3.8  
 52. Matth. 3.2  
 53. Tov. 13.15 etj.  
 54. Matth. 20.1-7  
 55. Jez. 44.1-2  
 56. I Tim. 4.10



## TË MËRKURËN E JAVËS SË PESTË NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve, Ali-luiat dhe Triadiket e Tingullit të javës dhe, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores Kryqësore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores Ting. Tërth. IV To prostahtën mistikòs*

Adami, siç s'duhej, kur shijoi dru-rin,<sup>1</sup> hidhërisht voli\* frytin pra të mos-përmbajtjes,<sup>2</sup> porse ti e çlirove\* nga dënimi plot tmer,<sup>3</sup> i miri Zot, kur u ngrite mbi dru, prandaj\* thërrasim: Vetëpërmbajtje\* jepna, kështu\* nuk do hamë fryt prishjeje, por do zbatojmë vullnetin tënd, që përdëllim me hir\* ne të gjejmë,<sup>3</sup> o Shpëtimtar.

*Lavdi dhe Tani Kryqhyjindësore*

Të mishëruarin prej gjakut tënd të pastër,\* që nga ti lindi\* përmbi mendje, o e Thjeshtë,\* kur e shihje të varur\* mbi dru dhe kusarësh,\*<sup>4</sup> ti ndjeje në kraharon shumë dhimbje, Vajz',\* me qarje thërrisje si nën':\* Vaj, Biri im!\* Ç'është kjo e pashprehshmjia dhe hyjnorja Ekonomi që ke? Ti ngjall krijimin tënd;\* ta himnoj dhembshurinë mjaft.

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësores*

*Ting. II Tin áhranton ikona su*

Të tërëshenjtin dru, Kryq pra,\* kur e për-

himnojmë ne,\* i falemi gjithnjë mirësi-së sate të skajshme, Krisht Perëndi,\* se i stërkueje forcat e armikut përmes tij, shenjë dhe\* tek ata që te ti besojn';\*<sup>5</sup> ndaj të thërrisim me hare:\* Denjësona gjithë ne, Shpëtimtar,\* që, duke pasur paqe, lehtësisht edhe me gaz\* ta plotësojm' kohën e kreshmimit që mbeti.

*Lavdi dhe Tani Kryqhyjindësore*

Kur shqerra shihte që mbi dru\* ishte varur, o bari\* pa cen,<sup>6</sup> vajtonte fort dhe thërriste si nënë: O Krisht, o Biri im,\* në vend të resë që e shtrive të ikte populli<sup>7</sup> i keq,\* të dënon ty për vdekje ky\* mos-mirënjohës! Mjerë, vaj,\*mbetem pa bir unë që burrë s'njoh!\* Por ngrihu, diell, dhe ndriço që të lëvdohem fort\* mes të dhelindurve mbar', mes bijve të njer'zve.

*Psalmi 50. Prifti thotë uratën e zakonshme: O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën, dhembshurinë dhe... Kamuni i Mujorit dhe Triodet në vendin e tyre. Lexohet dhe Ode III biblike.*

*Ode III*

*Triodi*

*Ting. Tërth. IV Uranias aspidhos*

Kur ti armiqësin' e dënoje,<sup>8</sup> shtrive në Kryq,\* o gjyqtar i drejtë,<sup>9</sup> pëllëmbët, ndaj më shpëto tani,\* sepse plot faje un' jam,\* i shturur,<sup>10</sup> o Çlirimtar Zot,\* dhe të hidhërova mjaft ty, zemërgjerin Krisht.

Preferova jetesë kafshore<sup>11</sup> dhe pri-shëse,\* u largova<sup>10</sup> nga porosit' e tua, o Çlirimtar\* i mir', u bëra rob, skllav,\* në qytetarë të huaj,\*<sup>11</sup> të papastër; prit se po kthehem dhe më shpëto.<sup>12</sup>

Sç ia hape të shurdhrit, o Zot, dëgjimin dikur,\*<sup>13</sup> o Jisu, m'i hap veshët shpirtërorë, i shurdhër jam\* vullnetarisht; denjësom'\* që të dëgjoj fjalën tënde\* shpëtimtare, o njeridashës i vetëm Krisht.

*Hyjlindësor*

Qeverismë, o mbrojtja e të krishterëve krejt;\* portë shpëtimtare dhe urë drejt Perëndisë je;\* peripeci plot mjerim\* më tundin shumë në jetë,\* e tërëdëlira Vajz', Zonjë, dhe më shtrëngoijn'.

*Kanuni tjetër, poezi e Theodorit  
Ting. II*

*Stirothenta mu ton nun*

Kur nga mirësia det,\* Krisht i dhembshur,<sup>14</sup> përmbi Kryq u ngjite, o Zot,\* nga gremina plot ves'\* jasht' më nxore, dhe në qiell, lart më ngrite ti.

Kur pëllëmbët përmbi Kryq,\* Krisht, i hape, përqafove kombet mbarë\* që qen' larg teje mjaft\* dhe i vure shumë afër, Zot, pushtetit tënd.

*Lavdi Triadik*

Na shpëto sa të nderojm',\* o Njësi trihipostate, mbi esencë\* Shën Trini, një Hyjni,\* Atë, Bir dhe Shpirt i drejtë; të besojmë ty.

*Tani Hyjlindësor*

Kush ka aftësi nga ne,\* të dhelindurit, të të himnojë, nënë\* virgjëresh', se ndër gra\* vetëm ti u shfaqe më e lum, e zgjedhur krejt.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

Kur u lartësove, Zot,\* përmbi Kryq, u shpove me një shtiz' në brinjë,\*<sup>15</sup> vrer ti pive, Jisu\*<sup>16</sup> Krisht, për mua që të hidhërova pa bindje.

*Irmosi: Stirothenta mu ton nun*

»Perëndia im, jam shterp'\*<sup>17</sup> un' në »mendje, ndaj frytdhënës më trego ti,\* »o bujk<sup>18</sup>, mbjellësi pra\* i të mirave, me »dhembshurinë tënde, Zot.

*Ode VIII**Eptaplasios kaminon*

Pasi të më mbikëqyrësh me syrin e pafjetur, mëshiromë mua që kapem nga dremitja e dembelizmit dhe jam skllav i gjumit të epsheve në krevat pasionesh, ti që e përkule kokën tënde mbi Kryq,<sup>19</sup> që fjete vullnetarisht<sup>20</sup> dhe e pakësive natën e mëkatit, meqenëse je dritë drejtësie, o Krisht.

Ndonëse u stolisa nga pagëzimi me karizma që burojnë pasuri, e desha më shumë varfërinë e të këqijave dhe u bëra i huaj për virtytet unë i mjeri, pasi u shpërngula në vend të largët mëkatar,<sup>10</sup> ndaj, pasi të më kthesh, o Shpëtimtar, më përqafo<sup>12</sup> duke më fortifikuar me Kryqin tënd në gjithë jetët.

O shpirt, hidhe poshtë dehjen e pasioneve dhe kërko përmes kreshmës verën pastruese të lotëve, e cila e dëfren zemrën,<sup>21</sup> i vyshk kënaqësitë dhe i shkrumbon kaminat e mishit; dhe nxito që të kryqëzohesh bashkë me Krishtin<sup>22</sup> që u mbërthye për ty mbi dru, që të jetosh në jetë.

*Hyjlindësor*

O Hyjlindëse e tërëdëlirë, shëroji traumat e shpirtit tim dhe shenjat e plagëve të mëkatit, duke i larë me burimet e brinjës së Birit tënd dhe duke i pastruar me rrjedhat e saj;<sup>15</sup> sepse drejt teje thërras, te ti përiki dhe të ftoj ty, hirploten.

*Tjetri: Ton en fonës angjelikës*

Jisuin që u kryqëzua në mish dhe nuk pësoi hyjnisht, e himnojnë engjëjt dhe ne të dhelindurit në gjithë jetët.

Gjatë kryqëzimit tënd, o Krisht, përdërisa e zgjodhe vdekjen e poshtëruar dhe të mallkuar,<sup>23</sup> na shpëtove dhe na çlirove nga prishja.



Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin  
e Shenjtë, Zotin (*Triadik*).

“I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë”,<sup>24</sup> të himnoj si Keruvim, o Trini, një Hyjni, pa fillim, e thjeshtë dhe e pakonceptueshme nga të gjithë.

Tani *Hyjindësor*

O e Kulluar, gjithë gjeneratat të mburrin<sup>25</sup> shkëlqyeshëm me lavdërime, sepse linde Krijuesin; o çudi e frikshme dhe punë e tërëlumërueshme!

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

Të tëra i pranove t'i pësoje, o Krisht, për një gjë: që të më shpëtosh; e himnoj kryqëzimin tënd, gozhdët dhe therjen në gjithë jetët.

*Irmosi: Ton en fonës angjelicës*

»Perëndinë që lavdërohet në qiej me »zëra engjëllorë,<sup>24</sup> le ta himnojmë të tërë »ne të dhelindurit në gjithë jetët.

*Ode IX*

*Eksesi epi tuto*

I mblodhi rrezet dielli kur të pa\* të tendosur mbi Kryq,<sup>26</sup> teksa tundej fort me frikë plot\* gjithë toka,<sup>27</sup> o Zot, o tërëmbret;\* shikonte që vullnetarisht\* po pësoje<sup>20</sup> edhe pse në natyr\* s'pranon pësim, të lyp pra,\* sëmundjet shpirtërore,\* si mjek që je, ti m'i shëro, o Krisht.

I lashë shpëtimaret udhë,<sup>28</sup> o Zot,\* ndoqa udhë që çojnë në Hadh, në terr, dhe më rrethojn\* epshe, errësirë e zezë skrop,\* rrëshqitje vesesh dhe stuhi,\* ngasje, ndaj të lyp, më çliro, o Krisht,\* me Kryqin tënd, se ti je\* dhe shumëmëshirues,\* i vetmi fortpërdëllimtar në ndjes'.

Një dimër ngasjesh po më shtrengon, më mbyt\* me shtrengata pasionesh dhe vuaj keq nga një furtun',\* epsi, por arrita në det të qet',\* të butë, kreshma është

ky;\* më drejto në të, Zot i dhembshur Krisht,\* të ankoroj në gjirin,\* në portin e shpëtimit,\* nëpërmjet Kryqit tënd të çmuar mjaft.

*Hyjindësor*

Pa far' u ngjize, pa dëshirim mishor;\* linde<sup>29</sup> pa dhimbje,<sup>29a</sup> nënë e virgjër ti, pa prishje hiç,\* vetë Krishtin, Fjalën e Perëndis',\* që e krijoi Gjithësin';\*<sup>30</sup> ndaj të madhërojmë edhe me shpirt,\* me zemër dhe me gjuhë,\* dhe të pohojmë, Zonjë,\* Perëndilindëse pa cen aspak.

*Tjetri: Tin parthenian su*

Vullnetarisht pranove të kryqëzohe-she,<sup>20</sup> o Shpëtimtari ynë, që t'u jepje të gjithëve jetë, pasi t'i çliroje nga vdekja.

Përmes një druri<sup>1</sup> vdiqa,<sup>2</sup> dhe jetova përmes drurit të Kryqit, në të cilin Krishti im, kur u mbërthe, e vrau armikun tim.

Lavdi *Triadik*

Le t'i falemi me një shpirt Birit që ekziston bashkë me Atin dhe Shpirtin të Shenjtë që është bashkë me ta.

Tani *Hyjindësor*

Çudi paradoksale dhe lajm i mrekullueshëm! Si edhe si nënë linde, edhe si e virgjër nuk njohe prishje, o e Kulluar?

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Himnoj heshtën tënde,<sup>15</sup> përhimnoj gozhdët, sfungjerin, kallamin<sup>31</sup> dhe Kryqin, me anën e të cilave kam shpëtuar, o Jisu Perëndi.

*Irmosi: Tin parthenian su*

»E madhështojmë me himne të pareshtura virgjërinë tënde, të cilën nuk e »shkrumboi zjarri i Hyjnisë, o Perëndilindëse e panjollë.

*Fotogojiku i Tingullit të javës*

*Pasvargjet e Lavdërimeve  
Ting. III Idhiomeli*

Pasi e le lartësinë e virtyteve, o shpirti im, zbritë në thellësinë e mëkatit, ngaqë re në kusarë djallëzorë; dhe, i mbushur me trauma erëkëqija, dergjesh përtokë pa shpresë;<sup>32</sup> prandaj Krishtit Perëndi, që u kryqëzua për ty dhe pranoi plagë vullnetarisht,<sup>20</sup> thirri: Kujdesu<sup>33</sup> për mua dhe shpëtomë, o Zot.

*Varg:* U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përule, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiq bijt' e tyre.

*Tjetër Idhiomel Ting. Tërth. IV*

Unë i mjeri, përderisa u plagosa prej mendimesh vjedhëse, u bëra gjysmë i vdekur,<sup>32</sup> o Zot; kori i profetëve më shpërfilli meqë më pa kur isha pothuajse i vdekur<sup>34</sup> dhe i pashëruar nga shkenca njerëzore; ndaj, duke vuajtur dhimbshëm, të thërras me përulesi zemre: O Krisht Perëndi, si i dhembshur, derdh mbi mua<sup>35</sup> përdëllimin tënd të madh.<sup>36</sup>

*Varg:* Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji te ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

*Martirik I njëjti*

O martirë të pamposhtur të Krishtit, që mundët mashtrimin nëpërmjet fuqisë së Kryqit, e fituat çmimin e jetës së amshuar; nuk u frikësuar nga kërcënimet e tiranëve, dëfrenit kur plagoseshit nga torturat; ndaj gjakrat tuaja të pacenuara, të pëlqyeshme prej Perëndisë, burojnë shërime për shpirtrat tanë.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësor I njëjti*  
Sapo të pa të varur trupërisht në dru, e Të rëkulluara u plagos në zemër dhe bërtiste duke lotuar: O Fjalë, ku më perëndove, o Jisu i tërëdashur, Biri dhe Zoti im? Mos më lër të vetme mua, lindësen tënde.

*Lexuesi:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin etj. si të hënën e javës së parë në mëngjes (fq. 63).

*Në orën e Gjashtë (në Trithektë), Tropari i Profecisë  
Ting. I*

Të ardhhtë keq për dhimbjet e shenjtoreve, të cilët pësuan për ty,<sup>37</sup> o Zot, dhe shëroji gjithë dhimbjet tona, o njeridashës, të lutemi.

Lavdi dhe Tani  
I njëjti

Proqimen. Ting. IV. Psalm 91.  
Është mirë ta lavdërojmë Zotin dhe t'i psalim emrit tënd, o i Tërëllartë.

*Varg:* Ta nojftojmë në mëngjes mëshirën tënde dhe të vërtetën tënde përnatë.

Këndimi i profecisë së Isaias  
(41.4-14)

Kështu thotë Zoti: "Unë jam Perëndia i parë, dhe në shekujt e ardhshëm unë jam. Panë kombet dhe u frikësuan, skajet e dheut u afruan dhe erdhën njësh, duke gjykuar çdokush për të afërmin dhe për të ndihmuar vëllanë, dhe do të thotë: 'U forcua një burrë marangoz dhe një bakërpunues që godet me çekiç duke farkëtuar njëkohësisht. Ndonjëherë do të thotë: 'Kombinim i mirë është'. Le t'i përforcojnë me gozhdë, do t'i vendosin dhe nuk do të lëvizin. Por ty, o Izrael, shërbëtori im Jakob, që të zgjodha, farë Abrahami, që të desha, që të mbajta nga skajet e dheut dhe nga vendet e tij



të larta, të thirra dhe të thashë: 'Je shërbëtori im, të zgjodha dhe nuk të braktisa; mos ki frikë, sepse jam me ty, mos u mashtro, sepse unë jam Perëndia yt që të përforcova dhe të ndihmova, dhe të sigurova me të djathtën time të drejtë'. Ja do të turpërohen dhe do të marrosen kundërshtarët e tu; do të jenë si të mos jenë dhe do të zhduken të gjithë ndër-gjyqësit e tu; do t'i kërkosh dhe nuk do t'i gjesh njerëzit që do të dehen te ti, sepse do të jenë si të mos jenë dhe nuk do të jenë ata që luftojnë kundër teje; se unë, Perëndia yt, jam ai që mbaj të djathtën tënde, që të them: 'Mos ki frikë, Jakov, Izrael i vogël, unë të ndihmova!', thotë, o Izrael, Perëndia yt që të çlliron.

Proqimen. Ting. IV. Psalm 92.  
Zoti mbretëroi, u vesh me hijeshi.

*Varg:* Zoti u vesh dhe u ngjesh me fuqi.



## TË MËRKURËN E JAVËS SË PESTË NË MBRËMËSORE

*Thirrtores, duke filluar nga*

*Varg:* Do të bien fajtorët në rrjetat e ngritura prej tyre, ndërsa mua ruajmë gjersa të kaloj.

*Ting. Tërth. IV Idhiomeli*

**K**ur rashë te kusarët e mendimeve të mia, mua të mjerit ma vodhën logjikën dhe, meqë u plagosa tmerrshëm, kam trauma në gjithë shpirtin tim dhe, si pasojë, dërgjem në udhën e jetës i zhveshur nga virtytet.<sup>32</sup> Një prift, kur më pa që vua-ja nga plagët, bëri sikur nuk më pa, dhe më shpërfilli, se nuk mund të shërohesha. Nga ana tjetër një levit, duke mos duruar dhimbjen shpirtshkatërruese, si më

pa, dhe ai kaloi anës.<sup>34</sup> Por ti që me mirëdashje u mishërove nga Maria dhe jo nga Samaria, o Krisht Perëndi, ma jep me njeridashjen tënde shërimin, duke derdhur mbi mua<sup>35</sup> përdëllimin tënd të madh.<sup>36</sup>

*Varg:* Me zërin tim i thirra Zotit, me zërin tim iu luta Zotit.

*I njëjti*

*Varg:* Do të derdh përpara tij lutjen time, përpara tij do të rrefej hidhërimin tim.

*Martirike*

**N**ë ka ndonjë virtut dhe në ka ndonjë lavdërim, këto u përkasin shenjtoreve, sepse i ulën qafat te shpata për ty<sup>37</sup> që i ule qiejt dhe zbritë;<sup>38</sup> derdhën gjakun e tyre për ty që zbraze veten dhe more pamje shërbëtori;<sup>39</sup> u ulën deri në vdekje, duke imituar varfërinë tënde;<sup>40</sup> me lutjet e tyre, o Perëndi, mëshirona sipas shumicës së dhembshurive të tua.<sup>41</sup>

*Të tjera, poezi e Josifit*

*Ting. Tërth. IV Kirie i qe kritirio*

*Varg:* Kur ishte duke m'u shterur fryma, ti njohe udhët e mia.

**Q**iej mendorë, Krisht, i shfaqe të hyjshmit e tu, shën Nxënësit; më çliro\* ti me ndër-mjetimin e tyre\* fort të shenjti' nga çdo e keqe pra\* mbitokësore, ma ngri\* logjikën mençurisht gjithnjë\* ndaj vesesh përmes vetëpërmbytjes\* si i dhembshur, njeridashës Zot.

*Varg:* Në këtë rrugë që ecja, më ngritën fshehurazi kurrth.

**M**eqë si bashkëpunëtore për vepra të hyjshme kemi kohën tani,\* të kreshmës, krejt ne me gjith' zemër\* le të qajmë; Çlirimtarit Zot\* le t'i thërrasim: Shpëto,\* ti shumëpërdëllyes Krisht,\* sa njeridashjen tënde të madhe\* e himnojnë, përmes

Nxënëseve.

*Tjetër, poezi e Theodorit*

*I njëjti Tin ëndhokson që àhranton*

**Varg:** Shtija sytë djathtas dhe vështroja, por askush s'më njhte.

**O** apostuj të tërëfamshëm, ndërmjetues të botës, mjekë të të sëmurëve, rojë të shëndetit, na mbani në të dyja anët ne që po përshkojmë kohën e kreshmës, që të kemi paqe hyjnisht me njëri-tjetrin<sup>42</sup> dhe ta ruajmë mendjen të pashqetësuar prej pasioneve, që t'i këndojmë të gjithë himn Krishtit që u ngjall si fitimtar.

*Të tjera sipas Alfabetit, poezi e Simeon Përkthyesit*

*Ting. V Ëthelon dhákrisin eksalipse*

**Varg:** Humbi çdo strehë shpëtimi për mua dhe s'ka kush kujdeset për shpirtin tim.

**Me** doganierë dhe prostituta\* gjithë jeta ime është shpenzuar,<sup>43</sup> vallë pra\* do mundem qoftë në pleqëri, tash\* të pendohem unë për shkeljet? Bërës, Krisht\* dhe mjek i çdo të sëmuri,\* Krijues i Gjithësisë,<sup>30</sup> Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

**Varg:** Te ti thirra, o Zot, dhe thashë: Ti je shpresa ime, ti je përkrahja ime te dheu i të gjallëve.

**Barrë** shkujdesjeje më shtrëngon fort,\* rrokullisem brenda baltës, beljari djall më shpon\* përmes shigjetës; k'të "Pas ikonës"<sup>44</sup> shumë e njollo, Krisht, që të shkujdesurit\* i kthen edhe i çliron tok\* nga fajet, paudhësitë,\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

**Varg:** Vëri veshin lutjes sime, se jam i munduar fort.

**Si** i dhelindur, i kultivova\* tokësoret, ndaj u bëra skandal i njerëzve;\* siç thotë urdhri, un' u martova,<sup>45</sup> por fajtova se

shtratin e njolloza mjaft;\* meqë nga dheu e bërë\* krijimin tënd,<sup>46</sup> mos e lër ti;\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

**Varg:** Shpëtomë prej ndjekësve të mi, se janë bërë më të fortë se unë.

**Meqë** për mishin tim u kujdesa\*<sup>47</sup> pra, për shpirtin tim u bëra xhelat; satani djall\* më ka si lodër, jam skllavëruar\* në kënaqësi, epshe, në të çrregulltat;\* me dhembshuri plot kursemë,\* ti që demonët i shporr larg,\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

**Varg:** Nxirr shpirtin tim prej burgut, që të lavdërojë emrin tënd.

**Më** shumë se çdo njeri fajtova\* dhe jam i braktisur dhe shpirtit tim ndërgjyqës kam\* mentalitetin e mishit,<sup>48</sup> është\* terr për mua; je drit' të errësuarish,\* me dashje un' mëkatova,\*<sup>49</sup> ti udhëzon drejt sa humbën;\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

**Varg:** Të drejtët do të më kërkojnë, kur të më shpërblesh.

**Thoshte** profeti se "Do jetojë\* shpirti im, o Zot, edhe do të të himnojë ty".<sup>50</sup> Kërkom' se humba në mal si dele\*<sup>51</sup> dhe me grigjën tënde radhitmë, jepmë koh'\* që të pendohem nga zemra,\* të të thërras me rënkime:\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

**Varg:** Nga thellësitë e shpirtit thirra më ty, o Zot, o Zot, dëgjo zërin tim.

**Urdhër** që ke dhënë, Zot, i shkela;\* mëkatova, mëkatova, le të të vlijë keq\* për mua,<sup>52</sup> o mirëbërës, o Krisht,\* që të shoh me sytë e brendshëm dhe të shkoj\* larg errësirës, me frikë\* të të thërras ty nga zemra:\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.



*Varg:* Veshët e tu le t'i vënë re zërit të lutjes sime.

**B**isha të egra tmerr më rrethuan,\* nga këto rrëmbemë ti që do që krejt njerëzit\* pra të shpëtojnë edhe të vijnë\* drejt te njohuria e së vërtetës, Krisht;\*<sup>53</sup> si Krijimtari i çdokujt\* shpëtomë tok me të gjithë;\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

*Varg:* Po të vësh re paudhësitë, o Zot, o Zot, kush ka për të mbetur? Por pranë teje është ndjesa.

**O** çlirimtar mirëbërës, bëhu\* si ilaç për mua, o Shpëtimtar, dhe mos më zbraps;\* më shih se dergjem në faje, ngrimë\* si i plotfuqishëm, që edhe un' të shpall\* veprimtarinë që kreva,\*<sup>54</sup> të të thërras që nga zemra.\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

*Varg:* Për emrin tënd të prita, o Zot; shpirti im priti fjalën tënde; shpirti im shpresoi më Zotin.

**S**i shërbëtori mosmirënjohës\* brenda tokës thell' e fsheha talantin që më dhe,\* si i pavlefshëm, drejt jam dënuar;\*<sup>55</sup> të kërkoj më gjë, nuk guxoj, por s'mban mëri,\* ndaj dhembshurorë, shpëtomë,\* që të thërras edhe unë.\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

*Varg:* Nga roja e mëngjesit gjer natën, nga roja e mëngjesit le të shpresojë Izraeli më Zotin.

**T**have me prekjen e rrobës sate,\* pak në cep, një pellg pësimesh që kish gjakrrjedhësja;\*<sup>56</sup> meqë me besë të palëkundur\* te ti po vij, ndjesën e fajeve do marr;\* ndaj pritmë si këtë grua\* dhe hiqe krejt dhimbjen time;\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

*Varg:* Se pranë Zotit është përdëllimi dhe

pranë tij shpërblimi i shumtë dhe ai do ta çlirojë Izraelin nga të gjitha paudhësitë e tij.

**K**ur do të ulesh mbi fron,<sup>57</sup> ti\* që me fjal' e bëre qiellin edhe dheun<sup>58</sup> tok,\* të gjithë do të qëndrojmë para\* që të të njoftojmë mëkatet tona ty;\* më par' se kjo ditë, pritmë\* se kam pendim,<sup>59</sup> mëshirorë;\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

*Varg:* Lavdërojeni Zotin gjithë kombet, lavdërojeni gjithë popujt.

**B**ëmë me syrin tënd shenj' të dhembshur,\* të të vijë keq për mua,<sup>62</sup> i vetmi Shpëtimtar;\* dhuroji shpirtit tim mjaft të mjerë\* dhe fatzi burime shërimesh, fshihe krejt\* papastërtinë që bëra\* me vepra, që të psal bukur:\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

*Varg:* Se i madh është përdëllimi i tij mbi ne dhe e vërteta e Zotit mbetet në jetë.

**K**a hijeshuar beljari shpata,\* se nxiton ta gjuaj' egër të varfrin shpirtin tim;\* të huaj për dritësimin, njohjen\*<sup>60</sup> e fytyrës sate më bëri, o i Mir';\* i dhembshur dhe fuqiplotë,\* nga enët e tij rrëmbemë;\*<sup>61</sup> Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

*Varg:* Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinye të tyre, si sytë e shërbëtorës në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

**S**hkrimet e Shenjta, pra ligjin, lashë,\* ndaj i tëri jam në vese i robëruar keq;\* të tërin më shëro, mirëbërës,\* që u bëre si unë krejt për mua, Krisht;\* më kthe, i dhembshur, i mirë,\* që i rrafshon veset fare;\* Zot, para zhdukjes përfundimtare shpëtomë ti.

*Farg:* Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

**K**ëmbët e çmuara dhe pa cen hiç\* ty t'i lan me lot Laviija,<sup>62</sup> na nxit të gjithë ne\* të rendim edhe të marrim faljen\* për mëkatet tona; ma jep, o Shpëtimtar,\* dhe mua besën e saj pra,\* të të thërras që nga zemra:\* Zot, para zhdokjes përfundimtare shpëtomë ti.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **N**jollën e shpirtit tim ma pastro, Krisht,\* që u bërë foshnj' për mua në mish me varfëri;\*<sup>40</sup> dhe të dërrmuarit pa fuqi hiç,\* mua, më dërgo një pik' përdëllimi, hir,\* ma laj dhe ndotjen, shëromë,\* se i sëmurë jam unë;\* Zot, para zhdokjes përfundimtare shpëtomë ti.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **S**hpirtin tim, Fjalë dhe Perëndi, Zot,\*<sup>63</sup> ma mbështet që shpejt të rendë te ti, të jet' aktiv\* për ty gjithnjë, se je roja, streha,\* ndihma ime, ndaj denjësomë me guxim\* të të thërras thell' nga zemra,\* edhe të të adhuroj ty;\* Zot, para zhdokjes përfundimtare shpëtomë ti.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **M**ur i pamposht për ne, Krisht, bëhu,\* i mëshirshmi Shpëtimtar, Perëndia yn' Jisu,\* se me mashtruesen tmerr mënyrë\* dhe aktivitetin të gjithë ramë, por\* si mirëbërës pajtohu,\* krijimin ngrije, i dhembshur;\* Zot, para zhdokjes përfundimtare shpëtomë ti.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **T**retëm tani nga uria;<sup>64</sup> meqë\* e shpërndava kamjen, Biri i Sththurur<sup>20</sup> jam dhe un';\* në strehën tënde po vij shpejt, pri-

tmë\* si atë, o atë i mir',<sup>12</sup> më denjëso\* për drekën tënde,<sup>65</sup> i dhembshur,\* të të thërras ty nga zemra:\* Zot, para zhdokjes përfundimtare shpëtomë ti.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **N**xori i keqi që nga fillimi\*<sup>66</sup> prej Parajsës – smirë kish –<sup>67</sup> të parëgatuarin;\*<sup>68</sup> kur tha Kusari mbi dru "Kujtomë!"\* mori dhe shijoi Parajsën,<sup>69</sup> edhe un'\* me besë edhe me frikë\* po të thërras ty "Kujtomë!";\* Zot, para zhdokjes përfundimtare shpëtomë ti.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **S**iç kishe bërë me Petron, shtrije\* dorën dhe nga fundi nxirrme,<sup>70</sup> o Perëndia im,\* më jep mëshir', hir me ndërmjetimet\* e asaj që pa farë të ka lindur ty,\* të nënës pa cen aspak pra,\* të shenjtëve të tu mbarë;\* Zot, para zhdokjes përfundimtare shpëtomë ti.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **Ç**do ditë pritmë kur psal, himnoj, Qengj,\* që ngre fajin tim;<sup>71</sup> ndaj shpirtin dhe trupin krejtësisht\* i dorëzoi un' në dorën tënde\*<sup>72</sup> edhe siç e kam për detyrë ditënat',\* o Zoti im, Perëndia,\* të të thërras ty nga zemra:\* Zot, para zhdokjes përfundimtare shpëtomë ti.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **Z**ot, i mbimirë që s'mban mëri kurr',\* – oh! – ai pra përdëllimi që ke, nuk shprehet dot;\* i pamëkatshëm, i dhembshur, pritmë,\* larg fytyrës sate, tej mos më hidh,<sup>73</sup> të lyp,\* që me pëlqim, gaz dhe unë\* të të thërras duke psalur:\* Zot, para zhdokjes përfundimtare shpëtomë ti.

Lavdi dhe Tani

**O**h, bashkëzbritje që nuk rrefehet!\* E përmbicuditshmja lindje e huaj! Si të mban\* një Virgjëresh' në pëqi si foshnjë\* ty, pra Perëndinë e saj, Gatuesin,\* ty që



prej saj, mirëbërës,\* Krisht, mish denjove të merrje!\* Zot, para zhdokjes përfundimtare shpëtomë ti.

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Prifti:* Mbrëmje!

*Lexuesi:* Proqimëni. Ting. IV. Psalm 93. Perëndi hakmarrjesh është Zoti, Perëndi hakmarrjesh.

*Varg:* Lartësohu ti që gjykon dheun.

Këndimi i Gjenezës

(17.1-9)

**U** bë Abram/ nëntëdhjetë vjeç dhe Zoti iu shfaq Abramit dhe i tha: “Unë jam Perëndia yt; ji i pëlqyeshëm para meje dhe bëhu i paqortueshëm; dhe unë do ta vendos besëlidhjen time mes meje dhe mes teje dhe do të të shumoj tepër”. Dhe Abrahami ra përmbys dhe Perëndia i foli duke thënë: “Dhe unë them, ja besëlidhja ime me ty; dhe do të jesh atë për shumicë kombesh, dhe nuk do të quhet më emri yt Abram, por emri yt do të jetë Abraham, sepse të vura si atë kombesh të shumta; dhe do të të shumoj tepër-tepër dhe do të të vendos në kombe; dhe mbretër do të dalin prej teje; dhe do ta bazoj besëlidhjen time mes teje dhe mes farës sate pas teje, në gjeneratat e tyre, në një besëlidhje të amshuar, që të jem Perëndia yt dhe i farës sate pas teje; dhe do të të jap ty dhe farës sate pas teje tokën në të cilën rri provizorisht, tërë tokën Hanaan, për zotërim të amshuar dhe do t’ju jem atyre në Perëndi”. Dhe tha Perëndia drejt Abrahamit: “Dhe ti besëlidhjen time do ta mbash, ti dhe fara jote pas teje në gjeneratat e tyre”.

Proqimëni. Ting. Tërth. II. Psalmi 95.

Këndojini Zotit një këngë të re.

*Varg:* Këndojini Zotit, bekojeni emrin e tij.

Këndimi i Fjalëve të Urta

(15.20-16.9)

**B**iri i urtë dëfren atin, ndërsa biri i pamend tallet me nënën e tij. Udhët e *idiotit janë* të varfra në mendje, ndërsa burri i mençur ecën drejt. Anullojnë mendime ata që nuk nderojnë mbledhje, ndërsa në zemrat e atyre që mendojnë, mbetet mendim. I keqi nuk do t’i bindet atij as do të thotë diçka të vlefshme dhe të mirë për bashkësinë. Udhë jete janë mendime të mençuri, që të shpëtojë pasi t’i shmanget Hadhit. Zoti dërrmon shtëpi sharësisht, ndërsa mbështeti kufi vejushe. I neveritshëm është për Zotin mendim i padrejtë, ndërsa thënie të dëlirësh janë modeste. E shfaros veten ai që merr rryshfet, ndërsa shpëton ai që urren marrje dhuratash. Me lëmosha dhe besueshmëri pastrohen mëkate, dhe me frikën e Zotit çdokush eviton të keqen. Zemrat e të drejtëve studiojnë besueshmëri, ndërsa gojë të pabesësh përgjigjet të këqija. Të pranueshme janë prej Zotit rrugë njerëzish të drejtë, dhe nëpërmjet tyre edhe armiqtë bëhen miq. Perëndia është larg nga të pabesët, ndërsa dëgjon në lutje të drejtësh. Është më mirë një marrje e paktë me drejtësi sesa shumë prodhime me padrejtësi. Zemër burri le të mendojë të drejta, që hapat e tij të kenë mbarësi prej Perëndisë. Kur syri shikon të mira, zemra dëfren, ndërsa një lajm i mirë i yndyros kockat. Ai që zmbrops çdo edukim, e urren veten, ndërsa ai që mban qortime, e do shpirtin e tij. Frikë Perëndie lind edukatë dhe urtësi, dhe pushtet lavdie do t’i përgjigjet urtësisë. Të gjitha veprat e të përrulurit janë të dukshme prej Perëndisë, ndërsa të pabesët do të shfarosen në ditë të keqe. I papastër për Perëndinë është çdo kryelartë, dhe ai që vuri padrejtësisht duar në dorë, nuk do

të shfaqësohet. Fillim udhe të mirë është bërja e të drejtave dhe janë të pranueshme nga Perëndia më shumë se filjimi i theroreve. Ai që e kërkon Zotin, do të gjejë njohuri me drejtësi, dhe ata që e kërkojnë atë drejt, do të gjejnë paqe. Të gjitha veprat e Zotit janë me drejtësi, ndërsa i pabesi ruhet për ditë të keqe.

Le të drejtohet lutja ime dhe shërbesa e të Parashenjtuara që mbetet. Në tryezë pime verë. Pasdarkën e bëjmë në qeli.

## CITIME

1. Gjen. 3.6
2. Gjen. 3.17-19
3. II Tim. 1.18
4. Joan 19.18
5. Ps. 59(60).6
6. Joan 10.11
7. Eks. 14.19-24
8. Ef. 2.14-15
9. II Tim. 4.8
10. Lluk. 15.13
11. Lluk. 15.15
12. Lluk. 15.18-20
13. Mark 7.32-35
14. Kol. 3.12
15. Joan 19.34
16. Matth. 27.34
17. I Mbret. [Sam.] 1.5
18. Joan 15.1
19. Joan 19.30
20. Joan 10.15,17-18
21. Ps. 103(104).15
22. Gal. 2.20
23. Ligji i Dytë 21.23; Gal. 3.13
24. Is. 6.3
25. Lluk. 1.48
26. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
27. Matth. 27.51-54
28. Vep. 16.17
29. Joan 1.13
- 29a Is. 66.7
30. Joan 1.3; Kol. 1.16
31. Matth. 27.48; Mark 15.36; Joan 19.29
32. Lluk. 10.30
33. Lluk. 10.35
34. Lluk. 10.31-32
35. Lluk. 10.34
36. Num. 14.19 etj.
37. Fil. 1.29
38. II Mbret. [Sam.] 22.10; Ps. 17(18).10; 143(144).5
39. Fil. 2.7

40. Matth. 8.20; Lluk. 8.3; 9.58; II Kor. 8.9
41. Ps. 50(51).3; 68(69).17; Is. 63.15
42. Mark 9.50
43. Lluk. 14.30
44. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
45. Gjen. 2.24; Matth. 9.5; Mark 10.7
46. Gjen. 2.7; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9
47. Rom. 13.14
48. Rom. 8.6-7
49. Hebr. 10.26
50. Ps. 118(119).175
51. Matth. 18.12
52. Amos. 7.2
53. I Tim. 2.4
54. Is. 43.26
55. Matth. 25.14-30
56. Matth. 9.20-22; Lluk. 8.43-47
57. Dan. 7.9
58. Gjen. 1.1-9
59. Rom. 14.10; Apok. 20.12
60. II Kor. 4.6
61. Matth. 12.29; Mark 3.27; Lluk. 11.21-22
62. Lluk. 7.37-38
63. Joan 1.1
64. Lluk. 15.14
65. Lluk. 15.23-24
66. Joan. 8.44
67. Urt. Sol. 2.24
68. Gjen. 3.24
69. Lluk. 23.42-43
70. Matth. 14.29-31
71. Joan 1.29,36; I Petr. 1.19
72. Lluk. 23.46
73. Ps. 50(51).13



## TË ENJTEN E JAVËS SË PESTË KANUNI I MADH

### A: NË PASDARKË B: NË MËNGJESORE

**A: NË PASDARKËN** (e së mërkurës)  
*Lexohet Pasdarka e Vogël deri në Të Meriton. Pas kësaj psalet Kanuni i Madh (pa Ndenjësoret dhe Triodet) me Varg "Mëshiromë, o Perëndi, mëshiromë" dhe Kanuni i shën Marisë me Varg "O oshë-nare e Perëndisë, ndërmjeto për ne". Pas Odes VI, psalet ngadalë Kontakti O shpirti im, o shpirti im. Pastaj Lumërimet e Ka-*



nunit të Madh, dhe Odet që mbeten. Në fund, Irmosi i Odes IX Pa prishje në bark. Trishenjtji, Kontaqi O shpirti im, o shpirt im (hima). Mëshiro, o Zot (40x), O Perëndi që adhurohesh, dhe të tjerat që mbeten nga Pasdarka e Vogël. Para "Me uratat" psallet (Ting. II Ote ek tu ksilu se): Gjithë\* sa përikin i përkrah\* ti nën mbrojtjen tënde të fortë, o Zonj' e shenjtë Mari,\* tjetër s'kemi ndërmjetim përpara Zotit t'Madh,\* në rrezik e në hidhërim, për ne pra kujdesesh,\* ne që po përmbysimi nga faj' i rënd' përdhe,\* Nën' e Perëndisë së lartë.\* ty po të përgjunemi, ngrina\* dhe shpëtona ne që po të lutemi.\*

*Të enjten në Mëngjesore:* Pas Alluiave (4x) me Vargjet e tyre, Himne Triadike të Tingullit si zakonisht. Ndenjësoret: Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret (apostolike etj.) të Tingullit si zakonisht. Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoerja e Triodit Ndrichues hyjshikimi (kërkoje pas Odes III, fq. 235). Lavdi dhe Tani Hyjlindësore (E ngjashme) Mbi dhe ka zbritur Fjala e Atit, Jisul; një engjëll drite të Hyjlindësja\* thërriste:\* Ki gaz, ti vetëm ruajte shtratin, zure kështu në zënie pra\* Zotin dhe Perëndinë e parajetshëm, o Vajzë plot bekim,\* që do shpëtonte si Zot Perëndi gjininë njerëzore. Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësoret e tjetra të Triodit Kor i hyzgjedhur. Lavdi dhe Tani Hyjlindësore Tok me apostujt (kërkoji gjithashtu pas Odes III, fq. 235). Psalmi 50 (hima). Stihologjia e Odeve. Kanunet: e Mujorit dhe Triodet e ditës (nga Triodi). Pas Odes III, Irmosi i Mujorit, Përsëri dhe përsëri etj. Ndenjësoret e Mujorit. Pas Odes VI, Irmosi i Mujorit. Përsëri dhe përsëri etj. Kontaqi O shpirti im, o shpirt im. Shtëpia. Sinaksari i ditës dhe i Triodit. Pas Odes VIII, Irmosi i Triodit: Ton ânarhon vasi-

lea Mbretin e pafillim të lavdisë. Më të nderuarën. Pas Odes IX, Irmosi po i Triodit: Se tin uranû qe jis Gjithë ne gjeneratat të madhështojmë ty, ndërmjetuesen e qiellit dhe të dheut, sepse në ty, o Virgjëreshë, fushoi trupërisht tërë Hyjnia. Të meriton. Fotagojiku i Tingullit. Ty të ka hije lavdi... Lavdi Perëndisë që është në më të lartat... etj. Në Pasvargje, Idhiomeli Meqenëse re, o shpirti im (2x), Martiriku dhe Hyjlindësori. Është mirë ta lavdërojmë Zotin etj. si të hënën e javës së parë në mëngjes (fq. 63). Në Orët dhe Lumërimet, Kontaqi O shpirti im, o shpirti im.

**B:** NË MËNGJESOREN (e së enjtes)

*Të mërkurën bëhet Pasdarka e Madhe.* Në vend të Mëshirona, o Zot, mëshirona etj. thuhet Kontaqi O shpirti im, o shpirti im. Shërbesa e Mëngjesores bëhet: A) ose në mbremjen e së mërkurës (pra Orët dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave bëhen të enjten në mëngjes dhe fillojnë: I bekuar është Perëndia ynë. O mbret qiellor. Trishenjtji, Mëshiro, o Zot (12x). Lavdi dhe Tani. Ejani t'i falemi.

B) ose në agimin e së enjtes, dhe në vazhdim Orët dhe Liturgjia e të Parashenjtëruarave. Mëngjesoria bëhet kështu: I bekuar është Perëndia ynë. O mbret qiellor. Trishenjtji. Mëshiro, o Zot (12x). Lavdi dhe Tani. Ejani t'i falemi. Psalmet mbretërore (19 dhe 20): Të dëgjoftë Zoti, ndërsa prifti temjanis. O Zot, shpëtoje popullin tënd etj. Gjashtë Psalmet. Paqësoret. Alluia (4x) me Vargjet e saj, Himnet Triadike të Tingullit si zakonisht. Ndenjësoret (apostolike etj.) të Tingullit si zakonisht. Psalmi 50 (hima). Stihologjia e Odeve. Kanuni i Madh me Varg: Mëshiomë, o Perëndi, mëshiomë dhe Kanuni i shën Marisë me Varg "O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne" (ndërsa të

*djya Triodet e apostujve psalen me Varg: O apostuj të Krishtit, ndërmjetoni për ne).*

*Kanuni i Madh, poezi e shën Andreas së Kretës\**

*Ting. Tërth. II*

*Ode I*

*Irmosi: Voithòs qe sqepastis*

»**M**'u bë ndihmës, mbrojtës, shpëtimtar, ky është Perëndia im pra\* dhe do ta lëvdoj, është Zoti ai\* për atin tim, do ta lartësoj shumë, se u lavdërua plot me lavd.<sup>1</sup> (2x)**H**

**N**ga t'ia nis un' që të qaj për veprat, jetën time të mjerë?\* Cilën nisje tash për vajtmin të bëj,\* o Krisht? Por, meqë i dhembshur je, jepma faljen për mëkatet që bëra. **H**

**E**ja, shpirt mjeran, me mishin tënd tok, bëj ti rrëfim te Zoti,\* Bërës i gjithçkaje, largohu kështu\* nga budallallëku i mëparshëm dhe sill te Perëndia lot, pendim. **H**

**T**ë parëguarin Adam e kisha zili në shkelje,\* ndaj e mora vesh se e zhvesha veten\* prej Zotit, shijimit, mbretëris' së përjetshme, nga mëkatet që bëra. **H**

**M**jerë, shpirt mjeran! Pse ngjave ti me Evën e parë? Se pe\* keq dhe u plagose vrer, pemën kështu\* e preke edhe me arrogancë shijove një ushqim paranojak. **H**

**P**o mendimi mëkatar në mish m'u bë si mendorja Evë,\* pra në vend të Evës së ndjeshme dikur:\* Tregon të pëlqyerat, shijon përgjithnjë edhe provon të hidhurat. **H**

**S**hpëtimtar, u flak Adami larg Edenit dikur siç duhej,\* meqë ky nuk ruajti një porosi\* që dhe ti; por un' që vazhdimisht t'i shpërfilla fjalët plot jet', ç'të pësoj? **H**

**P**ër sa varej nga dëshira, bëra vrasjen e neveritshme\* si Kaini dhe me ndërgjegje kam vrar'\* un' shpirtin, i dhashë jetë mishit dhe e luftova me veprim të keq. **M**

**O** Jisu, në drejtësi nuk ngjava dot me Abelin unë,\* nuk të solla kurrë dhuratë të mir'\* që pritej, as vepra Perëndie, as fli të pastër, jetë pa njollë. **M**

**D**he ne si Kaini, shpirt mjeran, Krijuesit të çdo gjëje\* i ofruam vepra të ndotura mjaft\* dhe fli të qortueshme, me jetë pa vlerë; ndaj dhe u dënuam fort. **M**

**M**a gatove baltën tok me jetën, o Tjegullar, më fute\* frymë, jetë, kocka dhe mish; Zoti im\* Gjykatës, Çlirues, Bërës, pritmë, pranomë mua që pendohem pra. **M**

**H**aptas t'i tregoj, o Shpëtimtar, mëkatet që bëra, plagët,\* si në shpirt ashtu dhe në trup, që m'i bën',\* m'i futën përbrenda si kusarë mendimet vrasëse plot neveri. **M**

**S**hpëtimtar, fajtova, por e di se je njerdashës, dhe rreh,\* por me dashuri dhembshuron nxehtësisht,\* si ati sheh birin pra plangprishës që qan, rend shejtit dhe e thërret rapë. **M**

**U**në dërgjem tash përpara derës sate, sado që jam plak,\* mos më hidh në Hadh, në boshllëkun e tij,\* por si njerdashës fa-

\* Për të mos u rënduar këtu me CITIMET, që në këtë rast janë tepër të domosdoshme, nuk i përsëritim te Troparet që u psalën në Pasdariat e javës së parë, por në fund të këtyre shënimejme germa. Kështu: "H" nënkupton se tropari është të hënën e javës së parë, "M" të martën, "m" të mërkurën dhe "E" të enjten.



li fajet e mia para fundit, Shpëtimtar. **m**

**U**në jam, o Shpëtimtar, ai që ra ndër kusarë, o Krisht,\* ndër mendime, nga k'to i tëri tani\* jam keq i plagosur plot me trauma, vetë ti arri dhe më shëro. **m**

**N**ë fillim, një prift më pa, kaloi anës; dhe një levit pas,\* kur pa në ç'tmerr isha, i zhveshur, as ky\* s'më dha rëndësi, por eja dhe dhembshuromë, ti që linde prej Maris'. **m**

**N**griji prangat fort të rënda të mëkatit nga unë, o Krisht,\* qengj i Perëndisë, që ngre çdo mëkat\* të njerëzve mbarë edhe lot kataniksi, si i dhembshur mjaft, më jep. **E**

**N**griji prangat fort të rënda të mëkatit nga unë, o Krisht,\* koha e pendimit tash është, kështu\* te ti rend, o Bërësi im, lot kataniksi, si i dhembshur mjaft, më jep. **E**

**M**os më neverit, mos m'hidh tej faqes sate,<sup>1</sup> prej meje hiqi\* prangat fort të rënda të fajeve, Zot,\* edhe si i dhembshur më jep ndjesë mëkatesh, shkeljesh, Shpëtimtari im.

**T**ë të vijë keq, o Çlirimtar, për shkeljet e tëra që kam,\* a të njohura, të panjohura tok,\* të dukshme, të fshehta, dashur pa dashur, ndjeji edhe më shpëto si Zot.

**P**rej rinis' i flaka porosit' e tua dhe tërë jetën\* e kalova me dembelizëm, pasion,\* shkujdesje, ndaj të thërras ty: Qoftë në fund, shpëtomë, Shpëtimtari im. **m**

**E** shpenzova pasurinë tënde, o Shpëtimtar, në shturje,\* kam shkreti virtyesh të mira, kështu\* i urët thërras: Arri, o atë i dhembshurive, dhembshuromë, Zot. **m**

**N**griji prangat fort të rënda të mëkatit, Jisu, nga unë,\* bie para teje, fajtova te ti;\*

më fal, të të vijë keq, pendim kam, ndaj si i dhembshur, Perëndi, pritmë. **E**

**Z**ot, në gjyq mos hyr me mua, mos më sill krejt sa duhej t'bëja\* dhe për hovet mos më kërko llogari;\* i tërëfuqishëm, m'i shpërfill si i dhembshur fajet tmerr dhe më shpëto. **E**

*Kanuni i oshënares Maria Egjiptiane (në Tingull dhe Irmos të njëjtë) që ka Akrostihidhë: "Ti, oshënarja Mari, ndihmo".*

**O** oshënore e Perëndisë, ndërmjeto për ne. **T**i më jep hir dritëplotë nga kujdesja hyjnore që lart,\* që të evitoj errësi' vesesh pra\* edhe t'i këndoj me zell rrëfimet e jetës sate gjithë hir, Mari. **m**

**O** oshënore e Perëndisë, ndërmjeto për ne. **K**ur u binde ti ndaj ligjeve hyjnore të Shpëtimtarit,\* hovet fort të vullshme të epshtit i le;\* si shkove te Krishti, krejt virtytet i bëre me kushtim, porsi një pra. **E**

### *Tropari i shën Andreas*

**O** shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne. **P**ërmes lutjeve të tua na çliro nga pasionet plot turp,\*<sup>2</sup> pjesëmarrës në mbretërin' e Krishtit\* tregoji, Andrea zëmadh, sa me mall, besë të himnojnë, lutemi.

### *Lavdi Triadik*

**M**biesenciale Shën Trini, të falemi në Njësi ne,\* hiq prej meje prangat e rënda plot tmerr\* të fajit edhe më jep mjaft lot kataniksi si e dhembshur plot me hir. **H**

### *Tani Hyllindësor*

**O** Hyllindëse, je shpresa, mbrojtja ti për sa të himnojnë,\* hiq prej meje prangat e rënda plot tmerr\* të fajit, si Zonjë e dëlirë, pranomë mua që pendohem sinqerisht. **H**

### *Ode II*

*Irmosi: Prôshe urané që laliso*

»**Ki** kujdes\* ti, o qiell, do flas un' dhe do  
»himnoj Zotin Krisht\* që nga e Virgjra na  
»erdhi brenda mishi pra. (2x) **H**

**Ki** kujdes\* ti, o qiell, do flas un'; o dhe,  
dëgjoje një zë,\* që po pendohet drejt Pe-  
rëndis' dhe e himnon. **H**

**Perëndi**,\* Shpëtimtari im, vër re me sy-  
rin tënd plot mëshir'\* edhe rrëfimin tim  
mjaft të nxehtë prite ti. **H**

**Shpëtimtar**,\* mëkatova më shumë se  
çdo njeri, vetëm un'\* fajtova, por dhemb-  
shuro krijimin tënd, si Zot. **H**

**Më** shtrëngon\* turbullim nga e keqja,  
por shtrima dorën, o Zot\* i dhembshur,  
siç bëre me shën Petron, Shpëtimtar. **H**

**Të** ofroj\* plot lot si prostituta,<sup>2a</sup> i miri  
Zot, Shpëtimtar,\* më dhembshuro, të të  
vijë keq për mua, Krisht.

**Bëra** terr\* bukurinë e shpirtit me vese,  
kënaqësi,\* dhe mendjen time të tër' e  
bëra pluhur krejt. **H**

**Dergjem** keq\* unë tash, lakuriq, se e  
grisa rrobën e par',\* stolin' që Bërësi në  
fillim ma thuri nur. **H**

**Jam** plot turp,\* se kam veshur këmishën  
që me këshillën e tij\* ma thuri gjarpri,  
këmisha është grisur keq. **H**

**Dergjem** keq\* lakuriq unë tash dhe kam  
turp, se pemën kam par'\* dhe bukurinë e  
saj, mashtrova mendjen pra. **H**

**Përbetim**\* bënin pra në kurrizin tim  
gjith' eprorët plot tmerr\* dhe vazhdimisht  
kundër meje shkelnin ligjin keq. **H**

**Humba** keq\* hijeshin', bukurinë e bërë  
qysh në fillim,\* më parë, dergjem tani i  
zhveshur, plot me turp. **m**

**Faji** tmerr\* dhe për mua këmisha lëkure  
qepi, pasi\* ma zhveshi më parë rrobën e  
hyjthurur lart. **M**

**Veshje**, rrob'\* kam stolinë e turpit si gje-  
the fiku, kështu\* kjo më qorton për pa-  
sionet që i bëj lirshëm. **M**

**Mua** pra\* më stolisi këmisha plot njollë,  
plot gjak me turp\* nëpërmjet rrjedhjes  
nga jeta me pasion dhe epshe. **M**

**Ndota** keq\* këtë: »Sipas ikonës dhe  
ngjashmëris', Shpëtimtar,\* meqë këmi-  
shën e mishit e njollosoa mjaft. **H**

**Rashë** keq\* brenda dhimbjes së vesit,  
prishja lëndore më zhdruk,\* prandaj tani  
mizorisht më shtyp armiku djall. **M**

**Jam** tani,\* Shpëtimtar, me zinxhirë të  
rënd', se zgjodha një jet'\* mikeshë lënde  
dhe pronash, dhe jo mospasjen. **M**

**Mishin** tim\* si statujë e veshë me lloj-lloj  
rrobash, stolish,\* përmes mendimesh të  
turpshme dhe dënohem fort. **M**

**Vetëm** për\* bukurinë e jashtme me  
zell kujdesesha un',\* shpërfilla tendën e  
brendshme që ka tip hyjnor. **M**

**Prisha** keq\* bukurinë e mendjes me  
vrulle mishi, me epshe,\* kështu formova  
shëmtimin e pasioneve.

**Shpëtimtar**,\* e kam nxirë përmes vesesh  
bukurinë që kish\* dikur ikona, kërko dhe  
gjeje si dhrahmin'. **M**

**Të** thërras:\* Si Laviija fajtova ndaj teje  
vetëm un' pra,\* prit dhe nga unë si miro  
lot, o Shpëtimtar. **M**

**Shpëtimtar**,\* si Davidi rëshqita në shtur-  
je, Jam bërë pis,\* por ti me lotët e mi më  
laj edhe mua. **m**



Të thërras,\* Zot, porsí Doganieri; Kursemë, o Shpëtimtar;\* ndaj teje, si un', s'fajtoi asnjë adamian. **M**

Nuk kam lot,\* as pendim, kataniks, mirëpo ti si Perëndi\* ato m'i jep pra, o Shpëtimtar plot mirësi. **m**

Mos ma mbyll\* derën tënde, Zot, Zot, atëherë përfundimisht;\* për mua hape, se po pendohem drejt teje. **m**

Ti që do\* të shpëtojme të gjithë, o Njeridashës, sërish\* porsí i mirë, më thirr, më prit, jam plot pendim. **m**

Zot, dëgjo\* psherëtimat e shpirtit tim, shih dhe lotët si çurg\* që derdhin sytë e mi, më ndje dhe më shpëto. **m**

#### *Hyllindësor*

Pa pushim\* përgjërohu për ne të shpëtojme, o Virgjëresh'\* pa cen, Hyllindëse; krejt himnoshesh vetëm ti. **H**

*Irmos tjetër: Ìdhetë, idhete otti ego  
I njëjti*

»Shihni ju, shihni ju, se unë jam Zot, Perëndi,\* që hodha manën si shi edhe nxorra qëmoti\* për popullin tim në shkretëri prej guri ujë me vetë forcën time, me të djathtën time pra. **m**

»Shihni ju, shihni ju, se unë jam Zot, Perëndi,\* thërret, shpirt, Zoti; ndaj dëgjo, largohu nga fajti\* që bëje, kije frikë si hetues edhe gjykatës dhe si Perëndi të drejtë me fuqi. **m**

Mjerë! Shpirt shumëfajtor, ti me cilin Kain ngjan?\* Me k'të të parin a me tjetrin, Lamehun? Dhe ti\* me gurë vrave trupin, me keqbërje; vrave dhe shpirtin përmes hoveve paranojake krejt. **m**

Kot tejkalove çdokënd që ish para Ligjit,

shpirt;\* me Sithin ti nuk ngjave, s'imitove Enosin\* dhe as Enohun në zhvendosje, dhe as Noen; të varfër nga jetesa e të drejtëve të shoh. **m**

Vetë ti hape, o shpirt, kataraktet plot inat\* të Perëndisë tënd: Si dhë i mbyte të tëra,\*<sup>24</sup> pra mishin, veprat, jetën; ndaj kështu ke mbetur përjashta arkës shpëtimtare, por pendohu ti. **m**

Duke vajtuar Lamehu keq: "Vrava një të ri\* për trauma për veten dhe një burrë për plagë",\* thërriste ky; por ti nuk trembesh që u ndote në mish dhe u njollose mjaft në mendje, shpirti im. **E**

Oh, si zilepsa Lamehun, pra vrasësin dikur!\* Si një të ri e vrava shpirtin tim, mendjen time\* si burrë edhe si Kaini vrasës trupin, vëllanë dhe me epshet, dhe me vrullet plot marri. **E**

Shpirt, keq mendove të ngrije një pìrg, të bëje ti\* për dëshirimet një fortifikatë, në Zoti\* vet' nuk do ta ndërlikte krejt mendimin tënd dhe dredhit' e tua nuk do t'i rrafshonte totalisht. **E**

Ja pra shigjetat që hodhi armiku, jam krejt plag';\* në shpirt, në trup më shpuan; ndaj ja traumat, plagët\* dhe sakatimet po thërrasin, deklarojnë goditjet e pasioneve që bëra me vullnet. **E**

Zoti, qëmoti prej Zotit kish hedhur zjarr si shi,\* dhe shturjen e paudhë të Sodomës e dogji;\* por zjarrin e Gjehenës ti e ndeze, o shpirt, në të ke për t'u djegur me tmerr dhe hidhërim. **E**

Njihni dhe shihni se unë jam Zot dhe Perëndi,<sup>20\*</sup> që zemrat i hetoj,<sup>3</sup> i kontrolloj veprat mbarë,\* mendimet i dënoj, djeg fajet, i gjykoj të vobektët, të përlulurit, jetimët,<sup>4</sup> çdo të ve.

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. **D**rejt Perëndisë së dhembshur i shtrive duart ti,\* Mari, kur ishe zhytur në avushë të keqe,\* edhe si Petros, dorë, ndihm' të dha ty, meqë patjetër e kërkonte kthimin tënd, shpëtimin tënd. **E**

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. **G**atishmërisht, me mall rende drejt Krishtit pra, pasi\* me neveri le udhën e mëparshme të fajit;\* ushqeheshe në shkretëtira të pashkelura, bëje porosit' e tij hyjnore pastër boll. **m**

O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne. **S**hihe, o shpirt, njeridashjen e Zotit Perëndi,\* ta shohim para fundit ne, të biem në gjunjë\* me lot përpara tij dhe të thërrasim: O Shpëtimtar, na mëshiro me lutjet e Andreas shenjt.

Lavdi *Triadik*

**P**ritmë, se jam plot pendim, o Trini pa kohë, mot,\* e pakrijuar; o Njësi pa ndarje, shpëtomë,\* sado fajtova, por krijimi yt jam, mos më shpërfill, kursemë; nga dënimi, zjarr më çliro. **m**

Tani *Hyllindësore*

**Z**onjë, hyjnënë, pa cen, ti je shpresë për sa vijn',\* përikin pranë teje, je liman për sa janë\* në dallgët e shtrëngatës; Birin tënd, Krijuesin tënd përdëllimtar, për mua lype, zbutë pra. **m**

*Ode III*

*Irmosi: Epi tin asálefton Hristé*

»**K**ishën tënde, Krisht, forcoje mbi gurin »e palëkundur\* të urdhrave të tu pra që na »dhe. **H**

**Z**jarr prej Zotit Zoti hodhi dikur si shi dhe e bëri\* më parë tokën e Sodomës shkruab. **H**

**E**dhe ti, shpirt, si ai, pra shën Loti, në

mal me vrap ik,\* arri që në Sigor lart të shpëtosh. **H**

**O** shpirt, ik larg flakës prush të Sodomës, dhe evitoje,\* dhe ik nga prishja dhe hyjnore zjarr. **H**

**S**hpëtimtar, te ti rrefehem, fajtova pa masë unë,\* por si i dhembshur falmë, ndjemë, Zot. **H**

**M**ëkatova vetëm unë ndaj teje më shumë' se çdokush,\* o Krisht dhe Shpëtimtar, mos më shpërfill. **H**

**M**ë kërko, jam delja, ti je bariu i mirë, o Krisht,\* edhe mos më shpërfill se kam humbur. **H**

**J**e i ëmbël ti Jisu; ti Gatuesi im; me ty, Krisht\* dhe Shpëtimtar, do drejtësohem un'. **H**

Lavdi *Triadik*

**P**erëndi, Trini, Njësi, na shpëto nga mashtrimi, hilja,\* nga ngasjet dhe peripecitë pra. **H**

Tani *Hyllindësore*

**N**gazëllohu bark hyjpritës, o nëna e jetës sonë;\* gëzohu, je fron Zoti, ki hare. **H**

*Irmos tjetër: Steréoson Kirie*

»**F**orco zemrën time, Krisht,\* të tundur »keq, përmbi gurin, shkëmbin,\* pra të »urdhrave të tu fort ti,\* se je Zot i vetëm dhe i shenjtë; lavdi më ty. (2x) **M**

**T**ë kam krua jete ty,\* shkatërrimtarin e vdekjes, me zë\* të them para fundit: Më shpëto,\* mëkatova, të të vijë keq, të më falësh, Zot. **M**

**O** Zot, imoralët krejt\* që po jetonin me Noen bashkë,\* i pasova, trashëgova un'\* dhe ndëshkim në zhytje, në përmbytje, o Shpëtimtar. **M**

**F**ajtova te ti, o Zot,\* fajtova, ki dhemb-



shuri për mua;\* s'ka asnjë fajtor mes njerëzve\* që në shkelje nuk e tejkalova, i mjeri un'.

M

O shpirt, atëvrasësin,\* të poshtrin Ham e ke imituar,\* turpin e të afërmit tënd pra\* s'e mbulove, nuk u ktheve prapa kur ecje ti.

M

Bekimin e Sithit, shpirt\* i mjerë, s'e trashëgove; pronën\* nuk e kishe hiç të gjerë ti,\* siç e kish Jafethi shenjt, në dheun e faljes pra.

m

Nga toka e fajit dil\* si nga Harani, o shpirt i mjerë,\* eja ti në tokën që gjithnjë\* rrjedh paprishje, jet', që Abrahami kish trashëgim.

m

Dëgjoje, o shpirti im,\* se Abrahami lashtë la dheun\* atëror dhe emigrant u bë,\* imito vullnetin që kish plot predispozicion.

m

Shën engjëjt i priti mir'\* në valanidh, në Mamvri, prandaj dhe\* trashëgoi gjahun, djalin, bir,\* sado kish kaluar patriarku mjaft pleqërin'.

m

Meqë Isaakun, shpirt,\* di që ish bërë fli, holokaust,\* mistikisht te Zoti, o i mjer',\* imito vullnetin që kish plot predispozicion.

m

U flak Izmaili, shpirt,\* e ke dëgjuar, si bir i skllaves,\* ki gatishmëri edhe kujdes,\* shih të mos pësosh diçka të tillë po të kesh epsh.

m

Shpirt, ngjan me Agarën ti,\* pra egjiptianen e lashtë, meqë\* në vullnet u skllavërove keq\* dhe e linde arrogancën si Ismail të ri.

E

E di që po shfaqej, shpirt,\* nga toka drejt qiellit lart shkalla\* e Jakovit, pse s'e kishe ti\* porsi bazë të sigurt mjaft edhe të

fort' besën?

E

Ndër njerëz, shpirt, imito\* ikonizimin e Krishtit, Zotit,\* brenda jetës tokësore, pra\* të veçuarin mbret si dhe priftin e Perëndisë'.

E

Kolon' kripte, shpirti im,\* ti mos u bëj dhe as mos u kthe pas,\* frikësohu ti nga shembulli\* i Sodomës, mirëpo shpëto në Sigorin lart.

E

Si Loti të shmangesh ti,\* o shpirt, nga zjarri i fajit, ik larg\* nga Sodoma dhe Gomorra tok,\* evito çdo flakë të oreksit paranojak.

M

Thërras: Mëshiomë, Zot,\* më përdëlle kur të vish së bashku\* ti me engjëjt e tu të shpërblesh,\* të shpaguash njerëzit pas veprave që bënë.

M

O Zot njeridashës krejt,\* mos e hidh poshtë keq përgjërimit\* e himnuesve të tu, ki dhembk',\* jepu falje meqë e kërkojnë me besë plot.

E

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. Furtuna po më shtrëngon\* me dallgë shkeljesh, prandaj shpëtomë\* dhe ti vetë futmë që tani\* në një gji pendimi të hyjnueshëm, o nënë.

m

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. Ti hyrjet hyjnore lart\* tani m'i hap pra, o oshënare,\* duke sjellë ndërmjetimin tënd,\* përgjërim me lutje tek e mira Hyllindëse.

m

O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne. Dhuromë dhe mua ti,\* epror i Kretës, ndjes' fajesh përmes\* lutjes sate, o Andrea shenjt,\* se je mist, mësues i shkëlqyer fort për pendim.

Lavdi *Triadik*

Natyre e pafillim,\* Njësi e thjeshtë, e

pakrijuar,\* në tri hipostaza të himnojm'\* dhe me bes' i falemi pushtetit tënd; na shpëto. **M**

Tani *Hyлиндësor*

**T**i Birin pa kohë krejt\* të Atit, pa burrë e ke lindur,\* o Hyjnënë, brenda kohës pra,\* mrekulli e huaj: Dhe gjë, por mbete virgjëresh' . **M**

*Irmosi: Steréoson Kírie*  
Forco zemrën time

*Ndenjësose, poezi e Josifit*  
*Ting. Tërth. IV Anestis e nekrón*

**N**drichues hyjshikimi që Zotin e patë,\* ndriconani se kemi errësir'\* në jetë,\* ndrirtshëm tani të ecim me hijeshi si në dit'<sup>5</sup> me vezullim\* dhe me vetëpërbajtje, duke dëbuar pasione nate larg,\* me gaz pësimin plot lavdi të Krishtit Shpëtimtar ta shohim.

*Tjetër, poezi e Theodorit*

Lavdi *I njëjti To prostahñen*

**K**or i hyzgjedhur, të dymbëdhjet' apostuj,\* tani t'i sillni\* Krishtit përgjërím, të gjithë\* stadiumin e kreshmës\* ta kalojmë mirë,\* t'i bëjmë me kataniks lutjet, dhe virtyt\* të marrim gatishmërisht ne,\* edhe kështu\* të arrijmë ta shohim ngjalljen plot lavdi të Jisuit Perëndi, Zot, duke sjell' \* lavdërim, himn, dhoknologji.

Tani *Hyлиндësore*

**T**ok me apostujt, ti lype të panxënshmin\* Perëndi Fjalë,\* Birin që nga ti pëmbi mend,\* pa shpjegim lindi, paqe\* të vërtet', të çiltër\* t'i japë planetit, ndjesë fajesh te ne;\* t'u falë përpara fundit,\* lart mbretërin'\* qiellore shërbyesve të tu dhe t'i denjësojë prej së skajshmes mirësi\* si i shumëmëshirshmi Zot.

*Ode IV*

*Triodi i apostujve, poezi e Josifit*  
*Ting. Tërth. IV*

*Irmosi: Isakioa Kírie tis ikonomas su*  
»**K**am dëgjuar misterin qart'\* të Ekonomis' sate, dhe kuptova krejt\* veprat »që ke bërë<sup>6</sup> dhe prandaj\* lavdërova un' »hyjninë tënde, Zot.

**A**postujt e ndriçuar të Krishtit, përdërisa bashkëjetuan me vetëpërbajtje, na hijsojnë kohën e kreshmës me ndërmjetimet e tyre të hyjshme.

**K**ori i perëndishëm i Nxënësve, instrumenti me dymbëdhjetë korda, nxori meloditë shpëtimtare dhe i ngatërroi këngët djallëzore.

**M**e shirat e Shpirtit e vaditët tërë kozmosin, pasi dëbuar thatësi tërë e politeizmit, o ju që ju lumturojmë shumë.

*Hyлиндësor*

**P**asi të më përlësh mua që jetova me kryelartësi, më shpëto meqenëse e lindi atë që e ngriti natyrën e përlulur, o e Tërdëlitë.

*Triodi tjetër i apostujve, poezi e Theodorit*  
*Ting. i njëjtë Isakioa Kírie tin akoin*

**O** kor i tërërespektuar i apostujve, lutju me përgjërím Krijuesit të të gjithave,<sup>7</sup> që të na mëshirojë ne që të mburrim ty.

**O** apostuj, meqë ishit punëtorë të Krishtit<sup>8</sup> dhe me fjalë hyjnore e kultivuat botën mbarë, i sillnit atij fryte gjithmonë.

**U** bëtë vresht për Krishtin e dashur vërtet,<sup>9</sup> sepse verën e Shpirtit e nxorët për botën, o apostuj.

Lavdi *Triadik*

**O** Atë, Fjalë, Shpirt i Shenjtë, Trini e Shenjtë, e përmëbipushtetshme e me një pamje, e tërëfortë, Perëndi, dritë dhe jetë,



ruaje grigjën tënde.

Tani *Hyllindësor*

Gëzohu, o fron pamjezjarrtë,<sup>10</sup> gëzohu, o kandil llambadheprurës,<sup>11</sup> gëzohu, o mal shenjtërimi,<sup>12</sup> arkë e jetës,<sup>13</sup> tendë e hyshme shenjtoreësh.<sup>14</sup>

*Kanuni i Madh*

*Irmosi: Akikoen o profitis*

»Dëgjoji për ardhjen tënde\* profeti dhe e «kapi frika, se do të lindësh\* nga e Virgjra, «edhe njerëzve në dhé\* do t'u shfaqesh ti, «do t'u tregohesh krejt,\* dhe thoshte: Zot, «dëgjimin tënd e dëgjoja plot tmerr,\* dhe «kam frik'; lavdi forcës sate pra. (2x) H

Gjykatës i drejtë, veprat\* dhe bërjen tënde mos i lër, mos i shpërfill ti;\* sado vetëm un' fajtova si njeri,\* njeridashës, më fort se të vdekshmit krejt,\* por ke pushtetin e të gjithave – se Zot je –\* që të falësh shkeljet si Perëndi. H

Afrohet, o shpirt, mbarimi,\* afrohet fundi dhe s'kujdesesh, nuk je gati,\* koha është' e shkurtër; ngrihu, ështëë bri,\* afër, pranë derës, Zoti yt gjyqtar;\* si lule dhe si ëndërr koha e jetës rend shpejt,\* pse ne shqetësohemi fare kot? H

Shpirt, zgjohu, mendoji veprat\* që bëre edhe silli para faqes sate,\* derdh dhe pika lotësh; shprehja qartësisht\* Zotit Krisht çdo punë që ke bërë ti,\* mendimet dhe kujtimet, edhe kështu do marrësh\* edhe drejtësimin dhe faljen njësh. H

Në jetë s'ka as të keqe,\* as vepër, as mëkat që unë nuk e bëra\* si me mendje, me vullnet dhe fjalë tok,\* Shpëtimtar, dhe mëkatova praktikisht\* edhe gjakftohtësisht me punë, plot turp më shumë\* se askush mbi dhe gjer tani, o Zot. H

Prandaj ndërgjegjja ime\* më ka gjykuar

dhe më ka dënuar mua,\* s'ka asgjë aq shumë' të dhunshme se ajo\* brenda botës, Çlirimtar, gjyqtari im;\* je tërënjohës, më kurse, më çliro pra mua,\* më shpëto, mjeran jam, më përdëlle. H

I madhi ndër patriarkë,\* shpirt, pa qëmoti shkallën, që ish tip për hipje\* diturore, ish dhe ngritje në praktik';\* ndaj, në do që të jetosh, bëhu i ri\* me veprën njësh dhe teorinë dhe diturinë\* përtëritu përmes virtyteve. H

Duronte nga varfëria\* dhe ditën vapën, vuante nga ngrica natën\* patriarku, bënte vjedhje në çdo dit'\* dhe kulloste, kryente me mund çdo pun';\* kështu ky do të merrte edhe dy gra së bashku,\* bënte pra përpjekje të lodhshme mjaft. H

Mendo si dy gratë, lutem,\* veprimtarin' dhe dijen tok me teorinë,\* Lian, si veprim, se shumë' fëmijë kish,\* si Rakelën, dijen që ka lodhje plot,\* se pa mund nuk arrihet fare, o shpirt, as punë\* dhe as teori, s'bëhet dot asgjë. H

Ji gati, shpirt, bëj arritje\* si patriarku më i madh, që të fitosh ti\* vepër tok me njohuri, të bëhesh k'shtu\* dhe një mendje që sheh Perëndinë Zot,\* të shkosh me teori në mjegull pa perëndim hiç\* dhe kështu të bëhesh tregtar i madh. M

I madhi ndër patriarkë\* u bë me dymbëdhjetë patriarkë, o shpirt,\* një shkall' ngjitjeje praktike vuri drejt,\* e vendosi mistikisht mjaft urtësisht;\* mbështetjen porsi baza, bijtë porsi shkallësa\* seç i rregulloi për ty saktë. M

Meqë ti, o shpirt, zilepse\* Isavin e urryer, bukurin', të drejtën\* e të parëlindurit, mashtruesit\* ia dhe; ndaj re nga bekimi atëror,\* dyfish k'shtu u mashtrove, o mje-

ran, në praktikë\* dhe në dije, ndaj ki pëndim tani. **M**

**I**savi, Edhom u quajt\* se kishte epush të madh për bashkim shpesh me femra,\* se gjithnjë nga mospërbajtja digjej fort\* dhe njollosej prej kënaqësive keq;\* Edhom u quajt që përkthehet fug', nxehtësi, vap',\* vapë shpirti, shok, mik mëkatesh, terr. **M**

**D**ëgjove se u drejt'sua\* i ulur sipër plehrash Jovi, nuk zilepse\* burrërin' e tij, edhe nuk kishe, shpirt,\* as fuqinë e moralit të tij ti\* në çdo gjë pra që dije, njihje si edhe bëje,\* por në ngasje u shfaqe pa durim. **M**

**A**i që mbi fron përpara\* po ulej, rri tani mbi plehra gjithë plagë,\* lakuriq ky famëmadi me mjaft bij.\* Befasisht u duk pa bij dhe pa shtëpi.\* Mendonte plehrat si pallat mbretëror plot prehje\* dhe margaritarët mbar', traumat. **M**

**I**drejtë krejt një njeri ish,\* dhe vishej me purpur, në grad' mbret me kurorë,\* me kope, me pasuri të bollshme tok,\* dhe me shumë prona; mirëpo u bë\* i varfër befasisht dhe humbi lavdin' e tërë\* si dhe mbretërinë vërtet mjerisht. **E**

**N**ë ky që i drejtë ishte,\* i paqortueshëm më shumë se çdo tjetër\* dhe nga kurthet, sprovat e mashtruesit\* nuk shpëtoi, ti që je mik faji keq,\* mjeran shpirt, çfarë do të bësh kur të ndodhë ngasje,\* kur gjë që s'e pret do të sulet fort? **E**

**U**ndota në trup, njollosa\* dhe shpirtin mjaft, i tëri un' jam i plagosur,\* por si mjek, Krisht, m'i shëro të dya; Zot,\* me pendimin tim, pastroji, laji krejt\* dhe çndoti, Shpëtimtari im, dhe këto tregoji\* më të pastra se bora, Perëndi. **m**

**F**lijove për ne të gjithë,\* o Fjal', kur kryqëzoheshe, trupin dhe gjakun;\* trupin tënd që t'më rigatuash ti,\* ndërsa gjakun tënd të më lash dhe pastrosh;\* e dorëzove shpirtin, o Krisht, që të më sjellësh,\* o Jisu, te Prindi yt, Ati yt. **m**

**I**dhembshur, shpëtim punove\* në mes të dheut që t'shpëtojmë, dhe me dashje\* ti në dru u kryqëzove dhe kështu\* na u hap Edeni që ish mbyllur krejt;\* të sipërmet, të poshtmet, kombet mbar', pra Krijesa,\* si shpëtoi, o Zot, të falet ty. **m**

**U**bëftë si kolimvithër\* për mua, Fjalë, gjaku që nga brinja jote\* kishte rrjedhur tok me pijen që më dha,\* më buroi ujë ndjese dhe kështu\* do lahem me të dya mir' kur të lyhem, do pi\* si një pije fjalën plot jet' që the. **m**

**I**zhveshur jam për martesën,\* i zhveshur dhe për darkën, dhe për nusëroren;\* llamba s'kish vaj dhe u shua, dhe m'u mbyll\* dhoma nusërore, sepse filja gjum';\* mbaroi darka edhe mua më hodhën jashtë,\* si m'i lidhën duart dhe këmbët tok. **m**

**E**ka brinjën tënde Kisha\* si kanë, është jetëprurëse, buroi\* për ne kroin e dyfishtë, ditori\* edhe falje porsi një simbolizim\* të dy pra Dhiatave, së Vjetrës, së Resë bashkë;\* o Zot Shpëtimtar, na dhurove hir. **m**

**Z**ot, koha e jetës sime\* e shkurtër është, plot dinakëri dhe dhimbje;\* por më prit, Zot, me pendim dhe më rithirr\* në ndër-gjegjësim, që të mos bëhem un'\* ushqim as pronë e të huajit, Shpëtimtar Krisht,\* ndaj më dhembshuro vetë ti, Jisu. **E**

**T**ash jam arrogant në zemër\* kot, humbazi, fodull në fjalë dhe në mendje,\* por me Fariseun, Zot, mos më dëno,\* për



më tepër ma dhuro përlulësin\* e Tagrambledhësit, gjykatës i drejt', i saktë\* dhe i dhembshur, më numëro me të. **E**

**E** di qart' se mëkatova,\* i dhembshur, poshtërova enën time, mishin,\* por më prit, Zot, me pendim dhe më rithirr\* në ndërgjegjësim, që të mos bëhem un'\* ushqim as pronë e të huajit, Shpëtimtar Krisht;\* ndaj më dhembshuro vetë ti, Jisu. **E**

**E** bëra krejt veten idhull,\* sepse njollosa rëndë me pasione shpirtin,\* por më prit, Zot, me pendim dhe më rithirr\* në ndërgjegjësim, që të mos bëhem un'\* ushqim as pronë e të huajit, Shpëtimtar Krisht;\* ndaj më dhembshuro vetë ti, Jisu. **E**

**S**u binda, s'dëgjova zërin\* as Shkrimin tënd që ti, Ligjvënës, na dhe neve,\* por më prit, Zot, me pendim dhe më rithirr\* në ndërgjegjësim, që të mos bëhem un'\* ushqim as pronë e të huajit, Shpëtimtar Krisht;\* ndaj më dhembshuro vetë ti, Jisu. **E**

**O** oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. **E**dhe pse në trup ti ishe,\* në jetë si pa trup ke jetuar, more\* hir të madh vërtet prej Zotit Perëndi,\* oshënare; mbro sa të nderojnë ty\* me besë, ndaj të përgjërohemi, nga çdo ngasje\* na çliro me lutjet e tua, nën'.

**O** oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. **S**'u kape kur kishe rënë\* në thellësi veprimesh pa vend, veçse rende\* me mendim të mirë shumë lart, Mari,\* drejtas kulmit të virtytit qartësisht\* përmes praktikës së çuditshme dhe e habite,\* shtange dhe natyrën e engjëjve. **E**

**O** shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne. **A**ndrea, lavdi për Etër,\* meqë rri pran'

Trinisë<sup>15</sup> së mbipërendishme,\* mos harro të përgjërohesh tek ajo,\* përmes lutjes sate të çlirohemi\* prej Ferrit ne që po të quajmë me plot mall ty\* mbrojtës, zbukurimin e Kretës nur.

#### Lavdi *Triadik*

**P**a ndarje në esencë,\* pa ngatërrim Personash të teologoj k'shtu,\* një Hyjni, Zot trinisor; tok mbretëron\* edhe je i bashkëfronshëm; të thërras\* të madhen këngë që himnohet në më të lartat,\* edhe refresh, ty të këndoju unë. **H**

#### Tani *Hyjindësor*

**D**he lind, dhe je virgjëreshë,\* e virgjër në natyrë mbetesh me të dyja,\* Biri përsërit pra ligjin natyror,\* mitra ka një shtatzëni unike krejt,\* se mposhtet rendi natyror ku do Perëndia,\* meqë bën ai sa do për një çast. **H**

#### *Ode V*

##### *Irmosi: Ek niktós orthrizonta*

»**P**o mëngoj menatë, njerldashës Zot,\* »lutem, ndriçomë ti,\* udhëhiqmë në drejtëtim,\* në urdhrat e tu mua,\* mësomë që »përherë\* ta bëj dëshirën tënde. (2x) **H**

**J**etën e kalova përgjithnjë si nat',\* meqë për mua ish\* terr dhe mjegullë e thell'\* nata e fajit, por ti\* tregomë, o Shpëtimtar\* i mirë, si bir dite. **H**

**D**uke imituar keq Ruvinin pra,\* unë i mjeri fort\* bëra kundër Zotit lart\* vendim pa ligj, jasht' normës\* se bëra pis shtratin tim\* si ky atë të atit. **H**

**T**ë rrëfehëm, Krisht mbret, bëra faj, mëkat,\* pors i vëllezërit\* përkundrejt Josifit shenjt\* më parë, që e shitën\* atë, që ishte një fryt\* urtie, pastërtie. **H**

**S**hpirti fort i drejtë nga të afërmit\* jepej

në shkllavëri,\* shitej ky i ëmbli mjaft,\* tipi i Zotit ishte;\* ndërsa të tërin, o shpirt,\* të shitën të këqijat. **H**

Imitoje, shpirt mjeran dhe pa sukses,\* mendjen e urtë mjaft,\* të fort drejtin shën Josif,\* mos kurvëro me vrullët\* e palogjikshme, mos bëj\* gjithnjë paligjësi, faj. **H**

Edhe pse banoi brenda gropës keq\* qëlashti, Mjeshtër Zot,\* shën Josifi para-dha\* tip për varrimin, ngjalljen\* që shfaqet; por unë ç'gjë\* të till' dikur të sjell ty? **H**

More vesh se dallgë lumi sillnin, shpirt,\* shportën që brenda kish\* Moisiun, kjo si dhom\* ishte qëmoti; ikte\* nga drama plot hidhërim\* prej urdhri faraoni. **M**

Shpirt mjeran, dëgjove se mamit' dikur\* vrisnin çdo mashkull, djal'\* të papjekur, - ishte kjo\* vrasja e mençurisë - \* si Moisiu i madh,\* urtin' tani ta rritësh. **M**

Mendjen egjiptiane e godite, shpirt,\* si Moisiu shenjt,\* zëmadh, por s'e vrave dot;\* dhe në shkreti pasionesh,\*<sup>4</sup> i mjerë, si do banosh\* përmes pendimit? - thua. **M**

Në shkreti banoi shenjt'i famëmadh,\* shenjt Moisiu, shpirt;\* eja imitoje ti\* sjelljen e tij, të shohësh\* hyshfaqjen po gjithashtu\* në ferrën që nuk digjej. **M**

Shfaqu si purteka e profetit pra,\* e Moisiut, shpirt,\* detin e goditi kjo,\* fundi u mpiks, me shenjë\* e Kryqit; dhe ti me të\* sukses do të arrish krejt. **M**

Ish autentik krejt zjarri, pa dredhi,\* shpirt, që i sillte drejt\* Aaroni Perëndis',\* por jet' të huaj, pise\* te Zoti sillnin, si ti,\* Ofni dhe Fineesi. **M**

Meqë kam logjik' të zhytur si në det,\* në mend i rëndë jam\* si në shpirt edhe në

trup,\* Janisi jam, Jamvrisi\* për faraonin plot vrer,\* por ti, o Zot, ndihmomë. **M**

E përzjeva mendjen tok me baltë un',\* të përgjërhem ty\* përmes lotëve të mi:\* Jam qyq, më laj si me dush,\* stolin' e shpirtit tim, Zot,\* ma zbardh porsi dëbora. **M**

Po të hulumtoj veprimet që kam bër',\* o Shpëtimtar, do shoh\* unë se krejt njerëzit\* në faj i tejkalova,\* se mëkatova me shpirt,\* me dije, jo pa dije. **M**

Të të vijë keq, Zot, për krijimin tënd,\* ndaj më kurse, më fal,\* mëkatova; vetëm ti\* je në natyr' i pastër,\* veç teje s'ka tjetër pra\* pa njollë dhe pa ndotje. **M**

U formove, Shpëtimtar, si ne për ne;\* si Zot ke bër' çudi\* dhe shërove lebrën ti,\* forcove paralizën\* dhe ndale hemo-rragjin'\* e gruas që të preku. **M**

Imitoje, shpirt mjeran, gjakrrjedhësen,\* rend, mbaje rrobën ti,\* cepin e Jisuit Krisht,\* prej fshikullash çlirohu\* dhe do dëgjosh nga ai:\* Ke bes', kjo të shpëton ty.<sup>16</sup>

O shpirt, imitoje të kërrusurën,\* dhe gjunjëzohu ti\* ndaj Jisuit, si t'i vish,\* që të të rimëkëmbë,\* të ecësh drejt në çdo udh'\* të Zotit, Perëndisë. **E**

Ti, meqë je pus i thellë, Zoti im,\* m'i nxirr dhe rrjedhat plot,\* nga damari yt hyjnor\* pa cen; buron, rrjedh jetë\* të pi, të mos kem rreshk un',\* porsi Samaritania. **E**

Mua pra m'u bëfshin lotët Siloam,\* o Krisht Zot, që t'i laj\* bebet zemërore krejt,\* që të të shoh ty që je\* shkëlqimi, o Shpëtimtar,\* dhe drita para jetës. **E**

O oshënore e Perëndisë, ndërmjeto për ne. **M**  
Me një dashuri pa krahasim, Mari,\* de-



she t'i faleshe\* drurit, Kryqit, denjësisht,\* realizove mallin;\* dhe mua më denjëso\* që të arrij në lavd lart. **E**

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. Kur kalove rrymën e Jordanit ti,\* prehje pa dhimbje krejt\* në mish gjete, meqë pra\* shmange kënaqësi, epush;\* shpëtona ne nga ato\* me lutjen tënde, nënë. **m**

O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne. Me një mall madhor, Andrea fort i urt,\* lutem me frikë tok,\* i shkëlqyer ndër barinj,\* epror, me lypjen tënde\* të gjej çlirim dhe shpëtim,\* dhe jetë të amshuar.

#### Lavdi *Triadik*

Të lëvdohmë, o Trini, një Perëndi,\* At', Bir, Shpirt; je i shenjt,\* je i shenjtë, je i shenjt,\* Njësi e thjeshtë, Zoti,\* esenca që përgjithnjë\* të falemi me besë. **H**

#### Tani *Hyjllindësor*

Nënë virgjëresh', pa prishje dhe pa burr'\* prej teje brumin tim\* e ka veshur Zoti im,\* Bërësi i çdo jete;\* e lidhi me veten krejt\* natyrën njerëzore. **H**

#### Ode VI

##### *Irmosi: Evòisa en oli kardhia mu*

»Nga zemra thell'\* drejt Zotit, të dhembshurit,\* thirra dhe më dëgjoji ky\* teksta »fare poshtë, në Hadh pra, isha unë\* dhe »e ngriti lart\* jetën time prej prishjes.

(2x) **H**

Me pastërti,\* nga sytë lot të ofroj\* dhe psherëtimë thellë krejt,\* Shpëtimtar, kur zemra thërrret: Kam faj ndaj teje,\* të të vijë keq,\* Perëndi Zot, për mua. **H**

Ke ikur larg\* nga Zoti yt, shpirt, porsì\* Dhathani, Avironi tok;\* "Të të vijë keq", thirr nga Hadhi më i poshtëm,\* të mos mbyllesh ti\* nga një plasë e tokës. **H**

Sado me zekth\* mëshjtjerre ke ngjarë mjaft,\* shpirt, me Efremin, por shpëto\* si sorkadhe jetën nga leqet, kur me krahë\* do të bëhesh ti,\* me akt, mend, teori tok. **H**

Na siguron,\* o shpirt, Moisiu ne,\* dora e tij, se Zoti mund\* të pastrojë jetën me lebër dhe ta zbardhë;\* mos u dëshpëro\* nëse je i lebrosur. **H**

Telashe plot\* nga shkëlqet e mia krejt\* si Det i Kuq u kthyen fort,\* befasisht më zhytën si treshet në karroca,\* egjiptianët mbar,\* Shpëtimtar Zot, qëmoti. **M**

Nuk kishe, shpirt,\* vullnet mirënjohës ti\* si Izraeli në një rast,\* preferove pa mend jo manën krejt të hyjshme,\* por të hash ves, epush\* dhe me pangopësi mjaft. **M**

Shpirt, preferenc\* për mish derrash dhe kazan\* kishe, ushqim Egjipti pra,\* qiellor ti s'deshe porsì në shkretëtirë\* më par' populli\* që ish mosmirënjohës. **M**

Shpirt, preferenc\* për pusët e mendjeve\* të Kanaanit kishe ti\* jo për fyzën, gurin, Jisuin, Zotin, kanë\* që buron rrëke\* theologe urtie. **M**

E rrahu fort\* me shkop shërbëtori yt,\* shën Moisiu, gurin, ish\* Shpëtimtar, tip, paraikonizonte brinjën\* jetëbërëse\* që nxjerr pijen e jetës. **M**

Spiuno, o shpirt,\* heto si Jisui, shenjt\* biri navian, dikur dheun\* e trashëgimisë; shih çfarë, cili është\* dhe bano në të\* dhe vepro ti pas ligjit. **M**

Bëj rezistenc\*, lufto si luftoi fort\* Jisui Amallkun,\* kundërshtoi veset në mish, gabaonitët,\* çdo mendim dinak\* dhe fito përgjithmonë. **m**

Si Arka, shpirt,\* më parë, ti ta kalosh\* natyrën që kalon shpejt, pra\* rrjedh, të kohës; Zoti kështu të urdhëron ty,\* trashëgoje drejt\* këtë dhë të premtimit. **m**

Siç, Shpëtimtar,\* shën Petron kur thirri fort:\* "Arri, shpëtom!", e ndihe krejt,\* më çliro nga bisha, tendose dorën tënde,\* jashtë nxirrme ti\* që nga fundi i fajit. **m**

Të di liman\* të qetë, o Zot, o Zot,\* arri të më çlirosh, o Krisht,\* që nga fundi ku nuk arrin gjë, nga mëkati\* që sjell dëshpërim\* dhe që ka fund të tmerrshëm. **m**

O Shpëtimtar,\* o Fjalë Zot, unë jam\* dërrahmia mbretërore pra\* që dikur kish humbur, por ndiz si llamb' Prodhromin,\* më kërko, më gjej,\* jam ikona që bëre. **E**

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. Gjithnjë, Mari,\* ti nxirrje çurg lotësh lum'\* të shuaje zjarr, flakërim\* vesesh brenda shpirtit që digjej; edhe mua,\* shërbëtorit tënd,\* jepm' lot, hirin e tyre. **E**

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. Fitove ti,\* o nën', papasionshmëri\* mbiqiellore, si mbi dhë\* ekstremisht jetove; ndaj për sa të himnojnë,\* lyp dhe ndërmjeto\* të shpëtojnë nga veset. **E**

O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne. Vrapoj te ti,\* të di si bari, epror\* të Kretës, o Andrea shenjt,\* ndërmjeton për botën, ndaj të thërras: O atë,\* më çliro, më nxirr\* që nga fundi i fajit.

Lavdi *Triadik*

"Triadhë jam,\* e thjeshtë, nuk ndahem hiç,\* por ndahem në Persona un',\* jam Njësi, bashkohem sipas natyrës", thotë\* Ati, Biri tok\* edhe Shpirti Hyjnor, Zot. **H**

Tani *Hyjlindësor*

Na lindi Zot\* me pamjen ton', mu si ne\*

barku yt, o Hyjlindëse;\* lype, ndërmjeto tek ai që, si Krijues\* i të gjithave,\* të na nxjerrë të drejtë. **H**

*Irmosi: Eyóisa en oli kardhia mu*  
Nga zemra thell'

*Kontaqi Ting. Tërth. II*  
(psalet ngadalë)

O shpirti im, o shpirt im, ngrihu, pse fle gjumë? Po afrohet fundi dhe ke për t'u trazuar; ndaj zgjohu që të të kursejë ty Perëndia, Zoti Krisht, që ndodhet kudo dhe i mbush të gjitha. **H**

*Shhtëpia*

Duke parë të hapur klinikën e Krishtit dhe shëndetin që buronte nga ajo për Adamin, djalli pësoi, u godit dhe, meqë rrezikonte, vajtonte dhe u thirri miqve të tij: Çfarë t'i bëj Birit të Marisë? Më vret bethlehemasi që ndodhet kudo dhe i mbush të gjitha.

*Sinakari i Mujorit dhe i sotëm:*

Në të njëjtën ditë, të Enjten e Javës së Pestë të Kreshmëve, sipas traditës së lashtë, psalin Shërbesën e Kanunit të Madh dhe Kataniktik.

*Vargje:* O Jisu, jepu mënyra kataniksi/ atyre që të psalin tani Kanunin e Madh. Me ndërmjetimet e shën Andreas, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

*Lumërimet dhe Troparet, me metani në secilin prej tyre (fillon psalti i dytë)*  
*Ting. Tërth. II Listin tu Paradhisu*

Në mbretërinë tënde kujtona, o Zot, kur të vish në mbretërinë tënde.

E bëre më përpara, Krisht, qytetar Iart,\* Zot, të Parajsës Kusarin, kur\* mbi kryq të thirri: "Kujtomë mua".\*<sup>17</sup> Më denjëso dhe mua,\* që s'jam i denj', pendimin që kish, ta kem.



Lum të varfrit në shpirt, sepse e tyrja është mbretëria e qiejve.

**D**ëgjon, shpirt, Manoun që qëmoti pati\* vegim nga Zoti, i cili pra\* nga shterpa mori fryt atëherë\* sipas premtimit,<sup>18</sup> fjalës;\* ta imitojmë shpresëtarin' e tij.

Lum ata që vajtojnë, sepse ata do të ngushëllohen.

**Z**ilepse dembelizmin, shpirt, të Sampsonit,\* e qethe lavdin e punëve\* që bëre; jetën e lum, të mençur\* mjerisht ti e tradhtove,\* me epshe ua dhe keq të huajve.<sup>19</sup>

Lum ata që janë të butë, sepse ata do të trashëgojnë dheun.

**A**i që me një nofull gomari dikur\* fitoi kundrejt të huajve,\*<sup>20</sup> tani u dogj nga pasioni, epshi;\*<sup>19</sup> largohu, shpirt, nga vepra,\* nga përtacia, nga imitimi ti.

Lum ata që kanë uri e etje për drejtësi, sepse ata do të ngopen.

**D**evora burrërore dhe gjeneralët\* Varaku<sup>21</sup> edhe Jefthau<sup>22</sup> tok\* gjyqtarë në Izrael u shfaqën\* me plot lavdi; forcohu\* si burrë nga arritjet e tyre, shpirt.

Lum ata që janë përdëllimtarë, sepse ata do të përdëllehen.

**J**aëlën burrërore që e mbërtheu\* Sisarin më parë, ti e njuh,\* dëgjon se sollti shpëtim me një hu;\*<sup>23</sup> me të ikonizohet\* për ty, shpirt, Kryqi, çlirim prej Zotit Krisht.

Lum ata që kanë zemër të pastër, sepse ata do të shohin Perëndinë.

**F**lijim të lavdërueshëm bëj, shpirt, veprë,\* si bijë sille, të jetë pra\* e pastër si bija e Jefthait,\*<sup>24</sup> dhe më e pastër; ther ti\* si fil pasione mishi për Zotin tënd.

Lum ata që bëjnë paqe, sepse ata do të quhen bij Perëndie.

**N**ë mendje ki shtëllungën e Gedeonit,\* prano prej qiellit vesë plot,\*<sup>25</sup> përkulu, pi, si sorkadhe, çurgun\*<sup>26</sup> që rrodhi mjaft nga shtrydhja\* e germës që kish Ligji,<sup>27</sup> o shpirti im.

Lum ata që përndiqen për punë drejtësie, sepse e tyrja është mbretëria e qiejve.

**D**ënimin e lliut, o shpirt, e more\* nga varfëria e mendjes ti,\* sepse duroje pasionet, si ky\* duronte bijt' që bënin\* veprime të paligjshme, mëkate<sup>28</sup> keq.

Të lumtur jeni ju, kur t'ju poshtërojnë e t'ju përndjekin, e të thonë kundër jush çdo lloj fjale të keqe me gënjeshtër për shkakun tim.

**L**eviti te Gjykatësit saktësisht, drejt,\* e ndau gruan e tij, o shpirt,\* te dymbëdhjetë fiset, se donte\* që neveritjen pa ligj\* që bëri Beniamini, ta shfaqte fort.<sup>29</sup>

Gëzohuni dhe gazmohuni, sepse paga juaj është e shumtë në qiej.

**N**jë mike mençurie, shën Ana, lutej,\* lëvizte buzët për lavdërim,\* sado s'dëgjohej zëri i saj hiç,\* por, edhe pse ish shterpë,\* një bir të denjë për lutje lindi kjo.<sup>30</sup>

Kujtona, o Zot, kur të vish në mbretërinë tënde.

**I** madhi Samuel i shën Anës, u zgjodh\* midis gjyqtarëve dhe u rrit\* në Armathem, në shtëpin' e Zotit;\*<sup>31</sup> o shpirt, këtë zilepse,\* gjykoji më par' veprat që bëre ti.

Kujtona, o Kryezot, kur të vish në mbretërinë tënde.

**D**avidi u krezmua për mbretërinë\* me bri, me miron e shenjtë pra,\* se ishte zgjedhur si mbret;<sup>32</sup> ndaj, o shpirt,\* në e do mbretërinë\* e sipërme, të lyhesh me miro, lot.

Kujtona, o i Shenjtë, kur të vish në mbretërinë tënde.

Përdëllimtar, krijimin tënd mëshiroje,\* atë që bëre me duar ti\*<sup>33</sup> dhe dhembshuro dhe kurse fajtorët\* të gjith' dhe mua; shkela,\* më keq se çdo njeri, urdhrat që ti dhe.

Lavdi *Triadik*

I falem Atit, pa nisje lindi, nxori,\* lëvdoj dhe Birin, të lindurin,\* himnoj dhe Shpirtin e bashkëndritshëm\* me Atin dhe me Birin,\* Triadhën e pandarë, Hyjninë pra.

Tani *Hyjlindësor*

I psal himn Birit tënd të përmbinatyrshëm,\* i falem pa ndarë hiç lavdin\* e foshnjës sate sipas natyrës,\* meqë si një person ky\* pohohet, edhe pse dy natyra ka.

*Ode VII*

*Irmosi: Imärtomen, inomisamen*

»Fajtuam ne,\* mëkatuam ne,\* para te-  
»je bëm' padrejtësi ne,\* s'i ruajtëm ne,  
»s'i zbatuam ne porosit' e tua, ne të pa-  
»mendët, o Zot,\* por mos na dorëzo më  
»në fund ti, o Perëndi i etërve, pra. (2x) H

Fajtova boll,\* mëkatova keq,\* e shfarosa porosinë tënde,\* i shtova mjaft mëkatet, shtova plagët në traumat e mia për tmeririn tim, Zot,\* porse ti si i dhembshur më mëshiro, Perëndi i etërve tan'. H

Gjykatës Zot,\* të rrëfeva ty\* çdo të fshehtë që ka zemra ime,\* shiko përuljen time, shih shtrengimin tim edhe vëri re tash gjykimit tim ti\* dhe kështu si i dhembshur më mëshiro, Perëndi i etërve tan'. H

O shpirt, dikur,\* kur Sauli djall\* humbi larg gomarët e të atit,\* e gjeti mbretërinë rastësisht dhe sundoi; ty të mos të shpëtojë, vër re\* edhe mos prefero hove

kafshësh më shumë\* se mbretërin' e Krishtit. H

Qëmoti pra\* bëri një mëkat\* të dyfishtë, shpirt, David hyjati,\* teksa shigjeta e kuro-rëshkeljes e gjeti dhe u kap nga dënuesi grep,\* se kish vrrar'; por ti je i sëmurë më rëndë, me ndërgegjeje, me vrull. H

Davidi mbret\* lidhi faj dikur\* me një tjetër, se përzejte vrasjen\* me një kuro-rëshkelje, por menjëher' tregoi drejt pendim të dyfishtë ai,\* por ti bëre, shpirt, vepra më djallëzore dhe s'u pendove në Zot. H

Davidi mbret\* shkroi si ikon',\* përmendore pra, dikur një himn nur,\* përmes këtij veprimin që kish bër', rëndë e qorton, thërret: Mëshiro më, o Zot,\* se fajtova te ti vetëm, Perëndi i çdo gjëje, ndaj më pastro. H

Kur sillej, shpirt,\* Arka mbi karroc'\* dhe përmysej viçi, Zani krejt thjesht\* e preku vetëm Arkën, dhe pësoi mërin' e Perëndisë, inatin e tij;\* mirë ti adhuoroj hyjnorët, shmangu nga arroganca e tij. M

Dëgjove, shpirt,\* si u ngrit pa mend\* ndaj natyrës pra Abesalomi;\* të neveritshmet vepra që ky bëri, i di; me to krevatin e atit David\* keq e shau, dhe ti i imitove hovet e vesit, epushin e tij. M

Në trupin tënd\* e nënshtrove keq\* gradën tënde të pamposhtur, o shpirt,\* se gjete si një tjetër Ahitofel armikun, i pranove mendimet e tij;\* por ato vetë Krishti i zhduki krejt, që ti me çdo kusht të shpëtosh. M

Shpirt, ishte plot\* me urti dhe hir\* Solomoni i çuditshëm, por, kur\* dinakërin' e bëri para Zotit dhe Perëndis' dikur, u largua prej tij;\* ti njësoj bëre jetë të



neveritshme dhe të mallkuar si ky. **M**

**Z**varritej, shpirt,\* nga një vesk e pshor,\* nga pasionet e tij, ndotej – mjerë! – \* i dashuruari pas urtësisë u bë i dashuruar pas grash pa moral\* dhe i huaj për Zotin; e imitove me vese turpi në mend. **M**

**Z**ilepse, shpirt,\* Rovoamin ti;\* pa mend s'bëri ç'deshte ati, si dhe\* Jerovoamin, shkelësin e keq, skllavin që më parë bëri grusht shteti mjerisht;\* lëre pra imitimn e tyre, thirr: Zot, fajtova, më dhembshuro. **M**

**N**ë neveri\* – mjerë! – shpirti im,\* ke zilepsur Ahaavin, meqë\* u ktheve në bodrum me njolla mishi dhe enë fort të turpshme pasionesh plot faj;\* Perëndisë rrëfeja të gjitha shkeljet, prej thellësis' psherëti. **m**

**I**lia shenjt\* lasht' i bëri shkumb\* dy her' pesëdhjetë të dërguar\* prej Jezabelës, kur krejt i shfarosi të turpshmit priftërinj; ky qortonte kështu\* Ahaavin; o shpirt, larg nga imitimi i tyre dhe merr fuqi. **m**

**U** mbyll për ty,\* o shpirt, qielli;\* të pustoit etja ty për Zotin,\* kur nuk iu binde fjalëve që tha shën Ilia, ky thesviti si mbreti dikur,\* Ahaavi pra; ngjaji krejt Serafthisë, ushqe ti shpirt profetik. **m**

**S**tivove, shpirt,\* me gjakftohtësi\* krimet krejt që Manasiu bëri,\* i kreve veset mu si tempuj plot neveri, i shtove idhujt, lehdin shpirtëror;\* ngrohtësisht ti pendimin e tij zilepse dhe përfito kataniks. **m**

**T**ë ulem ty\* dhe si lot të sjell\* fjalën time, mëkatova unë\* jo si Lavirja dhe fajtova, Zot, si askush pra tjetër mbi dhe, por më dhembshuro\* dhe më thirr përsëri, meqë jam krijesa që bëre, o Shpëtimtar. **E**

**K**am prishur keq\* urdhërimin tënd,\* dhe ikonën tënde e kam nxirë;\* e tërë bukuria vdiq dhe llamba u shua përmes veseve, o Shpëtimtar;\* por, siç psalte Davidi, më jep galdim ti, o Zot, dhe më dhembshuro. **E**

**P**endohu shpejt,\* kthehu dhe zbulo\* çka i ke të fshehura, t'i thuash\* te Perëndia që i njehtë gjitha: I vetmi Shpëtimtar, ti e di çdo sekret;\* mëshiromë dhe mua, siç psal Davidi, pas përdëllimit tënd, Zot. **E**

**M**baruan, shpirt,\* ditët që ti ke\* mu si ëndrra e atij që zgohet,\* lotoj si Ezekia përmbi shtratit tim të më shtohen dhe ca vjet jetë. Por kush\* do qëndrojë bri meje si Isaia, veç Zotit tim, të çdokujt? **E**

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne.

**M**ë parë ti\* thirre drejt asaj\* që s'ka cen, Hyjnënës, edhe zmbrespse\* tërbimin e pasionit shqetësues, të dhunshëm, turpërove mashtruesin tënd\* djall, armikun; tani jepi shërbëtorit tënd – mua – ndihm', se kam dert. **E**

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne.

**P**ër Krishtin tënd,\* që e deshe aq,\* pate mall, dhe mishin tënd e trete,\* tani për shërbëtorët ti kërko që të zbutet, për krejt ne; dhe porsì dhurëti\* ky të japë te sa po e adhurojnë jetesë paqeje plot. **E**

O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne.

**M**bështetmë ti\* mbi gur bese<sup>34</sup> fort,\* at', me lutjen, ndërmjetimin tënd, shenjt,\* me frik' të perëndishme, o Andrea, fortifikomë, jepmë pendim, lyp tani;\* nga armiqtë, nga kurthi i save që më kërkojnë, krejt më çliro.

Lavdi *Triadik*

“**T**rini e thjeshtë,\* e pandarë krejt,\* je Njësi e bashkëqenqshme, drita\* të shenjta, dritë, – tri të shenjta dhe një e

shenjtë”, Perëndia himnohet kështu.\*  
Por himnoje, lëvdoje, shpirt, jetën, jetët,  
pra Perëndin’ e çdokujt. **H**

### Tani *Hyjlindësor*

Të falemi,\* të himnojme ne,\* të bekojmë,  
Hyjnënë, se ti\* ke lindur një nga  
Shën Triadha krejt e pandarë, Perëndinë,  
një Bir dhe Zot pra;\* dhe ti vetë për ne to-  
kësorët hape nur qielloret me gaz. **H**

### *Ode VIII*

#### *Triodet e apostujve Ting. Tërth. IV*

#### *Irmosi: Ton ânarhon vasilea*

»Mbretin e pafillim të lavdisë, që e kanë  
»frikë Fuqitë e qiejve<sup>35</sup> dhe i tremben ren-  
»det e engjëjve, himnojeni, o priftërinj,<sup>36</sup>  
»popull, përmbilartësojeni në gjithë jetët.

**S**i qymyret e zjarrit të palëndshëm, digjini  
bashkë pasionet e mia lëndore, duke më  
ndezur tani dashurinë hyjnore, o apostuj.

**L**e t’i nderojmë trumbetat me tingëllim  
të mirë të Fjalës, me anën e të cilave ranë  
mure<sup>37</sup> të pathemelta armiku dhe u ba-  
zuan bedenat e hydjijes.

**D**ërrmojini fantazitë mëkatore të shpirtit  
tëm, ju që dërrmuat tempuj dhe shtylla  
armiku,<sup>38</sup> o apostuj të Zotit, tempuj të  
shenjtëruar.

### *Hyjlindësor*

**M**bajte të panxënshmin në natyrë, mbaj-  
te atë që i mban të gjitha, i dhe gj’i atij që  
e ushqen Krijesën, Krishtit jetëdhënës, o  
e Dëllirë.

### *Tingull dhe Irmos i njëjti*

**P**asi e ndërtuat Kishën mbarë me arkitek-  
turën e Shpirtit, o apostuj të Krishtit, në të  
e bekonit Zotin në jetë.

**A**postujt, kur trumbetuan me boritë e  
dogmave, e shkatërruan<sup>37</sup> çdo mashtrim  
idhujtar, duke e përmbilartësuar Krishtin

në gjithë jetët.

**O** apostuj, emigrues të mirë, qytetarë të  
qiejve,<sup>39</sup> mbikëqyrës të botës, na çlironi  
nga rreziqet ne që ju mburrim përgjithmo-  
në.

### Lavdi *Triadik*

**O** pushtet i hyjshëm, i tërëndritshëm dhe  
trediellor, natyrë e bashkëlavdishme dhe  
e bashkëfronshme, Atë gjithëbërës, Bir  
dhe Shpirt Hyjnor, të lavdëroj në jetë.

### Tani *Hyjlindësor*

**N**e popujt le ta himnojme pa pushim në-  
nën e Perëndisë si fron të nderuar<sup>40</sup> dhe  
të tërëllartë,<sup>40</sup> të vetmen nënë dhe virgjë-  
reshë pas lindjes.

### *Kanuni i Madh*

#### *Irmosi: On stratië uranôn*

»**E** lavdërojn’\* Zotin lart ushtritë qiellore,  
»e kanë frik’ Keruvimet tok\* me Serafi-  
»met; çdo frymë, çdo krijim, bekoje,\* për-  
»mbilartësoje, himnoje në gjith’ jetët. (2x) **H**

**O** Shpëtimtar,\* mëkatova; përdëllemë,  
mendjen ma ngri për kthim, pritme në  
pendim,\* më dhembshuro; thërras: Më-  
katova para teje,\* mëshiro më; bëra pau-  
dhësi, shpëtomë. **H**

**S**i mbi karroc’\* ushtarake karrocieri,  
shenjt’i Ilia, kish hipur mbi virtyt,\* dikur  
nga tokësoret lart sillej për në qiell;\*  
shpirt, mendoje ngjitjen e tij dhe lartë-  
sohu. **H**

**L**umi Jordan,\* rrjedha, rryma nëpërmjet  
gëzofit që kish Ilia, ndaloj krejt\* më parë  
në dy pjesë, e bëri Eliseu;\* por ti, shpirt,  
këtë hir s’e ke nga mospërmbajtja. **H**

**P**riti dikur\* shën profeti Elise gëzofin që  
kish Ilia dhe hir dyfish\* mori prej Zotit;  
por ti nuk more prej këtij hir,\* shpirt, se  
s’ke përmbajtje edhe vazhdon mëkatin. **H**



**M**endim të mir\* Somanitasja pra kish, prandaj mirëpriti, o shpirt, të drejtin kjo;\* por as të huajt, as udhëtarët, ti s'i prite,\* jashtë nusërores do flakesh plot me qarje. **H**

**O** shpirt mjeran,\* imitove përgjithnjë mendimin e ndotur llum të Jezeut ti;\* qoftë në pleqëri, kopracin' që kishte, zmbrapse,\* shmangu nga Gjehena, zbo zjarrin e së keqes. **H**

**K**ishe zili,\* shpirt, Ozinë, ndaj dyfish e ke brenda teje lebrën e tij, sepse\* gjëra pa vend mendon ti dhe bën dhe të paligjshme;\* lëri sa ke edhe vrapo shpejt drejt pendimit. **M**

**D**ëgjove ti\* se pendoheshin me thasë, hi para Perëndis' ninevitët mbar;\* s'i imitove, u shfaqe më i trashë nga sa\* mëkatuan para si dhe pas Ligjit, o shpirt. **M**

**D**ëgjove, shpirt,\* Jereminë që në gropë balte po qante fort për Sionin pra;\* thërri-ste, kritikonte qytetin, lot kërkonte;\* imitoje jetën e tij me vaj, shpëton k'shtu. **M**

**S**henjti Jona\* drejt Tharsisë rendi shpejt, se njohu pendimin ninevitan më par',\* se dinte si profet dhembshurin' e Perëndisë,\* kish zell të mos dilte si false profesia. **M**

**D**ëgjove, shpirt,\* për Danielin si në gropë kish mbyllur goja bishash; dhe more vesh\* si shuan me besim flakë furre që po digjej,\* sa rreth Azarias po rrinin lashtë Djemtë. **M**

**K**rejt njerëzit\* e së Vjetrës Dhiatë para teje i kam vendosur si shembull, shpirt;\* sa Zoti do, çka bënëin të drejtët, imitoji,\* veçse shmang mëkatet që bënë dretharakët. **M**

**O** Shpëtimtar\* dhe gjyqtar i drejtë, mëshiomë, çlirom' nga çdo zjarr dhe kërcënim\* që kam për të pësuar në gjyq un' drejtësisht krejt,\* falmë para fundit, do kem virtyt, pendim tok. **M**

**Ty** të thërras\* si Kusari "Më kujto!"; si shën Petro hidhur po qaj; "Më fal!" thërras\* si Doganieri; kam, Shpëtimtar, lot Prostitute;\* qarjen kananease prite, prit dhe timen. **M**

**O** Shpëtimtar,\* kalbësin' e shpirtit tim të ulët shëroje ti, o i vetmi mjek;\* vëre kompresën, vajin me verën, veprat, aktet\* e pendimit, lotët me kataniks përbrenda. **M**

**Po** imitoj\* Kananeasen, thërras drejt Birit davidian "Mëshiomë, ti!";\* cepin e veshjes mu si Gjakrrjedhësja e prek pak,\* qaj porsi Maria dhe Marta për Liazarin. **M**

**O** Shpëtimtar,\* derdh mbi kokën tënde mu si miro un' alabastrin e lotëve,\* thërras porsi Lavirja që donte përdëllim pra,\* lutjen sjell, kërkoi që të marr hir, ndjesë fajesh. **E**

**Sado** askush\* s'mëkatoi si un', por ti mua më prit, i dhembshuri Shpëtimtar;\* me frikë po pendohem, thërras me mall: Fajtova,\* bëra shkelje vetëm te ti, por përdëllemë. **E**

**O** Shpëtimtar,\* të të vijë keq për bërjen tënde, për delen e humbur, si bari\* kërkoi dhe rrëmbeje prej ujkut dhe vendose\* brenda mandrës sate me delet që ke ti, Zot. **E**

**Kur** si gjyqtar\* do të ulesh, o i dhembshur, Krisht, dhe do shfaqësh lavdin plot trembë ti,\* oh, atëherë ç'tmerr, kur kaminë do të ndizet,\* podium i frikshëm do llahtarisë çdokënd! **E**

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. Të feksi nur,\* nënë, nëna e ndriçimit pa perëndim, nga veset të zgjidhi ty,\* Hirin e Shpirtit prite, kështu, Mari, shkëlqej!\* dhe nga terri nxirri sa të himnojn' me besë. **E**

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. Çudi të re\* pa vërtet në ty, nën', Zosimai i hyshëm; shtangej se shihte pra\* engjëll me trup, pushtohej i tëri nga habia,\* duke e himnuar në jetë Krishtin, Zotin. **E**

O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne. Bri Zotit ke\* mjaft guxim, o mburrje e lavdishme e Kretës, lavd oshënarësh, shenjt,\* mësues; lyp të gjej zgjidhje pran-gash, pra mëkatesh,\* me uratën tënde, me ndërmjetimin tënd tash.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin (*Triadik*).

At' pa fillim,\* Bir i bashkëpafillim, i miri Ngushëllimtar, Shpirt i drejtë ti,\* prindi i Fjalës, Fjala e Atit pa fillim tok,\* Shpirt i gjall', krijues, Trini, Njësi, shpëtomë. **H**

Tani *Hyllindësor*

O e pacen,\* si me ngjyrë purpuri manteli mendor dhe perandorak, u thur\* përbrenda barkut tënd mishi i Emanuelit;\* të nderojmë ty, o Hyllindëse, vërtet pra. **H**

*Irmosi: On stratië uranôn*

**E** lavdërojn' Zotin

*Ode IX*

*Triodet e apostujve Ting. Tërth. IV*

*Irmosi: Kirios Theotokon*

»Hyllindëse të themi,\* të pohojmë ne »që\* shpëtuam, o e kulluar, e virgjër, me »ty;\* me koret e të patrupve të madhë- »shtojmë tok.

O apostuj të Krishtit, ndërmjetoni për ne. Freskomani ju shpirtin\* që ma thau

etja\* e fajit, o shën apostuj të shfaqur burim\* me rrjedhje krejt shpëtimtare,<sup>41</sup> me bes' të saktë krejt.

Notoj në det, po zhdukem,\* po fundosem tashmë;\* me dorën tënde të djathtë shpëtomë, o Zot,\* porsi apostullin Petro,<sup>42</sup> më dhembshuro, o Krisht.

Ju, si me krip' dhe shije\* mësimdhëniesh, hiqni\* krejt qelbëzimin e mendjes dhe ma flakni tej,\* larg, errësirën e injorancës që më rrethon.

*Hyllindësor*

Meqë haren' e linde,\* jepmë pikëllim ti,\* me të do mundem ta gjej ngushëllimn hyjnor,\* o Zonjë, gjatë së ardhmes ditë, Hyllindëse.

*Tjetri, Tingull i njëjtë*

*Se tin uranú qe jis*

Të madhërojmë me ode ty, organizatën e famshme të apostujve, sepse u shfaqët ndriçues të hijshëm të kozmosit<sup>43</sup> duke e dëbuar mashtrimin.

Duke zënë peshq të logjikshëm me rrejtën tuaj ungjillore,<sup>44</sup> ofrojani gjithmonë Krishtit si dhuratë, o apostuj të lumtur.

Lutemi, o apostuj, në kërkesën tuaj drejt Perëndisë, kujtonani që të çlirohemi nga çdo ngasje ne që ju përhimnojmë me mallëngjim.

*Triadik*

Të himnoj ty, Njësinë trihipostate, o Atë, Bir dhe Shpirt, një Perëndi të bashkëqen-shëm, Trini të bashkëfuqishme dhe pa fillim.

*Hyllindësor*

Meqë u çliuam me anën tënde nga mallkimi,<sup>45</sup> të gjitha ne gjeneratat të lumë-rojmë ty,<sup>46</sup> lindëse fëmije dhe Virgjërëshë, sepse na linde ngazëllim, Zotin.



*Kanuni i Madh**Irmosi: Asporu silipseos*

»Pa prishje në bark ka nxënë nënë pa «burr', lindja s'ka shpjegim, se zënia\* ish »pa farë, Perëndia lind dhe natyrat ky\* »i rinovon; prandaj ne,\* të gjithë brezat, »orthodhoksisht\* ty të madhërojmë plot »mall\* si hyjnuse, nënë pa qortim. (2x) **H**

**S**ëmuret dhe fryma ime, shpirti u plagos, sëmuret edhe mendja,\* dhe m'u dobësua fjala, vdiq jeta, fundi vjen,\* është te dera, o shpirt,\* kur pra Gjykatësi do të vij\* të he-tojë sa veprove,\* çfarë do të bësh, i mjeri ti? **H**

**O** shpirt, paraqita bërjen e Krijesës, siç e shkroi Moisiu,\* çdo rrëfim që ka ai në të, që të ekspozon\* të drejt' dhe të padrejtë,\* shpirt, imitove të dytët ti,\* jo të parët, duke bërë\* faje kundër Perëndisë Zot. **H**

**N**ë ty nuk vepron Ungjilli, ligji u sëmur, çdo Shkrim u anësua\* dhe profetët janë dobësuar, dhe çdo fjalim\* që than' të drejtët, o shpirt,\* shumëfishuan plagosjet mjaft,\* se s'ka mjek të të shërojë,\* je në gjendje fort të rëndë ti. **H**

**T**ë sjell unë shembuj të së Resë, shpirt, këta të çojn' në kataniks ty,\* mëkatarët evitoji, zileps të drejtët krejt,\* me kreshmë zbutë Krishtin\* si dhe me lutje, me thjeshtësi,\* me dëlirësi së bashku,\* do të glesh kështu shpëtim dhe hir. **H**

**N**jeri u bë Krishti dhe komunikoi, shpirt, me mua, dhe me dashje\* bëri çdo gjë që natyra ka, e zbatoi ky\* përveç mëkatit; shfaq\* që më përpara ikonën dhe\* tipin qart' të bashkëzbritjes\* që do bënte ky i dhembshuri. **H**

**N**jeri u bë Krishti edhe ftoi për pendim kusarë dhe lavire,\* o shpirt, ki pendim se

tashmë dera e mbretëris\* u hap edhe të parët\* që e rrëmbejnë jan' farisenj,\* tagrambledhës dhe tradhtarë\* bashkë-shortësh, që ndryshohen plot. **H**

**I**ftoi barinj', shpëtoi Magët, bashkësit' e foshnjave i shfaq\* Zoti Krisht martirë, lavdëroi një plak, të ve\* mjaft të moshuar, o shpirt;\* ti nuk zilepse veprimtarin\* dhe as jetën nur që kishin;\* mjerë ti kur të gjykoresh keq! **H**

**P**asi kish kreshmuar Krishti dyzet ditë në shkreti, uri i erdhi,\* shfaq pra natyrën e njeriut, ndaj mos u lodh:\* Nëse do të sulmojë\* armiku, zmbrowse ti me triumf\* përmes kreshmës, përmes lutjes\* dhe me ndihmën e Jisuit Zot. **H**

**N**gacmohej Jisui Krisht, fort djalli e tundonte duke shfaqur gurë\* për t'u bërë bukë dhe e ngjiti atë në mal\* të shihte mbretëritë\* e botës mbarë në çast. O shpirt,\* nga kjo dramë ki frik', lutju\* në çdo kohë Zotit, ji gati. **M**

**L**ëshoi zë, thirri si turtull që do shkretin' kandili zotëror nur\* predikonte ky pendim, Herodi paligjësi\* kish me Herodiadën.\* O shpirt, shih kurthet që ngrënë keq\* të paligjë, të mos biesh,\* por pendimin përqafoje drejt. **M**

**P**rodhromi i Hirit në shkreti banoi dhe Judea mbarë si dhe\* Samaria, si dëgjonin, rendnin, rrëfenin krejt\* shkeljet që kishin bërë\* dhe pagëzoheshin plot me zell,\* me gatishmëri; por ti, shpirt,\* nuk i imitove, ndaj ke faj. **M**

**S**hpirt, kurorëzimi ka nder, shtrati nuk ka njollë, se të dya Krishti,\* si njeri, kur hante, i bekoi në Kanë krejt\* përpara, gjatë dasmës,\* e ktheu ujin në verë pra,\* shfaq qart' çudin' e parë,\* që ti të

zhvendosesh me ndryshim. **M**

Forcoi paralitikon Krishti dhe ai e ngriti shtratin, o shpirt;\* ngjalli djal' të vdekur, bir vejushe pra ish ai,\* bëri me centurionin\* të njëjtën gjë; kur qart' u shfaq\* te Samaritania, të dha\* si në kicëe adhurim në frym'. **M**

Shëroi gjakrrjedhësen Krisht Zoti kur ia preku cepin e mantelit;\* ngriti sa çalonin dhe të verbit i shndriti, shpirt,\* lau sa kishin lebër,\* të shurdhrit edhe memecët njësh,\* të kërrusurën me fjalë\* e shëroi, që, qyq, të shpëtosh. **M**

Shëronte të çalët dhe ungjillëzonte te të varfrit, dhe shëndoshte\* të sëmurët dhe me doganierët seç hante tok\* Fjala Krisht, bisedonte\* me mëkatarët; me prekje, dor',\* ktheu shpirtin e zhvendosur\* të së bijës së Jairit pra. **M**

Një grua Lavire urtësohej, Doganieri seç shpëtohej, ndërsa\* Fariseu që me mburrje fliste, dënohej keq;\* një thoshte "Dhembshuromë!";\* një tjetër "Më përdëlle!", por ky\* veç krenohej dhe bërtiste\* "Zot, faleminderit!", fjal' pa mend. **M**

Zakheu qe doganier, por po shpëtohej; ishte farise Simoni,\* por gabonte; Prostituta ndjesën e fajeve\* e merrte prej Jisuit\* që ka fuqi që t'i falë krejt\* shkeljet, të dhurojë ndjesë;\* shpirt, nxito ta imitosh gruan. **M**

Nuk kishe zili, o shpirt mjeran, Laviren që, si mori miro,\* alabastër, leu tok me lot këmbët e Zotit,\* me flokët mir' i fshiu,\* tekxa ai griste për atë\* dorëshkrimin që kish krimet\* e mëparshme, që pat me tepri. **M**

E di si u nëmën, shpirt, qytetet te të cilat dha Ungjillin Krishti,\* ki frik' nga ky

shembull, që të mos bëhesh si ato;\* Zoti tha: Ishin njësoj\* k'to me Sodomën, ngjanin me të,\* edhe i dënoi rëndë,\* që të zbrisnin gjer në Hadh këto. **M**

Të mos shfaqesh më i keq se Kananeasja prej dëshpërimit, o shpirt;\* more vesh për besën që kish, iu dha shërimi krejt\* vajzës me fjalë Zotit;\* nga thellësia e zemrës ti\* si ajo thirr fort drejt Krishtit:\* Biri i Davidit, më shpëto. **M**

O Bir i Davidit, përdëllim të kesh për mua, dhembshurom', shpëtomë,\* mëshurom' ti që me fjal' shërove sa kishin djall;\* frazën që mirësisht the\* drejtas Kusarit, ma thuaj, Zot:\* Them: "Amin! Do jesh me mua\* në Parajsë kur të vij me lavd". **E**

Të theologonte një Kusar, ndërsa një tjetër të qortonte ashpër,\* varur që të dy në kryq me ty, përdëllyes fort;\* hap dhe për mua derën\* e mbretëris' sate plot lavdi,\* siç e bëre për Kusarin\* besimtar që ty të njohu, Zot. **E**

Shtrëngohej Krijesa kur të shihte ty që kryqëzohesh, nga frika\* çaheshin shkëmbinj dhe male, toka lëkundej fort,\* Hadhi po zhvishej, ndërsa\* gjat' ditës drita u bë si terr,\* o Jisu, kur të shikonte\* mbi dru të mbërthyer keq në mish. **E**

Zot, fryte të denja për pendim mos më kërk, sepse fuqia ime\* u shterua brenda meje; zemër me plot dërrmim\* gjithnjë më jep, dhuromë\* dhe varfëri shpirtërore tok,\* të t'i sjell ato, i vetmi\* Shpëtimtar, si fli të pritur mir'. **E**

Gjykatës, o njohësi im, kur ke për të ardhur përsëri me engjëjt\* të glykosh krejt botën, shihm' atëher' me sy të but'\* dhe të të vijë keq ty;\* më dhembshuro mua, o Jisu,\* se më fort se krejt natyra\*



njerëzore mëkatova pra. **E**

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. **H**abite të gjitha rendet engjëjlore dhe sistemet njerëzore,\* o Mari, përmes jetesës sate të huaj krejt;\* jetove si e palënd\* përmbi natyrë, u shfaqe qart'\* e çmaterializuar,\* kur më këmbë ecje mbi Jordan. **E**

O oshënare e Perëndisë, ndërmjeto për ne. **N**dërtuesin zbutë për ne që të mburrim, o Mari, nën' oshënare,\* dhe çlirona nga çdo keqtrajtim si dhe çdo shtrëngim\* nga sa përçark sulmojnë;\* kështu të lirë nga ngasjet krejt,\* pa pushim ta madhërojmë\* Zotin që të lavdëroi ty. **E**

O shenjt i Perëndisë, ndërmjeto për ne. **R**rofsh, psalt i shkëlqyer! At' shpirtmbajtës, nder, bari i Kretës, shën Andrea,\* pa pushim ti ndërmjeto te Krishti dhe Zoti yn',\* për ne që të himnojmë,\* të evitojmë krejt çdo mëri,\* të çlirohemi nga fajet\* ne që bëjm' kujtimin tënd gjithnjë.

#### Lavdi *Triadik*

**T**rini e njëqenshme, o Njësi trihipostate, ne të përhimnojmë,\* Atin e lëvdojm', e madhërojm' Birin, Shpirtit Shenjt\* i falemi; ju jeni\* një Zot vërtet në natyrë tok,\* mbretëri pa fund, një jetë\* si dhe jetët, Perëndi, Hyjni.

#### Tani *Hyjlindësor*

**Q**ytetin tënd ruaje ti, o e fort dëlirë dhe Hyjnënë Vajzë;\* mbretëron në ty me besë, në ty forcohet pra,\* fiton nëpërmjet teje\* edhe mbi çdo ngasje triumfon\* dhe armiqtë i plaçkit ky,\* mir' i qeveris nënshtetasit. **H**

*Irmosi: Asporu silipseos*

**P**a prishje në bark

*Fotagjoku i Tingullit.*

Ty të ka hije lavdi... Lavdi Perëndisë që është në më të lartat... *etj. (fq. 62)*

*Në Pasvargje Idhiomeli  
Ting. Tërth. V*

**M**eqenëse re, o shpirti im, në sulmet e kusarëve, u plagose tmerrësisht,<sup>47</sup> duke u dorëzuar marrëzisht tek armiqtë nga shkeljet e tua; por, përderisa ke kohë, thirr me kataniks: O Shpëtimtar, shpresa e të dëshpëruarve, jeta e zemërplagosurve, ngrimë dhe shpëtomë.

*Varg:* U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam, dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përulë, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt' e tyre.

*I njëjti*

*Varg:* Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji te ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

*Martirik*

**K**ur e veshët mirë parzmoren e besimit<sup>48</sup> dhe e fortifikuat veten tuaj me shenjen e kryqit, u dalluat si ushtarë të fortë,<sup>49</sup> i kundërshtuar tiranët burrërisht dhe e shfarosët mashtrimin e djallit; meqë u bëtë fitimtarë, u denjësuat për kurora; ndërmjetoni përgjithmonë për ne, që të shpëtojnë shpirtat tanë.

Lavdi *dhe Tani Hyjlindësor*

**P**ranoi zërat e shërbëtorëve të tu, o Perëndilindëse, virgjëreshë e tërëdëlirë, dhe ndërmjeto pa pushim që të na dhurohet falje mëkatesh dhe paqe.

*Lexuesi: Është mirë ta lavdërojmë Zotin etj. si të hënën e parë në mëngjes (fq. 63).*

*Në Orët dhe Lumërimet Kontaqi* O shpirti im, o shpirti im.

*Në orën e Gjashtë (në Trithektë), Tropari i Profecisë.*

*Ting. Tërth. IV*

O Zot i dhembshur, zemërgjerë, i tërëpushtetshëm, dërgoje mëshirën tënde përmbi popullin tënd.

Lavdi dhe Tani  
*I njëjti*

Proqimen. Ting. Tërth. IV. Psalm 96.  
Zoti mbretëroi, le të ngazëllohet dheu.  
*Varg:* Faljuni atij të gjithë engjëjt e tij.

Këndimi i profecisë së Isaiaas.  
*(42.5-16)*

Kështu thotë Zoti Perëndi, që bëri qiellin dhe e fiksoi, që forcoi tokën dhe ato që janë në të, dhe i dha frymë popullit që është mbi të dhe frymë atyre që e shkelin: "Unë, Zoti Perëndi, të ftova në drejtësi dhe do ta mbaj dorën tënde, dhe do të të fuqizoj dhe të dorëzoja për besëlidhje fisi, në dritë kombesh, që të hapësh sy të verbrish, të nxjerrësh prej prangash të lidhur dhe prej shtëpie burgu ata që rri në errësirë. Unë jam Zoti Perëndi, ky është emri im; lavdinë time nuk do t'ia jap asnjë tjetri, as virtytet e mia statujave. Ato që u thanë nga fillimi, ja erdhën; dhe të rejat që unë po i njoftoj dhe para se të njoftoheshin, jua deklaruan juve". Himnoni për Zotin një himn të ri, fillimi i tij: "Lavdërojeni emrin e tij nga skaji i dheut, ju që zbrisni në det dhe lundroni në të, ishuj dhe ju që banoni në ta. Dëfre, o shkretëtirë dhe qytezat e saj, vila dhe ju që banoni në Qidhar". Do të dëfrejnë ata që banojnë në Petra, nga majat e maleve do të thërrasin, do t'i japin lavdi Perëndisë, virtytet e tij do t'i njoftojnë në ishuj.

Zoti, Perëndia i fuqive, do të dalë dhe do të thërmojë luftë, do të ngrejë zell dhe do të thërrasë mbi armiqtë e tij me fuqi: "Heshta, mos do të hesht përherë dhe do të duroj? Durova si ajo që lind, do të shtang dhe do të thaj njëkohësisht. Do të shkrettoj male dhe bregore, dhe çdo bar të tyre do ta thaj, dhe do të vendos lumenj në ishuj dhe do të thaj kënetat. Dhe do të udhëheq të verbër në rrugë që nuk i njihnin dhe do t'i bëj të shkelin udhët që nuk i dinin, do ta bëj për ta terrin në dritë dhe të shtrembrat në të drejta. Këto fjalë do t'i bëj dhe nuk do t'i braktis ata".

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 97.  
Këndojini Zotit një këngë të re.  
*Varg:* Brohorisni për Perëndinë, i gjithë dheu.



## TË ENJTEN E JAVËS SË PESTË NË MBRËMËSORE

*Në vend të Kathizmës 18, lexohet Kathizma 12*

*10 Thirrortë*

*Ting. Tërth. IV Idhiomeli*

Më vetëdashje, e zhvesha hijeshinë e virtyteve për shkak të shkeljes sime të parë,<sup>50</sup> por e vështa përsëri me anën e bashkëzbrëritjes sate drejt meje, o Fjalë e Perëndisë; sepse nuk më shpërfillë mua që isha plot me shenja plagësh nga pësime të frikshme dhe u shkela në udhë nga kusarë,<sup>47</sup> por, pasi me fuqinë tënde të tërëpushtetshme më shërbeve, më denjësove për përkrahje, o i shumë-mëshirshëm. (2x)

*Martirike*

O martirë të Zotit, shenjtëroni çdo vend dhe shëroni çdo sëmundje; dhe tani ndër-



mjetoni që të çlirohen shpirtat tanë nga kurteth e armikut, lutemi.

*Të tjera, të zotit Josif*

*Ting. I Panëfimi mártires*

**O** Zot, kur mbërtheheshe në Kryq,\* grise dorëshkrimin ton',\*<sup>51</sup> pra të Adamit, me shtizën tënde fort të hyjshme ti;\* ndaj më ngri, hiq prangat,\* të të bëj therore himni,<sup>52</sup> duke u gëzuar me besë, Fjalë, meqë unë tash\* gjeta koh' të mirëpritur<sup>53</sup> mjaft,\* kreshmën që te krejt ne shfaqë për shpëtim.

**D**ikur Moisiu shndriste fort\* me shkëlqim prej kreshmës pra,\*<sup>54</sup> e pa lavdinë e Perëndisë,<sup>55</sup> si ta kesh zili,\* shpirti im i varfër,\* që të glesh shijim hyjnor, shërbeji Zotit Krisht që pëllëmbët i tendosi përmbi Kryq,\* mirësisht për ty; ti t'i shërbesh\* me veprim lutjesh, vetëpërmabajteje.

*Tjetër, e zotit Theodor*

*Ting. Tërth. II Arhangelikós animnisomen*

**D**uke iu falur Kryqit tënd jetëbërës të mirësisë sate të pafund dhe të pashprehshme ndaj nesh, o Krisht, ne, meqë u ndriçuan në shpirt përmes atij, të përhimnojmë pa pushim, duke kërkuar që ta mbarojmë me gatishmëri dhe gëzim stadiumin e Kreshmës dhe të arrijmë t'i përhimnojmë pësimet e tua, o Zot, me anën e të cilave na shpëtove.

*Dhe katër të Mujorit*

Lavdi dhe Tani

*E Mujorit (Kryqhyjlindësore)*

Proqimen. Ting. i Rëndë. Psalm 98.  
Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë, dhe falju-  
ni nënkëmbëzës së këmbëve të tij.

*Varg:* Zoti mbretëroi, le të inatosen popuj.

Këndimi i Gjenezës

*(18. 20-33)*

**T**ha Zoti: "Klithmat e Sodomës dhe të Gomorës u shumëfishuan drejt meje, dhe mëkatet e tyre janë tepër të mëdha. Ndaj, si të zbres, do të shikoj nëse bëhen sipas klithmës së tyre që vjen drejt meje, ndryshe, që të njoh". Dhe, si u kthyen që andej, burrat erdhën në Sodomë. Dhe Abrahami qëndronte akoma para Zotit. Dhe, sapo iu afrua, Abrahami tha: "Mos do t'i shfarosësh të drejtë bashkë me të pabesë, dhe do të jetë i drejti si i pabesi? Nëse do të jenë pesëdhjetë të drejtë në qytet, do t'i shfarosësh? Nuk do ta lësh të gjithë vendin për shkak të pesëdhjetë të drejtëve, nëse janë në të? Në asnjë mënyrë ti nuk do të veprosh sipas kësaj fjale, që të vrasësh të drejtë bashkë me të pabesë dhe do të jetë i drejti si i pabesi; në asnjë mënyrë; ti që gjykon tërë dheun, nuk do të bësh gjykim?". Dhe Zoti tha: "Nëse do të jenë në Sodomë pesëdhjetë të drejtë, në qytet, do ta lë të gjithë qytetin dhe të gjithë vendin për ta". Dhe, pasi u përgjigj, Abrahami tha: "Tani fillova të flas drejt Zotit tim, ndërsa unë jam dhë dhe hi. Por, nëse do të pakësohen të pesëdhjetë të drejtë në dyzet e pesë, do ta shfarosësh tërë qytetin për shkak të pesëve?". Dhe tha: "Nuk do të shfaros, nëse do të gjej atje dyzet e pesë". Dhe shtoi akoma të fliste drejt tij dhe tha: "Dhe nëse do të gjenden atje dyzet?". Dhe tha: "Nuk do të shfaros për hir të dyzetëve". Dhe tha: "Mos bëhet gjë, o Zot, nëse do të flas? Dhe nëse do të gjenden atje tridhjetë?". Dhe tha: "Nuk do të shfaros për hir të tridhjetëve". Dhe tha: "Meqë mund të flas drejt Zotit, dhe nëse do të gjenden atje njëzet?". Dhe tha: "Nuk do të shfaros, nëse do të gjej atje njëzet". Dhe tha: "Mos bëhet gjë, o Zot, nëse do të flas dhe një herë? Dhe nëse do të gjenden

atje dhjetë?”. Dhe tha: “Nuk do të shfaros për hir të dhjetëve”. Dhe Zoti iku sapo pushoi së foluri me Abrahamin, dhe Abrahami u kthye në vendin e tij.

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 99.

Brohorisni për Zotin, i gjithë dheu.

*Varg:* Shërbejini Zotit me ngazëllim.

Këndimi i Fjalëve të Urta

(16.17-17.17)

**A**i që pranon edukim, do të jetë në të mira, ndërsa ai që ruan vërejtje, do të urtësohet. Ai që i ruan udhët e tij, e ruan shpirtin e tij, ndërsa ai që e do jetën e tij, do ta kursejë gojën e tij. Para dërmimit paraprin kryelartësia, ndërsa para rënies mentalitet i keq. Më i mirë është një i butë me përlulesi se ai që ndan plaçka lufte me kryelartë. Ai që është i mençur në gjëra, gjen të mira, dhe atë që mbështetet mbi Perëndinë, vlen ta lumturojmë. Të urtët dhe të mençurit i quajnë të këqij, ndërsa të ëmblit në fjalë do të dëgjojnë më shumë. Mendja është burim jete për ata që e kanë, ndërsa edukim të pamendësh është i keq. Zemra e të urtit do t'i kuptojë fjalët nga goja e vet, dhe mbi buzë do të veshë ndërgjegjësim. Dyll mjalti janë fjalët e mira, dhe ëmbëlsia e tij shërim shpirti. Ka udhë që i duken një burri se janë të drejta, mirëpo përfundimet e tyre shohin në fund Hadhi. Një burrë e mundon veten në mundime, dhe dhunon që të zmbropsë katastrofën e tij, por i shtrembri e mban katastrofën mbi gojën e tij. Një burrë i pamend gërmon dhe nxjerr, si prej miniere, të këqija për veten dhe mbi buzët e veta grumbullon shumë zjarr. Një burrë i shtrembër dërgon përreth të këqija dhe ndez ndriçues tinëzie për të këqijat dhe ndan miq. Një burrë i paligjshëm nget miq dhe i rrëmben në udhë jo të mira.

Dhe, duke mbështetur sytë e tij, mendon të shtrembra, dhe përcakton në buzët e tij të gjitha të këqijat; ky është kaminë e së keqes. Kurorë krenarie është pleqëri, dhe gjendet në udhë drejtësie. Më i mirë është një burrë zemërgjerë se një i fortë; dhe ai që e përmban inatin, është më i mirë se ai që pushton një qytet. Në të padrejtë, në gjirin e tyre mësyjnë të gjitha të këqijat, ndërsa prej Zotit vijjnë të gjitha të drejtat. Më mirë bukë me kënaqësi në paqe se një shtëpi plot me shumë të mira dhe të therura të padrejta me lufta. Një shërbëtor i zgjuar do të mbizotërojë mbi pronarë të pamend dhe në mes vëllezërish do të ndajë pjesë. Si provohet në kaminë argjendi dhe ari, kështu janë pranë Zotit zemra të zgjedhura. Një i keq dëgjon gjuhë të paligjësh, ndërsa një i drejtë nuk i vë re buzët e gënjeshtërtë. Ai që tallet me të varfër, inatos atë që e bëri, dhe ai që gëzohet për atë që vdes, nuk do të shfaqësohet, ndërsa ai që ka dhembshuri, do të mëshirohet. Kurorë pleqsh janë fëmijë fëmijësh, ndërsa krenari fëmijësh etërit e tyre. Tërë bota e parave është e besimtarit, ndërsa të pabesit s'i përket asnjë lek. Nuk do t'i përshtaten të pamendit buzë të besueshme, as të drejtit buzë e gënjeshtërtë. Shpërblim hiresh është edukimi për ata që e përdorin, dhe ngado që të kthehet, do t'i shkojë mbarë. Ai që fsheh padrejtësi, kërkon miqësi, ndërsa ai që urren t'i fshehë ato, ndan miq dhe familjarë. Kërcënimi dërrmon zemër të mençuri, ndërsa i pamendi i fshikulluar nuk ndien. Çdo i keq ngre debate, dhe Zoti do t'i dërgojë një engjëll të pamëshirshëm. Do të bjerë përkujdesje mbi një burrë të mençur, ndërsa të pamendët mendojnë të këqija. Ai që shpaguean të këqija në vend të mirash, nuk do të lëvizin të këqija



nga shtëpia e tij. Sundim drejtësisë u jep pushtet fjalëve, ndërsa para varfërisë paraprin kundërshtim dhe luftë. Ai që e gjykon si të drejtë të padrejtin dhe si të padrejtë të drejtin është i papastër dhe i neveritshëm nga Perëndia. Pse ekzistuan para tek i pamendi? Sepse ai që s'ka zemër, nuk do të mund të fitojë urtësi. Ai që e bën të lartë shtëpinë e tij, kërkon dërmim, dhe ai që shtrembërohet të mësojë, do të bjerë në të këqija. Në çdo kohë le të ekzistojë miku, dhe vëllezërit le të jenë të vlefshëm në nevoja.

## CITIME

1. Ps. 50(51).13
2. Rom. 1.26
- 2a. Lluk. 7.39
- 2b. Eks. 6.7 etj.
3. Rom. 8.27; Apok. 2.23
4. Ps. 9.39
5. Ef. 5.8; I Thes. 4.12
6. Abak. 3.1-2
7. Sirak 24.8
8. Matth. 9.38; Lluk. 10.2
9. Is. 5.1
10. Jez. 1.13-26
11. Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
12. Ps. 77(78).54
13. Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
14. Ps. 45(46).5; Hebr. 9.2-3
15. III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
16. Matth. 9.20-22; Mark. 5.25-34; Lluk. 8.43-48
17. Lluk. 23.40-43
18. Gjyq. 13.2-24
19. Gjyq. 16.4-21
20. Gjyq. 15.15-16
21. Gjyq. 4.4-16
22. Gjyq. 11.1-33
23. Gjyq. 4.17-21
24. Gjyq. 11.29-39
25. Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6
26. Ps. 41(42).2
27. Rom. 7.6; II Kor. 3.6
28. I Mbret. [Sam.] 2.12-17,22-34; 4.11-18
29. Gjyq. kap. 19
30. I Mbret. [Sam.] 1.9-20
31. I Mbret. [Sam.] 2.11; 7.17; 25.1
32. I Mbret. [Sam.] 16.1-13
33. Ps. 118(119).73; Jov. 10.8-9
34. Matth. 7.24; 16.16-18; Lluk. 6.48
35. Is. 6.2
36. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
37. Jis. N. 6.20

38. Eks. 23.24
39. Fil. 3.20
40. Is. 6.1
41. Is. 12.3
42. Matth. 14.24-32
43. Fil. 2.15
44. Lluk. 5.10-11
45. Gjen. 3.16-19
46. Lluk. 1.48
47. Lluk. 10.30
48. I Thes. 5.8
49. II Tim. 2.3
50. Gjen. 3.3-7
51. Kol. 2.14
52. Lev. 7.12(2) etj.
53. Is. 49.8; II Kor. 6.2
54. Eks. 34.28-30
55. Eks. 33.18-23

TË PREMTEN E JAVËS SË PESTË  
NË MËNGJESORE

*Pas Gjashë Psalmeve dhe Paqësoreve, Alihuat dhe Triadiket e Tingullit të javës dhe, pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove Kryqësore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove  
Ting. I Ton tafon su Sotir*

Ishtirive lart në dru,\* Krisht, pëllëmbët, shërove\* pra plagën e Adamit<sup>1</sup> me traumën tënde,\* prandaj të lyp, shëroji plagët që më la mashtruesi\* brenda shpirtit tim,\* Zot, Shpëtimtar, denjësomë\* që të të shërbej\* me keshmë edhe me lutje,\* dhe vetëpërbajtje tok.

*Lavdi dhe Tani Kryqhyjindësore*

Kur nëna pa qortim\* të shikonte mbi dru ty,\* të shtrirë dhe të vdekur, thërriste: Im Bir, je\* i bashkëpafillim me Atin dhe Shpirtin Shenjt, ç'është, Zot,\* ky pësimi yt,\* Ekonomia që s'shpërehet?\* Bërjen që me dorë\* pa cen e kreve,<sup>2</sup> i dhembshur,\* me të e shpëtove, Krisht.

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësove*

*Ting. Tërth. II Elpis tu kosmu*

**O** Kryq, ruajtës i botës, dëbues i demoneve, ne që të kemi në çdo gjë si mbrojtje të pamposhtur, denjësona ta kalojmë kohën e mbetur të kreshmës me ndër-gjegje të pastër,<sup>3</sup> duke i drejtuar shpirtat tanë para Krishtit, o dru i bekuar.

*Lavdi dhe Tani Kryqhyjlindësore*

**O** Virgjëreshë e kulluar dhe e thjeshtë, lavdia e engjëjve, kur ishe pranë Kryqit të Birit dhe Perëndisë tënd, duke mos duruar t'i shikoje marrëzitë e armiqve, thërrisje me vaje nënore: Si i duron, o njeri-dashës, kërcënimet e të gjithëve? Lavdi zemërgjërësisë sate.

*Psalmi 50. Prifti thotë uratën e zakonshme: O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën, dhembshurinë dhe... Kanuni i Mujorit dhe Triodet në vendin e tyre. Lexohet dhe Ode V biblike.*

*Triodi, poezi e Josifit.*

*Ode V*

*Ting. III*

*O fotisas ti elampsi*

**O** Jisu i përmbimëri që e tendose qiellin pors i lëkurë,<sup>4</sup> i shtrive pëllëmbët në Kryq, prandaj të përgjërohëm: Dhembshuromë mua që tërhiqem poshtë prej influencimeve të armikut.

**F**jete në Kryq, o Zoti Jisu i përmbimëri, dhe na dhe gatishmëri shpëtimi neve të dërgjurve në më të poshtmet e vdekjes, ndaj të lavdërojmë me besë.

**D**enjësona ta shohim ditën e pësimit tënd ne shërbëtorët e tu, pasi të ndriçohemi me hijeshi zemre, si dhe ngjalljen tënde jetëprurëse, duke himnuar pushtetin e mbretërisë sate, o Shpëtimtar.

*Kryqhyjlindësor*

**E**tërdëlira, kur të pa të varur në Kryq, vaj-tonte me klithma, e plagosur në kraharor,

dhe thoshte: O Zot, pranove të pësosh nga dhembshuria thellë në shpirt,<sup>5</sup> për t'u dhënë të gjithëve papasionshmëri.

*Kanuni tjetër, poezi e Theodorit.*

*Ting. Tërth II*

*Ek niktós orthrizonta*

**I**tendose duart e tua në Kryq, o Krisht njeridashës, të cilat judenjti i mbërthyen, e shpuan dhe brinjën me shtizë;<sup>5a</sup> dhe i durove të gjitha që të shpëtojmë ne.

**D**ikur Adami vdiq<sup>1</sup> ngaqë hëngri nga një dru,<sup>6</sup> por përsëri nga druri i Kryqit gjeti jetën, me anën e së cilës shijon ëmbëlsi brenda Parajsës,<sup>7</sup> o i Dhembshur.

*Lavdi Triadik*

**O** Trini, të përhimnoj si Njësi në natyrë, pa fillim, pa krijim, të pushtetshme, mbretërore, të përsosur, Perëndi, dritë, jetë dhe krijuese të kozmosit.

*Tani Hyjlindësor*

**N**ë shtatzëninë tënde të përmbinatyrshme, ligjet natyrore asgjësohen qartë për hirin tënd, o e Dëlirë, sepse e lind pa farë Perëndinë e parajetshëm, që lindi prej Atit.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

**O** Zot, e respektoj Kryqin, shtizën<sup>5a</sup> dhe gozhdët e tua, sepse nëpërmjet tyre na çlirove nga prishja ne që u bëmë të pavdekshëm me pësimin tënd, o Krisht.

*Irmosi: Ek niktós orthrizonta*

»**P**o mëngoj menatë, njeridashës Zot,\*  
»lutem, ndriçomë ti,\* udhëhiqme në drej-  
»tim,\* në urdhrat e tu mua,\*<sup>8</sup> mësomë që  
»përherë\* ta bëj dëshirën tënde.<sup>9</sup>

*Ode VIII*

*Thávmatos iperfiús*

**I**çmprehe thumbat e të ligut, o Shpëtimtar, duke u karfosur me gozhdë në dru,



dhe u veshe për tallje me kurorë gjembash,<sup>10</sup> duke e shkukur gjembin e shkeljes;<sup>1</sup> prandaj thërrasim duke të përhimnuar: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin, dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

**T**endose mbi Kryq pëllëmbët, o Krisht, duke mbledhur njerëzinë për njohjen tënde, dhe pranove të shpoheshe me shtizë në brinjën tënde,<sup>5a</sup> nga ku gufove burim ndriçimi për ata që këndojnë: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin, dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

**M**e rrjedhat e mirësisë sate, o i dhembshur, pastroje zemrën time që u njollosh nga kafshimi i mëkatit, dhe më denjëso të derdh lumenj kataniksi, o Jisu Krisht, që të të thërras: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin, dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

#### *Hyllindësor*

**T**ë njohim, o Vajzë, si shtambë që mbajte manën hyjnore<sup>11</sup> të Hyjnisë, arkë,<sup>12</sup> tryezë,<sup>13</sup> llambë,<sup>14</sup> fron Perëndie,<sup>15</sup> pallat dhe urë që i transferon drejt jetës hyjnore ata që këndojnë: Le ta bekojë Krijesa e tërë Zotin, dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.

#### *Tjetri: Ton Pedhon tin odhin*

**K**ryqëzohet Krishti dhe unë, duke u gjallëruar, psal së bashku me Djemtë:<sup>16</sup> Bekojeni, o veprat e Zotit, Zotin.<sup>17</sup>

**B**ota, e çliruar nga prishja me anën e kryqëzimit tënd, psal së bashku me Djemtë:<sup>16</sup> Bekojeni, o veprat e Zotit, Zotin.<sup>17</sup>

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin (*Triadik*).

**O** Trini e baraslavdëruar, Njësi e bashkëqenshme, Atë, Bir dhe Shpirt, shpëtomë mua që të himnoj me besë.

#### *Tani Hyllindësor*

**I**falemi Birit të Perëndillindëses së dëlirë, duke psalur së bashku me Djemtë:<sup>16</sup> Bekojeni, o veprat e Zotit, Zotin.<sup>17</sup>

**L**avdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **E** himnoj Kryqin tënd, përmes të cilit u shpëtova, o Shpëtimtar, duke psalur së bashku me Djemtë:<sup>16</sup> Bekojeni, o veprat e Zotit, Zotin.<sup>17</sup>

#### *Irmos: Ton Pedhon tin odhin*

»Duke e imituar oden e Djemve thërras «duke psalur së bashku me Djemtë:<sup>16</sup> Bekojeni, o veprat e Zotit, Zotin.<sup>17</sup>

#### *Ode IX*

#### *Tipon tis agnis lohias su*

**Z**otin\* në një flad të lehtë krejt\* e pa lllia<sup>18</sup> kur më parë holloi drejt\* pra mishin përmes\* kreshmës<sup>19</sup> dhe lutjesh shkëlqyeshëm;\* shpirt, zilepse atë edhe hidhe tej\* çdo trashësi e pshore,\* që ta shikosh të dëshirueshmin.

**D**uke\* ngritur Moisiu lart\* në dru më parë gjarprin, të parashfaqte ty\* të ngritur në Kryq,\* o Shpëtimtar i mbimirë Zot;\* dhe me të nga e keqja helmuese,\*<sup>20</sup> nga gjarpri,<sup>21</sup> i çlirove\* të gjitha kombet që të falen ty.

**D**ergjem\* në varr përtacie keq,\* gur zemërgurtësie më ka pllakosur rënd',\* se nuk e kuptoj,\* Zot, fjalën tënde të gjall' gjithnjë,\*<sup>22</sup> s'e ndiej frikën tënde, o Shpëtimtar;\* më dhembshuro, shpëtomë,\* mëshirëmadh, me përdëllimin tënd.

#### *Hyllindësor*

**Z**onjë\* më e lartë se çdokush,\* tregomë më të lartë se çdo pasion i keq;\* un' ty të besoj,\* Perëndillindëse krejt vërtet,\* dhe himnoj Birin tënd që nderohet mjaft\* pa konceptim, e pacen,\* o hyjhirplote më-

shiruese.

*Tjetri: Asporu silipseos*

**O** Krisht, kryqëzohesh edhe më shpëton; ti vdes, ma jep pra jetën mua.\* Oh, sa dhembshuri, sa njeridashje! Kush vall' ka par'\* a ka dëgjuar: Një Zot\* të zgjedhë vdekje të dukshme krejt\* për shërbyesit? Prandaj lavd\* mirësisë sate që s'shprehet.

**K**ur dielli të pa ty të kryqëzuar, perëndoi;<sup>23</sup> si nuk kishte\* për të perënduar?! Ndjeu sharjen e Bërësit,\* si dhe Krijesa mbarë\* që tundej,<sup>24</sup> sado e heshtur ish,\* kryqëzuesve u thoshte\* fort se Zot i universit je.

Lavdi *Triadik*

**T**ë psal, Mendje, prind unik i Birit, pra të vetëm, edhe Mendje Fjalë,\* o agim i lavdit nur të Atit, dhe Mendje Zot,\* Dalje e vetme, Shën Shpirt\* i vetëm; botës iu shfaqe ti\* përmes Birit në gjith' jetët;\* vetëm ty, të vetmit, veç të psal.

Tani *Hyjlindësor*

“Çudia e lindjes sate më çudit, e Tërëpacenuar, Zonjë;\* si pa farë të pakapshmin, thua, si ti e nxë,\* si nënë meqë linde,\* por je e virgjër?“. “Kur ta mendosh\* me bes' të përmbinatyrshmen,\* falju Birit, se bën krejt sa do”.<sup>25</sup>

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **P**ër ne, çdo gjymtyrë jotja ka pranuar keq pësim, pra brinja shtizën,\*<sup>5a</sup> koka grushtin<sup>26</sup> dhe karfosjen duart, fytyra tok\* shuplaka,<sup>27</sup> paradokset\* në Kryq, prandaj, Shpëtimtari yn',\* lavde dhembshurisë sate\* plot çudi të parrëfyeshme.

*Irmosi: Asporu silipseos*

»**P**a prishje në bark ka nxënë nënë pa »burr', lindja s'ka shpjegim, se zënia\* ish »pa farë, Perëndia lind dhe natyrat ky\* i

»rinovon; prandaj ne,\* të gjithë brezat,<sup>28</sup> »orthodhoksisht\* ty të madhërojmë plot »mall\* si hyjnuse, nënë pa qortim.

*Fotogjoku i Tingullit të javës*

*Pasvargjet e Lavdërimeve*

*Ting. Tërth. IV Idhiomeli*

**O** Krisht Perëndi, që u mbërtheve në Kryq bashkë me kusarë<sup>29</sup> dhe që me traumën tënde e shërove natyrën njerëzore,<sup>30</sup> mos më shpërfill mua që rashë në hajdutë mendore dhe vjedhës të patrup, dhe u zhvesha nga virtyti prej tyre, dhe u plagosa rëndë, dhe nuk mund të shërohem nga asnjë oshënar; sepse jam gjysmë i vdekur, dhe kam një pjesë shumë të shkurtër jete, pra shpresën e vetme të ti që ua jep jetën edhe të vdekurve; madje m'i lidh traumat, duke më pikuar<sup>31</sup> mirësinë tënde, o i vetmi njeridashës.

*Varg:* U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përulë, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt' e tyre.

*I njëjti*

*Varg:* Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji të ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

*Martirik Ti imas kalësomen ajji*

Çfarë mund t'ju quajm', shenjtore, ne?\* Keruvime? Se u preh përmbi ju Krishti Perëndi.\*<sup>31a</sup> Serafime? E lëvduat pa pushim atë me himn.\*<sup>31b</sup> Dhe engjëj? Se shpërfillët trupin, mishin pra.\* Dhe Forca? Se veproni me çudi<sup>31c</sup> gjithnjë\* dhe keni emra të shumtë ju,\* karizma fort të mëdha me hir,\* ndaj ndërmjetim\* bëni



të shpëtohen shpirtrat tan'.

Lavdi *dhe* Tani *Kryqyjilindësore*  
*O tu paradhoksua thávmatos*

“O habi paradoksale krejt, mister i ri dhe guxim\* arrogant!”, tha e Virgjra Zonj\*, që të lindí pa dhembk’ ty\*<sup>31d</sup> dhe pa prishje, teksa të pa\* çuditërisht midis dy kusarëve\* në Kryq të varur,<sup>29</sup> “Jisu, o Biri im\* tepër i ëmbël, Krisht\* kaq i dashur, si të nguli përmbi një dru,\* plot tmerr, populli i keq, mosmirënjohës fort?”.

*Lexuesi:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin *etj. si të hënën e parë në mëngjes (fq. 63).*

*Në orën e Gjashtë (në Trithektë), Tropari i Profecisë.*

*Ting. Tërth. I*

Je i përmblimnuar, o Krisht, Perëndia ynë, që e tund dheun që të kthehen dhe të shpëtojnë ata që banojnë në të, dhe përsëri e forcon nga mirësia dhe dhembshuria jote e parrëfyshme; shpëtona me ndërmjetimet e Hyjllindëses.

Lavdi *dhe* Tani

*I njëjti*

Proqimen. Ting. Tërth. IV. Psalm 100.

Do të të psal mëshirë dhe gjykim, o Zot.

*Varg:* Do të psal dhe do të kuptoj në udhë të paqortueshme.

Këndimi i profecisë së Isaia

*(45.11-18)*

Kështu thotë Zoti Perëndi, i shenjt i Izraelit, i cili i bëri ato që do të vijnë: “Më pyesni për bijtë e mi dhe për bijat e mia, dhe më porosisni për punët e duarve të mia. Unë bëra tokë dhe njeri mbi të, unë me dorën time e sigurova qiellin, unë i porosita gjithë yjet. Unë e ngrita atë me drejtësi mbret, dhe të gjitha udhët e tij janë të drejta. Ky do të ndërtojë qytetin tim,

dhe robërinë e popullit tim do ta kthejë jo me shpërblesë, as me dhurata”, tha Zoti Sabaoth. Kështu thotë Zoti Sabaoth: “U lodh Egjipti dhe tregti etiopësh; dhe sevoimet, burra të gjatë, mbi ty do të kalojnë, dhe do të të jenë shërbëtorë të ti, dhe do të vijnë pas teje të lidhur me pranga në duar, dhe do të kalojnë drejt teje, dhe do të të falen dhe do të luten në ty”, se në ty është Perëndia dhe s’ka perëndi veç teje, sepse do të thonë: “Ti je Perëndi, dhe nuk e dinim, Perëndia i Izraelit, shpëtimtar”. Do të turpërohen dhe do të poshtërohen të gjithë kundërshtarët e tij dhe do të ecin në turp. “Përtërhuni drejt meje, o ishuj”. Izraeli shpëton nga Zoti me shpëtim të përfjetshëm. “Nuk do të turpërohen as nuk do të poshtërohen më gjër në jetë”, kështu thotë Zoti.

Proqimen. Ting. IV. Psalm 101.

O Zot, dëgjoje faljen time dhe klithma ime le të vijë drejt teje.

*Varg:* Mos e kthe mënjatë fytirën tënde nga unë.



## TË PREMTEN E JAVËS SË PESTË NË MBRËMËSORE

*6 Thirrtoje*

*Ting. Tërth. II Idhiomeli*

Duke dalë nga porositë e tua hyjnore si nga Jerusalemi dhe duke katandisur drejt pasioneve të Jerikosë, pasi u zvarrita poshtë përmes lavdisë së çnderimit të përkujdesjeve jetësore, rashë në kusarë të mendimeve; prej tyre u zhvesha nga këmisha e birësimit që kisha përmes Hirit, dhe dergjem si pa frymë për shkak të plagëve. Një prift më erdhi pranë dhe, pasi më pa të rrëzuar, nuk më vuri re. Edhe një levit,

pasi më neveriti, më kaloi anës.<sup>31</sup> Por ti, o Zoti Krisht Perëndi, që u mishërove pashprehshëm prej një Virgjëreshe, nëpërmjet derdhjes vullnetare<sup>31a</sup> të gjakut dhe të ujit që rrodhën nga brinja jote,<sup>5a</sup> pasi t'i pikosh si me vaj vendet e traumave të mia, lidhi me fasha,<sup>31</sup> dhe më numëro në vendin qiellor, si i dhembshur. (2x)

### Martirike

Martirët e tu, o Zot, nuk të mohuan, nuk u larguan nga porositë e tua; me ndërmetimet e tyre mëshirona.

### Të Perëndilindëses

#### Ting. Tërth. II Olin apothëmeni

Duke të zbuluar ty\* haptas vendim para jete,\*<sup>32</sup> Vajzë, Gabrieli vjen\* dhe të përshëndet, thotë pra: Gëzohu, ti\* dhe i pambjellë krejt,\* ferrë e padjegur,\*<sup>33</sup> thellësi ku nuk vështrohet dot; gëzohu, urë je,\* që drejt qielloreve transferon;\* gëzohu, shkall' e lartë mjaft\* që të pa Jakovi;<sup>34</sup> gëzo, dëfre,\* shtambë fort e shenjtë e manës,<sup>11</sup> zgjidhje e mallkimit,<sup>1</sup> ndjes',\* rithirrje je për Adamin ti,\* Zoti është tok me ty.

“Si njeri më dukesh ti”,\* i thotë Vajza pa prishje\* kryegjeneralit,<sup>35</sup> “pra\* fjal' mblinjerëzore mbi mend më thua ti,\* se the do jetë tok\* Zot me mua, Perëndi,\* do fushojë brenda mitrës sime; kështu më sqaro,\* si një vend i gjerë do bëhem mjaft,\* banesë shenjtërimi un'\* për atë që mbi Keruvimet hip?\*<sup>36</sup> Mos më josh me fjalë mashtrimi, se s'njoh ëndje edhe epsh,\* nuk di as dasmë, as burr' aspak,\* si do lind fëmijë, bir?”.

“Mundet rendi natyror\* kudo që do Perëndia”,\* i patrupi tha drejt saj\* “dhe realizohet çdo gjë përmbi njeri,\* Vajzë e tërëshenjt'\* dhe e paqortueshme,\* fjalën

time të vërtetë ta besosh”, në çast ajo\* thirri: “Të më bëhet tani siç the;\* do lind atë që nuk ka mish,\* që do marr' prej meje si hua mish,\* që, pors i vetmi i fortë, lart ta ngrejë njerëzin'\* në gradën që kish në lashtësi\*<sup>37</sup> duke u përzier me ne.”

### Lavdi dhe Tani

#### Ting. II I Theofanit

Misteri i parajetshëm zbulohet<sup>38</sup> sot dhe Biri i Perëndisë bëhet bir njeriu, që, pasi të marrë pjesë te më e keqja, të më përçojë më të mirën. U zhgënyje qëmoti Adami dhe, ndonëse e dëshiroi, nuk u bë perëndi.<sup>39</sup> Perëndia bëhet njeri që Adamin ta bëjë perëndi. Le të dëfrejë Krijesa, le të kërcejë natyra, sepse një kryeengjell qëndron me frikë pranë një Virgjëreshe dhe sjell “Gëzohu-n”,<sup>40</sup> të kundërtën e trishtimit. O Perëndia ynë, që u njerëzove nga dhembshuria,<sup>41</sup> lavdi më ty.

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Prifti:* Mbrëmje!

*Lexuesi:* Proqimen. Ting. IV. Psalm 102.

I dhembshur dhe përdëlyes është Zoti.

*Varg:* Bekoje, o shpirti im, Zotin.

### Këndimi i Gjenezës

#### (22.1-18)

U bë që, pas këtyre fjalëve, Perëndia e provoi Abrahamin dhe i tha: “Abraham, Abraham!”. Dhe ai tha: “Ja unë!”. Dhe tha: “Merre birin tënd të dashur, që e deshe, Isaakun, dhe ec drejt tokës së lartë, dhe ofroje atje në holokaust mbi një nga malet që do të të them”. Dhe, kur u ngrit në mëngjes, Abrahami vuri samarin mbi gomaren e tij, dhe mori me vete dy shërbëtorë dhe Isaakun, birin e tij, dhe, pasi çau dru për fli të plotë, si u ngrit, eci dhe erdhë ditën e tretë mbi vendin që i tha Perëndia. Dhe, pasi pa lart me sytë e tij, Abrahami e vëzhgoi vendin prej së largu.



Dhe Abrahami u tha shërbëtorëve të tij: "Rrini këtu bashkë me gomaren, ndërsa unë dhe djaloshi do të kalojmë deri këtu dhe, pasi të falemi, do të kthehemi drejt jush". Dhe Abrahami mori drutë e flisë së plotë dhe i vuri mbi Isaakun, birin e tij, dhe mori në duar edhe zjarrin, edhe thikën, dhe ecën të dy bashkë. Dhe Isaaku tha drejt Abrahamit, atit të tij: "O atë!". Dhe ai tha: "Ç'është, o bir?". Dhe tha: "Ja zjarri dhe drutë; ku është delja për fli të plotë?". Dhe Abrahami tha: "Përrëndia do të shikojë për veten dele për fli të plotë, o bir". Dhe, si ecën të dy së bashku, erdhën mbi vendin që i tha Përrëndia. Dhe Abrahami e ndërtoi atje altarin dhe vuri mbi të drutë dhe, pasi lidhi këmbët dhe duart e Isaakut, birit të tij, e vuri mbi altar sipër druve. Dhe Abrahami shtriu dorën e tij që të merrte thikën për të therur birin e tij. Dhe e thirri një engjëll Zoti nga qielli dhe tha: "Abraham, Abraham!". Dhe ai tha: "Ja unë". Dhe tha: "Mos e vër dorën tënde mbi djaloshin, as mos i bëj gjë, se tani njoha se ti e ke frikë Përrëndinë dhe për hirin tim nuk e kurseve birin tënd të dashur". Dhe, si pa lart me sytë e tij, Abrahami vëshgoi, dhe ja, ish një dash i kapur nga brirët në pemën e savekut; dhe Abrahami eci, dhe e mori dashin, dhe e ofroi për fli të plotë në vend të Isaakut, birit të tij. Dhe Abrahami e quajti emrin e këtij vendi "Zoti pa", që të thonë sot "Zoti u shfaq në mal". Dhe një engjëll Zoti e thirri Abrahamin për herë të dytë nga qielli duke thënë: "U betova ndaj meje, thotë Zoti; përderisa e bëre këtë fjalë, dhe për hirin tim nuk e kurseve birin tënd të dashur, patjetër duke bekuar do të të bekoj, dhe duke shumëfishuar do ta shumëfishoj farën tënde si yjet e qiellit dhe si rërën pranë buzës së detit,

dhe fara jote do t'i trashëgojë qytetet e kundërshtarëve; dhe do të bekohen në farën tënde të gjitha kombet e dheut si shpërblim, sepse e dëgjove zërin tim".

Proqimen. Ting. IV. Psalm 103.  
Sa u madhështuan veprat e tua, o Zot!  
*Varg:* Bekoje, o shpirti im, Zotin.

Këndimi i Fjalëve të Urta

(17.17-18.5)

Vëllezërit le të jenë të vlefshëm në nevoja, sepse për këtë lindin. Një burrë i pamend duartroket dhe kënaqet për veten e tij, porsí dhe ai që bëhet garant e jep garanci për miqtë e tij. Ai që e do mëkatin, gëzohet në luftëra, dhe ai që e lartëson derën e tij, kërkon dërrmim, ndërsa zemërashpri nuk takohet me të mirët. Një burrë që e ndryshon lehtë gjuhën, do të bjerë në të këqija, ndërsa zemër të pamendi është dhimbje për atë që e ka. Nuk dëfren një atë mbi bir të paedukuar, ndërsa bir i mençur e dëfren nënën e tij. Një zemër që dëfren, i bën mirë shëndetit, ndërsa kocka burri të trishtuar thahen. Nuk shkojnë mbarë udhët e atij që merr padrejtësisht dhurata në gjí; dhe i pabesi shtrembëron udhë drejtësie. Fytyrë burri të urtë është e mençur, ndërsa sytë e të pamendit *rotullohen* mbi skajet e dheut. Një bir i pamend është zemërim për atë dhe vuajtje për atë që e lindi. S'është mirë të dëmtosh burrë të drejtë, as e pëlqyeshme të Zoti të intrigosh kundër eporësh të drejtë. Ai që ruhet të mos nxjerrë *ndonjë* fjalë të ashpër, është i mençur, dhe burrë zemërgjerë është i urtë. Idiotit që pyet urtësinë, do t'i llogaritet *si* urtësi, dhe ai që e bëri veten *si* të shurdhër, do të konsiderohet se është i mençur. Kërkon pretekste një burrë që do që të ndahet nga miqtë, dhe në çdo kohë do të jetë i

turpëruar. Nuk ka nevojë për urtësi *një* i varfër në mendje, sepse më shumë udhëhiqet prej marrëzie. Kur do të vijë në thellësi të këqijash, i pabesi do të bëhet i pandjeshëm, dhe vjen mbi të çnderim dhe poshtërim. *Si* ujë i thellë është fjalë në zemër burri, dhe kërcen lart lumë dhe burim jete. Të admirosh fytyrë të pabesi, nuk është mirë, as e pëlqyeshme para Zotit të shtrembëros të drejtën në gjykim.

Le të drejtohet lutja ime *dhe shërbesa e të Parashenjtëruarave që mbetet.*

*Në Pasdarkë psalim Kanunin Nekrosim të Tingullit dhe atë të Mujorit.*

#### CITIME

1. Gjen. 3.17-19
2. Ps. 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9
3. I Tim. 3.4; II Tim. 1.3
4. Ps. 103(104).2
5. Kol. 3.12
- 5a. Joan 19.34
6. Gjen. 3.6
7. Gjen. 2.15
8. Is. 26.9
9. Ps. 142(143).10; Matth. 7.21
10. Matth. 27.29; Mark 15.17; Joan 19.2,5
11. Eks. 16.33; Hebr. 9.4
12. Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
13. Eks. 25.22-29; 39.18; 40.20; Lev. 24.6; Hebr. 9.2
14. Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 8.2; Hebr. 9.2
15. IV [III] Mbret. 19.15; II Kron. 18.18; Is. 6.1; Jez. 1.13-26; 10.1; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 32
16. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 27
17. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
18. III [I] Mbret. 19.12
19. III [I] Mbret. 19.8
20. Num. 21.6-9
21. Apok. 12.9; 20.2
22. Joan 6.63,68
23. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
24. Matth. 27.50
25. Ps. 134(135).6
26. Lluk. 22.64
27. Joan 18.22; 19.3
28. Lluk. 1.48
29. Matth. 27.38; Mark. 15.27; Lluk. 23.32-33; Joan 19.18
30. Is. 53.5; I Petr. 2.24
31. Lluk. 10.30-34
- 31a. IV [II] Mbret. 19.15; Is. 37.16; Jez. 10.1; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 31

- 31b. Is. 6.2-3; Apok. 4.8
- 31c. Matth. 14.2; Mark 6.14; Gal. 3.5
- 31d. Is. 66.7
- 31e. Joan 10.15,17-18
32. Is. 25.1
33. Eks. 3.2-5
34. Gjen. 28.12-17
35. Jis. N. 5.14-15
36. IV [III] Mbret. 19.15; Jez. 10.1
37. Gjen. 1.27-30
38. Kol. 1.26
39. Gjen. 3.1-6
40. Lluk. 1.26-28
41. Lluk. 1.78

#### TË SHTUNËN E JAVËS SË PESTË TË HIMNIT AKATHIST

**A:** HIMNI AKATHIST NË PASDARKË

**B:** HIMNI AKATHIST NË MËNGJESORE

**A:** HIMNI AKATHIST NË PASDARKË

*Të premtën në Pasdarkën e Vogël, pas Të meriton, psalet tropari Si mori vesh (3x) dhe menjëherë prifti lexon Stancën e Parë të Himnit Akathist (fq. 271). Pastaj psalen Odet I dhe III të Kanunit Ja gojën e çel tani në 6 bashkë me Irmoset. Pas Odes III, psalet Kontaqi Përlufteshës ngadalë me melodi dykoresh, dhe lexohet Stanca e Dytë e Himnit (fq. 273). Pastaj psalen Odet IV, V dhe VI të Kanunit dhe përsëri Përlufteshës shpejt dhe dykoresh (fillon psalti i dytë). Lexohet Stanca e Tretë e Himnit (fq. 274). Pastaj psalen Odet VII, VIII dhe IX dhe dhjaku (ose prifti) temjanis tërë kishën. Psalet përsëri Përlufteshës shpejt dhe dykoresh (fillon psalti i parë) dhe lexohet Stanca e Katërt (fq. 278). Përlufteshës shpejt. Trishenjtë. Përlufteshës (hima). Mëshiro, o Zot (40x). O Perëndi që adhurohesh dhe të tjerë të Pasdarkës së Vogël. Para Me uratat, psalet O bukuri me nam.*

*Të shtunën në Mëngjesore, pas Perëndia është Zoti, këtë Tropar:*



*Ting. Tërth. IV To prostahthën mistikós*

**S**i mori vesh mistikisht krejt porosinë,\* po vjen në tendën\* e Josifit me nxitim mjaft\* kryeengjëlli, thotë\* tek ajo që s'kish burr'\*: Ai që i uli qiejt kur zbriti<sup>1</sup> posht',\* i tëri pa u ndryshuar\* mbahet nga ti;\* kur e shoh tashmë që ka marrë formë rob<sup>2</sup> në mitrën tënde, shtangem dhe thërras:\* G'zohu, Nuse e panusëruar. (3x)

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore*

*Ting. III Tin oreótita*

**T**ërë Krijesa sot\* ka gaz, se engjëlli\* "Gëzohu" të thërret,\* "Je e bekuar ti,\* e tërëpaqortueshme, modeste, e pacenuar".\* Pranga e mallkimit<sup>3</sup> ra,\* që në vuri stërat<sup>4</sup> yn',\* çdo tërbim i gjarpit djall<sup>4</sup> shuhet sot, të thërresim pra:\* Gëzohu, o Hirplote e virgjër,\* linde ti Perëndinë tonë.

Lavdi dhe Tani

*E njëjta*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore*

*Ting. IV Kateplaji Iosif*

**G**abrieli i thërret\* modestes që nga qielli:\* "Gaz ki, se do nxësh në bark\* të parajetshmin, Zotin Krisht,\* që përmes fjalës ka bërë çdo skaj të botës".\*<sup>5</sup> "Si do lind bir unë që burrë s'kam?"\* tha Mariama se, "pjellori pa far',\* kush pra ka parë?". Engjëlli shpjegoi,\* i tha Hyjllindëses virgjëresh'\*: "Do vij' te ti Shpirt,\* do hijeshohesh\* me fuqi nga i Larti".

Lavdi dhe Tani

**S**ë dëlirës Virgjëresh' i çohet kryeengjëlli\* Gabriel; i lajmëron\* hare që s'shprihet dot aspak:\* Pa far' do ngjizesh, s'do prishesh, sepse do lindësh\* Bir, të parajetshmin Zot, Perëndi;\* do shpëtojë nga faji popullin;\*<sup>6</sup> dëshmon ai që më dërgoi të them:\* "O e bekuar, gëzohu!".\* Ti lind e virgjër\* edhe pas lindjes\* mbetesh prapë

e virgjër.

*Psalmit 50 dhe Kanuni, dhe Tetraodet në vendin e tyre. Kanuni i Perëndilindëses (me Varg: E përbishenjtë Hyjllindëse, shpëtona), që ka Akrostihidhë pa Irmoset: "O ena e haresë, ty vetëm të përket të gëzohesh. Josif" (me Irmoset, në 6). Në fund të çdo Ode psalet Zbritësorja (ose Irmosi).*

*Ting. IV*

*Ode I*

*Anikso to stoma mu*

»Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej »Shpirtit<sup>7</sup> Shenjt,\* dhe këngë do t'i këndoj, Nënës së Madhe mbi fron,\*<sup>8</sup> dhe do »ta kremtoj\* me valle buzëqeshur,\* me »zë do t'i shpall kudo, gjithë çudit' e saj.\* (2x)

**S**i libër të Zotit Krisht, të hirësuar<sup>9</sup> prej Shpirtit Shenjt,\* të pa Kryeengjëlli, Mari Hyjllindëse,\* dhe të tha kështu:\* Lum ti që sjell gëzimin;\* mallkimin stërgjyshëror,<sup>3</sup> ti do ta zhdokësh krejt.\*

**A**damin e ngrite lart, o Virgjëreshë Hyjllindëse,\* dhe Ferrin e shtrin përdhe, o Zonj' e Shenjtë Mari,\* lum ti, o pallat\* i Zotit edhe Mbretit,\* lum ti, o i zjarrti fron i perandorit<sup>10</sup> Krisht.\*

**G**ëzohu, o lindëse e të pafishkurit trëndafil,\* gëzohu se ti po rrit mollën e erëshme,\* lule e qiellshme\* e Zotit edhe Mbretit,\*<sup>11</sup> lum ti, o Hyjllindëse, Zonjë shpëtonjëse.\*

**T**hesar i virtyteve, që na ke ngritur prej varreve,\*<sup>4</sup> edhe prej kufomave, Zonjë Hyjllindëse,\* lule dhe zambak,\* aromë për besnikët,\* temjan erëmirë, mir' e paçmueshme.\*

*Zbriësore: Anikso to stoma mu*

**J**a gojën e çel tani

*Ode III**Tus sus innologus*

»O Zonjë dhe Nën' e Perëndisë, burim i pasosur jetësor,\* ti siguroji gjith' ata që të këndojnë plot me zell,\* dhe lart në q'ell ku mbretëron, kurorëzoi me çdo lavdi.<sup>12\*</sup> (2x)

Kallin' qiellor ti na ke mbirë, si arë pa bujq dhe pa lërim,\* lum ti altar<sup>13</sup> i shpirtëshmë, ku buk' e jetës<sup>14</sup> na u vu,\* lum ti burim i ujëve<sup>15</sup> që japin jetë Hyjlindëse.\*

Mëshqerrë që demin na ke lindur, q'ellor për besnikët pa cenim,\* lum ti, o del' e hyjëshme, se qengjin Perëndi na dhe,\* mëkatin botëror që ngre,<sup>15a</sup> gëzohu Zonjë ndërmjetëse.\*

Gëzohu, mëngjes i ditës sonë, që Diellin solle Jisu Krisht,\* për botën dritë dhe për ne, dhe errësirë s'le mbi dhë,\* dhe Ferrin e demonëve e shkatërrove përgjithënjë.\*

Gëzohu, o derë shpëtimtare, ku Fjala dhe Bir i vetëm shkoj,\*<sup>16</sup> Ferrit ia theve dyertë,<sup>17</sup> me lindjen e çlironjësit,\* gëzohu port' e hyjëshme, dhe shpëtimtare e ndritëshme.\*

*Zbritësore: Tus sus innologus*

O Zonjë dhe nën'

*Ndenjësore*

*Ting. I Ton tafon su Sotir*

Arrin në Nazaret,\* në qytet gjenerali\* i madh i forcave të patrup,<sup>18</sup> të njofton pra,\* o Vajzë pa cenim, ty Mbretin e jetëve, Zotin<sup>19</sup> Krisht;\* thotë: Ki gëzim,\* Mari e tërëbëkuar,\* nuk kuptohet dot\* dhe nuk shpjegohet çudia;\* gjinin' e rithirre ti.

Lavdi dhe Tani

E njëjta

Ode IV

*O kathimēnos en dhoksi.*

»Ti që rri midis lavdisë\* përmbi fronin<sup>20</sup> »e hyjëshëm,\* nga një re e lehtë\*<sup>21</sup> erdhe, »o Jisu i përjetëshëm,\* dhe na shpëtove »me dorën jetëdhënëse,\* të thërresim »pra: Nder dhe lavdi gjithënjë mbi ty.\*

Me këndime dhe me besë\* të thërresim Hyjlindëse,\* lum ti mal i Shenjtë\* që u hijesove prej Shpirtit Shenjt,\*<sup>22</sup> lum ti kandil<sup>23</sup> edhe shtambë manapurëse,\*<sup>24</sup> që i ëmbëlson<sup>25</sup> ndjenjat e gjithë besnikëve.\*

Mëshironjëse e botës,\* Virgjëreshë Hyjlindëse,\* lum ti shkall' e shenjtë,\*<sup>26</sup> që nga dheu shpie në q'ell me hir,\* lum ti, o urë, që prior lavdëronjësit\* që prej varreve lart në<sup>27</sup> Parajsën e engjëjve.\*

Me e lartë prej çdo q'elli,\* Shpëtimtarin e njerzve,\* ti në gjin' e shenjtë\* e ke mbajtur Zonjë Hyjlindëse,\* lum ti që ngeve me gjakun rrobën ndritëse\* dhe shkëlqjenjëse të Komandantit të Forcave.<sup>28\*</sup>

Ligjvënësin ke lindur,\* Virgjëreshë Hyjlindëse,\* që paligjësitë\* ua fal të gjithëve darovisht;\* o lartësi pa kufi, o thellësi pa fund,\* ndërmjetonjëse, ti na ke ngritur në qiellin.\*

Ty që plekse për njerinë\* një kurorë të qiellshme,\* ty të përhimnojmë,\* lum ti Virgjëreshë Hyjlindëse,\* lum ti fortesë dhe mbrojtje e të gjithëve,\* o përkrahëse, streh' e përlkij' e besnikëve.\*

*Zbritësore: O kathimēnos en dhoksi.*

Ti që rri midis lavdisë

Ode V

*Eksesti ta simpanta*

»Të gjith' i habite ti, me një çudi dhe një »lavdi:\* Ti, o Virgjëresh' e pamartuar,\* »Zotin e botës<sup>29</sup> që mbretëron lart në q'ell, »si një bir e mbajte në pëqi,\* dhe shpëtim



»që lartazi\* u dhurove besnikëve.\*

**O** Zonjë Hyjllindëse, që linde udhëheqësin,<sup>30</sup> ti na ke shpëtuar nga përmbytja<sup>31</sup> ne mëkatarët dhe të pavyerit, Nus' e Perëndisë Shën Mari,\* lum ti, o Hyjpritëse,\* Nën' e Zotit të gjithëve.<sup>32\*</sup>

**K**ështjella e njerëzve, gëzohu, o Hyjllindëse,\* vend i shenjtërim<sup>33</sup> dhe lavdisë,\* vdekja e Ferrit, o Nus' e ndritëshme,\* o gëzim i engjëjve në q'ell,\* lum ti, o përkrahëse\* e të gjithë besnikëve.\*

**O** fron që shkëlqen dhe ndrit me Fjalën<sup>10</sup> e përjetëshme,\* lum ti, o Parajsë shpirtërore,\* që ke në qendër<sup>34</sup> Zotin e jetëve, që i ëmbëlson edhe i ngjall\* gjithë të gëzuarit\* me kungatën e qiellshme.\*

**P**rej teje forcohem, thërresim pra me zë të madh:\* Lum ti, o qytet i Mbretit<sup>35</sup> tonë,\* e lavdëruar prej gjithë brezave dhe prej<sup>36</sup> gjithë kishave kudo,\* mal<sup>37</sup> i lartë gjer në q'ell,\* det pa fund edhe pa kufi.\*

**P**allat i diamanteve të çmuara, Hyjllindëse,\* ti që na dhuron margaritarin,\* Fjalën e Atit dhe Shpëtimtarit ton' Krisht, ti me Perëndinë i pajton\* gjithë lumuronjësit\* që të lusin besnikërisht.\*

*Zbritësore: Eksesti ta simpanta*

**T**ë gjith' i habite ti

*Ode VI*

*Tin thian taftin*

»Këtë të kremte e lusim sot, për Zonjën edhe Nënë Hyjllindëse, gjithë hyj-mëndësit,\* eni trokisni pra duartë,\* dhe »lavdëroni Zotin që lindi prej asaj.\* (2x)

**B**anes' e Fjalës, e ndritëshme, gëzohu, shenjtërim i të gjithëve, Zonjë Hyjllindëse,\* mburrur prej gjithë profetëve\* dhe prej të gjith' apostujve dhe shenjtoreve.\*

**N**a prure vesën e qiellshme që shoi tërë zjarrin pagan të keq. Ty të thërresim pra:\* Lum ti, shtëllunga e vesëve,\* që Gedeoni e pa,<sup>38</sup> Zonjë Hyjllindëse.\*

**G**ëzohu, Zonjë Hyjllindëse, liman u bëj për ne lundëronjësit ku të përmbldhemi\* brenda në detin e helmeve\* dhe të përballim sulmet e të paudhëve.\*

**G**ëzohu, Zonjë gëzonjëse, mendimet që të themi me zë të lartë: Lum ti, Hyjllindëse,\* re<sup>39</sup> edhe ferrë<sup>40</sup> e ndritëshme,\* që ne besnikët na mbron dhe na mbulon gjithnjë.\*

*Pastaj Tetraodi, poezi e të njëjtit Josif (në 4, me Varg: O shenjtore të Perëndisë, ndër-mjetoni për ne), që ka Akrostihdhë: «Kjo ode është e Josifit».*

*Ting. Tërth. II*

*Tu viu tin thalasan*

**M**artirët garonin fort\* dhe, si gur' të zgjedhur mjaft\* që rrokulliseshin mbi dhë,\*<sup>41</sup> çdo ndërtim të armikut rrafshuan krejt,\* u bënë kështu komplet\* kisha, tempuj të Perëndisë<sup>42</sup> Shpëtimtar.

**J**u lypim martirë ju\* që të mirin rrugëtim\* mbaruat.<sup>43</sup> Na forconi ne\* që në rrugën e keshmës të rendim mir',\* si dhe në përsosmërin\* e virtyteve të shkëlqejmë të-rësisht.

Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mira.

*Nekrosim*

**O** Zot përdëllyes krejt,\* shërbëtorët e tu mbar'\* që u shpërngulën drejt teje,\* të mbimirit, nga dheu, në Mbretëri\* t'i bësh pjesëtarë ti,\* siç të luten martirët e tu fort të shenjt'.

*Hyjllindësor*

**E** tërëhimnuar je\* vetëm ti, e Virgjër,

nën';\* lyp të fortshenjtën Fjalë Zot,\* që t'u ndahen të hyjshmet karizma mjaft,\* t'u falen mëkatet krejt\* pra atyre që të himnojnë besërisht.

*Tetraodi tjetër (në 6, me Varg po ashtu: O shenjtore të Perëndisë, ndërmjetoni për ne), poezi e Theodor Studitit:*

*Ting, Tërth. I*

*Tu kitus ton profitin*

Duke kremtuar kujtimin e martirëve, le t'ia drejtojmë Zotit himnet sot, duke dërfryer hyjnisht.

Duke pasur guxim në besim, o athloforë, dhe duke mos u frikësuar nga shpata dhe zjarri, i habitët kështu tiranët.

*Lavdi Triadik*

Të përhimnoj ty, Trini në Persona, të fallem si Njësi në esencë, o Atë, Bir dhe Shpirt i Shenjtë.

*Tani Hyjlindësor*

Je mburrje engjëjsh dhe njerëzish, o Virgjëreshë, sepse linde Krishtin, Shpëtimtarin e shpirtave tanë.

I çuditshëm është Perëndia  
në shenjtoret e tij.

Meqenëse morët jetën në vend të vdekjes, kërceni duke banuar në qiellore, o athloforë të lavdishëm të Krishtit Perëndi.

Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mira.

*Nekrosim*

O Krisht që sundon mbi vdekjen dhe jetën,<sup>44</sup> të zhvendosurit besërisht nga jeta prehri së bashku me shenjtoret e tu.

*[Irmosi: Tu kitus ton profitin*

»Profetin e çlirove nga peshku i madh,<sup>45</sup> dhe mua më nxirr lart nga fundi i mëkatëve, o Zot, dhe shpëtomë.]

*Zbritësore: Tin thian taftin*

**K**ëtë të kremte e lusim sot

*Kontaqi*

*Ting. Tërth. IV Ti ipermaho (hima)*

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse, si përhirim që e shpëtove prej tmerreve, qyteti yt po të përshkruan, o Virgjëreshë, po sikurse ke fuqi të paluftueshme, prej çfarëdo rreziku shpëtomë, se po të thërrës: Gëzohu, o Nuse e panusëruar.\*

*Shhtëpia*

Engjëlli kryetar u dërgua nga qielli t'i thotë Hyjlindëses: "Gëzohu". Dhe, duke të parë të trupëzohesh, o Zot, bashkë me zërin engjëllor, çuditëj e qëndronte duke i thirrur asaj kështu: Gëzohu, ti me anën e së cilës do të shkëlqejë gazi; gëzohu, ti me anën e së cilës do të humbasë mallkimi.<sup>3</sup> Gëzohu, o rithirrje e Adamit të rënë; gëzohu, o shpërblim i lotëve të Evës. Gëzohu, o lartësi ku mendjet njerëzore nuk arrijnë të ngjiten dot; gëzohu, o thellësi ku edhe sytë engjëllorë e kanë të vështirë të shikojnë. Gëzohu, se ti je fron i Mbretit; gëzohu, se ti mban atë që i mban të gjitha.<sup>46</sup> Gëzohu, o yll që tregon Diellin; gëzohu, o bark që trupëzoh Hyjninë. Gëzohu, ti me anën e së cilës përtërihet Krijesa; gëzohu, ti me anën e së cilës foshnjëzohet Krijuesi. Gëzohu, o Nuse e panusëruar.\*

*Sinakარი i Mujorit dhe i sotëm:*

Në të njëjtën ditë, të Shtunën e Javës së Pestë të Kreshmëve, kremtojmë Himnin Akathist të Zonjës sonë të përmbishenjtë, Perëndilindëses dhe gjithmonëvirgjëreshës Mari.

*Vargje:* Me himne të pafjetura, Qyteti e himnon me kënaqësi/ Mbrojtësen vigjilente në luftëra.

Me ndërmjetimet e Nënës sate mbrojtëse dhe të pamposhtur, o Krisht Perëndi, na



çliri dhe ne nga fatkeqësitë që na rrethojnë, dhe na mëshiro si i vetmi njeri dashës.

*Ode VII*  
*Uk elatrefsan*

»Nuk u faleshin krijesave hyjmenësit, »por Kryetarit<sup>47</sup> Iart,\* dhe kërcënimin me »zjarr,\* e shkelën me trimëri, psalnin me »brohori:\* Zot, lavdi më ty,\* o Perëndi i »Etërve,\* ti je vetëm i bekuar.<sup>48\*</sup>

O Hyjlindëse, gëzohu fron i shpirtëshëm, o vreshtë me plot hardhi,\* ngarkuar me rrush të kuq,\* zambak i pafishkur krejt që lulëzon, o Zonj',\* pra gëzohu, ti\* që shpirtrat e besnikëve,\* i gëzon me gjak të Krishtit.\*

Ti që linde mjek, shërues të besnikëve, Mari Hyjlindëse,\* o shkop i shenjtë mistik,\* që lulen e qiellshme ti lulëzon<sup>49</sup> tani,\* Zonj' e ndritëshme,\* me gaz prej teje mbushemi\* edhe jetën trashëgojmë.<sup>50\*</sup>

Asnjë gjuhë s'mund të të lëvdojë vlerësisht ty, o Hyjlindëse;\* nga Serafimët më Iart\* u ngrite kur linde ti Mbretin Jisu Shpëtimtar;\* pra atij iu lut\* të na shpëtojë gjithënjë,\* sa të lusim plot me besë.\*

Prej gjith' anëve të lumërojm', Hyjlindëse, me thirrje gjithënjë.\* Gëzohu, o Shën Mari,\* që mban në pëqirin tënd Fjalën dhe<sup>51</sup> Zotin Krisht;\* pra<sup>52</sup> atij iu lut,\* në librin e të gjallëve të na shkruajë,<sup>53</sup> o Zonjë.\*

Ty të lutemi të gjithë dhe përgjunjemi me gjithë zemër e shpirt;\* dëgjoja pra,<sup>54</sup> Shën Mari,\* shpëtona prej helmeve se po përmysemi,\* edhe ruaje\* qytetin tënd, Hyjlindëse,\* prej armiqve të pabesë.\*

*Tetraadi: Dhrosovolon men tin káminon*

O i shumëmëshirshmi Krisht, bashkësia e përbindritshme e martirëve të tu të

hyjnueshëm tani lëviz në dritën tënde që s'perëndon; me përgjërimet e tyre na jep të gjithëve ndriçim dhe falje mëkatesh.

O Zot, sa e bukur është periudha e vetë-përbajtjes që na dhe! Në të dhembshuroji shpirtrat tanë si i mirë, përmes lutjeve të atleteve të shenjtë që duruan pësimet e tua të bukura dhe të nderuara.

Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mira.

*Nekrosim*

Përderisa shërbyesit e tu tejkaluan shtrëngatën e shumëvuajtur të jetës, bëji të ankorohen në liman jete, o Zot, që të thërrasin bashkë me tërë të zgjedhurit: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.<sup>48</sup>

*Hyjlindësor*

O Gjithmonëvirgëreshë, që kishe në mitër dhënësin e ligjit, përgjërohu që, në kohën e tanishme, të hiqen gjithë paudhësitë nga ata që duan ta praktikojnë mirë dhe me gatishmëri kreshmën e hyjshme.

*Tjetri: Evlojitòs i o Theòs*

I bekuar je, o Perëndi i përbihimnuar dhe i përbilavdëruar,<sup>48</sup> që i tregove tri-ma martirët që garonin për ty.

I bekuar je, o Perëndi i përbihimnuar dhe i përbilavdëruar,<sup>48</sup> që i bëre athloforët ndërmjetues për ne pranë teje.

*Lavdi Triadik*

I bekuar je, o Perëndi i përbihimnuar dhe i përbilavdëruar,<sup>48</sup> që je një në natyrë dhe njëhesh në tre Persona.

*Tani Hyjlindësor*

I bekuar je, o Perëndi i përbihimnuar dhe i përbilavdëruar,<sup>48</sup> që je një në natyrë dhe që e tregove të delirë lindësen.

I çuditshëm është Perëndia ndër shenjtoret e tij.

I bekuar je, o Perëndi i përmbihimnuar dhe i përmbilavdëruar,<sup>48</sup> që mbylle gojë bishash dhe shove zjarr<sup>55</sup> për lavdinë e shenjtoreve të tu.

Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot. I bekuar je, o Perëndi, që i zhvendose nga vdekja në jetën e pafund ata që në jetë të adhuruan besërisht.

*[Irmosi: Evlojitos i o Theos*

»I bekuar je, o Perëndi i përmbihimnuar dhe i përmbilavdëruar,<sup>48</sup> që i sheh avushat, i ulur mbi Keruvime.<sup>56]</sup>

*Zbritësore: Ûk Elátrefsan*

Nuk u faleshin

*Ode VIII*

*Pédhas evajís en ti kamino*

»Djemtë\* e dënuar për t'u djegur, prej «zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit Krisht,<sup>55</sup> «si simbol në vjetëri\* dhe si një veprim «tani,\* dhe tërë botën po e mbledh për «këng' e lavdërim:\* Himnojeni, ju veprat «e Zotit,\* dhe e lartësoni përmbi të gjitha «jetët.<sup>57\*</sup>

Fjalën\* Jisu Krisht në krah' e prite, atë që mban gjithësinë ti e mban në gjj, ti me qumësht e ushqen\* Zotin dhe ushqenjësini\* e dheut dhe të qiellit, dhe të këndonjësve:\* Himnojeni, ju veprat e Zotit,\* dhe e lartësoni përmbi të gjitha jetët.<sup>57\*</sup>

Ferrën\* e kuptoi Moisiu<sup>40</sup> dhe lindjen e Virgjërëshës na e mori vesh. Shembëlla e djemave\* na e shfaqti qartazi:\* Në mes të zjarrit hidheshin edhe nuk digjeshin,<sup>55</sup> Hyllindëse, Mari Virgjërëshë;\* ty pra të himnojme përherë dhe përjetë.\*

Grackat\* e demonëve na zhveshën,<sup>58</sup> po ti përsëri stolin' e re na veshe ne<sup>59</sup> kur na linde Zotin Krisht,\* edhe të verbuarit,\*

nga hija e mëkateve e panë Diellin,<sup>60</sup> Hyllindëse, banesa e dritës,<sup>61</sup> ty pra të himnojme përherë dhe përjetë.\*

Ngjallen\* dhe të vdekurit prej teje, se jetën dhe jetëdhënësin e linde ti, flasin gjuhëlidhurit,\* shohin të verbuarit,\* shërohen të lebrosurit dhe të lënguarit,\*<sup>62</sup> dhe zhduken krejt nga drita demonët,\*<sup>63</sup> Zonjë Virgjërëshë, shpëtim i njerëzisë.\*

Ti që\* na dhurove Shpëtimtarin,<sup>64</sup> dhe ti që na lartësove gjer në qiellin, lum ti, o Hyllindëse,\* rojtëse, shpëtonjëse,\* se ti i mbron dhe i bekon gjithë këndonjësit:\* Himnojeni, ju veprat e Zotit,\* dhe e lartësoni përherë dhe përjetë.<sup>57\*</sup>

*Tetraodi: Ek flogós tis oisii*

Arritjet e martirëve të shenjtë i habitën shumë Mendjet përmbiqiellore; me lutjet e tyre, o Zot i dhembshur, bëji të çuditshme pasurisht mëshirat e tua<sup>64b</sup> te ne.

O atletë të admirueshëm të Krishtit, që shkelët zjarrin nëpërmjet vesës hyjnore,<sup>55</sup> me ndërmjetimet tuaja të nxehta pranë Zotit na çlironi nga zjarri i ndëshkimit.

Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

*Nekrosim*

O Fjalë e përmbimire, orthodhoksët që u larguan prej nesh, denjësoji për jetën në qiell dhe për shkëlqimin e shenjtë me përgjërimet e martirëve bukurmundës.

*Hyllindësor*

O i Dhembshur, me përgjërimet e asaj që të kishte në mitër, të martirëve të shenjtë dhe të apostujve, ndriçoji shpirtat tanë që të të lavdërojmë me ngazëllim shpirti në jetë.

*Tjetri: Ton piitín tis ktíseos*

O kore të shenjtë martirësh, kujtojini ata që ju përhimojnë me mallëngjim dhe e



përbilartësojnë Krishtin në jetë.

**M**artirët, kur po torturoheshin me shpata, ngazëlloheshin duke e himnuar dhe e përbilavdëruar Krishtin në gjithë jetët.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin  
e Shenjtë, Zotin (*Triadik*).

**N**ë mënyrë paradoksale, Trinia ndahet dhe mbetet e pandarë si Perëndi; atë e përbilartësojmë në gjithë jetët.

Tani *Hyllindësor*

**N**jë Virgjëreshë lindi një foshnjë, sepse Perëndia u bë njeri prej saj. Çdo njeri le ta himnojë këtë Zot në jetë.

I çuditshëm është Perëndia  
ndër shenjtoret e tij.

**M**artirët që e himnonin Krishtin në jetë, u shfaqën si përmendore burrërie që shpallnin me triumf rënien e djallit.

Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mira.  
**S**hërbëtorët e tu, o Zot, që u zhvendosën drejt teje me besim dhe shpresë, denjësoji t'i marrë Abrahami në gj. <sup>65</sup>

[*Irmosi: Ton piitn tis ktiseos*

»Bërësin e Krijesës,<sup>66</sup> që e kanë frikë  
»engjëjt,<sup>20</sup> përhimnojeni, o popuj, dhe  
»përbilartësojeni në gjithë jetët.]

*Zbritësore: Pédhas evajis en ti kamino*

Djemtë e dënuar për t'u djegur

*Psalet dhe Më të nderuarën*

*Ode IX*

*Apas jjenis*

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazëllim te  
»drit' e Shpirtit Shenjt,\* eni lavdërojeni,\*  
»engjëjt e q'ellit eni kremtojeni\* këtë të  
»shenjtë panair të Kryezonjës Mari\* dhe  
»thërrisni: Ti je më e lumura,\* Virgjëresh'  
»e kulluar Hyllindëse.\*

Çdo besnik thërret: Gëzohu, Hyllindëse, se gjithënjë na jep,\* gaz që fare nuk mbaron,\* ti pra shpëtona prej gjithë ngasjeve,\* nga sulmet e barbarëve dhe gjithë plagëve\* që na vijnë, nga shumic' e fajeve\* dhe mëkateve tona të tmerrshme.\*

**E**rdhe për ndriçim, për mbrojtje dhe për shpëtim, pra të thërresim sot:\* Lum, o yll pa perëndim,\* që sjell në botë Jisunë, diellin;\* lum, hapëse<sup>67</sup> e mbretëris', kolon' e zjarrt' shum' e fort'\* që u shpie<sup>68</sup> njerëzve një jet' të re\* qiellore që kurrë nuk ka mbarim.\*

**E**jani me bes' në kishën e Zotit Krisht dhe përhëndosheni\* Nënë dhe Hyllindësen:\* O Virgjëreshë, Zonj' e të gjithëve,\* lum ti më e bekuara në mes të grave<sup>69</sup> mbi dhé,\* lum, ti lule,\* miron<sup>70</sup> e përbotëshme\* ti e prite në gjirin dhe na e dhe.\*

**L**um ti, o pëllumb, se ti mëshironjësën na prure përbmi dhé,\* mburrj' eoshënarëve,\* edhe kurora e athloforëve,\* dhe e dëshmorëve si dhe e gjith' shenjtoreve,\* zburimi\* i gjith' të krishterëve\* dhe shpëtimi i gjithë besnikëve.\*

**Z**ot dhe Perëndi, kurse trashëgimin tënd, falu besnikëve\* ndjesën e mëkateve,\* dëgjoja lutjet Nënë Hyllindëse\* dhe ndërmjetimet pa pushim për gjithë njerëzit,\* dhe shpëtoji\* sipas përdëllimit<sup>71</sup> tënd,\* edhe<sup>2</sup> falna Parajsën e qiellit.\*

*Tetraodi: Theón anthropis*

**S**i drit', si diell, martirët lindën plot,\* mbar' sferën e ndriçuan me shkëlqim nga çuditë nur,\* ndaj kështu edhe me rrezatim shpresëtar\* zhdukën çdo terr politeizmi; o Perëndi,\* mëshirona ne me

ndërmjetimet, lutjet që bëjnë.

Ushtri martirësh që s'mposhtesh dot aspak,\* na përforco krejt ne që stadiumin e kreshmëve\* ta mbarojmë, si pra të garojmë mir', drejt,\* vepra të hyjshme mjaft të bëjmë në jetën ton'\* dhe kështu të jemi pjesëtarë jete me hare.

Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

### *Nekrosim*

Zot, mirësia që ke, le t'i arrij'\* sa përmes urdhrat tënd të frikshëm ikën nga ne te ti;\* përdëllimi yt le t'i rrethojë ata,\*<sup>72</sup> t'i udhëheqë për në tendat që shndrijnë fort\* me shkëlqimin e fytyrës sate në amshim gjithnjë.

### *Hyjlindësor*

Krejt parrëfyeshëm me zë engjëlli,\* në bark e kishe engjëllin pas mendjes<sup>73</sup> së Atit Zot;\* zërat e shërbyesve të tu, Zonj', prano,\* te ti i sjellim gjatë kohës së kreshmëve\* edhe si temjan drejt Perëndisë t'i blatosh ato.

### *Tjetri: Isaia horeve*

Duke bërë panair\* për martirët,\* të kërcëjmë sot\* me ode duke psalur, o popuj ne,\* drejt Krishtit që shpalli ndeshje dhe ju dha çdo fitore, lavd\* kundër armiqve mbar';\* le ta madhërojmë me himnim.

Thonj pra ju gërvishtën keq\* dhe ju prenë\* shpata copë-cop';\* me Zotin Krisht u lidhët me dashuri,\* martirë të tërëfamshëm, plot lavd, ndaj lutuni tani\* me ngazëllim të madh\* lart në qiej për të gjithë ne.

### Lavdi *Triadik*

Si të bashkëqenshme ty\* të lëvdoj fort,\* o e pafillim\* Trini, epore jete, me plot respekt,\* Njësi e pandarë, Atë i palindur me Fjalën Bir\* që linde dhe Shën Shpirt,\* ne që të himnojmë, na shpëto.

### Tani *Hyjlindësor*

O Hyjnënë, linde Bir\* përmbi mendje,\* ishe ti me barr'\* pa burr', se Perëndi ish i linduri,\* prandaj edhe shtatzënia jote ish virgjërore nur;\* të lumërojmë ty\* dhe e madhërojmë Zotin Krisht.

Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

T'i kurorëzojmë ne\* me himn, ode,\* trimat, krejt ushtrinë\* e mbretit të të gjithave, Perëndisë\*,<sup>74</sup> sepse mbi kolona demoniake qartë fituan fort;\* duke u psalur njësh,\* madhërojmë Zotin, o popuj.

Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

Krisht, kur gjith' krijimin tënd\* do ta ngjallësh\* për gjykimin tënd,\* shërbyesve të tu besimtarë tash\* që more, u fal krejt fajet gjatë jetës; ndaj ndjeji, Zot,\* prehi ata gjithnjë\* me shenjtoret e tu bashkë lart.

### *[Irmosi: Isaia horeve*

» Isaia vallëzo,\* Virgjëresha,\* Zonja Shën «Mari,\* na lindi Jisu Krishtin Emanuel,\*<sup>75</sup> «njeri edhe Perëndi; dhe emër ka Lindjen<sup>76</sup> «që na ndrit.\* Pra, madhështojm' atë,\* «lumërojmë dhe Hyjlindësen.\* ]

### *Zbritësore: Apas jjenis* Gjithë njerëzit

### *Dërgimësore* *Jinekes akutishite*

Misteri shekullor krejt sot\* na njihet,<sup>77</sup> Biri i Maris',\* Zonjës së virgjër, po bëhet\* nga dhembshuria vet' Fjala\* e Perëndisë, Perëndi.\*<sup>78</sup> Thotë shën Gabrieli\* një lajm hareje. Tok me të,\* të gjithë ne të thërrasim:\* Gëzohu, nëna e Krishtit. (2x)

### *Lavdërime*

### *Ting. IV Os jeneon en mërtisin*

Një mister që ish fshehur krejt,\*<sup>77</sup> i panjohur prej engjëjve,\*<sup>79</sup> i besohet shën



Gabrielit që tash vjen\* te ti, e vetmja pa cen dhe pëllumbeshë plot bukuri,\*<sup>80</sup> dhe rithirje e gjinis';\* të thërret kryeengjëlli, o e Tërëshenjt':\* Gaz ki dhe përgatitu ta pranosh në mitrën tënde, përmes fjale<sup>81</sup> ti, Fjalën Zot, Perëndinë Krisht. (2x)

U bë gati për ty, o Zot,\* një pallat dritë-prurës nur,\* mitra e paprishur krejt e hybijës Vajz',\* eja në të, zbrit, si të të vijë keq për krijimin tënd,\* të luftuar prej zilis',\* që i papastri rob e mban,\*<sup>82</sup> dhe e zhdoku pra\* bukurin' e mëparshme edhe po pret zbritjen tënde shpëtimtare me ngazëllim dhe me padurim.

Zonj' e fortpaqortueshme,\* kryeengjëlli Gabriel\* haptas do të vijë të të thërrasë ty:\* Zgjidhja e nëmës,<sup>3</sup> gëzohu, rimëkëmbje të rënësh je,\*<sup>83</sup> gaz ki, se prej Perëndis'\* vetëm ti u përzgjedhe pra;\* ki gaz, re e gjall'\* dhe e shenjtë e Diellit;<sup>21</sup> mikprit atë që nuk ka mish, që do që të rrijë brenda në barkun tënd.

Lavdi dhe Tani

Ting, IV

Një gjuhë që nuk e njohu, dëgjo Perëndilindësja, sepse i fliste kryeengjëlli fjalët e ungjillëzimit; prandaj, meqë pranoi besërisht përshëndetjen, të zuri ty, Perëndinë para jetëve; kështu edhe ne, duke u ngazëlluar, të thërrasim: O Perëndi, që u mishërove pa ndryshim prej saj, fali botës paqë<sup>84</sup> dhe shpirtave tanë përdëllimin e madh.<sup>71</sup>

*Dhoksologjia e Madhe dhe në fund, Si mori vesh.*

*Në Liturgji, [Tipiket dhe nga Kanuni i Perëndilindësës Ode III dhe VI, ose] dy të parat nga Antifonet e së dielës, dhe Antifoni i tretë si më poshtë:*

*Varg a):* Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ul

veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do ta dëshirojë mbreti bukurinë tënde.

Si mori vesh.

*Varg b):* Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

Si mori vesh.

*Varg c):* Do ta kujtoj emrin tënd në gjithë brezat e brezave.

Si mori vesh.

*Pas Hyrjes, Si mori vesh dhe Kontaqi Përlufteshës. Të meriton. Kungatore:* Kupë shpëtimi. Pamë dritën.

CITIME

Ungjillëzimi: shih Lluk.1.26-38

1. Ps.17(18).10
2. Fil.2.7
3. Gjen. 3.16-19
4. Gjen. 3.1-65. Gjen. 1.1-24; Ps. 148.5
6. Matth. 1.21; Joan 12.47
7. Ps. 118(119).131
8. Ps. 44(45).2,10
9. Is. 29.11
10. Jez. 1.13-28
11. II Makk. 1.24
12. I Petr. 5.4
13. Eks. 25.22-29; 39.18; Lev. 24.6; Hebr. 9.2
14. Joan 6.35,48,51
15. Joan 4.10
- 15a. Is. 13.7; Joan 1.29,36; I Petr. 1.19
16. Jez. 44.1-4
17. Ps. 106(107).16
18. Jis. N. 5.14-15
19. Ps. 144(145).13; I Tim. 1.17
20. II Kron. 18.18; Is. 6.1; Dan. 7.9
21. Is. 19.1
22. Ps. 67(68).16
23. Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
24. Eks. 16.33; Hebr. 9.4
25. Eks. 16.14-32
26. Gjen. 28.12-17
27. Joan 5.24; I Joan 3.14
28. Ps. 67(68).13
29. Rom. 9.5
30. Ps. 15(16).11; Fja. Urt. 6.23; 10.17; 15.24
31. Gjen. 7.6; Sirak 40.10; 44.17; Matth. 24.38-39; Lluk. 17.27-28; II Petr. 2.5
32. III Makk. 2.2
33. I Esd. 8.75; II Esd. 9.8
34. Gjen. 2.9; Apok. 2.7
35. Ps. 47(48).3

36. Ps. 86(87).3  
 37. Dan. 2.34-35  
 38. Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6  
 39. Num. 9.18,22; 10.36; Urt. Sol. 19.7  
 40. Eks. 3.2-5 etj.  
 41. Zah. 9.16  
 42. I Kor. 3.16; II Kor. 6.16  
 43. II Tim. 4.7  
 44. Rom 14.9  
 45. Jona 2.11  
 46. Est. 4.17b; Ps. 94(95).4; Jov 9.19  
 47. Rom. 1.25  
 48. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28  
 49. Num. 17.23; Hebr. 9.4  
 50. Matth. 19.29; Mark 10.17; Lluk. 10.25; 18.18  
 51. Is. 8.1  
 52. Eks. 31.18; 34.1-4,28; Ligji i Dytë 4.13; 5.22(19); 9.9-11; 10.1-4  
 53. Dan. 12.1; Apok. 17.8; 21.27  
 54. IV [II] Mbret. 19.16 etj.  
 55. III Makk. 6.6; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26  
 56. Dan. kap.3 Lutja e Azarias 31  
 57. Dan. kap.3 Lutja e Azarias 34  
 58. Gjen. 3.7  
 59. I Kor. 15.53  
 60. Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79  
 61. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46  
 62. Matth. 11.5; Lluk. 7.22  
 63. Ef. 2.2  
 64. Vep. 4.12; Hebr. 2.10; 5.9  
 64a. Ps. 16(17); 30(31).22  
 65. Luk. 16.22  
 66. Kol. 1.16  
 67. Gjen. 3.24  
 68. Eks. 13.21-22; Num. 14.14; Neh. 9.12  
 69. Kënga 1.8; 5.9; 6.1  
 70. Kënga 1.3  
 71. Num. 14.19 etj.  
 72. Ps. 31(32).10  
 73. Is. 9.6  
 74. Sirak 36(33).1  
 75. Is. 7.14  
 76. Zah. 3.8; 6.12  
 77. Rom. (14,24) 16.25; Ef. 3.3; Kol. 1.26  
 78. Joan 1.1  
 79. I Petr. 1.12;  
 80. Kënga 2.10,13  
 81. Lluk. 1.28-35  
 82. Ef. 6.12  
 83. Lluk. 2.34.  
 84. Joan 14.27



## **B: HIMNI AKATHIST NË MËNGJESORE**

*Të premtën, Pasdarka e Vogël me Theotokarionin dhe Kanunin e shenjtii të së shtunës. Kontaqi Përlufteshës.*

*Të shtunën në Mëngjesore pas* Perëndia është Zoti, *këtë Tropar:*

*Ting. Tërth. IV To prostahtëhën mistikôs*

Si mori vesh mistikisht krejt porosinë,\* po vjen në tendën\* e Josifit me nxitim mjaft\* kryeengjëlli, thotë\* tek ajo që s'kish burr':\* Ai që i uli qiejt kur zbriti<sup>1</sup> posht',\* i tëri pa u ndryshuar\* mbahet nga ti,\* kur e shoh tashmë që ka marrë formë robi<sup>2</sup> në mitrën tënde, shtangem dhe thërras:\* G'zohu, Nuse e panusëruar. (3x)

*Pas Stihologjisë së parë, Përsëri dhe përsëri. Se yti është pushteti, dhe psalet ngadalë me melodi dykoresh Kontaqi Përlufteshës:*

*Ting. Tërth. IV Ti ipermaho*

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse, si përhirim që e shpëtove prej tmerreve, qyteti yti po të përshkruan, o Virgjëreshë. Po sikurse ke fuqi të paluftueshme, prej çfarëdo rreziku, shpëtomë se po të thërras: Gëzohu, o Nuse e panusëruar.\*

*dhe lexohet Stanca e Parë e Himnit:\**

Engjëlli kryetar u dërgua nga qielli t'i thotë Hyjlindëses: Gëzohu (3x); dhe, duke të parë të trupëzohesh, o Zot, bashkë me zërin engjëllor, çuditëj e qëndronte duke i thirrur asaj kështu:

Gëzohu, ti, me anën e së cilës do të shkëlqejë gazi; gëzohu, ti, me anën e së cilës do të humbasë mallkimi.<sup>3</sup>

Gëzohu, o rithirrje e Adamit të rënë;<sup>4</sup> gëzohu, o shpërblim i lotëve të Evës.<sup>3</sup>

Gëzohu, o lartësi, ku mendjet njerëzore nuk arrijnë të ngjiten dot; gëzohu, o thellësi, ku dhe sytë engjëllorë e kanë të vështirë të shikojnë.

Gëzohu, se ti je froni i Mbretit; gëzohu, se ti mban atë që i mban të gjitha.

Gëzohu, o yll, që tregon diellin; gëzohu, o bark që trupëzon Hyjninë.



Gëzohu, ti, me anën e së cilës përtërihet Krijesa; gëzohu, ti, me anën e së cilës foshnjëzohet Krijuesi.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**D**uke parë e Shenjta veten e saj të kulluar, i thotë Gabrielit me guxim: Lajmi i çuditshëm i duket shpirtit tim i pabesueshëm; se, si flet për shtatzëni nga një ngjizje e pafarshme? Edhe thërret:

Alilulia.

**D**uke dashur të njohë të panjohurën, Virgjëresha i thirri meshtarit: Si mund të lindet një bir prej gjiri të kulluar? Thuamë. Dhe ai i tha asaj me frikë, duke thirrur kështu:

Gëzohu, o njohëse e misterit të vullnetit të fshehtë; gëzohu, o besim i heshtjes së atyre që falen.

Gëzohu, o preludi i mrekullive të Krishtit; gëzohu, o kreu i doktrinave të tij.

Gëzohu, o shkallë qiellore,<sup>5</sup> me anën e së cilës zbriti Perëndia; gëzohu, o urë që çon njerëzit nga toka në qiell.

Gëzohu, o çudi e famshme e engjëjve; gëzohu, o plagë e shumëvajtueshme e demonëve.

Gëzohu, ti që në mënyrë të patreguar lindre dritën,<sup>6</sup> gëzohu, ti që nuk i the askujt se si.

Gëzohu, ti që kapërcen dijen e të urtëve; gëzohu, ti që ndriçon mendjet e besimtarëve.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**F**uqia e të Shumëlartit e hijesoi atëherë të Pamartuarën që të ngjizet dhe barkun e saj të frytshëm si arë ua tregoi të gjithë atyre që duan të korrin shpëtim, duke psalur kështu:

Alilulia.

**D**uke pasur mitrën hyjpritëse, Virgjëresha

nxitoi tek Elisabeta; dhe foshnja e saj, duke kuptuar menjëherë përhëndetjen e saj, gëzohej dhe me kërcime,<sup>7</sup> si me këngë, i thërriste Hyjllindëses:

Gëzohu, o lastar hardhie që nuk fishket; gëzohu, o arë fryti të përjetshëm.

Gëzohu, ti që kultivon bujkun njeridashës; gëzohu, ti që mban mbjellësin e jetës sonë.

Gëzohu, o arë që nxjerr pjellori mëshirash; gëzohu, o tryezë që mban bollëk dhembshurish.

Gëzohu, se lulëzon livadhin e dëfrimit; gëzohu, se përgatit limanin e shpirttrave.

Gëzohu, o temjan i mirëpritur ndërmjetimi; gëzohu, o ndjesë e gjithë botës.

Gëzohu, o mirëdashje e Perëndisë për njerëzit; gëzohu, o guxim i njerëzve përpara Perëndisë.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**D**uke pasur përbrenda turbullim mendimesh të dyshimta, Josifi i urtë u shqetësua duke të parë të pamartuar e duke të kujtuar martesëvjedhëse, o e Paqortueshme; po, kur mësoi për ngjizjen tënde nga Shpirti i Shenjtë,<sup>8</sup> tha:

Alilulia.

Përlufteshës *nga të dyja koret në mënyrë të shpejtë.*

*Pas Stihologjisë së dytë të Psaltrit, Përsëri dhe përsëri. Se ti je Perëndi i mirë. Përlufteshës nga të dyja koret në mënyrë të shpejtë; dhe lexohet **Stanca e Dytë e Himnit:**\**

**B**arinjtë dëgjuan engjëjt që himnonin ardhjen trupësore të Krishtit, dhe, duke rendur si te një bari,<sup>9</sup> e panë<sup>10</sup> si qengj të panjollë,<sup>11</sup> të kullotur në barkun e Marisë, së cilës, duke himnuar, i thanë:

Gëzohu, o Nënë qengji<sup>11</sup> dhe bariu;<sup>9</sup> gëzohu, o oborr dhensh<sup>12</sup> të arsyeshëm.

Gëzohu, o mbrojtëse kundër armiqve të

padukshëm; gëzohu, o hapëse e dyerve të Parajsës.<sup>13</sup>

Gëzohu, se qielloret gëzohen bashkë me tokën; gëzohu, se tokësoret vallëzojnë bashkë me qiejt.

Gëzohu, o gojë e paheshtur e Apostujve; gëzohu, o guxim i pamposhtur i Athloforëve.

Gëzohu, o mbështetje e fortë e besimit; gëzohu, o njohëse e shkëlqyer e Hirit.

Gëzohu, ti, me anën e së cilës u zhvesh Ferri; gëzohu, ti, me anën e së cilës u veshëm<sup>14</sup> me lavdi.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**D**uke parë Yllin Hyjrendës, Magët i ranë pas dritës së tij; dhe, duke e mbajtur si kandil, kërkonin me të mbretin e fortë; dhe, duke e arritur<sup>15</sup> të paarrtshmin, u gëzuan duke i thirrur:

Alilua.

**B**ijtë e kaldenjve panë në duart e Virgjëreshës atë që gatoi me dorë njerëzit;<sup>16</sup> dhe, duke e njohur për Zot, megjithëse mori formë shërbëtori,<sup>2</sup> vrapuan ta adhuronjë nëpërmjet dhuratave<sup>16</sup> e t'i thërrasin së Bekuarës:

Gëzohu, o nënë ylli të paperëndueshëm; gëzohu, o agim dite mistike.

Gëzohu, ti që shove furrën e gënjeshtres; gëzohu, ti që ndriçon ata që hyjnë në të fshहतat e Trinisë.

Gëzohu, ti që nxore nga fuqia tiranin çnjërrëzor; gëzohu, ti që tregove Krishtin, Zot njeridashës.

Gëzohu, ti që shpërblen nga feja barbarë; gëzohu, ti që shpëton nga balta e veprave.

Gëzohu, ti që pushove adhurimin e zjarrit; gëzohu, ti që çliron nga zjarri i pasioneve.

Gëzohu, o udhëheqëse e urtësisë së besimtarëve; gëzohu, o dëfrim i gjithë brezave.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**M**agët, duke u bërë predikues hyjprurës, u kthyen në Babiloni, duke kryer profecinë tënde e duke të predikuar ty, Krishtin, te të gjithë, duke lënë si të marrë Herodin<sup>17</sup> që s'dinte të këndonte:

Alilua.

**D**uke ndritur në Egjipt<sup>18</sup> ndriçim të vërtetë, dëbove errësirën e gënjeshtres, se idhujt e saj, o Shpëtimtar, ranë ngaqë nuk duruan fuqinë tënde; dhe ata që shpëtuan prej tyre, i thërritnin Hyjllindëses:

Gëzohu, o ringritje e njerëzve; gëzohu, o rënie e demonëve.

Gëzohu, ti që shkele mashtrimin e gënjeshtres; gëzohu, ti që demaskove dinakërinë e idhujve.

Gëzohu, o det, që përmbyste Faraonin<sup>19</sup> e përfytyruar; gëzohu, o shkëmb, që ujite të eturit<sup>20</sup> për jetë.

Gëzohu, o shtyllë e zjarrtë, që udhëheq<sup>21</sup> ata që ndodhen në errësi; gëzohu, o strehë e botës, më e gjerë se një re.

Gëzohu, o ushqim, pasardhës i manës;<sup>22</sup> gëzohu, o shërbyese dëfrimi të shenjtë.

Gëzohu, o toka e premtimit;<sup>23</sup> gëzohu, ti, prej së cilës rrjedh mjaltë dhe qumësht.<sup>24</sup>

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**K**ur Simeoni do të ikte nga jeta e tanishme mashtroese, iu dhe në duar si foshnjë, por u njohe prej tij<sup>25</sup> si Perëndi i përkryer; prandaj u çudit për urtësinë tënde të pashprehur, duke i thirrur:

Alilua.

*Përlufteshës nga të dyja koret në mënyrë të shpejtë. Psalmi 50 dhe Kanuni, dhe Tetraodet në vendin e tyre. Kanuni i Perëndilindëses (me Varg: E përmbishenjtë, Hyjllindëse, shpëtona), që ka Akrostihidhë pa Irmoset: "O ena e haresë, ty vetëm të përket të gëzo-*



hesh. Josif" (me Irmoset, në 6). Në fund të çdo Ode psalet Zbritësorja (ose Irmosi).

Ting. IV  
Ode I

Aniko to stoma mu

»Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej Shpirtit<sup>26</sup> Shenjt,\* dhe këngë do t'i këndoj,  
»Nënës së Madhe mbi fron,\*<sup>27</sup> dhe do ta  
»kremtoj\* me valle buzëqeshur,\* me zë  
»do t'i shpall kudo, gjithë çudit' e saj.\* (2x)

Si libër të Zotit Krisht, të hirësuar<sup>28</sup> prej Shpirtit Shenjt,\* të pa Kryeengjëlli, Mari Hyjlindëse,\* dhe të tha kështu:\* Lum ti që sjell gëzimin;\* mallkimin stërgjyshëror,<sup>3</sup> ti do ta zhdukësh krejt.\*

Adamin e ngrite lart, o Virgjëreshë Hyjlindëse,\* dhe Ferrin e shtrin përdhe, o Zonj' e Shenjtë Mari,\* lum ti, o pallat\* i Zotit edhe Mbretit,\* lum ti, o i zjarrti fron i perandorit<sup>29</sup> Krisht.\*

Gëzohu, o lindëse e të pafishkurit trëndafil;\* gëzohu, se ti po rrit mollën e erëshme,\* lule e qiellshme\* e Zotit edhe Mbretit,\*<sup>30</sup> lum ti, o Hyjlindëse, Zonjë shpëtonjëse.\*

Thesar i virtyteve, që na ke ngritur prej varreve,\*<sup>4</sup> edhe prej kufomave, Zonjë Hyjlindëse,\* lule dhe zambak, aromë për besnikët,\* temjan erëmirë, mir' e paçmueshme.\*

Zbritësore: Aniko to stoma mu

Ja gojën e çel tani

Ode III

Tus sus innologus

»O Zonjë dhe Nën' e Perëndisë, burim i pasosur jetësor,\* ti siguroji gjith' ata që «të këndojnë plot me zell,\* dhe lart në «q'ell ku mbretëron, kurorëzoi me çdo «lavdi.<sup>31\*</sup> (2x)

Kallin' qiellor ti na ke mbirë, si arë pa bujq dhe pa lërim,\* lum ti altar<sup>32</sup> i shpirtëshme, ku buk' e jetës<sup>33</sup> na u vu,\* lum ti burim i ujëve<sup>34</sup> që japin jetë, Hyjlindëse.\*

Mëshqerrë që demin na ke lindur, q'ellor për besnikët pa cenim,\* lum ti, o del' e hyjëshme, se qengjin Perëndi na dhe,\* mëkatin botëror që ngre,<sup>11</sup> gëzohu, Zonjë ndërmjetëse.\*

Gëzohu, mëngjes i ditës sonë, që Diellin solle Jisu Krisht,\* për botën dritë dhe për ne, dhe errësi s'le mbi dhé,\* dhe Ferrin e demonëve e shkatërrove përgjithënjë.\*

Gëzohu, o derë shpëtimtare, ku Fjala dhe Bir' i vetëm shkoi,\*<sup>35</sup> Ferrit ia theve dyertë,<sup>36</sup> me lindjen e çlironjësit,\* gëzohu port' e hyjëshme, dhe shpëtimtare e ndritëshme.\*

Zbritësore: Tus sus innologus

O Zonjë dhe nën'

Përlufteshës nga të dyja koret në mënyrë të shpejtë.

Dhe lexohet *Stanca e Tretë e Himnit*.\*

Krijesë të re na tregoi Krijuesi ne që u krijuam prej tij; duke lindur prej barku të pafarë dhe duke e ruajtur ashtu siç ishte të pacenuar; që, duke parë çudinë, ta himnojmë duke thirrur:

Gëzohu, o lule e paprishjes; gëzohu, o kurorë e vetëpërmbajtjes.

Gëzohu, ti që shkëlqen tipin e ngjalljes; gëzohu, ti që tregon jetën e Engjëjve.

Gëzohu, o pemë me fruta të shkëlqyera, prej së cilës ushqehen besimtarët; gëzohu, o dru me gjethe që bëjnë hije të mirë, nën të cilën shumë veta strehohen.

Gëzohu, ti që linde udhëheqës për të humburit; gëzohu, ti që linde shpërblyes për robërit.<sup>37</sup>

Gëzohu, o zbutja e gjykatësit të drejtë,<sup>38</sup>  
gëzohu, o falja e shumë fajtorëve.  
Gëzohu, o veshje nga guximi i të zhveshur-  
ve;<sup>14</sup> gëzohu, o dashuri që tejkalon çdo  
mall.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**D**uke parë lindje të çuditshme, le të bë-  
hemi të huaj për botën, duke transferuar  
mendjen në qiell; se prandaj Perëndia i  
Lartë u shfaq mbi tokë si njeri i përlurur,  
duke dashur të tërheqë te lartësia ata që  
i thërrasin:

Aliluia.

**I** tëri ishte në të poshtmet, dhe nga të  
sipërmet s'u largua fare Fjala e papër-  
shkrueshme; sepse u bë denjim hyjnor  
dhe jo lëvizje vendore; dhe lindje me  
Shpirt Perëndie prej Virgjëreshe, e cila  
dëgjon këto:

Gëzohu, o vend i Perëndisë së panxën-  
shëm; gëzohu, o derë misterit të nderuar.

Gëzohu, o dëgjim i dyshimtë për të pa-  
besët; gëzohu, o mburrje e padyshimtë  
për besimtarët.

Gëzohu, o qerre e tërëshenj të e atij që rri  
mbi Keruvimet;<sup>39</sup> gëzohu, o shtëpi e mirë  
shumë e atij që rri mbi Serafimët.

Gëzohu, ti që i bashkove në një të kund-  
dërtat; gëzohu, ti që lidhe virgjëri dhe le-  
honi.

Gëzohu, ti, me anën e së cilës u zgjidh  
shkelja;<sup>4</sup> gëzohu, ti, me anën e së cilës u  
hap Parajsa.<sup>13</sup>

Gëzohu, o çelës i mbretërisë së Krishtit;<sup>40</sup>  
gëzohu, o shpresë e të mirave të përjet-  
shme.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**T**ërë natyra e engjëjve u çudit për veprën  
e madhe të njerëzimit tënd, se shikonte  
të paafërshmin Perëndi si njeri të afër-

shëm për të gjithë, që rronte bashkë me  
ne<sup>41</sup> dhe që dëgjon prej të gjithëve kështu:  
Aliluia.

**O**ratorë shumëfolës i shohim si peshq të  
heshtur mbi ty, o Hyllindëse, se nuk dinë  
të thonë se si edhe Virgjëreshë mbete,  
edhe të lindësh munde; por ne, duke  
admiruar misterin, me besim thërrasim:  
Gëzohu, o enë e urtësisë së Perëndisë;<sup>42</sup>  
gëzohu, o arkë e providencës së tij.  
Gëzohu, ti që i tregon filozofët të paditur;  
gëzohu, ti që demaskon mjeshtërit e fja-  
lës të paarsyeshëm.

Gëzohu, se u marrosën biseduesit e fortë;  
gëzohu, se u fishkën autorët e miteve.

Gëzohu, ti që thyen thurjet e athinianëve;  
gëzohu, ti që mbush rrjetat e peshkata-  
rëve.

Gëzohu, ti që nxjerr nga thellësia e padi-  
jes; gëzohu, ti që ndriçon shumë veta në  
dije.

Gëzohu, o anije e atyre që duan të shpë-  
tojnë; gëzohu, o liman i atyre që lundrojnë  
në jetë.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**D**uke dashur të shpëtojë botën,<sup>43</sup> Bërësi  
i gjithçkaje erdhi tek ajo i vetëftuar; dhe,  
duke qenë bar<sup>9</sup> si Perëndia, për ne u  
shfaq njeri sipas nesh; se, duke ftuar i  
ngjashmi të ngjashmin, dëgjon si Perëndi:

Aliluia.

Përlufteshës nga të dyja koret në mënyrë  
të shpejtë. Përsëri dhe përsëri. Se ti je Pe-  
rëndia ynë.

*Ndenjësore*

*Ting. 1 Ton tafon su Sotir*

**A**rrin në Nazaret,\* në qytet gjenerali\*  
i madh i forcave të patrup,<sup>44</sup> të njofton  
pra,\* o Vajzë pa cenim, ty Mbretin e jetë-  
ve, Zotin<sup>45</sup> Krisht,\* thotë: Ki gëzim,\* Ma-



ri e tërëbëkuar,\* nuk kuptohet dot\* dhe nuk shpjegohet çudia;\* gjinin' e rithirre ti.

Lavdi dhe Tani

*E njëjta*

*Ode IV*

*O kathimenos en dhoksi.*

»Ti që rri midis lavdisë\* përmbi fronin<sup>46</sup> e »hyjëshëm,\* nga një re e lehtë\*<sup>47</sup> erdhe, »o Jisu i përjetëshëm,\* dhe na shpëtove »me dorën jetëdhënëse,\* të thërresim »pra: Nder dhe lavdi gjithënjë mbi ty.\*

Me këndime dhe me besë\* të thërresim Hyjlindëse,\* lum ti, mal i shenjtë,\* që u hijesove prej Shpirtit Shenjt;\*<sup>48</sup> lum ti, kandil<sup>49</sup> edhe shtambë manapurëse,\*<sup>50</sup> që i ëmbëlson<sup>22</sup> ndjenjat e gjithë besnikëve.\*

Mëshironjëse e botës,\* Virgjëreshë Hyjlindëse,\* lum ti, shkall' e shenjtë,\*<sup>5</sup> që nga dheu shpie në q'ell me hir,\* lum ti, o urë, që prier lavdëronjësit\* që prej varreve lart në<sup>51</sup> Parajsën e engjëjve.\*

Më e lartë prej çdo q'elli,\* Shpëtimtarin e njerëzve,\* ti në gjin' e shenjtë\* e ke mbajtur Zonjë Hyjlindëse,\* lum ti që ngjelve me gjakun rrobën ndritëse\* dhe shkëlqenjese të Komandantit të Forcave.<sup>52</sup>\*

Ligjvënësin ke lindur,\* Virgjëreshë Hyjlindëse,\* që paligjësitë\* ua fal të gjithëve darovisht,\* o lartësi pa kufi, o thellësi pa fund,\* ndërmjetonjëse, ti na ke ngritur në qiellin.\*

Ty që plekse për njerinë\* një kurorë të qiellshme,\* ty të përhimnojmë;\* lum ti, Virgjëreshë Hyjlindëse;\* lum ti, fortesë dhe mbrojtje e të gjithëve,\* o përkrahëse, streh' e përikj' e besnikëve.\*

*Zbritësore: O kathimenos en dhoksi.*

Ti që rri midis lavdisë

*Ode V*

*Eksesi ta simpanta*

»Të gjith' i habite ti, me një çudi dhe një »lavdi:\* Ti, o Virgjëresh' e pamartuar,\* »Zotin e botës<sup>53</sup> që mbretëron lart në q'ell, »si një bir e mbajte në pëqi,\* dhe shpëtim »që lartazi\* u dhurove besnikëve.\*

O Zonjë Hyjlindëse, që linde udhëheqësin,\*<sup>54</sup> ti na ke shpëtuar nga përmytja\*<sup>55</sup> ne mëkatarët dhe të pavyerit, Nus' e Perëndisë Shën Mari,\* lum ti, o Hyjpritëse,\* Nën' e Zotit të gjithave.<sup>56</sup>\*

Kështjellë e njerëzve, gëzohu, o Hyjlindëse,\* vend i shenjtërimit<sup>57</sup> dhe lavdisë,\* vdekje e Ferrit, o Nus' e ndritëshme,\* o gëzim i engjëjve në q'ell, lum ti, o përkrahëse\* e të gjithë besnikëve.\*

O fron që shkëlqen dhe ndrit me Fjalën<sup>29</sup> e përjetëshme,\* lum ti, o Parajsë shpirtërore,\* që ke në qendër<sup>58</sup> Zotin e jetëve, që i ëmbëlson edhe i ngjall\* gjithë të gëzuarit\* me kungatën e qiellshme.\*

Prej teje forcohemi, thërresim pra me zë të madh:\* Lum ti, o qytet i Mbretit<sup>59</sup> tonë,\* e lavdëruar prej gjithë brezave dhe prej<sup>60</sup> gjithë kishave kudo,\* mal<sup>61</sup> i lartë gjer në q'ell,\* det pa fund edhe pa kufi.\*

Pallat i diamanteve të çmuara, Hyjlindëse,\* ti që na dhuron margaritarin,\* Fjalën e Atit dhe Shpëtimtarit ton' Krisht, ti me Perëndinë i pajton\* gjithë lumuronjësit\* që të lusin besnikërisht.\*

*Zbritësore: Eksesi ta simpanta*

Të gjith' i habite ti

*Ode VI*

*Tin thian taftin*

»Këtë të kremte e lusim sot, për Zo-

»njën edhe Nënë Hyllindëse, gjithë hyj-  
»mendësit;\* eni trokitni pra duartë,\* dhe  
»lavdëroni Zotin që lindi prej asaj.\* (2x)

**B**anes' e Fjalës, e ndritëshme, gëzohu,  
shenjtërim i të gjithëve, Zonjë Hyllindëse,\*  
mburrur prej gjithë profetëve\* dhe prej të  
gjith' apostujve dhe shenjtoreve.\*

**N**a prure vesën e qiellshme që shoi tërë  
zjarrin pagan të keq: Ty të thërresim pra:\*  
Lum ti, shtëllunga e vesëve,\* që Gedeoni  
e pa,<sup>62</sup> Zonjë Hyllindëse.\*

**G**ëzohu, Zonjë Hyllindëse, lliman u bëj  
për ne lundëronjesit ku të përmbldhemi\*  
brenda në detin e helmeve\* dhe të përba-  
llim sulmet e të paudhëve.\*

**G**ëzona, Zonjë gëzonjëse, mendimet që të  
themí me zë të lartë: Lum ti, Hyllindëse,\*  
re<sup>63</sup> edhe ferrë<sup>64</sup> e ndritëshme,\* që ne be-  
snikët na mbron dhe na mbulon gjithnjë.\*

*Pastaj Tetraodi, poezi e të njëjtit Josif (në 4,  
me Varg: O shenjtore të Perëndisë, ndër-  
mjetoni për ne), që ka Akrostihidhë: "Kjo  
ode është e Josifit".*

*Ting. Tërth. II*

*Tu viu tin thálasan*

**M**artirët garonin fort\* dhe, si gur' të zgje-  
dhur mjaft\* që rrokulliseshin mbi dhé,\*<sup>65</sup>  
çdo ndërtim të armikut rrafshuan krejt,\*  
u bënë kështu komplet\* kisha, tempuj të  
Perëndisë<sup>66</sup> Shpëtimtar.

**J**u lypim martirë ju\* që të mirin rrugëtim\*  
mbaruat.<sup>67</sup> Na forconi ne\* që në rrugën  
e kreshmës të rendim mir',\* si dhe në  
përsosmërin'\* e virtyteve të shkëlqejmë  
tërësisht.

Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mira.

*Nekrosim*

**O** Zot përdëllyes krejt,\* shërbëtorët e tu

mbar'\* që u shpërngulën drejt teje,\* të  
mbimirit, nga dheu, në Mbretëri\* t'i bësh  
pjesëtarë ti,\* siç të luten martirët e tu fort  
të shenjt'.

*Hyllindësor*

**E** tërëhimnuar je\* vetëm ti, e Virgjër,  
nën';\* lyp të fortshenjtën Fjalë Zot,\* që  
t'u ndahen të hyjshmet karizma mjaft,\*  
t'u falen mëkatet krejt\* pra atyre që të  
himnojnë besërisht.

*Tetraodi tjetër (në 6, me Varg po ashtu: O  
shenjtore të Perëndisë, ndërmjetoni për  
ne), poezi e Theodor Studjtit*

*Ting. Tërth. I*

*Tu kitus ton profitin*

**D**uke kremtuar kujtimin e martirëve, le  
t'ia drejtojmë Zotit himnet sot, duke dë-  
fryer hyjnisht.

**D**uke pasur guxim në besim, o athloforë,  
dhe duke mos u frikësuar nga shpata dhe  
zjarri, i habitët kështu tiranët.

*Lavdi Triadik*

**T**ë përhimnoj ty, Trini në Persona, të fa-  
lem si Njësi në esencë, o Atë, Bir dhe  
Shpirt i Shenjtë.

*Tani Hyllindësor*

**J**e mburrje engjëjsh dhe njerëzish, o Vir-  
gjëreshë, sepse linde Krishtin, Shpëtim-  
tarin e shpirtave tanë.

I çuditshëm është Perëndia  
ndër shenjtoret e tij.

**M**eqenëse morët jetën në vend të vde-  
kjes, kërceni duke banuar në qiellore, o  
athloforë të lavdishëm të Krishtit Perëndi.

Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mira.

*Nekrosim*

**O** Krisht që sundon mbi vdekjen dhe je-  
tën,<sup>68</sup> të zhvendosurit besërisht nga jeta  
prehi së bashku me shenjtoret e tu.



*[Irmosi: Tu kitus ton profitin*

»Profetin e çlirove nga peshku i madh,<sup>69</sup>  
»dhe mua më nxirr lart nga fundi i më-  
»kateve, o Zot, dhe shpëtomë.]

*Zbritësore: Tin thian taftin*

**K**ëtë të kremte e lusim sot

Përlufteshës *nga të dyja koret në mënyrë të shpejtë*

*Dhe lexohet Stanca e Katërt e Himnit:\**

**K**ështjellë e virgjërshave je, o Hyjllindëse Virgjërshë, dhe e gjithë atyre që përikin te ti; se Ai që bëri qiellin dhe tokën,<sup>70</sup> të bëri, o e Kulluar, duke banuar në mitrën tënde dhe duke i mësuar të gjithë të të thërrasin:

Gëzohu, o shtyllë e virgjërisë; gëzohu, o portë e shpëtimit.

Gëzohu, o kryetare e rigatimit mendor; gëzohu, o dhënëse e mirësisë hyjnore.

Gëzohu, se ti rilinde ata që u ngjizën turpërisht; gëzohu, se ti urtësove të plaçkiturit në mendje.

Gëzohu, ti që shfuqizove prishësin e mendjeve; gëzohu, ti që linde mbjellësin e dëlirësisë.

Gëzohu, o thalam nusërimi të pafarshëm; gëzohu, ti që lidh besimtarët me Zotin.<sup>71</sup>

Gëzohu, o rritëse e mirë e virgjërshave; gëzohu, o nusestolisëse e shpirtrave të shenjtë.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**Ç**do himn mposhtet kur përpiqet të zgjerohet sipas shumicës së mëshirave të tua të shumta; se, edhe në të blatofshim këngë aq sa rërë, o Mbret i shenjtë,<sup>72</sup> nuk bëjmë asgjë të barazvlefshme për sa na ke dhënë neve që të thërrasim:

Alliua.

**L**lambadhe dritëpritëse, që u shfaq për ata që ndodhen në errësirë, e shohim

Virgjërshën e shenjtë; se, duke nderuar dritën e palëndshme, i udhëheq të gjithë në dijen hyjnore, duke ndriçuar mendjen me agim dhe duke u nderuar me thirrje si këto:

Gëzohu, o rreze e Diellit mendor; gëzohu, o shigjetë e dritës së paperëndueshme.

Gëzohu, o vetëtimë që shkëlqen shpirtrat; gëzohu, ti që çudit armiqtë si gjëmim.

Gëzohu, se lind ndriçimin e shumëditrëshëm; gëzohu, se buron lumin e shumëvalshëm.

Gëzohu, ti që pikturon tipin e kolimvithrës; gëzohu, ti që heq njollën e mëkatit.

Gëzohu, vaskë që shpëlan ndërgjegjen; gëzohu, o krater që qeras<sup>73</sup> ngazëllim.

Gëzohu, o aromë e erës së mirë të Krishtit;<sup>74</sup> gëzohu, o jetë dëfrimi mistik.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**D**etyrimet e vjetra<sup>4</sup> duke dashur të falë borxhshlyesi i gjithë njerëzve, erdhi me anën e vetes së tij tek ata që u larguan nga Hiri i tij; dhe, duke grisur dorëshkrimin,<sup>75</sup> dëgjon prej të gjithëve kështu:

Alliua.

**D**uke kënduar lindjen tënde, të përhimnojmë të gjithë si tempull i shpirtshëm,<sup>66</sup> o Hyjllindëse; se, duke banuar në barkun tënd Zoti që i mban të gjitha në dorë,<sup>76</sup> të shenjtëroi, të lavdëroi dhe i mësoi të gjithë të të thërrasin:

Gëzohu, o tendë e Perëndisë<sup>77</sup> Fjalë;<sup>78</sup> gëzohu, o e Shenjtë, më e madhe se shenjtëtorët.

Gëzohu, o arkë e larë me ar<sup>79</sup> prej Shpirtit; gëzohu, o thesar i pashpenzuar i jetës.

Gëzohu, o kurorë e çmueshme e mbretërve shpresëtarë; gëzohu, o mburrje e nderuar e priftërinjve të devotshëm.

Gëzohu, o fortesë e patundur e Kishës; gëzohu, o kështjellë e papushtueshme e

mbretërisë.

Gëzohu, ti, me anën e së cilës ngrihen trofe; gëzohu, ti, me anën e së cilës rrëzohen armiqtë.

Gëzohu, o shërim i lëkurës sime; gëzohu, o shpëtim i shpirtit tim.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

**O** Nënë e tërëhimnuar, që linde Fjalën, më të shenjtë se gjithë shenjtorët (3x); duke pritur blatën e tanishme, shpëtoji të gjithë nga çdo fatkeqësi dhe shpërbleji prej skëterrës së ardhshme ata që thërrasin bashkë:

Aliluia.

**E**ngjëlli kryetar u dërgua nga qielli t'i thotë Hyjlindëses: Gëzohu (3x); dhe, duke të parë të trupëzohesh, o Zot, bashkë me zërin engjëllor, çuditëj e qëndronte duke i thirrur asaj kështu:

Gëzohu, ti, me anën e së cilës do të shkëlqejë gazi; gëzohu, ti, me anën e së cilës do të humbasë mallkimi.<sup>3</sup>

Gëzohu, o rithirrje e Adamit të rënë;<sup>4</sup> gëzohu, o shpërblim i lotëve të Evës.

Gëzohu, o lartësi, ku mendjet njerëzore nuk arrijnë të ngjiten dot; gëzohu, o thellësi, ku dhe sytë engjëllorë e kanë të vështirë të shikojnë.

Gëzohu, se ti je froni i Mbretit; gëzohu, se ti mban atë që i mban të gjitha.

Gëzohu, o yll, që tregon diellin; gëzohu, o bark, që trupëzon Hyjninë.

Gëzohu, ti, me anën e së cilës përtërihet Krijesa; gëzohu, ti, me anën e së cilës foshnjëzohet Krijuesi.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Përlufteshës nga të dyja koret në mënyrë të shpejtë. Përsëri dhe përsëri. Se ti je mbreti i paqes.

*Kontaqi (hima)*

*Ting. Tërth. IV Ti ipermaho*

**P**ërlufteshës gjenerale këngët mundëse, si përhirim që e shpëtove prej tmerreve, qyteti yt po të përshkruan, o Virgjëreshë. Po sikurse ke fuqi të paluftueshme, prej çfarëdo rreziku, shpëtomë, se po të thërrës: Gëzohu, o Nuse e panusëruar.\*

*Dhe Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:*

Në të njëjtën ditë, të Shtonën e Javës së Pestë të Kreshmëve, kremtojmë Himnin Akathist të Zonjës sonë të përmbishenjtë, Perëndilindëses dhe gjithmonëvirgjëreshës Mari.

*Vargje:* Me himne të pafjetura Qyteti e himnon me kënaqësi/ mbrojtësen vigjilente në luftëra.

Me ndërmjetimet e Nënës sate mbrojtëse dhe të pamposhtur, o Krisht Perëndi, na çliro dhe ne nga fatkeqësitë që na rrethojnë, dhe na mëshiro, si i vetmi njeri-dashës.

*Ode VII*

*Irmosi: Uk elatrefsan*

»Nuk u faleshin krijesave hyjmendësit, »por Kryetarit<sup>80</sup> Iart,\* dhe kërcënimin me »zjar,\* e shkëlën me trimëri, psalnin me brohori:\* Zot, lavdi më ty,\* o Perëndi i »Etërve,\* ti je vetëm i bekuar.<sup>81\*</sup>

**O** Hyjlindëse, gëzohu fron i shpirtëshëm, o vreshtë me plot hardhi,\* ngarkuar me rrush të kuq,\* zambak i pafishkur krejt që lulëzon, o Zonj,\* pra gëzohu, ti\* që shpirtrat e besnikëve\* i gëzon me gjak të Krishtit.\*

**Ti** që linde mjek, shërues të besnikëve, Mari Hyjlindëse,\* o shkop i shenjtë mistik,\* që lulen e qiellshme ti lulëzon<sup>82</sup> tani,\* Zonj' e ndritëshme,\* me gaz prej teje mbushemi\* edhe jetë trashëgojmë.<sup>83\*</sup>

**A**snjë gjuhë s'mund të të lëvdojë vlerë-



sisht ty, o Hyjlindëse;\* nga Serafimet më lart\* u ngrite kur linde ti Mbretin Jisu Shpëtimtar;\* pra atij iu lut\* të na shpëtojë gjithënjë,\* sa të lusim plot me besë.\*

Prej gjith' anëve të lumërojm' Hyjlindëse, me thirrje gjithënjë.\* Gëzohu, o Shën Mari,\* që mban në pëqirin tënd Fjalën dhe<sup>84</sup> Zotin Krisht;\* pra<sup>85</sup> atij iu lut,\* në librin e të gjallëve të na shkruajë,<sup>86</sup> o Zonjë.\*

Ty të lutemi të gjithë dhe përgjunjemi, me gjithë zemër e shpirt;\* dëgjona pra,<sup>87</sup> Shën Mari,\* shpëtona prej helmeve se po përmbysimi,\* edhe ruaje\* qytetin tënd Hyjlindëse\* prej armiqve të pabesë.\*

#### *Tetraodi: Dhrosovolon men tin káminon*

O i shumëmëshirshmi Krisht, bashkësia e përbindritshme e martirëve të tu të hyjnueshëm tani lëviz në dritën tënde që s'perëndon; me përgjërimet e tyre na jep të gjithëve ndriçim dhe falje mëkatesh.

O Zot, sa e bukur është periudha e vetëpërbajtjes që na dhe! Në të dhembshuroji shpirtrat tanë si i mirë, përmes lutjeve të atletëve të shenjtë që duruan pësimet e tua të bukura dhe të nderuara.

Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mira.

#### *Nekrosim*

Përderisa shërbyesit e tu tejkaluan shtrengatën e shumëvuajtur të jetës, bëji të ankorohen në liman jete, o Zot, që të thërrasin bashkë me tërë të zgjedhurit: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.<sup>81</sup>

#### *Hyjlindësor*

O gjithmonëvirgjëreshë, që kisha në mitër dhënësin e ligjit, përgjërohu që, në kohën e tanishme, të hiqen gjithë paudhësitë nga ata që duan ta praktikojnë mirë dhe me gatishmëri kreshmën e hyjshme.

*Tjetri: Evlojitës i o Theòs*

I bekuar je, o Perëndi i përmbihimnuar dhe i përmbilavdëruar,<sup>81</sup> që i tregove trima martirët që garonin për ty.

I bekuar je, o Perëndi i përmbihimnuar dhe i përmbilavdëruar,<sup>81</sup> që i bëre athloforët ndërmjetues për ne pranë teje.

#### *Lavdi Triadik*

I bekuar je, o Perëndi i përmbihimnuar dhe i përmbilavdëruar,<sup>81</sup> që je një në natyrë dhe njëhesh në tre Persona.

#### *Tani Hyjlindësor*

I bekuar je, o Perëndi i përmbihimnuar dhe i përmbilavdëruar,<sup>81</sup> që je një në natyrë dhe që e tregove të dëlirë lindësen.

I çuditshëm është Perëndia

ndër shenjtoret e tij.

I bekuar je, o Perëndi i përmbihimnuar dhe i përmbilavdëruar,<sup>81</sup> që mbylle gojë bishash dhe shove zjarr<sup>88</sup> për lavdinë e shenjtoreve të tu.

Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

I bekuar je, o Perëndi, që i zhvendose nga vdekja në jetën e pafund ata që në jetë të adhuruan besërisht.

#### *[Irmosi: Evlojitës i o Theos*

»I bekuar je, o Perëndi i përmbihimnuar »dhe i përmbilavdëruar,<sup>81</sup> që i sheh avu- »shat, i ulur mbi Keruvime.<sup>89</sup>]

#### *Zbritësore: Uk elátrefsan*

Nuk u faleshin

#### *Ode VIII*

#### *Irmosi: Pédhas evajis en ti kamino*

»Djemtë\* e dënuar për t'u djegur, prej »zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit Krisht,<sup>88</sup> »si simbol në vjetëri\* dhe si një veprim »tani,\* dhe tërë botën po e mbledh për »këng' e lavdërim:\* Himnojeni, ju veprat »e Zotit,\* dhe e lartësoni përmbi të gjitha

jetët.<sup>90\*</sup>

**F**jalën\* Jisu Krisht në krah' e prite, atë që mban gjithësinë ti e mban në gji, ti me qumësht e ushqen\* Zotin dhe ushqenjësini\* e dheut dhe të qiellit, dhe të këndonjësve:\* Himnojeni, ju veprat e Zotit,\* dhe e lartësoni përmbi të gjitha jetët.<sup>90\*</sup>

**F**errën\* e kuptoi Moisiu<sup>64</sup> dhe lindjen e Virgjërëshës na e mori vesh. Shembëlla e djemave\* na e shfaqti qartazi:\* Në mes të zjarrit hidheshin edhe nuk digjeshin,\*<sup>88</sup> Hyllindëse, Mari Virgjërëshë;\* ty pra të himnojme përherë dhe përjetë.\*

**G**rackat\* e demonëve na zhveshën,<sup>14</sup> po ti përsëri stolin' e re na veshe ne<sup>91</sup> kur na linde Zotin Krisht,\* edhe të verbuarit,\* nga hija e mëkateve e panë Diellin,\*<sup>92</sup> Hyllindëse, banesa e dritës,\*<sup>6</sup> ty pra të himnojme përherë dhe përjetë.\*

**N**gjallen\* dhe të vdekurit prej teje, se jetën dhe jetëdhënësin e linde ti, flasin gjuhëlidhurit,\* shohin të verbuarit,\* shërohen të lebrosurit dhe të lënguarit,\*<sup>93</sup> dhe zhduken krejt nga drita demonët,\*<sup>94</sup> Zonjë Virgjërëshë, shpëtim i njerëzisë.\*

**T**i që\* na dhurove Shpëtimtarin,<sup>95</sup> dhe ti që na lartësove gjer në qiellin, lum ti, o Hyllindëse,\* rojtëse shpëtonjëse,\* se ti i mbron dhe i bekon gjithë këndonjësit:\* Himnojeni, ju veprat e Zotit,\* dhe e lartësoni përherë dhe përjetë.<sup>90\*</sup>

*Tetraodi: Ek flogōs tis osiis*

**A**rritjet e martirëve të shenjtë i habitën shumë Mendjet përmbiqiellore; me lutjet e tyre, o Zot i dhembshur, bëji të çuditshme pasurisht mëshirat e tua<sup>95a</sup> te ne.

**O** atletë të admirueshëm të Krishtit, që shkelët zjarrin nëpërmjet vesës hyjnore,<sup>88</sup> me ndërmjetimet tuaja të nxehta pranë

Zotit na çlironi nga zjarri i ndëshkimit.

Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

*Nekrosim*

**O** Fjalë e përmbimirë, orthodhoksët që u larguan prej nesh, denjësoji për jetën në qiell dhe për shkëlqimin e shenjtë me përgjërimit e martirëve bukurmundës.

*Hyllindësor*

**O** i Dhembshur, me përgjërimit e asaj që të kishte në mitër, të martirëve të shenjtë dhe të apostujve, ndriçoji shpirtat tanë që të të lavdërojmë me ngazëllim shpirti në jetë.

*Tjetri: Ton piitn tis ktiseos*

**O** kore të shenja martirësh, kujtojini ata që ju përhimnojnë me mallëngjim dhe e përmbilartësojnë Krishtin në jetë.

**M**artirët, kur po torturoheshin me shpatë, ngazëlloheshin duke e himnuar dhe e përmbilavdëruar Krishtin në gjithë jetët.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin (*Triadik*).

**N**ë mënyrë paradoksale, Trinia ndahet dhe mbetet e pandarë si Perëndi; atë e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Tani *Hyllindësor*

**N**jë Virgjërëshë lindi një foshnjë, sepse Perëndia u bë njeri prej saj. Çdo njeri le ta himnojë këtë Zot në jetë.

I çuditshëm është Perëndia ndër shenjtoret e tij.

**M**artirët që e himnonin Krishtin në jetë, u shfaqën si përmendore burrërie që shpallnin me triumf rënien e djallit.

Shpirtat e tyre do të rrinë në të mira.

**S**hërbëtorët e tu, o Zot, që u zhvendosën drejt teje me besim dhe shpresë, denjësoji



t'i marrë Abrahami në gji.<sup>96</sup>

*[Irmosi: Ton piitn tis ktiseos*

» Bërësin e Krijesës,<sup>70</sup> që e kanë frikë en-  
» gjëjt, përhimojeni, o popuj, dhe përmbi-  
» lartësojeni në gjithë jetët.]

*Zbritësore: Pédhas evajis en ti kamino*

Djemtë e dënuar për t'u djegur

*Psalet dhe Më të nderuarën*

*Ode IX*

*Irmosi: Apas jijenís*

» Gjithë njerëzit, kërceni me ngazëllim te  
» drit' e Shpirtit Shenjt, \* eni lavdërojeni, \*  
» engjëjt e q'ellit, eni kremtojeni \* këtë të  
» shenjtë panair të Kryezonjës Mari \* dhe  
» thërrisni: Ti je më e lumura, \* Virgjëresh' \*  
» e kulluar Hyjllindëse. \*

Çdo besnik thërret: Gëzohu, Hyjllindë-  
se, se gjithënjë na jep, \* gaz që fare nuk  
mbaron, \* ti pra shpëtona prej gjithë nga-  
sjeve, \* nga sulmet e barbarëve dhe gjithë  
plagëve \* që na vijnë, nga shumic' e faje-  
ve \* dhe mëkateve tona të tmerrëshme. \*

Edhe për ndriçim, për mbrojtje dhe për  
shpëtim, pra të thërresim sot: \* Lum, o  
yll pa perëndim, \* që sjell në botë Jisunë,  
diellin; \* lum, o hapës' e<sup>13</sup> mbretëris', ko-  
lon' e zjarrt' shum' e fort' \* që u shpie<sup>21</sup>  
njerëzve një jet' të re \* qiellore që kurrë  
nuk ka mbarim. \*

Ejani me bes' në kishën e Zotit Krisht  
dhe përhëndosheni! Nënë dhe Hyjllin-  
dësen: \* O Virgjëreshë, Zonj' e të gjithë-  
ve, \* lum ti më e bekuara në mes të gra-  
ve<sup>97</sup> mbi dhé, \* lum ti lule, \* miron<sup>98</sup> e  
përbotëshme \* ti e prite në gjirin dhe na  
e dhe. \*

Lum ti, o pëllumb, se ti mëshironjësini na  
prure përmbi dhé, \* mburrj' e oshënarëve, \*

edhe kurora e athloforëve, \* dhe e dësh-  
morëve, si dhe e gjith' shenjtoreëve, \* zbu-  
kurimi \* i gjith' të krishterëve \* dhe shpë-  
timi i gjithë besnikëve. \*

Zot dhe Perëndi, kurse trashëgimin tënd,  
falu besnikëve \* ndjesën e mëkateve, \*  
dëgjoja lutjet Nënë Hyjllindëse \* dhe ndër-  
mjetimet pa pushim për gjithë njerëzit, \*  
dhe shpëtoji \* sipas përdëllimit<sup>99</sup> tënd, \*  
edhe<sup>2</sup> falna Parajsën e qiellit. \*

*Tetraodi: Theón anthropis*

Si drit', si diell, martirët lindën plot, \*  
mbar' sferën e ndriçuan me shkëlqim  
nga çuditë nur, \* ndaj kështu edhe me  
rezatim shpresëtar \* zhdukën çdo terr  
politeizmi; o Perëndi, \* mëshirona ne me  
ndërmjetimet, lutjet që bëjnë.

Ushtri martirësh që s' mposhtesh dot as-  
pak, \* na përforco krejt ne, që stadiumin  
e kreshmëve \* ta mbarojmë, si pra të ga-  
rojmë mir', drejt, \* vepra të hyjshme mjaft  
të bëjmë në jetën ton' \* dhe kështu të je-  
mi pjesëtarë jete me hare.

Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

*Nekrosim*

Zot, mirësia që ke, le t'i arrij' \* sa përmes  
urdhrit tënd të frikshëm ikën nga ne te ti; \*  
përdëllimi yt le t'i rrethojë ata, \*<sup>100</sup>  
t'i udhëheq për në tentat që shndrijnë  
fort \* me shkëlqimin prej fytyrës sate në  
amshim gjithnjë.

*Hyjllindësor*

Krejt parrëfyeshëm me zë engjëlli, \* në  
bark e kishe engjëllin pas mendjes<sup>101</sup> së  
Atit Zot; \* zërat e shërbyesve të tu, Zonj',  
prano, \* te ti i sjellim gjatë kohës së kre-  
shmëve \* edhe si temjan drejt Perëndisë  
t'i blatosh ata.

*Tjetri: Isaia hóreve*

Duke bërë panair \* për martirët, \* të kër-

cejmë sot\* me ode duke psalur, o popuj ne,\* drejt Krishtit që shpalli ndeshje dhe ju dha çdo fitore, lavd\* kundër armiqve mbar\*;\* le ta madhërojmë me himnim.

Thonj pra ju gërvishtën keq\* dhe ju prenë\* shpata copë-cop\*;\* me Zotin Krisht u lidhët me dashuri,\* martirë të tërëfamshëm, plot lavd, ndaj lutuni tani\* me ngazëllim të madh\* lart në qiej për të gjithë ne.

Lavdi *Triadik*

Si të bashkëqenshme ty\* të lëvdoj fort,\* o e pafillim\* Trini, epore jete, me plot respekt,\* Njësi e pandarë, Atë i palindur me Fjalën Bir\* që linde dhe Shën Shpirt\*;\* ne që të himnojmë, na shpëto.

Tani *Hyjlindësor*

O Hyjnënë, linde Bir\* përmbi mendje,\* ishe ti me barr\* pa burr', se Perëndi ish i linduri,\* prandaj edhe shtazënia jote ish virgjërore nur\*;\* të lumërojmë ty\* dhe e madhërojmë Zotin Krisht.

Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

Ti kurorëzojmë ne\* me himn, ode,\* trimat, krejt ushtrin\* e mbretit të të gjithave, Perëndis',\*<sup>102</sup> sepe mbi kolona demoniake qartë fituan fort;\* duke u psalur njësh,\* madhërojmë Zotin, o popuj.

Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot. Krisht, kur gjith' krijimin tënd\* do ta ngjallësh\* për gjykimin tënd,\* shërbyesve të tu besimtarë tash\* që more, u fal krejt fajet gjatë jetës; ndaj ndjeji, Zot,\* prehi ata gjithnjë\* bashkë me shenjtoret e tu lart.

[*Irmosi: Isaia hóreve*

» Isaia vallëzo,\* Virgjëresha,\* Zonja Shën «Mari,\* na lindi Jisu Krishtin Emanuel,\*<sup>103</sup> »njeri edhe Perëndi; dhe emër ka Lindjen<sup>104</sup> »që na ndrit.\* Pra, madhështojm' atë,\*

»lumërojmë dhe Hyjlindësen.\* ]

*Zbritësore: Apas jjenis*  
Gjithë njerëzit

*Dërgimësore*  
*Jinekës akutishite*

Misteri shekullor krejt sot\* na njihet,<sup>105</sup> Biri i Maris',\* Zonjës së virgjër, po bëhet\* nga dhembshuria vet' Fjala\* e Perëndisë, Perëndi.\*<sup>78</sup> Thotë shën Gabrieli\* një lajm hareje. Tok me të,\* të gjithë ne të thërrasim:\* Gëzohu, nëna e Krishtit. (2x)

*Lavdërime*

*Ting. IV Os jeneon en mártisin*

Një mister që ish fshehur krejt,\*<sup>105</sup> i pa-njohur prej engjëjve,\*<sup>106</sup> i besohet shën Gabrielit që po vjen\* te ti, e vetme pa cen dhe pëllumbeshë plot bukuri,\*<sup>107</sup> dhe rithirrje e gjinis',\* të thërret kryeengjëlli, o e Tërëshenjt'.\* Gaz ki dhe përgatitu ta pranosh në mitrën tënde, përmes fjale<sup>108</sup> ti, Fjalën Zot, Perëndinë Krisht. (2x)

U bë gati për ty, o Zot,\* një pallat dritë-prurës nur,\* mitra e paprishur krejt e hybijës Vajz',\* eja në të, zbrit, si të të vijë keq për krijimin tënd,\* të luftuar prej zilis',\* që i papastri rob e mban,\*<sup>109</sup> dhe e zhduku pra\* bukurin' e mëparshme edhe po pret zbritjen tënde shpëtimtare me ngazëllim dhe me padurim.

Zonjë e paqortueshme,\* kryeengjëlli Gabriel\* haptas do të vijë të të thërrasë ty:\* Zgjidhja e nëmës,<sup>3</sup> gëzohu, rimëkëmbje të rënësh je;\*<sup>110</sup> gaz ki, se prej Perëndis'\* vetëm ti u përzgjedhe pra;\* ki gaz, re e gjall' \* dhe e shenjtë e Diellit;<sup>47</sup> mikprit atë që nuk ka mish, që do që të rrijë brenda në barkun tënd.

Lavdi dhe Tani

*Ting. IV*



Një gjuhë që nuk e njohu, dëgjo Perëndilindësja, sepse i fliste kryeengjëlli fjalët e unguillëzimit; prandaj, meqë pranoi besërisht përshëndetjen, të zuri ty, Perëndinë para jetëve; ndaj edhe ne, duke u ngazëlluar, të thërrasim: O Perëndi, që u mishërove pa ndryshim prej saj, fali botës paqe<sup>11</sup> dhe shpirttrave tanë përdëllimin e madh.<sup>99</sup>

*Dhoksologjia e Madhe dhe në fund, Tropari*

**Si** mori vesh mistikisht krejt porosinë,\* po vjen në tendën\* e Josifit me nxitim mjaft\* kryeengjëlli, thotë\* tek ajo që s'kish burr':\* Ai që i uli qiejt kur zbriti<sup>1</sup> posht',\* i tëri pa u ndryshuar\* mbahet nga ti;\* kur e shoh tashmë që ka marrë formë robi<sup>2</sup> në mitrën tënde, shtangem dhe thërras:\* G'zohu, Nuse e panusëruar.

*Në Liturgji, [Tipiket dhe nga Kanuni i Perëndilindësës Ode III dhe VI, ose] dy të parat nga Antifonet e së dieles, dhe Antifoni i tretë si më poshtë:*

*Varg a):* Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ulë veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do ta dëshirojë mbretit bukurinë tënde.

Si mori vesh.

*Varg b):* Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

Si mori vesh.

*Varg c):* Do ta kujtoj emrin tënd në gjithë brezat e brezave.

Si mori vesh.

*Pas Hyrjes, Si mori vesh dhe Kontaqi Përlufteshës. Të meriton. Kungatore Kupë shpëtimi. Pamë dritën.*

### CITIME

Ungjillëzimi: shih Lluk.1.26-38

1. Ps. 17(18).10  
2. Fil. 2.7

3. Gjen. 3.16-19
4. Gjen. 3.1-6
5. Gjen. 28.12-17
6. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
7. Lluk.1.39-44
8. Matth. 1.18-24
9. Joan 10.11,14
10. Lluk. 2.8-17
11. Is. 53.7; Joan 1.29,36; I Petr. 1.19
12. Joan 10.1
13. Gjen. 3.24
14. Gjen. 3.7
15. Matth. 2.1-11
16. Ps. 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9
17. Matth.2.12
18. Matth. 2.14-15
19. Eks. 14.27-28 etj.
20. Eks. 17.6 etj.
21. Eks. 13.21-22; Num. 14.14; Neh. 9.12
22. Eks. 16.14-32
23. Eks. 13.5 etj.
24. Eks. 3.8 etj.
25. Lluk. 2.25-32
26. Ps. 118(119).131
27. Ps. 44(45).2,10
28. Is. 29.11
29. Jez. 1.13-28
30. II Makk. 1.24
31. I Petr. 5.4
32. Eks. 25.22-29; 39.18; Lev. 24.6; Hebr. 9.2
33. Joan 6.35,48,51
34. Joan 4.10
35. Jez. 44.1-4
36. Ps. 106(107).16
37. Is. 61.1
38. Ps. 7.12; II Tim. 4.8
39. Jez. 10.1,18
40. Matth. 16.19
41. Baruh 3.38
42. I Kor. 1.24
43. Joan 12.47
44. Jis. N. 5.14-15
45. Ps. 144(145).13; I Tim. 1.17
46. II. Kron. 18.18; Is. 6.1; Dan. 7.10
47. Is. 19.1
48. Ps. 67(68).16
49. Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
50. Eks. 26.33; Hebr. 9.4
51. Joan 5.24; I Joan 3.14
52. Ps. 67(68).13
53. Rom. 9.5
54. Ps. 15(16).11; Fja. Urt. 6.23; 10.17; 15.24
55. Gjen. 7.6; Sirak 40.10; 44.17; Matth. 24.38-39; Lluk. 17.27-28; II Petr. 2.5
56. III Makk. 2.2
57. I Esd. 8.75; II Esd. 9.8
58. Gjen. 2.9; Apok. 2.7
59. Ps. 47(48).3
60. Ps. 86(87).3
61. Dan. 2.34-35

62. Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6  
 63. Num. 9.18,22; 10.36; Urt. Sol. 19.7  
 64. Eks. 3.2-5 etj.  
 65. Zah. 9.16  
 66. I Kor. 3.16; II Kor. 6.16  
 67. II Tim. 4.7  
 68. Rom. 14.9  
 69. Jona 2.11  
 70. Kol. 1.16  
 71. II Kor. 11.2  
 72. III Makk. 2.13  
 73. Fja. Urt. 9.2  
 74. II Kor. 2.14-15  
 75. Kol. 2.14  
 76. Ps. 94(95).4  
 77. Eks. 25.8 etj.  
 78. Joan 1.1  
 79. Eks. 25.9-10; 38.1-2; Hebr. 9.4  
 80. Rom. 1.25  
 81. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28  
 82. Num. 17.23; Hebr. 9.4  
 83. Matth. 19.29; Mark 10.17; Lluk. 10.25; 18.18  
 84. Is. 8.1  
 85. Eks. 31.18; 34.1-4,28; Ligji i Dytë 4.13; 5.22(19); 9.9-11; 10.1-4  
 86. Dan. 12.1; Apok. 17.8; 21.27  
 87. IV [III] Mbret. 19.16 etj.  
 88. III Makk. 6.6; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26  
 89. Dan. kap.3 Lutja e Azurias 31  
 90. Dan. kap.3 Lutja e Azurias 34  
 91. I Kor. 15.53  
 92. Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79  
 93. Matth. 11.5; Lluk. 7.22  
 94. Ef. 2.2  
 95. Vep. 4.12; Hebr. 2.10; 5.9  
 95a. Ps. 16(17).7; 30(31).22  
 96. Luk.16.22  
 97. Kënga 1.8; 5.9; 6.1  
 98. Kënga 1.3  
 99. Num. 14.19 etj.  
 100. Ps. 31(32).10  
 101. Is. 9.6  
 102. Sirak 36(33).1  
 103. Is. 7.14  
 104. Zah. 3.8; 6.12  
 105. Rom. (14.24) 16.25; Ef. 3.3; Kol. 1.26  
 106. I Petr. 1.12;  
 107. Kënga 2.10,13  
 108. Lluk. 1.28-35  
 109. Ef. 6.12  
 110. Lluk. 2.34.  
 111. Joan 14.27

## E DIELA E PESTË E NËNËS SONË OSHËNARE MARIA EGJIPTIANE NË MBRËMËSORE

*Thirrto*

*6 ngjallësore dhe 4 të oshënare:*

*Ting. Tërth. II Olin apothëmene*

**N**dotja që të vinte pas\* nga e mëparshmeja njollosje,\* ish pengesë, s'shihje dot\* te shenjtorët, veçse ndërgjegjësimi yt,\* njohja, ndijimi yt\* për sa kishe bërë,\* kryen kthesën tënde te të mirat më të larta pra,\* se, kur pe ikonën e Zonjës son, '\* hybjijës, së bekuarës,\* i qortove gjithë mëkatet fort\* që më parë bëre, e tërëfamshme, ndaj dhe me guxim\* iu fale drurit të çmuar krejt,\* oshënare shën Mari. (2x)

**S**i iu fale vendeve\* të shenjta plot gaz, u bërë\* shembull në virtyt, shpëtim\* dhe pajim; në udhën e mirë rende shpejt,\* dhe në vendin që ish\* Pagëzori,<sup>1</sup> shkove\* si kalove rrjedhën e Jordanit, ndenje ti atje\* edhe egërsimin e veseve\* e zhduke me jetesën drejt\* kur hollove ënjtjen e mishit tënd,\* dhe kështu fitove guxim, Mari e famshme me lavdi,\* e paharruar; ndaj ndërmjeto\* pranë Zotit Krisht për ne.

**S**i banove në shkreti,\* prej shpirtit hoqe ikona\* vesesh, dhe kështu atje\* shkrove saktë skicën e hyjshme<sup>2</sup> me ide\* dhe mendim plot virtyt,\* dhe shkëlqeve aq shumë,\* sa kalove lehtë ujin dhe nga toka ngriheshe\* kur te Perëndia ti luteshe;\* tani që me guxim qëndron,\* o e tërëfamshme, e lum gjithnjë,\* pranë Zotit Krisht, përgjërohu, lyp për shpirtat tanë mjaft,\* ne me respekt të nderojmë ty,\* shembull për pendim na je.

Lavdi *Ting. IV*

**O** Krisht, fuqia e Kryqit tënd bëri çudi, se pse dhe ish-prostituta garoi në ndeshjen





asketike; prandaj, pasi hodhi poshtë dobësinë, rezistoi me trimëri kundër djallit;<sup>3</sup> kështu që, pasi fitoi çmimin e fitores, ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjllindësore*  
*Dogmatike e Tingullit të javës*

*Pasvargje ngjallësore*

Lavdi *Ting. II*

**S**klavëritë e shpirtit dhe pasionet e mishit i preve me shpatën e vetëpërbajtjes; krimet e mendjes i mbyte me heshtjen e asketizmit; me rrjedhjet e lotëve të tu e vadite tërë shkretëtirën dhe na nxore frytet e pendimit; prandaj kremtojmë kujtimin tënd, o oshënare.

Tani *Hyjllindësor*

**O** çudi e re mbi gjithë çuditë qëmoti, se cili njohu nënë të ketë lindur pa burrë dhe të mbajë në pëqi atë që përmban tërë krijesën.<sup>4</sup> Është vullnet Perëndie ai që lindi, të cilin, o e gjithëpastër, meqë e mbajte në krahët e tu si foshnjë dhe meqë ke guxim përpara tij si nënë, mos pusho së luturi për ata që të nderojnë, që të na mëshirojë dhe të shpëtojë shpirtrat tanë.\*

*Përlëshore ngjallësore*

Lavdi *I oshënares:*

*Ting. Tërth. IV*

**N**ë ty, o nënë, mbijetoi pikërisht ajo «sipas ikonës»,<sup>2</sup> sepse, kur e more kryqin, ndoqe Krishtin<sup>5</sup> dhe me vepra na mësoje ta shpërfillim mishin, se kalon, por të kujdesemi për shpirtin, gjënë e pavdekshme; prandaj dhe ngazëllohet bashkë me engjëjt shpirti yt, o Mari oshënare.

Tani *Hyjllindësore*

**T**i që linde për ne prej Virgjëreshës dhe durove kryqëzim, o i mirë, që plaçkove

vdekjen me vdekje dhe rrefeve ngjalljen si Perëndi, mos i zhvështro ata që gatove me dorën tënde;<sup>6</sup> trego njeridashjen tënde, o mëshir'plot, prit Hyjllindësen që të lindi, të ndërmjetojë për ne dhe shpëto, o Shpëtimtari ynë, një popull të dëshpëruar.\*



## NË MËNGJESORE

*Shërbesa e zakonshme. Kanunet: Ngjallësori në 4, i Hyjllindëses në 2, i Triodit në 4 dhe i oshënares në 4.*

*Ode I*

*Kanuni i Triodit: i të Pasurit dhe i Llazarit të varfër*

*Ting. Tërth IV*

*Igrân dhiodhefsas*

**P**ër shkak pasurie kënaqësish,\* më ke krahasuar me të pasurin që përdit\* me shijim dëfrente, Shpëtimtar Zot;\* lyp, si Llazarin nga zjarri çliromë pra.

**I** veshur me epshe jam, Shpëtimtar,\* si ai që vishej me të artën rrobë, me li\* fort të çmuar, por porsi atë, Krisht,\* mos më hidh mua në zjarr, njeridashës Zot.

**D**ëfrente qëmoti me pasuri\* dhe shijim i pasuri në jetën që ka dëmtim;\* ndaj dhe për tortura u dënua,\* tekta i varfri, Llazari, freskohej mjaft.

*Hyjllindësor*

**R**reshtim engjëllor si dhe njerëzor,\* nënë e panusëruar, pa pushim të lëvdojn\*, se Ndërtuesin e tyre kishe\* në prehrin tënd, si një foshnjë e mbajte ti.

*Kanuni i oshënares*

*Ting. Tërth II*

*Kímati thalasis*

Më dërgo shkëlqim ti,\* se bëj panair për kujtimin tënd me mall;\* dritëprurës ky është,\* i hyjshëm, o oshënare,\* që rri pranë Krishtit, dritës Zot\* që s'afrohet;<sup>7</sup> më shpëton nga lloj-lloj ngasjesh të jetës.

Zoti që di çdo gjë,<sup>8</sup> madje para bërjes së tyre,<sup>9</sup> ky me trup\* u zhvendos në Egjipt\* përpara;<sup>10</sup> dhe të tregon ty\* yll plot dritë prej Egjiptit pra;\* është i papërshkrueshmi, i parajetshmi Perëndi.

S'njihje, oshënare,\* e thjeshtë, ti urdhra të hyjshëm, ndote keq\* ti ikonën e shenjt'\* të Perëndisë,<sup>2</sup> e famshme,\* por me providenc' hyjnore prap'\* e pastrove dhe u hyjnzove me virtyt hyjnisht.

#### *Hyjlindësor*

Oh, sa dhembshuri ke! Oh, sa bashkëzbritje të madhe, s'shprehet dot,\* Perëndia im Zot!\* Se të mëparshmen e shturur,\* si të pastër që s'kish hiç qortim,\* me kërkes' nënore, e ke bër' të ngjashme me engjëjt.

*Zbritësore: Anikso to stoma mu*

Ja gojën e çel tani (fq. 114)

#### *Ode III*

#### *Si i to steréoma*

Nga zjarri, Gjhena<sup>11</sup> tmerr,\* Krisht, shërbëtorin tënd të padenj',\* pra mua, ti\* më shpëto sikundër\* dhe Llazarin prej flakëve.

O Zot, në kënaqësi\* si dhe në epshe i pasur jam,\* por i vobekt'\* si Llazari un' jam\* në virtyte, por më shpëto.

Dhe vishte të purpurta\* dhe li të çmuar i pasuri,\* dhe epshe tok\* me kënaqësi boll,\* dhe prandaj flakërohet zjarr.

#### *Hyjlindësor*

E Tërëdëlirë, jep\* me ndërmjetimet e

tua ndihm',\* dhe zbrapsi larg\* sulmet e armiqve\* të çdo gjendjeje të vështir'.

#### *Tjetri: Se ton epi idhaton*

Dera e jetës, Krishti,\*<sup>12</sup> që theu më parë dyert<sup>13</sup> e Hadhit\* me forcën e Hyjnisë, të hapi derë pendimi ty\* që, me veprime të pavend, në porta zhdukjeje\* qe afruar, o e tërëthjesht'.

Gruan që më përpara\* ish armë mëkati, tash me shën Kryqin,\* tekxa iu fal atij, e tregove si triumfuese\* mbi gjithë armët, mbi çdo marifet demoniak\*, o i dhembshur, zemërgjeri Zot.

Ai që, si shpërblesë,\* për gjithë ne gjakun e tij e derdhi\*<sup>14</sup> më parë dhe kish dhënë krejt ekzistencë në çdo krijim,\*<sup>15</sup> të bën të pastër ty me banjë lotësh, kur kishe\* lebër tmerr nga akti mjaft i keq.

#### *Hyjlindësor*

Më sipër se çdo fjalë\* misteri yt është, o Virgjëreshë:\* Në ty fushoi Fjala e Atit hyjnisht, jep ndjesë plot\* me vetë fjalën për mëkatet<sup>16</sup> te fajtorët mbar',\* se kjo ka mëshirë, dhembshuri.

*Zbritësore: Tus sus innologus*

O Zonjë dhe nën' (fq. 115)

#### *Ndenjësore*

#### *Ting. Tërth IV Tin sofian qe Logon*

Si të gjitha lëvizjet e mishit tënd\* i frenove me lodhje, asketizim,\* tregove mentalitet\* burrëror brenda shpirtit tënd\* se dëshiroje Kryqin e Zotit ta shihje ti,\* hyjnisht u kryqëzove për botën,<sup>17</sup> e famshme mjaft;\* ndaj, e tërëlumtur, për jetes' engjëjllore\* e nxisje gatishmërisht\* veten tënde me zell, Mari,\* e lëvdojmë\* kujtimin tënd\* besërisht, dhe ndjes' pasurisht\* për fajet tona ne lypim,\* kërkojmë fort,\* nëpërmjet ndërmjetimit tënd, nga



Jisui Krisht.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

**J**am i ngulur në baltë pasionesh keq,\* dhe nuk kam bazament, më fundosi tmerr \* stuhia<sup>18</sup> e shkeljeve;\* por, meqë linde Fjalën Zot,\* të vetmin njeridashës, shikomë me mirësi,\* të lutem un' shërbyesi yt edhe nga çdo faj\* dhe nga çdo shpirtprishje, ves dhe hall ti çliromë,\* nga çdo keqtrajtim, mundim\* të keqbërësit, që të psal\* me hare, gaz,\* o Zonjë Vajz:\* Ndërmjeto te Zoti yn' Krisht,\* të na dhurojë pra ndjesën\* e fajeve,\* me bes' nën strehën tënde përikim, e pacen.

*Ode IV*  
*Isakikoa Kirie*

**S**hijonte thellë i pasuri duke dëfryer me ushqim dhe veshje, mirëpo Llazari dëshironte të ngopej me thërrimet e tryezës së tij.

**Q**entë lëpinin me gjuhë plagët e Llazarit të varfër, duke u bërë kështu për të vobektin më të dhembshur se i pasuri.

**O** Shpëtimtar, qëmoti Llazari ishte hedhur në portën e të pasurit, duke u dënuar prej kamxhikëve të varfërisë, prandaj lavdërohet tani.

*Hyjlindësor*

**N**dërmjeto, o e Pacenuar, tek ai që e kishe në bark, që të shpëtoj më nga skllavëria e të fëlliqurit ne që të himnojmë, sepse vetëm ti je mbrojtja jonë.

*Tjetri: Tin en stavró su*

**S**i Gatues i natyrës njerëzore,<sup>6</sup> si burim mëshire dhe pasuri zemërdhembshurie, të erdhni keq për gruan që përiku drejt teje dhe e rëmbeve nga egërsira shfarosëse, o njeridashës.

**K**ur po nixtoje që të vështroje Kryqin, me

ndriçim kryqësor u shkëlqeve, o Mari, me aprovimin hyjnor të atij që komunikoi me Kryq, pasi u kryqëzove për botën,<sup>18a</sup> o e admirueshme.

**M**ë parë oshënarja u bë për shumë veta shkak i të këqijave përmes kënaqësie dinake; por, kur feksi si diell, u tregua udhëheqës për të gjithë ata që mëkatojnë.

*Hyjlindësor*

**I**a kalove edhe mendjes qiellore, o qielli mendor i mbretit të të gjithave,<sup>18b</sup> se, pa ligjet e natyrës, kishe në shtatzëni ligdhënësin dhe krijuesin e të gjithave,<sup>19</sup> o e Dëllirë.

*Zbritësore: Tin aneksihniaston*  
**T**ë pagjurmësuarin plan (fq. 380)

*Ode V*  
*Ina ti me aposo*

**I** pasuri, sapo pa Llazarin të dëfrente në dritë dhe lavdi në gjirin e Abrahamit, thërriste: O atë Abraham, mëshiro më mua që u dënova në zjarr dhe më flakërohet tmerrshëm gjuha.

**A**brahami i tha të pasurit: Shijove skajshëm duke dëfryer me pasuri në jetë, prandaj u ndëshkove këtu përjetësisht dhe je në zjarr, ndërsa Llazari i vobektë ngazëllohet me harenë e pafund.

**N**ëpërmjet mashtrimit të jetës u bëra i pasur<sup>20</sup> si i pasuri që e shpenzonte tërë pasurinë në epshe, o Njeridashës; i lutem dhembshurisë sate, që të çlirohem nga zjarri, siç shpëtoi Llazari.

*Hyjlindësore*

**D**uke pasur guxim nënorr para Birit tënd, o e Tërëkulluar, të përgjërohemi, të mos e shpërfillësh përkujdesjen tonë farefisnore, sepse ne të krishterët vetëm ty të vëmë para Zotit si zbutje dashamirëse.

*Tjetri: Theofanias su Hristë*

Moisiu i famshëm u lavdërua dikur<sup>21</sup> kur pa mistikisht në Sina shpinën e Perëndisë,<sup>22</sup> kështu simbolizonte disi një mister të çuditshëm; ndërsa tani Maria e konsideron si shtambë manapurëse<sup>23</sup> ikonën e pacenuar; kur u gjunjëzua nxeh-tësisht para saj, fitoi jetë engjëjlore.

“Ngaqë dëshiroj të shikoj psalmikisht<sup>24</sup> hijeshinë e kishës sate dhe tendën mendore të lavdisë sate,<sup>25</sup> mua përdhosësen<sup>26</sup> e tempullit tënd, o Krisht,<sup>27</sup> bëmë tempull të Shpirtit tënd<sup>28</sup> gjithëbërës me ndërmjetimet mendore të asaj që, pa burrë, u bë tempulli yt”.

Ajo që me grepin e mishit zuri shumë veta përmes syve<sup>29</sup> dhe i bëri përmes kënaqësisë së shkurtër si ushqim për djallin, u kap vërtet si me grep plotësisht me anën e Hirit hyjnor të Kryqit të çmuar, meqë ishte ushqim shumë i ëmbël për Krishtin.

*Hyllindësor*

Kori i profetëve, meqë mësoi mistikisht për misterin që u bë te ti, o e Pacenuar, të paraquante larmishëm me fjalime të hyshme mistike; ndërsa tani ikonë të pacenuar të shtambës manapurëse<sup>23</sup> të quan Maria, garante mëkatarësh te Perëndia, kur ajo u gjunjëzua para ikonës.

*Zbritësore: Eksesti ta simpanta*

Të gjith' i habite ti (fq. 117)

*Ode VI**Ilëshiti mi Sotir*

Dënoi veten e tij\* i pasuri me jetesë epsesh, për në flakë dhe zjarr,\* por zgjodhi Llazari i vobektë krejt varfëri\* në këtë jet', tokë,\* dhe u bë i denj' për gaz pa fund.

U bë Llazari i denj'\* për jetën lart, në

amshim, o Krisht, ndaj Abrahami e kish\* në gjirin e tij, ndërsa i pasuri, si fajtor,\* shumë u ndëshkua\* si në shpirt ashtu edhe në trup.

Drejt u dënua në zjarr\* i pasuri për Llazarin; lutem, njeridashës, o Zot,\* të mos më ndëshkosh, se jam me faj plot i mjeri un',\* por për dritën tënde\* denjësomë si Llazarin ti.

*Hyllindësor*

Le të çlirohemi ne\* nga shkeljet e rënda, o Hyjnënë e kulluar, pa cen\* dhe me përgjërimit tënd të gjejmë ndriçim hyjnor\* nga ai që mori\* mish prej teje, Bir i Perëndis'.

*Tjetri: Ávisos eskati*

Kanë gaz, Mari, lart ushtrit' e engjëjve se shikojnë,\* oshënare, të kesh njësoj jetë\* me ta,<sup>30</sup> ndaj dhe duke thirrur, lëvdojnë\* Zotin Krisht që të dha fuqi.

Krejt organizata demonësh skrop të zinj kanë frikë\* nga fuqia e durimit tënd derr,\* se, sado grua, e zhveshur, e vetme,\* ti i ke turpëruar keq.

Shndrite, o Mari, o e tërëfamshme, si diell, fekse,\* llamburite shkretëtirën mbarë\* me vezullime; prandaj edhe mua\* më ndriço me shkëlqimin tënd.

*Hyllindësor*

Engjëjt, nga lavdia e lindjes sate, shkëlqyen shumë,\* thirrën pra, o Virgjëreshë: Paqe\* mbi tërë dheun, mbi njerëzit mbarë,\* mirëdashje prej qiellit.<sup>31</sup>

*Zbritësore: Tin thian taftin*

Këtë të kremte (fq. 117)

*Kontaqi**Ting, III I Parthenos simeron*

Më përpara ngopeshe\* me çdo lloj pro-



stitucioni,\* por sot me pendimin tënd\* u shfaqe nuse e Krishtit,\* doje fort\* jetesë engjëjsh; me armë Kryqin\* shkele krejt\* demonët qartë, Mari e shenjtë;\* dhe kështu na u tregove,\* e tërëthjeshta ti, nuse e mbretëris'.

### *Shtëpia*

**O** Mari e gjithëkënduar, shqerrë dhe bijë e Krishtit, të mburrim tani me këngë ty që u duke fryti i egjiptianëve; por u largove nga tërë mashtrimi i tyre dhe iu ofrove mirë Kishës si bimë e çmuar, dhe asketizove me vetëpërbajtje dhe me lutje përmbi masën e natyrës njerëzore; prandaj dhe u lartësove në Krishtin falë jetës dhe veprës, dhe na u tregove, e tërëthjeshta ti, nuse e mbretëris'.

### *Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm*

*(Nëse kjo e diel bie më 1 prill, meqë atëherë kremtohet palëvizshëm oshënarja, lihet Sinaksari që vijon, dhe lexohet vetëm sinaksari i saj në Mujor).*

Në të njëjtën ditë, të Dielën e Pestë të Kreshmëve, u urdhëruam të kujtojmë nënën tonë oshënore Maria Egjiptiane.

*Varg:* Iku fryma, mishi u tret shumë më parë;/o dhë, fshihe trupin skelet të Marisë. Me ndërmjetimet e saj, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

### *Ode VII*

#### *I ek tis Iudheas*

**S**i rrinte qëmoti Jovi mbi qelb krimbash dhe mbi pleh,<sup>32</sup> ashtu rrinte dhe Lazari para portës së të pasurit duke thirrur: O Perëndi i etërve, je i bekuar.<sup>33</sup>

**Q**ëmoti, Lazari i hedhur në portat e të pasurit të pamëshirshëm, dëshironte thërrimet e tryezës së tij, por askush nuk ia jepte; por, në vend të tyre, gjeti gjirin e Abrahamit.

**O** Krishti im, lutem, më çliro nga pjesa e të pasurit të pamëshirshëm dhe, pasi të më radhitësh bashkë me Llazarin e varfër, denjësomë që të të thërras me kënaqësi: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>33</sup>

### *Hyjlindësor*

**U** shfaqe për shpëtimin tonë, pasi u mishërove nga një mitër virgjërore; prandaj, duke e ditur nënën tënde si Hyjlindëse, thërrasim me kënaqësi: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>33</sup>

### *Tjetri: I Pedhes en Vaviloni*

**Z**osimai i urtë, tepër madhor mes etërve, duke e endur nëpër shkretëtirë, u denjësuva ta shikonte oshënares, dhe thërret: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>33</sup>

**O**shënarja i thërriste plakut: "Pse, o atë, ke ardhur të shikosh një grua të parëndësishme, të huaj për çdo virtyt praktik?". Dhe thërret: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>33</sup>

**P**ërderisa, o e lumtur, i vdiqe lëvizjet e veseve<sup>34</sup> të tua, u ankorove tani në liman papasionshmërie duke thirrur: O Zot, Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>33</sup>

### *Hyjlindësor*

**U** ngjize parrëfyeshëm duke mbetur e virgjër, o e Pacenuar, dhe kishe në bark shpëtimin<sup>35</sup> për hirin e botës, Krishtin, Perëndinë tonë; prandaj të gjithë ne besimtarët të madhërojmë me këngë.

*Zbritësore: Uk elâtrefsan*  
**N**uk u faleshin (fq. 118)

### *Ode VIII*

#### *Eptaplasios káminon*

**Q**ëmoti, i pasuri vishej shkëlqyeshëm me stoli të kuqe, li të çmuar dhe purpur, i mjeri, teksa Lazari i varfër dergjej dhimb-

shëm në portën e tij duke dashur të ngopej me thërrimet që binin nga tryeza, por askush nuk i jepte; prandaj mbretëron në lavdi bashkë me Krishtin.<sup>36</sup>

Lazari dergjej në portën e të pasurit, i kalbur me plagë në trup, dhe donte të ngopej me ushqim, por askush nuk i jepte; madje dhe qentë dhembshurisht i lëpinin me gjuhë traumat e tij; prandaj u denjësua për shijim në Parajsë.

O i Shumëmëshirshëm, edhe unë në shijimin e kësaj jete u pasurova në epshe si dikur i pasuri që vishej çdo ditë me robë të kuqe; unë vetëdënohem përmes shijimesh dhe mashtrimesh; ndaj të përgjërohem, o Krisht, më çliro nga zjarri i amshuar<sup>37</sup> në gjithë jetët.

#### *Triadik*

Hyjninë me tri drita, që llamburit dritë unike prej një natyre trihipostate, Lindësin pa fillim, Fjalën bashkekzistuese me Atin dhe Shpirtin e bashkëqenshëm që bashkëmbretëron, o Djem, bekojeni;<sup>38</sup> priftërinj, përhimnojeni;<sup>39</sup> popull, përmbilartësojeni në gjithë jetët.

#### *Tjetri: Ëkstithi friton uranë*

O Shpëtimtar, që i di, para se të ndodhin, ato që kanë lidhje me gjërat tona,<sup>9</sup> duke hetuar thellësitë e zemrës,<sup>40</sup> e rrëmbeve nga jetesa e dhunshme gruan që përiku drejt teje me siguri për njeridashjen tënde, e cila thërriste pa pushim: O priftërinj, bekojeni;<sup>39</sup> popull, përmbilartësojeni në gjithë jetët.

Oh, ndryshim i nderuar për zhvendosjen tënde drejt më së mirës, o Mari e tërëfamshme dhe e thjeshtë! Oh, mallëngjim i hyjshëm që urreu kënaqësi mishore! Oh, besim i nxehtë dhe hyjnor! Atë, oshënares, e mburrim besërisht dhe e përmbilar-

tësojmë në gjithë jetët.

O Mari modeste, e more pagën e dhimbjeve të tua dhe shpërblimin e mundimeve, në saje të të cilave e mposhte armikun vrasës; dhe tani tok me engjëjt thërret me zë të lartë himnin pa reshtur<sup>41</sup> dhe e përmbilartëson Krishtin në jetë.

#### *Hyjlindësor*

Si Zot i të gjithë jetës, pa prishur veçoritë e dy natyrave më rigatoi të tërin në mitrën tënde nga mirësia, o e Dëllirë; prandaj ty, si shkak të shpëtimit tonë, të himnojmë me këngë në gjithë jetët.

#### *Zbritësore: Pedhas evajis* **Djemat e dënuar (fq. 119)**

#### *Ode IX*

#### *Se tin apirógamon*

Krisht, kërkoj që të më bësh L Lazar të varfër, ndaj dëboji,\* meqë nga natyra je Perëndi, orekset e kënaqësis;\* por përmes virtytesh si të pasurin ti më bëj,\* që me besë dhe himne unë të të madhështoj.

Zot, i pasur pa mëshirë isha dhe shpërfillja besën,\* mendjen tok të hedhur tmerr para portës së porosive që dhe;\* njeridashës, ngrimë dhembshurisht, dashurisht, i mir,\* si qëmoti L Lazarin, mikun, katërditëshin.<sup>42</sup>

Gjithë ne paravolin' e Zotit e mësuam mirë;\* ndaj, besnikë, që gjithnjë të kërcejm' të gjithë në gjë abramian\* pasi të shpëtojme krejt nga Ferri, nga çdo ndëshkim,\* ta urrejmë fort egërsinë e të pasurit.

#### *Hyjlindësor*

Besërisht të madhështojme ty që mbajte në pëqij, Vajz,\* të padukshmin Perëndi qiellor që tërë Krijesa, çdo gjë\* e himnon, e lavdëron; ai, përmes teje pra,\* na du-



ron përgjithnjë shpëtim, mëshirë si dhe hir.

*Tjetri: Mi epodhiru mu miter*

Të rregullonte fuqia e pushtetshme e Krishtit,\* nënë, duroje dhimbjen e shkretisë më lehtë ti;\* me rrëke lotësh fort të hyjshëm fikje krejt,\* o modeste, mendime të pista në çdo sulm;\* krenari oshënarësh dhe kulm asketësh je.

Të shndrit me reze shkëlqyeshëm e vetmja e Virgjër,\* pra e dëlira Vajz' që lindi dritën, Zotin Krisht;<sup>43\*</sup> ndaj armiqve të bën të frikshme, o e thjeshtë,\* o Mari, dhe të dukshme te krejt ne të tregon,\* bukuri oshënarësh, mbështetje asketësh.

Si le me mendje të gjitha tokësoret, u shfaqe\* banes' e hyjshme për Shën Shpirtin;<sup>28</sup> Krishtin lype ti,\* Çlirimtarin e vetëm, të shpëtojnë krejt\* nga çdo gjë e mbindheshme, nga dhimbjet mbar' që kanë,\* sa me besë kremtojnë kujtimin tënd hyjnor.

*Hyjllindësor*

Vajz', si u shmange nga ligjet që i vuri natyra,\* përmbi natyrë mbi dhë kishe Bir të ri në bark,\* pra ligjvënësin, më të vjetrin nga çdo dit';<sup>44</sup> e kulluar, me mall, bes' të lumërojmë ne,\* se je qiell mendor për Gatuesin unik.

*Pas Zbritësoreve, i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor dhe Idhiomele Hapmi dyert; Drejtomë në rrugët; Unë i mjeri (fq. 10).*

Më të nderuarën. *Dhe Zbritësorja: Apas jijenis Gjithë njerëzit (fq. 120)*

*Dërgimësore ngjallësore dhe të Triodit:*

*O uranón tis astris*

Duke të pasur shembull\* pendimi, Krishtin lype ti,\* që të na e japë gjatë\* kohës

së kreshmës, që me himn,\* fortoshënares Mari, pra\* me bes', mall, këng' të të mburrim.

*Hyjllindësore*

O ëmbëlsi engjëjlore dhe ngazëllim për të mjerët, ti që i mbron të krishterët, o Shën Mari Virgjëreshë; përkrahmë ti dhe shpëtomë, nga zjarr' i ferrit përjetë.\*

*Lavdërime: 4 ngjallësore dhe 4 të oshënares (ato të Mbrëmësoreve në 4, me Vargje, në të tretën: Duke duruar, durova duke pritur Zotin dhe më vuri re; dhe në të katërtën: Dhe siguroi mbi gur këmbët e mia dhe drejtoi hapat e mi).*

*Lavdi Ting. I*

Nuk është mbretëria e Perëndisë ngrënie dhe pirje, por drejtësi<sup>45</sup> dhe asketizëm me shenjtërim; prandaj, as të pasurit nuk do të hyjnë në të,<sup>46</sup> veçse sa i depozitojnë thesaret e tyre në duart e të varfërve. Këto na mëson dhe profeti David kur thotë: "I drejtë është burri që jep lëmoshë tërë ditën,<sup>47</sup> që e shijon Zotin<sup>48</sup> dhe ecën në dritë, i cili nuk do të pengohet".<sup>49</sup> Të gjitha këto u shkruan për urtësimin tonë, që, duke kreshmuar, të bëjmë mirësi;<sup>50</sup> dhe na dhëntë Zoti qielloret në vend të tokësoreve.

Tani

E përmëbëkuar

*Dhoksologjia e Madhe.*

*Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Triodit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e oshënares dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e pa-turpëruar.*



NË TË NJËJTËN TË DIEL  
NË MBRËMËSOREN KATANIKTIKE

*Pas Psalmit Nistor (dhe pa Psaltir si në  
çdo të diel),*

*10 Thirrtoret: 4 Kataniktike të Tingullit të  
javës, 3 të mëposhtme të Triodit dhe 3 të Mu-  
jorit.*

*Të Triodit*

*Ting. I Panëfimi märtires*

*Poezi e zotit Josif*

**M**e dritë, Krisht, dhe pavdekësi\* plot i mbushë njerëzit,\* i pasur krejt, kur u varfërove;<sup>51</sup> ndaj me çdo virtyt\* pasuro-më mua\* që u varfërova përmes epshe-ve të jetës, rreshtomë me Lazarin e vobekt';\* nga ndëshkimet e të pasurit\* përjashtomë, nga Gjehena që më pret.

**T**ë keqen e pasurova tmerr,\* desha, o Zot, dhe shijim\* dhe u kënaqa me epsh në jetë, ndaj përgjegjësi\* për Gjehenën zjar<sup>11</sup> kam,\* se shpërfilla mendjen që uri kish, si Lazarin; dhe ishte hedhur para portave\* të veprimeve të hyjshme, pra\* dhembshuromë, Shpëtimtar, me mirësi.

*Tjetër; i zotit Theodor*

*Injëjti Nefelin se fotós*

**F**illojm' të gjashtën javë me plot nder të Kreshmës\* zellshëm, himnim parakremtor të ditës, të Dielës\* së Dafinave, t'ia psalim Zotit Krisht që vjen,\* o besnikë, me lavdin dhe forcën hyjnore për në Jerusalem të vrasë vdekjen; të përgatisim degë virtytesh tok\* si simbol për fitoren, që plot bes' të thërrasim ne "Hosana"\*<sup>52</sup> drejt Krijimtarit të botës së tërë, Bërësit.

*Dhe 3 të Mujorit. Lavdi dhe Tani e tij  
(Hyjlindësore).*

*Hyrje me temjanicë. O dritë gazmore dhe  
Proqimieni i Madh:*

*Ting. Tërth. IV*

U dhe trashëgim atyre që e kanë frikë emrin tënd, o Zot.

*Varg:* Nga skajet e tokës thirra drejt teje.  
U dhe trashëgim...

*Varg:* Do të mbulohem në strehën e kraheve të tu.

U dhe trashëgim...

*Lutja e gjatë (Ektenis):* Le të themi, të gjithë... Bëna të denjë, o Zot... Le ta plotësojmë lutjen...

*Pasvargje Ting. I Idhiomeli*

**I** çuditshëm është qëndrimi njeridashës i Shpëtimtarit ndaj nesh, sepse, duke pasur njohjen e të ardhshmeve<sup>9</sup> si të të tashmeve, publikoi jetën e Lazarit dhe të të pasurit; duke pasur kështu para syve fundin e secilit prej tyre, le të shmangemi nga ashpërsia dhe urrejtja kundër njërit, ndërsa ta kemi zili durimin dhe zemërgjerësinë e tjetrit që, duke u ngrohur bashkë me të në gjirin e Abrahamit, të thërrasim: O Zot i drejtë në gjykim,<sup>53</sup> lavdi më ty.

*Varg:* Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

*Injëjti*

*Varg:* Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

*Martirik*

**M**e ndërmjetimin e të gjithë shenjtorëve dhe të Hyjlindësës, o Zot, na jep paqen tënde<sup>54</sup> dhe mëshirona, si i vetmi i dhembshur.



Lavdi dhe Tani *Hyjllindësor*  
Ton uranion tagmaton

Je për rreshtimet e engjëjve ngazëllim,  
hare,\* dhe mbrojtje e fuqishme\* për  
të vdekshmit mbi dhe ti;\* o e Virgjër pa  
cen, shpëtona ne\* që përikim drejt teje  
shpejt,\* se i vendosim në ty, pra pas Pe-  
rëndis',\* shpresat tona, o Hyjllindëse.

*Dhe shërbesa që mbetet sikundër të Dielën  
e të Lidhurit të Djathit (fq. 57).*

## CITIME

Llazari i varfër dhe i pasuri: Lluk. 16.19-31

1. Matth. 3.1; Mark 1.4; Lluk. 1.80; 3.2
2. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
3. Jakov 4.7
4. Ps. 94(95).4
5. Matth. 10.38; 16.24; Mark 8.34; Lluk. 9.23; 14.27
6. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5;  
Jov 10.8-9; II Makk. 7.23
7. I Tim. 6.16
8. Joan 21.17
9. Ps. 138(139).16
10. Matth. 2.14
11. Matth. 5.22; 18.9; Mark 9.43-45,47
12. Joan 10.9-10
13. Ps. 106 (107).16
14. Matth. 20.28; Mark 10.45
15. Vep. 17.25
16. Matth. 9.5; Mark 2.9; Lluk. 5.23
17. Gal. 6.14
18. Ps. 68(69).3
- 18a. Gal. 6.14
- 18b. Est. 4.17b
19. II Makk. 1.24; Sirak 24.8; IV Makk. 11.5
20. Matth. 13.22; Mark 4.19
21. Eks. 34.29-30; II Kor. 3.7
22. Eks. 33.23
23. Eks. 16.33; Hebr. 9.4
24. Ps. 16(17).15
25. Ps. 25(26).8
26. I Kor. 6.15
27. I Kor. 3.16; II Kor. 6.16
28. I Kor. 6.19
29. Fja. Urt. 6.25
30. Lluk. 20.36
31. Lluk. 2.13-14
32. Jov 2.8; 7.5
33. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
34. Kol. 3.5
35. Hebr. 2.10
36. II Tim. 2.12
37. Matth. 18.8; 25.41; Jude 7

38. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 27
39. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
40. I Kron. 28.9; 29.17; Ps. 7.10; Jer.17.10; Rom. 8.27; Apok. 2.23
41. Apok. 4.8
42. Joan 11.39-44
43. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
44. Dan. 7.9-13,22
45. Rom. 14.17
46. Matth. 19.23; Mark 10.23; Lluk. 18.24
47. Ps. 36(37).26
48. Ps. 36(37).4
49. Joan 11.9
50. Ps. 36(37). 3
51. II Kor. 8.9
52. Joan 12.12-13
53. Ps. 7.12; II Tim. 4.8
54. Joan 14.27



TË MËRKURËN PARA PALMAVE  
NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve, Ali-  
luitat dhe Triadiket e Tingullit të javës dhe,  
pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove Kryqë-  
sore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove  
Ting. II Ton lithon tu mnimatos*

Rëndohem me shumë mëkate si me gur  
dhe dergjem\* në varr<sup>1</sup> përtacie un',\* prej tij  
ngrimë, Zot i dhembshur, me mirësi të plot'.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjllindësore*  
*Ejfspahnias iparhusa*

Përmes Kryqit të Birit tënd, o Zonj'\* e dë-  
lirë, Hyjllindëse, fort ruhemi, zmbropsim\*  
lehtë gjithë sulmet e armikut djall,\* ndaj  
detyrimisht të lumërojmë ty\* si nënën e  
dritës<sup>2</sup> son',\* si shpresën e vetme krejt\*  
pra për shpirtat tanë, Vajz';\* je e lavdëruar,  
e kulluar fort.

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësove  
Ting. III Tm oreoitia*

Llazari vdiq dhe sot\* varroset, motrat

tok\* vajtojnë; por, si Zot,\* që paranjeh çdo gjë,\* vdekjen te Nxënësit e parathe k'shtu: "Llazari fjeti,\* po shkoj që ta ngre tani,\* do ta ngjall un' gatimin tim".\* Ndaj, drejt teje gjithë ne\* po thërrasim me zë të lart':\* Lavdi pushtetit tënd të fuqishëm,\*<sup>3</sup> o Perëndi i tërëdhembshur.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyllindësore*

Sapo të pa, o Krisht,\* të varur përmbi dru,\* të vdekur, me vajtim\* si nënë, qante keq\* nëna pa burrë, e dëlira, tha: Çfarë të shpagoi\* hebraikja bashkësi\* pa ligj, mosmirënjohëse\* që shijoi, Biri im,\* dhurëti të mëdha pa fund\* nga ti, o Shpëtimtar, ndaj po psal himn\* plot lavd për bashkëzbritjen tënde.

*Psalmi 50. Prifti thotë uratën e zakonshme:*  
O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën, dhembshurinë dhe... *Kanuni i Mujorit dhe Triodet në vendin e tyre. Lexohet dhe Ode III biblike.*

*Triodi, poezi e Josifit.*

*Ode III*

*Ting. II*

*Stirohenta mu ton nun*

Me fuqin' e Kryqit tënd,\* fuqizoma mendjen aq të dobësuar\* nga çdo sulm djallëzor,\* dhe drejtoje te vullnetit yt, o Zoti im.

Me dremitje, përtaci\* fle në shtrat kënaqësish un', Krisht, dhe ephesh;\* ngrimë dhe më trego\* besimtarin që do falem te pësimi yt.

Të ndriçuar fort në shpirt\* përmes kreshmës, të nxitojmë që, të pastër,\* Zotin Krisht që me trup\* po vjen në Jerusaleam, ta mirëpresim ne.

*Hyjllindësor*

Meqë zjarri i Hyjnis'\* nuk të dogji, m'i digj vrullet krejt lëndore,\* veset dhe çdo

pasion,\* e Dëlirë, që me bes' të të lëvdjo gjithnjë.

*Kanun tjetër; poezi e Theodorit. Ting. III*  
*Stira psihi qe agone*

Nga syri që sheh krejt çdo gjë,\* pra i Jisuit Krisht Zot,\* s'shpëtoi sot Llazari shenjt\* që vdiq; u thotë vetë Nxënësve,\* thërret ky: Miku yn'\* fjeti, ndaj po shkoj unë që ta ngre atë.

Zot, i tmerrove Nxënësit\* kur thoshe se përsëri\* do shkoje në Jude; veçse\* Thomai thirri me guxim kështu:\* Të shkojmë,<sup>4</sup> jeta është',<sup>5</sup> do jetojmë prapë edhe në vdesim ne.

Lavdi *Triadik*

O e njëqenshmja Shën Trini,\* si një të falemi ne,\* Hyjni e pakrijueshme.\* o Atë fuqiplotë edhe Bir\* i bashkëpafillim,\* Shpirt Hyjnor, i bashk'fronshëm, ju psal çdo njeri.

Tani *Hyjllindësor*

Je rrënja e Jeseut<sup>6</sup> ti,\* nënë e Virgjër pa cen,\* se lulen jetëprurëse,\* pra Krishtin, linde për ne njerëzit,\* prej prishjes, vdekjes k'shtu\* u çliruam; krejt ne të psalim, e dëlir'.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Gaz ki, Sion, se mbreti yt\* po vjen tani butësisht,\* siç tha me zë profeti<sup>7</sup> fort,\* e sjell pulishti trupërisht atë,\* atë që mban në dor'\* çdo gjë, botën; forcës së tij le t'i këndojm'.

*Imosi: Stira psihi qe agone*

»O shpirt pa pjellori, shpirt shterp,\*<sup>8</sup> fryt »të lavdishëm fito,\* dhe me dëfrim, gaz, »thirri fort:\* U sigurova, Perëndi, me ty;\* »veç teje s'ka shenjtor,\* as nuk ka të drejt »të aspak, o Zoti im.<sup>9</sup>

*Ode VIII*



*Ton en ti vato Mosi*

**O** Krisht, rrokullise gurin tejet të rëndë<sup>1</sup> të dembelizmit tim të frikshëm që e ka shpirti im i varfër; dhe ngrimë nga varri i apatisë, për lavdërimin tënd, o Fjalë.

**N**ga dhembshuria e thellë u paradeklaroje miqve të tu ti, paranjohësi dhe Perëndia, vdekjen e mikut tënd, të cilin kish për ta ngritur pas katër ditësh nga varri, për dhoknologjinë tënde.

**O** Krisht, sërish vjen drejt Judesë që kërkon të të vrasë<sup>4</sup> përmes druri ty, drurin e jetës.<sup>10</sup> sepse ti dëshiron t'i bësh të pavdekshëm ata që vdiqën për shkak të ngrënies nga druri.<sup>11</sup>

*Hyllindësor*

**N**ë ty, o Virgjëreshë e kulluar, u dukën të gjitha udhët e Perëndisë,<sup>12</sup> i cili e ruajti pas lindjes dëlirësinë tënde të vultur qartësisht në gjithë jetët.

*Tjetri: Ton eks anarhu Patrës*

**M**iku i Krishtit, Llazari që vdiq sot, çohet për varrim dhe ato që janë rreth Martës, vajtojnë për fatkeqësinë vëllazërore; ndër-  
sa Krishti shkon me gëzim drejt tij që t'u tregojë popujve se ai është jeta e të gjithëve.<sup>5</sup>

**S**i nga Malë i Ullinjve, nga lartësia e lëmoshave, o popuj, pasi të presim degë virtytesh, ejani ta përgatisim praninë e Krishtit në veten tonë mendërisht, duke e himnuar, bekuar dhe përmblartësuar atë në jetë.<sup>13</sup>

Bekojmë Atin, Birin edhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin (*Triadik*).

**O** Njësi trihipostate, Atë, Bir dhe Shpirt i gjallë, një Hyjni, një mbretëri, të himnon drita që nuk perëndon, ushtritë e engjëjve; dhe ne të mbidheshmit të himnojme, të

bekojmë dhe të përmblartësojmë në gjithë jetët.<sup>13</sup>

*Tani Hyllindësor*

**J**a që gjithë gjeneratat të lumërojmë, o e pacenuar, duke vëzhguar madhësitë e tua,<sup>14</sup> sepse lind përmblartësojmë Bërrësin e Gjithësisë, i cili është Perëndi dhe njeri; prandaj të bekojmë dhe të përmblartësojmë, o e Dëlirë, në jetë.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **S**ë bashku me fëmijët, le t'i dalim dhe ne para Krishtit Perëndi duke i ofruar në vend të palmave lëmoshë dhe lutje me zemër, me degë duke thirrur: Hosana, bekojeni dhe përmblartësojeni atë në jetë.<sup>13</sup>

*Irmosi: Ton eks anarhu tu Patrës*

»Perëndinë që lindi para jetëve prej Atit »pa fillim dhe në fund prej Hyllindësës »pasi veshi mish, si njeri të përsosur dhe »Perëndi prej Perëndisë, himnojeni, bekojeni dhe përmblartësojeni në gjithë jetët.<sup>13</sup>

*Ode IX**Ton jijenon tis ikusen*

**K**ish mbyllur goja bishash Danieli<sup>15</sup> kur ish fortifikuar, shpirt,\* me kreshmë; pra ti zilepse, gjarprin<sup>16</sup> që ulërin\* pors i luan që do çdo shpirt ta glabërojë,\*<sup>17</sup> me Kryqin aleat, ti\* dëboje, zbrapse, fitimtar dil edhe nderoje Zotin tënd.

**O** Fjalë Perëndie, shpirtin tim që u vra prej shumë fajesh keq\* dhe brenda varrit të shkëlqes është\* burgosur me tmerr,\* si do ta ngjallësh me fjalë që jetë na jep,\* ta denjësosh të sjellë\* mjaft palma, çdo virtyt, te ti fitimtari, Zot i vdekjes, Krisht.

**Ai** që ka fron qiellin, nënkëmbëz posht' dheun,<sup>18</sup> Fjala Perëndi\* e Atit Zot, tash ka hipur mbi pulisht, edhe shkon,\* hyn në qytetin e shenjtë,<sup>18a</sup> të rregullojë,\* si mbret

i çdo krijese,\* himnim të hijshëm që nga gojë të foshnjave, me lavd të madh.

### *Hyjlindësor*

Nga gratë, vetëm ti ke bukuri,<sup>19</sup> e dëlirë, ke plot admirim,\* se Fjalën e përmbibukur ti e linde, u shfaq\* i bukur më shumë se njerëzit<sup>20</sup> e gjithë;\* ndaj lypj që ta bëjë\* shëmtin' e zemrës sime, o Virgjëreshë, bukuri, stoll.

### *Tjetri: En Sineo to ori*

Duke parë sot motrat vëllan' që ish\* nën të hidhurin helm gur,\* shën Llazarin, mbi varr lot lëshonin lum',\* por nga larg, o Krishti im,\* e njoftoje këtë ti,\* dhe apostujve të tu\* "Kam gaz për ju" u the,\* se atje nuk ishe me trup, Zot, kur vdiq ai.

Përsëri te ti vjen, Jude vrasëse,\* Krishti, se fort dëshiron\* ta përmbushë pësimin<sup>21</sup> si Perëndi;\* sado deshe që me gur\* ti ta vrisje,<sup>4</sup> ky po shkon\* drejt te sakrilegji tmerr,\* vullnetarisht, pa dhun'\* që të na çlirojë me një pësim shpëtimtar.

### Lavdi *Triadik*

Është Hyjnia Njësi dhe Trini - çudi,\* o ç'shkëmbim! - se ndahet kjo\* në Persona veçan, dhe bashkohet krejt\* në natyrë, s'ndahet hiç\* dhe kur pritet; një është,\* veçse e trefishtë pra,\* ruan dhe mban çdo gjë,\* është Ati, Biri si dhe i gjall Shpirt tok.

### Tani *Hyjlindësor*

"Kush dëgjo se lindi një virgjëresh'\* dhe pa burrë është nën'?'\* Ti e kreve, Mariam, aktin kolosal,\* si e bëre? Thuamë".\* "Mos heto lindjen time,\* ka një thellësi pa fund,\* është e vërtetë krejt,\* është mbi çdo mendim njerëzor koncepti i saj".

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. Si të thurim ne degët e palmave,\* mendë-

risht dhe realisht,\* Zotin ta mirëpresim, drejt nesh po vjen;\* i bekuar është ky\* që në emrin e Zotit,\* Atit, vjen, afrohet bri\* si i vërteti Bir,\* me devotshmëri ta lëvdojmë ardhjen e tij.

### *Irmosi: En Sineo to ori*

»Moisiu në malin Sina të pa\* në një »ferrë, se në bark\* zure, pa u shkruar »dot, zjarrin tmerr\*<sup>22</sup> të Hyjnisë, ndërsa »mal\* pa latim Danieli\* të pa,<sup>23</sup> Isaia »shenj\* shkop pra të thirri ty\* që do »mbije prej rrënjës së Davidit shenjtor.<sup>6</sup>

### *Fotogojiku i Tingullit të javës*

#### *Pasvargjet e Lavdërimeve*

#### *Ting. 1 Idhiomeli*

Izraeli ishte veshur me purpur dhe li të çmuar dhe shkëlqente me stoli të hyshme dhe mbretërore, dhe, i pasur me Ligj dhe profetë, dëfrente me adhurime Ligjore. Por, kur ti, o mirëbërës, që je përgjithmonë në gjirin e Atit,<sup>24</sup> u varfërove,<sup>25</sup> të kryqëzoi jashtë portave<sup>26</sup> dhe të shpërfilli edhe pse ti jeton pas Kryqit, për këtë arsye ka etje për një pikë Hir; ngjau me të pasurin e pamëshirshëm ndaj Lazarit të varfër, dhe u fut brenda zjarrit të pashuar<sup>27</sup> në vend të purpurit dhe të lirit të çmuar; dhe vuan duke parë popullin e kombeve, të varra më parë, pa thërrimet e së vërtetës, të ngrohet tani në gjirin e besimit të Abrahamit<sup>28</sup> dhe të vishet me purpurin e gjakut tënd bashkë me lirin e çmuar të pagëzimit, të ketë komoditet dhe, duke shijuar karizma, të thotë: O Krisht, Perëndia ynë, lavdi më ty.

*Varg:* U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përulë, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shër-



bëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqij bijt' e tyre.

*I njëjti*

*Varg:* Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji të ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

*Martirik*

**J**u, o martirë të tërëfamshëm, as shtrëngim, as ngushtësi, as uri, as përndjekje, as fshikullime, as tërbim bishash, as shpatë, as zjarr kërcënues nuk mundën t'ju ndanin dot nga Perëndia;<sup>29</sup> për më tepër, me mallëngjim për të, pasi luftuat si në trupa të huaj, shpëtuar fshehtas nga natyra meqë e shpërfillët vdekjen; prandaj dhe denjësisht fituat pagën e mundimeve tuaja dhe u bëtë trashëgimtarë të mbretërisë së qiejve;<sup>30</sup> ndërmjetoni pa pushim për shpirtat tanë.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësore*

*Panëfimi martires*

**T**ë varur të pa, o Krisht, ajo\* që dëlirësisht në bark,\* o njeridashës, të kish ty që në ujë vare dhen';\* dhe thërriste: Mjerë!\* Ç'pamje krejt e huaj është? Ku ka perënduar kjo bukuria jote që s'kish fund? Me vullnet pëson,<sup>21</sup> i ëmbli Bir,\* për të gjith'; ta madhëroj mëshirën, Zot.

*Lexuesi:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin *etj. si të hënën e parë në mëngjes (fq. 63).*

*Në orën e Gjashtë (në Trithektë). Tropari i*

*Profecisë*

*Ting. Tërth. 1*

**T**ë përgjrohemi, o Zot, mëshirat e tua kryeji mbi ne,<sup>31</sup> dhe mos na dorëzo në paudhësitë tona o Sundues i tërëpushtetshëm.

Lavdi dhe Tani

*I njëjti*

Proqimen. Ting. IV. Psalm 112.

Himnojeni, o djem, Zotin, himnojeni emrin e Zotit.

*Varg:* Emri i Zotit qoftë i bekuar.

Këndimi i profecisë së Isaias

*(58.1-11)*

**K**ështu thotë Zoti: "Thirr fuqishëm dhe mos u kurse, si trumbetë lartësoje zërin tënd dhe njoftoju popullit tim mëkatet e tyre, dhe shtëpisë së Jakovit paudhësitë e tyre. Më kërkojnë ditë për ditë dhe dëshirojnë t'i njohin udhët e mia. Si një popull që ka bërë drejtësi dhe s'e ka braktisur gjykimin e Perëndisë së tij, kërkojnë prej meje tani gjykim të drejtë dhe dëshirojnë t'i afrohen Perëndisë duke thënë: 'Pse kreshmuam, dhe ti nuk e pe? I përkulëm shpirtat tanë dhe ti nuk e dije?'. Sepse në ditët e kreshmëve tuaja i gjeni vullnetet tuaja dhe, të gjithë sa janë nën pushtetin tuaj, i shponi. Nëse kreshmoni për gjykime dhe luftëra, dhe godisni me grushte një të parëndësishëm, pse kreshmoni për mua si sot, që të dëgjohej me klithmë zëri juaj? Nuk e zgjodha këtë kreshmë dhe ditë që njeriu ta përkulë shpirtin e tij; edhe sikur ta përkulësh si hallkë qafën tënde, dhe të nënshtrosh poshtë thasë dhe hi, as kështu nuk do ta quani si kreshmë të pranueshme. Nuk e zgjova unë një kreshmë të tillë", thotë Zoti, "por zgjidh çdo zinxhir të padrejtësisë, shkatërro nyja të pleksura keq marrëdhëniesh të dhunshme, dërgo në çlirim të dërrmuar dhe grise çdo padi të padrejtë. Bëje thërrime *gjatë copëtimit* bukën tënde për atë që ka uri, dhe fut në shtëpinë tënde të varfër pa strehë. Në qoftë se do të shikosh *ndonjë* lakuriq, mbështille, dhe nuk do t'i shpërfillësh me egoizëm familjarët e farës sate. Atëherë

do të shpërthejë herët drita jote dhe shërimet e tua do të lindin shpejt, dhe do të të paraprijë para teje drejtësia jote, dhe lavdia e Perëndisë do të të mbështjellë". Atëherë do të thërrasësh, dhe Perëndia do të të dëgjojë; ende kur të jesh duke folur, do të thotë: "Ja, jam prezent". Nëse do të heqësh nga vetja zinxhir dhe goditje me dorë dhe fjalë ankimi, dhe do t'i japësh me shpirt bukë atij që ka uri dhe do të mbushësh një shpirt të poshtëruar, atëherë do të lindë në errësirë drita jote dhe terri yt do të bëhet si mesditë. Dhe Perëndia yt do të jetë me ty përherë.

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 113.

Ju qofshit të bekuar në Zotin që bëri qiellin dhe dheun.

*Varg:* Në daljen e Izraelit nga Egjipti.



## TË MËRKURËN E JAVËS PARA PALMAVE NË MBRËMËSORE

### 10 Thirtore

#### Ting. Tërth. I Idhiomeli

Edhe pse jam i pasur në pasione, kam veshur stolinë mashtruese të hipokrizisë, dhe dëfregjet të këqijave të mospërmbajtjes; dhe e tregoj zemërgurtësinë të pafund, duke e shpërfillur mendjen time të hedhur para portës së pendimit, duke pasur uri për çdo të mirë, dhe duke qenë e sëmurë nga pakujdesia. Por ti, o Zot, bëmë Llazar, të varfër në mëkate, se mos vallë atëherë, kur të kem nevojë, do të kërkoj dhe nuk do të arrij të gjej një gisht freskues, teksa gjuha ime do të vuajë në flakë të pashuar; dhe fushomë në gjirin e patriarkut Abraham, si njeridashës.

*Varg:* Ngrita sytë e mi drejt teje që banon

në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

### I njëjti

*Varg:* Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

### Martirik

Me predispozicion të pangopur shpirti, nuk e mohuat Krishtin, o martirë të shenjtë; përderisa duruat tortura të ndryshme pësimesh, i mposhtëm arrogancat e tiranëve; pasi e ruajtët besimin të paepur dhe të pagjymtuar, u zhvendosët në qiej; prandaj, meqë gjetët guxim para tij, kërkon që t'i dhurojë paqe botës dhe shpirtave tanë përdëllimin e madh.<sup>32</sup>

### Të tjera, poezi e zotit Josif

#### Ting. Tërth. I Heris askitikón

Duke lëvizur, Jisu, me trup\* përtej Jordanit,<sup>33</sup> thoshe te të pranishmit ti:\* Llazar mik para pak vdiq, në varr tash është; kam gaz\* për ju, miqt' e mi, që të mësoni drejt\* se unë di krejt çdo gjë,\*<sup>34</sup> Perëndi pa shkëputje jam,\* edhe pse dukem\* thjesht njeri; ndaj të shkojmë ne\* ta ringjallim pra;\* vdekja, zhdukjen e saj të plot',\* qartë ta marrë vesh si dhe rrëzimin e saj përdhe,\* që do ta bëj si Zot, duke i dhënë kozmosit përdëllim,\* mëshirë të madhe,\*<sup>32</sup> si i dhembshur, Shpëtimtar, njeridashës Çlirimtar.

Martën, besnikë, edhe Marin'\* t'i imitojmë, t'i dërgojmë ne Zotit Krisht\* veprime të hyshme si ndërmjetuese, që të vij',\* mendjen t'na e ngrejë se po dergjet tmerr\*



në varr, pra në përtaci,\* s'e ndien frikën hyjnore hiç\* dhe energjinë\* jetësore tani s'e ka;\* të thërrasim ne:\* Shih dhe siç kishe bërë Krisht,\* o Zot, qëmoti dhe Lazarin, mikun, e ngrite lart,\* kur shkove pranë tij frikshëm, kështu të bësh që të gjithë ne\* të kemi plot jetë\* duke dhënë ti mëshirë të madhe<sup>32</sup> tok me hir.

*Tjetër, poezi e zotit Theodor  
Ting. Tërth. II Kirie epi ton tafon*

Lazari ka dy ditë që është në varr dhe sheh të vdekurit që nga jeta. Atje shikoi tmerre të çuditshme, shumicën e panumërt që mbahet në prangat e Hadhit; prandaj motrat qajnë hidhur duke parë varrin e tij. Por Krishti erdhi që ta gjallërojë mikun e vet, që të kryhet një simfoni nga të gjithë së bashku: I bekuar je, o Shpëtimtar, mëshirona.

*Dhe katër të Mujorit*

Lavdi dhe Tani  
*E Mujorit (Hyjlindësore)*

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Prifti:* Mbrëmje!  
*Lexuesi:* Proqimen. Ting. IV. Psalm 114.  
Do të jem i pëlqyer para Zotit, në vend të gjallësh.

*Varg:* Desha, sepse do ta dëgjojë Zoti zërin e lutjes sime.

Këndimi i Gjenezës  
*(43.25-30; 45.1-16)*

I ofruan Josifit vëllezërit e tij dhuratat që kishin në duart e tyre dhe iu falën atij me fytyrë përtokë. Dhe i pyeti: "Si jeni?". Dhe u tha atyre: "A ka shëndet ati juaj plak që thatë? Jeton akoma?". Dhe ata thanë: "Ka shëndet shërbëtori yt, ati ynë, jeton akoma". Dhe tha: "I bekuar qoftë prej Perëndisë ai njeri". Dhe, si u përkulën, iu falën atij. Dhe, si pa lart, Josifi

e shikoi me sytë e tij Benjaminin, vëllanë e tij nga e njëjta mitër, dhe tha: "Ky është vëllai juaj më i ri, që thatë se do ta sillnit drejt meje?". Dhe tha: "Perëndia le të të mëshirojë, o bir". Dhe u trazua Josifi, sepse përziheshin të përbrendshmet e tij mbi vëllanë e tij, dhe kërkonte vend për të qarë; dhe, si hyri në dhomën e brendshme, qau atje. Dhe, si lau fytyrën, kur doli, e përmbajti veten. Dhe Josifi nuk mund t'i duronte të gjithë ata që i qëndronin pranë, por tha: "Dërgojini të gjithë larg meje". Dhe s'rrinte askush afër Josifit kur bëhej i njohur prej vëllezërve të tij. Dhe lëshoi zë me qarje; dhe dëgjuan të gjithë egjiptianët dhe u dëgjua në shtëpinë e Faraonit. Dhe Josifi tha drejt vëllezërve të tij: "Unë jam Josifi; akoma jeton babai im?". Dhe vëllezërit nuk mund t'i përgjigjeshin atij, sepse u tronditën. Dhe Josifi tha drejt vëllezërve të tij: "Afrhuni drejt meje". Dhe ata u afruan. Dhe tha: "Unë jam Josifi, vëllai juaj, që e dorëzua në Egjipt. Pra, le të mos ju vijë keq tani, as të mos ju duket e ashpër që më dorëzua këtu, sepse në jetë më dërgoi Perëndia përpara jush, sepse ky është viti i dytë, që ka zi mbi dhe, dhe akoma do të ketë pesë vitet që mbetën, në të cilat s'ka lërim as korrje; sepse më dërgoi Perëndia përpara jush, që t'ju ngelet mbetje mbi dhe, dhe që të ushqej mangësinë tuaj të madhe. Pra, tani nuk më dërgua ju këtu, por Perëndia, dhe më bëri si atë të Faraonit dhe zot të gjithë shtëpisë së tij, dhe sundimtar të gjithë dheut të Egjiptit. Duke nxituar pra, ngjituni drejt atit tim dhe thojini: 'Këto thotë biri yt Josif: Perëndia më bëri zot të gjithë tokës së Egjiptit; zbrit pra drejt meje dhe mos rri; dhe do të banosh në dheun e Jesemit të Arabisë dhe do të jesh afër meje ti dhe bijtë e tu

dhe bijtë e bijve të tu, delet e tua dhe lopët e tua dhe sa janë te ti; dhe do të të ushqej atje, sepse akoma do të ketë pesë vjet zi, që të mos mbarosh ti dhe bijtë e tu dhe gjithë pasja jote'. Ja ku sytë tuaj shikojnë, dhe sytë e Beniaminit, vëllait tim, se goja ime është ajo që flet drejt jush. Njoftojeni pra atin tim për të tërë lavdinë time në Egjipt dhe sa patë, dhe shpejtoni dhe zbriteni atin tim këtu". Dhe si ra mbi qafën e Beniaminit, vëllait të tij, qau mbi të, dhe Beniamini qau mbi qafën e tij. Dhe pasi i puthi fort të gjithë vëllezërit e tij, qau mbi ta dhe, pas këtyre, vëllezërit e tij folën drejt tij. Dhe u dëgjua fort zëri në shtëpinë e Faraonit, duke thënë: "Kanë ardhur vëllezërit e Josifit". Dhe u gëzua Faraoni dhe shërbimi i tij.

Proqimen. Ting. IV. Psalm 115.

Do t'la kthej sa i kam taksur Zotit përballë gjithë popullit të tij.

*Varg:* Besova, prandaj fola, dhe unë u përula fort.

Këndimi i Fjalëve të Urta  
(21.23-22.4)

**Ai** që e ruan gojën dhe gjuhën e tij, e mban larg nga shtrëngimi shpirtin e tij; një arrogant e i paturp e mendjemadh quhet infektues, dhe ai që mban mëri, është i paligjishëm. Dëshirat e vrasin dembelin, sepse duart e tij nuk duan të bëjnë diçka. I pabesi dëshiron tërë ditën dëshira të këqija, ndërsa i drejti bën lëmoshë dhe dhembshuron pa kursim. Flijime të pabesësh janë neveri për Zotin, sepse i ofrojnë kundër ligjit. Dëshmitari gënjeshtar do të vdesë, ndërsa burri i bindur do të flasë duke u përmbajtur. Burri i pabesë është me paturpësi në fytyrë, ndërsa i drejti, ai i kupton udhët e veta. Nuk ekziston urtësi, nuk ekziston burrëri,

nuk ekziston mendim tek i pabesi. Kali përgatitet për ditë lufte, por nga Zoti jepet ndihma. Është më e preferuar një emër i mirë sesa një pasuri e madhe, dhe më shumë se argjendi dhe ari i mirë. Një i pasur dhe një i varfër takuan njëri-tjetrin, por të dy Zoti i bëri. Një i zgjuar, kur pa një dinak të ndëshkohej, ai mëson fuqishëm, ndërsa të pamendët, meqë kaluan anës, u dëmtuan. Një brez urtësie, me frikë Zoti, do të ketë dhe pasuri, dhe lavdi, dhe jetë.

Le të drejtohet lutja ime dhe shërbesa e të Parashenjësuarave që mbetet.

### CITIME

Ngjallja e Llazarit: Joan 11.1-44  
Hyrja e Krishtit në Jerusalem, në ditën e Palmave: Matth. 21.1-11; Mark 11.1-10; Lluk. 19.28-38; Joan 12.22-15  
Llazarit i varfër dhe i pasuri: Lluk. 16.19-31

1. Joan 11.38-41
2. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
3. Is. 40.26; Ef. 6.10
4. Joan 11.7-8.16
5. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
6. Is. 11.1.10; Rom. 15.12; Apok. 5.5; 22.16
7. Zah. 9.9
8. I Mbret. [Sam.] 1.2,11
9. I Mbret. [Sam.] 2.1-2
10. Gjen. 2.9; 3.22,24; Fja. Urt. 3.18; Apok. 2.7; 22.2,14
11. Gjen. 2.16-17
12. Ps. 67(68).25
13. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
14. Lluk. 1.48-49
15. Dan. 6.18
16. Apok. 12.9; 20.2
17. I Petr. 5.8
- 18a. II Makk. 9.14; 15.14; III Makk. 6.5; Is. 52.1; 66.20; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 4; 9.24
18. Is. 66.1; Vep. 7.49
19. Kënga 1.8; 5.9,17(6.1)
20. Ps. 44(45).3
21. Joan 10.15,17-18
22. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
23. Dan. 2.34-35
24. Joan 1.18
25. II Kor. 8.9
26. Hebr. 13.12
27. Mark 9.44-48
28. Rom. 4.9-10,16; Hebr. 11.8
29. Rom. 8.35-39
30. Jakov 2.5



31. Ps. 108(109):21; 118(119):124

32. Num. 14.19 etj

33. Joan 10.40

34. Joan 21.17



## TË PREMTEN PARA PALMAVE NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve, Ali-  
luia dhe Triadiket e Tingullit të javës dhe,  
pas Stihologjisë së parë, Ndenjësove Kry-  
qësore të Tingullit të javës.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësove  
Ting. IV Tahi prokatálave*

Dërgohet një dyshe Nxënësish të sjell'  
një pulisht,\* siç është\* shkruar, mbi të do  
të hipë Zoti Krisht, që të vijë i bukur nur\*  
ta rregullojë himnin,\* lavd të hyshëm  
prej foshnjash;\* ndaj të nxitojmë shpejt  
ta mirëpresim me besë,\* t'i sjellim atij si  
palma vepra virtyti ne.

*Kryqhyjldësore*

O nënë e Zotit Krisht, o Virgjëreshë pa  
cen,\* një sapatë përshkoi shpirtin tënd<sup>1</sup>  
të shenjt' fort, kur pe tët Bir edhe Perën-  
di\* mbi dru të kryqëzohej\* me vullnetin  
e vet pra;\*<sup>2</sup> o e bekuar, mos pusho së  
luturi atë,\* që të na dhurojë ndjesë, o e  
panjollshme krejt.

*Pas Stihologjisë së tretë, Ndenjësove  
Ting. Tërth. IV Anestis ek nekrón*

Dërgohen sot dy Nxënës të sjellin puli-  
shtin\* për Zotin e të gjithave,<sup>3</sup> që vjen\*  
i hipur\* mbi shumë Serafime, shumicë  
engjëjsh, ndaj nis, fillon vdekja,\* Hadhi  
botësundues<sup>4</sup> që e ha çdo gjë, të frikëso-  
het fort.\* Ky u plaçkit, e humbi njerëzin'  
më parë me Llazarin.

*Kryqhyjldësore*

Me klithma, me vajtim e Dëlira mjaft  
qante\* kur ish prezente, tek pësonte keq\*  
i Biri:\* Ti pa pushim lëvdohesh me himne  
engjëjsh,<sup>5</sup> por – vaj! – si bij hebrenjsh,\* o  
Bir, të vunë para, që të gjykohesh kot nga  
Pilati<sup>6</sup> ti?\* Himnoj të madhen dhembshuri  
që ke dhe s'shprehet dot, o Fjalë.

*Psalmi 50. Prifti thotë uratën e zakonshme:  
O Perëndi, shpëtoje... Me mëshirën,  
dhembshurinë dhe... Kanuni i Mujorit dhe  
Triodet në vendin e tyre. Lexohet dhe Ode V  
biblike.*

*Triodi, poezi e Josifit  
Ode V  
Ting. IV  
Anátílón mi Kírie*

O Zot sundues, kur fjete mbi Kryq, vde-  
kjen e shndërrova në gjumë, sepse thë-  
rrisje: Shoku Llazar ka fjetur, por do të  
shkoj tani që ta zgjoj.

Duke përmbushur predikimet e profecive  
të profetëve, arrite, o Krisht i dhembshur,  
në qytetin profetvrasës<sup>7</sup> që të të vrasin  
vullnetarisht,<sup>2</sup> duke më shpëtuar nga pri-  
shja mua të varrin.

O eremitë dhe murgj të manastireve, që  
me vetëpërbajtje dhe lutje ia nënshtruat  
logjikës trupin që nuk sundohet lehtë, di-  
lini para Krishtit që ka hipur mbi pulisht  
dhe vjen për të pësuar.

*Hyjldësor*

Me pikat e mëshirës sate, vadite boll-  
shëm zemrën time të tharë nga flakëri-  
mi i mëkatit dhe ndize llambën e fikur të  
zembrës sime, o e Tërëpacenuar, portë e  
dritës.<sup>8</sup>

*Kanuni tjetër, poezi e Theodorit  
Ting. Tërth. IV  
Ton zofon tis psihis mu*

**O** Krisht, meqë do të arrish në Betani, dërgon dyshen e Nxënësve të tu që të të sjellin një pulisht mbi të cilin asnjë njeri nuk kishte hipur; sepse, veç teje, askush nuk i nënshtroi dot kombet e paglljikshme, o Shpëtimtar.

**U** mblodh shumicë judenjsh nga Jerusalemi në Betani dhe vuajnë me motrat e Llazarit sot; por, kur të nesërmen do të marrin vesh se ai do të kërcejë nga varri, do të aktivizohen për vrasjen e Krishtit.<sup>9</sup>

#### Lavdi *Triadik*

**O** Trini e tërëshnjtë, Atë, Bir dhe Shpirt tërëbërës, Hyjni e lumtur, esencë pa fillim, dritë e trishkëlqyer fort, pushtet tërëshikues plotësisht, ruaji shërbëtorët e tu.

#### Tani *Kryqhyjlindësor*

**O** Krisht, sapo të pa të karfosur me gozhdë si dhe gjakun e ujin që rrodhi nga brinja jote<sup>10</sup> e gjallë, nëna u plagos thellë prej dhembshurisë nënore, se të njohu si Birin e saj.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty. **J**a ku u përgatit Krishti që të shkojë në Jerusalem. Ejani tok, o murgj të gjithë në male dhe në shkretëtira, që ta mirëprisni ngazëllueshëm bashkë me tërë Krijesën nën qiell.

#### *Irmosi: Ton zofon tis psihis mu*

»Terrin e shpirtit tim shpërndaje, o Krisht, »Perëndi dritëdhënës, që flake errësirën »primitive të avushës;<sup>11</sup> dhe më dhuro »dritën e urdhrave të tu, që të të lavdëroj »duke mënguar,<sup>12</sup> o Fjalë.

#### *Ode VIII*

#### *Ji qe panta ta en afti*

**D**uke pasur mikeshë Ngjalljen dhe Jetën, o gra, pse vajtoni hidhur? Po vjen mirëbërësi i të gjithëve dhe do ta ringjallë mi-

kun e sinqertë, me ngjalljen e të cilit do të paralajmërojë ngjalljen e të gjithëve.

**O** shpella të murgjve, mblidhuni si qengja të arsyeshëm, që ta prisni me degë kryebariani Krisht;<sup>13</sup> Zoti vjen vullnetarisht,<sup>2</sup> që të theret si qengj,<sup>14</sup> për të hequr tiraninë e ujkut.

**K**ur ishe duke ardhur drejt Bethsfajisë, Hadhi dashakeq ndjeu zhurmën e këmbëve të tua, dhe prekte këmbët e Llazarit, duke thënë: Nëse do të të thërrasë Jeta,<sup>15</sup> mos u vono, por dil, se parandiej se së shpejti do të ndodhë katastrofa ime.

#### *Hyjlindësor*

**O** Virgjëreshë, zërat e hyjshëm të profetëve të predikojnë simbolikisht si portë,<sup>16</sup> mal,<sup>17</sup> tendë të shenjtë<sup>18</sup> dhe re drite,<sup>19</sup> nga e cila lindi dielli për ata që rrinin në errësirë dhe hije,<sup>20</sup> i vetmi Dritëdhënës.

#### *Tjetri: Ængjeli qe urani*

**D**yshja e Nxënësve, si u dërgua, udhëheq një kafshë ngarkuese për atë që ka hipur mbi re,<sup>21</sup> të cilin të gjitha e himnojnë dhe e përmbilartësojnë në gjithë jetët.

**K**rishti është para portave,<sup>22</sup> prandaj, o Betani, mos u zyfto, sepse zinë tënde e shndërron në gëzim,<sup>23</sup> duke ngritur prej varrit birin tënd, Llazarin, që e himnon atë.

Bekojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin (*Triadik*).

**P**ra, një Perëndi është Triadha, jo se Ati doli dhe u bë bir, as se Biri u shndërrua në dalje, por veç dhe bashkë të dy; i lavdëroj në jetë të tre si Perëndi, dritë.

#### Tani *Hyjlindësor*

**V**etëm ti je shtatzënë e paprishur; vetëm ti i jep gji foshnjës pa qenë lehonë; vetëm ti lind Krijuesin dhe Zotin tënd, me-



gjithëse je nënë dhe shërbëtoje; ty, o Në-  
në e virgjër, të himnojmë në jetë.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.  
**M**e bimët e virtyteve dhe, nga ana e  
jashtme, me degë le të përgatitemi të  
gjithë ta mirëpresim si të dyfishtë Kri-  
shtin që ka hipur në pulisht; atë e për-  
mbilartësojmë në gjithë jetët.

*Irmosi: Ængjeli qe urani*

»O engjëj<sup>24</sup> dhe qiej,<sup>25</sup> atë që ka hipur  
»mbi fron lavdi<sup>26</sup> dhe lavdërohet pa pu-  
»shim si Perëndi,<sup>5</sup> bekojeni, himnjeni  
»dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.

*Ode IX*

*Oti epiisë mi megalia*

**J**isu, thërrisje më parë: Ja ku po ngjitemi  
për në qytetin e shenjtë,<sup>27</sup> dhe do të dorë-  
zohem vërtet në duar vrasësish të ndyrë  
që të më vrasin mishërisht në Kryq.<sup>28</sup>

**O** Fjalë, duke dashur ta rrëmbesh nga  
vdekja mikun tënd, nxiton të vritesh në  
trup për ne vdekatarët, duke i bërë të  
pavdekshëm besimtarët, o i vetmi i pa-  
vdekshëm.

**P**alma mençurie le të tundim për Krishtin  
që u përul mishërisht në pulisht, dhe le t'i  
themi atij: I bekuar je, o Shpëtimtar, që  
erdhe për pësim.

*Hyllindësor*

**L**ehonia jote është e frikshme, o Hyllin-  
dëse, nënë e Krishtit; prandaj të lumë-  
rojmë besërisht dhe të lavdërojmë me  
nderime ne dhe gjeneratat e gjenerata-  
ve<sup>29</sup> në jetë.

*Tjetri: Ton prodhilothenta*

**U**tha Krishti Nxënësve kur në fund i dër-  
goi: \* Zgjidhni një pulisht për mua dhe  
sillmani t'i hipi, \* që t'i zgjidh kombet nga  
marrëzia, \* si Bir\* tek im Atë t'i nënshtroj

ato.

**H**ape portën, se Zoti vjen, Betani, pra-  
noje\* Perëndinë me besim, se arriti ta  
ringjallë\* që nga varri L Lazarin; i vetmi\*  
është ky\* pra i plotfuqishmi me pushtet.

*Lavdi Triadik*

**D**rita e trefisht' e pushtetit tënd, monar-  
kia,\* feks në mendjet tona fort mjaft  
shkëlqime, llamburitje,\* dhe na kthen  
nga mashtrimet e ndryshme,\* na sjell,\*  
Zot, në hyznizim ne bashkërisht.

*Tani Hyllindësor*

**G**az ki, o pallati i mbretit të Gjithësisë;\*  
mbretëritë qiellore u hapën përmes teje,\*  
Virgjëreshë Hyllindëse, për sa\* jemi\* për-  
mbi dhe, banojm' me engjëjt tok.

Lavdi më ty, o Perëndia ynë, lavdi më ty.  
**J**u që në shkreti dhe në male, dhe shpella  
ishit,\* erdhët; mblidhuni me ne, duke  
mbajtur degë palmash,\* që tok mbretin  
Zot ta mirëpresim,\* se vjen\* t'i shpëtojë  
shpirtrat tanë krejt.

*Irmosi: Ton prodhilothenta*

»Birin e Gjithnjëvirgjëreshës, të dekla-  
»ruar\* që më parë përmes ferrës me zjarr  
»te një llgjvënës\* mbi një maj<sup>30</sup> për shpë-  
»tim besëmirësh,\* Krishtin,\* pa pushim e  
»madhështojm' me himn.

*Fotogojiku i Tingullit të javës*

*Pasvargjet e Lavdërimeve*

*Ting. IV Idhiomeli, poezi e mbretit Leon*

**M**e qenëse i shpërfille, o shpirti im, ora-  
kujt hyjnorë, u bërë i lehtë për robërimin e  
djallëzive të armikut; përderisa me prirje  
vullnetare u dorëzove në prishje dhe u  
turbullove prej mëkatesh të shumta, e  
ndote veshjen e thurur prej Zotit dhe e bërë  
të pahijshme për dasmën mbretërore,<sup>31</sup>  
por, që të mos tërhiqesh bashkë me fajin

dhe të mos ulesh në tryezë i fshehur nën rrobën e pasioneve, dhe të mos mbash përgjegjësitë e hyrjes, dhe të mos hidhesh jashtë nusërores,<sup>31</sup> thirri Shpëtimtarit: O sy i frikshëm, që more atë që jam unë dhe nuk e le atë që ishe, dhe para Kryqit veshe mantel talljeje<sup>32</sup> për mua, grise thesin tim dhe më vish me ngazëllim,<sup>33</sup> dhe çliromë nga errësira më e jashtëme<sup>34</sup> dhe qarja e amshuar, dhe mëshiromë.

*Varg:* U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot, dhe u ngazëlluam dhe u dëfryem në gjithë ditët tona; dëfrefshim në vend të ditëve që na përulë, të viteve që pamë të këqija; dhe vështro mbi shërbëtorët e tu dhe veprat e tua, dhe udhëhiqi bijt' e tyre.

### *I njëjti*

*Varg:* Dhe qoftë shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, mbi ne; dhe veprat e duarve tona drejtoji te ne, dhe veprën e duarve tona drejtoje.

### *Martirik*

**O** popuj të tërë, le t'i nderojmë me himne dhe ode shpirtërore<sup>35</sup> athloforët e Krishtit, ndriçuesit e botës,<sup>36</sup> predikuesit e besimit, burimin e përhershëm nga gufojnë shërime për shpresëplotët. Me ndërmjetimet e tyre, o Krisht Perëndi, dhuroji botës sate paqen<sup>37</sup> dhe shpirttrave tanë përdëllimin e madh.<sup>38</sup>

### Lavdi *Idhiomeli*

#### *Ting. Tërth. IV*

**Si** e përbushëm Kreshmën dyzetditore, që është e dobishme për shpirtin, kërkujmë ta shohim edhe javën e shenjtë të pësimit tënd, o Njeridashës, që t'i lavdërojmë në të madhësitë e tua dhe Ekonominë tënde të parrëfyeshme për ne, duke kënduar me një shpirt: O Zot, lavdi më ty.

### Tani

#### *I njëjti*

*Lexuesi:* Është mirë ta lavdërojmë Zotin etj. si të hënën e parë në mëngjes (fq. 63).

*Në orën e Gjashtë (në Trihektë), Tropari i Profecisë.*

#### *Ting. III*

**O** Zot, i pafund është inati i kërcënimit tënd kundër mëkatarëve, dhe ne nuk jemi të denjë të shikojmë lart dhe të kërkujmë prej teje mëshirë; mos na shfaros me inatin tënd, as me mërinë tënde<sup>39</sup> ne që na gatove nga dheu me dorën tënde.<sup>40</sup>

### Lavdi *dhe* Tani

#### *I njëjti*

Proqimen. Ting. IV. Psalm 121.

Dëfrevë mbi ata që më kishin thënë: Le të shkojmë në shtëpinë e Zotit.

*Varg:* Për hir të shtëpisë së Zotit, Perëndisë tonë, kërkova të mira për ty.

### Këndimi i profecisë së Isaia

#### *(66.10-24)*

**D**ëfre, o Jerusalem, dhe bëni panair në të, gjithë ju që e doni; gëzohuni me hare së bashku me të sa mbani zi mbi atë, që të thithni dhe të mbusheni prej gjirit e ngushëllisë së tij, që, si ta mbaroni thithjen, të shijoni prej hyrjes së lavdisë së tij, sepse këto thotë Zot: "Ja ku unë kthehem tek ata si lumë paqeje dhe si përrua që përmbyt lavdi kombesh; fëmijët e tyre do të ngrihen mbi supe, dhe mbi gjunjë do të ngushëllohen; sikundër një nënë do të ngushëllojë dikë, po ashtu edhe unë do t'ju ngushëlloj dhe do të ngushëlloheni në Jerusalem; dhe do të shihni, dhe do të ngazëllohet zemra juaj, dhe kockat tuaja do të lindin si blerim". Dhe do të bëhet e njohur dora e Zotit tek ata që e kanë frikë dhe do të kërcënojnë të pabindurit.



Sepse ja, Zoti si zjarr do të vijë dhe si stuhi karrocat e tij, për të shkëmbyer në inat hakmarrjen e tij dhe zmbropsjen e tij në flakë zjarri, sepse në zjarrin e Zotit do të gjykohet tërë dheu dhe në shpatën e tij çdo mish; do të jenë shumë të plagosurit prej Zotit; ata që dëliren dhe pastrohen në kopshte dhe në pragje, që hanë mish derri dhe neveritjet, dhe miun, do të shka- tërrohen kolektivisht, tha Zoti. "Dhe unë i di punët e tyre dhe e njoh saktë mendimin e tyre. Po vij që t'i mbledh të gjitha kombet dhe gjuhët, dhe do të vijnë dhe do të shohin lavdinë time. Dhe do të lë mbi ta shenja, dhe do të dërgoj nga ata, të shpëtuar në kombe, në Tharsis dhe Fudh, dhe Ludh, dhe Mosoh, dhe në Thovel, dhe në Greqi, dhe në ishuj të largët, që nuk e kanë dëgjuar emrin tim, as e kanë parë lavdinë time, dhe do ta lajmërojnë lavdinë time në kombe. Dhe do t'i sjellin vëllezërit tuaj nga të gjitha kombet si dhuratë për Zotin me kuaj dhe karroca, në karro mushkash me tenda në qytetin e shenjtë Jerusalem", tha Zoti, "që të m'i sjellin mua bijtë e Izraelit theroret e tyre, me psalme, në shtëpinë e Zotit; dhe nga ata do të marr për mua priftërinj dhe levitë", tha Zoti. "Sepse, si mbetet para meje i ri qielli dhe e re toka, të cilat unë i bëj", thotë Zoti, "kështu do të qëndrojnë fara juaj dhe emri juaj. Dhe do të jetë muaj nga muaji dhe e shtunë nga e shtuna, do të vijë çdo mish që të falet para meje në Jerusalem", tha Zoti. "Dhe do të dalin dhe do t'i shohin kofshët e njerëzve që shkelen në mua; sepse krimbi i tyre nuk do të mbarojë dhe zjarri i tyre nuk do të shuhet, dhe do të jenë në pamje për çdo mish".

Proqimen. Ting. Tërth. II. Psalm 122.

Mëshirona, o Zot, mëshirona.

*Varg:* Ngrita sytë e mi drejt teje.

## TË PREMTEN PARA PALMAVE NË MBRËMËSORE

*10 Thirrto*

*Ting. Tërth IV Idhiomeli*

**S**i e përbushëm Kreshmën dyzetditore, që është e dobishme për shpirtin, kërkojmë ta shohim edhe javën e shenjtë të pësimt tënd, o Njerëdashës, që t'i lavdërojmë në të madhësitë e tua dhe Ekonominë tënde të parrëfyeshme për ne, duke kënduar me një shpirt: O Zot, lavdi më ty. (2x)

*Martirike*

**O** martirë Zoti, përgjërojni Perëndisë tonë dhe kërkojini për shpirtat tanë shumicë dhembshurish<sup>41</sup> dhe zbutje për shkeljet e shumta, lutemi.

*Idhiomele të Shën Llazarit,*

*poezi e mbretit Leon*

*Ting. Tërth. II*

**O** Zot, meqë doje ta shihje varrin e Llazarit, ti që kishe për të banuar vullnetarisht në varr,<sup>2</sup> pyete "Ku e keni vënë atë?". Dhe, kur e mësove atë që dije, i thirre atij që deshe shumë: "Llazar, eja jashtë!". Dhe iu bind i pafrymi atij që i jep frymë, pra ty, Shpëtimtarit të shpirtave tanë. (2x)

**O** Zot, erdhe në varrin e katërditëshit, në vendin ku u varros Llazar; dhe, pasi e spërkate me lot për mikun, e ngrite të vdekurin katërditësh ti, kalliri i jetës;<sup>42</sup> ndaj vdekja u lidh me zë, shpërgënjtë u zgjidhën si me duar; atëherë grupi i Nxënësve u mbush me gëzim, dhe nga të gjithë bëhej shërbesë me një zë: I bekuar je, o Shpëtimtar, mëshirona. (2x)

**O** Zot, zëri yt i shkatërroi mbretëritë e Hadhit, dhe fjala e pushtetit tënd ngriti nga varri një katërditësh, Lllazarin, i cili u bë preludi shpëtimtar i rilindjes; të gjithë

tha janë të mundshme për ty,<sup>43</sup> mbretin e të gjithave, o Sundimtar;<sup>44</sup> dhuroju shërbëtorëve të tu zbutjen dhe përdëlimin e madh.<sup>38</sup>

**O** Zot, meqë doje t'ua vërtetoje Nxënësve të tu ngritjen tënde nga të vdekurit, arrite në varrin e Llazarit; dhe, sapo i thirre, Hadhi u plaçkit dhe e lëshoi katërditëshin që të thërriste: O Zot i bekuar, lavdi më ty.

**O** Zot, pasi more me vete Nxënësit e tu, arrite në Betani që ta ngrije Llazarin; dhe, pasi lotove për të, sipas ligjit të natyrës njerëzore, si Perëndi e ngjalle këtë katërditësh, Shpëtimtar, dhe të thërriste: O Zot i bekuar, lavdi më ty.

#### Lavdi *Ting. Tërth. IV*

**K**ur qëndrove pranë varrit të Llazarit, o Shpëtimtari ynë, dhe, si i thirre të vdekurit, e ngrite si prej gjumit; dhe ai e hodhi larg prishjen me anën e frymës së pavdekësisë dhe pikërisht me fjalën doli i lidhur me shpërgënj; mundesh t'i bësh të gjitha,<sup>43</sup> të gjitha janë nën sundimin tënd, të gjitha të nënshtrohen ty, o Shpëtimtari ynë njeridashës; lavdi më ty.

#### Tani *Injëti*

##### *E Andreas së verbër*

**P**ërderisa e pëmbushëm Kreshmën dyzetdore, që është e dobishme për shpirtin, le të thërrasim: Gëzohu, o qytet Betani, vendlindje e Llazarit. Gëzohuni, Marta dhe Maria, motrat e tij, nesër arrin Krishti që t'i japë jetë përmes fjalës vëllait të vdekur; sapo ta dëgjojë zërin e tij, Hadhi i hidhur dhe i pangopur, pasi do të trembet nga frika dhe do të rënkojë shumë, do ta lëshojë Llazarin e shtrënguar me shpërgënj; bashkësia e hebrenjve, duke e shikuar, do të çuditet dhe do t'i dalë para me palma dhe dafina; dhe do të shfaqen fë-

mijë ta mburrin atë që e kanë zili etër. I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit, mbreti i Izraelit.

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Prifit:* Mbrëmje!

*Lexuesi:* Proqimën. *Ting. Tërth. II.* Psalm 123. Ndihma jonë është në emrin e Zotit.

*Varg:* Nëse nuk do të ishte Zoti me ne, le të thotë pra Izraeli.

#### Këndimi i Gjenezës

(49.33-50.26)

**J**akovi pushoi së lëni amanete bijve të tij dhe, pasi i ngriti këmbët e tij mbi krevat, mbaroi dhe u shtua drejt popullit të tij. Dhe Josifi, si ra mbi fytyrën e të atit, qau për të dhe e puthi. Dhe Josifi i urdhëroi shërbëtorët e tij, varrmihësit *balsamues*, që ta varrosnin atin e tij; dhe varrmihësit e varrosën Izraelin. E i pëmbushën dyzet ditët e tij, sepse kështu numërohen ditët e varrimit. Dhe Egjipti mbajti zi për të shtatëdhjetë ditë. Dhe, kur kaluan ditët e zisë, Josifi foli drejt sundimtarëve të Faraonit duke thënë: "Në qoftë se kam gjetur hir para jush, flisni për mua në veshët e Faraonit duke thënë: 'Ati im më vuri në be duke thënë: Në varrin që gërmova për veten time, në tokën Kanaan, atje të më varrosësh'. Pra tani, si të ngjitem, do të varros atin tim dhe do të kthehem". Dhe Faraoni i tha Josifit: "Ngjitu, varrose atin tënd, sikurse të vuri në be". Dhe Josifi u ngjit që të varrose të atin, dhe u ngjitën bashkë me të të gjithë shërbëtorët e Faraonit, dhe pleqtë e shtëpisë së tij, dhe të gjithë pleqtë e tokës së Egjiptit, dhe gjithë tërësia e shtëpisë së Josifit, dhe vëllezërit e tij, dhe gjithë shtëpia e tij atërore; dhe farefisninë e tij *fëmijërore*, dhe dhentë, dhe qetë i lanë në tokën Jesem. Dhe u ngjitën tok me të edhe karroca, edhe kalorës, dhe reparti



u bë tejet i madh. Dhe arritën në lëmin Atadh, që është përtej Jordanit. Dhe ia bëri zinë atit të tij shtatë ditë. Dhe e panë banorët e tokës Kanaan zinë mbi lëmin Atadh dhe thanë: "Kjo është zi e madhe për egjiptianët". Prandaj e quajti emrin e tij "Zi Egjipti", që është përtej Jordanit. Dhe ia bënë atit kështu bijtë e tij, dhe e morën bijtë e tij në tokën Kanaan dhe e varrosën në shpellën e dyfishtë, që e mori në pronësi Abrahami, shpellën që mori për varr nga Efron hiteu, përballë Mamvrisë. Dhe Josifi u kthye në Egjipt, ai dhe vëllezërit e tij, dhe ata që u ngjiten bashkë që të varrosnin atin e tij. Dhe, pasi panë se ati i tyre vdiq, vëllezërit e Josifit thanë: "Mos vallë do të mbajë mëri kundër nesh Josifi dhe do të na shpaguajë si shpajim të gjitha të këqijat që i treguam atij". Dhe, pasi arritën drejt Josifit, thanë: "Ati yt na vuri në be para se ai të mbaronte, duke thënë: 'Kështu thojni Josifit: Falua drejtësinë dhe mëkatin e tyre se të treguan dinakëri'. Dhe tani pranoje drejtësinë e shërbëtorëve të Perëndisë së atit tënd". Dhe Josifi qau kur ata flisnin drejt tij. Dhe, si erdhën drejt tij, thanë: "Ja, ne jemi skllëvërit e tu". Dhe Josifi u tha: "Mos kini frikë, sepse unë jam i Perëndisë. Ju menduat kundër meje për të këqija, por Perëndia mendoi për mua për të mira, që të bëhet si sot, dhe të ushqehet shumë popull". Dhe u tha atyre: "Mos kini frikë, unë do t'ju ushqej ju dhe shtëpitë juaja"; dhe i ngushëlloi dhe foli në zemrën e tyre. Dhe Josifi banoi në Egjipt, ai dhe vëllezërit e tij dhe gjithë tërësia e shtëpisë së atit të tij. Dhe Josifi jetoi njëqind e dhjetë vjeç. Dhe Josifi pa bijtë e Efraimit gjer në gjeneratën e tretë, dhe bijtë e Mahirit, birët të Manasiut, lindën mbi kofshët e Josifit. Dhe Josifi u tha

vëllezërve të tij duke thënë: "Unë po vdes, por Perëndia do t'ju vizitojë në vizitë dhe do t'ju ngjitë nga kjo tokë në tokën për të cilën iu betua Perëndia etërve tanë, Abrahamit, Isaakut dhe Jakovit". Dhe Josifi i vuri të betoheshin bijtë e Izraelit, duke thënë: "Në vizitën, në të cilën do t'ju vizitojë Perëndia, dhe do t'i mbartni me vete eshtrat e mia nga këtej". Dhe Josifi vdiq njëqind e dhjetë vjeç. Dhe e varrosën dhe e vunë në një varr në Egjipt.

Proqimen. Ting. IV. Psalm 124.

Ata që kanë besim mbi Zotin, janë si mal Sion.

*Varg:* Nuk do të lëkundet në jetë ai që banon në Jerusalem.

Këndimi i Fjalëve të Urta

(Mas. 31.8--31)

**Bir,** hape gojën tënde në fjalë Perëndie dhe gjykoji të gjithë shëndetshëm. Hape gojën tënde dhe gjyko drejt, dhe gjyko të varfër dhe të pafuqishëm. Grua burrenshë kush do të gjejë? Një e tillë është më e çmuar se gurët e çmuar. Zemra e burrit të saj ka guxim mbi të, një e tillë nuk do të mbetet pa plaçka të mira, sepse gjatë gjithë jetës bën të mira për hir të burrit. Duke tjerë lesh dhe li me duart e saj, bëri gjë të dobishme. U bë si anije që tregton nga larg, dhe mbledh paturinë e saj. Dhe ngrihet qëmenatë dhe i dha ushqime shtëpisë dhe punë shërbëtorëve. Pasi pa një arë, e bleu dhe nga frytet e duarve të saj mbolli plotësisht pronën. Si e ngjeshi fort mesin e saj, i mbështeti krahët e saj në punë. Shijoi se puna është e mirë dhe llamba e saj nuk fiket tërë natën. Parakrahët e saj i vendos mbi të dobishmet, ndërsa duart e saj i mbështet në furkë. Duart e saj i hapi tek i varfri, dhe i zgjati frutë të vobektit.

Burri i saj nuk kujdeset për sa janë në shtëpi, kur vonohet diku, sepse të gjithë ata që janë pranë saj, janë të veshur. Dy palë pallto bëri për burrin e saj, ndërsa rroba nga liri i çmuar dhe purpuri për veten. Dhe i shkëlqyeshëm bëhet burri i saj në porta, kur do të ulet në këshill së bashku me pleqtë, baronët e tokës. Bëri çarçafë dhe ua dha fenikasve dhe breza kananeasve. Veshi fuqi dhe hijeshi, dhe dëfreu në ditët e fundme. Gojën e saj e hapí me kujdes dhe ligjërisht, dhe gjuhës së saj i vuri rregull. Janë të thata banimet e shtëpisë së vet, dhe ushqime përtace nuk hëngri. Dhe ajo e hap gojën urtësisht dhe ligjërisht, ndërsa lëmosha e saj i ngri-ti fëmijët e saj dhe u pasuruan, dhe burri i saj e lavdëroi: "Shumë bija fituan pasuri, shumë bënë fuqi, por ti je më sipër dhe u lartësove përmbi të gjitha". Janë të gënjeshtertë pëlqimet dhe e rreme bukuri gruaja, sepse gruaja e mençur bekohet, dhe frikën e Perëndisë ajo le ta himnojë. Jepini asaj nga fryti i buzëve të saj dhe le të himnohet në porta burri i saj.

Le të drejtohet lutja ime dhe shërbesa e të Parashenjtuarave që mbetet.

## NË PASDARKËN E VOGËL

(Sonte bëhet e Vogla dhe menjëherë pas të meriton dhe para Trishenjtit etj., psalim këtë):

*Kanun, poezi e Andreas së Kretës*

*Ting. I*

*Ode I*

*Irmosi: Odhin epinikion*

»Një ode triumfi të gjithë t'i psalim ne  
»Zotit, që bëri mrekulli mahnitëse<sup>45</sup> me  
»krahun shumë të lart<sup>\*46</sup> dhe e shpëtoi  
»Izraelin; u lëvdua fort.

**O** Shpëtimtari im, e çlirove nga prishja kur me krah të lartë<sup>46</sup> e ngrite një të vdekur katërditësh, Lllazarin, dhe e tregove, si i fuqishëm, autoritetin tënd.

**S**apo i thirre Lllazarit nga varri, menjëherë e ngjalle, por Hadhi poshtë vajtonte hithur dhe, duke psherëtirë, trembej nga autoriteti yt, o Shpëtimtar.

**L**otove, o Zot, për Lllazarin, duke treguar mishërimin e Ekonomisë sate dhe se, ndonëse je Perëndi nga natyra, u bërë në natyrë njeri sipas nesh.

**I** pushove, o Zot Shpëtimtar, lotët e Martës dhe të Marisë, sapo e ngjalle Lllazarin nga të vdekurit dhe e tregove me frymë të vdekurin me anën e fuqisë sate.

**S**ipas ligjit të natyrës njerëzore, o Zoti Shpëtimtar, pyete "Ku është vënë Lllazari?", duke ua treguar të gjithëve të pabastarduar Ekonominë tënde për ne.

**I** dërmovë llozet e Hadhit atëherë kur i thirre Lllazarit dhe e tunde pushtetin e armikut, dhe e binde të të trembej që para Kryqit, i vetmi Shpëtimtar.

**O** Zot, si Perëndi arrite dhe e zgjidhe nga prangat Lllazarin, që mbahej i burgosur prej Hadhit, sepse nga urdhri yt zbrapsen të gjitha, o i fuqishëm.

Lavdi *Triadik*

**L**e ta lavdërojmë Atin, Birin dhe Shpirtin, Trininë e pandarë në Njësi natyre, dhe së bashku me engjëjt le ta himnojmë si një Perëndi të pakrijuar.

Tani *Hyjllindësor*

**K**ishe në bark, pa ndryshim, nga Shpirti i Shenjtë dhe me mirëdashjen e Atit, o Nënë e virgjër, Krijuesin e natyrës, i cili u bë ajo që jemi ne, pa ndryshim dhe përzjerje.



## Ode II

*Irmosi: Prôsehe urané qe laliso*

»Ki kujdes, ti, o qiell, do flas<sup>47</sup> un' dhe do  
»himnoj Zotin Krisht, shpëtimtarin e bo-  
»tës,<sup>48</sup> të vetmin njeridashës.

Lavdi ty që, vetëm sa i thirre, e ngrite nga  
varri të vdekurin katërditësh, mikun Lla-  
zar.

E dëgjoji zërin tënd i pafrymi dhe, si u gja-  
llërua, u ngrit menjëherë nga të vdekurit,  
duke të lavdëruar, o Zot.

O Shpëtimtari im, Llazari erëkeq u ngrit  
prej varrit sapo mori urdhrin nga zëri yt  
jetëprurës.

O Shpëtimtari im, duke na siguruar se  
e veshe natyrën tonë, lotove për mikun  
tënd dhe e ngjalle atë.

U tremb Hadhi sapo pa të kthehej sakaq,  
përmes zërit, drejt jetës së këtushme i  
lidhuri me shpërgënj.

Lavdi

U habitën bashkësitë e hebrenjve, o  
Shpëtimtar, kur i thirre dhe e ringjalle me  
fjalë Llazarin që lëshonte erë.

Tani

U tundën dhomat e Hadhit kur gjallëro-  
hej poshtë në moment Llazari, atëherë,  
me zërin e gjallëruesit.

## Ode III

*Irmosi: Lithon on apedhokimasan*

»Gurin që e poshtëruan ndërtuesit, ja  
»ku vet\* është bër' gur qosheje,<sup>49</sup> ky pra,  
»është guri\* përmbi të cilin Krishti\* forcoi,  
»bazoi Kishën ton'<sup>50</sup> që bleu, Kishën e  
»tij,\* që e ka blerë prej gjith' kombeve. (2x)

Çudi e huaj dhe paradoksale! Si krijuesi i  
të gjithave<sup>50a</sup> pyeste, sikur nuk e dinte, për  
atë që e dinte? Ku dergjet ai që e qani?

Ku u varros Llazari të cilin pas pak do t'jua  
ngre unë të ngjallur nga të vdekurit.

Jisui, pasi i urdhëroi ta lëviznin gurin ata  
që ta rrokullisën kur të varrosën, menjë-  
herë të ngjalli kur të thirri: Lllazar, ngjallu,  
eja tek unë që të frikësohet Hadhi nga  
zëri yt.

O Zot, Marta dhe Maria thërrisnin me vaj:  
"Shih, ai që e deshe, ka katër ditë që ka  
vdekur dhe lëshon erë të keqe; nëse do  
të ishte këtu atëherë, nuk do të vdiste Lla-  
zari". Por ti, si i panxënshëm asgjëkund, i  
thirre dhe në çast e ngjalle atë.

Nga Ekonomia, meqë derdhe lot për mi-  
kun tënd, e tregove mishin që more prej  
nesh, se u bashkua me ty në esencë, jo  
në fantazi, o Shpëtimtar; dhe, si Perëndi  
njeridashës, sapo i thirre, menjëherë e  
ngrite atë.

"Mjerë! Me të vërtetë tani u shkatërro-  
va!". Duke thirrur kështu, Hadhi u drejtua  
te vdekja dhe thoshte: "Ja, nazaretasi  
tundi të poshtmet dhe, si e preu barkun  
tim, thirri një të vdekur pa frymë dhe e  
ngriti".

Ku është marrëzia e hebrenjve? Ku pa-  
besia? Deri kur, o mashtrues? Deri kur, o  
bastardë? Shikoni të vdekurin të kërcejë  
përmes fjalës dhe nuk besoni te Krishti?  
Me të vërtetë jeni bij të errësirës që të  
gjithe ju!

Lavdi *Triadik*

Të di si një nga Triadha edhe pse u mishë-  
rove, dhe lavdëroj një Bir të mishëruar,  
i cili lindi pa farë prej Perëndilindëses  
dhe lavdërohet bashkë me Atin dhe me  
Shpirtin.

Tani *Hyllindësor*

Vizioni, të cilin e parashikonin profetët  
nga Ekonomia, është i huaj dhe i frikshëm:

Një Virgjëreshë Hyjlindëse me barrë pa farë, do të lindte pa prishje Perëndinë dhe do të mbetej e dëlirë pas lindjes.

#### Ode IV

*Imrosi: Epirthi o ilios*

»U ngrit dielli dhe hëna qëndroi në rëndin  
»e saj.<sup>54</sup> U lartësove mbi dru, o Zemërgjerë,  
»dhe fiksove në të Kishën tënde.

**O** Zot, lotove për Llazarin, duke treguar se ishte njeri; dhe e ngrite, o Sundimtar, të vdekurin, dhe u tregove popujve se ishte Biri i Perëndisë.

**I** pafrymi e dëgjoji urdhrin tënd "Llazar, eja jashtë!"; u ngrit, vrapoi me shpërgënj dhe kërcente, o i Mirë, duke treguar pushtetin tënd.

**O** Krisht Perëndi, i pushove lotët e Martës dhe të Marisë kur i thirre Llazarit; e ngrite me pushtetin tënd përmes zërit, dhe ai t'u fal ty.

**E**dhe pse lotove si njeri për Llazarin, e ngrite si Perëndi; pyesje: "Ku u varros katërditëshi?", duke vërtetuar, o i Mirë, një-rëzimin tënd.

**M**eqenëse deshe, o i Mirë, të na i bëje të njohura simbolet e pësimit dhe të Kryqit tënd, pasi e çave barkun e pangopur të Hadhit, si Perëndi e ngjalle katërditëshin.

**K**ush di, kush dëgjoji, se u ngjall njeri i vdekur me erë të keqe? Ilia<sup>52</sup> dhe Eliseu ngritën,<sup>53</sup> por jo nga varri, as katërditësh.

**E** himnojmë, o Zoti Krisht, pushtetin tënd, i himnojmë dhe pësimet e tua; përmes të parit bëje çudi si i dhembshur, ndërsa të dytat i zgjodhe si njeri sipas Ekonomisë.

**J**e Perëndi dhe njeri, dhe i vërtetove emrat falë gjërave; qëndrove mbi varr mishërisht, Fjalë, dhe si Perëndi e ngrite

katërditëshin.

**O** Zot, u shtangën bashkësi hebrejsh sa-po panë të ngjallur sakaq me zërin tënd një të vdekur, Llazarin, por nuk u bindën nga mrekullitë e tua.

#### Lavdi Triadik

**P**a mot shkëlqeve nga Ati yt si njëri nga Trinia, o Shpëtimtar; në mot dole prej gjakrash virgjërore nga Shpirti, pasi more mish ti, i përbisubstancshmi.

#### Tani Hyjlindësor

**Z**ënia e Hyjlindëses ishte pa farë, lindja pa pësim prishjeje, sepse, pasi Perëndia i bëri që të dyja si çudi, e boshatisi veten<sup>54</sup> që të bashkohej me ne.

#### Ode V

*Imrosi: Tin sin irinin dhos imin*

»**O** Bir i Perëndisë, na jep paqen tënde, »sepse veç teje nuk njohim ndonjë tjetër »Perëndi; emrin tënd e thërrasim,<sup>55</sup> se je »Perëndi të gjallësh dhe të vdekurish. (2x)

**O** Zot, meqenëse je jetë<sup>15</sup> dhe dritë<sup>8</sup> e vërtetë, kur i thirre Llazarit të vdekur, e ngjalle; si i fuqishëm, u tregove të gjithëve se je Perëndi të gjallësh dhe të vdekurish.

**O** Jisu, Hadhi që priti shumë veta, u frikësua ngaqë nuk duroi dot urdhrin tënd kolosal, dhe tok me zërin e ngjalle Llazarin, ndonëse kishte vdekur që prej katër ditësh.

**O** Fjalë, bashkove dheun me frymë, kur qëmoti i dhe jetë baltës me frymë shpirti<sup>56</sup> përmes fjalës sate, pra dhe tani me fjalë e ngrite një mik nga prishja dhe të nëndheshmet.

**N**ë shenjë tënde, o Zot, askush nuk kundërshtoi, sepse, kur i thirre të vdekurit Llazar, menjëherë i pafrymi u ngrit dhe,



pa mbajtur prangat, ecte më këmbë.

**O** marrëzi e judenje! O zemërgurtësi e armiqve! Kush pa ndonjë të ketë ngritur nga varri një të vdekur? Ilia qëmoti ngjalli, por jo nga varri, as ndonjë katërditësh.<sup>52</sup>

**O** zemërgjerë i paimagjinueshëm, që i bën të gjitha si Perëndi për ne dhe pëson si njeri, bëna ne të gjithë pjesëmarrës të mbretërisë sate me ndërmjetimet e Lazarit.

Lavdi *Triadik*

**O** Trini e parapafillim, e bashkëpafillim, e njënderuar, Atë i tërëpushtetshëm, Bir, Shpirt i Shenjtë, Njësi e Shenjtë trihipostate, shpëtoji të lindurit nga Adami, të cilët të përhimnojnë besërisht.

Tani *Hyjlindësor*

**O** e Dëllirë, barkun tënd të pacenuar e shenjtëroi, kur mori prej teje mish, Përmbiperëndia, të cilit i falemi në Trini, Fjala që lindi nga Ati, Perëndi tok edhe me Shpirtin.

*Ode VI*

*Irmosi: Apërripsás me is vathi*

»**O** Shpëtimtar, më hodhe në thellësitë »e zemrës së detit<sup>57</sup> dhe më shpëtove nga »skllavëri vdekjeje, dhe i zgjidhe prangat »e paudhësive të mia.<sup>58</sup> (2x)

**O** Shpëtimtar, pyete ku jam ti që i di të gjitha,<sup>58a</sup> lotove për mua si njeri nga natyra, dhe mua të vdekurin më ngrite me urdhrin tënd.

**T**hërret Lazari drejt teje, shkatërruesit të Hadhit: O Shpëtimtar, më thirre nga Hadhi më i poshtëm dhe më ngrite mua të vdekurin me urdhrin tënd.

**O** Shpëtimtar, më veshe me trup balte dhe më fryve jetë,<sup>56</sup> dhe unë e pashë dritën tënde, dhe më ngrite mua të vdekurin

me urdhrin tënd.

**O** Shpëtimtar, e gjallërove ti pamjen e pafymë të mishit tim,<sup>56</sup> më fiksove me kocka dhe nerva, dhe më ngrite mua të vdekurin me urdhrin tënd.

**O** Shpëtimtar, pasi e çave barkun hamës të Hadhit, më rrëmbeve me pushtetin tënd dhe më ngrite mua të vdekurin me urdhrin tënd.

**O** Shpëtimtar, e veshe tërë brumin tim, ndërsa e ruajte të dëllirë mitrën e pacenuar nga ku dole i mishëruar, megjithëse je një prej Triadhës.

Lavdi *Triadik*

**O** Trini e Shenjtë, e lavdëroj dhembshurinë tënde dhe bashkë me engjëjt e himnoj himnin trishenjtor,<sup>59</sup> mëshiroji shpirtrat e neve që të përhimnojmë.

Tani *Hyjlindësor*

**U** fut Fjala në barkun tënd të pacenuar, o Hyjnënë, dhe e mbajti të kulluar përsëri pas lindjes; çudi vërtet paradoksale!

*Ode VII*

*Irmosi: Tus en kamino Pedhas su*

»**O** Shpëtimtar, Djemtë e tu në kaminë »nuk i preku as i shqetësoi zjarri; atëherë »të tre si me një gojë himnonin dhe be- »konin duke thënë: I bekuar je, o Perëndi »i etërve tanë.<sup>60</sup>

**O** Shpëtimtar njeridashës, lotove për një të vdekur, që t'u tregosh popujve të tërë se, ndonëse je Perëndi, u shfaqe si njeri për ne, dhe lotove vullnetarisht duke na vënë para shembuj të dashurisë së thellë.

**O** Shpëtimtar, sapo e dëgjoji poshtë zërin tënd Lazari katërditësh, u ngrit, të përhimnoi dhe, i ngazëlluar, thërriste kështu: Ti je Perëndia dhe Krijuesi im; të falemi

dhe të himnoj ty që më ngjalle.

**O** Çlirimtar, Llazar, nga poshtë, thërriste: O Shpëtimtar, edhe pse shtrëngohem nga prangat, por në asnjë mënyrë nuk do të mbetem në barkun e Hadhit, në qoftë se vetëm më thërret "O Llazar, eja jashtë!", sepse ti je drita dhe jeta ime.

**Thotë:** Të lutem, Llazar, ngrihu, dil shpejt nga llozet e mia, pra ik; sepse është më mirë për mua që të qaj për një që më hiqet hidhur, sesa për të gjithë ata që më parë i përpiva i uritur.

**Thotë:** Pra, pse vonon, o Llazar? Duke qëndruar jashtë, miku yt thërret: "Eja jashtë!". Dil pra, që dhe unë të lehtësohem, sepse që atëherë që të hëngra, m'u zëvendësua ushqimi me të vjellat.

**Hadhi,** duke qarë, thërriste nga poshtë: Pse nuk ngrihesh shpejt, o Llazar? Pse nuk ngrihesh sakaq dhe nuk vrapon që këtej, që Krishti, pasi të të ngjallë, të mos të më robërojë dhe të tjerë?

**O** Zoti Krisht, u bëre i çuditshëm meqë kreve atëherë mrekulli të shumta: të verbërve u dhe dritë, me fjalë hape veshët e të shurdhërve<sup>61</sup> dhe, kur si Perëndi i thirre mikut Llazar, e ngrite nga të vdekurit.

#### Lavdi *Triadik*

**Le** të himnojmë me ode trinisore, duke lavdëruar Atë pa fillim, Bir dhe Shpirt të drejtë, një esencë unike, të cilën le ta himnojmë trefish: Shën, Shën, Shën je,<sup>59</sup> o Triadhë.

#### Tani *Hyjlindësor*

**O** Jisu Krisht, të lavdërojmë si një nga Trinia, sepse, pasi u mishërove nga një e Virgjër pa ndryshim, i durove të gjitha si njeri, duke mos dalë nga natyra atërore, megjithëse u bashkove me ne.

#### *Ode VIII*

##### *Irmosi: I urani ton uranôn*

»Qiejt e qiejve dhe uji më sipër se qiejt,<sup>62</sup> »bekojeni, himnojeni Zotin.<sup>25</sup>

**Bërësi** dhe mbajtësi i të gjithave, arriti nga dhembshuria në Betani dhe e ngriti Llazarin.

**O** Zot, kur i thirre katërditëshit që lëshonte erë të keqe dhe që qe i lidhur me shpërngënj, ai, i pafrymi, kërcente i gjallë.

**O** Krisht, populli i judenjve u inatos kur e pa katërditëshin që u ngjall me zërin tënd.<sup>9</sup>

**O** judenj të ertësuar për sa i përket dritës, pse s'besoni për ngritjen e Llazarit? Kryevepra është e Krishtit.

**Le** të ngazëllohet Sioni dhe le ta himnojë Jetëdhënësin, i cili me fjalë e ngriti nga varri Llazarin.

**O** Shpëtimtari im, ushtritë e qiejve dhe fisi i të dhelindurve të himnuan, sepse e ngrite Llazarin.

#### Lavdi *Triadik*

**Lavdëroj** së bashku me Atin, edhe Birin, edhe Shpirtin dhe, duke himnuar pareshtur, thërras: O Trishenjt, lavdi më ty.

#### Tani *Hyjlindësor*

**Të** bekuj dhe të falem ty që linde nga Virgjëresha dhe nuk u ndave prej frontit të lavdisë sate të shenjtë.

#### *Ode IX*

##### *Irmosi: Eptise kratos*

»Rrëfeu forc' Krishti\* përmes krahut të »tij krejt,\* përmbysi të fuqishmit pra prej »fronesh,\* i ngriti të mjerët lart\*<sup>63</sup> – Izraeli e ka Zot –\* dhe na vizitoi<sup>64</sup> me këto:\* »ky është lindje nga lart\* dhe na çoi ne »në udhën e paqes shenjtë.<sup>65</sup>



Le ta himnojë çudinë Betania tok me ne, sepse në të Krijuesi lotoi sipas ligjit të natyrës së mishit dhe e ngjalli Llazarin; dhe, si i ndali lotët e Martës, e shndërroi në gëzim qarjen e Marisë, se e ngriti të vdekurin.

O Fjalë, që ta vërtetoje ngjalljen tënde, i thirre Llazarit nga varri dhe e ngrite si Perëndi, që t'u tregojë popujve se je me të vërtetë Perëndi dhe njeri bashkë, dhe se ngrite një tempull, atë të trupit tënd.<sup>66</sup>

Tunde porta dhe shula të hekurit,<sup>67</sup> e trembe Hadhin me zërin tënd, dhe u frikësua tok me të edhe vdekja menjëherë, sapo e panë Llazarin, të burgosurin e tyre, që mori jetë përmes zërit, dhe u ngrit, o Shpëtimtar.

O Shpëtimtar, u shtangën të gjithë kur të panë që lotoje për Llazarin që vdiq, dhe të këqijtë thoshin: "Shih sa e do!". Në çast pra i thirre dhe i pafrymi, si u ngrit, e hoqi prishjen me urdhrin tënd.

U lëkundën portat, u dërrmuan shulat,<sup>67</sup> u zgjidhën prangat e të vdekurit ndërsa Hadhi, nga zëri i fuqisë së Krishtit, rënkoj hidhur dhe thërriste: Mjerë! I kujt është dhe nga vjen ky zë që gjallëron të vdekur?

Meqë dëgjove një zë, ngrihu që aty, se miku yt të thërret përjashta; ky është ai që më parë i ngriti të vdekurit; Ilija ngjalli një të vdekur<sup>52</sup> dhe Eliseu<sup>53</sup> gjithashtu, por vetë ai ishte që fliste dhe vepronte nëpërmjet tyre.

O Fjalë, himnojme forcën tënde të pamagjinueshme, se me kocka dhe nerva e ngrite të vdekurin përmes fjalës sate si Gatues<sup>40</sup> i të gjithave; e ngrite nga të nëndheshmet porsi birin e vejushës, i cili ishte shtrirë në krevat,<sup>68</sup> o Shpëtimtar.

### Lavdi *Triadik*

O Trini e Tërëshenjtë, Atë i pafillim, Perëndi, Bir i bashkëpafillim, Fjalë hyjnore, Ngushëllimtar i mirë, Shpirt i Shenjtë Perëndie, një dritë dhe trediellore, esencë e bashkëmbirë, një Perëndi dhe Zot, dhembshuroje botën.

### Tani *Hyjlindësor*

O Jisu, i bërë të gjitha me urtësi,<sup>69</sup> dhe më veshe mua të tërin prej Virgjëreshës, dhe je përgjithmonë i tëri në gjirin e Atit;<sup>70</sup> pasi ta dërgosh Shpirtin tënd të Shenjtë poshtë mbi grigjën tënde, na hijesho si Perëndi, o Krisht.

*Duhet të dihet se, që nga sot deri të Shtunën e Javës së Ndrishme, nuk psalet as Oktoihu, as ndonjë Martirik, as ndonjë Hyjlindësor.*

### CITIME

Ngjallja e Llazarit: Joan 11.1-44  
Hyrya e Krishtit në Jerusalem në ditën e Palmave: Matth. 21.1-11; Mark 11.1-10; Lluk. 19.28-38; Joan 12.12-15

1. Lluk. 2.35
2. Joan 10.15,17-18
3. Jov 5.8; Urt. Sol. 6.7; 8.3
4. Ef. 6.12
5. Apok. 4.8
6. Matth. 27.2; Mark 15.1; Lluk. 23.1; Joan 18.29
7. Matth. 23.37; Lluk 13.34
8. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5;12.46
9. Joan 11.46-54
10. Joan 19.34
11. Gjen. 1.2
12. Is. 26.9
13. I Petr. 5.4
14. Is. 53.7; Vep. 8.32
15. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
16. Gjen. 28.17; Jez. 44.1-4
17. Abak. 3.3; Dan. 2.34-35
18. Eks. 25.8 etj. Hebr. 9.4
19. Eks. 13.21-22 etj.
20. Is. 9.2; Matth. 4.16
21. Ps. 103(104).3
22. Apok. 3.20
23. Jer. 38(31).13
24. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 36
25. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 35
26. Urt. Sol. 9.10; Jer. 17.12; Matth. 25.31
27. Ne. 11.1 etj.

28. Matth. 20.17-19; Mark 32-34; Lluk. 18.31-33  
 29. Lluk. 1.48  
 30. Eks. 3.2-5  
 31. Matth. 22.11-13  
 32. Matth. 27.28; Mark 15.17; Lluk. 23.11; Joan 19.2  
 33. Ps. 29 (30).12  
 34. Matth. 8.12; 22.13; 25.30  
 35. Ef. 5.19; Kol. 3.16  
 36. Fil. 2.15  
 37. Joan 14.27  
 38. Num. 14.19 etj.  
 39. Ps.6.2; 37(38).2  
 40. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5;  
 Jov 10.8-9; II Makk. 7.23  
 41. Ps. 50(51).3; 68(69).17  
 42. Joan 6.48,51  
 43. Ps. 113(114).11; 134(135).6; Jov 23.13; Urt. Sol. 12.18  
 44. Jov 5.8; Urt. Sol. 6.7; 8.3  
 45. Eks. 15.1-21  
 46. Eks. 32.11 etj.  
 47. Ligji i Dytë 32.1  
 48. Joan 4.42; I Joan 4.14  
 49. Ps. 117(118).22; Matth. 21.42; Mark 12.10; Lluk. 20.17;  
 Vep. 4.11; I Petr. 2.7  
 50. Matth. 16.18  
 50a. Sirak 24.8  
 51. Abak. 3.11  
 52. III [I] Mbret. 17.21-22  
 53. IV [II] Mbret. 4.35  
 54. Fil. 2.7  
 55. Is. 26.12-13  
 56. Gjen. 2.7  
 57. Jona 2.4  
 58. Fja. Urt. 5.22  
 58a. Joan 16.30  
 59. Is. 6.3  
 60. Dan. 3.23; kap. 3 Lutja e Azarias 1-2.27-28  
 61. Matth. 11.5; 15.30; Mark 7.37; Lluk. 4.19; 7.21  
 62. Ps. 148.4  
 63. Lluk. 1.51-52  
 64. Lluk. 1.68  
 65. Lluk. 1.78-79  
 66. Matth. 26.61; 27.40; Mark 14.58; 15.29; Joan 2.19  
 67. Ps. 106(107).16; Is. 45.2; Jer. 28(51).30; Vajt. 2.9  
 68. Lluk. 7.12-15  
 69. Ps. 103(104).24  
 70. Joan 1.18



TË SHITUNËN PARA PALMAVE  
 E SHËN LLAZARIT TË DREJTË  
 NË MËNGJESORE

*Pas Perëndia është Zoti, Përlëshore*

*Ting. I*

Vërtetove Ngjalljen e përbashkët përpara pësimi tënd, e ngrite Llazarin prej së vdekurish, o Krisht Perëndi; prandaj dhe ne porsì djemtë duke mbajtur shenjat e mundjes, ty po të thërrasim, mundësit të vdekjes: Hosana ti në më të lartat, i bekuar je ti që vjen më emrin e Zotit. \* (3x)

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso*

*Ting. I Tu lithu sfracjsthesont*

Të erdhi keq për lotët e Martës dhe Mari-së,\* urdhërove gurin e varrit ta rrokullisnin, o Krisht,\* që je Perëndi, e ngjalle pra\* të vdekurin, pasi i thirre fort;\* vërtetove me të ngjalljen e botës mbar,\* i dhembshur dhe jetëdhënës,\* lavd në pushtetin tënd, o Shpëtimtar;\* lavd në fuqinë tënde tok;\* lavd më ty që bërë çdo gjë me fjalë,<sup>1</sup> i miri Zot.

Lavdi dhe Tani

*E njëjta*

*Pas (Stihologjisë së dytë, të të Paqortueshmit, Ps. 118, dhe) Bekimtorove Ngjallësore, Ndenjëso*

*Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon*

Je burim i urtis' dhe i paranjohjes drejt,\* por, Njeridashës, kur ishe në Betani, pyesje\* gjithë sa rreth Martës ishin, ku e kishin vën'\* mikun Llazar; dhe dhembshurish,\* si lotove, katërditëshin\* përmes zërit tënd ti,\* o i mirë, si jetëdhënës dhe Zot, e ngrite nga të vdekurit.

Lavdi dhe Tani

*E njëjta*

*(Nuk ka Ungjill, por thuhet) Ne që pamë ngjalljen. Psalmi 50 dhe Kanunet:*

*Ode I*

*Kanuni, poezi e Theofanit*

*Ting. Tërth. IV*

*Irmosi: Ásomen to Kirio*



»Le t'ia këndojmë Zotit\* himnin triumfu-  
»es, se fitoi lavd,\* kur popullin e vet pra\*  
»e kaloi në Detin e Kuq në këmb'.<sup>2</sup> (2x)

O Njeridashës, ngrite\* me të hyjshmen  
shenjë ti të vdekurin\* Llazar, se je gatu-  
es,\* o i mir', arkëtar jete plot mëshir'.

Zot, me një fjal' e ngrite,\* kur i thirre ka-  
tërditëshit Llazar,\* shpërbëre, i pavdek-  
shëm,\* me fuqi mbretërinë e Hadhit terr.

Neve krejt na tregove\* shenjën e mbi-  
perëndishme të Hyjnis'\* kur ngrite, Zot,  
Llazarin\* nga të vdekurit, pra katërditë-  
shin.

Gjat' ngjalljes së Llazarit,\* Betania sot  
kërcen, fort parashpall\* dhe ngjalljen e  
Jisuit,\* Jetëdhënësit Krisht, Perëndi dhe  
Zot.

*Kanuni tjetër, poezi e Kozma Monakut*

*Ting. Tërth. IV*

*Igrân dhiodhefsas*

Ti që Gjithësinë nga hiçi krejt\* e krijove  
që më parë, dhe si Zot thellësit\* i njeh,  
sa ka zemra,<sup>3</sup> Nxënësve mbar'\* u parathe  
se Llazarit kish fjetur pra.

Nga një Virgjëreshë e more, Krisht,\* në  
natyrën tënde krejt esencën e njerëzve,\*  
e dije si Zot ku ish Llazarit,\* por si njeri ku  
qe varri po pyesje.

Që ti ngjalljen tënde ta sigurosh,\* mikun,  
katërditëshin e dashur fort, Fjalë Zot,\*  
që në varr lëshon të keqen erë,\* vërtet e  
ngre si nga gjumi, o Shpëtimtar.

*Kryqhyjindësor*

Rreshtim engjëllor si dhe njerëzor,\* nënë  
e panusëruar, pa pushim të lëvdojm',\* se  
Ndërtuesin e tyre si foshnj'\* në prehrin  
tënd ti e mbajte, Hyjindëse.

*Zbritësore: Igrân dhiodhefsas*

»Pasi kish kaluar det si sterë\*<sup>2</sup> edhe u  
»shpëtua nga inati egjiptian,\*<sup>4</sup> me zë  
»Izraeli po thërriste:\* Le t'ia këndojm'  
»Perëndis', Çlirimtarit Zot.

*Ode III*

*Irmosi: Si i to steréoma*

»Ti je përforsim për ne\* që po përikim  
»te ti, o Zot,\*<sup>5</sup> je drit' për sa\* janë errësu-  
»ar,\*<sup>6</sup> ndaj dhe shpirti im të himnon. (2x)

Kur shfaqe dy energjit',\* tregove se dy  
esenca ke,\* o Shpëtimtar,\* meqë je njeri  
ti,\* por edhe Perëndia Zot.

Avushë e dijes je,\* por pyet se ku e kanë  
vën'\* atë që vdiq\* se ti, Jetëdhënësi,\* do  
ta ngresh lart të shtririn posht'.

Lëvizje dhe shfaqeshe\* në vende, se ishe  
bër' njeri\* me pamje, ti\* që i mbush të  
gjitha\*<sup>7</sup> porsi Zot që s'përskruhesh dot.

Me fjalë hyjnore thjesht\* ngrite Llazarin,  
ndaj lutem, Krisht,\* dhe mua pra\* ngrimë,  
jam i vdekur\* nga shumica e shkeljeve.

*Tjetri: Uranias apsidhos*

Kur arrite, o Krisht çudibërës, në Betani,\*  
mu ku qe varrosur Llazarit, pas të natyr-  
shmit ligj\* lotove, edhe kështu\* e vërte-  
tove drejt mishin\* që ti more, o Perëndi  
edhe Zoti im.

Menjëherë e ndale ti zinë vrer të Maris'\*  
dhe të Martës, duke treguar se ke vullnet  
të lir',\* sepse vërtet jeta je\* dhe ngjallja,  
siç kishe thënë,\* Zoti i të gjithave, o Shpë-  
timtari im.

Të mbështjellë me rripa, nga Hadhi dhe  
terri, Zot,\* e rrëmbeve mikun tënd nga të  
vdekurit, Shpëtimtar,\* me fjalën tënde  
plot forc',\* i theve llozet e vdekjes\* dhe  
të mbretërisë së saj, fitimtar me lavd.

*Hyjlindësor*

Si banove me mish te një Virgjëreshë, o Zot,\* njerëzve u shfaqe<sup>8</sup> siç duhej të të shikonin ty;\* atë e shfaqe vërtet\* Perëndilindëse, ndihmë\* për besnikët, o njeridashës i vetëm Krisht.

*Zbritësore: Uranias apsidhos*

»Perëndi që apsidë bëre në q'ell si çati,\*<sup>9</sup> ti që je ndërtues i Kishës,<sup>10</sup> mirë më »siguro\* në dashurinë që ke;\* je maja »e çdo dëshire,\* njeridashës, edhe mbështetja për çdo besnik.

*Ndenjëso**Ting. IV Kateplaji Iosif*

Motrat e Lazarit shenjt\* qëndruan pranë Krishtit ton';\* tërë helm vajtonin fort,\* lotonin dhe i thanë: "Zot,\* Lazari vdiq". Sado, si Zot, e dinte varrin,\* thjesht i pyeti "Ku e keni vën'?";\* dhe si vajti bri varrit Krishti yn',\* Lazarit, katërditëshit, i thirri.\* Ai u ngjall menjëherë, brof,\* dhe iu fal Krishtit\* që e kish ngritur,\* Shpëtimtarit të mirë.

*Lavdi dhe Tani**Ting. Tërth. IV Tin Sofian qe Logon*

Që më parë, si Bërës, ti di çdo gjë,\* parathe tek apostujt në Betani:\* "Ka fjetur Lazari sot,\* miku ynë," dhe pyete,\* sado e dije, siç është shkruar, "Ku është vën'?".\* Dhe, si iu lute Atit, lotove porsinjeri;\* ndaj dhe katërditëshin që deshe, Lazarin,\* e ngjalle nga Hadhi, Zot,\* kur i thirre; të themi fort:\* Prite himnin,\* o Shpëtimtar,\* nga ata që kanë guxim\* të të lëvdojnë ty, o Krisht,\* o Perëndi,\* dhe të gjithë për lavdin tënd denjësoji pra.

*Ode IV**Irmosi: Isakikoa Kirie tis ikononias su*

»Kam dëgjuar misterin qart'\* të Ekonomis' sate dhe kuptova krejt\* veprat që

»ke bërë<sup>11</sup> dhe prandaj\* lavdërova un' »hyjninë tënde, Zot.

Jo se kishe nevojë për aleat, por se kryejë Ekonomi të parrëfyeshme, e ngjalle duke u lutur të vdekurin që prej katër ditësh, o i Tërëfuqishëm.

Fjala dhe Perëndia<sup>12</sup> që më parë shfaqej i bashkëpërtjetshëm me Atin, tani lutet si njeri, ai që pranon lutjet e të gjithëve.

Zëri yt, o Shpëtimtar, e vithisi të gjithë fuqinë e vdekjes dhe i tundi me fuqi hyjnore themelet e Hadhit.

*Hyjlindësor*

Le ta himnojmë Virgjëreshën, meqenëse mbeti e virgjër pas lindjes, dhe kishte në bark Krishtin Perëndi, që e çliroi botën nga mashtrimi.

*Tjetri: Si mu iskis Kirie*

Si i fortë dhe Zot, o bërës Shpëtimtar, e rrëmbeve porsin bari<sup>13</sup> nga ujku vërtet i tmerrshëm dhe hamës, njeriun tashmë katërditësh dhe të prishur; në të paratregojë lavdinë botërore të ngritjes sate të tanishme pas tri ditësh.

Ata që ishin rreth Martës, kur të panë ty, jetën, thërrisnin: "Nëse do të ishe këtu, o Zot, dritësimi dhe jeta e të gjithëve,<sup>14</sup> patjetër që nuk do të vdiste Lazari, nuk do të shfaqej i vdekur". Mirëpo, përderisa ti je jeta e të vdekurve, o njeridashës, e ktheve në gëzim zinë e tyre.<sup>15</sup>

O Zot, avushat frikësohen prej teje, burimit; të shërbejnë gjithë ujërat, të tremben portierët e Hadhit, dhe llozet shpërbëhen nga pushteti yt me ngjalljen e Lazarit nga të vdekurit me anën e zërit tënd, o Krisht Shpëtimtar, njeridashës i tërëfuqishëm.

*Hyjlindësor*



Ti je krenari besëmirësh, o e panusëruar, je mbrojtje, je edhe strehë të krishterësh, mur dhe liman, sepse çon lutje te Biri yt, o e tërëpaqortueshme, dhe shpëton nga reziqe ata që me besë dhe dëshirë të njohin si Perëndilindëse të kulluar.

*Zbritësore: Si mu iskis Kirie*

»Ti je, o Zot,\* forca për mua, fuqia je,\* »ngazëllimi\* si dhe Perëndia im, ti që s'e »le\* gjirin atëror\*<sup>16</sup> dhe e vizitove mjerimin »ton',<sup>17</sup> ndaj thërras te ti\* së bashku me »profetin\* Abakum: Njeridashës,\* lavd »pushtetit, fuqis' sate, Zoti im.

*Ode V*

*Irmosi: Ina ti me aposo*

»Pse, o Zot, më ke zbrapsur\* nga fyty- »ra jote,<sup>18</sup> o shkëlqim<sup>14</sup> pa perëndim?\* »Edhe u mbuloval\* un' i mjeri prej territ »të huaj krejt;\* por, të lyp, drejt dritës së »porosive<sup>19</sup> që the, kthemë\* edhe udhët e »mia drejtoji ti.<sup>20</sup>

Kur arrite në varrin e Llazarit, o njeridashës, i thirre atij dhe i dhe jetë, meqë je jeta e pavdekshme e gjithë të vdekshmeve; si Perëndi, e paracaktove qartësisht ngjalljen që do të bëhej.

Llazar ecte i lidhur në këmbë, – çudi brenda çudish! – sepse Krishti që e përforconte, u shfaq më i madh se ajo që e pengonte. Me fjalën e Zotit, të gjitha, pors i skllave, atij i shërbejnë, si Perëndi dhe sundimtar.

O Krisht, që e ngrite Llazarin, të vdekurin që prej katër ditësh dhe me erë të qelbur, ngrimë mua që vdiqa tani nga mëkatet dhe u vura në gropë dhe hije të errët vdekjeje;<sup>21</sup> por çliromë dhe shpëtomë si i dhembshur.

*Tjetri, Irmos i njëjti*

Duke i dhënë Atit dhokologji, shfaqeshe se nuk ishte kundërshtar Perëndie; luteshe, duke e siguruar turmën e pranishme se falënderimin ia ofroje Atit tënd, kur me urdhër e ngrite Llazarin, o zemërgjerë.

O zëri i hyjshqiptuar dhe fuqia hyjnore e pushtetit tënd, o Shpëtimtar! Me të i dërmovë portat e Hadhit, të vdekjes hamëse; më rrëmbe nga pasionet e mia, si më parë mikun tënd katërditësh, Llazarin.

Me përgjërimet e Llazarit, të Martës dhe të Marisë na denjëso, o Zot njeridashës, që të bëhemi shikues të Kryqit, të pësimit dhe të Ngjalljes sate, të mbretëreshës dritëprurëse të ditëve.

*Hyjlindësore*

Duke pasur guxim nënori para Birit tënd, o e Tërëkulluar, të përgjërohemi të mos e shpërfillësh përkujdesjen tonë farefisnore, sepse ne të krishterët vetëm ty të vëmë para Zotit si zbutje dashmirëse.

*Zbritësore: Ina ti me aposo*

»Pse, o Zot, më ke zbrapsur\* nga fytyra jote,<sup>18</sup> o shkëlqim<sup>14</sup> pa perëndim?\* »Edhe u mbuloval\* un' i mjeri prej territ »të huaj krejt;\* por, të lyp, drejt dritës së »porosive<sup>19</sup> që the, kthemë\* edhe udhët e »mia drejtoji ti.<sup>20</sup>

*Këtu fillojnë Tetraodet. Irmoset (2x),*

*Troparet në 4.*

*Ode VI*

*Kanuni, poezi e të njëjtit Kozma*

*Ting. Tërth. IV*

*Irmosi: Ton Ionán en to kiti*

»O Zot, Jonain e vure për banim tepër të »izoluuar në peshkun e madh;<sup>22</sup> dhe mua, »të lidhurin në rrjetat e armikut, shpëtomë »si atë nga prishja.<sup>23</sup>

**O** Zot, dashuria të rrëmbeu në Betani drejt Llazarit dhe atë, tashmë me erë të keqe, e ngrite si Perëndi dhe e shpëtove nga prangat e Hadhit.

**Marta** ishte e dëshpëruar për Llazarin, meqë kishte tashmë katër ditë në varr; por Krishti si Perëndi nëpërmjet fjale e ngjalli të prishurin dhe e transferoi në jetë.

*Kanuni tjetër, poezi e Joan Monakut*

*Ting. i njëjti*

*Ilëshiti mi Sotir*

**Ti** je vërtet Perëndi,\* e dije dhe fjetjen e Llazarit dhe ua parathe\* apostujve, Nxënësve të tu; siguroje fort\* energjinë tënde,\* të Hyjnisë që nuk ka kufi.

**Në** mish përshkruhesh, o Zot,\* sado je i papërshkruar dhe, pasi vjen në Betani,\* për mikun Llazar loton porsì një njeri, veçse\* ti si Perëndi pra\* katërditëshin e ngre siç do.

*Zbritësore: Ilëshiti mi Sotir*

»Jan' shum' mëkatet që kam,\* ndaj le »të të vijë keq, o Zot, për mua; lutem, më »nxirr\* nga fundi i vreveve, sepse thirra »fort te ti\*<sup>24</sup> dhe dëgjomë mua,\* Perëndia »i shpëtimit tim.<sup>25</sup>

*Kontaqi Ting. II Ta ano zitón*

**Mbi** dhé na u shfaq\* me an' të mirësis' së tij\* Krisht Zoti që është\* për krejt ne jetë, gaz, ndriçim,\*<sup>14</sup> ngjallje për planetin dhe e vërteta,<sup>26</sup> edhe kështu u bë\* shëmbëllim, tip ngjallje pra,\* na jep neve mbarë ndjes' hyjnore me hir.

*Shtëpia*

**Krijuesi** i të gjithave<sup>26a</sup> i paralajmëroi Nxënësit duke thënë: "O vëllezër dhe të njohur, miku ynë fjeti". Me këto paratho-she dhe i mësoje se ti i di të gjitha si Kri-

juesi i të gjithave. "Prandaj le të ikim, le të shkojmë dhe le të shikojmë varrim të huaj, qarjen e Marisë, dhe do ta shohim varrin e Llazarit, sepse atje kam për të bërë çudi, si paralajmërim të Kryqit dhe do t'ju jap juve mbarë ndjes' hyjnore me hir".

*Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:*

Në të njëjtën ditë, të Shtunën para Palmave, kremtojmë ngritjen e Llazarit, mik i shenjtë dhe i drejtë i Krishtit, i cili ishte katër ditë në varr.

*Varg:* Qan, o Jisu, kjo i përket esencës së vdekshme;/ gjallëron mikun tënd, kjo i përket fuqisë hyjnore.

Me ndërmjetimet e mikut tënd Llazar, o Krisht Perëndi, mëshirona. Amin.

*Ode VII*

*Irmosi: Pedhes Evreon en kamino*

»Djem hebrejsh në kaminë e shkelën »flakën guximshëm<sup>27</sup> dhe e kthyen zjarrin »në vesë duke thirrur.<sup>28</sup> I bekuar je, o Zot, »Perëndi, në jetë.<sup>29</sup>

**Pasi** lotove si njeri, o i dhembshur, e ngrite si Perëndi atë që ishte në varr, Llazarin; dhe ai, sapo u zgjidh nga Hadhi, thërriste: I bekuar je, o Zot, Perëndi, në jetë.<sup>29</sup>

**Llazari**, sapo u arratis nga kaosi dhe nga terri i Hadhit, nëpërmjet fjalës së Zotit, doli i lidhur me shpërgën, duke thirrur: I bekuar je, o Zot, Perëndi, në jetë.<sup>29</sup>

*Tjetri: I ek tis Iudheas*

**Kur** lotove për mikun, o i Dhembshur, i pushove lotët e Martës; dhe me pësim vullnetar<sup>30</sup> e hoqe çdo lot prej faqes së popullit tënd;<sup>31</sup> o Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>29</sup>

**O** Shpëtimtar, arkëtar i jetës, i thirre të vdekurit si dikujt që flinte; dhe, kur me fjalë e çave barkun e Hadhit, e ngrite atë



që psalte: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>29</sup>

**O** Zot, e ngrite të vdekurin e lidhur me shpërgënj, i cili lëshonte erë të qelbur; dhe mua që jam i lidhur me pranga mëkatesh,<sup>32</sup> më ngri tekta do të psal: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.<sup>29</sup>

*Zbritësore: I ek tis Iudheas*

»**T**re Djem që nga Judea\* përfunduan »si robër në Babilonë dikur,\*<sup>33</sup> me besën »e Triadhës kan' shkelur flakë furre duke »psalur me gaz e hir:\*<sup>27</sup> O Perëndi atëror,\* »o Zot, je i bekuar.<sup>29</sup>

*Ode VIII*

*Irmosi: Musikón organon simfonunton*

»**K**ur instrumente muzikore krijonin sim- »foni, dhe popuj pa fund i faleshin ikonës »në Dheira, tre Djemtë që nuk u bindën,<sup>34</sup> »e përhimnonin Zotin dhe e lavdëronin në »gjithë jetët.<sup>27</sup>

**T**i, sunduesi, si bari<sup>35</sup> e gjurmoje qen- gjin<sup>35</sup> dhe, kur e rrëmbeve nga ujku i tmerrshëm shfarosës, e përtërite meqë ishte prishur, tekta ai thërriste: Himnoni dhe përmbilartësoni në gjithë jetët.

**S**i i vdekshëm kërkoje varrin, si Gatues e ngrite të vdekurin me urdhër zotëror; Hadhi u shtang me atë që thërriste: Himnoni dhe përmbilartësoni në gjithë jetët.

*Tjetri: Ton vasilea ton uranôn*

**N**ga njëra anë kërkon katërditëshin si vdekatari, nga ana tjetër e ngre me fjalë si Perëndi, prandaj të himnojme në gjithë jetët.

**S**i detyrim për të vëllanë, o Zot, Maria të ofron miro me mirënjohje,<sup>36</sup> duke përhimnuar në gjithë jetët.

**N**ga njëra anë si vdekatari thërret Atin,

nga ana tjetër si Perëndi e ngre L Lazarin, prandaj të himnojme, o Krisht, në jetë.

*Zbritësore: Ton vasilea ton uranôn*

»**M**bretni në qiej,\* që e himnojne ushtri- »të\* engjëllore, dhe ju ta himnoni\* dhe ta »lartësoni gjithnjë në gjithë jetët.

*(Nuk psalet Më të nderuarën)*

*Ode IX*

*Irmosi: Tin agnin endhoksos timisomen*

»**T**ë dëlirën, popuj, ta madhështojm'\* me »himne pareshtur,\* ta nderojmë ne me »lavdi Hyjllindësen që zuri\* pra në bark »hyjnorin zjarr dhe nuk u dogj.

**K**ur të vdekurin, katërditëshin,\* e panë të ecte,\* prej çudis' të shtangur, i thoshin popujt Çlirimtarit:\* Ne të madhërojmë, Perëndi, me himn.

**S**hpëtimtari im, paravërtetoi\* se plot lavd do ngjalleh,\* kur çliron nga Hadhi L Lazarin që kish vdekur para\* katër ditësh; ty të madhëroj me himn.

*Tjetri: Kirios Theotokon*

**F**akti se nuk je kundër\* Perëndis', nderon mjaft\* ti Atin tënd dhe, si lutesh, e ngre, o Krisht Zot,\* shën katërditëshin me vullnetin tënd lirshëm krejt.

**T**e gjith' ne shfaq L Lazarin\* si të fortvërtetin\* fakt, dëshmitar, Zot, për ngjalljen pas tri ditësh pra,\* pasi e ngrite nga varri, Krisht, katërditëshin.

**L**oton, flet, ecën, shfaq qart'\* energjinë tënde\* krejt njerëzore, por, tekta L Lazarin e ngre,\* njofton atë krejt hyjnore, o Shpëtimtari im.

**S**hpëtimin tim e kreve\* me vullnet të lirë,\* pashprehshëm, Zot, Çlirimtari im, o Krishti im;\* me dy natyrat e tua e bëre ti këtë.

*Zbritësore: Kirios Theotokon*

»Hyllindëse të themi,\* të pohojmë ne  
 »që\* shpëtuam, o e kulluar, e virgjër, me  
 »ty,\* me koret e të patrupve të madhë-  
 »shtojmë tok.

I shenjtë është Perëndia ynë (3x)

*Dhe Dërgimësoret**Epesképsato imás*

Në jet' kthehet përsëri\* Llazari plot me  
 hov tani\* me fjalën tënde, Fjalë Zot\* e  
 Perëndisë, o i Fort\*;\* popuj me degë të lë-  
 vdojn',\* sepse me vdekjen tënde do zhdu-  
 kësh krejt Hadhin ti. (2x)

Tashmë, vdekje, të plaçkit\* përmes Lla-  
 zarit Zotit Krisht;\* fitorja jote ku është,  
 Hadh?\*<sup>37</sup> Tani te ti zhvendoset, vjen\* qa-  
 rja e Betanisë mbar\*;\* për Krishtin tun-  
 dim dega fitoreje gjithë ne.

*Lavdërime Idhiomele  
 (8, me Vargjet e së dielës)**Ting. I*

Meqë je ngjallja dhe jeta e njerëzve,  
 o Krisht zemërgjerë, arrite në varrin e  
 Llazarit, duke na i vërtetuar të dyja esen-  
 cat e tua, se erdhe nga një Virgjëreshë e  
 dëlirë si Perëndi dhe njeri; sepse si vde-  
 katar pyete ku ishte varrosur, ndërsa si  
 Perëndi e ngrite katërditëshin me shenjë  
 jetëprurëse.

O Krisht, para vdekjes sate, e ngrite prej  
 Hadhit Llazarin që kishte vdekur që prej  
 katër ditësh, duke e tundur pushtetin e  
 vdekjes dhe, përmes një të dashuri, para-  
 lajmërove çlirimin e të gjithë njerëzve nga  
 prishja;<sup>38</sup> prandaj, duke iu falur autoritetit  
 tënd të tërëfuqishëm, thërrasim: I bekuar  
 je, o Shpëtimtar, mëshirona.

Marta dhe Maria i thoshin Shpëtimtarit:  
 "Nëse do të ishte këtu, o Zot, nuk do

të vdite Llazari". Por Krishti, ngjallja e  
 të fjeturve, e ngriti nga të vdekurit katër-  
 ditëshin tashmë. Ejanë, gjithë besimtarët,  
 t'i falemi atij që po vjen me lavdi, për të  
 shpëtuar shpirtat tanë.

Megjithëse u jepje Nxënësve të tu, o  
 Krisht, simbolet e hyjnisë sate, ua përluje  
 veten turmave, ngaqë doje ta fshihje atë;  
 ndaj ua parathe apostujve, si paranjohës  
 dhe Perëndi, vdekjen e Llazarit; dhe, kur në  
 Betani ishte i pranishëm te popujt, kërkoje  
 të mësoje ngaqë nuk e dije, si njeri, varrin  
 e mikut tënd; por i ngjalluri përmes teje,  
 katërditëshi, e deklaroi pushtetin tënd  
 hyjnor; o Zot i tërëfuqishëm, lavdi më ty.

*Ting. IV*

E ngrite mikun tënd katërditësh, o Krisht,  
 dhe e ndalove qarjen e Martës dhe të Ma-  
 risë, duke e shfaqur disi te të gjithë se ti je  
 ai që i mbush të gjitha<sup>7</sup> me pushtet hyjnor  
 nëpërmjet vullnetit të lirë; drejt teje Keru-  
 vimet thërresin pa pushim: Hosana në  
 më të lartat, i bekuar je ti, Perëndia mbi  
 të gjitha;<sup>39</sup> lavdi më ty.

Marta i thërriste Marisë: "Mësuesi arriti  
 dhe të thërret, eja". Dhe ajo erdhi duke  
 vrapuar atje ku qëndronte Zoti. Sapo e  
 pa, thirri duke i rënë një gjunjë dhe iu fal.  
 Dhe, duke i puthur me mallëngjim këmbët  
 e tua të pacenuara, thoshte: O Zot, në-  
 se do të ishte këtu, nuk do të vdite vëllai  
 ynë.

*Ting. Tërth. IV*

E ngrite në Betani Llazarin e vdekur që prej  
 katër ditësh; vetëm sa qëndrove në varr,  
 zëri u bë jetë për të vdekurin; Hadhi, pasi  
 rënkoj, e lëshoi me frikë. Mrekullia është  
 e madhe! O Zot i shumëmëshirshëm, la-  
 vdi më ty.

Siç i the Martës, o Zot, "Unë jam ngjallja",



e përmbushe fjalën me vepër, i thirre Llazarit që qe në Hadh; lutem, o njeridashës, si i dhembshur, ngrimë edhe mua që jam i vdekur për shkak të pasioneve.

### Lavdi *Ting. II*

Një çudi e madhe dhe paradoksale u krye sot, se Krishti, pasi i thirri nga varri një të vdekuri katërditësh, e ngriti dhe e quajti mik; le t'i ofrojmë dhoksologji atij si të përmbilavdishëm, që, me ndërmjetimet e Llazarit të drejtë, t'i shpëtojë shpirtat tanë.

### Tani

E përmbibekuar je.

*Dhoksologjia e Madhe.*

*Në Liturgji Tipiket dhe nga Kanuni, Ode III dhe VI. Hyrtore: Ejani t'i falemi... Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. Pas Hyrjes, Përlëshore Vërtetove Ngjalljen. Kontaqi Mbi dhë na u shfaq. Në vend të Trishenjtit, Sa u pagëzuat. Kungatore Nga gojë foshnjash dhe thithanikësh përgatite himn. Alluia.*

### CITIME

Ngjallja e Llazarit: Joan 11.1-44  
Hyrja e Krishtit në Jerusalem në ditën e Palmave: Matth. 21.1-11; Mark 11.1-10;  
Lluk. 19.28-38; Joan 12.12-15

1. Gjen. 1.1-24; Ps. 148.5; Ju. 16.14
2. Eks. 14.29-15.1,20 etj.
3. II Kron. 6.30; Fja. Urt. 24.11-12; Lluk. 16.15
4. Eks. 14.27-28
5. Ps.70(71).3
6. Ps. 111(112).4; Lluk. 1.79; Rom. 2.19
7. Ef. 1.23
8. Baruh 3.38
9. Gjen. 1.7; Is. 40.22
10. Ef. 2.20-21
11. Abak. 3.13
12. Joan 1.1
13. Joan 10.11,14
14. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
15. Est. 9.22
16. Joan 1.13
17. II Kor. 8.9
18. Ps. 42(43).2; 73(74).1

19. Fja. Urt. 6.23
20. Ps. 5.9; 118(119).5
21. Ps. 87(88).7
22. Jona 2.1
23. Jona 2.7
24. Jona 2.2
25. I Kron. 16.35; Ps. 17(18).47; 50(51).16; 87(88).2
26. Joan 14.6
- 26a. Sirak 24.8
27. Dan. 3.23
28. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26-27
29. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
30. Joan 10.15,17-18
31. Is. 25.8
32. Fja. Urt. 5.22
33. Dan. 1.3-6
34. Dan. 3.1-12
35. Matth. 18.12; Lluk. 15.4
36. Joan 11.2; 12.3
37. Osia 13.14; I Kor. 15.55
38. Rom. 8.21
39. Rom. 9.5



## E DIELA E PALMAVE

### TË SHTUNËN NË MBRËMËSOREN E VOGËL

#### *Thirtore*

#### *Ting. Tërth. II Triimeros anestis*

Nga foshnjat e patëkeq, o Krisht, kur ishe ulur mbi pulisht, pranove me mirësi ode fitoreje ndërsa shkoje drejt pësimit, ti që përhimnohesh prej engjëjve me himnim trishenjtor.<sup>1</sup>

O Sion, ja ku po vjen mbreti yt i butë dhe si shpëtues mbi pulisht,<sup>2</sup> duke kërkuar t'i godasë me fuqi armiqtë;<sup>3</sup> gëzohu dhe dëfre shumë,<sup>2</sup> duke kremtuar me palma.

Le të duartrokasim së bashku, o besnikë, duke i ofruar tani Krishtit si djemtë degët e virtyteve, dhe le t'i shtrijmë për të velat e punëve të hyjshme, dhe le ta mirëpresim mistikisht.

O vëllezër, palma virtytsh le t'i sjellim Krishtit Perëndi, që po vjen për hirin tonë,

për të pësuar si njeri vullnetarisht,<sup>4</sup> që me fuqi Hyjnie t'u dhurojë të gjithëve pashmëri.

Lavdi dhe Tani

**Ai** që si Perëndi hipën mbi shpina Keruvimesh,<sup>5</sup> ulet mbi pulisht dhe vjen vullnetarisht drejt therjes<sup>4</sup> për hirin tonë; e jani ta përhimnojmë gatishmërisht me palma.

*Pasvargje*

*Ting. II Ikos tu Efrathá*

**Shkëlqej**, Sion i ri, dhe bashkë me fëmijët përhimno me palma; ja ku po vjen mbreti yt drejt pësimi për të na shpëtuar.

*Varg:* Nga gojë foshnjash dhe thithanikësh përgatite himn.

**Ngazellohuni**, o Adam dhe Eva, tok me profetët; ja ku po nxiton Zoti që t'ju rithërrasë me anë të pësimi.

*Varg:* O Zot, Zoti ynë, sa i çuditshëm është emri yt në gjithë dheun!

**Ai** që bashkë me Atin dhe Shpirtin e pranon sipër himnin e engjëjve,<sup>1</sup> varfërohet<sup>6</sup> poshtë në mënyrë të çuditshme dhe pranon himnim djemsh.

Lavdi dhe Tani *Ingjashëm*

**E** himnoj me druajtje Ekonominë tënde të frikshme dhe të thërras "Hosana!", sepse po vjen që të më shpëtosh mua, o Zot i bekuar.

*Përlëshore*

**V**ërtetove Ngjalljen

**U** varrosëm me pagëzim



NË MBRËMËSOREN E MADHE

*Pas Kathizmës së parë  
10 Thirrtoje Idhiomele*

*Ting. Tërth. II*

**Sot**, Hiri i Shpirtit të Shenjtë na mblodhi; dhe të gjithë ne, duke e ngritur Kryqin tënd,<sup>7</sup> themi: I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit, hosana në më të lartat. (2x)

**Ai** që ka fron qiellin dhe nënkëmbëz tokën,<sup>8</sup> Fjala e Perëndisë Atë dhe Biri i bashkëpërdetshëm, u përul sot mbi pulisht të paarsyeshëm, kur erdhi në Betani; ndaj djem hebrenjsh, duke mbajtur degë në duar, e mburrnin me zë: Hosana në më të lartat, i bekuar është ai që vjen, mbreti i Izraelit. (2x)

**Le** të vijnë sot dhe ne, i gjithë Izraeli i ri, Kisha e komeve,<sup>9</sup> le të thërrasim bashkë me profetin Zaharia: Gëzohu fort, o bijë Sion, shpall, o bijë e Jerusalemit, sepse ja mbreti yt po vjen i butë dhe shpëtues, i hipur mbi pulisht gomareje, bir kafshe;<sup>2</sup> kremtoje festën e fëmijëve, duke mbajtur degë në duar, lavdëroje: Hosana në më të lartat, i bekuar është ai që vjen, mbreti i Izraelit. (2x)

**Duke** na paraikonizuar ngjalljen tënde të nderuar, e ngrite nga varri me urdhrin tënd mikun e vdekur L Lazar, pa frymë, pas katër ditësh, që lëshonte erë të keqe, o i mirë; prandaj edhe hiqe mbi pulisht simbolikisht, duke u sjellë si mbi karrocë, duke paraqitur kombet, o Shpëtimtar; ndaj edhe të ofron Izraeli i dashur<sup>10</sup> lavdërimin nga gojë e thithanikëve dhe foshnjat e patëkeq, që të shikojnë të futesh, o Krisht, në qytetin e shenjtë<sup>11</sup> gjashtë ditë para Pashkës.<sup>12</sup> (2x)

**Gjashtë** ditë para Pashkës, Jisui erdhi në Betani.<sup>12</sup> Dhe i shkuan pranë Nxënësit e tij dhe i thanë: "O Zot, ku do që të të përgatisim ta hash Pashkën?". Dhe ai i dërgoi dhe u tha: "Shkoni në qytezën përballë dhe do të gjeni një njeri duke



mbajtur një shtambë uji. Ndiqeni atë dhe thojini Zotit të shtëpisë: 'Mësuesi thotë, se do ta bëj pranë teje Pashkën bashkë me Nxënësit e mi!'.<sup>13</sup> (2x)

Lavdi

**Sot**, Hiri i Shpirtit të Shenjtë na mblodhi; dhe të gjithë ne, duke e ngritur Kryqin tënd,<sup>7</sup> themi: I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit, hosana në më të lartat.

Tani

*E njëjta*

*Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni (i ditës):*  
Zoti mbretëroi. *Dhe lexime:*

Këndimi i Gjenezës

(49.1-2; 8-12)

Iftoi Jakovi bijtë e tij dhe u tha: "Mblidhuni që t'ju lajmëroj çfarë do të hasni mbi ditët e fundme; grumbullohuni dhe më dëgjojnë, o bij të Jakovit; dëgjojeni Izraelin, atin tuaj. O Judë, le të të lavdërojnë vëllezërit e tu, duart e tua *qofshin* mbi shpinën e armiqve të tu; do të të falen bijtë e atit tënd. Luan i vogël je, o Judë; nga lastari, o biri im, u ngjite; pasi u shtrive, flete si luan dhe si këlysh luan; kush do ta ngrejë? Nuk do të mungojë *asnjë* arkond prej Judës dhe udhëheqës nga kofshët e tij, derisa të vijnë të rezervuarat për të, dhe ai është i prituri prej kombesh; duke lidhur drejt një hardhie pulishtin e tij dhe në helikën pulishtin e gomares së tij; do ta lajë në verë stolinë e tij dhe në gjak rru-shi veshjen e tij; *do të jenë* gazmorë sytë e tij prej verës, dhe dhëmbët e tij më të bardhë se qumështi".

Këndimi i profecisë së Sofonias

(3.14-19)

**Këto** thotë Zoti: "Ngazëllohu fort, o bijë Sion, shpall, o bijë e Jerusalemit; dëfre dhe gëzohu tepër fort nga gjithë

zemra jote, o bijë e Jerusalemit. Zoti i hoqi padrejtësitë e tua, të ka çliruar nga dora e armiqve të tu; mbreti i Izraelit, Zoti, është mes teje, nuk do të shikosh më të këqija". Në atë kohë, Zoti do t'i thotë Jerusalemit: "Ki kurajë, o Sion! Mos u paralizofshin duart e tua!". Zoti, Perëndia yt, është në ty, i fortë, do të të shpëtojë, do të sjellë mbi ty hare dhe do të të përtëritë në dashurinë e tij, dhe do të dëfrojë mbi ty në kënaqësi si në ditë feste. "Dhe do t'i mbledh të dërrmuarit e tu. Mjerë! Kush mori tallje mbi të? Ja, unë bëj në ty për hirin tënd në atë kohë", thotë Zoti, "dhe do ta shpëtoj të shtypurën, dhe të zmrapsurën do ta pranoj, dhe do t'i vendos ata për krenari, dhe do t'i bëj të famshëm në gjithë dheun".

Këndimi i profecisë së Zaharias

(9.9-15)

**Këto** thotë Zoti: "Ngazëllohu fort, o bijë Sion, shpall, o bijë e Jerusalemit; ja ku mbreti yt po të vjen i drejtë dhe duke shpëtuar, i butë dhe i hipur mbi kafshë ngarkese, dhe pulisht të ri; dhe do të shfarosë karrocë ushtarake nga Efremi, dhe kalë nga Jerusalemi, dhe do të shfaroset hark luftime; dhe *do të bëhet* shumicë dhe paqe prej kombesh; dhe do të sundojë mbi ujëra gjer në det, dhe prej lumenjsh gjer në dalje toke". Dhe ti, në gjakun e dhlatës sate, i lëshove të lidhurit e tu nga gropa që s'kishte ujë. Do të rri në fortesë, *ju* të lidhurit e sinagogës, dhe në vend të një dite të zhvendosjes sate do të të shpërblej dyfish; sepse të tendosa, o Judë, për hirin tim në hark, e mbusha Efremin dhe do t'i ngrejë bijtë e tu, o Sion, mbi bijtë e grekëve dhe do të të prek si një shpatë luftëtari. Dhe Zoti do të jetë mbi ta, dhe do të dalë si rufe një predhë,

dhe Zoti i Tërëfuqishëm do të trumbetojë me trumbetë, dhe do të ecë në tallazin e kërcënimit të tij. *Zoti i Gjithëpushtetshëm do t'i mbrojë ata.*

*Në Liti Idhiemele  
Ting. I*

**S**hpirti i Tërëshenjtë, që u mësoi edhe apostujve të flasin në gjuhë të tjera të huaja,<sup>14</sup> i nxit fëmijët e patëkeq të hebrejve të thërrasin: Hosana në më të lartat, i bekuar është ai që vjen, mbreti i Izraelit.

**F**jala e Atit, Biri i bashkëpafillim dhe i bashkëpërbërës, erdhi sot në qytetin Jerusalem, i ulur mbi pulisht të paarsyeshëm. Atë që Keruvimet e shohin me frikë,<sup>15</sup> fëmijët e mburrën me palma dhe dafina, duke kënduar mistikisht lavdërimin: Hosana në më të lartat për atë që erdhi të shpëtojë nga mashtrimi tërë gjininë tonë.

**G**jashtë ditë para Pashkës,<sup>12</sup> zëri yt, o Zot, u dëgjua në thellësitë e Hadhit, ndaj edhe e ngrite Lazarin katërditësh; dhe fëmijët e hebrejve thërrisnin: Hosana, o Perëndia ynë, lavdi më ty.

*Ting. II*

**T**eksa po futeshe, o Zot, në qytetin e shenjtë, i ulur mbi pulisht, nxitoje të shkoje drejt pësimit,<sup>4</sup> që të përmbushje Ligjin dhe profetët;<sup>16</sup> ndërsa fëmijët e hebrejve, duke paralajmëruar fitoren e ngjalljes, të dolën para me degë dhe palma dhe thoshin: I bekuar je, o Shpëtimtar, mëshirona.

**L**avdi më ty, o Krisht, që rri ulur në më të lartat mbi fron,<sup>17</sup> dhe që tani të presim bashkë me Kryqin tënd të çmuar; prandaj dëfren bija Sion,<sup>2</sup> ngazëllohen kombet e dheut, fëmijët mbajnë degë, këmishë

Nxënësit, dhe bota mbarë mësoi të të thërrasë: I bekuar je, o Shpëtimtar, mëshirona.

*Lavdi dhe Tani Ting. III*

**G**jashtë ditë para se të bëhej Pashka, Jisui shkoi në Betani,<sup>12</sup> që të rithërriste Lazarin e vdekur që prej katër ditësh dhe që të parashpallte ngjalljen; dhe e mirëpritën edhe gra, Marta dhe Maria, motrat e Lazarit, dhe i thërrisnin atij: "O Zot, nëse do të ishe këtu, nuk do të vdiste vëllai ynë". Atëherë ai u thotë: "Nuk ju parathashë se ai që beson tek unë, edhe nëse vdes, do të jetojë? Ma tregoni ku e vendosët atë". Edhe ky, Krijuesi i të gjithave, i thërriste:<sup>18</sup> "Lazar, eja jashtë!".

*Pasvargje Idhiemele  
Ting. Tërth. IV*

**K**i gaz dhe dëfre, o qytet Sion,<sup>2</sup> kënaqu dhe ngazëllohu,<sup>19</sup> o Kishë e Perëndisë, sepse ja ku mbreti yt arriti me drejtësi, i ulur mbi pulisht, i përhimnuar prej fëmijësh. Hosana në më të lartat, i bekuar je ti që ke dhembshuri të madhe,<sup>20</sup> mëshirona.

**Varg:** Nga gojë foshnjash dhe thithanikësh përgatite himn.

**S**ot, në qytetin Jerusalem, erdhi Shpëtimtari të përmbushë Shkrimin. Dhe të gjithë morën palma në duar, ndërsa këmishët i shtrinin përtokë për të, duke ditur se ai është Perëndia ynë, drejt të cilit Keruvimet thërrasin pa pushim: Hosana në më të lartat, i bekuar je ti që ke dhembshuri të madhe,<sup>20</sup> mëshirona.

**Varg:** O Zot, Zoti ynë, sa i çuditshëm është emri yt në gjithë dheun!

**T**i që rri mbi Keruvime<sup>5</sup> dhe himnohesh prej Serafimeve,<sup>1</sup> hiqe mbi pulisht sipas Davidit,<sup>21</sup> o i mirë; fëmijë të përhimnonin



siç i përket Perëndisë, judenj blasfemonin paligjësisht,<sup>22</sup> ulja mbi pulisht i parasimbolizonte kombet e pafre, që ktheheshin nga ateizmi në besim; lavdi më ty, o Krisht, i vetmi mëshirues dhe njeridashës.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

**S**ot, Hiri i Shpirtit të Shenjtë na mblodhi; dhe të gjithë ne, duke e ngritur Kryqin tënd,<sup>7</sup> themi: I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit, hosana në më të lartat.

Tani  
*Injëjti*

*Përlëshore*  
*Ting. I*

Vërtetove Ngjalljen e përbashkët përpara pësimit tënd, e ngrite Llazarin prej së vdekurish, o Krisht Perëndi; prandaj dhe ne porsì djemtë duke mbajtur shenjtat e mundjes, ty po të thërrasim, mundësit të vdekjes: Hosana ti në më të lartat, i bekuar je ti që vjen në emrin e Zotit.\*

Lavdi  
*E njëjta*

Tani  
*Tjetër Ting. IV*

**U** varrosëm me pagëzimin tok me ty, o Krisht, Perëndia ynë, u vlerësua për jetën<sup>23</sup> pa vdekje me Ngjalljen tënde, dhe të thërrasim me lavdi: Hosana në më të lartat, i bekuar je ti që vjen në emrin e Zotit.\*



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores*  
*Ting. IV Kateplaji Iosif*

**T**ë pastruar drit' në shpirt,\* dhe mendërisht me degë plot,\* si fëmijët, Fjalën

Zot\* le ta lëvdojmë besërisht\* me zë të fortë: Sundues, je i bekuar\* ti që erdhe, o Shpëtimtar, në bot'\* të shpëtosh Adamin prej nëmës helm,\* të lashtë,<sup>24</sup> shpirtërisht si u bërë\* Adam i ri,<sup>25</sup> njeridashës Krisht,\* nga dhembshuria;\* lavd ty që bërë,\* për të mirën ton', çdo gjë.

Lavdi dhe Tani

*Ting. IV Epefanis simeron*

**Z**ot, kur katërditëshin\* në varr, e ngrite,\* shën Llazarin, krejt ne na\* mësove që të mbanim tok\* dafina, palma edhe me zë\* të thoshim: Je i bekuar, ti që po vjen.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores*  
*Ting. IV Kateplaji Iosif*

**M**istikisht ti po derdh lot\* për mikun tënd, Llazarin shenjt,\* që i vdekur dergjet, Krisht,\* dhe nga të vdekurit e ngrë;\* plot dhembshuri, njeridashës, për të tregove;\* kur për ardhjen tënde, o Shpëtimtar,\* Zot, mësuan, turmat e foshnjave\* sot dolën duke mbajtur nëpër duar\* plot palma dhe të thërrasin:\* Je i bekuar,\* vjen ta shpëtosh krejt\* botën<sup>26</sup> mbarë, Hosana.

Lavdi dhe Tani

*Ting. I Tu lithu sfracishtos*

**L**ëvdoni me një zë ju, o popuj dhe ju, kombe,\* mbi pulisht tani hipi mbreti i engjëjve dhe po vjen\* në Kryq krejt me dashje,<sup>4</sup> sepse do\* armiqtë t'i godasë<sup>3</sup> si i fort';\* ndaj fëmijët mbajnë palma me gaz dhe thon',\* thërrasin njësh himn: Lavdi ty,\* o fitimtar që erdhe; Shpëtimtar\* Krisht, lavd ty të bekuarit,\* lavd ty; Perëndia ynë i vetëm je ti, o Zot.<sup>27</sup>

*Pas Polieleit, Ndenjësores*

*Ting. Tërth. IV To prostahthën mistikòs*

**Ai** që ulet përmbi fron Keruvimesh,\*<sup>5</sup> për ne u ul sot\* mbi pulisht, vjen te pësimi\* vet' me dashje,<sup>4</sup> dëgjon pra\* djemtë që

thërrasin\* "Hosana", dhe turmat thonë me zë të lart\*: "Nxito, o Bir i Davidit,\* dhe na shpëto,\* o Jisu i bekuar, ne që na gatove, se erdhe për këtë, o Çlirimtar:\* që të njohim lavdin' tënde".

Lavdi dhe Tani  
E njëjta

Shkallesa. Antifoni i parë i Ting. IV  
Proqimieni Ting. IV

Nga gojë foshnjash dhe thithanikësh përgatite himn.

Varg: O Zot, Zoti ynë, sa i çuditshëm është emri yt në gjithë dheun!

Çdo frymë. Ungjilli. Psalm 50. (Nuk thuhet Ne që pamë ngjalljen, por menjëherë:) Lexohet Urata e palmave (Ungjilli i shenjtë vendoset mbi proskinitar dhe besimtarët kalojnë, puthin Ungjillin dhe marrin palma nga prifti, i cili është pranë proskinitarit [Për lehtësimin e besimtarëve, Urata mund të lexohet pikërisht para Lavdërimeve, ndërsa palma shpërndahet në fund bashkë me naforën]; njëkohësisht, psaltët vazhdojnë:)

Lavdi Ting. II

Sot, Krishti futet në qytetin e shenjtë,<sup>11</sup> i ulur në pulisht, dhe asgjëson marrëzinë tepër të keqe të kombeve, e cila, qysh qëmoti, qe djerrinë.

Tani  
E njëjta

Varg: Përdëllemë, o Perëndi. Dhe Idiomeli. Ting. Tërth. II

Sot, Hiri i Shpirtit të Shenjtë na mblodhi; dhe të gjithë ne, duke e ngritur Kryqin tënd,<sup>7</sup> themi: I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit, hosana në më të lartat.

Kanuni (Irmoset dy herë, troparet në 4) me Akrostihidhë: "Hosana; Krishti, Perëndia i

bekuar". Poezi e Kozma Monakut.

Ode I

Irmosi: Ófthisan e pijë tis avisu

»Çdo burim\* i avushës u shfaq krejt pa »vesë, igrasi,\* u zbuluan edhe themele\* »deti plot me dallgë, se stuhi\* u bë<sup>28</sup> me »shenjën tënde pra,\* se e qortove,<sup>29</sup> dhe »kështu\* e shpëtove popullin e zgjedhur,<sup>30</sup> »Zot,\* kur të këndonte himn për fitoren, o »Perëndi.<sup>31</sup>

Bëre himn\* që nga gojë të foshnjave, thithanikëve\* pa hiç faj, shërbyesve të tu,\* që ta zhdukësh kundërshtarin djall\* përmes pësimit, Kryqit tënd,\* të marrësh hak<sup>32</sup> për rrënjën thell\* të Adamit atë, lashtë,<sup>33</sup> dhe me dru,\* o Zot, ta ngresh kur do të të psalë himn triumfal.

I ofron\* Kisha e oshënarëve himn<sup>34</sup> banuesit\* në Sion,<sup>35</sup> ty, o Krisht, dhe ka gaz\* Izraeli për ty Bërësin\* e tij, dhe male shembuj, tip,\* kombesh të ngurtësuar,\* u gëzuan para faqes sate<sup>36</sup> fort\* duke kënduar himn triumfal për ty, Zoti yn'.

Zbritësore: Ófthisan e pijë tis avisu

Çdo burim i avushës.

Ode III

Irmosi: Náusan akrótomon

»Thithi shkëmb të ashpër, të thepisur një »komb,\* Izraeli; ky gur buronte\* me ur- »dhrin tënd ujë plot;\*<sup>37</sup> guri je ti, Krisht,<sup>38</sup> »dhe jeta, mbi këtë gur pra\* fort u bazua »Kisha, edhe "Hosana" po thërret,\* "i be- »kuar je, o Zot që vjen, Shpëtimtar me »lavd".

Hadhi i tmerruar nga të vdekurit, Krisht,\* la, siç urdhërove, L Lazarin\* për katër ditë në varr;\* sepse ngjallja si dhe jeta ti je, ndaj në ty\* fort u bazua Kisha edhe "Hosana" po thërret,\* "i bekuar je, o Zot



që vjen, Shpëtimtar me lavd'.

**P**opuj, në Sion këndon siç i përket\* Perëndis', përbushni sa taksët\*<sup>39</sup> më Krisht, në Jerusalem;\* vjen me lavd, fuqi dhe me pushtet, edhe në të\* fort u bazua Kisha edhe "Hosana" po thërrret,\* "i bekuar je, o Zot që vjen, Shpëtimtar me lavd".

*Zbritësore: Náusan akrótomon*

**T**hithi shkëmb të ashpër

*Ipakioia Ting. Tërth. II*

**P**asi e himnuan më përpara me degë, judenjtë mosmirënjohës më pas e zunë me dru<sup>40</sup> Krishtin Perëndi; por ne, me besim të patundur, duke e nderuar përgjithmonë si mirëbërës, le t'i thërrasim përherë: I bekuar je ti që po vjen të rithërrasësh Adamin.

*Lexojmë homelinë e zotit Andrea të Kretës.*

*Ode IV*

*Irmosi: Hristós o erhómenos*

»**Ai** Krisht që dukshëm vjen,\*<sup>41</sup> do arrijë »pa vonim;\*<sup>42</sup> është ai Perëndia ynë,\* »vjen prej mali të dendur,\* vajzës së vir- »gjër që pa burr' lind,\* siç tha dikur një »profet;\*<sup>43</sup> ndaj të gjithë thërrsim:\* Lavd »fuqisë sate, o Zoti yn'.

**G**jithë malet dhe kodrat le të çahen duke buruar ngazëllim të fortë<sup>44</sup> për mëshirë, dhe drurët e pyllit le të duartrokasim. O kombe, lavdërojeni Krishtin dhe të gjithë ju, o popuj, duke e mburrur, thërrisni: Lavd fuqisë sate, o Zoti ynë.

**Z**oti që mbretëron mbi jetët,<sup>45</sup> do të vlijë i veshur me fuqi,<sup>46</sup> Hijeshia e bukurisë dhe e lavdisë së tij është e pakrahueshme në Sion;<sup>47</sup> prandaj të gjithë thërrsim: Lavd fuqisë sate, o Zoti ynë.

Është i pranishëm Zoti që e mati qiellin me pëllëmbë dhe tokën me shpullë,<sup>48</sup> sepse e zgjodhi Sionin; preferoi të banonte në të<sup>49</sup> dhe të mbretëronte mbi popujt që thërrasin besërisht: Lavd fuqisë sate, o Zoti ynë.

*Zbritësore: Hristós o erhómenos*

**Ai** Krisht që dukshëm

*Ode V*

*Irmosi: Tin Sión ep orus*

»**M**bi mal ngrihu ti që ungjillëzon fort, në »Jerusalem, Sion;\* ti që shpall me forcë, »ngrije lart zërin.\*<sup>50</sup> Për ty janë folur me »çudi\* të lavdëruara, qytet shenjt,\* famë- »madh i Perëndisë<sup>51</sup> Zot.\* Dhe paqe mbi »Izraelin<sup>52</sup> mbar',\* dhe në kombe shpë- »tim<sup>53</sup> dhe hir.

**P**erëndia që në më të lartat ulet mbi Keruvime<sup>5</sup> dhe mbikëqyr të ulëtat,<sup>54</sup> ai vjen me lavd dhe fuqi, dhe do të mbushen të gjitha me lavdërimin e tij hyjnor. Paqe mbi Izraelin<sup>52</sup> mbar',\* dhe në kombe shpëtim<sup>53</sup> dhe hir.

**O** Sion, mal i shenjtë i Perëndisë,<sup>55</sup> o Jerusalem, ngriji sytë e tu rotull, dhe shikoji bijtë e tu të mbledhur rreth teje; sepse ja ku erdhën nga larg<sup>56</sup> që t'i falen mbretit tënd. Paqe mbi Izraelin<sup>52</sup> mbar', dhe në kombe shpëtim<sup>53</sup> dhe hir.

*Zbritësore: Tin Sión ep orus*

**M**bi mal ngrihu

*Ode VI*

*Irmosi: Evoisan en efrosini*

»**M**e gaz thirrën\* të drejtët, shpirtat »e tyre; në botë tash\* po na lidhet\* be- »sëlidhje e re;<sup>57</sup> edhe populli\* u rinoftë »përmes spërkatjes me gjak të hyjnu- »eshëm.<sup>58</sup>

Pranoje ti,\* o Izrael, mbretërinë e Perëndis';\* ti që ecën\* në terr, shih drit' të madhe,<sup>59</sup> dhe populli\* u rinofte përmes spërkatjes me gjak të hyjnueshëm.<sup>58</sup>

T'i lësh, Sion,\* të zgjidhur pra të burgosurit që ti ke\* dhe nga gropa,\* injoranca e that', nxirri,<sup>60</sup> populli\* u rinofte përmes spërkatjes me gjak të hyjnueshëm.<sup>58</sup>

*Zbritësore: Evóisan en efrosini*

**Me gaz thirrën**

*Kontaqi*

*Ting. Tërth. II To throno en uranó*

Duke qenë hipur mbi fron në qiell,<sup>5</sup> mbi pulisht në tokë, o Krisht Perëndi, e pranove mburrjen e engjëjve dhe përhimnimin e fëmijëve që të thërrisnin: I bekuar je ti që vjen të rithërrasësh Adamin.

*Shtëpia*

Meqenëse e lidhe Hadhin, o i pavdekshëm, e vrave vdekjen dhe e ngjalle botën, foshnjat, duke mbajtur palma, të lavdëronin si fitimtar, o Krisht, dhe të thërrisnin sot "Hosana, ty, Birit të Davidit". Sepse thotë se nuk do të thërrisnin më foshnja për hir të foshnjës së Marjamës,<sup>61</sup> por vetëm ti kryqëzohesh për gjithë foshnjat dhe pleqtë; nuk do të lëvizë më shpata kundër nesh,<sup>62</sup> sepse brinja jote do të shpohet me shtizë,<sup>63</sup> ndaj, duke u ngazëlluar, themi: I bekuar je ti që vjen të rithërrasësh Adamin.

*Sinaksari i Mujorit dhe i soiëm:*

Në të njëjtën ditë, të Dielën e Palmave, kremtojmë panairin e shkëlqyeshëm dhe të lavdishëm të hyrjes së Zotit tonë Jisu Krisht në Jerusalem.

*Vargje:* Meqë u ul në pulisht ai që e tendosi qiellin me fjalë,<sup>64</sup>/ kërkon t'i zgjidhë vdekatarët nga idiotësia.

O Krisht, Perëndia ynë, me dhembshurinë tënde të pashprehshme, bëna fitimtarë mbi pasionet absurde dhe denjësona ta shohim fitoren tënde të qartë mbi vdekjen, domethënë ngjalljen tënde gazmore dhe jetëprurëse, dhe mëshirona.

*Ode VII*

*Irmosi: O dhiasosas en piri*

»Djemtë e tu abrahamian'\* mjaft të drejtë, ti i shpëtove\* nga zjarri, zhduke »krejt kaldenjt'<sup>65</sup>\* që u ngritën kurth pa »drejtësisht,<sup>66</sup> o Zot,\* Perëndi i bekuar »je,\* i himnuar; Zot i etërve tanë,<sup>67</sup> lavd ty.

»Popujt, të gjunjëzuar dhe të gëzuar bashkë me Nxënësit, i thërrisnin me palma Birit të Davidit: "Hosana". O Zot, Perëndi i bekuar je, i himnuar; Zot i etërve tanë,<sup>67</sup> lavd ty.

»Turma e patëkeq, natyra ende foshnjore, të përhimnoi siç të takonte ty, Perëndisë, mbretit të Izraelit dhe të engjëjve. O Zot, Perëndi i bekuar je, i himnuar; Zot i etërve tanë,<sup>67</sup> lavd ty.

»O Krisht, turmat të duartrokisnin dhe me degë palmash thërrisnin: "I bekuar është ai që erdhi, mbreti i jetëve". O Zot, Perëndi i bekuar je, i himnuar; Zot i etërve tanë,<sup>67</sup> lavd ty.

*Zbritësore: O dhiasosas en piri*

**Djemtë e tu abrahamian'**

*Ode VIII*

*Irmosi: Efránhiti Ierusalim*

»Dëfre, o qytet Jerusalem;\* dhe, sa e »doni Sionin, të bëni tok panair,<sup>68</sup> sepse »ai që mbretëron në jet',<sup>45</sup> i madhi Zot\* i »fuqive,<sup>69</sup> ka ardhur;\* ndrojtje para faqes »së tij\* tërë dheu të ket'<sup>70</sup> duke thirrur:\* »Zotin përhimnojoni gjithë ju, vepra, pra »çdo krijim.<sup>71</sup>



**O** Sion, mbreti yt, Krishti, erdhi i hipur mbi pulisht, sepse arriti ta vithiste mashtrimin e palogjikshëm të idhujve dhe ta frenonte vullin e papërbajtur të gjithë kombeve, që të psalin: Zotin përhimnojeni gjithë ju, vepra, pra çdo krijim.<sup>71</sup>

**G**ëzohu fort, o Sion, Perëndia yt, Krishti, mbretëroi në Jetë;<sup>72</sup> siç është shkruar, ai erdhi i butë dhe për të shpëtuar, Çlirimtari ynë i drejtë arriti mbi pulisht<sup>2</sup> që të shkatërronte arrogancë kali të armiqve që nuk thërrasin: Zotin përhimnojeni gjithë ju, vepra, pra çdo krijim.<sup>71</sup>

**Shkon** rrallë në avllitë hyjnore Këshilli i paligjshëm i të pabindurve, sepse shtëpinë e lutjes së Perëndisë, e bëri shpellë hajdutësh,<sup>73</sup> kur nga zemra e zmbrapsi Çlirimtarin, për të cilin thërrasim: Zotin përhimnojeni gjithë ju, vepra, pra çdo krijim.<sup>71</sup>

*Zbritësore: Efránthiti Ierusalim*

**D**ëfre, o qytet

*(Nuk psalet Më të nderuarën)*

*Ode IX*

*Irmosi: Theòs Kírios që epëfanen*

»Perëndia është!\* Zoti dhe u shfaq ndër »ne,\* të bëni një festë;<sup>74</sup> ejani me nga »zëllim,\* Krishtin\* le ta madhërojmë »njësh,\* me degë edhe me palma himn »të thërrasim tok:\* Është i bekuar fort ai »që vjen\* pra në emrin zotëror të Shpëtuesit ton'.

**P**se, o priftërinj,\* shkrues, pse menduat kot?\* Dhe, pse u tërbuat, kombe?<sup>75</sup> Thatë "Kush është ky?\*" Për k'të\* me dafina, palma tok,\* fëmijët, duke himnuar, thërrasin me hare:\* Është i bekuar fort ai që vjen\* pra në emrin zotëror të Shpëtuesit ton'.

**K**y është' Perëndi,\* dhe s'ka tjetër mu si ky;\* ka gjetur një udhë krejt të drejtë dhe ia dha\* kombit\* Izrael të dashur mjaft;\* pastaj u shfaq dhe u shoqërua me njerëzit.\*<sup>76</sup> Është' i bekuar fort ai që vjen\* pra në emrin zotëror të Shpëtuesit ton'.

**P**se i vutë, ju,\* bri nesh, të pabindur shumë,\* skandalet e udhës?<sup>77</sup> Keni këmb' të shpejta ju,\* doni\* derdhje gjaku<sup>78</sup> zotëror,\* por Krishti do ngrihet, do shpëtojë çdokënd që thot':\* Është' i bekuar fort ai që vjen\* pra në emrin zotëror të Shpëtuesit ton'.

*Zbritësore: Theòs Kírios që epëfanen*

**P**erëndia është'

*Dërgimësore*

I shenjtë është Zoti, Perëndia ynë. (3x pa Lartësoni).

*Lavdërimet Idhiomele (në 6)*

*Ting. IV*

**O** Zot, turma e madhe i shtrinte në udhë rrobat e saj; të tjerë prisnin degë pemësh dhe i mbanin, ndërsa ata që paraprinin dhe ata që vinin pas, thoshin duke bërtitur: Hosana për Birin e Davidit, i bekuar je ti që ke ardhur dhe që do të vish përsëri në emrin e Zotit. (2x)

**K**ur po hyje në qytetin e shenjtë,<sup>11</sup> o Zot, popujt mbanin degë pemësh dhe të himnonin ty, Sunduesin e të gjithave,<sup>79</sup> kur të panë të ulur mbi pulisht, të mendonin si të hipur mbi Keruvime,<sup>5</sup> dhe prandaj thërrisnin kështu: Hosana në më të lartat, i bekuar je ti që ke ardhur dhe që do të vish përsëri në emrin e Zotit. (2x)

**D**ilni, o kombe, dilni dhe ju, o popuj, dhe shihni sot mbretin e qiejve<sup>80</sup> që po vjen në Jerusalem mbi pulisht të thjeshtë si mbi fron të lartë.<sup>81</sup> O gjeneratë e pabesë dhe

kurorëshkelëse judenjsh,<sup>82</sup> eja shih atë që e pa Isaia të arrinte<sup>83</sup> në mish për ne, qysh martohet, si i mençur, me Sionin e re, dhe e dëbon Sinagogën e dënuar; dhe, si në dasmë të paprishshme dhe të pacenueshme, vrapuan duke e mburrur tok fëmijët e patëkeq e të sinqertë; së bashku me ta, duke himnuar, le t'i thërrasim himnin engjëllor: Hosana në më të lartat, për atë që ka përdëllim të madh.<sup>83a</sup>

**O** Krisht Perëndi, për bindjen e të gjithëve, e shfaqe para pësimit tënd vullnetar<sup>4</sup> ngjalljen e përbashkët, kur Llazarin, të vdekur që prej katër ditësh, e ngrite në Betani me forcën tënde të pushtetshme; dhe, si dritëdhënës, o Shpëtimtar, u dhurove të verbërve shikimin;<sup>84</sup> dhe në qytetin e shenjtë<sup>11</sup> hyre së bashku me Nxënësit e tu, i ulur mbi pulisht gomareje, si i hipur mbi Keruvime,<sup>5</sup> duke i përmbushur predikimet e profetëve; dhe fëmijë hebrenjsh të mirëprisnin me degë dhe palma; prandaj dhe ne, duke mbajtur degë ullinjsh dhe palmash, të thërrasim me kënaqësi: Hosana në më të lartat, i bekuar je ti që vjen në emrin e Zotit.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

**G**jashtë ditë para Pashkës, Jisui erdhi në Betani.<sup>12</sup> Dhe i shkuan pranë Nxënësit e tij dhe i thanë: "O Zot, ku do që të të përgatisim të hash Pashkën?". Dhe ai i dërgoi dhe u tha: "Shkoni në qytezën përballë dhe do të gjeni një njeri duke mbajtur një shtambë uji. Ndiqeni atë dhe thojini zotit të shtëpisë: 'Mësuesi thotë, se do ta bëmë bri teje Pashkën bashkë me Nxënësit e mi'".<sup>13</sup>

*Dhoksologjia e Madhe.*

*Në Liturgjinë (e shën Joan Gojartit),  
Antifonet:*

*Antifoni i parë*

*Varg a):* Desha, se do ta dëgjojë Zoti zërin e lutjes sime.

Me ndërmjetimet e Hyjllindëses.

*Varg b):* Më rrethuan dhimbje vdekjeje, rreziqe Hadhi më gjetën.

Me ndërmjetimet.

*Varg c):* Gjeta shtrëngim dhe dhimbje, dhe e thirra emrin e Zotit.

Me ndërmjetimet.

*Varg d):* Do të jem i pëlqyeshëm para Zotit në vend të gjallësh.

Me ndërmjetimet.

Lavdi dhe Tani  
Me ndërmjetimet.

*Antifoni i dytë*

*Varg a):* Besova, prandaj fola, ndërsa unë u përula fort.

Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që u lue mbi pulisht gomareje, ne që të psalim Aliluia.

*Varg b):* Me çfarë do t'ia shpërblej Zotit për të gjitha ato që më shpërbleu?  
Shpëtona.

*Varg c):* Kupë shpëtimi do të marr dhe emrin e Zotit do të thërras.  
Shpëtona.

*Varg d):* Ato që ia taksa Zotit, do t'ia jap para gjithë popullit të tij.  
Shpëtona.

Lavdi dhe Tani  
O i vetëmlindur

*Antifoni i tretë*

*Varg a):* Lavdërojeni Zotin, se është i mirë, se përdëllimi i tij është përjetë.  
Vërtetove Ngjalljen e përbashkët.

*Varg b):* Le të thotë pra shtëpia e Izraelit



se është i mirë, se përdëllimi i tij është përjetë.

Vërtetove Ngjalljen e përbashkët.

*Varg c):* Le të thotë pra shtëpia e Aaronit se është i mirë, se përdëllimi i tij është përjetë.

Vërtetove Ngjalljen e përbashkët.

*Varg d):* Le të thonë pra të gjithë ata që ia kanë frikën Zotit, se është i mirë, se përdëllimi i tij është përjetë.

Vërtetove Ngjalljen e përbashkët.

### *Hyrtores*

I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit; Perëndia është Zoti dhe u shfaq ndër ne. Shpëtona.

*Pas Hyrjes, të dyja Përlëshoret. Kontaqi* Duke qenë hipur. *Trishenjti. Në vend të* Të meriton, *Irmosi* Perëndia është Zoti. *Kungatore* I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit; Alluia. *Në vend të* Pamë dritën, *Përlëshorja* Vërtetove Ngjalljen e përbashkët.

*Në tavolinë bëhet "ngushëllim" për vëllezërit, se hamë peshk.*



### NË TË NJËTËN TË DIEL NË MBRËMËSORE

*Nuk lexohet Psaltri (si në të gjitha të dielat e vitit).*

*Thirrtores Idhiomele (Pasvargjet e Mbrëmësorese së Madhe fq. 325)*  
*Ting. Tërth. IV*

Ki gaz dhe dëfre, o qytet Zion (2x)

Sot në qytetin Jerusalem (2x)

Ti që rri mbi Keruvime (2x)

Lavdi

*E para:* Ki gaz dhe dëfre, o qytet Zion

Tani

*E treta:* Ti që rri mbi Keruvime

*Hyrje.* O dritë gazmore. *Proqimen (i ditës)*  
*Ting. Tërth. IV:* Ja tani bekoni Zotin, gjithë ju shërbëtorët e Zotit.

*Varg:* Ju që qëndroni në shtëpinë e Zotit, në oborret e shtëpisë së Perëndisë tonë.

### *Pasvargje Idhiomele* *Ting. II*

Nga palmat dhe degët, si nga e kremtja hyjnore, pasi kaluam në të kremen tjetër hyjnore, në atë të nderuar të pësimeve të Krishtit, pra të festës shpëtimtare, o besnikë, le të vrapojmë së bashku dhe le ta shohim atë që duron për ne pësim vullnetar;<sup>4</sup> dhe atij le t'i këndojmë himnin duke e falënderuar dhe duke i thirrur siç i takon: O burimi i dhembshurisë, limani i shpëtimit, o Zot, lavdi më ty.

*Varg:* Këndojini Zotit një këngë të re.

### *Ting. III*

Është e tmerrshme të biesh në duart e Perëndisë së gjallë.<sup>85</sup> Ai është gjykatës i mendimeve dhe i ideve të zemrës.<sup>85a</sup> Askush të mos futet duke provokuar besimin e paqortueshëm, por me butësi dhe frikë le t'i afrohej Krishtit, që të marrim përdëllim dhe të gjejmë hir për ndihmë në kohën e duhur.<sup>86</sup>

*Varg:* E panë të gjitha anët e tokës shpëtimin e Perëndisë tonë.

### *Ting. i Rëndë*

O Sinagogë dinake dhe kurorëshkelëse,<sup>82</sup> që nuk ia mbajte besën burrit tënd, pse ke dhiatë kur nuk je trashëgimtare e saj? Pse krenohesh me Atin ndërsa ia shpërfille Birin? Ti s'i pranove profetët që e shpallën Birin; të paktën, ki turp nga bijtë e tu që thërrasin kështu: Hosana për Birin e Davidit, i bekuar është ai që vjen

në emrin e Zotit.

Lavdi

*I pari:* Nga palmat dhe degët

Tani

*I dyti:* Është e tmerrshme

Tani përlëshoje. *Trishenjtë etj. si në Mbrëmësoren e së Dielës së të Lidhurit të Djathit (fq. 57), por Përlëshimi i përshtatshëm (nga "Uratore e Vogël").*

*Nëse Triodi i Pasdarkës, që vijon pikërisht më poshtë, nuk do të psalet në Pasdarkë, atëherë psalet pas Tani përlëshoje. Në fund Irmosi Alótrion ton miteron: E huaj është virgjëria. Në vazhdim Trishenjtë etj. si në Mbrëmësoren e së Dielës së të Lidhurit të Djathit, por Përlëshimi i përshtatshëm (nga "Uratore e Vogël").*



## NË TË NJËTËN DITË NË PASDARKË

*Triodi, poezi e zotit Andrea të Kretës*

*Ting. Tërth. IV*

*Ode I*

*To sintripsanti*

Le ta imitojmë, o besnikë, mençurinë e Josifit,<sup>87</sup> le ta njohim atë që e nderoi esencën e logjikshme të njerëzve, pasi të sillemi me vigjilencë të madhe nëpërmjet virtutit praktik.

Mosveprimi i të mirave u shëmbëllje me fikun, ndaj ta evitojmë që të mos thahemi si ai atëherë; ai paraikonizonte Sinagogën e mbushur me gjethe.<sup>88</sup>

Josifi, duke skicuar ikonën e Zotit, vendoset poshtë në gropë, flaket prej vëllezërve,<sup>89</sup> i duron të gjitha, i kënduari, si tip i vërtetë i Krishtit.

O vëllezër, le ta evitojmë pafrytshmërinë e fikut, ta dimë shëmbullin, që të mos thahemi si ai atëherë që Njeridashësi, kur po kthehej, shkoi i uritur tek ai.<sup>88</sup>

Jisui, duke nxituar të pësonte për botën, u ngjit me dashje bashkë me Nxënësit e tij në qytetin Jerusalem drejt pësimit të tij<sup>90</sup> vullnetar,<sup>4</sup> për të cilin kishte ardhur.

Pasi të ngjitemi te Zoti<sup>91</sup> që nxitohet t'i pësojë të gjitha, le të bëhemi gati për tallje, pështyma dhe përqeshje, që të lavdërohemi bashkë, o shpresëplotë, me anën e pësimeve të tij<sup>92</sup> të pacenuara.

Ai që pësoi për ne, i shëron pasionet me pësimet, se vullnetarisht<sup>4</sup> pranon, në esencën njerëzore sipas nesh, pësimet e tij jetëbërëse, që të shpëtojmë ne.

Lavdi *Triadik*

Lavdëroj tri të panisshme, tri të shenja po himnoj, tri të bashkëpërrjetshme, por në një esencë po i shpall me besë. Një Perëndi në Atin, Birin edhe Shpirtin e Shenjtë lëvdoj.

Tani *Hyjlindësor*

Shkopi i Moisiut<sup>93</sup> dhe ai i Aaronit<sup>94</sup> kishin ndryshim paradoks dhe Ekonomi përmbi mendje; ndërsa mitra jote, o Perëndilindëse, bën një lindje të re.

*Ndenjëso*

*Ting. IV Epefanis simeron*

O shpirt, akuza e fikut<sup>88</sup> mos të të arriftë, por nxito t'i sjellësh Bërësit tënd Krisht fryte të mira, përmes brazdate të zemrës, duke iu ofruar me pendim.

*Ode VIII*

*Ton en ori ajo dhoksasthenta*

Pasi ta stolisim jetën me mençuri dhe ta ruajmë besimin me urtësi, nëpërmjet



drejtësisë le të fitojmë mënyra me qëllim që, duke ndjekur me burrëri<sup>95</sup> Krishtin, të kryqëzohemi me të.<sup>96</sup>

**P**atriarku Josif, kur e gjeti egjiptianen si një tjetër Evë,<sup>33</sup> nuk u mashtrua për faj të rëndë,<sup>87</sup> por qëndroi si një diamant, dhe nuk u pushtua nga pasionet e mëkatit.

**O** Shpëtimtari im, duke kaluar nëpër udhët e jetës, kishe uri vullnetarisht<sup>88</sup> ngaqë dëshiroje shpëtimin e të gjithëve; se kishe uri për këtë: për kthimin e atyre që dështuan larg teje.

**P**araati, kur e shijoi drurin,<sup>33</sup> kuptoi menjëherë që ishte lakuriq, pati turp, mori gjethe fiku dhe u vesh;<sup>97</sup> ky i fundit e paraikonizonte Sinagogën e zhveshur, pa Krishtin.

**P**ërgatitu, o shpirt, para daljes, hijeshohu për jetën e përtëjshme, dhe nxito të pësosh, të kryqëzohesh<sup>98</sup> dhe të vdesësh bashkë me Krishtin, i cili nxiton të pësojë për ty, që të të lavdërojë.<sup>92</sup>

**O** Shpëtimtari im, si të mos frikësohej vdekja? Si të mos tmerrohej Hadhi kur të takoi ty që, me mirëdashjen e Atit, nxitoje drejt pësimit dhe të pa që erdhe për të pësuar ti, i drejti, për hir të të padrejtëve?<sup>98</sup>

**J**udenjtë, priftërinjtë dhe levitët, kur panë ngritjen e L Lazarit, pasi kurdisën nga xhelozia intriga me anë të tinëzisë së tradhtisë,<sup>99</sup> ia dorëzuan Krishtin për vdekje Pilatit.<sup>100</sup>

**S**hqerra jote, shërbëtore dhe virgjëreshë, kur të shikonte që hidheshe drejt pësimit<sup>4</sup> dhe lije dhe shpirtin për ne, ti, Bari u mirë,<sup>101</sup> vuante për ty thellë në shpirtin nënor.

Lavdi *Triadik*

**T**ë himnoj si Njësi në esencë, të adhuroj si Trini në Persona, o Atë, Bir dhe Shpirt i Tërëshenjtë; e lavdëroj në jetë si të panisshëm pushtetin e mbretërisë sate.

Tani *Hyjindësor*

**T**ë përgjërohet, o Krisht, Perëndilindësja, të lyp bashkësia e Nxënësve: Dhuroji botës sate paqen tënde,<sup>102</sup> dhe neve na fal paqurisht dhembshuritë e tua në jetë.

*Ode IX*

*Alótrion ton miteron*

**E** huaj është për të pahijshmit mençuria, dhe e huaj për të drejtët paligjësia. Dhe Josifi i madh iku larg mëkatit<sup>87</sup> dhe u bë ikonë mençurie dhe vërtet simbol i Krishtit.

**E** huaj është për të paligjshmit ligjshmëria dhe për të pabesët njohja e Perëndisë. Judenjtë i zbrapsën këto për hir të paligjësisë, prandaj dhe vetë ata, pikërisht si fiku, e trashëguan mallkimin.<sup>88</sup>

**K**rishti, Perëndia im, duke qenë bukë jete,<sup>103</sup> kishte uri për shpëtimin e njerëzve; dhe, si arriti te fiku, pra te Sinagoga e pafrytshme, sapo e pa të mbushur me gjethe Ligjore, e mallkoi.<sup>88</sup>

**O** Shpëtimtar, mallkove më parë pafrytshmerinë Ligjore, sepse nxirrte gjethe, mentalitetin e germës<sup>104</sup> në hije,<sup>105</sup> dhe, për shkak të paligjësisë, s'kishte frytet<sup>88</sup> e veprave; por bekona të gjithë ne, bijtë e Hirit.

**N**ga njëra anë, purteka e Moisiut u shndërrua dikur në giarpër,<sup>93</sup> nga ana tjetër, bastuni i Aaronit në gjelbërim, dhe lulëzoi gjethe ai i pafrytshmi dhe i thari;<sup>94</sup> por Sinagoga ilegale u shndërrua në fik të pafrytshëm.<sup>88</sup>

**O** Judë, përgatiti priftërinjtë e tu, hijeshoji duart e tua për vrasjen e Perëndisë, sepse ja ku erdhi i butë dhe i qetë<sup>2</sup> te pësimi Krishti, mbreti i Izraelit, që është qengji<sup>106</sup> dhe bariu ynë.<sup>101</sup>

**Mirëprite, o Judë, mbretin, sepse ja ku vjen vullnetarisht drejt pësimi<sup>4</sup> që të vuajë dhe të shpëtojë ata që thërrasin pa pushim: I bekuar është ai që vjen ta shpëtojë Gjithësinë nëpërmjet Kryqit.**

**O** Judë, Zoti i shndërroi festat e tua në zi, sipas profecisë,<sup>107</sup> sepse u shfaqe si vrasëse e Perëndisë, të atij që ktheu dikur gurin e thepisur në ujëra dhe liqene, siç psal Davidi.<sup>37</sup>

#### Lavdi *Triadik*

**Është e huaj për të paudhët të të lavdërojnë ty, esencën pa fillim, Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, gjithëkundimin e pakrijuar, përmes të cilit tërë bota u sigurua me shenjë e pushtetit të tij hyjnor.**

#### Tani *Hyjllindësor*

**O** Zot, sjellim për ndërmjetim Perëndilindësen; me përgjërimit e saj dhe të apostujve të tu, bëna pjesëmarrës të të mirave të tua dhe denjësona për shkëlqimin e ngjalljes sate, o Shpëtimtar.

#### *Zbritësore: Alótrion ton miteron*

**»E huaj është\* virgjëria për nënat, Zonjë,\*  
»e huaj është lindja\* për çdo virgjërëshë,\*  
»në ty Ekonomia hyjnore i ka bër' të dyja,\*  
»pra gjithë fiset nëpër botë, pa pushim të lumërojn', Mari.<sup>108</sup>**

#### *CITIME*

Ngjallja e Lazarit: Joan 11.1-44  
Hyrja e Krishtit në Jerusalem në ditën e Palmave: Matth. 21.1-11; Mark 11.1-10;  
Lluk. 19.28-38; Joan 12.12-15

3. Zah. 9.10; Ps.77(78),66
4. Joan 10.15,17-18
5. II Mbret. [Sam.] 6.2; Ps. 79(80).2; 98(99).1; Is. 37.16; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 31
6. II Kor. 8.9
7. Matth. 16.24; Mark 8.34; 10.21; Lluk. 9.23
8. Is. 66.1
9. Rom. 16.4
10. Is. 44.2
11. II Makk. 9.14; 15.14; III Makk. 6.5; Is. 52.1; 66.20; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 4; 9.24
12. Joan 12.1,12
13. Matth. 26.17-19; Mark 14.12-15; Lluk. 22.7-13
14. Vep. 2.3-4
15. Ps. 88(89).8
16. Matth. 5.17
17. Ps. 46(47).8; Sirak 1.8; Is. 6.1; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 32
18. II Makk 1.24; Sirak 24.8
19. Zah. 2.14
20. Ps. 50(51).2; 68(69).17; Is. 63.15
21. Ps. 17(18).11
22. Joan 11.46-53
23. Rom. 6.4-5; Kol. 2.12-13
24. Gjen. 3.17-19
25. I Kor. 15.45
26. Joan 3.17; 12.47
27. IV [III] Mbret. 19.15,19; II Makk. 7.37; Ps. 85(86).10; Is. 37.16,20
28. Eks. 14.21-22 etj.
29. Ps. 105(106).9
30. Eks. 19.5; 23.22; Ligji i Dytë 7.6; 14.2; 26.18; Tit. 2.14
31. Eks. 14.29-15.1
32. Ps. 8.3
33. Gjen. 3.6
34. Ps. 149.1
35. Ps. 9.12
36. Ps. 97(98).8-9
37. Eks. 17.6; Num. 20.8-11; Ligji i Dytë 8.15; 32.13; Ne. 9.15; Ps. 77(78).15-16,20; 104(105).41; 113(114).8; Urt. Sol. 11.4
38. I Kor. 10.4
39. Ps. 21(22).26 etj.
40. Matth. 26.47-57; Mark 14.43-46; Lluk. 22.52-54
41. Ps. 49(50).3
42. Abak. 2.3
43. Abak. 3.3
44. Is. 49.13
45. Ps.144(145).13; I Tim. 1.17
46. Ps. 92(93).1
47. Ps. 49(50).2
48. Is. 40.12
49. Ps. 131(132).13
50. Is. 40.9
51. Ps. 86(87).3
52. Ps. 124(125).5; 127(128).6
53. Ps. 66(67).3
54. Ps. 112(113).5-6
55. Ps. 2.6
56. Is. 49.18; 60.4
57. Jer. 38(31).31
58. Hebr. 12.24; I Petr. 1.2

1. Is. 6.2-3

2. Zah. 9.9; Matth. 21.5



59. Is. 9.2; Matth. 4.16  
 60. Zah. 9.11  
 61. Matth. 2.16  
 62. Gjen. 3.24  
 63. Joan 19.34  
 64. Gjen. 1.6-8  
 65. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23-26  
 66. Dan. 3.8-11  
 67. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28  
 68. Is. 66.10  
 69. II Mbret. [Sam.] 6.2 etj.  
 70. Abak. 2.20  
 71. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34  
 72. Apok. 11.15  
 73. Jer. 7.11; Matth. 21.13; Mark 11.17; Lluk. 19.46  
 74. Ps. 117(118),27  
 75. Ps. 2.1  
 76. Baruh 3.36-38  
 77. Ps. 139(140),6  
 78. Is. 59.7; Rom. 3.15  
 79. Jov 5.8; Urt. Sol. 6.7; 8.3  
 80. I Esd. 4.46,58; III Makk. 2.2; Dan. 4.34  
 81. Is. 6.1  
 82. Matth. 12.39; 16.4; Mark 8.38  
 83. Is. 40.10  
 83a. Num. 14.19 etj.  
 84. Is. 61.1; Matth. 11.5; 15.30-31; Lluk. 4.19; 7.21-22; Joan  
 10.21  
 85. Hebr. 10.31  
 85a. Hebr. 4.12  
 86. Hebr. 4.16  
 87. Gjen. 39.6-12  
 88. Matth. 21.18; Mark 11.12,20  
 89. Gjen. 37.19-24  
 90. Matth. 20.17-19; Mark 10.33-34; Lluk. 18.31-33  
 91. I Kor. 6.17  
 92. Rom. 8.17  
 93. Eks. 4.3  
 94. Num. 17.23; Hebr. 9.4  
 95. Urt. Sol. 8.7  
 96. Rom. 6.6; Gal. 2.20  
 97. Gjen. 3.7  
 98. Rom. 5.6-8  
 99. Joan 11.45-53  
 100. Matth. 27.1-2; Mark 15.1; Lluk. 23.1; Joan 18.28-29  
 101. Joan 10.11,14  
 102. Joan 14.27  
 103. Joan 6.35,48,51  
 104. Rom. 7.6; II Kor. 3.6  
 105. Hebr. 10.1  
 106. Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vepr. 8.32; I Petr. 1.19  
 107. Amos 8.10  
 108. Lluk. 1.48



# HIMNET TRIADIKE DHE FOTAGOJIKËT

që psalen sipas Tingullit të javës gjatë Kreshmës së Shenjtë dhe të Madhe

*I plotësojmë troparet e para të Triadikeve dhe Fotagojikëve me karakteristikat e çdo dite si më poshtë:*

*Të hënën:* me mbrojtjen e të patrupëve

*Të martën:* me ndërmjetimet e Pararendësit

*Të mërkurën dhe të premten:* me fuqinë e Kryqit tënd

*Të enjten:* me ndërmjetimet e apostujve

*Të shtunën:* me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu

*Troparet e dyta i plotësojmë me karakteristikën e shenjtut të kishës, p.sh. "me ndërmjetimet e athloforit" ose "e oshënarit", ose "e hierarkut" etj. Të tretat me "me ndërmjetimet e Hyjlindësës".*

*Nëse Kisha nderon Zotin Krisht ose Perëndilindësen, në të dytat përsëriten karakteristikat e të parave. Por të enjten, meqë përveç apostujve kujtohet edhe shën Nikolla, në të dytat shtohet me ndërmjetimet e hierarkut.*

## TINGULL I PARË

### Triadiket

Ne, duke u transferuar lart, drejt kuptimit jolëndor, përmes pamjes trupore të Forcave pa trup dhe duke pritur, përmes melodisë trishenjtoje, ndriçim nga Hyjnia trihipostate, le t'i thërrasim, si Keruvimet, Perëndisë unik: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

### Lavdi

Bashkë me tërë Fuqitë qiellore le t'ia thërrasim lavdërimin trishenjtor, si Keruvimet, atij që është në më të lartat: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë;

[...] shpëtona.

### Tani

Pasi u ngritëm prej gjumit, biem para teje, o i mirë, dhe të thërrasim himnin e engjëjve, o i fortë: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë, me ndërmjetimet e Hyjlindësës mëshirona.

### Fotagojiku

O Zot, që lind dritën, pastroje shpirtin tim nga çdo mëkat [...], dhe shpëtomë. (3x)

## TINGULL I DYTË

### Triadiket

Ne të mbidheshmit, duke imituar Fuqitë e sipërme, të ofrojmë himnin triumfal, o i mirë: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

### Lavdi

O natyrë e pakrijuar, Krijues i të gjithave, hapi buzët tona që të rrëfejme lavdërimin tënd,<sup>2</sup> duke thirrur: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

### Tani

Pasi më ngrite prej krevatit dhe gjumit, o Zot, ndriçoje mendjen time dhe hape zemrën dhe buzët e mia që të të himnoj, o Trini e Shenjtë: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë, me ndërmjetimet e Hyjlindësës mëshirona.

### Fotagojiku

Dërgoje dritën tënde<sup>3</sup> të përhershme, o Krisht Perëndi, dhe ndriçoji sytë e fshehtë të zemrës sime [...], dhe shpëtomë. (3x)

## TINGULL I TRETË

### Triadiket

O Trini e bashkëqenshme dhe e pandarë, Njësi trihipostate dhe e bashkëpërtjet-



shme, të thërrasim si Perëndi himnin e engjëjve: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Lavdi

**D**uke guxuar të lavdërojmë Atë të pafillim, Bir të bashkëpafillim dhe Shpirt të bashkëpërrjetshëm, një Hyjni, themi: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Tani

**P**apritur Gjykatësi do të vijë dhe veprat e secilit do të dalin lakuriq; pra, le të thërrasim në mes të natës: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë, me ndërmjetimet e Hyjlindëses mëshirona.

*Fotogjiku*

**D**ërgoje dritën tënde<sup>3</sup>, o Krisht Perëndi, dhe ndriçoje zemrën time [...], dhe shpëtomë. (3x)

## TINGULL I KATËR

*Triadiket*

**D**uke guxuar ta shqiptojmë ne të vdekshmit himnin e shërbyesve të tu mendorë, themi: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Lavdi

**A**shtu si rendet e engjëjve në qiej tani, edhe ne, rreshtat e njerëzve me frikë mbi dhë, të ofrojmë himnin triumfal, o i mirë: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Tani

**D**uke guxuar të lavdërojmë, si Keruvimet, Atin tënd pa fillim, dhe ty, o Krisht Perëndi dhe Shpirtin tënd të Tërëshenjtë, themi: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë, me ndërmjetimet e Hyjlindëses mëshirona.

*Fotogjiku*

**T**i që lind dritën në botën tënde, shpirtin tim që është në errësirë pastroje nga çdo mëkat [...], dhe shpëtomë. (3x)

## TINGULL TËRTHOR I TË PARIT

*Triadiket*

**Ë**shtë koha e himnodisë dhe ora e lutjes; le t'i thërrasim pa pushim Perëndisë unik: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Lavdi

**D**uke guxuar që t'i ikonizojmë ushtritë e tua mendore, o Triadhë pa fillim, thërrasim me gojë të padenja: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Tani

**O** Krisht Perëndi, që të nxuri mitra virgjërore dhe nuk u ndave nga gjiri i Atit,<sup>4</sup> pranona tok me engjëjt dhe ne që të thërrasim: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; me ndërmjetimet e Hyjlindëses mëshirona.

*Fotogjiku*

**O** Zot dritëdhënës, dërgoje dritën tënde<sup>3</sup> dhe ndriçoje zemrën time [...], dhe shpëtomë. (3x)

## TINGULL TËRTHOR I TË DYTIT

*Triadiket*

**D**uke qëndruar pranë me frikë Keruvimet dhe duke u shtangur me tmerr Serafimet,<sup>5</sup> ofrojnë me zë të pareshtur himnin trishenjtor. Së bashku me ta edhe ne mëkatarët thërrasim: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Lavdi

**M**e gojë të patrupësh, me dhoksologji të pareshtura, gjashtëkrahëset të këndojnë himnin trishenjtor, o Perëndia ynë;

edhe ne të mbidheshmit të drejtojmë lavdërim me buzë të padenja: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Tani

Le ta lavdërojmë Hyjninë e Njesisë Triadike që ka bashkim të papërzier, dhe le t'i thërresim himnin e engjëjve: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë, me ndërmjetimet e Hyjlindëses mëshirona.

*Fotagojiku*

[...], o Zot, dërgojuva poshtë shpirtave tanë dritën tënde të përjetshme. (3x)

### TINGULL I RËNDË

*Triadiket*

Ti që për hir të fuqisë së tërëlargtë për-himnohesh prej Keruvimeve dhe që për hir të lavdisë hyjnore të falen engjëjt,<sup>6</sup> pranona dhe ne mëkatarët që guxojmë të të thërrasim padenjësisht: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Lavdi

Hidhe tej dembelizmin si gjumin,<sup>7</sup> o shpirt, tregoji Gjykatësit korrigjim për lavdërim dhe thirr me frikë: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Tani

Duke i drejtuar Hyjnisë së paafueshme, Trinisë në Njësi, lavdërimin trishenjtor të Serafimeve, le të thërrasim me frikë: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë, me ndërmjetimet e Hyjlindëses mëshirona.

*Fotagojiku*

Nxitmë, o Zot, për himnodinë tënde dhe më mëso të bëj dëshirën tënde,<sup>8</sup> o i shenjtë, [...] dhe shpëtomë. (3x)

### TINGULL TËRTHOR I TË KATËRTIT

*Triadiket*

Duke pasur zemrat në qiell, le të imitojmë rendin engjëllor dhe le t'i biem me frikë para atij që nuk bën korrupsion, duke thirrur himnin triumfal: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Lavdi

Keruvimet, duke mos guxuar të të shikojnë,<sup>5</sup> fluturojnë dhe thërrasin me brohoritje melodinë e perëndishme të zërit trishenjtor. Tok me ta, edhe ne mëkatarët të thërrasim: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë; [...] shpëtona.

Tani

Ne, duke u përkulur nga shkeljet tona të shumta dhe duke mos guxuar të shikojmë drejt lartësisë sate,<sup>9</sup> pasi e përkulëm shpirtin bashkë me trupin, të thërrasim tok me engjëjt himnin: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,<sup>1</sup> o Perëndia ynë, me ndërmjetimet e Hyjlindëses mëshirona.

*Fotagojiku*

Duke qenë, o Krisht, dritë,<sup>10</sup> le të ndriçohem në ty [...] dhe të shpëtohem. (3x)

*CITIME*

1. Is. 6:2-3
2. Ps. 50(51).17
3. Ps. 42(43).3
4. Joan 1.18
5. Ps. 88(89).8
6. Ps. 96(97).7
7. Rom. 13.11
8. Ps. 142(143).10
9. Lluk. 18.13
10. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46





# VARGËZIME DHE NDENJËSORE KATANIKTIKE, HYJLINDËSORE, KRYQËSORE, KRYQHJYLINDËSORE, APOSTOLIKE DHE MARTIRIKE

që psalen sipas Tingullit të javës gjatë Kreshmës së Shenjtë dhe të Madhe  
(Martiriku thuhet kur Mujori s'ka Kontaq)

## TINGULL I PARË

### TË DIEJËN NË MBRËMËSORE

#### *Thirrtores Kataniktike*

#### *Ting. I*

**M**eqë deti i shkeljeve të mia është i madh, o Shpëtimtar, dhe jam mbytur tmerrshëm në paudhësitë e mia, ma jep dorën, shpëtomë si Petron, o Perëndi,<sup>1</sup> dhe mëshiro më.

**M**eqë u dënova për shkak mendimesh dhe veprash djallëzore, o Shpëtimtar, më dhuro mendim kthimi, o Perëndi, mua që të thërras: Shpëtomë, o mirëbërës i dhembshur, dhe mëshiro më.

**O** shpirt, të pret një tjetër botë dhe gjyqtar, i cili ka për t'i publikuar të fshehtat<sup>2</sup> dhe të tmerrshmet e tua; ndaj mos qëndro te të këtushmet, por nxito t'i thërrasësh gjykatësit: O Perëndi, le të të vijë keq për mua<sup>3</sup> dhe shpëtomë.

**O** Shpëtimtari im, mos më moho mua që jam pushtuar nga përtacia e mëkatit; ma ngri mendimin drejt pendimit dhe më trego punëtor të sprovuar të vreshtit tënd, si dhe më dhuro pagën e orës njëmbëdhjetë<sup>4</sup> dhe përdëllimin e madh.<sup>5</sup>

### TË HËNËN NË MËNGJESORE

#### *Pas Stihologjisë së parë*

#### *Ndenjësores Kataniktike Ting. I*

**M**eqë u zura në paudhësi,<sup>6</sup> unë i shtururi nuk guxoj të vështroj në lartësinë e qiellit,<sup>3</sup> por, duke u mbështetur në njeridashjen tënde, thërras: O Perëndi, le të të vijë keq për mua<sup>3</sup> dhe shpëtomë.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

**M**eqë i drejti me vështirësi shpëtohet, unë mëkatari ku do të shfaqem?<sup>7</sup> Nuk e mbajta peshën dhe vapën e ditës,<sup>8</sup> o Perëndi; më numëro së bashku me ata të orës njëmbëdhjetë<sup>4</sup> dhe shpëtomë.

#### *Lavdi dhe Tani Hyjllindësore*

**O** Hirplote, Krijesa ngazëllohet duke parë në ty çudinë e çudive, sepse zure pa farë dhe linde parrëfyeshëm atë që nuk mund ta vështrojnë dot batalionet e engjëjve;<sup>9</sup> atij përgjëroju, o Perëndilindëse, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

#### *Pas Odes VI Martirik*

**O** Zot, athloforët e lavdishëm të kanë veshur si krenari atletizmi dhe gradë kurorash, sepse me durim në tortura triumfuan mbi të paudhë, dhe me fuqi hyjnore e morën fitoren nga qielli; me përgjërimit e tyre dhurona, o Perëndi, përdëllimin tënd të madh.<sup>5</sup>

### TË MARTËN NË MËNGJESORE

#### *Pas Stihologjisë së parë*

#### *Ndenjësores Kataniktike Ting. I*

#### *Ton tafon su Sotir*

**N**xito t'më hapësh ti\* krahe ati; e prisha\* në shturje jetën time, por shoh pasurinë,\* bollëkun e mëshirës sate të pashtershme; mos e lër\* zemrën që tani\* e varfër është, se, o Zot,\* po thërras te ti\* me kataniks: Mëkatova,\* shpëtomë, i mirë krejt.<sup>10</sup>

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

Tribuna jote është e frikshme, i drejtë\* gjykimi yt,<sup>11</sup> të tmerrshme jan' veprat e mia,\* por ti arri, shpëtomë, o përdëllyes, nga Ferri skrop;\* më çliro, o Zot,\* mua nga pjesa e dhive,\* denjësom' të rri,\* gjykatës tepër i drejtë,\*<sup>11</sup> në të djathtën tënde pra.<sup>12</sup>

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësore*

Meqenëse e zure pa u djegur zjarrin e Hyjnisë dhe linde pa farë Zotin, burimin e jetës,<sup>13</sup> o Perëndillindëse hirplote, shpëtoji ata që të madhësojnë.

*Pas Odes VI Martirik*

*Tu lithu sfracjsthesos*

Shenjtore, si ushtarë të mirë,<sup>14</sup> me një mendje\* kishit besë, nga kërcënim tiranik hiç s'u tmerruat;\* si ngritët të çmuarin fort Kryq,\* pasuat Krishtin me gatishtëmëri,<sup>15</sup> dhe fitoren lart e morët prej qiellit\* kur udhën krejt e mbaruat;\*<sup>16</sup> lavd përforcuesit që ju dha forc';\* dhe lavd kurorëzuesit;\* lavd atij që përmes jush bën shërime ndër gjithë ne.

#### TË MËRKURËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësore Kryqësore Ting. I  
Ton tafon su Sotir*

Kur nëna pa qortim\* të shikonte mbi dru ty,\* të shtrirë dhe të vdekur, thërriste: Im Bir, je\* i bashkëpafillim me Atin dhe Shpirtin Shenjt, ç'është pra\* ky pësimi yt,\* Ekonomia që s'shprihet? Bërjen që me dor'\* pa cen e kreve,<sup>17</sup> i dhembshur,\* me të e shpëtove, Krisht.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

I falemi drurit të Kryqit tënd, o njeridashës Shpëtimtar, sepse në të u ngule ti, jeta e të gjithave;<sup>18</sup> ia hape Parajsën kusarit që të erdhë me besim dhe u denjësova për

shijim kur të pohoi: "Kujtomë, o Zot!",<sup>19</sup> Pranona si atë edhe ne që thërrasim: Të gjithë mëkatuam; falë dhembshurisë sate, mos na shpërfill.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësore*

*Tu lithu sfracjsthesos*

Kur shqerra të shikonte ty, qengjin, mes kusarësh\*<sup>20</sup> që po kryqëzoheshë,<sup>20a</sup> Fjalë, mbi dru dhe që në brinjë\* shtizoheshë,<sup>21</sup> thirri me vajtim,\* me klithmë porsi nënë: O Jisu,\* Biri im, ç'mister i huaj, i frikshëm është? Si mbyllesh në varr ti, Zoti,\* që s'ke përshkrim? Kjo ndodhje s'shprihet dot;\* o Biri im i ëmbël krejt,\* mos më lër pra të vetmuar keq, o zemërgjeri Krisht.

*Pas Odes VI Martirik*

Të ardhët keq për dhimbjet e shenjtoreve, të cilët pësuan për ty,<sup>21a</sup> o Zot, dhe shëroji gjithë dhimbjet tona, o njeridashës, të lutemi.

#### TË ENJTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësore Apostolike Ting. I  
Tu lithu sfracjsthesos*

Me fjalën si me rrjeta, me Kryqin si kallam tok\* peshkatarët, kur asgjësuam sofizma oratorësh,\* ndriçojn fort kombet që me bes'\* të të lëvdojnë si Zot të vërtet';\* ndaj te ti që i forcove, thërrasim himn:\* Lavdi ty, o Zot, o Atë;\* lavd Birit, Shpirtit të njëqenshëm lavd;\* lavd ty që përmes tyre pra\* botën e shkëlqeve dhe na shpëtove të gjithë ne.

*Varg:* Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

O peshkatarë të urtë të botës, përderisa e morët prej Perëndisë dhembshurinë, ndërmjetoni dhe tani për ne që thërrasim: O Zot, shpëtoji mbretërit dhe qytetin tënd dhe, nëpërmjet apostujve, çliroji shpirtat



tanë nga të këqijat që i shtrëngojnë.

Lavdi dhe Tani *Hyjindësore*

**O** Hyjindëse, përmbi mendim dhe dëgjim linde mbi dhë pa atë, atë që është në qiell pa nënë; atij përgjeroju për shpirtrat tanë.

*Pas Odes VI Martirik*

*Ton tafon su Sotir*

**T**'i lypim gjithë ne tok martirët e Krishtit,\* sepse shpëtimin tonë kërkojnë ata pra;\* të tërë të afrohemi pranë tyre me plot besim,\* se burojnë mjaft\* hir për shërime,<sup>22</sup> dhe zbojnë\* dhe kolona krejt\* demonësh, se janë rojat\* e besës së Zotit Krisht.

#### TË PREMTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kryqësore Ting. I*

**K**ur u kryqëzove, o Krisht, u zhduk tirania, u shkel fuqia e armikut, sepse as engjëll, as njeri, por vetë ti, Zoti, na shpëtovë;<sup>23</sup> lavdi më ty.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

*Ton tafon su Sotir*

**P**a mbreti shpresëtar\* Kostandin një arm', Kryqin,\* dikur në luftë, si një trofe të pamposhtur,\* përmes besimit, ndaj armiqsh; edhe forcat e Hadhit posht\* patën tmerr prej tij;\* dhe për besnikët shpëtimi,\* ndjesa ky u bë,\* dhe është mburrja e Pavlit\* si dhe krenari<sup>24</sup> plot lavd.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjindësore*

**O** e pacenuar, ne që e kemi mbrojtjen tënde dhe çlirohemi nga mjerimet me përgjërimit e tua, dhe ruhemi në çdo gjë nëpërmjet Kryqit të Birit tënd, të madhështojmë të gjithë besërisht, siç e kemi për detyrë.

*Pas Odes VI Martirik*

**O** Zot, athloforët e lavdishëm të kanë veshur si krenari atletizmi dhe gradë kurorash, sepse me durim në tortura triumfuan mbi të paudhë, dhe me fuqi hyjnore e morën fitoren nga qielli; me përgjërimit e tyre dhurova, o Perëndi, përdëllimin tënd të madh.<sup>5</sup>

#### TË PREMTEN NË MBRËMËSORE

*Te Thirtoret pas Idhiomelit*

*Martirike Ting. I*

**M**e ndërmjetimin e të gjithë shenjtoreve dhe të Hyjindësës, o Zot, na jep paqen tënde<sup>25</sup> dhe mëshirona, si i vetmi i dhembshur.

**O** shenjtore, pohimi juaj i mirë në stadium e frikësoi fuqinë e demonëve dhe i çliroi njerëzit nga mashtrimi; prandaj, kur po jua pritnin kokat, thërrisnit: O Zot, le të bëhet i mirëpritur para teje flijimi<sup>26</sup> i shpirtave tanë, sepse, meqë të dëshiruam thellë, e shpërfillëm jetën kalimtare, o njeridashës.

**O**h, sa e mirë është tregtia juaj, o shenjtore! Sepse dhatë gjakra dhe trashëguat qiej; dhe, pasi u sprouat për njëfarë kohe,<sup>27</sup> ngazëlloheni përjetësisht; me të vërtetë që i mirë malli juaj, sepse, kur braktisët të prishshmet, shijuat të pa-prishshmet; dhe, duke kërcyer tok me engjëjt, e himnoni pa pushim Trininë e bashkëqenshme.

*Panëfimi martires*

**M**artirë të famshëm krejtësisht,\* toka nuk ju fshehu dot,\* por ju mikpriti lart qielli, ju hapën plotësisht\* dyert e Parajsës\* dhe, si hytë brenda, po shijoni drurin, pemën e jetës,<sup>28</sup> Krishtit përgjerojuni\* që në shpirt të na dhurohet hir,\* paqe dhe përdëllim i madh<sup>5</sup> gjithnjë.

Lavdi *Idhiomeli Nekrosim*,  
poezi e Joan Monakut.

Cili gëzim i jetës mbetet i papërzier me hidhërim? Cila lavdi qëndron mbi dhé e pandryshuar? Të gjitha janë më të dobëta se hija, të gjitha janë më të rreme se ëndrrat; një çast dhe të gjitha këto i zëvendëson vdekja. Po te drita e fytyrës sate dhe tek ëmbëlsia e bukurisë sate, o Krisht, prehi ata që zgjodhe si njeridashës.\*

Tani *Hyj lindësore*

Lavdin' e përbotëshme që u mboll prej njerëzish dhe lindi Zotin, derën qiellore,<sup>29</sup> Marinë Virgjëreshë, le ta himnojmë, këngën e engjëjve dhe zbulimin e besnikëve, se ajo u rrëfye qiell dhe tempull i hyjnisë; ajo, duke rrëzuar mesmurin<sup>30</sup> e armiqtë, kallë paqen në vend të saj dhe e çeli mbretërinë. Duke pasur pra atë spirancën<sup>31</sup> e besës, kemi përluftar atë që lindi prej saj. Le të ketë pra kurajë, le të ketë kurajë popull' i Perëndisë se ai do t'i luftojë armiqtë si i tërëfuqishëm.\*

## TË SHITUNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësore Martirike Ting. I  
Tu lithu sfragjisthentos*

Shenjtore, si ushtarë të mirë,<sup>14</sup> me një mendje\* kishit besë, nga kërcënim tiranik hiç s'u tmerruat;\* si ngritët të çmuarin fort kryq,\* pasuat Krishtin me gati-shmëri,\*<sup>15</sup> dhe fitoren lart e morët prej qiellit\* kur udhën krejt e mbaruat;\*<sup>16</sup> lavd përforcuesit që ju dha forc' :\* dhe lavd kurorëzuesit;\* lavd atij që përmes jush bën shërime ndër gjithë ne.

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

Të ardhte keq për dhimbjet e shenjtoreve,

të cilët pësuan për ty,<sup>21a</sup> o Zot, dhe shëroji gjithë dhimbjet tona, o njeridashës, të lutemi.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

*Ton tafon su Sotir*

T'i lypim gjithë ne tok martirët e Krishtit,\* sepse shpëtimin tonë kërkojnë ata pra;\* të tërë të afrohem pranë tyre me plot besim,\* se burojnë mjaft\* hir për shërim, <sup>22</sup> dhe zbojnë\* dhe kolona krejt\* demonësh, se janë rojat\* e besës së Zotit Krisht.

Lavdi *Nekrosime*

*E ngjashme*

Ti veshe mish për ne\* pa ndryshim prej një nëne\* të virgjër, Krisht, në vitet e fundit,<sup>32</sup> ndaj si Zot\* e di sa lehtë shkasim; ndaj dhembshuroji të ikurit\* që nga jeta posht',\* se t'i besuan drejt shpirtat\* plot me përkushtim\* ty, Perëndisë së vetëm,\* të mirë dhe sundimtar.

Tani *Hyj lindësore*

Gabrieli kur të tha Virgjëreshë gëzohu,<sup>33</sup> bashkë me zërin mishërohej Zot' i Gjithësisë<sup>33a</sup> te ti arka e shenjtë, siç tha David' i drejtë.<sup>34</sup> U rrëfeve më e gjerë se qiejtë, duke mbajtur krijuesin tënd. Lavdi atij që ndenji te ti. Lavdi atij që lindi prej teje. Lavdi atij që na çliroi me lindjen tënde.\*

*Lavdërime Martirike*

*Ting. I*

Ejani, gjithë popujt, t'i nderojmë me himne dhe ode shpirtërore<sup>35</sup> athlorët e Krishtit, ndriçuesit e botës,<sup>36</sup> predikuesit e besimit dhe burimin e përhershëm, nga gufojnë shërime për shpresëplotët. Me përgjërimet e tyre, o Krisht Perëndi, dhu-roji paqen botës sate dhe shpirtave tanë përdëllimin e madh.<sup>5</sup>



Këta ushtarë<sup>14</sup> të mbretit të madh i kundërshtuan urdhrat e tiranëve, i shpërfillën me trimëri torturat dhe, pasi e shkelën tërë mashtrimin, u kurorëzuan denjësisht, dhe kërkojnë paqe nga Shpëtimtari dhe për shpirtrat tanë përdëllimin e madh.<sup>5</sup>

Ju, o martirë të tërëfamshëm, as shtrengim, as ngushtësi, as uri, as përndjekje, as fshikullime, as tërbim bishash, as shpatë, as zjarr kërcënues nuk mundën t'ju ndanin dot nga Perëndia;<sup>37</sup> për më tepër, me mallëngjim për të, pasi luftuat si në trupa të huaj, u arratisët nga natyra ngaqë e shpërfillët vdekjen; prandaj dhe denjësisht fituat pagën e mundimeve tua-ja dhe u bëtë trashëgimtarë të mbretërisë së qiejve;<sup>38</sup> ndërmjetoni pa pushim për shpirtrat tanë.

Ngazëllohuni, o martirë, në Zotin, sepse garuat luftën e mirë,<sup>16</sup> kundërshtuat mbretër dhe mundët tiranë; nuk u trembët nga zjarri dhe shpata, as nga bishat e egra që i hanin plotësisht trupat tuaj; duke ia drejtuar Krishtit psalmodinë tok me engjëjt, morët kurora nga qiejt; kërkonë që të na dhurohet përdëllimi i madh.<sup>5</sup>

Lavdi *Nekrosim,*

*poezi e Joan Damaskinot.*

O Shpëtimtari im, duke e treguar me vepër se ti je ngjallja e të gjithëve,<sup>39</sup> o Fjalë, me fjalë e ngrite Llazarin nga të vdekurit;<sup>40</sup> atëherë shula u tundën dhe portat e Hadhit u lëkundën, atëherë vdekja e njerëzve vërtetohej si gumë,<sup>41</sup> ndaj ti që erdhe jo që të glykosh, por të shpëtosh gatimin tënd,<sup>42</sup> ata që i zgjodhe, prehi si njerëdashës.

Tani *Hyjlindësor*

Kënaqet me lindjen tënde, o Vajzë, kori i profetëve, bashkësia e hyjshme e patri-

arkëve, apostujt e respektuar, shoqëria e kryepftërinjve dhe e martirëve, rreshtat e oshënarëve dhe të të drejtëve; dhe të njohin si shkak të rendit të tyre dhe të nderojnë si lindëse Perëndie.

*Pasvargjet Nekrosime të Lavdërimeve, të cilat, bashkë me Nekrosimet e të gjithë Tingujve në të shtunat, formojnë Akrostihidhë: "O Krisht, shërbëtorët e tu shkruaji në librin e të gjallëve". Poezi e Theofanit.*

*Ting. I Panëfimi martires*

Të lutemi, denjësoji, Zot,\* Shpëtimtar, të ikurit\* që ta shijojn' ëmbëlsinë tënde, vëri në tendat\* e të drejtëve<sup>43</sup> lart,\* në banimin qiellor, në vendin ku jan' shenjtët e tu, pasi t'ua falësh dhembshurisht\* shkeljet, fajet krejt që bënë pra,\* dhe kështu t'u japësh prehje në amshim.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

Askush s'është midis njerëzve,\* përveç teje, pa mëkat,\*<sup>45</sup> Zot i pavdekshëm, i vetëm, ndaj shërbyesit e tu\* vëri brenda dritës\* përmes dhembshurisë sate tok me koret e engjëjve të tu; si Perëndi i mir',\* mos vër re paudhësi a faj,\* dhe kështu t'u japësh ndjesë, përdëllim.

*Varg:* Dhe kujtimi i tyre do të jetë në gjeneratë dhe gjeneratë.

Më lart janë nga sa duken k'tu\* Shpëtimtar, premtimet që\* na dhe, që syri s'i pa dhe veshi s'i dëgjo dot,\* s'shkuan kurr' në zemër;\*<sup>46</sup> mirësisht, Zot, denjësoji që të marrin pjesë në to sa u zhvendosën drejt teje;\* jepu jetën e përjetshme ti,\* si i vetmi njerëdashës çlirimtar.

Lavdi

Për Kryqin tënd kishin gaz, guxim,\* Zot, shërbyesit e tu,\* kështu te ti u shpërngulën; dhe shpërbletë për këta,\* për

mëkatet që bën',\* Kryqin tënd dhurove si dhe gjakun që u derdh dhembshurisht për jetën botërore krejt;\* ndjeji shkeljet, feksi me shkëlqim\* përmes dritës së fyt-rës sate, Krisht.

### Tani *Hyllindësor*

Lyp Krishtin, e Virgjira nënë ti,\* Birin tënd Zot, që ai\* t'u japë falje mëkatesh, ndjes' shërbyesve të tu\* që me bes' të shpallën\* si Perëndilindëse edhe me të vërtetat fjalime dogmatisën; për shkëlqim,\* hijeshi, t'i denjësosh ata\* ndër shenjtore,<sup>47</sup> brenda mbretëris' së tij.

### CITIME

1. Matth. 14. 29-31
2. Rom. 2.16; I Kor. 4.5
3. Lluk. 18.13
4. Matth. 20.1-9
5. Num. 14.19 etj.
6. Ps. 50(51).7
7. Fja. Urt. 11.31; I Petr. 4.18
8. Matth. 20.12
9. Is. 6.2
10. Lluk. 15.11-18
11. Ps. 7.12; II Tim. 4.8
12. Matth. 25.31-33
13. Jer. 2.13
14. II Tim. 2.3
15. Matth. 16.24; Mark 8.34; 10.21; Lluk. 9.23
16. II Tim. 4.7
17. Gjen. 2.7-8.15; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9; II Makk. 7.23
18. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
19. Lluk. 23.42-43
20. Matth. 27.38; Mark 15.27; Lluk. 23.33; Joan 19.18
- 20a. Is. 53.7; Vep. 8.32; I Petr. 1.19; Apok. 5.6; 7.14; 12.11
21. Joan 19.34
- 21a. Fil. 1.29
22. I Kor. 12.9,28
23. Is. 63.9
24. Gal. 6.14
25. Joan 14.27
26. I Petr. 2.5
27. I Petr. 1.6; 5.10
28. Gjen. 2.9; 3.22,24; Fja. Urt. 3.18; Is. 65.22; Apok. 2.7; 22.2,14,19
29. Gjen. 28.17
30. Ef. 2.14
31. Hebr. 6.19
32. I Petr. 1.20
33. Lluk. 1.26-33
- 33a. Urt. Sol. 8.3

34. Ps. 131(132).8
35. Ef. 5.19; Kol. 3.16
36. Fil. 2.15
37. Rom. 8.35-39
38. Jakov 2.5
39. Joan 11.25
40. Joan 11.43-44
41. Matth. 9.24; Mark 5.39; Lluk. 8.52; Joan 11.11
42. Joan 12.47
43. Ps. 117(118).15
44. Rom. 3.23; 5.12
45. Joan 8.46
46. I Kor. 2.9
47. Ps. 109(110).3



### TINGULL I DYTË

### TË DIELËN NË MBRËMËSORE

#### *Thirrtores Kataniktike*

#### *Ting. II*

Mëkatova ndaj teje, o Shpëtimtar, si Biri Plangprishës; pranomë, o atë, mua që pendohem<sup>1</sup> dhe mëshiro më, o Perëndi.

Të thërras, o Krisht Shpëtimtar, fjalët e Doganierit; le të të vijë keq për mua si për të<sup>2</sup> dhe mëshiro më, o Perëndi.

Duke kuptuar absurditetin e të tmerrshmeve që bëra, përiki drejt dhembshurive të tua, duke imituar Doganierin,<sup>2</sup> Lavren që lotoi<sup>3</sup> dhe Birin Plangprishës;<sup>1</sup> prandaj dhe gjuhëzohem para teje, o përdëllimtar: Para se të më dënosh, le të të vijë keq për mua, o Perëndi, dhe mëshiro më.<sup>4</sup>

Mos i vër re paudhësitë e mia, o Zot që linde prej Virgjërëshës, dhe pastroma zemrën, duke e bërë tempull të Shpirtit<sup>5</sup> tënd të Shenjtë; mos më hidh të turpëruar tej fytërës sate, ti, që ke përdëllimin e madh të pamatur.<sup>6\*</sup>

### TË HËNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësores Kataniktike Ting. II*



**P**aligjësitë e mia u ngritën kundër meje si dallgë deti, dimëroj unë vetëm nga shkëlqej të shumta si anije në oqean; por më drejto në liman të qetë me anën e pendimit, o Zot, dhe shpëtomë.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

**O** Zot, unë jam pema e pafrytshme, ngaqë nuk sjell fare fryt kataniksi, dhe tmerrohem nga prerja,<sup>7</sup> dhe frikësohem nga ai zjarr i pashuar;<sup>8</sup> prandaj të përgjërohem: Para kësaj nevoje, kthemë dhe shpëtomë.

Lavdi dhe Tani *Hyllindësore*  
*Efsplahnias ipárhusa piji*

**J**e burim dhembshurie dhe kështu,\* o Hyllindëse, bëna krejt të denj' për mëshirë;\* popullin që mëkatoï,<sup>8a</sup> shihe pra,\* si gjithnjë tregojë qart' pushtetin tënd;\* meqë ne shpresojm' te ti,\* "Ki gaz", të thërrasim ty\* si një kryegjeneral\* të pastrupësh, Gabrieli shenjt, dikur.<sup>9</sup>

*Pas Odes VI Martirik*

**S**henjtorët, duke të pasur në botë si robë ty që mbështjell qiellin me re,<sup>10</sup> i duruan torturat e të paligjëve dhe e shfuqizuan mashtrimin e idhujve; me përgjërimit e tyre çlirona dhe ne nga armiku i padukshëm, o Shpëtimtar, dhe shpëtona.

TË MARTËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*  
*Ndenjësore Kataniktike Ting. II*

**"P**ërdëlleme", tha Davidi,<sup>11</sup> dhe unë të thërras: Mëkatova, o Shpëtimtar; pasi t'i shuash fajet e mia nëpërmjet pendimit, mëshiro më.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

**"P**ërdëlleme, o Perëndi,<sup>11</sup> përdëlleme", qante Davidi për dy mëkate;<sup>12</sup> unë të thërras për mijëra e mijëra paudhësi; ai lagte dyshekun me lot,<sup>13</sup> ndërsa unë nuk kam asnjë pikë; u dëshpërova dhe lutem: Përdëlleme, o Perëndi, sipas përdëllimit tënd të madh.<sup>11</sup>

Lavdi dhe Tani *Hyllindësore*

**O** Perëndilindëse, mos më shpëfill mua që kam nevojë për përkrahjen tënde, sepse te ti ka besim shpirti im; mëshiro më.

*Pas Odes VI Martirik*

**O** Krisht Perëndi, që i ndriçove shenjtorët e tu më shumë se ari dhe i lavdërove oshënarët e tu si i mirë, me përgjërimit e tyre paqësoje jetën tonë si njeridashës, dhe drejtoje lutjen si temjam<sup>14</sup> ti, i vetmi që prehesh ndër shenjtorë.<sup>15</sup>

TË MËRKURËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*  
*Ndenjësore Kryqësore Ting. II*

**T**ë sjellim për ndërmjetim Kryqin jetëbërës të mirësisë sate, të cilin na e dhurove neve të padenjëve, o Zot; shpëtoji mbretërit e tu dhe qytetet e tua në paqe nëpërmjet Perëndilindëses, o i vetmi njeridashës.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

**S**i e robëroi armiku Adamin përmes ngrënies së drurit,<sup>16</sup> o Zot, kështu ti vetë e robërove armikun përmes drurit të Kryqit dhe pësimi tënd; sepse për këtë erdhe ti, Adami i dytë,<sup>17</sup> që të kërkosh të humburin<sup>18</sup> dhe të gjallërosh të vdekurin; o Perëndi, lavdi më ty.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyllindësore*  
*Efsplahnias ipárhusa*

**K**ur të pa të tendosur mbi një dru\* dhe

të vdekur, e Virgjra nëna jote po qante,\* o Krisht, hidhur thoshte: Ç'është ky mister\* plot tmerr, Biri im? Si përmbi Kryq po vdes\* me vdekje të turpshme<sup>18a</sup> krejt\* me dashje<sup>19</sup> ti që dhuron\* jetë të përjetshme nur\* te të gjithë<sup>20</sup> pranë teje në amshim?

*Pas Odes VI Martirike*

**O** athloforë të Zotit, është e lumtur toka që u bë pjellore me anën e gjakrave tuaja, dhe të shenjta janë tendat që pritën<sup>21</sup> trupat tuaj, sepse në stadium e poshtëruat armikun dhe e shpallët me guxim Krishtin; lutemi, atij përgjërojuni që, si i mirë, t'i shpëtojë shpirtrat tanë.

TË ENJTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Apostolike Ting. II*

**O** Krisht Perëndi, që i urtësove peshkatarët më shumë se oratorët dhe i dërgove si predikues në tërë dheun, nëpërmjet njeridashjes sate të parrëfyeshme forcoje Kishën tënde me anën e tyre, dhe dërgoju besimtarëve bekimin tënd, i vetmi përdëllyes dhe njeridashës.

*Varg:* Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

**P**eshkatarët hodhën rrjeta dhe i kapën kombet,<sup>22</sup> dhe i mësuan skajet e planetit që të të falen, o Krisht Perëndi; nëpërmjet njeridashjes sate të parrëfyeshme siguroje Kishën tënde, i vetmi që prehesh ndër shenjtore.<sup>15</sup>

*Lavdi dhe Tani Hyjllindësore*

**T**y të madhërojmë, o Hyjllindëse, duke thirrur: Gëzohu, o re e dritës<sup>23</sup> së papeënduar, që mbajte në prehër vetë Zotin e lavdisë.<sup>24</sup>

*Pas Odes VI Martirik*

**O** apostuj, martirë, profetë, hierarkë, oshënarë dhe të drejtë, që e mbaruat mirë garën dhe e ruajtët besën,<sup>25</sup> meqë keni guxim para Shpëtimtarit, lutemi, ly-peni atë për ne që, si i mirë, t'i shpëtojë shpirtrat tanë.

TË PREMTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kryqësore Ting. II*

**I**konës sate të pacenuar i falemi, o i Mirë, duke kërkuar ndjesën e shkeljeve tona, o Krisht Perëndi, sepse vullnetarisht deshe me mirëdashje të ngjiteshe në Kryq,<sup>19</sup> që t'i çliroh ata që gatove<sup>19a</sup> nga skllavëria e armikut; ndaj me kënaqësi të thërrasim: I mbushe me hare të gjitha, o Shpëtimtari ynë, kur erdhe për të shpëtuar botën.<sup>26</sup>

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

**B**ëre shpëtim në mes të dheut,<sup>27</sup> o Krisht Perëndi; mbi Kryq i tendose duart e tua të pacenuara dhe i përmbloodhe tërë kombet<sup>28</sup> që thërrisinin: O Zot, lavdi më ty.

*Lavdi dhe Tani Kryqhyjllindësore*

**E** përmbibekuar je, o Hyjllindëse Virgjëreshë; të himnojmë se, me anën e Kryqit të Birit tënd, u vithis Hadhi, vdekja vdiq; ne, ndonëse vdiqëm, u ngjallëm dhe u vlerësua për jetë, e morëm Parajsën, shijimin e lashtë;<sup>29</sup> prandaj, duke falënderuar, e lavdërojmë si të fuqishëm dhe të vtmnin të shumëmëshirshëm, Krishtin, Perëndinë tonë.

*Pas Odes VI Martirik*

**M**eqë shenjtoret u mbështetën përmbi gurin<sup>30</sup> e palëkundur, si burra u fuqizuan kundër tiranëve, dhe përmes torturash morën kurora. Me anën e tyre, o Perëndi, mëshirona.



## TË PREMTEN NË MBRËMËSORE

*Në Thirrtores, pas Idhiomelit  
Martirike Ting. II*

Athlororët, meqenëse nuk e dëshiruan shijimin tokësor, u denjësuan për të mirat qiellore dhe u bënë bashkëqytetarë me engjëjt. O Zot, me ndërmjetimet e tyre mëshirona dhe shpëtona.

Meqë martirët e shenjtë ndërmjetojnë për ne dhe e himnojnë Krishtin, çdo mashtrim pushoi, dhe gjinia e njerëzve shpëton përmes besimit.

Kore martirësh i kundërshtuan tiranët dhe u thanë: Ne mobilizohemi për mbretin e fuqive;<sup>31</sup> nëse do të na shfarosni dhe me zjarr, dhe me tortura, nuk e mohojmë forcën e Trinisë.

O shenjtore, është e madhe lavdia që morët me anën e besës, sepse jo vetëm kur pësonit e mundët armikun, por edhe pas vdekjes dëboni frymë dhe shëroni të sëmurë, o mjekë shpirtash dhe trupash; ndërmjetoni pranë Zotit që t'i mëshirojë shpirtat tanë.

Lavdi *Idhiomeli Nekrosim,*  
*poezi e Joan Monakut.*

Mjerë! Ç'illoj lufte ka shpirti kur ndahet nga trupi! Mjerë! Sa loton atëherë dhe s'ka kush ta përdëllejë! I kthen sytë drejt engjëjve, por kot iu përgjërohet; i shtrin duart drejt njerëzve, por askush nuk e ndihmon. Prandaj, vëllezërit e mi të dashur, pasi ta kuptojmë se sa e shkurtër është jeta jonë, le të kërkojmë prej Krishtit prehjen për të shpërngulurit, dhe për shpirtat tanë përdëllimin e madh.<sup>6</sup>

Tani *Hyjllindësore*

Shkoi hija e ligjës<sup>32</sup> si erdhi hiri, se, sikundër ferra nuk digjej me gjithë që nxirrte

flakë,<sup>33</sup> ashtu dhe ti virgjëreshë linde dhe virgjëreshë mbete; në vend kolonë zjarri,<sup>23</sup> lindi Diell drejtësie;<sup>34</sup> në vend të Moisiut, Krishti, shpëtimi i shpirtave tanë.\*

## TË SHUTUNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësores Martirike Ting. II*

O Krisht Perëndi, që i ndriçove shenjtoret e tu më shumë se ari dhe i lavdërove oshënarët e tu si i mirë, me përgjërimet e tyre paqësoje jetën tonë si njerdashës, dhe drejtoje lutjen si temjam<sup>14</sup> ti, i vetmi që prehesh ndër shenjtore.<sup>15</sup>

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

O athlororë të Zotit, është e lumtur toka që u bë pjellore me anën e gjakrave tuaja, dhe të shenjtja janë tendat që pritën<sup>21</sup> trupat tuaj, sepse në stadium e poshtëruat armikun dhe e shpallët me guxim Krishtin; lutemi, atij përgjërojuni që, si i mirë, t'i shpëtojë shpirtat tanë.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

O apostuj, martirë, profetë, hierarkë, oshënarë dhe të drejtë, që e mbaruat mirë garën dhe e ruajtët besën,<sup>25</sup> meqë keni guxim para Shpëtimtarit, lutemi, lypeni atë për ne që, si i mirë, t'i shpëtojë shpirtat tanë.

Lavdi *Nekrosime*

Kujtimi i të fjeturve, o Zot, më drejton te kujtimi i atyre që presim; dhe, duke parë qartë dënimin tim, ofroj zërin prej torturash: Përdëlleme, o përdëlleys.

Tani *Hyjllindësore*

O nënë e shenjtë e dritës<sup>35</sup> së pashprehshme, të madhërojmë duke të nderuar me himne engjëllore.

*Lavdërime Martirike**Ting. II*

O martirë athlororë, përderisa pësuar për hir të Krishtit<sup>35a</sup> deri në vdekje, i keni shpirtat në qiej, në dorë Perëndie,<sup>36</sup> dhe në botën mbarë bëhen litani lipsanet tuaja; falen priftërinj dhe mbretër, dhe të gjithë ne popujt, duke u ngazëlluar, thërrasim zakonisht: Gjumë i çmuar është para Zotit vdekja e oshënarëve të tij.<sup>37</sup>

Martirët e shenjtë, kur e morën Kryqin e Krishtit si armë të pamposhtur, shfuqizuan tërë forcën e djallit dhe, meqë morën kurorë qiellore, na u bënë si mur, duke ndërmjetuar përherë për ne.

O martirë athlororë, çdo qytet dhe vend i nderon lipsanet tuaja, sepse ju, pasi garuat ligjërisht,<sup>38</sup> morët kurorë qiellore; kështu jeni krenaria e priftërinjve, fitorja e mbretërve dhe hijeshia e Kishave.

*Lavdi Nekrosim,**poezi e Joan Damaskinoit.*

Meqenëse më gatove nga dheu,<sup>39</sup> për shkak të shkeljes<sup>16</sup> më dënove të shkoja prapë në dhë;<sup>40</sup> caktove ditë hetimi, në të cilën të fshehtat e veprimtarisë së secilit<sup>41</sup> do të paraqiten dukshëm para teje; atëherë kursemë,<sup>42</sup> o i pamëkatshëm dhe, pasi të më japësh ndjesën e gabimeve të mia, mos më nda nga mbretëria jote.

*Tani Hyjindësor*

Gëzohu, o Mari Perëndilindëse, tempulli i parrëzueshëm, madje i shenjtë, siç thërrret profeti: I shenjtë është tempulli yt, i çuditshëm në drejtësi.<sup>43</sup>

*Pasvargjet Nekrosime të Lavdërimeve,**poezi e Theofanit.**Ting. II Ote ek tu ksilu se*

Prishje\* edhe rrymë vdekjeje,\* Zot, me vdekjen tënde që solli jet', ti shfarose

dikur\* dhe burove për të gjithë jetën në amshim;\* u dhurove të vdekshmëve ringjallje, kështu që\* lutemi t'i prehësh sa shpërngulen drejt teje\* edhe, Shpëtimtar njeridashës,\* Krisht, për lavdin tënd denjësoji,\* se lart u zhvendosën me besim te ti.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

Kryqin\* e durove që krejt pra\* njerëzit t'i bësh pjesëmarrës në mbretërinë e shenjt',\* vdekjen vullnetare<sup>19</sup> e pranove, ndaj lypim\* dhembshurin' tënde, njeridashës: Shfaq sa ikën\* me besim te ti, kungues lart në mbretëri,\* denjësoji dhe për lavdinë,\* dhe për lumurin' tënde, dritën,\* në përjetësi, i miri Shpëtimtar.

*Varg:* Dhe kujtimi i tyre do të jetë në gjeneratë dhe gjeneratë.

Meqë\* deshe që gatimin tënd\* ta shpëtosh, misterin e thellë vërtet të Ekonomis'\* me hare e bërë si i përmbimbirë, Zot;\* dhe me çmim gjakun tënd të çmuar bleve<sup>44</sup> mbar' botën,\* ndaj, o njeridashës, ty të përgjerohem: Sa te ti shpërngulen me besë,\* denjësoji për ëmbëlsinë\* edhe bukurinë tënde përgjithnjë.

*Lavdi*

Meqë\* para podiumit tënd\* fort të frikshëm, plot trembë rrinë të tër' të vdekurit pra\* qysh përpara jetëve, Zot, dhe mendimin tënd\* krejt të saktë e presin dhe vendimin e drejtë,\* atëherë, Shpëtimtar, kurseji<sup>42</sup> gjithë sa,\* plot me besë, vdiqën me shpresë\* jete<sup>45</sup> në ty dhe denjësoji\* për shijimin tënd gjithnjë, për lumturi.

*Tani Hyjindësor*

Zure,\* e dëlirë, Perëndi\* edhe borxhin e paranënës, të Evës,<sup>16</sup> shleve kështu;\*



ky dhuron te besimtarët ngjalljen, papi-shjen,\* si dhe sa të lëvdojnë, tash i kur-rorëzon nur\* me shkëlqimin e pavdek-shëm; o Hyjnuse Vajz\*,\* mos pusho së lypuri Krishtin\* që të gjithë ne të na shndri-të\* zjarr me llamburitjen e tij tërë hir.

## CITIME

1. Lluk. 15.11-19
2. Lluk. 18.13
3. Lluk. 7.37-38
4. Ne. 13.22
5. I Kor. 3.16
6. Num. 14.19 etj.
7. Lluk. 13.6-7
8. Matth. 3.10; 7.19; Lluk. 3.9; 13.6-7
- 8a. Jis. N. 7.11; I Mbret. [Sam.] 14.33; II Kron. 6.39
9. Lluk. 1.26-28
10. Ps. 146(147).8
11. Ps. 50(51).1
12. II Mbret. [Sam.] 11.2-4; 15-17
13. Ps. 6.6
14. Ps. 140(141).3
15. Is. 57.15
16. Gjen. 3.1-6
17. I Kor. 15.45
18. Lluk. 19.10
- 18a. Ligji I Dytë 21.23; Gal. 3.13
19. Joan 10.15,17-18
20. Joan 10.28; 17.2
21. Lluk. 16.9
22. Matth. 4.18-20; Mark 1.16-18; Lluk. 5.10-11
23. Eks. 13.21-22 etj.
24. I Kor. 2.8
25. II Tim. 4.7
26. Joan 12.47
27. Ps. 73(74).12
28. Joan 11.52
29. Gjen. 2.15; 3.23
30. Matth. 7.24; Lluk.6.48
31. Ps. 67(68).13
32. Hebr. 10.1
33. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
34. Mal. 4.2 (3,20)
35. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
- 35a. Fil. 1.29
36. Urt. Sol. 3.1
37. Ps. 115.6 (116.15)
38. II Tim. 2.5
39. Gjen. 2.7; Ps. 102(103).14; Jov 10.9
40. Gjen. 3.19
41. Rom. 2.16
42. Ne. 13.22
43. Ps. 64(65).5-6
44. I Kor. 6.20
45. Tit. 1.2; 3-7

## TINGULL I TRETË

## TË DIEJËN NË MBRËMËSORE

*Thirrjore Kataniktike*

*Ting. III*

Himn mbrëmësor të ofrojmë, o Krisht, me temjan dhe ode shpirtërore;<sup>1</sup> më-shiroji, o Shpëtimtar, shpirtat tanë.

Shpëtomë, o Zot, Perëndia im, se ti je shpëtimi i të gjithëve; shtrëngata e pa-sioneve më trazon dhe pesha e paudhë-sive të mia më fundos; më jep një dorë ndihmë dhe më lartëso<sup>2a</sup> drejt drite ka-taniksi, si i vetmi i dhembshur dhe njeri-dashës.

Mblidhe, o Zot, mendjen time të shpër-ndarë dhe pastroje zemrën time djerre; më jep pendim si i dhe Petros,<sup>2</sup> pshe-rëtimë si i dhe Doganierit<sup>3</sup> dhe lot si i dhe Lavires,<sup>4</sup> që me zë të lartë të të thërras: O Perëndi, shpëtomë, si i vetmi i dhembshur dhe njeridashës.

Shumë herë, duke himnuar, gjendesha duke mëkatuar, sepse thosha këngë me gjuhë, teksa mendoja të pavenda në shpirt; por, o Krisht Perëndi, korrigjoji të dyja me anë të pendimit dhe mëshirorë.

## TË HËNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kataniktike Ting. III*

Në gjyqin e frikshëm shqyrtohem pa akuzues, dënohem pa dëshmitarë, sepse hapen librat<sup>5</sup> e ndërgegjes dhe zbu-lohen veprat e fshehura; ndaj, para se të hulumtosh sa bëra, në atë teatër mbarë-publik, o Perëndi, të të vijë keq për mua<sup>3</sup> dhe të më mëshirosh.

*Varg.* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

Deri kur, o shpirti im, do të insistosh në shkelje? Deri kur do të bësh shtyrje pendimi? Mendoje gjykimin e ardhshëm dhe thirri Zotit: Mëkatova, o Zot i pamëkatshëm, mëshiomë.

Lavdi dhe Tani *Hyllindësore*

**C**ilido atje ku shpëton, atje dhe drejtësisht vrapon; dhe a ka tjetër përkije të tillë si ti, o Perëndilindëse, që i mbulon shpirtrat tanë?

*Pas Odes VI Martirik*

**K**ush nuk do të çuditet për luftërat e pamposhtura të martirëve të shenjtë? Kush nuk do të habitet për arritjet e tyre të përhershme? Sepse triumfuan mbi armikun, kundërshtarin, në zjarr, kamxhikime, bisha dhe therje, pasi neveritën lajka mbretërishe dhe hodhën poshtë kërcënime tiranësh; prandaj dhe i morën kurorat prej Krishtit Perëndi, që i jep botës përdëllimin e madh.<sup>6</sup>

#### TË MARTËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kataniktike Ting. III*

**O** shpirt, duke ndenjur për njëfarë kohe në tokë, pendohu; dhe në varr<sup>7</sup> nuk himnon, nuk çlirohet nga shkeljet; thirri Krishtit Perëndi: O zemërnjohës,<sup>7a</sup> mëkatova; para se të më dënosh, mëshiomë.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërlimin tënd.

**G**jatë orës së lutjes premtoj se do të pendohem dhe armiku me gatishmëri më shtyn të mëkatoj pa vend; por më çliro nga ai, o Perëndi, dhe mëshiomë.

Lavdi dhe Tani *Hyllindësore*

**O** Perëndilindëse, përkija dhe fuqia jonë, ndihma e fortë e botës, me anën e ndër-

mjetimeve të tua shpëtoji shërbëtorët e tu nga çdo nevojë, o e vetmja e bekuar.

*Pas Odes VI Martirik*

**T**rimëria e rezistencës suaj fitoi mbi marifetet e armikut të keq që nga fillimi, o athlororë të tërëfamshëm, prandaj u vlerësua për lumturinë e përjetshme; ndërmetoni pranë Krishtit që ta shpëtojë grigjën e popullit krishtdashës, meqë jeni dëshmitarë të së vërtetës.

#### TË MËRKURËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kryqësore Ting. III*

*Tin oreōtita*

**U**shtir' e engjëjve\* habiteshin sepse\* pushtetin tënd pa fund\* dhe kryqëzimin tënd\* me dashje krejt,<sup>8</sup> po shihnin; si në mish kamxhikoheshe ti\*<sup>9</sup> i padukshmi?<sup>10</sup> Deshe pra\* njerëzinë nga prishja keq\* ta çliroje, ndaj dhe ne\* po thërrasim me zë të lart\* te ti si jetëdhënëse: Lavdi ty,\* lavd mbretërisë sate, o Krisht.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

**N**jë Kryq u ngul mbi dhé, dhe i preku qielloret, jo se druri e arriti lartësinë, por ti që në të e mbush Gjithësinë;<sup>11</sup> lavdi më ty.

Lavdi dhe Tani *Hyllindësore*

**O** Perëndilindëse, duke pasur si shkop fuqie<sup>12</sup> Kryqin e Birit tënd, i vithisim me të tërbimet e armiqtë ne që me mallëngjim të madhështojmë pa pushim.

*Pas Odes VI Martirik*

**O** Zot, si i tërëfuqishëm e hijeshove tepër kujtimin e athlororëve të tu, sepse i forcove që t'i imitonin pësimet e tua; kështu me burrëri e mundën fuqinë e beljarit, ndaj dhe morën karizma shërimesh;<sup>13</sup> me përgjërimit e tyre, o njeridashës, jepu paqë shpirtrave tanë.



## TË ENJTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësores Apostolike Ting. III  
Thias pisteos*

**O** apostuj ju,\* sytamës, dolët\* shpallës të hyshëm\* të së vërtetës\* dhe mësues brenda Kishës; e shkelët krejt\* idhujtarinë, mashtrimin që kish ajo,\* dhe predikuat Triadhën me plot fuqi,\* ndërmjetoni, o të lum, që ajo t'na japë boll,\* të na dhurojë hir, të madhin përdëllim.<sup>6</sup>

*Varg:* Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

**T**ërë ne të vijm'\* t'i përhimnojmë\* shën apostujt tok\* si udhëzues,\* se e flakën tej mashtrimin e idhujve\* dhe na risollën te drita e jetës drejt,\* dhe na mësuan Trininë ta lavdërojm\*;\* ne besnikët mbarë pra, Shpëtimtarin e himnojm'\* kur kryejmë me nder kujtimin e tyre.

Lavdi dhe Tani *Hyjindësore*

**O** Virgjëreshë, bistakun tepër të bukur e nxore si hardhi të pakultivuar; ai na buron verën shpëtimtare që i dëfren shpirtrat dhe trupat e të gjithëve; prandaj, duke të lumëruar si shkakun e të mirave, tok me engjëllin të thërrasim gjithmonë: Gëzohu, o hirplote.<sup>14</sup>

*Pas Odes VI Martirik  
Tin oreótita*

**V**ithisët, o atlet',\* çdo rend armiqësor,\* se veshët armë, bes',\* dhe u forcuat mjaft\* me arsenalin që jep Zoti,<sup>15</sup> meqenëse duruat\* me gatishmëri çdo gjë,\* kërcënime të tëra ju,\* madje kamxhikime tok\* nga tiranët, se kishit shpres'\* për jetën,<sup>16</sup> o martirë të Krishtit\* plot forcë, mo-rët drejt kurora.

## TË PREMTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësores Kryqësore Ting. III  
Tin oreótita*

**T**i zgjodhe dhe pësim,\* dhe vdekje, Kryqin<sup>8</sup> tënd\* që ngule publikisht,\* dhe mes Krijesës, Krisht,\* kur deshe mirësisht që trupi yt, Shpëtimtar, të ngulej;\* atëherë dielli\* rrezet mbarë i fshehu mjaft\*<sup>17</sup> dhe Kusari, kur i pa,\* të pohoi si Perëndi\* dhe thirri: "Më kujto, Zot!"; Parajsën\* ndaj e fitoi se besoi.<sup>18</sup>

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

**N**ë qiparis, në pishë dhe në kedër<sup>19</sup> u ngrite, o qengji i Perëndisë,<sup>20</sup> që t'i shpëtosha ata që me besim i falen kryqëzimit tënd vullnetar,<sup>8</sup> o Krisht Zot; lavdi më ty.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjindësore  
Tin oreótita*

**D**urove vdekjen keq\* plot turp, i dhembshur fort,\* vullnetarisht në dru\*<sup>21</sup> kur kryqëzoheshë,\*<sup>20a</sup> të cilën, kur e shihte nëna jote, o Krisht, plagosej\* dhe vajtonte brenda saj\* pors i nënë dhe qante mjaft;\* ndaj nga dhembshuria det\* përmes lutjeve të asaj\* shpëto me përdëllimin tënd botën,\* ti që e ngre mëkatin e saj.<sup>21</sup>

*Pas Odes VI Martirik*

**S**hkëlqeni nëpërmjet besës, o shenjtore, ndriçues tepër të ndritshëm, mjekë me devocion hyjnor, athloforë të tërëfamshëm; sepse, përderisa nuk u frikësuat nga torturat e tiranëve, e rrëzuat diskreditimin e idhujve, ngaqë kishit si trofe të pamposhtur kryqin e së vërtetës.

## TË PREMTEN NË MBRËMËSORE

*Në Thirrtoret pas Idhiomelit  
Martirike Ting. III*

**E** madhe është fuqia e martirëve të tu, o

Krisht, sepse sado të shtrirë në varre, ata dëbojnë frymë, pasi e asgjësuan pushtetin e armikut me anën e besimit të Trinia, meqë garuan për shpresëtarinë.

**P**rofetët, apostujt e Krishtit dhe martirët na mësuan ta himnojmë Trininë e bashkëqenshme; i ndriçuan kombet e humbura dhe i bënë bijtë e njerëzve shokë me engjëjt.

**M**artirët e tu, o Zot, si u mbështetën në besim dhe u siguruan në shpresë, e shkatërruan tiraninë e armikut; dhe, pasi fituan kurora, ndërmjetojnë bashkë me të patrupët për shpirtat tanë.

**E** madhe është fuqia e Kryqit tënd, o Zot, sepse ai u mbërthye në një vend dhe vepron në botë; dhe nga peshkatarët shfaqti apostuj, dhe nga kombet martirë, që të ndërmjetojnë për shpirtat tanë.

Lavdi *Idhiomeli Nekrosim*,  
poezi e Joan Monakut.

**K**otësira janë gjithë gjërat<sup>22</sup> njerëzore, që s'qëndrojnë pas vdekjes; nuk mbetet pasuria, nuk vete pas lavdia; se, me të ardhur vdekja, këto të gjitha zhduken; prandaj le t'i thërresim Krishtit, mbretit të pavdekshëm: Prehi këta që u ndanë prej nesh, atje tek është banesa e gjithë atyre që dëfrenjë.<sup>23\*</sup>

Tani *Hyjllindësore*

**S**i të mos admirojmë lindjen tënde hynore-njerëzore, o e gjithënderuar! Se, pa njohur burrë, o e kulluar, linde bir pa atë trupërisht atë që lindi prej Atit para jetëve pa nënë, i cili s'pësoj fare ndryshim a trazim, a ndarje, por ruajti të thjeshtë cilësin' e secilës qenieje. Prandaj, o Zonjë, nënë dhe virgjëreshë, atij iu lut të shpëtohen shpirtat e atyre që të njohin me besë të drejtë për Hyjllindëse.\*

TË SHTUNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësore Martirike Ting. III*

**S**a jeni martirdashës, dëfreni dhe tani duke i kënduar Krishtit himnodinë me një zë, sepse e lindi për ne kujtimin e përvitshëm të athlorëve të tij, ndriçuesve të botës,<sup>24</sup> i cili rrezaton hir mrekullish dhe e feks mendjen dhe shpirtat tanë.

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

**T**rimëria e rezistencës suaj fitoi mbi marifetet e armikut të keq që nga fillimi, o athlorë të tërëfamshëm, prandaj u vlerësuar për lumturinë e përvitshme; ndërmjetoni pranë Krishtit që ta shpëtojë grigjen e popullit krishtdashës, meqë jeni dëshmitarë të së vërtetës.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

**S**hkëlqeni nëpërmjet besës, o shenjtore, ndriçues tepër të ndritshëm, mjekë me devocion hyjnor, athlorë të tërëfamshëm; sepse, përderisa nuk u frikësuar nga torturat e tiranëve, e rrëzuar diskreditimin e idhujve, ngaqë kishit si trofe të pamposhtur kryqin e së vërtetës.

Lavdi *Nekrosime*  
*Tin oreótita*

**K**ur do qëndrojmë tok\* me urdhrin tënd, Jisu,\* në podiumin tënd\* pa korrupsion aspak,\* mos na dëno ne që te ti besuam, o Shpëtimtar Krisht,\* se fajtuam gjithë ne,\* por nga ti s'u larguam kurr\*, ndaj të përgjerohem!\* Sa i more, rreshtoj njësh\* në tendat e të drejtëve,<sup>25</sup> se je\* i vetmi Zot, mëshirëplotë.

Tani *Hyjllindësore*

**T**y që ndërmjetove për shpëtimin e gjindjes sonë, të përhimnojmë, o Hyjllindëse



Virgjëreshë. Se, duke denjuar pësimin e Kryqit me trupin që mori prej teje Biri yt dhe Perëndia ynë, na çliroi prej prishjes si njeridashës.\*

*Lavdërimi Martirike*

*Ting. III*

**O** popuj, ejani të gjithë ta nderojmë kujtimin e athloforëve të shenjtë, se, pasi u bënë teatër për engjëj dhe njerëz,<sup>26</sup> morën prej Krishtit kurorën e fitores dhe ndërmjetojnë për shpirtat tanë.

**U**shtarët e Krishtit e zmbropsën frikën e mbretërve dhe të tiranëve; dhe me guxim e burrëri e pohuan atë, Zotin e të gjithave,<sup>27</sup> Perëndinë dhe mbretin<sup>28</sup> tonë dhe ndërmjetojnë për shpirtat tanë.

**F**ugitë e engjëjve të shenjtë i admiruan trimëritë e martirëve, se, ndonëse ishin veshur me trup, përbuzën tortura dhe u bënë imitues të pësimt të Shpëtimtarit Krisht, dhe ndërmjetojnë për shpirtat tanë.

**S**i ndriçues, në botë<sup>24</sup> shkëlqeni dhe pas vdekjes, o martirë të shenjtë, sepse garruat në ndeshjen e mirë;<sup>29</sup> prandaj, meqë keni guxim, lypeni Krishtin Perëndi që t'i mëshirojë shpirtat tanë.

*Lavdi Nekrasim*

**O** njerëz, pse turbullohemi kot? Udhë në të cilën rendim, është e shkurtër, jeta është tym, avull, hi dhe pluhur; shfaqet për pak kohë dhe shpejt zhduket; prandaj le t'i thërrasim Krishtit të pavdekshëm: Sa u zhvendosën nga ne, prehi atje ku është banesa e gjithë atyre që dëfrenë<sup>23</sup> pranë teje.

*Tani Hyllindësor*

**O** Perëndilindëse, mbrojtja e të gjithë nevojtareve, në ty guxojmë, në ty kreno-

hemi, në ty është e gjithë shpresa jonë; ndërmjeto pranë atij që lindi prej teje për shërbëtorët e tu të pavlefshëm.<sup>30</sup>

*Pasvargjet Nekrosime të Lavdërimeve,*

*poezi e Theofanit.*

*Ting. III To tipo tu stavrù*

**E** lavdëroj Kryqin tënd të çmuar, me anën e të cillit iu dhurua jeta dhe shijimi i kënaqësisë atyre që të himnojnë me besim dhe mall, o i vetmi i shumëmëshirshëm; prandaj të thërrasim, o Krisht Perëndi: Sa u zhvendosën nga ne, prehi atje ku është banesa e gjithë atyre që dëfrenë<sup>23</sup> pranë teje.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

**O** Krisht Perëndi, i vetmi mëshirues dhe i dhembshur, që ke det të pakonceptueshëm mirësie dhe e nje natyrën e njerëzve, të cilën e bëre, ty të përgjërrohemi: Sa u zhvendosën nga ne, prehi atje ku është banesa e gjithë atyre që dëfrenë<sup>23</sup> pranë teje.

*Varg:* Dhe kujtimi i tyre do të jetë në gjeneratë dhe gjeneratë.

**K**ur fjete në varr si njeri, i ngrite, si Perëndi, me fuqinë tënde të pamposhtur, ata që filin në varr, që të ofronin himn pareshtur; prandaj të thërrasim, o Krisht Perëndi: Sa u zhvendosën nga ne, prehi atje ku është banesa e gjithë atyre që dëfrenë<sup>23</sup> pranë teje.

*Lavdi dhe Tani Hyllindësor*

**T**ë njohim të gjithë ne, o Hyllindëse, si llambë mendore që mbajte dritësimin e Hyjnisë, i cili pati lidhje me trashësinë e esencës së njerëzve; përgjëroju Birit dhe Perëndisë tënd: Sa u zhvendosën nga ne, prehi atje ku është banesa e gjithë atyre që dëfrenë<sup>23</sup> pranë teje.

## CITIME

1. Ef. 5.19; Kol. 3.16
- 1a. Matth. 14.30-31
2. Matth. 26.75; Lluk. 22.61-62
3. Lluk. 18.13
4. Lluk. 7.37-38
5. Dan. 7.10
6. Num. 14.19 etj.
7. Gjen. 3.19
- 7a. Fja. Urt. 24.12
8. Joan 10.15,17-18
9. Matth. 27.26; Mark 15.15; Joan 19.1
10. Joan 1.18
11. Ef. 1.23
12. Ps. 109(110).2
13. I Kor. 12.9,28,30
14. Lluk. 1.28
15. Ef. 6.11,13
16. Tit. 1.2; 3.7
17. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
18. Lluk. 23.42-43
19. Is. 60.13
20. Joan 1.29,36; I Petr. 1.19
- 20a. Ligji i Dytë 21.23; Gal.3.13
21. Joan 1.29; I Joan 3.5
22. Kishit. 1.2 etj.
23. Ps. 86(87).7
24. Fil. 2.15
25. Ps. 117(118).15
26. I Kor. 4.9
27. Est. 4.17b
28. Tov. 13.15 etj.
29. II Tim. 4.7
30. Lluk. 17.10



**TINGULL I KATËRT**  
**TË DIELËN NË MBRËMËSORE**

*Thirrtores Kataniktike*  
*Ting. IV*

Doja ta shlyeja përmes lotëve dorëshkrimin e fajeve të mia, o Zot, dhe në jetën time që mbetet të të kënaqja nëpërmjet pendimit; por armiku më mashtron dhe lufton kundër shpirtit tim; o Zot, para se të shfarosem përfundimisht, më shpëto.

**K**ush është ai që dimëron dhe vrapon drejt këtij limani, dhe nuk shpëton? Ose kush është ai që ka dhimbje dhe bie para

kësaj klinike, dhe nuk shërohet? O Bërës i të gjithave dhe mjek i të sëmurëve, o Zot, para se të shfarosem përfundimisht, më shpëto.

**L**amë me lotët e mi, o Shpëtimtar, se u ndota me mëkate të shumta; prandaj dhe bie para teje: Fajtova, mëshiro më, o Perëndi.

**J**am dele e grigjës sate të arsyeshme dhe përiki drejt teje, bariut të mirë;<sup>1</sup> kërkomë mua që humba,<sup>2</sup> o Perëndi, dhe mëshiro më.

**TË HËNËN NË MËNGJESORE**

*Pas Stihologjisë së parë*  
*Ndenjësores Kataniktike Ting. IV*

**K**theje shpirtin tim të varfër që e shpenzoi në mëkate tërë pasurinë,<sup>2a</sup> o Zot; pranomë edhe mua si Laviren,<sup>3</sup> dhe shpëtomë.

*Varg.* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

**D**uke lundruar në detin e jetës së tanishme, kujtoj avushën e të këqijave të mia të shumta; dhe, duke mos pasur si kapiten mendimin,<sup>4</sup> të drejtohem me zërin e Petros: Shpëtomë, o Krisht,<sup>5</sup> shpëtomë, o Perëndi, si njeridashës.

*Lavdi dhe Tani Hyjllindësore*

**A**saj që u rrit në Tempull, në të Shenjtat e të Shenjtave, e cila kishte veshur besimin, urtësinë dhe virgjërinë e paqortueshme, kryegjenerali Gabriel i solli nga qielli përshëndetjen dhe atë "Gëzohu". Gëzohu, o e bekuar; gëzohu, o e lavdëruar, Zoti është me ty.<sup>6</sup>

*Pas Odes VI Martirik*

**S**ot, në kujtimin e athloforëve, ushtritë e engjëjve erdhën t'i ndriçojnë mendjet e



shpresëplotëve dhe ta hijeshojnë kozmosin me hir. O Perëndi, me përgjërimit e tyre, na dhuro përdëllimin e madh.<sup>7</sup>

#### TË MARTËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësores Kataniktike Ting. IV  
Tahi prokatálave*

**S**hejpt, në nusëroren e Krishtit të hyjmë mbar' ne,\* që zërin e lum të Perëndisë tonë Zot ta dëgjojmë me ngazëllim:\* "Ejani ju që doni\* qiellorin lavd, nderin,\* njëlloj me virgjërëshat krejt të urta ju jeni".\* Përmes besës llambat tona t'i hijeshojmë drejt.<sup>8</sup>

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

#### *Kateplaji Iosif*

**S**i do rrimë, shpirti im,\* para Gjykatësit, mendo,\* do vendosen frone lart\* në orën mjaft të frikshme pra\* dhe atëher' do shqyrtohet çdo vepër e kujtdo,\* pa mëshir' do jetë Gjykatësi\* edhe gati zjarri për ty plot tmerr\* porsì det i trazuar<sup>9</sup> egërsisht fort\* që t'i mbulojë të gjitha tok;\* këto të tëra,\* o shpirt, shikoj,\* psherëti para fundit.

#### Lavdi dhe Tani *Hyllindësore*

**O** Hyllindëse, që ndërmjeton vërtet dhe kryesisht me guxim si nënë pranë Birit tënd dhe Perëndisë tonë, ruaje qytetin që rend sidomos te streha jote dhe e ka pushtetin në ty, dhe përik te ti, limani, muri, mbrojtja e vetme e gjinisë së njerëzve.

#### *Pas Odes VI Martirik*

**M**e gjakrat e martirëve të tu në tërë botën, Kisha jote, e stolisur si me purpur dhe me li të çmuar, të thërret përmes tyre, o Krisht Perëndi: Dërgoju popullit tënd

dhembshuritë e tua, dhuroji paqe shtetit tënd dhe shpirtëve tanë përdëllimin e madh.<sup>7</sup>

#### TË MËRKURËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësores Kryqësore Ting. IV*

**N**a shpërbleve prej mallkimit të Ligjit<sup>10</sup> me gjakun tënd të çmuar; duke mbërthyer mbi Kryq e duke u shpuar me shtizë,<sup>11</sup> u burove njerëzve pavdekësinë, o Shpëtimtar ynë, lavdi më ty.\*

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

#### *Tahi prokatálave*

**A**rri sa më shejpt,<sup>12</sup> Perëndi, Zoti ynë, o Krisht,\* përpara se të na skllavërojnë armiq që të blasfemojnë dhe na kërcënojnë;\* zhduki me Kryqin tënd sa\* na luftojnë, të njohin\* sa forcë ka besimi orthodhoks, njeridashës\* i vetëm, me ndërmjetimet zjarr të Hyllindëses.

#### Lavdi dhe Tani *Kryqhyllindësore*

**O** nënë e Zotit Krisht, o Virgjërëshë pa cen,\* një shpatë përshkoi shpirtin tënd<sup>13</sup> të shenjt' fort, kur pe tët Bir edhe Perëndi\* mbi dru të kryqëzohej\* me vullnetin e vet pra;\*<sup>14</sup> o e bekuar, mos pusho së luturi atë,\* që të na dhurojë ndjesë, o e panjollshme krejt.

#### *Pas Odes VI Martirik*

#### *Tahi prokatálave*

**D**ëshmorët e tu, o Zot, në ndeshjen e tyre, fituan kurorat e mosprishjes prej teje, Perëndisë tonë, se, duke pasur fuqinë tënde, i mposhtën tiranët dhe thyen ambientet e pafuqishme të demonëve. Me lutjet e tyre, o Krisht Perëndi, shpëto shpirtat tanë.\*

## TË ENJTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësore Apostolike Ting. IV  
Tahi prokatalave*

Ndriçues në skajet e sferës,<sup>15</sup> që feksin, o Krisht,\* i shfaqe tër' Nxënësit e tu që shpirtrat na shndrisin me predikimin tënd;\* me ta i errësove\* idhujt, tërë mashtrim,\* me dogma shpresëtare llamburite nur botën;\* shpëto shpirtrat tanë me ndërmjetimet e tyre, Zot.

*Varg:* Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

*O ipsothis en to stavro*

Si Izraelin, Zot,\* përmes Detit të Kuq,\* nga skllavëria në\* Egjipt Moisiu\* e nxori, kur e zhyte Faraonin,<sup>16</sup> kështu\* Nxënësit e tu të urtë krejt\* me çudi plot pra çanë det\* pabesie, tërë helm,\* udhëzuan drejt teje,\* i vetmi njeridashës, popullin;\* e djathta jote\* bën<sup>17</sup> çdo gjë, Fjal' pa fillim.

Lavdi dhe Tani *Hyjindësore*

E dimë se Fjala e Atit, Krishti, Perëndia ynë, u mishërua prej teje, o Hyjindëse e virgjër, e vetmja e dëlirë, e vetmja e bekuar; ndaj pa pushim të madhërojmë duke të përhimnuar.

*Pas Odes VI Martirik  
Tahi prokatalave*

Pasi, Perëndia yn' Krisht, athloforët e tu\* i zhdukën me Kryq porsi me arm' dredhit' e armikut djall e të keqit krejt\* që nga fillimi,<sup>18</sup> shndritën\* si ndriçues,<sup>15</sup> drejtuan\* njerëzit, dhe shërim ndajnë te sa e kërkojnë\* me bes'; shpirtrat na shpëto me lutjet e tyre, Zot.

## TË PREMTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësore Kryqësore Ting. IV*

*Tahi prokatalave*

Në Kryq të mbërthyen judenjtë, o Zot Shpëtimtar,\* me të na rithirre ne nga kombet më parë, njeridashës, kur shtrive ti\* vullnetarisht<sup>14</sup> pëllëmbët\* përmbi të dhe pranove\* që me shtiz' fort të shpoheshe në brinjë,<sup>11</sup> i qoft' lavd\* shumicës së dashurisë sate,<sup>19</sup> o zemërmadh.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

Tani që shikojmë ne dritën e shpirtrave tan',\* shën Kryqin tënd pa cen, Krisht, edhe i falemi, të thërrasim me ngazëllim:\* "Lavd ty, Zot, që me dashje\* mbi të u lartësove;\*<sup>20</sup> lavd ty që, përmes tij, tërë Krijesën e shndrite".\* Në të pa pushim me himne të lavdërojmë ty.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjindësore*

Kur ty nëna jote e pacen të pa përmbi Kryq\* të ngjitesh, thërriste me vajtim nënor keq, o Fjalë e Perëndisë, Zot:\* O sa çudi e huaj,\* e re është, im Bir, kjo?\* Si, jeta e të gjithave,<sup>21</sup> ke lidhje me vdekjen? Se do, si i dhembshur, që të ngjallësh të vdekurit.

*Pas Odes VI Martirik*

Panairi i nderuar i athloforëve e tregoi qiell Kishën, dhe bashkë me njerëzit kërcejnë engjëjt. Me përgjërimet e tyre, o Krisht Perëndi, shpëtoji shpirtrat tanë.

## TË PREMTEN NË MBRËMËSORE

*Në Thirrtoret pas Idhiomelit,  
Martirike Ting. IV*

O Krisht Perëndi, që lavdërohesh në kujtimet e shenjtoreve të tu, me anë të përgjëtimeve të tyre, na dërgo përdëllimin e madh.<sup>7</sup>

Ti që e pranove durimin e martirëve të shenjtë,<sup>22</sup> pranoje edhe prej nesh him-



nodinë, o Njeridashës, dhe na dhuro me përgjërimit e tyre përdëllimin e madh.<sup>7</sup>

**M**eqë keni guxim para Shpëtimtarit, o shenjtorë, ndërmjetoni pa pushim për ne mëkatarët, dhe kërkoni ndjesë mëkatesh, dhe për shpirtrat tanë përdëllimin e madh.<sup>7</sup>

**O** flijime të gjalla, holokauste me logjikë,<sup>23</sup> martirë Zoti, therorë të përsosur Perëndie, dele që e njihni Perëndinë dhe jeni të njohura prej Perëndisë,<sup>1</sup> mandra e të cilave nuk shkelet nga ujqërit, ndërmjetoni që të kullosisim edhe ne bashkë me ju në ujë preheje.<sup>24</sup>

Lavdi *Idhiomel Nekrosim i Damaskinoit*

**K**u është të ngjiturit pas botës? Ku është pompoziteti<sup>25</sup> i kalimtareve? Ku është ari dhe argjendi? Ku është përmbytja e shërbëtorëve dhe zhurma? Të gjitha janë hi, të gjitha pluhur, të gjitha hije. Prandaj, ejani t'i thërrasim mbretit të pavdekshëm: O Zot, denjësoji për të mirat e tua të përjetshme ata që u larguan nga ne, dhe prehi në lumturinë e përjetshme.

Tani *Hyjlindësore*

**P**rofeti David, që u bë hyjprinç me anën tënde, i parathirri melodikërisht atij që të madhështoi.<sup>25a</sup> Qëndroi mbretëresha në të djathtë tënde.<sup>26</sup> Se ty, Perëndia që denjoi të bëhet njeri prej teje pa atë, të rrëfeu nënë shkaktare jete që të gatojë përsëri ikonën e tij<sup>27</sup> të prishur prej pasioneve. Dhe, duke gjetur delen e arratisur nëpër male, ta marrë mbi supë<sup>28</sup> e t'ia shpjerë Atit.<sup>29</sup> Dhe me dëshirën e tij, ta bashkojë me fuqitë qiellore dhe ta shpëtojë botën, o Hyjlindëse, Krishti që ka përdëllimin e madh<sup>7</sup> e të pasur.\*

## TË SHTUNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Martirike Ting. IV*

*Tahi prokatàlave*

**D**ëshmorët e tu, o Zot, në ndeshjen e tyre, fituan kurorat e mosprishjes prej teje, Perëndisë tonë, se, duke pasur fuqinë tënde, i mposhtën tiranët dhe thyen ambiciet e pafuqishme të demonëve. Me lutjet e tyre, o Krisht Perëndi, shpëto shpirtrat tanë.\*

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

**M**e gjakrat e martirëve të tu në tërë botën, Kisha jote, e stolitur si me purpur dhe me li të çmuar, të thërret përmes tyre, o Krisht Perëndi: Dërgoju popullit tënd dhembshuritë e tua, dhuroji paqe shtetit tënd dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.<sup>7</sup>

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

*Tahi prokatàlave*

**P**asi, Perëndia yn' Krisht, athloforët e tu\* i zhdukën me Kryq porsì me arm' dredhit' e armikut djall e të keqit krejt\* që nga fillimi,<sup>18</sup> shndritën\* si ndriçues,<sup>15</sup> drejtuan\* njerëzit dhe shërim ndajnë te sa e kërkojnë\* me bes'; shpirtrat na shpëto me lutjet e tyre, Zot.

Lavdi *Nekrosime*

**Z**ot, shpirtrat që nga kalimtarët i more ti pran',\* o Krisht, Perëndia ynë, si i tërëpushtetshëm edhe i dhembshur krejt,\* prehi dhe, si i mirë,\* ndjeji sa kanë bërë,\* punën e dorës sate<sup>30</sup> përdëlle, përdëllyes,\* siç lutet, i vetmi njeridashës, Hyjlindësja.

Tani *Hyjlindësore*

**M**isteri i fshehur prej jete<sup>31</sup> dhe i panjohur ndër ëngjëjtë<sup>32</sup> u shfaq<sup>33</sup> ndër të dheshmit me anën tënde, o Hyjlindëse, Perëndia që

u mishërua me bashkim të papërzier dhe denjoi Kryq për ne duke dashur,<sup>34</sup> me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtrat tanë.\*

*Lavdërime Martirike*  
*Ting. IV*

**K**ush nuk habitet duke parë, o martirë të shenjtë, luftën e mirë që bëtë?<sup>34</sup> Se, ndonëse ishit me trup, fituat mbi armikun e patrup, kur e pohuat Krishtin<sup>35</sup> dhe u armatosët me kryq; prandaj denjësisht u treguat dëbues demonësh dhe luftëtarë barbarësh; ndërmjetoni pa pushim që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

**U** bëtë shokë me engjëjt, o martirë të shenjtë, kur predikuat burrërisht Krishtin në stadium, sepse të gjitha të kënaqshmet e botës i braktisët si të paqena, dhe e mbajtët besën si spirancë të sigurt;<sup>36</sup> prandaj, pasi e dëbuat mashtrimin, u derdhni si burim besimtarëve karizma shërimesh;<sup>37</sup> ndërmjetoni pa pushim për shpirtrat tanë.

**Si** të mos i admirojmë garat tuaja, o martirë të shenjtë? Sepse, ndonëse të veshur me trup të vdekshëm, triumfuat kundër armiqsh të patrup; nuk ju trembën kërcënimet e tiranëve, nuk ju tmerruan sulmet e torturave; me të vërtetë u lavdëruat denjësisht prej Krishtit, që u jep shpirtrave tanë përdëllimin e madh.<sup>7</sup>

**Ë**shtë e çmuar vdekja e shenjtoreve të tu, o Zot,<sup>38</sup> sepse të dërrmuarit nga shpata, zjarri dhe të ftohtët, e derdhën gjakun e tyre, ngaqë kishin shpresë të ti, që të merrnin pagën e mundimit; duruan dhe morën prej teje, o Shpëtimtar, përdëllimin e madh.<sup>7</sup>

*Lavdi Nekrosim*

**Te** prehja jote, o Zot,<sup>39</sup> ku prehen gjithë

shenjtoret e tu, prehi shërbëtorët e tu, se ti je i vetmi njeridashës.

*Tani Hyjlindësor*

**D**uke të pasur ty, o Perëndillindëse, si shpresë dhe mbrojtje, nuk trembemi nga intrigat e armiqve, se ti i strehohet shpirtrat tanë.

*Pasvargjet Nekrosime të Lavdërimeve,*  
*poezi e Theofanit.*

*Ting. IV Ëdhokas simiosin*

**M**e të vërtetë është fort i frikshëm misteri i vdekjes; si ndahet me pahir shpirti prej harmonisë me trupin, dhe pritet me vullnet të perëndishëm lidhja e natyrshme e bashkëqenies. Prandaj të lutemi, këta që u ndanë prej nesh, prehi në tendat e të drejtëve të tu, o Jetëdhënës njeridashës.\*

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

**Si** gjum' u faktua fjetja e besnikëve,<sup>40</sup> kur në varr\* u vendose ti që sundon\* mbi çdo gjë; e munde pra\* forcën tmerr të vdekjes\* dhe ia asgjësove pushtetin aq shumëvjeçar;\* prandaj dhe ne ty të përgjrohemi:\* Në tendat e shenjtoreve të tu, krejt sa u shpërngulën lart,\* prehi, o jetëdhënës Zot,\* njeridashës, përdëllimtar.

*Varg:* Dhe kujtimi i tyre do të jetë në gjeneratë dhe gjeneratë.

**Na** u bërë drejtësim, çlirim për shpirtrat dhe shenjtëri,\*<sup>41</sup> se na shpurre tek Ati<sup>29</sup> lart,\* si more mbi vete ti,\* Çlirimtar, dënimin\* që e kishim ne pors i borxh; të drejtësuar krejt\* edhe të lirë na solle pranë tij;\* tani të përgjrohemi: Prehi në gaz, hijeshi, hare\* të shpërngulurit, Shpëtimtar,\* mirëbërësi ynë, Zot.

*Lavdi*

**Në** pavdekësi, paprishje, u thirr prapë gjinia jon\* njerëzore prej prishjes keq\*



nga larja me gjakun tënd\* që nga brinja jote,\* Shpëtimtar, ka rrjedhur;<sup>14</sup> me të na lave totalisht\*<sup>42</sup> nga shkelja, faji i paratit ton\*;<sup>43</sup> ndaj ty të lypim: Prehi ti sa u shpërngulën në tendat lart\* në amshim midis koreve\* të martirëve pra të tu.

### Tani *Hyllindësor*

Fjalët e hyjfolësve i ndjekim, ndaj si Hyllindëse\* të besojm' ty që s'ke qortim,\* sepse linde Perëndi,\* Zot, të mishëruar\* krejt pakonceptueshëm; dhe ne, robërit e rën'\* në faje, ky na çliroi plotësisht;\* tani, e Tërëpacenuar, lype fort t'i shkëlqejë mjaft\* krejt sa ikën, shërbyesit\* e tu, lart me hyjnoren drit'.

### CITIME

1. Joan 10.11-14
2. Matth. 18.12; Lluk.15.4
- 2a. Lluk. 15.13-20
3. Lluk. 7.37-50
4. IV Makk. 7.1
5. Matth. 14.30
6. Lluk. 1.26-29
7. Num. 14.19 etj.
8. Matth. 25.1-10
9. Dan. 7.9-10
10. Gal. 3.13
11. Joan 19.34
12. Ps. 78(79).8
13. Lluk. 2.35
14. Joan 10.15,17-18
15. Fil. 2.15
16. Eks. 14.21-31 etj.
17. Eks. 15.6
18. Joan 8.44
19. Ps. 50(51).2; 68(69).17
20. Joan 3.14
21. Joan 1.4; 11.25;14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
22. Apok. 14.12
23. Lev. 1.3; 17.4; Is. 56.7; Rom. 12.1
24. Ps. 22(23).2
25. Vep. 25.23
- 25a. Lluk. 1.49
26. Ps. 44(45).10
27. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
28. Matth. 18.12-13; Lluk. 15.4-5
29. Ef. 2.18; 3.12
30. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9; II Makk. 7.23
31. Ef. 3.9
32. I Petr. 1.12
33. Kol. 1.26

34. II Tim. 4.7
35. Matth. 10.32; Lluk. 12.8
36. Hebr. 6.19
37. I Kor. 12.9; 28.30
38. Ps. 115.6(116.15)
39. Hebr. 4.10
40. Matth. 9.24; Mark 5.39; Lluk. 8.52; Joan 11.11
41. I Kor. 1.30
42. Hebr. 9.14; I Joan 1.7; Apok. 7.14
43. Gjen. 3.2-6



## TINGULL TËRTHOR I TË PARIT TË DIELËN NË MBRËMËSORE

### *Thirrtoje Kataniktike Ting. Tërth. I*

**O** Zot, nuk pushoj së mëkatuari, dhe, sado më bën të denjë për njeridashje, nuk e kuptoj; munde zemërgurtësinë time, o i vetmi i mirë, dhe mëshiomë.

**O** Zot, edhe trembem nga frika jote, edhe nuk pushoj së bëri të ligën; kush në gjykatë nuk e ka frikë gjykatësin? A kush do që të shërohet dhe e inatos mjekun si unë? O Zot zemërgjerë, të të vijë keq për dobësinë time dhe mëshiomë.

**Mjërë!** Pse u bëra i ngjashëm unë me fikun e pafrytshëm dhe trembem për mallkimin<sup>1</sup> dhe prerjen?<sup>2</sup> Por, o bujk përmbiqiellor, Krisht Perëndi, shpirtin tim djerrë tregojë të frytshëm dhe, si Birin e Sththurur, pranomë<sup>3</sup> dhe mëshiomë.

**Moritë** e shkeljeve të mia shpërfilli, o Zot, që linde prej Virgjëreshe, dhe shuaji të gjitha paudhësitë e mia, dhe më jep mendim kthimi, si i vetmi njeridashës dhe mëshiomë, lutem.

## TË HËNËN NË MËNGJESORE

### *Pas Stihologjisë së parë Ndenjësoje Kataniktike Ting. Tërth. I*

**Kur** do të ulet gjykatësi, do të qëndrojnë

engjëjt, do të oshtijë trumbeta dhe do të ndizet flaka, çfarë do të bësh, o shpirti im, kur të çohesh për në gjykim?<sup>4</sup> Sepse atëherë të këqijat e tua do të jenë të pranishme, do të shqyrtohen keqbërjet e tua të fshehura;<sup>5</sup> prandaj, para fundit, thirri Krishtit Perëndi: O zemërnjohës,<sup>5a</sup> mëkatova, mëshiro më.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

O shpirt, të këtushmet janë të përkohshme, ndërsa të atjeshmet të përjetshme; shikoj gjykatoren dhe mbi fron gjykatësin,<sup>4</sup> dhe tmerrohem për vendimin; ndaj, o shpirt, kthehu; gjyqi s'të fal.

Lavdi dhe Tani *Hyjindësore*

Qielloret bashkë me engjëjt, dhe tokësoret bashkë me njerëzit të thërrasim ty, o Hyjindëse, me zë ngazëllimi: Gëzohu, o portë më e gjerë se qiejt;<sup>6</sup> gëzohu, i vetmi shpëtim i vdekatarëve; gëzohu, o e thjeshtë; gëzohu, o hirplote<sup>7</sup> që linde Perëndi të mishëruar.

*Pas Odes VI Martirik*

O Zot, athloforët e tu, meqë e patën zili gotën e pësimit tënd,<sup>8</sup> e lanë kënaqësinë e jetës dhe u bënë shokë me engjëjt; me lutjet e tyre jepu shpirttrave tanë ndjesë dhe përdëllimin e madh.<sup>9</sup>

TË MARTËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kataniktike Ting. Tërth. I*

Duke u dergjur në krevat mëkatesh të shumta, ato ma vjedhin shpresën e shpëtimit tim, sepse gjumi i përtacisë sime i shkakton shpirtit tim dënim; prandaj kursemë, o Krisht Perëndi,<sup>10</sup> si i vetmi njeridashës.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin

tënd.

Le të rrimë zgjuar dhe le t'i dalim para Krishtit të gjithë ne me shumicë mëshire dhe llamba të ndritshme, që të denjësohemi për të hyrë brenda në nusërore, se ai që flet nga jashtë derës, pa efekt i thërrret Perëndisë: Mëshiro më.<sup>11</sup>

Lavdi dhe Tani *Hyjindësore*

*To ksenon tis Parthenu*

Misteri i huaj i Virgjërshës u tregua shpëtimtar për botën, se prej saj lindi pa farë dhe u shfaq me mish pa prishje gëzimi i të gjithëve. O Zot, lavdi më ty.

*Pas Odes VI Martirik*

Përderisa çuditë e martirëve të tu të shenjtë na i dhurove si mur të pamposhtur, o Krisht Perëndi, me përgjërimet e tyre shpërndaji mendimet e kombeve<sup>11a</sup> dhe përforcoji skeprat e mbretërisë, si i vetmi i mirë dhe njeridashës.

TË MËRKURËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kryqësore Ting. Tërth. I*

*Ton sinánarhon Logon*

Shpëtimtarin, Çliuesin tonë, e himnojm',\* u kryqëzua si dinte i miri vullnetarisht;\*<sup>12</sup> besimtarët e lëvdajnë, se mbërtheu krejt\* fajet e njerëzve; kështu,\* prej mashtrimit, hiles e çliroi gjininë tonë,\* njerëzinë e denjësoi për mbretërinë<sup>13</sup> qiellore me Hir.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

Shpëtimtar që durove Kryq me mendim të lir\* dhe vullnetar,<sup>12</sup> dhe nga prishja çlirove njerëzit pra,\* ne besnikët të himnojmë dhe të falemi,\* se me fuqin' e Kryqit tënd\* na ndriçove, ndaj të lavdërojmë të gjithë bashkë,\* o i dhembshur dhe njeridashës, si jetëdhënës, Zot edhe



Perëndi.

Lavdi *dhe* Tani *Kryqhyjlindësore*

Teksa ishte bri Kryqit të Krishtit, qante mjaft,\* thërriste Perëndilindësja: Mjerë, o Biri im!\* Si mbi dru fort u tendose ti që qiellin\* e shtrive prerëndishëm lart\* si lëkurë,<sup>14</sup> edhe nxjerr nga deti burime uji\* përmes urdhrit tënd? Ah, o drita e syve, dhe shikimi im, Zoti im!

*Pas Odes VI Martirik*

Athlororët e tu, o Zoti Shpëtimtar, i tregove në kozmos si përkrahës të mëdhenj; përmes tyre pasionet dëbohen; me ndërjetimet e tyre shpëtoji shpirtat tanë.

#### TË ENJTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësores Apostolike Ting. Tërth. I*  
*Ton sinânarhon Logon*

Si të urtë sypamës dhe shërbëtorë tok\* të Fjalës Zot, krejt ne njerëzit me himnim shpirtëror\* dhe me ode<sup>15</sup> t'i lëvdojm' apostujt; se ata\* Krishtin e lypin pa pus him\* për gjith' ne që e himnojm' kujtimin e shenjtë plot nder,\* dhe lipsaneve të atyre u falemi devotshmërisht dhe me mall.

*Varg:* Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

Tok apostujt e Krishtit t'i mburrim me një zë,\* meqë u shfaqën ndriçues nëpër planet,<sup>16</sup> se ata\* besërisht rrjetuan kombet dhe na shndritën nur,\* shpallin dhe predikojnë fort\* t'i besojmë ne Trinisë Shenjte, është e bashkuar\* në esencë, veçse e ndarë në hipostaza, një Hyjni, një Zot pra.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

Nuse pa dasmë, gjithnjë e virgjër, ne pa fund\* të mburrim bashkë me engjëjt, se mrekulli na ka bër' \*<sup>17</sup> përmes teje Biri yt dhe Perëndia yt;\* deshë me mirësi ai,\* që

nga Ati lindi para jetëve, që të mbahej\* brenda mitrës që ta shpëtonte gjininë tonë prej mashtrimit të keq.

*Pas Odes VI Martirik*

*I ngjashëm*

Plot çudi admiruan Fuqit\* e qiejve\* arritjet që kanë kryer martirët, se, edhe pse\* kishin trup të vdekshëm, mbi armikun që s'ka trup\* padukurisht fituan krejt\* me fuqin' e Kryqit kur garuan drejt; ndërmetojnë\* pra të shenjtët për ne te Zoti, t'i mëshirojë shpirtat tanë gjithnjë.

#### TË PREMTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësores Kryqësore Ting. Tërth. I*

Vëndi i Kalvarit<sup>18</sup> u bë Parajsë, sepse, vetëm sa u ngul druri i Kryqit, menjëherë nxori bistakun e jetës, ty, o Shpëtimtar, për ngazëllimin tonë; lavdi më ty.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

*To ksenon tis Parthenu*

Druri i Kryqit tënd, o Shpëtimtari ynë, u tregua shpëtimtar për botën, sepse, kur u karfose në të vullnetarisht,<sup>12</sup> i çlirove nga mallkimi<sup>19</sup> të dhelindurit; o Zot, gëzimi i të gjithëve, lavdi më ty.

Lavdi *dhe* Tani *Kryqhyjlindësore*

*Ton sinânarhon Logon*

Kur të shihte mbi Kryq nëna Jote, o Krisht Zot,\* që me dëshirë<sup>12</sup> po vareshe mes kusharësh me trup,\*<sup>20</sup> keq në shpirt si nënë po vajtonte, thoshte pra:\* Si u mbërtheve përmbi Kryq,\* Bir i pamëkatshëm,<sup>21</sup> si keqbërës padrejtësisht ti,\* duke dashur, si i mbimirë, ta gjallërosh gjinin' e njerëzve mbar'?

*Pas Odes VI Martirik*

Shkëlqen sot kujtimi i athlororëve, sepse ka edhe nga qielli vezullim: Kori i engjëjve

bën panair dhe gjinia e njerëzve kremton bashkë me të; prandaj ndërmjetojnë pranë Zotit që t'i mëshirojë shpirtat tanë.

### TË PREMTEN NË MBRËMËSORE

*Në Thirrtoret pas Idhiomelit,  
Martirike Ting. Tërth. I*

**O** martirë të tërëfamshëm, meqenëse i shpërfillët të gjitha tokësoret dhe u futët me guxim dhe burrërisht në tortura, nuk dështuat në shpresat e lumtura,<sup>22</sup> por u bëtë trashëgimtarë të mbretërisë<sup>23</sup> së qiejve; duke pasur guxim para Perëndisë njeridashës, kërkoni paqen për botën dhe për shpirtat tanë përdëllimin e madh.<sup>9</sup>

**O** Zot, shenjtoret e tu, pasi u rrethuan me mburojën e besimit<sup>24</sup> dhe e nxitën veten e tyre me shenjën e Kryqit, shkuan me vetëdashje dhe plot burrëri drejt torturave dhe e shfuqizuan mashtrimin dhe arrogancën e djallit; me ndërmjetimet e tyre dërgoju, si Perëndi i tërëfuqishëm, botës paqen dhe shpirtave tanë përdëllimin e madh.<sup>9</sup>

**N**dërmjetoni për ne, o martirë të shenjtë, që të shpëtojme nga paudhësitë tona, sepse juve ju është dhënë hiri që të ndërmjetoni për ne.

**M**e predispozicion të pangopur shpirti, nuk e mohuat Krishtin, o martirë të shenjtë; përderisa duruat tortura të ndryshme pësimesh, i mposhtët arrogancat e tiranëve; pasi e ruajtët besimin të pae-pur dhe të paglymtuar, u zhvendosët në qiej; prandaj, meqë gjetët guxim para tij, kërkoni që t'i dhurojë botës paqen dhe shpirtave tanë përdëllimin e madh.<sup>9</sup>

Lavdi *Idhiomeli Nekrosim,*  
*poezi e Joan Monakut.*

**K**ujtova profetin që thërriste: Unë jam

dhë edhe hi;<sup>25</sup> dhe hodha sytë prapë ndër varre ku pashë eshtrat e zhveshura e thashë: Vallë cili është mbret a ushtar, i pasur a i varfër, i drejtë a mëkatar? Po prehi, o Zot, shërbëtorët e tu me të drejtët.\*

Tani *Hyllindësore*

**N**ë Det të Kuq u përshkrua njëherë kora e nuses së pamartuar. Atje Moisiu, shpërndarës i ujit, këtu Gabrieli, shërbëtor i çudisë. Atëher' Izraeli shkoj në këmbë detin, pa u lagur, dhe tani Virgjëresha lindi Krishtin pafarisht. Deti, pas kalimit t' Izraelit, mbeti i pashkuar;<sup>26</sup> e pacenuara, pas lindjes s' Emanuelit,<sup>27</sup> mbeti e pacenuar. O Perëndi, që je<sup>28</sup> dhe ishe më parë, dhe u duke si njeri,<sup>29</sup> mëshirona.\*

### TË SHTUNËN NË MËNGJËSORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësore Martirike Ting. Tërth. I*

**O** Zot, athloforët e tu, meqë e patën zilli gotën e pësimit tënd,<sup>9</sup> e lanë kënaqësinë e jetës dhe u bënë shokë me engjëjt; me lutjet e tyre jepu shpirtave tanë ndjesë dhe përdëllimin e madh.<sup>9</sup>

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

**P**ërderisa çuditë e martirëve të tu të shenjtë na i dhurove si mur të pamposhtur, o Krisht Perëndi, me përgjërimit e tyre shpërndaji mendimet e kombeve<sup>11a</sup> dhe përforcoji skeprat e mbretërisë, si i vetmi i mirë dhe njeridashës.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

**A**thloforët, meqenëse shpërfillën përndjekje e rreziqe dhe nuk u frikësuan nga arrogancat e tiranëve, e shpallnin me guxim Krishtin; dhe, përderisa duruan fort plagë torturash, rëzuan mashtrim



idhujsh dhe pushtetin e djallit, dhe fituan mbi të qartësisht.

#### Lavdi *Nekrosime*

**P**rehi, o Shpëtimtari ynë, bashkë me të drejtët shërbëtorët e tu dhe fushoji në avilitë e tua siç është shkruar,<sup>30</sup> duke mos i vënë re, si i mirë, paudhësitë e tyre të bëra me dashje dhe pa dashje dhe të gjitha ato me dije dhe pa dije, o njeridashës.

#### Tani *Hyjindësore*

**O** Krisht Perëndi, që nga një Virgjëreshë linde si diell për botën, pasi të na shfaqësh me anën e saj bij drite,<sup>31</sup> mëshirona.

#### *Lavdërime Martirike*

##### *Ting. Tërth. I*

**E** bekuar është ushtria e mbretit të qi-  
ejve, sepse, ndonëse athlororët ishin të  
dhelindur, nxitoheshin të arrinin gradën  
engjëllore, pasi i shpërfillën trupat dhe u  
denjësuuan me anën e pësimeve për çmi-  
min e të patrupëve. Me uratat e tyre, o  
Zot, shpëtoji shpirtrat tanë.

**O** Zot, athlororët e tu, duke imituar ren-  
det e engjëjve, duruan si të patrup në  
tortura, duke menduar vetëm shpresën  
për shijimin e të mirave të premtuara; me  
ndërmjetimet e tyre, o Krisht, Perëndia  
ynë, dhuroji botës sate paqen dhe shpir-  
trave tanë përdëllimin e madh.<sup>9</sup>

**M**artirët e shenjtë garuan në tokë, du-  
ruan në ajër, u dorëzuan në zjarr, i priti uji.  
I këtyre është zëri që thotë "Kaluan për-  
mes zjarri dhe uji, dhe na nxore në pre-  
hje".<sup>32</sup> Me ndërmjetimet e tyre, o Perëndi,  
mëshirona.

**S**henjtorët, kur ishin në mes të torturave,  
thërrisnin me ngazëllim: "Shkëmbim janë  
këto për ne drejt Sunduesit; në vend të  
traumave në trup, të cilat na mundojnë,

do të na lulëzojë rrobë e ndritshme gjatë  
ringjalljes; në vend të çnderimit, kurora;  
në vend të burgjeve, Parajsa; dhe në  
vend të dënimit bashkë me kriminelët,  
shoqëria me engjëjt". Prandaj, o Zot, me  
uratat e tyre shpëtoji shpirtrat tanë.

#### Lavdi *Nekrosim*

**Ti** më gatove, o Zot,<sup>33</sup> dhe e vure mbi  
mua dorën tënde, dhe më porosite, dhe  
më the: "Në tokë sërish do të ikësh".<sup>19</sup>  
Lutem, o njeridashës, drejtomë në udhën  
tënde të drejtë,<sup>34</sup> ndjeji paudhësitë e mia  
dhe shpëtomë.

#### Tani *Hyjindësore*

**Të** lumërojmë, o Perëndilindëse e virgjër,  
se prej teje lindi Dielli i drejtësisë,<sup>35</sup> Kri-  
shti, që ka përdëllimin e madh.<sup>9</sup>

#### *Pasvargjet Nekrosime të Lavdërimeve, poezi e Theofanit.*

##### *Ting. Tërth. I Heris askitikón*

**O** Krisht, radhit sa ikën prej nesh,\* në  
dritën e fytyrës sate, i dhembshur fort,\*  
pra që të banojn' në vend me blerim, me  
ujë që ka\* prehjen<sup>36</sup> tënde mbarë dhe të  
shenjtë krejt,\* në gjirin plot lehtësi\* të  
stëratit ton' Abraham,\*<sup>37</sup> atje ku shfaqet\*  
drita jote e pastër xham,\* dhe gufojn' rrë-  
ke\* e burime të dhembshurisë,\* ku me  
të thellin gaz kërcejnë koret e shenjtëve\*  
rreth mirësisë si dhe njeridashjes sate; bëj  
që me ta,\* shërbyesit e tu,\* të rreshtohen,  
edhe jepu të madhin përdëllim.<sup>9</sup>

**Varg:** Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i mo-  
re, o Zot.

**D**uaj, i dhembshur, Krisht, mirësisht\*  
me një zë plot me harmoni të të psalin  
ty,\* pushtetin tënd ta lëvdojnë sa nga të  
rrjedhshmet këtu\* u shpërngulën te ti që  
sundon çdo gjë,\*<sup>38</sup> dhe bëj që prej bu-  
kurisë,\* hijeshisë sate<sup>39</sup> të shkëlqejn' dhe

të shijojnë\* ëmbëlsi tërë gaz që ka\* shoqërimi yt,\* me hare fort të pastër, lart\* ku përreth fronit tënd kërcëjnë engjëj, dhe tërësi\* shenjtësh me kënaqësi janë pranë, o njeridashës Zot,\* me ta jepu prehe\* krejt shërbyesve të tu dhe të madhin përdëllim.<sup>9</sup>

**Varg:** Dhe kujtimi i tyre do të jetë në gjeneratë dhe gjeneratë.

**P**rehi si njeridashës atje\* ku ndodhet kor apostujsh, rreshta martirësh tok\* profetë, çdo shpirt nga jeta, të drejtësuarit mbar\* me pësimin tënd, me gjakun shpëtimtar;\*<sup>40</sup> me të e shpërbleve krejt\*<sup>41</sup> njerëzinë prej skllavëris',\* atje lart prehi\* pra të fjeturit me besim,\* Çlirimtar dhe Zot,\* si t'u falësh çdo faj, mëkat\* si zemërgjer', se vetëm ti jetove në dhë pa faj,\* je shenjt i vetmi, i vetmi i lirë midis të vdekurve;\* prandaj jepu prehjen\* shërbëtorëve të tu dhe të madhin përdëllim.<sup>9</sup>

Lavdi dhe Tani *Hijlindësor*

**K**ur Perëndinë ligdhënës mbret\* në bark e zure, ti e vetmja e virgjra nën\*, e tërëdëlirë, sa ishim skllavëruar mjerisht,\* keq nën ligj mëkati, na çlirove<sup>42</sup> krejt,\* përmes Krishtit falas ne\* dhe me hir drejtësohemi;\*<sup>43</sup> lypi atij tash\* që në libër të gjallësh,<sup>44</sup> drejt\* t'i radhitë lart\* shpirtrat tanë që të himnojn',\* që përmes ndër-mjetimit tënd, e fortpaqortueshme,\* kur të shpëtojm', të arrijmë çlirimin e dëshiruar mjaft\* të Birit tënd,<sup>45</sup> që jep\* përdëllim të madh<sup>9</sup> në botë; atij i falemi.

### CITIME

1. Matth. 21.19; Mark 11.13-14,20
2. Lluk. 13.6-7
3. Lluk. 15.11-20
4. Dan. 7.9-10
5. Rom. 2.16

- 5a. Fja. Urt. 24.12
6. Gjen. 28.17
7. Lluk. 1.28
8. Matth. 20.22; Mark 10.38-39
9. Num. 14.19 etj.
10. Ne. 13.22
11. Matth. 25.1-12
- 11a. Ps. 32(33).10
12. Joan 10.15,17-18
13. II Thes. 1.5
14. Ps. 103(104).2
15. Ef. 5.19; Kol. 3.16
16. Fil. 2.15
17. Lluk. 1.49
18. Matth. 27.33; Mark 15.22; Lluk. 23.33; Joan 19.17
19. Gjen. 3.16-19
20. Matth. 27.38; Mark 15.27; Lluk. 23.32-3; Joan 19.18
21. Joan 8.46
22. Tit. 2.13
23. Jakov 2.5
24. Ef. 6.17; I Thes. 5.8
25. Gjen. 18.27; Jov 42.6
26. Eks. 14.21-28 etj.
27. Lluk. 1.26-38
28. Eks. 3.14
29. Baruh 3.38
30. Ps. 64(65).5
31. I Thes. 5.5
32. Ps. 65(66).12
33. Gjen. 2.7-8,15; II Makk. 7.23; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9
34. Ps. 26(37).11
35. Mal. 4.2 (3.20)
36. Ps. 22(23).2
37. Lluk. 16.22
38. Jov 5.8; Urt. Sol. 6.7; 8.3
39. Ps. 44(45).3
40. Rom. 5.9
41. Gal. 3.13
42. Rom. 6.17-18
43. Rom. 3.24; Tit. 3.7
44. Fil. 4.3; Apok. 13.8; 20.15
45. Rom. 3.24-25; Ef. 1.7; Kol. 1.14



## TINGULL TËRTHOR I TË DYTIT TË DIELËN NË MBRËMËSORE

*Thirrtore Kataniktike*  
*Ting. Tërth. II*

**N**uk kam pendim edhe as lot, ndaj të përgjërohem, o Shpëtimtar, kthemë para fundit, dhe jepmë kataniks, që të çlirohëm nga Ferri.



Në praninë tënde të frikshme, o Krisht, le të mos dëgjojmë "Nuk ju njoh",<sup>1</sup> sepse shpresën e vumë mbi ty,<sup>2</sup> Shpëtimtarin, ndonëse nuk i zbatojmë urdhërimet e tua për shkak të neglizhencës sonë; por kursej<sup>3</sup> shpirtrat tanë, lutemi.

Traumat e zemrës sime, që më mbinë prej mëkatesh të shumta, shëroji, o Shpëtimtar, mjeku i shpirtrave dhe i trupave; ti që ua jep gjithmonë kërkuesve faljen e shkeljeve, më dhuro lot pendimi, duke më dhënë faljen e mëkateve, o Zot, dhe mëshiromë.

Meqenëse armiku më gjeti lakuriq, pa virtyte, më plagosi me shigjetën e mëkatit; mirëpo ti, si mjek shpirtrash dhe trupash, shëroji, o Perëndi, traumat e shpirtit tim, dhe mëshiromë.

#### TË HËNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kataniktike Ting. Tërth. II*

Mendoj ditën e frikshme, dhe qaj për veprat e mia djallëzore; si do të mbrohem para mbretit të pavdekshëm? Me çfarë guximi do ta shikoj gjykatësin në plangprishësi? O Atë i dhembshur, Bir i vetëmlindur<sup>4</sup> dhe Shpirt i Shenjtë, mëshiromë.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

Në luginën e qarjes, në vendin që rregullove,<sup>5</sup> kur të ulesh, o Mëshirues, që të bësh gjykim të drejtë,<sup>5a</sup> mos i nxirr para publikut të fshehtat e mia, as mos më turpëro rëndë para engjëjve,<sup>5b</sup> por kursemë, o Perëndi,<sup>3</sup> dhe përdëlleme.

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësore*

Nënën e përmbilavdishme të Perëndisë,

që është më e shenjtë se engjëjt e shenjtë, le ta himnojmë pa pushim me zemër dhe buzë, duke e pohuar si Hyjlindëse, përdërisa ajo kryesisht lindi Perëndi të mishëruar, dhe ndërmjeton pareshtur për shpirtrat tanë.

*Pas Odes VI Martirik*

Ka përgjithmonë dritë për të drejtët,<sup>6</sup> sepse shenjtorët, meqë shkëlqyen në ty, feksin përherë si ndriçues, pasi fikën llambë të pabesësh;<sup>7</sup> me lutjet e tyre, o Shpëtimtari ynë, ndriçoje kandilin tim, o Zot,<sup>8</sup> dhe shpëtomë.

#### TË MARTËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kataniktike Ting. Tërth. II*

O Zot, ma dhuro vigjilencën e virgjëreshave të urta dhe hijeshoje llambën e shpirtit tim me vajin<sup>9</sup> e dhembshurive të tua, që të thërras himnin e engjëjve: Allluia.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

Mëshirona, o Zot, mëshirona; se, duke na munguar çdo mbrojtje, ne mëkatarët të drejtojmë ty, si Zot që je, këtë lutje, mëshirona.\*

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësore*

Hapna derën e dhembshurisë, o Hyjlindëse e bekuar; ne që kemi shpresë te ti, të mos gabohemi, shpëtofshim me anën tënde nga rastet e këqija, se ti je shpëtim i të krishterëve.\*

*Pas Odes VI Martirik*

Kur duruan në garë atletike dhe morën prej teje çmimet e fitores, shenjtorët asgjësuan dinakëritë e të paligjshmëve dhe fituan kurorat e pavdekësisë; duke u zbutur me anën e tyre, o Perëndi, dhurona

përdëllimin e madh.<sup>10</sup>

## TË MËRKURËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kryqësore Ting, Tërth. II*

**S**ot u përbush thënia profetike, sepse ja po falemi në vendin ku qëndruan këmbët e tua, o Zot;<sup>11</sup> dhe, si shijuaam dru shpëtimi, fituam çlirim prej pasioneve të mëkatit me anën e ndërmjetimeve të Perëndilindëses, o i vetmi njeridashës.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

**K**ryqi yt, o Zot, u shenjtërua, sepse në të bëhen shërime për ata që sëmuren nga mëkate; përmes tij të biem ndër këmbë; mëshirona.

*Lavdi dhe Tani Kryqhyllindësore*

*Elpis tu kosmu agathi*

**K**risht, Vajza virgjëresh' gjithnjë,\* që në bark ty të kishte,\* tekta të shihte mbi një Kryq,\* lart të ngritur për krejt ne\* në shpirt plagosej nga trishtimi si me shpat'\*<sup>12</sup> dhe qante me vajtim si nënë; ndaj, o Zot\* përdëllimtar, na mëshiro\* me lutjet e asaj,\* o Shpëtimtar i mirë.

*Pas Odes VI Martirik*

**K**ishte rezistenca atletike në arenë, tortura tiranike ndaj martirëve; dhe qëndronin korët e të patrupëve duke mbajtur çmimet e fitores. Të urtët shastisën tiranë dhe mbretër, dhe e mposhtën beljarin me pohimin e Krishtit. O Zot, që i përforcove, lavdi më ty.

## TË ENJTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Apostolike Ting, Tërth. II*

**S**iç arrite në mes të Nxënësve të tu dhe u dhe paqen, o Shpëtimtar,<sup>13</sup> eja dhe te ne dhe shpëtona.

*Varg:* Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

**O** Zoti Jisu, kur i dërgove në skajet e dheut, Nxënësit e tu i kapën besërisht si peshq kombet dhe ia sollën mirësisë sate; dhe ne, nëpërmjet tyre, të thërrasim, o njeridashës: Jepja popullit tënd përdëllimin e madh.<sup>10</sup>

*Lavdi dhe Tani Hyllindësore*

*Elpis tu kosmu agathi*

**E** linde parrëfyeshëm\* Perëndinë ton', Krishtin,\* që bëri tërë kozmosin;\*<sup>14</sup> me të hyshmit apostuj,\* e shenjtja nënë, lype mirësin' e tij\* gjithnjë, që nga pasionet t'na çlirojë ne\* dhe ndjesën e mëkateve\* të na e japë pra,\* o Zonjë e bekuar.

*Pas Odes VI Martirik*

**O** Zot, kujtimi i athloforëve të tu u tregua si Parajsa e Edenit,<sup>15</sup> sepse gjatë tij ngazëllohet tërë Krijesa; prandaj me lutjen e tyre na jep paqen dhe përdëllimin e madh.<sup>10</sup>

## TË PREMTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kryqësore Ting, Ting, Tërth. II*

**V**etëm sa u ngul druri i Kryqit tënd, o Zoti Krisht, themelet e vdekjes u tundën, sepse atë që Hadhi e përpiu me dëshirë, e lëshoi me tmerr; na tregove shpëtimin tënd,<sup>16</sup> o i Shenjtë, dhe të lavdërojmë, Bir i Perëndisë; mëshirona.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

**O** Zot, judenjtë të dënuan me vdekje ty, jetën e të gjithave;<sup>17</sup> ata që, falë shkopit, ecën në Detin e Kuq,<sup>18</sup> të karfosën në Kryq; dhe ata që thithën, si prej gjiri, mjaltë nga guri,<sup>19</sup> të sollën vrer;<sup>20</sup> por pësive vullnetarisht,<sup>21</sup> që të na çlirosh nga



skllavëria e armikut; o Krisht, Perëndia ynë, lavdi më ty.

Lavdi *dhe* Tani *Kryqhyllindësore*

**O** Hyllindëse e virgjër, përgjëroju Birit tënd, Krishtit, Perëndisë tonë, që u mbërthye vullnetarisht<sup>21</sup> në Kryq dhe u ngjall nga të vdekurit, që t'i shpëtojë shpirtat tanë.

*Pas Odes VI Martirik*

**Ata** që shpallën Krishtin në stadium dhe nuk u frikësuan prej kërcënimeve të tiranëve, Zoti i bëri të çuditshëm, sepse mposhtën me durim atletik arrogancat e të paligjëve; e morën denjësisht nga Krishti hirin e shërimeve,<sup>22</sup> dhe i luten pareshtur që t'i shpëtojë shpirtat tanë.

#### TË PREMTEN NË MBRËMËSORE

*Në Thirrtoret pas Idhiomeli,  
Martirike Ting Tërth. II*

**Martirët** e tu, o Zot, nuk të mohuan, nuk u larguan nga porosité e tua; me ndërmjetimet e tyre, mëshirona.

**Ata** që u bënë martirë për hirin tënd, o Zoti Krisht, duruan shumë tortura; me ndërmjetimet dhe lutjet e tyre, ruana të gjithë ne.

**Martirët** athloforë dhe qytetarët e qiellit, kur garuan mbi dhé, duruan shumë tortura dhe e fituan kurorën e përsosur në qiej, që të ndërmjetojnë për shpirtat tanë.

**Kryqi** yt, o Zot, u bë armë e pamposhtur për martirët, sepse e shikonin para tyre vdekjen dhe, duke synuar jetën e ardhshme, përforcoshin me shpresën tënde; me lutjet e tyre, mëshirona.

Lavdi *Idhiomeli Nekrosim,  
poezi e Joan Monakut.*

**Urdhri** yt krijues ka qenë fillimi im dhe qenia ime; dhe, duke dashur të më bësh krijesë të gjallë prej natyre të dukur dhe të padukur, ma formove trupin prej dheut dhe më dhe shpirt me fryrjen tënde të përrëndishme dhe jetëbërëse.<sup>23</sup> Prandaj, o Krisht, vendosi shërbëtorët e tu në vendin e të gjallëve<sup>24</sup> e në tendat e të drejtëve.<sup>25\*</sup>

Tani *Hyllindësore*

**Cili** s'do të të lumërojë, o Hyllindëse Virgjëreshë, cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastresë i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier; atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtat tanë.\*

#### TË SHTUNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësores Martirike Ting Tërth. II*

**Kur** duruan në garë atletike dhe morën prej teje çmimet e fitores, shenjtoret asgjësuan dinakëritë e të paligjshmëve dhe fituan kurorat e pavdekësisë; duke u zbutur me anën e tyre, o Perëndi, dhurona përdëllimin e madh.<sup>10</sup>

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

**Kishte** rezistenca atletike në arenë, tortura tiranike ndaj martirëve; dhe qëndronin korët e të patrupëve duke mbajtur çmimet e fitores. Të urtët shastisën tiranë dhe mbretër, dhe e mposhtën beljarin me pohimin e Krishtit. O Zot, që i përforcove, lavdi më ty.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

O Zot, kujtimi i athlorëve të tu u tregua si Parajsa e Edenit,<sup>15</sup> sepse gjatë tij ngazëllohet tërë Krijesa; prandaj me lutjen e tyre na jep paqen dhe përdëllimin e madh.<sup>10</sup>

Lavdi *Nekrosime*

Me të vërtetë janë kotësi të gjitha,<sup>26</sup> ndërsa jeta është hij<sup>27</sup> dhe ëndërr, dhe kot trazohet çdo i dhelindur siç tha Shkrimi.<sup>28</sup> Kur tërë botën ta fitojmë, atëherë në varr do të banojmë, atje ku së bashku janë mbretër dhe të varfër. Prandaj, o Krisht Perëndi, prehi si njeridashës shërbyesit e tu që u zhvendosën.

Tani *Hyjindësore*

O shpresë e mirë e botës, Hyjindëse e virgjër, kërkoj mbrojtjen tënde, të vetmen të frikshme; dhembshuroje popullin që është në peripeci, përgjëroju Perëndisë mëshirues që të çlirohen shpirtat tanë nga çdo kërcënim, o e vetmja e bekuar.

*Lavdërime Martirike*  
*Ting. Tërth. II*

O Zot, në kujtimin e martirëve të tu tërë Krijesa kremton, qiejt ngazëllohen bashkë me engjëjt dhe toka dëfren bashkë me njerëzit; me lutjet e tyre, mëshirona.

O Zot, nëse nuk do të kishim shenjtoret e tu si ndërmjetues dhe mirësinë tënde që të na dhembshuronte, si do të guxonim, o Shpëtimtar, të të himnonim ty që të bekojnë pareshtur engjëjt? O zemërnjohës,<sup>28a</sup> kurseji<sup>3</sup> shpirtat tanë.

Kujtimi i martirëve është ngazëllim për ata që e kanë frikë Zotin, sepse, meqenëse garuan për Krishtin, morën prej tij kurora, dhe tani ndërmjetojnë me guxim për shpirtat tanë.

Shenjtoret dhe të zgjedhurit i bëri të çuditshëm Perëndia ynë.<sup>29</sup> Ngazëllohuni

dhe dëfreni të gjithë ju, o shërbëtorët e tij, sepse për ju e përgatiti kurorën dhe mbretërinë<sup>30</sup> e tij; dhe kërkojmë, mos na harroni edhe ne.

Lavdi *Nekrosim*

Ishte dhimbje për Adamin shijimi i drurit qëmoti në Eden, kur gjarpri nxori helm<sup>31</sup> nga goja, sepse nëpërmjet tij hyri vdekja<sup>32</sup> dhe hëngri tërë gjininë njerëzore; por Zoti, kur erdhi, e vithisi dragoin dhe na dhuroi prehje; prandaj le t'i thërrasim: Le të vijë keq, o Shpëtimtar, dhe prehi së bashku me të zgjedhurit e tu ata që i more.

Tani *Hyjindësore*

*Trimeros anestis Hristë*

Krisht, prehi shërbëtorët e tu\* që fjetën, ndërmjetojn' te ti\* nëna jote,\* oshënarët, çdo shenjtor,\* profetët me apostujt, martirët, hierarkët\* edhe të drejtët, që bri teje jan'.

*Pasvargjet Nekrosime të Lavdërimeve,*  
*poezi e Theofanit.*

*Ting. Tërth. II Olin apothémëni*

Duke pasur mirësi\* të pakuptuar për krejt ne,\* dhe burim që nuk shteron\* plot mëshir' hyjnore, te ti sa erdhën bri,\* vëri, Zot, të fushojn'\* përmbi dhë të gjallësh\*<sup>33</sup> dhe në tenda fort të dashura,<sup>34</sup> plot mallëngjim, hare;\* jepu pasurinë që s'zhduket hiç,\* por mbetet e qëndrueshme\* përgjithnjë, sepse derdhe gjakun tënd,\* Krisht, për gjithë<sup>35</sup> ne edhe bleve botën me një çmim<sup>36</sup> të madh\* dhe jetëprurës, o Shpëtimtar,\* shumë-përdëllyes Zot.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

Vdekjen jetëbërëse\* vullnetarisht e durove,\*<sup>21</sup> jetën na e fale ti\* dhe shijim përherë për ne besnikët mbar';\* Krisht, rre-



shtoji në të\* sa me shpres' për ngjalljen\* kanë fjetur, ndjeji mirësisht çdo faj që bënë keq,\* ndjeji si i vetmi që s'ke mëkat,\* i vetmi njeridashës, Zot,\* që të la-  
vdërohet me çdo mënyr',\* të himnohet emri yt, o i mirë, dhe ta mburrim mjaft\* të gjithë në të shpëtuarit,\* njeridashjen tënde pra.

*Varg:* Dhe kujtimi i tyre do të jetë në gjeneratë dhe gjeneratë.

Shumëpërdëllyes Krisht,\* të dimë si sundimtarin\* me fuqi hyjnore ty\* mbi të gjallët dhe Zotin e të vdekurve,\*<sup>37</sup> shërbëtorët e tu\* besimtarë prehi,\* njeridashës, në vend lehtësimi me të zgjedhurit\* edhe në shkëlqimet e shenjtëve,\*<sup>38</sup> sepse shpërngulen lart te ti\* që Je mirëbërësi krejt unik,\* dashamirësi, përdëllyesi<sup>39</sup> i vetëm dhe shpëton\* ata që "sipas ikonës" pra\* i gatove<sup>40</sup> porsit Zot.

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësore*

Shfaqesh, o e Tërshenjt',\* shtëpi hyjnore, se zure\* Perëndi dhe linde ti,\* por pa burrë, Zotin në dy natyra veç;\* kish vullnet të dyfisht',\* në një hipostazë;\* lyp atë, të vetëmlindurin,<sup>4</sup> të parëlindurin,\*<sup>41</sup> që edhe pas lindjes të ruajti\* të virgjër pa qortim aspak,\* që të prehë shpirta të vdekurish,\* sa me besë fjetën, në gjendje hijeshie pa cenim,\* në lumturi qiellore lart,\* Zonjë e dëlirë krejt.

### CITIME

1. Matth. 7.23; 25.12
2. Ps. 72(73).28; 77(78).7
3. Ne. 13.22
4. Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
5. Ps. 83(84).7
- 5a. I Petr. 2.23
- 5b. Dan. 7.9-10
6. Fja. Urt. 13.9
7. Jov 21.17
8. Ps. 17(18).29
9. Matth. 25.1-7

10. Num. 14.19 etj.
11. Ps. 131(132).7
12. Lluk. 2.35
13. Lluk. 24.36; Joan 20.19,26
14. Joan 1.3; Kol. 1.16
15. Gjen. 2.8
16. Ps. 49(50).23; 90(91).16
17. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
18. Eks. 14.16,22 etj.
19. Ligji i Dytë 32,13; Ps. 80(81).17
20. Matth. 27.34
21. Joan 10.15,17-18
22. I Kor. 12.9, 28,30
23. Gjen. 2.7
24. Ps. 114(115).9
25. Ps. 117(118).15
26. Kisht. 1.2 etj.
27. Jov 8.9
28. Ps. 38(39).7,12
- 28a. Fja. Urt. 24.12
29. Ps. 15(16).3
30. Matth. 25.34
31. Gjen. 3.1-6, 17-19
32. Rom. 5.12
33. Ps. 114(115).9
34. Ps. 83(84).2
35. Matth. 26.28; Mark. 14.24; Lluk. 22.20
36. I Kor. 6.20
37. Rom. 14.9
38. Ps. 109(110).3
39. Mih. 7.18
40. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
41. Rom. 8.29; Kol. 1.15; Hebr. 1.6



## TINGULL I RËNDË

### TË DIELËN NË MBRËMËSORE

*Thirrtoje Kataniktike*

*Ting. i Rëndë*

Porsi Biri Plangprishës erdha edhe unë, o i dhembshur; mua që bie para teje, pronomë si një nga rrogëtarët e tu,<sup>1</sup> o Perëndi, dhe mëshiro më.

Si ai që ra në kusarë dhe u plagos, po ashtu edhe unë rashë për shkak të mëkateve të mia, dhe m'u plagos shpirti. Drejt kujt të përiki unë që mbaj përgjegjësi, veçse drejt teje, mjekut të dhembshur të shpirttrave? Derdhe mbi mua,<sup>2</sup> o Perëndi,

përdëllimin tënd të madh.<sup>3</sup>

**S**i fikun e pafytyshëm, mos më prit mua mëkatarin, o Shpëtimtar; mirëpo, ndonëse kaluan shumë vjet,<sup>4</sup> më dhuro ndjesë, dhe ujite shpirtin tim me lotët e pendimit, që të të sjell fryt lëmoshe.

**M**eqë je Diell drejtësie,<sup>5</sup> shkëlqej zemrat e atyre që të himnojnë, o Zot, lavdi më ty.

#### TË HËNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kataniktike Ting. i Rëndë*

**D**uke pasur klinikën e pendimit, o shpirti im, afrohu duke lotuar me psherëtima, dhe thirr mjekut të shpirtave dhe të trupave: O Njeridashës, çliromë nga paudhësitë e mia, rreshtomë me Lavren,<sup>6</sup> Kusarin<sup>7</sup> dhe Doganierin,<sup>8</sup> dhe dhuromë, o Perëndi, faljen e paligjësive të mia dhe shpëtomë.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

**N**uk e pata zili pendimin e Doganierit<sup>8</sup> dhe nuk kam lotët e Lavres,<sup>6</sup> sepse për shkak të zemërgurtësisë privohem nga një korrigjim i tillë; por me anën e dhembshurisë sate, o Perëndi, shpëtomë si njeridashës.

Lavdi dhe Tani *Hyllindësore*

**J**e më e çmuar se Keruvimet, o Virgjëreshë e Tërëshenjtë, sepse ata, ngaqë nuk e durojnë dot shkëlqimin hyjnor, e kryejnë shërbimin me fytyrë të mbuluar me krahë,<sup>9</sup> ndërsa ti e mban dhe e shikon dukshëm të mishëruar Zotin Fjalë; përgjëroju atij pa pushim për shpirtat tanë.

*Pas Odes VI Martirik*

**S**henjtorët e tu, o Zot, kur garuan mbi dhë, e shkelën armikun dhe e asgjësuan

mashttrimin e idhujve, prandaj edhe i morën kurorat<sup>10</sup> nga ti, Zoti njeridashës, Perëndia mëshirues, që na dhuron përdëllimin e madh.<sup>3</sup>

#### TË MARTËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kataniktike Ting. i Rëndë*

**O** Shpëtimtar, që i pranove lotët e Lavres<sup>6</sup> dhe të Petros,<sup>11</sup> si dhe e drejtësive Publikanin që psherëtiu nga thellësia e shpirtit,<sup>8</sup> le të të vijë keq edhe për mua të dëshpëruarin për shkak të veprave dhe mëshimomë.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

**O** Njeridashës, që e pastrove mohimin e Petros nëpërmjet lotëve<sup>11</sup> dhe i fale shkeljet e Doganierit nëpërmjet psherëtimës,<sup>8</sup> lavdi më ty.

Lavdi dhe Tani *Hyllindësore*

**I**tejallove Fuqitë e qiejve, sepse u tregove tempull hyjnor, o Perëndilindëse e bekuar, meqë linde Krishtin, Shpëtimtarin e shpirtave tanë.

*Pas Odes VI Martirik*

**N**gazëllohuni, o të drejtë, dhe dëfreni,<sup>12</sup> o qiellorë, sepse martirët, kur garuan mbi dhë, e shfarosën mashttrimin. Le të kërcejë Kisha duke kremtuar fitoren për hir të dhënësit të çmimeve dhe të të vetmit bërës të fitoreve, Krishtit Perëndi, që i jep botës përdëllimin e madh.<sup>3</sup>

#### TË MËRKURËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësore Kryqësore Ting. i Rëndë*

**K**isha, duke t'u falur në kedër, pishë dhe qiparis,<sup>13</sup> të thërret, o Krisht Perëndi: Dhuroju fitore mbretërve tanë përmes Perën-



dindëses dhe mëshirona.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

**T**i që për mua e durove gozhdimin në Kryq, pranoje himnimin tim të pafjetur, o Krisht Perëndi, si njeridashës.

Lavdi *dhe* Tani *Kryqhyllindësore*

**O** Hyllindëse, Krishtit Perëndi, që u kryqëzua për ne dhe e vithisi pushtetin e Hadhit, përgjeroju pareshtur që t'i shpëtojë shpirtrat tanë.

*Pas Odes VI Martirik*

**O** shenjtorë, kur e shpërfilltë ateizmin e tiranëve dhe nuk i dhatë rëndësi dhimbjes së torturave, nuk e mohuat besimin te Krishti; ndaj lypeni Perëndinë njeridashës që t'i shpëtojë shpirtrat tanë.

#### TË ENJTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësores Apostolike Ting. i Rëndë*

**O** Fjalë, apostujt e tu i tregove bujq të arës sate, të cilët i prenë idhujt; prandaj, kur të predikuan në kombe ty, Zotin, të madhëruan besërisht.

*Varg:* Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

**N**e, bijtë e Kishës, duke kryer kujtimet e apostujve të tërëfamshëm, le ta himnojmë Krishtin me ode këngësh, sepse ata, me predikimin e pendimit, shpëtuan sa mbanin përgjegjësi për mëkatin; janë dëbues të mashtrimit, ndriçues të botës<sup>14</sup> dhe ndërmjetues të kozmosit.

Lavdi *dhe* Tani *Hyllindësore*

**G**ëzohu, ti, nga e cila u bë mish Fjala pa ndryshim dhe fushoi ndër ne;<sup>15</sup> gëzohu, o e thjeshtë, ngazëllimi i apostujve dhe i martirëve, si dhe shpëtimi i besnikëve; gëzohu, o nëna e Krishtit Perëndi.

*Pas Odes VI Martirik*

**O** shenjtorë, ndërmjetoni që të na jepet ndjesa e paudhësive tona dhe të shpëtojme nga tmerret e ardhshme si dhe nga vdekja e hidhur,<sup>16</sup> lutemi.

#### TË PREMTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë*

*Ndenjësores Kryqësore Ting. i Rëndë*

**D**rrurin e Kryqit tënd e tregove më të ndritshëm se zjarrë dhe më të efektshëm se flaka; ai i djeg mëkatet e të sëmurëve dhe i feks zemrat e atyre që e himnojnë kryqëzimin tënd vullnetar,<sup>17</sup> o Krisht Perëndi; lavdi më ty.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

**T**i që sundon mbi Fuqitë e patrup dhe e njeh dembelizmin e shpirtit tim, më shpëto me anën e Kryqit tënd, o Krisht Perëndi, si njeridashës.

Lavdi *dhe* Tani *Hyllindësore*

**K**rishtin Perëndi që u kryqëzua për ne dhe e rrëzoi pushtetin e vdekjes, lype pa pushim, o Hyllindëse Virgjërëshë, që t'i shpëtojë shpirtrat tanë.

*Pas Odes VI Martirik*

**O** Zot, kur u armatosën me fuqinë e Kryqit, martirët e tu triumfuan mbi armikun dhe e turpëruan mashtrimin e idhujve; prandaj, duke përhimnuar bashkë me engjëjt, thërrasin himnin triumfal, duke të lavdëruar, o Krisht; përmes tyre të përgjerohem: Mëshirona.

#### TË PREMTEN NË MBRËMËSORE

*Në Thirrtoret pas Idhiomelit,*

*Martirike Ting. i Rëndë*

**L**avdi ty, o Krisht Perëndi, mburrja e Apostujve, gëzimi i martirëve, lëçitje e të cilëve është Trinia e njëqenëshme.\*

Martirë të shenjtë, që luftuat mirë dhe u kurorëzuar, ndërmjetoni te Zoti të mëshirohen shpirtat tanë.\*

Përderisa e shpërfillët çdo gjë mbi tokë dhe e shpallët pa u trembur Krishtin në stadium, e morët pagën e torturave prej tij, o martirë të shenjtë; meqë keni guxim, atë lypeni si Perëndi të tërëfuqishëm, që të na i shpëtojë shpirtat neve që rendim drejt jush, lutemi.

O martirë të tërëfamshëm, krijime shpirtërore, holokauste me arsye, flijim i mirëpritur dhe i pëlqyeshëm te Krishti,<sup>18</sup> nuk ju fshehu dheu, por ju pranoi qielli; u bëtë shokë me engjëjt; së bashku me ta, lutemi, lypini Shpëtimtarit dhe Perëndisë tonë, që ta paqësojë botën dhe t'i shpëtojë shpirtat tanë.

Lavdi *Idhiomeli Nekrosim*,  
poezi e Joan Monakut.

O jetëdhënë, Shpëtimtari ynë, prehi vëllezërit tanë që i ngrite nga jeta e përkohshme, dhe që thërrasin: Lavdi më ty.\*

Tani *Hyjindësore*

Nënë u njohe përmbi natyrën, o Hyjindëse, dhe Virgjëreshë mbete përmbi arsye dhe mendim; dhe çudin' e lindjes sate, gjuhë nuk mund ta shpjegojë; se, ngaqë është e çuditshme zënia, o e pastër, prandaj është e pakuptueshme dhe mënyra e lindjes; se, atje ku do Perëndia, mundet rregull' i natyrës. Prandaj, duke të njohur të gjithë si Nënë të Perëndisë', të lutemi nxehtësisht: Ndërmjeto të shpëtohen shpirtat tanë.\*

TË SHTUNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësore Martirike Ting, i Rëndë*

Ngazëllohuni, o të drejtë, dhe dëfreni,<sup>12</sup> o qiellorë, sepse martirët, kur garuan mbi dhë, e shfarosën mashtrimin. Le të kërcejë Kisha duke kremtuar fitoren për hir të dhënësit të çmimeve dhe të të veçmit bërës të fitoreve, Krishtit Perëndi, që i jep botës përdëllimin e madh.<sup>3</sup>

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

O shenjtore, kur e shpërfillët ateizmin e tiranëve dhe nuk i dhatë rëndësi dhimbjes gjatë torturave, nuk e mohuat besimin te Krishti; ndaj lypeni Perëndinë njeridashës që t'i shpëtojë shpirtat tanë.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

O shenjtore, ndërmjetoni që të na jepet ndjesa e paudhësive tona dhe të shpëtojmë nga tmerret e ardhshme si dhe nga vdekja e hidhur,<sup>16</sup> lutemi.

Lavdi *Nekrosime*

O Zot, në vendin e të gjallëve<sup>19</sup> dhe në tentat e të drejtëve<sup>20</sup> prehi shërbëtorët e tu, kujtimin e të cilëve e kremtojmë, o njeridashës; dhe, nëse mëkatuan në diçka kur ishin në jetë, fali, si mëshirues dhe Perëndi që pajtohesh lehtë dhe i jep botës përdëllimin e madh.<sup>3</sup>

Tani *Hyjindësore*

Si thesari i ngjalljes sonë, o e gjithëhimmuar, nxirri prej thellësisë dhe gropës së fajeve ata që kanë besim më ty. Se ti i shpëtove fajtorët e mëkatit, duke lindur shpëtimin ti që ishte Virgjëreshë para lindjes, Virgjëreshë në lindje dhe mbete dhe pas lindjes Virgjëreshë.\*

*Lavdërimi Martirike  
Ting, i Rëndë*

Duke festuar kujtimin e athlorëve të tu



të shenjtë, o Krisht, të përhimnojme duke thirrur: O Zot, lavdi më ty.

**N**ë mes të stadiumit të të paligjëve athloforët, të ngazëllyer, i thërrisin Krishtit: O Zot, lavdi më ty.

**M**artirët athloforë u dalluan si ndriçues të planetit<sup>14</sup> duke i thirrur Krishtit: O Zot, lavdi më ty.

**A**thloforët martirë, duke parë me një frymë drejt një gjëje, pasi gjetën një udhë jete,<sup>21</sup> vdekjen për Krishtin, dhe, pasi patën zili vdekjen e njëri-tjetrit, – oh, çudi! – i rrëmbenin, kush e kush më parë, si thesarë torturat, dhe i thoshin njëri-tjetrit se “Edhe nëse nuk do të vdesim tani, ne patjetër do të vdesim dhe do t’ia shpaguajmë lindjes sonë borxhet, vdekjen; le ta bëjmë sedër nevojën, le ta konsiderojmë gjënë e përbashkët si të vetme për secilin, dhe le ta blejmë me vdekje jetën”. Me ndërmjetimet e tyre, o Perëndi, mëshirona.

Lavdi *Nekrosim*

**O** Zot, Shpëtimtari i botës, prehi shpirtrat që more në tentat e të drejtëve<sup>20</sup> dhe të të zgjedhurve të tu.

Tani *Hyjindësor*

**O** Hyjnuse, të thërrasim “Gëzohu” bashkë me engjëllin,<sup>22</sup> duke të quajtur dhomë nusërore, portë,<sup>23</sup> fron të zjarrtë,<sup>24</sup> mal të palatuar<sup>25</sup> dhe ferrë të padjegshme.<sup>26</sup>

*Pasvargjet Nekrosime të Lavdërimeve,  
poezi e Theofanit.*

*Ting. i Rëndë Katafronisantes*

**O** i vetmi i pavdekshëm,<sup>27</sup> u duke mbi Kryq i vdekur dhe u vendose si i vdekshëm në varr, pasi i çlirove njerëzit nga prishja dhe vdekja; por, meqë je det i pasosur dhembshurie dhe burim mirësie,

prehi shpirtrat e shërbëtorëve të tu që u zhvendosën nga ne.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

**O** i Mirë, ata që erdhën drejt teje, denjësoji për bukurinë tënde të pacenuar dhe për ëmbëlsinë e hijeshisë, që të shkëlqejnë përmes rrezeve të dritësimit tënd hyjnor në derdhje drite nga shfaqja jote vezulluese dhe të kërcëjnë së bashku me engjëjt rreth teje, sunduesit, mbretit të lavdisë<sup>28</sup> dhe Zotit.

*Varg:* Dhe kujtimi i tyre do të jetë në gjeneratë dhe gjeneratë.

**M**eqë e ke si thesar të plotë mirësinë e pasur,<sup>29</sup> si të pafund madhështinë e dhuratave, ata që u shpërngulën drejt teje, fushoju në vendin e të zgjedhurve të tu, në vendin e mirëqenies, në shtëpinë e lavdisë sate, në shijimin e Parajsës<sup>30</sup> dhe në nusëroren e virgjëreshave,<sup>31</sup> si Perëndi i dhembshur.

Lavdi dhe Tani *Hyjindësor*

**O** e Tërëhimnuar, lind përmbushjen e Ligjit,<sup>32</sup> Çlirimtarin që u bë mish, sepse në të mëparshmit s’u realizua drejtësimi me anë të Ligjit,<sup>33</sup> Krishti na drejtësoi kur u kryqëzua për ne;<sup>34</sup> prandaj, meqë ke guxim si nënë, përgjëroju Birit tënd të dhembshur, që t’i prehë shpirtrat e të zhvendosurve besërisht.

*CITIME*

1. Lluk. 15. 11-21
2. Lluk. 10.30-34
3. Num. 14.19 etj.
4. Lluk. 13.6-9
5. Mal 4.2(3.20)
6. Lluk. 7.37-48
7. Lluk. 23.39-44
8. Lluk. 18.10-14
9. Is. 6.2
10. I Petr. 5.4

11. Matth. 26,75; Mark. 14,72; Lluk.22.62  
 12. Ps. 31(32).11; 32(33).1  
 13. Is. 60.13  
 14. Fil. 2.15  
 15. Joan 1,14  
 16. I Mbret. [Sam.] 15.32  
 17. Joan 10.15,17-18  
 18. Fil. 4.18  
 19. Ps. 114(115).9  
 20. Ps. 117(118).15  
 21. Ps. 15(16).11 etj.  
 22. Lluk. 1.28  
 23. Gjen. 28.17; Jez. 44.1-4  
 24. Jez. 1.13-26  
 25. Dan. 2.34-35  
 26. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16  
 27. I Tim. 6.16  
 28. Ps. 23(24).7 etj.  
 29. Rom. 2.4  
 30. Gjen. 2.15; 3.23  
 31. Matth. 25.1-10  
 32. Matth. 5.17  
 33. Rom. 3.20; Gal. 2.16; 3.11  
 34. Tit. 3.7



## TINGULL TËRTHOR I TË KATËRTIT TË DIELËN NË MBRËMËSORE

*Thirrtores Kataniktike  
Ting. Tërth. IV*

**T**y, mbretin edhe Zotin, engjëjt të përhimnojnë pa pushim, ndërsa unë bie para teje si Doganieri dhe të thërras: O Perëndi, të të vijë keq për mua<sup>1</sup> dhe shpëtomë.

**O** shpirti im, meqë je i pavdekshëm, mos u mbulo nga dallgët e jetës; zgjohu dhe thirr drejt mirëbërësit tënd: O Perëndi, të të vijë keq për mua<sup>1</sup> dhe shpëtomë.

**O** Perëndi, më jep lot siç i dhe dikur gruas mëkatore dhe denjësomë që t'i lag këmbët e tua që më çliroan nga udha e mashtrimit dhe të të ofroj, si miro erëkëndshme, jetën e pastër të krijuar me pendimin tim; kështu le ta dëgjoj edhe unë zërin tënd të dëshiruar: Besimi yt të shpëtoi, shko në paqe.<sup>2</sup>

**K**ur sjell në mendje moritë e të këqijave që kam bërë dhe mendoj thellë për hetimin e frikshëm, i pushtuar nga frika përiki te ti, Perëndi njeridashës; ndaj lyp, mos më shpërfill, o i vetmi i pamëkatshëm; dhuroji kataniks para vdekjes shpirtit tim të përlulur dhe shpëtomë.

## TË HËNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësores Kataniktike Ting. Tërth. IV*

**M**e sy të dhembshur, o Zot, shihe përlësinë time, sepse pak nga pak jeta ime po konsumohet dhe nuk shpëtoj dot në përmjet veprave të mia; prandaj lutem: Me sy të dhembshur, o Zot, shihe përlësinë time dhe shpëtomë.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

**O** Shpirt, kujdesu si të jetë i pranishëm gjykatësi, dhe kujtoje orën e ditës së frikshme, sepse vendimi do të jetë pa mëshirë për ata që nuk e praktikuan mëshirën.<sup>3</sup> Prandaj, o Shpëtimtar, kursemë,<sup>4</sup> meqë je i vetmi njeridashës.

*Lavdi dhe Tani Hyjllindësore*

**O** Perëndillindëse e pacenuar, dera mendore e jetës sonë, ne që vrapojmë te ti besërisht, çlirova nga rreziqet, që të lavdërojmë Birin tënd të tërëshenjtë, për shpëtimin e shpirtit tanë.

*Pas Odes VI Martirik*

**U**treguat ndriçues mendorë, o martirë të shenjtë, sepse e asgjësuat mjegullën e mashtrimit përmes besimit, i hijeshuat llambat tuaja shpirtërore dhe me lavdi hytë bashkë me Dhëndrin në nusëroren<sup>5</sup> qiellore; dhe tani përgjërohuni që të shpëtohen shpirtit tanë, lutemi.



## TË MARTËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë**Ndenjësore Kataniktike Ting. Tërth. IV*

**S**i Lavirja bie para teje që të marr ndjesën dhe, në vend të miros, të ofroj, o Krisht Perëndi, lot nga zemra, që të më dhembshurosh si atë, o Shpëtimtar, dhe të më japësh faljen e mëkateve;<sup>5a</sup> sepse si ajo të thërras: Çliromë nga balta e veprave të mia.

*Varg:* O Zot, mos më qorto në zemërimin tënd.

*Tin sofian qe Logon*

**A**të ditë të frikshme mendoje, shpirt,\* llambën ti hijesoje, ndize me vaj\* dhe ji në gatishmëri,\* se s'di kur do të vij' një zë\* që do të thotë: "Ja Dhëndri yt",<sup>5</sup> ndaj kujdesu drejt,\* të mos dremitësh dhe që të mos mbetesh jashtë pra,\* dhe si pesë vajzat të trokasësh kot fare,\* por, pa gjumë, fort duro,\* mirëprit Krishtin Perëndi,\*<sup>6</sup> duke pasur\* të mirin vaj\* dhe do të ta japë ai\* dhe nusëroren e tij<sup>5</sup> ty,\* e cila ka\* tok hyjnoren lavdi dhe gazin përjetësisht.

*Lavdi dhe Tani Hyjlindësore*

**P**erëndilindësen, mbështetjen e palëkundur të besës dhe dhuratën e respektuar të shpirttrave tanë, le ta madhësojmë me himne, o shpresëplotë: Gëzohu, ti që mbajte në barkun tënd gurin e jetës; gëzohu, o shpresa e skajeve, përkrahja e të shtërnguarve; gëzohu, o nuse e panusëruar.

*Pas Odes VI Martirik*

**N**ga një dritë qiellore shkëlqen sot kjo tendë, sepse në të, gjatë kujtimit të athloforëve, ngazëllohen ushtritë e engjëjve dhe, së bashku me ta, dëfrenjë edhe korë e martirëve. O Krisht, me lutjet e tyre

dërgoji nga lart botës sate paqen dhe përdëllimin e madh.<sup>7</sup>

## TË MËRKURËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë**Ndenjësore Kryqësore Ting. Tërth. IV*

**K**usari, duke parë kryetarin e jetës<sup>8</sup> të varur mbi Kryq, thoshte: Nëse nuk do të ishte Perëndi i mishëruar i kryqëzuar bashkë me ne, nuk do t'i fshihte rrezet dielli,<sup>9</sup> as do të lëkundej toka nga tërmeti;<sup>10</sup> por "Ti, o Zot, që i duron të gjitha, kujtomë në mbretërinë tënde".<sup>11</sup>

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

**N**ë mes dy kusarësh Kryqi yt<sup>12</sup> u gjet si peshore drejtësie: njëri zbriste në Hadh për shkak të peshës së blasfemisë, ndërsa tjetri lehtësohej nga shkeljet për njohje theologjike;<sup>11</sup> o Krisht Perëndi, lavdi më ty.

*Lavdi dhe Tani Kryqhyjlindësore*

**D**uke parë në Kryq qengjin,<sup>13</sup> barium<sup>14</sup> dhe Shpëtimtarin e botës,<sup>15</sup> lindësja thoshte e përlotur: Nga një anë kozmosi ngazëllohet duke pranuar çlirimin, nga ana tjetër shpirti im thellë flakërohet, kur po shikoj kryqëzimin që duron për hirin e të gjithëve, o Biri im dhe Perëndia im.

*Pas Odes VI Martirik*

**O** martirë të shenjtë, u bëtë udhëtarë të padevijueshëm nga rruga e ngushtë dhe e shtrënguar,<sup>16</sup> sepse duruat furtunën e ngasjeve, dhe ndërmorët jetesën e shërbyesve të patrup, dhe u treguat gur duri mi dhe themel shpresëtarie; ndërmjetoni pranë Krishtit Perëndi për shpirtat tanë.

## TË ENJTEN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë**Ndenjësore Apostolike Ting. Tërth. IV*

**I** bekuar je, o Krisht Perëndia ynë, që i

tregove peshkatarët të gjithur të duke u dërguar Shpirtin e Shenjtë,<sup>17</sup> dhe me anën e tyre rrjetove tërë botën, njeridashës, lavdi më ty.\*

*Varg:* Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

#### *Tin sofian që Logon*

T'i himnojme ndriçesit botëror,\*<sup>18</sup> nisjen për në shpëtimin tonë me hir\* si dhe udhëzuesit,\* të hyjnueshmit, Nxënësit\* e Perëndisë tonë, se lindën shkëlqim për ne\* që ishim brenda territ,<sup>19</sup> na vënë në dijeni\* gjithë neve Diellin e lavdit; dhe mposhtën\* mashtrimin e idhujve,\* predikuan Trininë fort\* një Hyjni pra,\* ndaj lutemi:\* Jepni ndjesë fajesh te sa\* me mall kremtojnë kujtimin\* tuaj hyjnor\*,\* o apostuj të Zotit Krisht, njeridashësit.

#### *Lavdi dhe Tani Hyjlindësore*

Gëzohu, ti që prite me anën e engjëllit gëzimin e botës;<sup>20</sup> gëzohu, ti që linde Bërësin dhe Zotin tënd; gëzohu, ti që u vlerësove të bëhesh nën' e Krishtit Perëndi.\*

#### *Pas Odes VI Martirik*

I kundërshtuat tiranët, o martirë, kur e kryet udhën<sup>21</sup> me burrëri, sepse, pasi i bëtë të vdekur trupat në tokë,<sup>22</sup> u shpërblyet me jetë qiellore, o shenjtore.

#### TË PREMTEN NË MËNGJESORE

##### *Pas Stihologjisë së parë*

##### *Ndenjësore Kryqësore Ting. Tërth. IV*

Në mes të Edenit, një dru<sup>23</sup> lulëzoi vdekjen;<sup>24</sup> në mes të dheut mbarë një dru nxori jetën; kur shijua nga i pari, megjithëse ishim të paprishshëm, u bëmë të prishshëm; ndërsa, kur morëm të dytin, e shijua fort paprishjen, sepse në Kryq ti shpëton si Perëndi gjininë e njerëzve.

*Varg:* Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë.

#### *To prostahthën mistikës*

Me dru, armiku më parë në Parajsë\*<sup>24a</sup> më zhveshi,<sup>25</sup> solli\* vdekje me shijim,<sup>24</sup> por solli\* një dru, Kryqi, rrob' jete\* te krejt njerëzia\* tekta përmbi dhë u ngul; bota mbarë pra\* u mbush tërë gaz; ndaj Kryqin, kur e shikojm'\* dhe i falemi, popuj, me besim, me një zë le t'i thërrasim Perëndisë Zot:\* Ti shtëpinë plot lavd e ke.<sup>26</sup>

#### *Lavdi dhe Tani Kryqhyjlindësore*

Të mishëruarin prej gjakut tënd të pastër,\* që nga ti lindi\* përmbi mendje, o e Thjeshtë,\* kur e shihje të varur\* mbi dru mes kusarësh,\*<sup>12</sup> ti kishe në kraharor shumë dhimbje, Vajz',\* me qarje thërrisje si nën':\* Vaj, Biri im!\* Ç'është kjo e pashprehshmjia dhe hyjnorja Ekonomi që ke? Ti ngjall krijimin tënd,\* e himnoj dhembshurin' tënde.

#### *Pas Odes VI Martirik*

##### *Ingjashëm*

Si ndalën vullte të zjarra me përmbajtjen,\* lëvizje vesesh,\* shën martirët e Jisuit\* morën hir të dëbojnë\* larg nga të sëmuret\* sëmundjet, siç bënin dhe kur jetonin pra,\* por edhe pas vdekjes – oh, sa çudi vërtet,\* paradoks! – po burojnë eshtrat krejt të zhveshura plot shërime. Lavd Krijuesit\* Zot, të vetmit të urtë<sup>26a</sup> mjaft.

#### TË PREMTEN NË MBRËMËSORE

##### *Në Thirroret pas Idhiomelit*

##### *Martirike Ting. Tërth. IV*

O martirë të Zotit, shenjtëroni çdo vend dhe shëroni çdo sëmundje; lutemi, dhe tani ndërmjetoni që të çlirohen shpirtat tanë nga kurthet e armikut.

O martirë të Zotit, përgjërojni Perëndisë tonë dhe kërkoni për shpirtat tanë



shumicë dhembshurish<sup>26b</sup> dhe zbutje për shkeljet e shumta, lutemi.

**O** Perëndi, martirët e tu, pasi i harruan gjërat e jetës dhe i shpërfillën torturat për hir të jetës së ardhshme, u bënë trashëgimtarë të saj, prandaj dhe ngazëllohen tok me engjëjt; me përgjërimet e tyre dhuroju popullit tënd përdëllimin e madh.<sup>7</sup>

**Në** ka ndonjë virtyt dhe në ka ndonjë lavdërim, këto u përkasin shenjtoreve, sepse i ulën qafat te shpata për ty<sup>26c</sup> që i ule qiejt dhe zbritë;<sup>27</sup> derdhën gjakun e tyre për ty që zbraze veten dhe more pamje shërbëtori;<sup>28</sup> u përlën deri në vdekje, duke imituar varfërinë tënde;<sup>29</sup> me lutjet e tyre, o Perëndi, mëshirona sipas shumicës së dhembshurive të tua.<sup>26b</sup>

Lavdi *Idhiomeli Nekrosim*,  
poezi e Joan Monakut.

**Q**aj e vajtoj kur shkoj ndër mend vdekjen, dhe shoh bukurinë tonë të formuar sipas ikonës së Perëndisë,<sup>30</sup> të shtrirë në varr, të shëmtuar, pa rëndësi, pa formë. O çudi! Ç'është ky mister që ndodh me ne? Si u dorëzuam prishjes dhe si u bashkuam me vdekjen? Me të vërtetë, siç është shkruar, sipas urdhrit të Perëndisë,<sup>24</sup> i cili u fal prehjen atyre që u ndanë prej nesh.\*

Tani *Hyjllindësore*

**M**bret' i qiejve u duk mbi dhe nga njeri-dashja dhe u shoqërua me njerëzit;<sup>31</sup> se, duke marrë trup prej Virgjëreshës së pastër, lindi prej saj me këtë mishërim; dhe është një bir i dypalëshëm nga natyra, por jo nga substanca; prandaj, duke e lëçitur Perëndi perfekte dhe njeri perfekt, me të vërtetë rrëfejme Krishtin, Perëndinë tonë; atij lutju, o nën' e Panusëruar, të mëshirohen shpirtat tanë.\*

## TË SHTUNËN NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë  
Ndenjësore Martirike Ting. Tërth. IV*

**U** treguat ndriçues mendorë, o martirë të shenjtë, sepse e asgjësuat mjegullën e mashtrimit përmes besimit, i hijeshuat llambat tuaja shpirtërore dhe me lavdi hytë tok me Dhëndrin në nusëroren<sup>5</sup> qiellore; dhe tani përgjërohuni që të shpëtohen shpirtat tanë, lutemi.

*Varg:* I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

*Tin sofian qe Logon*

**M**e besim martirik u treguat qart'\* si ndriçues në rruzull<sup>18</sup> ju përgjithnjë;\* te Zoti e varët fort\* gjithë shpresën,<sup>32</sup> shenjtore mbar',\* me vaj mendor të Shpirtit stolisët llambadhet<sup>5</sup> nur\* në shpirtin tuaj, ndaj dhe u shfaqët si kanë ju\* mendërisht në Kishë, athloforë të hyjshëm\* me famë plot, tërë lavd,\* edhe gjakrat i derdhnit çurg;\* o të urtë,\* të lumtur mjaft;\* ndërmjetoni të Zoti Krisht,\* të na dhurojë ky ndjesën\* e fajeve\* ne që bëjmë kujtimin tuaj të shenjt' me mall.

*Varg:* Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

*To prostathën mistikós*

**S**i ndalën vulltë të zjarrta me përmbajtjen,\* lëvizje vesesh,\* shën martirët e Jisuit\* morën hir të dëbojnë\* larg nga të sëmuret\* sëmundjet, siç bënin dhe kur jetonin pra,\* por edhe pas vdekjes – oh, sa çudi vërtet,\* paradoks! – po burojnë eshtrat krejt të zhveshura plot shërime. Lavd Krijuesit\* Zot, të vetmit të urtë<sup>26a</sup> mjaft.

Lavdi *Nekrosime*

**O** i vetmi Krijues, që i rregullon të gjitha me thellësi urtësie<sup>33</sup> dhe njeri-dashje, dhe

ua shpërndan të gjithëve atë që është në dobi të tyre, prehë, o Zot, shpirtrat e shërbëtorëve të tu, sepse shpresën e besuan të ti, Bërësi, Gatuesi dhe Perëndia ynë.<sup>32</sup>

#### Tani *Hyjlindësore*

Ty të kemi dhe mur, dhe liman, dhe ndërmjetuese që të pret mirë Perëndia që linde, o Hyjlindëse e panusëruar, shpëtimi i besimtarëve.

#### *Lavdërimi Martirike*

##### *Ting. Tërth. IV Ti imás kalësomen*

Çfarë mund t'ju quajm', shenjtorë, ne? Keruvime? Se u preh përmbi ju Krishti Perëndi.\*<sup>34</sup> Serafime? Se lëvduat pa pushim atë me himn.\*<sup>35</sup> Dhe engjëj? Se shpërfillët trupin, mishin pra.\* Dhe Forca? Se vepronë me çudi<sup>35a</sup> gjithnjë\* dhe kenë emra të shumtë ju,\* karizma fort të mëdha me hir,\* ndaj ndërmjetim\* bëni të shpëtohen shpirtrat tan'.

O shumic' martirësh, vërtet mjaft mir'\* e bët' garën<sup>21</sup> që jep çmime që nga Perëndia Zot,\* se duruat torturime\* të paudhësh, me guxim,\* dhe Krishtin e po-huat mu si Perëndi,\* tiranët arrogant' i turpëruat fort;\* tash pluhuri juaj na shëron\* dhe shpirtrat tanë, dhe trupat tok,\* si argument\* që jetuat siç do Zoti ju.

O martirë të pamposhtur të Zotit, që mundët mashtrimin nëpërmjet fuqisë së Kryqit me shpresë që të ngjallen në jetën e amshuar.<sup>35b</sup> nuk u frikësuar nga kërcënimet e tiranëve, dëfrenit kur po plagoseshit nga torturat; vetëm me prekjen e pluhurit shëroni shpirtin dhe trupin, si të gjallë, përkrahës të nxehtë të besimtarëve.

Kur e veshët mirë parzmoren e besimit<sup>36</sup> dhe e fortifikuat veten tuaj me shenjën e kryqit, u dalluat si ushtarë të fortë,<sup>37</sup>

i kundërshtuat tiranët burrërisht dhe e zhdukët mashtrimin e djallit; meqë u bëtë fitimtarë, u denjësuat për kurora; ndërmjetoni përgjithmonë për ne, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

#### Lavdi *Nekrosim*

Vdekja jote, o Zot, u bë shkak pavdekësie, se, po të mos viheshë në varr, nuk do të hapej Parajsa;<sup>38</sup> prandaj të shpërngulurit prehë si i dhembshur.

#### Tani *Hyjlindësor*

Streha jote, o Perëndilindëse, është klinikë shpirtërore, sepse, kur përikim në të, çlirohemi nga sëmundjet shpirtërore.

#### *Pasvargjet Nekrosime të Lavdërimeve, poezi e Theofanit.*

##### *Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu thávmatos*

Më firmose, si një mbret, çlirim, kur i ngjyrose, o Zot,\* gishtërinjtë e tu komplet\* me një ngjyrë gjaku pra,\* si me bojë të kuqe flak';\* radhiti tok me të parëlindurit\* dhe denjësoji – të përgjërohëm tash –\* që të arrijnë lart\* gazin e të drejtëve sa ikën larg,\* u shpërngulën me besim te ti, i dhembshur fort.

*Varg:* Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

Si njeri ke qenë kryepriift, si qengj<sup>13</sup> u there, dhe fli\* e ofrove tek Ati yt\* vdektarin që ke bler'\* ti prej prishjes; ndaj dhe rreshto\* si njeridashës krejt të shpërngulurit\* në vend të gjallësh,\*<sup>39</sup> ku derdhen dhe përrenj\* tërë shijim<sup>40</sup> dhe gaz,\* dhe gufojn' burime jete në amshim,\* jetëdhënës, Krishti im, i miri Shpëtimtar.

*Varg:* Dhe kujtimi i tyre do të jetë në gjeneratë dhe gjeneratë.

Vë kufi te jeta dhe parashikon të ardhmet



gjithnjë\* me urtinë e thellë mjaft\*<sup>33</sup> që s'rrefehet dot, zhvendos\* shërbëtorët e tu, ndaj dhe\* sa bri i more, në ujë prehjeje\*<sup>41</sup> radhiti dhe në shkëlqim shenjtorësh,<sup>42</sup> Zot,\* ku zë gëzimi ka\*<sup>43</sup> dhe himnim plot me lavdi, o Çlirimtar,\* lart në tjetrën jetë, Krisht, i miri Shpëtimtar.

#### Lavdi

Edhe pse je e padukshmja Fjalë, e njëqenshmja, o Krisht,\* tok me Atin, dhe je në fron\* tok me Shpirtin, ti je bër'\* krejt për mua njeri në mish;\*<sup>44</sup> si mëshir'plot njeridashës feksi nur\* sa u larguan nga jeta, shndriti fort,\* Zoti i jetës mbar',\* dhe me bukuri stolisi hijesisht,\*<sup>45</sup> cingëlloji, Çlirimtar, i miri Shpëtimtar.

#### Tani *Hyjlindësore*

Meqë zure, o Hyjlindëse, Fjalën e Atit Zot pra,\* pa pushim përgjërohu, lyp\* me guximin tënd nënor,\* shërbëtorët e tu, o Vajz',\* le t'i renditë me korin që nuk vdes,\* njësh me dëfryesit që të mburrin ty,\* ku shndritjet pa mbarim\* ekzistojn' me tingëllim të ëmbël fort\* të atij që po kremton,<sup>43</sup> bri Birit pa fillim.

#### CITIME

1. Lluk. 18.13
2. Lluk. 7.50; 8.48
3. Jak. 2.13
4. Ne. 13.22
5. Matth. 25.10
- 5a. Lluk. 7.37-38
6. Matth. 25.11-13

7. Num. 14.19 etj.
8. Vep. 3.15
9. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
10. Matth. 27.51
11. Lluk. 23.42
12. Matth. 27.38; Mark 15.27; Lluk. 23.33; Joan 19.18
13. Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32; I Petr. 1.19
14. Mark. 14.27; Joan 10.11,14; Hebr. 13.20; I Petr. 2.25
15. Joan 4.42; I Joan 4.14
16. Matth. 7.13-14; Lluk. 13.24
17. Joan 14.16; 15.26
18. Fil. 2.15
19. Is. 9.2; Matth. 4.16
20. Lluk. 1.28
21. II Tim. 4.7
22. Kol. 3.5
23. Gjen. 2.9
24. Gjen. 3.19
- 24a. Gjen. 3.3-6
25. Gjen. 3.7
26. Is. 6.1; Jez. 43.5; 44.4
- 26a. Rom. 14.26(16,27)
- 26b. Ps. 50(51).3; 68(69).17
- 26c. Fil. 1.29
27. II Mbret. [Sam.] 22.10; Ps. 17(18).10; 143(144).5
28. Fil. 2.7
29. Matth. 8.20
30. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
31. Baruh 3.38
32. Ps. 77(78).7
33. Rom. 11.33
34. II Mbret. [Sam.] 6.2; 22.11; IV [II] Mbret. 19.15; I Kron. 13.6; Ps. 79(80).2; 98(99).1; Is. 37.16; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 31
35. Is. 6.2-3
- 35a. Matth. 14.2; Mark 6.14; Gal. 3.5
- 35b. Tit. 1.2; 3.7
36. I Thes. 5.8
37. II Tim. 2.3
38. Gjen. 3.24
39. Ps. 114(115).9
40. Ps. 35(36).9
41. Ps. 22(23).2
42. Ps. 109(110).3
43. Ps. 41(42).5
44. I Tim. 3.16
45. Ps. 49(50).



#### Shtojcë

#### *Irmosi: Tin aneksihniaston*

»Të pagjurmësuarin plan perëndor që po mishërohet i larti Zot  
 »prej Virgjëreshës, Abakumi si profet e pa dhe tha me zë të madh:  
 »Zot i fuqishëm, lavdi më ty.\*

## KËNDIMET E DITËVE QË NUK PËRFSHIHEN NË KËTË TRIOD

**TË MËRKURËN E TË LIDHURIT TË DJATHIT:** Joel 2.12-26/ Joel 4.12-21

**TË PREMTEN E TË LIDHURIT TË DJATHIT:** Zah. 8.7-17/Zah. 8.19-23

**JAVA I:** TË MARTËN: Isaia 1.19-2.3/Gjen. 1.14-23/Fjalët e Urta 1.20-33

TË ENJTEN: Isaia 2.11-21/Gjen. 2.4-19/ Fjalët e Urta 3.1-18

**JAVA II:** TË HËNËN: Isaia 4.2-5.7/Gjen. 3.21-4.7/Fjalët e Urta 3.34-4.22

TË MARTËN: Isaia 5.7-16/Gjen. 4.8-15/Fjalët e Urta 5.1-15

TË ENJTEN: Isaia 6.1-12/Gjen. 5.1-24/Fjalët e Urta 6.3-20

**JAVA III:** TË HËNËN: Isaia 8.13-9.7/Gjen. 6.9-22/Fjalët e Urta 8.1-21

TË MARTËN: Isaia 9.9-10.4/Gjen. 7.1-5/Fjalët e Urta 8.32-9.18

TË ENJTEN: Isaia 11.10-12.2/Gjen. 7.11-8.3/Fjalët e Urta 10.1-22

**JAVA IV:** TË HËNËN: Isaia 14.24-32/Gjen. 8.21-9.7/Fjalët e Urta 11.19-12.6

TË MARTËN: Isaia 25.1-9/Gjen. 9.8-17/Fjalët e Urta 12.8-22

TË ENJTEN: Isaia 28.14-22/Gjen. 10.32-11.9/Fjalët e Urta 13.19-14.6

**JAVA V:** TË HËNËN: Isaia 37.33-38.6/Gjen. 13.12-18/Fjalët e Urta 14.27-15.4

TË MARTËN: Isaia 40.18-31/Gjen. 15.1-15/Fjalët e Urta 15.7-19

**PARA PALMAVE:** TË HËNËN: Isaia 48.17-49.4/Gjen. 27.1-14/Fjalët e Urta 19.16-25

TË MARTËN: Isaia 49.6-10/Gjen. 31.3-16/Fjalët e Urta 21.3-21

TË ENJTEN: Isaia 65.8-16/Gjen. 46.1-7/Fjalët e Urta 23.15-24.5



# PËRMBAJTJA

- E Diela e Fariseut dhe e Doganierit.....	5
- E Diela e Plangprishësit.....	12
- E Shtuna para të Lidhurit të Mishit.....	18
- E Diela e të Lidhurit të Mishit.....	28
- E Shtuna para të Lidhurit të Djathit.....	38
- E Diela e të Lidhurit të Djathit në Mbrëmësoren Kataniktike.....	49

## KRESHMA E MADHE DHE E SHENJTË

- Të Hënë e Javës I në Mëngjesore.....	58
në Mbrëmësore.....	64
në Pasdarkë.....	69
- Të Martën e Javës I në Pasdarkë.....	75
- Të Mërkurën e Javës I në Mëngjesore.....	82
në Mbrëmësore.....	86
në Pasdarkë.....	89
- Të Enjten e Javës I në Pasdarkë.....	96
- Të Premten e Javës I në Mëngjesore.....	102
në Mbrëmësore.....	107
- Të Shtunën e Javës I në Mëngjesore.....	113
- E Diela e Parë, e Orthodhoksisë në Mbrëmësoren e Vogël.....	122
në Mbrëmësoren e Madhe.....	123
në Mëngjesore.....	124
në Mbrëmësoren Kataniktike.....	131
- Të Mërkurën e Javës II në Mëngjesore.....	133
në Mbrëmësore.....	137
- Të Premten e Javës II në Mëngjesore.....	139
në Mbrëmësore.....	143
- Të Shtunën e Javës II	

në Mëngjesore.....	144
- E Diela e Dytë, e Shën Grigor Palamait	
në Mbrëmësore.....	149
në Mëngjesore.....	150
në Mbrëmësoren Kataniktike.....	155
- Të Mërkurën e Javës III	
në Mëngjesore.....	156
në Mbrëmësore.....	160
- Të Premten e Javës III	
në Mëngjesore.....	162
në Mbrëmësore.....	166
- Të Shtunën e Javës III	
në Mëngjesore.....	168
- E Diela e Tretë, e Faljes së Kryqit	
në Mbrëmësoren e Vogël.....	172
në Mbrëmësoren e Madhe.....	173
në Mëngjesore.....	175
në Mbrëmësoren Kataniktike.....	183
- Të Mërkurën e Javës IV	
në Mëngjesore.....	184
në Mbrëmësore.....	192
- Të Premten e Javës IV	
në Mëngjesore.....	195
në Mbrëmësore.....	203
- Të Shtunën e Javës IV	
në Mëngjesore.....	204
- E Diela e Katërt, e Shën Joanit të Shkallës	
në Mbrëmësore.....	209
në Mëngjesore.....	210
në Mbrëmësoren Kataniktike.....	216
- Të Mërkurën e Javës V	
në Mëngjesore.....	218
në Mbrëmësore.....	222
- Të Enjten e Kanunit të Madh	
a) Në Pasdarkën (e së mërkurës).....	227
b) Në Mëngjesoren (e së enjtes).....	228
në Mbrëmësore.....	251
- Të Premten e Javës V	



në Mëngjesore.....	254
në Mbrëmësore.....	258
- Të Shtunën e Himnit Akathist	
a) Himni Akathist në Pasdarkë.....	261
b) Himni Akathist në Mëngjesore.....	271
- E Diela e Javës V, e Shën Marisë Egjiptiane	
në Mbrëmësore.....	285
në Mëngjesore.....	286
në Mbrëmësoren Kataniktike.....	293
- Të Mërkurën para Palmave	
në Mëngjesore.....	294
në Mbrëmësore.....	299
- Të Premten para Palmave	
në Mëngjesore.....	302
në Mbrëmësore.....	306
në Pasdarkë.....	309
- Të Shtunën para Palmave, e Shën Lllazarit	
në Mëngjesore.....	315
- E Diela e Palmave	
në Mbrëmësoren e Vogël.....	322
në Mbrëmësoren e Madhe.....	323
në Mëngjesore.....	326
- Në të njëjtën ditë në Mbrëmësore.....	332
- Në Pasdarkë.....	333

## **HIMNE TRIADIKE DHE FOTAGOJIKËT sipas tingullit.....337**

### **VARGËZIME DHE NDEJËSORE sipas tingullit**

- Ting. I.....	340
- Ting. II.....	345
- Ting. III.....	350
- Ting. IV.....	355
- Ting. Tërth. I.....	360
- Ting. Tërth. II.....	365
- Ting. i Rëndë.....	370
- Ting. Tërth. IV.....	375